

A blue-tinted portrait of Lasgush Poradeci, a man with a beard and mustache, wearing a dark cap and a light-colored jacket. The text is overlaid on the image.

Lasgush Poradeci

KONFERENCË SHKENCORE
LASGUSH PORADECI
NË 120-VJETORIN E LINDJES

25 TETOR 2019



UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË

NË BASHKËPUNIM ME:

AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË
INSTITUTIN ALBANOLOGJIK TË PRISHTINËS
INSTITUTIN E GJUHËSISË DHE LETËRSISË, AKADEMIA E
STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, TIRANË
INSTITUTIN E TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Konferencë Shkencore Kombëtare

LASGUSH PORADECI

NË 120-VJETORIN E LINDJES

25 TETOR 2019

KOMITETI SHKENCOR

Akad. JANI THOMAI, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

Akad. FLORESHA DADO, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

Prof. dr. ALI JASHARI, Universiteti i Korçës

Prof. dr. HYSEN MATOSHI, Instituti Albanologjik, Prishtinë

Prof. dr. VALTER MEMISHA, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë

Prof. dr. SHABAN SINANI, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

Prof. dr. QEMAL MURATI, Instituti Albanologjik, Prishtinë

Prof. dr. SKENDER ASANI, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup

Prof. as. dr. JONELA SPAHO, Universiteti i Korçës

Dr. ERINDA PAPA, Universiteti i Korçës

Dr. ZEQRIRJA IBRAHIMI, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup

Dr. PANDI BELLO, Universiteti i Korçës

KOMITETI ORGANIZATOR I KONFERENCËS

Prof. as. dr. ELONA BIBA (ÇEÇE)

Prof. as. dr. DION TUSHI

Dr. ILIR SHYTA

PhD Cand. NELI NAÇO

PhD Cand. OLGIER BRAME (koordinatori i konferencës)

**KONFERENCË SHKENCORE KOMBËTARE:
“LASGUSH PORADECI NË 120-VJETORIN E LINDJES”**

25 TETOR 2019

Redaktoi: EFTIONA BYLYKBASHI

Përgatitja kompjuterike & kopertina: OLGER BRAME

© Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Botim elektronik

ISBN: 978-9928-4568-4-7

Korçë, 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

KRONIKË	8
MARIA LLAZAR GUSHO	
<i>FJALË PËRSHËNDETËSE</i>	9
JANI THOMAI	
<i>SEMANTIKË LEKSIKORE E SEMANTIKË POETIKE NË LIGJËRIMIN LASGUSHIAN</i>	16
QEMAL MURATI	
<i>LASGUSH PORADECI NË GJUHË</i>	25
VALTER MEMISHA	
<i>DUKURI TË KOHERENCËS LEKSIKORE NË FORMIMIN E FJALËVE NË LETËRKËMBIMIN E LASGUSH PORADECIT</i>	35
ISAK SHEMA	
<i>BISEDË MBRESËLËNËSE ME LASGUSH PORADECIN</i>	52
JONELA SPAHO	
<i>"KAMADEVA" - NJË SIMFONI E DASHURISË QIELLORE DHE TOKËSORE</i> ... 63	
VILMA PROKO (JAZEXHIU)	
ELVI PROKO	
<i>ÇËSHTJE TË LEKSIKUT TË POEZISË SË PËRKTHYER LASGUSHIANE</i>	74
DION TUSHI	
<i>ARTI DHE FILOZOFIA NË POEZINË LASGUSHIANE</i>	84
JONIDA CUNGU & ABDULLA BALLHYSA	
<i>POEZIA LASGUSHIANE SI VEPËR E ARTIT FIGURATIV</i>	90
MAJLINDA BUSHAJ	
<i>QARTËSIA E GJUHËS SHQIPE PËRMES FIGURSHMËRISË POETIKE NË PËRKTHIMET E LASGUSH PORADECIT</i>	96

ELONA BIBA (ÇEÇE)

POZICIONI I PJESËVE TË NËNRENDITURA PËRCAKTORE, KOHORE DHE SHKAKORE NË STRUKTURËN E VARGUT DHE POEZISË SI NJË VEÇORI E STILIT TË LASGUSH PORADECIT 120

LUAN TOPÇIU

LASGUSH PORADeci DHE LIGJËRIMI MODERN I POEZISË SHQIPE..... 127

MELIHATE ZEQIRI

LASGUSH PORADeci SI PËRKTHYES..... 135

RAKELA LUNIKU

PRURJE FJALËFORMUESE NË LIRIKËN LASGUSHIANE..... 149

NELI NAÇO

ETNIKJA SI FILLESË: PIKËVËSHTRIMI DHE VENDNDODHJA NË POEZINË "PORADeci" 159

MERITA GJOKUTAJ-SHEHU

TRINIA EKZISTENCIALE E JETËS, QIELLI, TOKA DHE NJERIU, NË POEZINË E LASGUSH PORADECIT..... 165

EMINE SHABANI

FILOZOFIA E POEZISË SË LASGUSH PORADECIT 170

LULJETA ADILI-ÇELIKU

MERAL SHEHABI-VESELI

FJALËFORMIMET PARASHTESORE DHE PRAPASHTESORE TE DISA POEZI TË LASGUSH PORADECIT..... 179

ETILDA KALIVAÇI

KLARA KODRA

MBI VLERAT STILISTIKORE TË LEKSIKUT DIALEKTOR DHE VETJAK TË LASGUSH PORADECIT 190

ERIS RUSI

RRETHRROTULLIMI EROTIK: LIRIZMI I IMAZHEVE NË POEZINË E LASGUSH PORADECIT 198

MELEQ SHOPI

ALMA BRAZHDA

LASGUSH PORADECI DHE VENDI I TIJ NË SHYTYPIN PERIODIK TË KOHËS
.....208

VALBONA SINANAJ

VEÇORI TË GJUHËS E TË STILIT NË VEPRËN POETIKE TË PORADECIT...213

PANDI BELLO

LASGUSHI DHE MUZIKA224

LABINOT BERISHA

VLERËSIMET TË LASGUSH PORADECIT PËR VEPRËN LETRARE TË FISHTËS
.....234

MATILDA PARLLAKU

TË PËRKTHESH SI LASGUSHI. KUR PËRFTESAT STILISTIKE RRAFSHOJNË
DALLIMET MES PËRKTHYESIT DHE AUTORIT.....244

MERAL SHEHABI-VESELI

LULJETA ADILI-ÇELIKU

KOMUNIKIMI LETRAR I LASGUSH PORADECIT NË POEZINË BALADË
BAZUAR NË TEORINË E LEXUESIT.....264

AFRIM A. REXHEPI

ESTETIKA E MARTIN HEIDEGGER-IT DHE POEZIA E LASGUSH PORADECIT
.....271

DONIKA BAKIU

HISTORIZMAT, HUAZIMET DHE NEOLOGJIZMAT NË DISA POEZI TË
LASGUSH PORADECIT279

SALI BYTYÇI

BEDRI ZYBERAJ

BOTIMI DHE STUDIMI I POEZISË SË LASGUSH PORADECIT NË KOSOVË 283

BESIM MUHADRI

STUDIMI I VEPRËS SË LASGUSH PORADECIT NË KOSOVË313

ERMELINDA KASHAH

E VEÇANTA E POEZISË SË LASGUSHIT324

MIMOZA ZEKAJ

MERITA ISARAJ

*VËZHGIME RRETH MJETEVE DHE MËNYRAVE TË NDRYSHME TË SINTAKSO-STILISTIKËS NË POEZITË E LASGUSH PORADECIT.....*330

EMIN AZEMI

*LASGUSHI POET, NJË LËVRUES SPECIFIK I KRITIKËS DHE PUBLICISTIKËS SHQIPTARË.....*340

ILIR SHYTA

*LASGUSH PORADeci NË FILMIN DOKUMENTAR*345

LAURANT BICA

*FILOZOFIA NË POEZINË E LASGUSH PORADECIT*353

RUDIAN ZEKTHI

*TEKNIKA POETIKE E VARFËRIMIT TË QËLLIMSHËM*372

KRONIKË

Në datën 25 tetor 2019, në Universitetin e Korçës, zhvilloi punimet Konferenca Shkencore Kombëtare: "Lasgush Poradeci në 120-vjetorin e lindjes", një bashkëpunim i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë së këtij universiteti me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Akademinë e Studimeve Albanologjike Tiranë, Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Në fjalën e hapjes rektori i UNIKO prof. dr. Ali Jashari theksoi se këtë tubim e bën më të veçantë pjesëmarrja e gjerë e profesorëve dhe studiuesve nga universitetet e Shqipërisë, profesorëve e studiuesve nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut, si dhe pranua e zuj. Marie Gusho, bija e poetit tonë të madh.

Zonja Marie Gusho falënderoi Universitetin e Korçës për këtë nderësim dhe nderim që iu bë babait të saj, si dhe solli për të pranishmit kujtime të familjes. Më pas rektori e nderoi zuj. Gusho me Certifikatën e Mirënjohjes me këtë motivacion: "Intelektuale dhe bijë e denjë e poetit tonë të madh e laudplotë Lasgush Poradecit, e cila ia ka kushtuar jetën e saj mbledhjes e nxjerrjes në dritë të gjithë trashëgimisë së shkruar të tij, që me zemërbardhësi e mendjehapje e ka vënë këtë pasuri të vyer në shërbim të studiuesve të rinj, në shenjë mirënjohjeje nga Universiteti "Fan S. Noli", në ditën e Konferencës Shkencore Kombëtare kushtuar Lasgush Poradecit me rastin e 120-vjetorit të lindjes".

Në seancën plenare të konferencës përshëndetën dhe referuan akademikë dhe studiues të njohur si: akad. Jani Thomai, prof. dr. Zemal Murati, prof. dr. Valter Memisha, prof. dr. Kristaq Jorgo etj.

Konferenca i vijoi punimet në tri sesione paralele ku u paraqitën nga studiuesit dhe profesorët e pranishëm rreth 60 punime mbi veprimtarinë e Lasgush Poradecit në fushën e letërsisë, gjuhësisë, përkthimit etj.

MARIA LLAZAR GUSHO

FJALË PËRSHËNDETËSE

Motra dhe vëllezër të nderuar,

Unë dhe motra ime Kostandina e ndiejmë për detyrë të falënderojmë të gjithë ata që u kujdesën dhe derdhen mund për këtë konferencë shkencore me rastin e 120-vjetorit të lindjes së babait tonë Lasgush Poradeci, si dhe mbarë mirëdashësit e pranishëm.

Babai im, Lasgushi Poradeci (pseudonimi letrar i Llazar Gushos, në një letër, që i dërgon të kushëririt të tij të parë në Amerikë, Gjokë Ndinkë Gushos, më datën 14 mars 1937, i tregon formimin e emrit Lasgush. **Lazar Sotir Gusho** = La+S+Gush = Lasgush dhe si mbiemër vuri mbiemrin e vendlindjes së tij), lindi më 27 dhjetor 1899 në Pogradec. I ati i Lasgushit, Sotir Gusho, kishte në Pogradec një dyqan dhe me punën e tij të ndershme dhe këmbëngulëse munda të rregullonte jetesën e familjes. Ai e donte shumë kulturën. Vinte nga një familje, origjina e së cilës është nga Rrëmenji (një fshat rrëzë Pogradecit i rrethuar me gështenja). Origjina imediate e Gushove të Rrëmenjit është origjinare nga Kolonja.

Lasgushi erdhi në Pogradec në fillim të shekullit. Lindi në njërën nga 200 shtëpitë e mbyllura në guackë malesh, përmes të cilave shkëlqen si perlë njëri nga liqenet më të bukur të botës. Pogradeci ishte diçka midis fshatit dhe qytetit.

Ai mbushi moshën shkollore, kur lëvizja për pavarësi ngjitej në kulmet e veta. Në këtë kohë në Pogradec kishte një shkollë fillore greke që ishte hapur me ndihmën e arsimdashësve pogradecarë.

Pak kohë pasi Lasgushi kishte filluar mësimet në shkollën greke, ajo u nda më dysh. Më 1908 rifilloi jetën shkolla shqipe. Ishte hera e dytë që hapej kjo shkollë në Pogradec në gjuhën shqipe pas mbylljes të shkollës së parë e hapur më 1886 (?).

Që në vogëli, Lasgushi shquhej për një zgjuarsiri të veçantë. Kishte fituar kështu simpatinë e gjithë fëmijëve moshatarë dhe të prindërve të tyre. Kështu tërhoqi pas vetes një pjesë të mirë të fëmijëve që vazhdonin shkollën greke. Dhaskali grek, me një fytyrë të kuqe, të ashpër, kur e mori vesh se Lasgushi do të kalonte në shkollën shqipe, e detyroi fëmijën të ulej në gjuhë, përdhe, e i ra disa herë me thupër në kokë. Me këtë veprim kishte për qëllim, t'i friksonte fëmijët e t'ua priste rrugën për në shkollën shqipe. Ai ishte shumë i vogël për të kundërshtuar. Po kjo ngjarje i la mbresë të fortë. I pajisur me zgjuarsiri, i ushqyer me atdhedashuri, e ndjeu veten shumë të prekur në sedrën

delikate të fëmijës. Nuk donte t'i tregonte të atit për fyerjen e rëndë që kish pësuar nga fytyrëkuqi i urryer. Po fëmijët e tjerë i treguan Sotir "shqiptarit". Ai u nis drejt e në shkollë i revoltuar keq, e mbërtheu për gryke dhaskalin e i tha: "Tradhtar i ndyrë, çfarë do gjuha greke tek ne?".

Sërisht shkolla shqipe e Pogradecit e pati jetën e shkurtër. Me mbylljen e saj më 1909, Lasgushi u nis për në Manastir (Bitola), ku u regjistrua në Liceun rumun, mbasi dha edhe një herë provimet e shkollës fillore që kish kryer në Pogradec, sepse drejtori i kësaj shkolle nuk i dha dëftesë si rezultat i zënkës së të atit me dhaskalin. Në Liceun rumun të Manastirit, Lasgushi do të mësonte gjuhët rumanisht, frëngjisht, latinisht, greqisht. Do të nxirrte me iniciativën e tij revistën e Liceut të titulluar prej tij "Ekciklopedika". Do të fillonte edhe vargëzimet e para në gjuhën rumune, ku është një poezi shumë e bukur të cilën e botoi në revistën e tij. Ajo titullohej "Ah, gjithçka është zero dhe asgjë!". Në Lice është dhe vargëzimi i tij i parë në gjuhën shqipe.

Me fillimin e Luftës së Parë Botërore më 1914, Liceu u mbyll dhe ai u kthye në Pogradec. Më 1915, Liceu u rihap dhe ai shkoi përsëri në Manastir. Më 1916, Liceu u mbyll përfundimisht dhe ai u kthye në Pogradec duke e lënë Liceun përgjysëm. Vazhdon të vizatojë. Ndër vizatimet e para janë portreti i motrës së tij Aspasia, i vëllait të tij Pandel, i miqve dhe shokëve.

Kishte filluar Lufta e Parë Botërore. Por, Sotiri nuk mund ta shihte djalin e tij pa shkollë. Në atë kohë vetëm Greqia nuk ishte përfshirë në luftën e përbotshme. Në vitin 1916 poeti nisët në Greqi për të përfunduar Liceun e lënë përgjysmë në Manastir.

Sapo mbërriti në Athinë u paraqit në konsullatën rumune. Princi Filidor, ministër fuqiplotë i Rumanisë në Athinë e ndihmoi për t'u regjistruar në LYCÉE LÉONIN (Saint-Denis) par les FRÉRES MARISTES. Në kapakun e librezës së shkollës, të vitit shkollor 1916-1917, ai ka shënuar: "U pranash me provime, në liceun frëng Leonin të Athinës, sekcia A Letra. Drejtor i Liceut, Père Louis-Marie. Në kohën e bllokimit të Greqisë i prisha dhe të hollat e fundit që ishin 17 frënga dhe rrojta 2 muaj me radhë dyke ngrënë nga 25 qindarka rrushka të zeza ditën. Pasi mbeta si mos më keq, iu luta Ministrit Filidor, i cili më dha pak të holla dhe pastaj më futi si kontabël në bankën "Jonian", ku u pranash me provim. Pas 6 muaj pune, më goditi oftika nga shkaku i urisë. U shtrova në Sanatoriumin "Sotiria" në një pyll me boriga dy orë larg Athinës. Më futi në sanator gratis, Madam Schliemann, gruaja e arkeologut të famshëm Heinri Schliemann të

Greqisë, bërësit të sbulimeve të mëdha në Trojë. Pranë madam Schliemann ndërhyri për mua me mirëdashje Princi Filidor”.

Në Sanatorium Lasgushi qëndroi 2 vjet, 1918-1920.

Nga fundi i 1921-së, erdhi në Poradec. Nëna e tij u mundua ta shërojë me barëra grash, veçanërisht me këlkozë (të bashkuar me mjaltë), të cilën e mblidhte Zylferica (një evgjitkë e fshatit) nëpër ugare. Nuk u shërua dot. Po klima e atdheut, i bëri mirë. U shëndosh mjaft. Por, poeti nuk mund të rrinte ashtu kot pa shkollë. U nis për në Vllahi (Rumani) tek i vëllai, i cili jetonte në një qytet malor shumë të bukur të quajtur Campulung dhe ishte martuar me një mësuese rumune. Zuri prapë të “shëndoshej”. Por, zemërgjërësia e të vëllait nuk vazhdoi shumë. Ai i tha se nuk mund ta ushqente.

Poeti në një letër që i shkruan atij i thotë:

“Ç’të bënja? Pasi u hoqa zvarrë, vendosa: mëgjithë sëmundën e gjoksit, ju përvësua punës: dhashë mësimë private nëpër shqiptarët e Bukureshtit (ne Zoti Basile Dogani, Kryekonsull i Shqipërisë, ne Zoti Pandeli Evangjeli, Kryetar i Parlamentit, (për të nipin), për vëllezërit Emanoil, Padronë të Kazinosë së Konstancës (për djalin dhe çupën). Më thërrisnin të gjithë, më tepër për ndihmë sesa për mësimë: me takt...; u bëra arkëtar i gazetës ‘Monitorul industriei române’; agjent shëtitës për pajtime i gazetës ‘Organul proprietarilor urbani’; hyra nëpunës (desenator) diurnist në Udhët e hekurta rumâne (Gara de Nord, Directiunea I regionalà, Biroul T (tehnic) II. Mirrja në muaj 600 Lei. Kjo shumë s’më mjaftonte. Më dhanë ndihmë veçanërisht, kolegu im Sandu (për të ngrënë, disa kohë, gratuitërisht në Kantinën e studentëve); Jorgu Steriu, proprietari i restorantit ‘Carpati’ (hëngra një muaj drekë e darkë pa të holla); Inxhineri Aqile Eftimiu (me të holla dhe me të ngrënë): ky më ftonte kur e kur për drekë; etc, etc.

Me gjithë mjerimin financiar, shëndetsor, nuk desha t’a le pa mbushur dëshirën e fundit të babajt: “*Llazari të mbarojë mësimet*”. Dhashë provimet për klasën VI, VII dhe VIII liceale: Mora bakalaureatën në Silistra (Sepse Ministria e Arsimit të Rumanisë nuk pranonte Klasën I të Lycée Leonin të Athinës) dhashë provimet e pranimit në Shkollën e Arteve të Bukura: u pranova drejt për drejt në vitin IV; dhashë provimet e pranimit në Universitet. U pranova në Fakultetin e letrave dhe të Filozofisë, ku vazhdova një vit; ndoqa dy vjet e ca Drejtesinë; disa kohë Teologjinë: u shkrojta në Konservatorin e Muzikës dhe të Artit dramatik. Nuk mbarova asnjë degë: nevoja e jetës, sëmunda, më shtrëngonin t’i këput studimet...

Në këto kohë të zeza për mua, nuk piva -siç i thonë- ujin e ëmbël (po të turbull) të Dàmbovicës: nuk e rumanizova shpirtin tim, me

fuqitë e mija të varfëra u mundova të ndihmoj për të ngritur emrin shqiptar, të përbuzur padrejtësisht prej të huajve: shkrojta këngë, vjersha, poezi, prozë... nëpër fletoret dhe të përkohshmet kombëtare - "Shqipërinë e Re" dhe në "Dodonën" e Kontancës, në "Djalërinë" e Vienës, në "Dielli" i Bostonit, në "Studentin shqiptar" të Torinos, në "Gazetën e Re" të Tiranës. Reproduktime të vjershave të mija pastaj shtypnë "Vullneti", "Ora", dhe "Arbëria" e Tiranës, "Zëri" dhe "Gazeta e Korçës", "Demokracia" e Gjirokastrës, "Në shekullin e Ri" i Durrësit, Gazeta shqiptare e Barit, etc.

Kolonija ndërhyri të më jepet një bursë. Në vjeshtën e 1924, Ministri i Arsimit, Dr. Stavro Vinjau, më emroj telegrafisht bursier të Shtetit në Berlin. I hypa trenit përnjeresh. Mbeta në Vjenë, pastaj ardhja në Graz. U shkrojta në Fakultetin e filozofisë. Me bursën m'u sigurua sado pak jeta-pas 7 vjetësh sfilitje. Ju thashë lamtumirë mjerimeve të Bukureshtit: Ju futa studimeve me gjithë zemër.

Fletoret e përmëndura tashi në sëmundjen time të fundit, shkrojtne artikulla mbi veprën time dhe mbi të mjerën jetën time. Enciklopedia e madhe gjermane "Brockhaus Konv. Lexikon", që filloj të shtypet në Leipzig më 1925, duke shkruar mbi literaturën shqiptare, nuk harron të shënojë dhe emrin tim të shkretë".

Një ditë poeti ndodhej në zyrat e Kolonisë dhe vjen Asdreni. Duke qeshur i thotë: "Po ku je mor Lasgush, shiko!"-dhe i tregon një telegram dërguar nga Shqipëria, nga qeveria e Nolit. Në të shkruhej: "Lasgush Poradeci emërohet bursist i shtetit në Berlin. Të studiojë albanologji". U gëzua shumë. Pas shumë vuajtjeve dhe vështirësive financiare që po kalonte në Bukuresht, iu hap një shpresë. U nis për në Berlin (Gjermani). Atje ishte mbyllur katedra e albanologjisë. I thanë se duhej të shkonte në Vienë (Austri). As në Vienë nuk kishte katedër albanologjie, ajo ishte vetëm në Universitetin e Grazit (Austri). U nis për në Graz. Edhe atje ishte e mbyllur. Kështu u regjistrua në Fakultetin e Filologjisë dhe Letrave, dega gjuhët romano-gjermanike.

Në Graz ndenji rreth 10 vjet. Universiteti i Grazit ishte më i madh se Universiteti i Vienës dhe Grazi quhej Qyteti i Studetëve. E zonja e shtëpisë quhej Elisabet Pichler. Ajo ishte vejushë dhe kishte tre fëmijë: dy djem, Karolin dhe Richardin dhe një vajzë, Elfridën. Banonin në një ndërtesë në rrugën Klosterëiesgasse nr. 74, në katin e parë. U shtrua disa herë për t'u kuruar në Sanatorin "Pichl-schloss" të Neumarktit i St. Sëmundjet bënë që herë pas here t'i shkëpuste studimet dhe të shtrohej në spital.

Vonesa e bursës shumë herë e bënte të ndodheshe edhe në vështirësi ekonomike. Por, qëllimi i tij ishte të mbaronte studimet dhe

për ta realizuar këtë nuk e trembte asgjë. Përballonte çdo situatë me durim, sepse Zoti nuk vonon kurrë të na shpërblejë për durimin tonë.

Ai u mrekullua nga ai vend aq i kulturuar, nga femrat austriake që sipas tij nuk ishin të bukura, por ishin nimfa. Nuk u martua në Austri, sepse siç thoshte dhe vetë “donte që këtë nder t’ia bënte një femre shqiptare”. Shumë vite më vonë kur e kam pyetur njëherë babain tim se çfarë dëshire do të kishte nëqoftëse do t’i jepej mundësia për të dalë jashtë shtetit, më ka thënë: “Dëshira e vetme është t’i vendos një tufë lule tek varri Zonjës Elisabet Pichler”. Në 25 shkurt 1932 Lasgushi kurorëzon studimet e tij me titullin Doktor në filologji në desertacionin me temë “Eminescu i injoruar dhe lidhja e tij me filozofinë popullore vëndase”.

Vetë poeti ka si leitmotiv: “Të kesh kulturë do të thotë të kesh lexuar”. Përvetësimi i disa gjuhëve të huaja bëri që ai të lexojë në origjinal kryeveprat e letërsisë botërore. Nëqoftëse pyesim çfarë lexoi, na duhet doemos të përgjigjemi: “s’la gjë pa lexuar” dhe nuk e teprojmë aspak. Ai pati një prirje të veçantë për gjuhët e huaja. Në moshë akoma të re zotëronte, me shkrim e me gojë, frëngjishten, rumanishten, greqishten e re, gjermanishten dhe italishten; me shkrim: anglishten, latinishten, greqishten e vjetër e rusishten. Për gjermanishten thoshte “Unë nuk di gjermanisht, unë e sundoj atë”.

Në 1 dhjetor 1934 Lasgushi emërohet profesor i vizatimit dhe bukurshkrimit në Liceun Shtetëror të Tiranës. Më 2 dhjetor 1935, me Dekret të Mbretit Zog I, emërohet profesor i gjuhës shqipe në Gjymnazin e Tiranës. Ai kishte një shtëpi shumë të vjetër (më tepër mund të quhej një karrakatinë sesa shtëpi) në Pogradec, trashëgim nga babaj i tij, të cilin e përdorte për të qëndruar vetëm muajt e verës së nxehtë të Tiranës. Fillimisht në Tiranë, ai qëndron në një shtëpi me qera, (rruga e Shallvares nr.34, tek vejusha Velika Çepunja). E më vonë vendos të ndërtojë një shtëpi.

Në vitin 1939 bleu tokën tek familjet tiranase dhe miku i tij arkitekti Anton Lufi i projekton një shtëpi sipas stilit gjerman. Në vitin 1939 martohet me Nafije Memën, një vajzë nga Durrësi, e cila atë vit kish mbaruar Institutin “Nana mbretëreshë”. Fillon jetën bashkëshortore me gruan e re dhe të bukur me të cilën jetoi plot 44 vjet duke ndarë bashkë me të, të gjitha vështirësitë e jetës. Ai ishte i “braktisur” pothuaj nga të gjithë miqtë e tij të ngushtë. “Braktisja” e tyre ishte një gjë e imponuar nga regjimi, sepse ata vazhdonin ta donin e ta adhuronin njëri-tjetrin njësoj si dikur.

Mungesën e miqve ai e ndiente shumë, por fati e kish përkëdhelur sepse gruaja e tij, Nafija, nuk e braktisi kurrë. Ajo ishte një

grua e mençur, e urtë, e ndershme që e donte poetin deri në adhurim. Ajo kishte pikërisht cilësitë që i pëlqenin atij aq shumë te vasha shqiptare. Ishte një mësuese metodiste e profesioniste e shkëlqyer që me punën e saj të palodhur mësoi breza të tërë nxënësish. Për punën e saj të vetmohuese, edhe pse meritonte më shumë, Kuvendi Popullor i kish dhënë asaj titullin “Mësuese e merituar”. Por duke qenë gruaja e Lasgushit ajo “paguante” edhe në një formë tjetër për cilësitë e saj. Atë e “zvogëlonte” fama e tij.

Regjimi komunist, pas ardhjes në fuqi, kishte shpallur de facto vdekjen e Lasgush Poradecit. Por edhe ai, antikonformisti më i madh, me heshtjen e tij e kish shpërfillur atë. Vazhdonte jetën njësoj. Ishte i bindur se e sotmja nuk ishte e tij, por e ardhmja plotësisht. Ai përmbushte destinin e caktuar nga Zoti dhe me siguri shumë herë është ngushëlluar me fjalët e Krishtit para kryqëzimit “Fali o Zot, se nuk dinë se ç’bëjnë!”. Mbas 16 vjet martesë, Zoti i fali dy vajza që sipas zakonit shqiptar ato trashëguan emrat e nënës dhe motrës së Lasgushit, Kostandina dhe Maria.

Mbas vitit 1944 regjimi komunist nuk i dha punë dhe dy-tre vitet e para ai jetoi vetëm me rrogën e gruas, e cila ishte mësuese në një nga shkollat e Tiranës.

Më vonë ai punoi si përkthyes i normuar në Ndërmarrjen e Botimeve “Naim Frashëri”. Paguhej me një rrogë mizerabile kundrejt normës që dorëzonte në Ndërmarrjen e Botimeve. Vazhdoi kështu deri në vitin 1974, vit kur e nxorrën në pension. Ishte 74 vjeç. Ai nuk mund të pranonte atë kur mbushi moshën 60 vjeç, sepse me pensionin qesharak nuk mund të ushqente as veten e tij, jo më dhe dy vajzat e vogla (njëra 5 vjeç dhe tjetra 2 vjeç).

Megjithëse ishte ndër të paktit shqiptarë që kishte marrë një diplomë në Austri, e cila i dha titullin “Doktor”, ky titull nuk iu njoh dhe nuk iu pagua asnjëherë.

I dha shqip, letërsisë sonë disa kryevepra të letërsisë botrore. Ai skalit në mermer dhe zgjedh edhe mermerin edhe daltën. E mendoni, të gjithë këto kryevepra duke kaluar në një numër vështirësish, ekonomike, shëndetësore, familjare. Kur nata binte e të gjithë flinin e kishte pak qetësi, ai ulej për të përkthyer normën.

Jeta e këtij poeti të anatemuar nga regjimi komunist nuk ishte aspak e lehtë. Vështirësitë ekonomike, sëmundjet dhe shëndeti i dobët, jeta e vështirë pa komoditet, mundimet e njëpasnjëshme për rritjen e dy fëmijëve të vegjël, dëshira për t’i shkolluar, nuk arrinin dot ta thyenin karakterin e tij.

Nuk jetonte dot pa Pogradecin e tij të dashur. Sapo vinte pranvera ai shkonte atje me gruan dhe fëmijët dhe qëndronte derisa vinte dimri, të shkelte dëborën e parë, për t'u kthyer përsëri në Tiranë. Kur makina fillonte zbriste Qafën e Thanës dhe dukej pamja madhështore e liqenit, ai thoshte: “Këtu fillon bukuria! Që tani e ndjej si më skuqen faqet nga shëndeti!”. Në qytetin e tij e nderonin të gjithë. “Ardhe zoti Llazar, na zbukurove mëhallën!” Zoti Llazar, në një kohë kur gjithandej dëgjohej vetëm fjala shok. Shëtijtjet e tij vetëm edhe me familjen nëpër Najazmë, Qoshk, Lumi i Trahanit, Çezma e Paput, Katjel. Poeti tregon: “Shkoj me familjen time larg njerëzve, sepse atje flasim me Perëndinë”.

Mbas viteve '80, shëndeti i tij ishte dobësuar mjaft. Në fillim ischemia cerebrale e vitit 1982, pastaj më 3 gusht 1983, i vdiq gruaja që kish qenë shoqja e tij më e afërt për 44 vjet. Më 18 shtator 1986, vdiq Cuci, konia e tij e dashur dhe shoku i tij besnik për 13 vjet. Ishte data 19 tetor e vitit 1987, mbasdite. Duke shtëtitur nëpër shtëpi ndjeu lodhje dhe u shtri. Dy vajzat ishin pranë tij si gjithmonë. Ishte 88 vjeç. Kishte 70 vjet që luftonte me vdekjen. Por, ai trupi i tij i pakët i gatuar me mish e gjak fisniku, gjithmonë e kishte mundur atë. Por, edhe në këtë ndeshje që me sa dukej ishte finale, ai e dinte që përsëri do të dilte fitimtar. Nuk e kishte frikë atë. Ai ishte i pavdekshëm. Fjalët e fundit qenë: “*Kostandinë, bijë e babkës, edhe po të vdes, trupin tim të vdekur ta shpini në Poradec. Po a ke lekë ti bijë e babkës ta shpjesh trupin tim të vdekur atje?!?*”

Vdiq në shtëpinë e Tiranës më 12 nëntor 1987, e enjte, ora 15.32'. Atë natë sipas zakonit shqiptar qëndroi në shtëpinë e tij. Ditën tjetër, në orën 10 u bënë homazhe në Lidhjen e Shkrimtarëve deri në orën 12. Pastaj trupi i tij u çua në morg të spitalit të Tiranës. Ditën e shtunë në orën 12 u varros sipas amanetit të tij në Pogradec. Kishte dalë për ta përcjellë i gjithë qyteti.

JANI THOMAI

SEMANTIKË LEKSIKORE E SEMANTIKË POETIKE NË LIGJËRIMIN LASGUSHIAN

Për këtë temë kam mbajtur një referat në sesionin shkencor “Vepra e Lasgush Poradecit” në Institutin Oriental të Napolit në vitin 2000. Atje kam theksuar, ndër të tjera, se, që nga vitet ‘30 të shekullit të kaluar janë botuar shumë shkrime për krijimtarinë poetike të Lasgushit, nga autorë të shquar; lista për ta është e gjatë, por le të përmendim Eqrem Çabejn, Mitrush Kutelin, Vehbi Balën, Fatos Arapin, Ismail Kadarenë, Rexhep Qosjen, Muzafer Xhaxhiun, Rexhep Ismajlin, Sabri Hamitin, Klara Kodrën e studiues të tjerë, prestigji shkencor i të cilëve përputhet cilësisht me prestigjin e poetit Lasgush. Të gjithë njëzëshëm e vlerësojnë Lasgushin si poet i madh në radhën e parë të poetëve të mëdhenj shqiptarë. Megjithatë, në studimin e krijimtarisë së tij poetike, veçanërisht në aspektin semiologjik e semasiologjik, ka ende zbrazëti. Ligjërimin poetik të Lasgushit natyrshëm duhet ta vështrojmë edhe nga ana e simbolikës dhe e estetikës gjuhësore. Në këtë tipar të komunikimit letrar ai është pa dyshim poet i thellë e me shije të hollë. E peshën kryesore në stilemat poetike e mbartin fjalët. “Zgjedhja e fjalëve, – shkruan Mitrush Kuteli, – kalitja dhe radhitja e tyre... pasqyrojnë shkallën e ndiesisë artistike të një shkrimtari. Këtë ndjenjë Lasgushi e ka të zhvilluar në shkallë të naltë” (6/9).

Nga leximi linguistik dhe estetik i tekstit letrar zbulohet, ndër të tjera, një lidhje e fortë ndërmjet semantikës leksikore e semantikës poetike. Nuk është e veçantë vetë prania e kësaj lidhjeje as këtu e as në një vepër tjetër letrare ose në gjithë krijimtarinë letrare të një autori. I veçantë është sendërtimi i tij në ligjërimin poetik, mjetet që përzgjedh dhe mënyrat si i përdor autori, tipologjia e zhvillimeve semantike, fushat a klasat leksikore që aktivizohen më shumë, ndërthurjet e domehtënieve horizontale e pingule në tekst dhe pesha e vlerave gjuhësore e letrare e mjeteve të shprehjes në semantikën e gjithë tekstit. Duke u nisur nga këto përshenja, mund të interpretohet edhe ligjërimi lasgushian në tekstin e vet letrar e prej këtej mund të veçojmë disa karakteristika të këtij ligjërimi, i cili quhet “lasgushian”, por gjithsesi i

pashkëputur nga ligjërimi poetik në përgjithësi dhe nga ligjërimi poetik i traditës e i kohës së poetit.

Një e dhënë tjetër e njohur dhe e pranuar në procedurat e analizës është dallimi ndërmjet njësisë semantike të rrafshit gjuhësor dhe njësisë semantike të rrafshit letrar. Dihet që bazat e tyre janë të njëjta: janë tropet (figurat) e njëjta gjuhësore e letrare (krahasimi, metafora, metonimia, sinekdoka, hiperbola etj.), që shërbejnë si pikënisje e motive të lëvizjeve semantike në të dyja rrafshet dhe që rëndom përmenden në komentin letrar. Nuk ka kufi krejt të prerë ndërmjet dy rrafsheve të semantikës, sepse ka raste kalimtare ose lëvizje të pandërprera nga semantika letrare drejt semantikës leksikore e anasjellas. E kjo lëvizje te Lasgushi është shumë e gjallë. Tek ai, edhe tipare të tilla, si shkalla e lartë e ngjyrimit subjektiv, që shoqërohet me nuanca të forta (e shumë herë vetjake) emocionuese e shprehëse, funksioni estetik i theksuar, kufizimi i fushës së përdorimit vetëm në rrafshin letrar ose, madje, vetëm në krijimtarinë e vet, – mëvetësi artistike që sjell ndarje të dallueshme me ligjërimin e përgjithshëm, – e ndonjë tipar tjetër, janë cilësi të dukshme për shumë njësi të semantikës poetike. Lëvizjet drejt semantikës gjuhësore do të shoqëroheshin me humbjen a me zbehjen e këtyre tipareve.

Pas këtyre të dhënave paraprake mund t'i drejtohem më konkretisht poezisë së Lasgush Poradecit. Për shkak të hapësirave të kufizuara, do të ndalem shkurt vetëm në tri çështje: 1) Ç'mjete leksikore vë në punë poeti për të sendërtuar sistemin e vet të semantikës poetike; 2) cila është tipologjia e semantikës poetike dhe ç'lidhje ka me semantikën leksikore si sendërtim estetik; 3) cila është e veçanta e ligjërimin lasgushian në këto aspekte (motivet e afrimit e të largimit me rrjedhën poetike të kohës). Këtë të veçantë do të përpiqem ta nxjerr gjatë shtjellimit të dy çështjeve të para.

1. *Çështja e parë*: Në formacionin linguistiko-poetik të Lasgush Poradecit marrin pjesë tri komponente: ligjërimi popullor, ai naimian e komponentja vetjake.

Në lirikat e tij ndeshim vargje popullore të përpunuara e të stilizuara, me një fjalor mjaft të begatshëm popullor e me burim shqip (mjafton të përmendim te “*Kroi i fshatit tonë*”, fjalët *sylynjarë*, *cipëzën*, *ngaj mali*,

ose krahasimet *gushën si zambaku, buzët si burbuqe* etj.). Eqrem Çabej shkruan: “Me fjalë e mënyra foljesh fare të thjeshta, shumë herë popullore, arrin të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirinthike, idetë më të larta” (3/3). Komponentja naimiane është e pranishme edhe si kategori gjuhësore estetike. “Naimi, – shkruan Fatos Arapi, – është nga poetët e paktë tanët, për të mos thënë i vetmi, që ka pasuruar arsenalin shpirtëror e ideor të Lasgush Poradecit” (1/141). Komponentja naimiane në krijimtarinë poetike të Lasgushit e vë atë në të njëjtin rrafsh krahasues me poetin kombëtar Naim Frashëri, por me identitet vetjak të papërsëritshëm. Sikurse Naimi, Lasgushi dallohet për gjerësinë e disa shtresave leksikore, si emërtimet e trupave qiellorë, e sendeve dhe e dukurive të natyrës (*qiell, yll, dhe, erë, veri, borë, shi, ylber* etj.), emërtimet e bimësisë, sidomos të luleve (*zambak, trëndafil, trëndelinë, borzilok, jargavan, lule* etj.). Shtresa e dytë është karakteristike edhe për poezinë liriko-erotike popullore shqiptare e orientale. Sikurse Naimi, Lasgushi përdor shumë fjalë “të buta”, d.m.th. me tingëllim të këndshëm e me ngjyrim përkëdhelie e dashurie (*lozonjare, trimush, mjerush, vogëloshe, bukuroshe, pleqërishte* etj.). Kuptohet që është poezia erotike e para, e cila kërkon fjalë me ngjyime të tilla, por është edhe *shpirti i butë i poetit* që i pëlqen ato. Sikurse te Naimi, edhe te Lasgushi zotërojnë fjalët me ngjyrim emocionues pozitiv, ka fare pak fjalë me ngjyrim emocionues negativ. Mirëpo ata të dy dallohen qartazi nga seria e fjalëve kyçe, d.m.th. e fjalëve që organizojnë semantikiisht tekstin poetik: Te Naimi zotërojnë fjalët kyçe *perëndi, njerëzi, mirësi, gjithësi* etj., d.m.th. fjalë abstrakte me kuptim të gjerë përfshirës, kurse te Lasgushi fjalët *shpirt, zemër, dashuri, yll* etj., pra, emërtime realiesh si vatra simbolike ndjenjësore që mundësojnë zhvillimin e kuptimeve të figurshme të këto emërtime. Dihet që fjalët kyçe nuk dallohen aq nga denduria e përdorimit, por ngaqë ato mbartin peshën kryesore të mendimit poetik të autorit. Ky korpus, sado i vogël, i fjalëve kyçe (fjalë konkrete në rrafsh të figurshëm) mund të jetë një element që tregon natyrën më konkrete e më tokësore të shprehjes së ndjenjave të poezia e Lasgushit, si të thuash, “sendësinë” e perceptimit poetik. Por, edhe më gjerë, leksiku lasgushian në tërësi përmban më shumë fjalë me kuptim

konkret të figurativizueshëm, kurse leksiku naimian ka më shumë fjalë me kuptim *abstrakt*.

Po ashtu, komponentja semantike vetjake, përfshirë këtu edhe në fjalëkrijimet vetjake, në strukturën linguistiko-estetike të krijimtarisë poetike të Lasgush Poradeci, përpjesëtimisht me vëllimin e krijimtarisë, është shumë më e gjerë dhe shumë më e larmishme se te Naim Frashëri. Me përmasat që ka, ajo e dallon poetin në mënyrë të dukshme dhe përbën veçanti të ligjërimit lasgushian. Mitrush Kuteli, që më 1937, shkruante: “Përmjet fjalorit Lasgushi shquhet haptazi nga gjithë poetët e tjerë të shqipes. Lasgushi ka një fjalor të tijnë, një fjalor të cilit dal-nga-dal do stërvitemi t’i themi *lasgushian*” (6/10). Përfshirë këtë “fjalor të tijnë”, së bashku me mjete të tjera të shprehjes, është e përligjur madje “t’i themi *lasgushian*” gjithë ligjërimit të tij poetik.

Këtë “*fjalor lasgushian*” e përbëjnë kryesisht tri klasa leksiko-semantike:

a) Fjalët e reja të krijuara prej tij me ndajshtesa e me përbërje, sipas frymës, mjeteve e strukturës së gjuhës shqipe; p.sh. “Mes trimërisht *stërgjyshërishte* / Të shoh ndaj po m’i bje xhurasë” (“*Naimit*”); “Vijnë vashat *valle-valle* / Gush’e gjë stolisura” (“*Vallja e luleve*”); *vraparak, vjeshtarak, lotak, i shkrepëtimtë, vetëtimtare, paemërsi* “anonimat”, *i paemërshëm* “anonim”, *jashtërendësisht* “jashtëzakonisht” etj. Edhe disa krijime, që duken në lexim të parë si të çuditshme (si: “Në qiell, që mendjen ty ta *qiellëzon*, / Në diellë, me mendjen që ta *djellëson*, / Në botë, mendjen që ta *botëson*” – “*Përjetësia*”), kanë në semantikën poetike ngjyresë funksionale të përligjur. Autori krijues, së paku, nuk do që nga emërtimi i sendit të shkëputë veprimin a tiparin e tij, çka e bën tekstin të njënjëshëm gjuhësisht dhe siguron kontinuitetin e tingëllimit poetik në rrjedhën e ligjërimit, pra, ruan kompaktësinë e tekstit me lidhjet derivuese gjuhësore, siç vepron edhe në raste të tjera: *i paemërshëm / paemërsi, stërgjyshëror / stërgjyshërisht, i përrallshëm / përrallor* etj., ose siç lidh me fjalën *yll* titujt e dy vëllimeve të para (“*Vallja e Yjeve*” 1933 e “*Ylli i zemrës*” 1937) të trilogjisë së papërmbyllur poetike.

b) Lasgushi ka prirjen të përdorë sa më shumë mjete leksiko-semantike të pakonsumuara, që gjallojnë në gjuhë a që i krijon vetë, kryesisht të

botës së ndjenjave. Prandaj parapëlqen *i përrallshëm* në vend të *përrallor* (pas shumë vjetësh, te “*Mbi ta*”, e përdor këtë mbiemër: “Drini plak e *përrallor*”), *mjerush* për *mjeran* ose për *i mjerë*, *parëverak* për *pranëveror* a *prëndveror* (te përkthimi “*Vjersha dhe ballada*” të R. Bërnsit e gjejmë *pranverak*), *stërgjyshërishte* për *stërgjyshor* etj. Te poeti kjo është një prirje, që do të mjaftonte edhe e vetme për të identifikuar “ligjërimin lasgushian”.

c) Njësitë leksiko-sintaksore me strukturë të mbyllur, të përbëra me bashkërenditje kryesisht kopulative 2-3 gjymtyrësh kuptimisht asnjënëse dhe një gjymtyrë bashkuese e me mundësi poetizuese, duke formuar kështu një njësi shenjuese me dy vlera e funksione: si njësi gjuhësore emërtuese e kompaktësuar formalisht e me kuptim të kondensuar dhe si njësi me semantikë e funksion poetik. Përdorimi i këtij mekanizmi njëfjalësimi te Lasgushi nuk është i rastit, por prirje e rregulsi në krijimin e njësive me semantikë gjuhësore e poetike njëherazi; p.sh. “*Gjimburuara si krua, / Shtat-lëkundura-pallua*” (“*Vate prilli*”); “*Kur m’u rite vogëloshe, / Vogëlo si flutura, / Mes-hollë-këputura*” (“*Kur m’u rite vogëloshe*”); “*Ta shoh me sy prej vetëtime / Sy-vështrimderdhurën përdhe*” (“*Oh, vanë fletët*”); “*Mbledhur shoqet në një qoshe, / Diç m’ju flisje, diç m’ju thoshe. / Gushë-e-llërë-e-gji-bardhoshe*” (“*Kush të fali bukurinë*”); *qipallë-dendur-përprjetë; mall-i-djegurdurim-plotë* etj. Mënyra e përdorimit të tyre nga Lasgushi sjell një përtëritje të shprehjes e kjo fiton gjallëri e ngjyresë të re.

2. *Çështja e dytë*: Zhvillimet semantike të natyrës gjuhësore dhe estetike janë një përbërëse e fuqishme si për rrafshin e shprehjes, ashtu edhe për rrafshin e përmbajtjes në poezitë e Lasgush Poradecit. Deri më sot kjo përbërëse nuk është studiuar thujse fare, megjithëse, siç më duket, ajo është palca stilistike kryesore e ligjërimin lasgushian.

Te Lasgushi gjejmë *tri shkallë të zhvillimeve semantike leksikore dhe estetike*:

Shkalla e parë: Zhvillime semantike të mirëfillta leksikore, popullore ose me shtrirje të gjerë; p.sh. “*O këngë pleqërishte! / Ti vjershë e shpirtit tem!*” (“*Këngë pleqërishte*”); “*E pastaj le të venitem, le të hesht e le të vdes*” (“*Ti po vjen që prej së largu*”); “*Do të tretem të kullohem në kalim të këmbës sate*” (“*Ti po vjen që prej së largu*”); “*Ku këndon*

bilbil' i kombit, / *Grifsh*' e huaj çirret pas" ("*Naimit*"); Kur zbrite n'atë terr / Të zemrës sime, / Që rridhte vaj e vrer / E shërëmtime" ("*Kamadeva*"); "O gjuhë e shenjtëruar, o mall me shpirtin plot. / O vetëtim' e qiellit që fërfëllon me flakë" ("*Gjuha e zjarrtë*"); "Po vjen malli të më ndezë / Zjarr në zemër, zjarr në ball" ("*Rri mbështetem në tryezë*"); "Dënimi im nis e m'i lag / Frëngjitë e shpirtit varfanjak" ("*Lundra dhe flamuri*"): yll i vjershërisë; deti *margaritar*; shqiponjë e *arratisur* etj. Figurshmëria e kuptimeve, e arritur me prejardhje semantike, si te *venitem*, *tretem*, *kullohem*, *yll*, *bilbil*, *grifshë*, *terr*, *vetëtimë*, *zjarr*, *det* etj., del gjithashtu si prirje e qëndrueshme, e vetëmjaftueshme për të identifikuar ligjërimin lasgushian. Është e njëjta dukuri në semantikën e ligjërimin popullor, kur tipare të spikatura të realieve përbëjnë motivin e lëvizjeve drejt kuptimeve të figurshme në emërtimet e tyre.

Shkalla e dytë: Zhvillime semantike të veçanta, të përdorura me funksione estetike. Këto arrihen me përdorime të figurshme të fjalëve nëpërmjet (po e quajmë) "alternimit semantik" të fjalëve të së njëjtës fushë, të zgjedhura sipas rendit të prejardhjes semantike ose sipas mundësisë së lidhjeve të sinonimisë a të antonimisë gjuhësore. Ato shprehin aftësinë kombinuëse të poetit dhe ngrenë mëtimin estetik të krijimit letrar. Po interpretoj këtu një krahasim shembujsh: "Kur del mi male yll'i ditës / E *shuhet* nata prapa tij" ("*Shpirtit*") dhe: "Fli, shpirt, edhe fli. Zemërore / Po *dirgjet* dhe nata ngadalë" ("*Gjumi i shpirtit*"). Është fjala për agimin dhe për muzgun, që kanë të përbashkët ndriçimin e zbehtë. Mirëpo estetikisht, simbolikisht, janë të kundërt të njëritjetrit. Pra, Lasgushi përdor *shuhet* nata / *dirgjet* nata, me kuptim të kundërt në rrafshin gjuhësor *iku* (*u tret*) nata dhe *ra* (*zbriti*) nata, porse dihet që folja *dirgjem* ka, veç kuptimit "zdirgjem, zbres, ulem, bie", edhe kuptimin "shkrihet, tretet" (*dëbora* dhe, në rrafsh të figurshëm, *errësira*). Përdorimi (i supozuar) i fjalës *dirgjet* në këtë kuptim të dytë ("shkrihet, tretet"), përkrah fjalës *shuhet*, d.m.th. si sinonim i saj, nuk do të kishte stilistikisht të njëjtën forcë. E përsëritim që ky "alternim" (d.m.th. ndërkëmbimi i foljeve *shuhet* e *dirgjet* dhe zgjedhja e lidhjeve të tyre antonimike e jo sinonimike) nga mundësia që jep fusha semantike e polisemisë së fjalëve, bëhet vetëm për funksione estetike në

poezi. Kështu Lasgushi, si këtu edhe në raste të tjera, ndërthur semantikën leksikore me semantikën poetike. Këto kombinime origjinale semantikash zënë vend të madh në poezinë e Lasgushit. Dhe aftësia kombinuese nuk mund të kuptohet pa njohjen e gjuhës në rrafshin e dytë. Vëreni si shprehet poeti: “E si fjalës *së palosur* / M’i hap kindën e një pale; ... Po nga mërgimi zemërak / Të pres me *mardhje* të më vish” (“*Të ritë e viteve të mi*”); “Nëpër mal e nër lëndina, / *Shkrum* i natës që po bi”e (“*Poradeci*”); “Dashuri! Heu! Mall i ri! / Dashuri! *Këng’e* durimit! / Ti liri, liri! Ti robëri! / Ti *valim* i shkreptimit!” (“*Vallja e yjeve*”); “Se prapa lë vazhdën e ndritur / Q’ë hapa me shpirtin *fatos*” (“*Gjeniu i anijes*”); “Drini *plak* e i *përrallshëm* po mburon prej Shëndnaumi” (“*Poradeci*”); “Gjersa gjumi të më zërë, / ... Syri i *urtë* si mëshqerrë” (“*Balladë*”); djalëri *këng’e* shëndetit; *afshi* i gjallë i jetës; *verb* i Perëndisë; *lajmës* qiellor; *vallja* e luleve etj. Kategoria semantike e estetike në kuptimet e figurshme të fjalëve, si: *e palosur*, *mardhje*, *shkrum*, *këngë*, *valim*, *fatos*, *plak*, *i përrallshëm*, *i urtë*, *afsh*, *lajmës*, *valle* është shumë e pasur në poezitë e Lasgushit dhe përbën një dukuri të veçantisë ligjërimore e poetike.

Shkalla e tretë: Zhvillime semantike të veçanta së bashku me formime fjalësh të reja, të përdorura poetikisht. Formimet ndajshesore hyjnë në tipet e njohura të shqipes, por si fjalë janë krijime vetjake lasgushiane (siç u përmendën më lart: *qiellëzon*, *diellëson*, *botëson*, *vraparak*, *mjerush*, *vetëtimtare* etj.), kurse formimet leksiko-sintaksore të tipit analitiko-sintetik, që nuk i gjejmë te Naimi dhe që shumë rrallë ndeshen te Fan Noli, janë karakteristike të ligjërimin lasgushian, krejt origjinale, si nga ndërtimi, ashtu edhe nga kuptimi (siç u përmendën më parë: *shtat-lëkundura-pallua*, *mes-hollë-këputura*, *sy-vështrim-derdhurën*, *gushë-e-llërë-e-gji-bardhoshe*, *qipallë-dendur-përperjetë* etj.). Është e ditur që çdo fjalë e re, e krijuar me mënyra e mjete të ndryshme, mbart edhe një kuptim të ri. Funkzioni i krijimeve të tilla këtu është gjithashtu estetik, pra, semantika poetike zotëron mbi semantikën leksikore, por e mbështetur te kjo. Originaliteti lasgushian nuk qëndron vetëm te ndërtimi e kuptimi i tyre, por edhe te prirja për sintetizëm dhe mënyra artistike e integritit në vargje.

Edhe këto kategori leksikore e semantike ndikojnë në shkallën e

figurshmërisë e të simbolikës së tekstit poetik. Kështu, teksti poetik i Naimit ka më shumë domethënie horizontale, – kuptim të drejtpërdrejtë (qoftë edhe abstrakt), – prandaj është më i thjeshtë e më i lehtë për t’u kuptuar; teksti poetik i Lasgushit ka më shumë domethënie pingule, është më i figurshëm, më simbolik, prandaj në disa raste është më e vështirë për t’u receiptuar poetika e tij.

Do të shtojmë që krijimtaria gjuhësore – poetike origjinale në rrafshin e formës e të përmbajtjes e dallon ligjërimin poetik të Lasgushit nga poetë të tjerë, por gjithsesi hyn në rrjedhën e ligjërimin popullor të Jugut, sidomos të së folmes juglindore e, më ngushtë, të Pogradecit. I referohem përsëri Mitrush Kutelit, i cili thotë se jo vetëm modelet fjalëformuese, por edhe “përfytyrimet e metaforat, si edhe simbolet, kanë pra një rrënjë shqiptare, një burim shqiptar”. Këto dhe nyja të tjera të rjetit të semantikës poetike e dallojnë qartazi ligjërimin lasgushian, gjithësesi si një sistem i organizuar sipas identitetit artistik të poetit. Lasgushi pati mënyrën e vet të konceptimit poetik, identiteti i tij krijues u shpreh edhe në strukturimin e mendimit e në ndërtimin e figurës artistike, ai shfrytëzoi me mjeshtëri edhe poezinë më të mirë të Rilindjes e poezinë popullore, duke e rivalorizuar fjalën shqipe brenda sistemit të vet të mjeteve të shprehjes artistike. Kjo është forca e bukuria e këtij ligjërimi, që e mbush me aq emocion edhe thirrjen e Eqrem Çabejt: “Kush nuk mundet nga magjia e kësaj gjuhe? Djalëri shqiptare, këndo Lasgush Poradecin, pastaj vdis!” (3/3).

Literaturë

Arapi, F., *Shënime mbi lirikën e Lasgush Poradecit*, në “Studime filologjike”, 1978/4.

Bala, V., *Me gjuhën e ëmbël e të begatë shqipe*, në “Nëntori”, 1980, 7.

Çabej, E., *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit*, në “Gazeta e re”, 1929, 22 shkurt.

Jasiqi, A., *Poezia popullore dhe lirika e Lasgush Poradecit*, në “Pesha e fjalës”, 1971.

Kadare, I., *Përtëritja e poetit*, në “Drita”, 1977, 6/19.

Kuteli, M., *Poeti Lasgush Poradeci*, 1937.

- Kuteli, M., *Poetika e Lasgush Poradecit*, në “Përpyjekja shqiptare”, 1938, 17.
- Poradeci, L., *Vallja e yjeve*, 1933.
- Poradeci L., *Ylli i zemrës*, 1937.
- Poradeci, L., *Vdekja e nositit*, 1978.
- Poradeci, L., *Vepra letrare*, 1990.
- Qosja, R., *Vallet poetike të Lasgush Poradecit*, në “Jeta e re”, 1967, 2.

LASGUSH PORADECI NË GJUHË

Lagush Poradeci është ndër poetët që i njihte më së miri fshehtësitë e shqipes, që krijoi gjuhë dhe poeti që shkroi edhe poezi më të arrira për të lartësuar gjuhën shqipe. Një erudit në fushën e filologjisë e të gjuhësisë dhe në gjuhë është ai i tëri. Ai përmendet si poeti “që e cenoi ngurtësinë e formave dhe të normave” letrare-gjuhësore për të dhënë një shprehje të re të mëvetësishme, atë shqipen lasgushiane. Ashtu siç flitet sot për një shqipe noliane, shqipe kuteliane, po ashtu mund të flitet edhe për një shqipe lasgushiane. Lasgushi krijoi artin e gjuhës poetike. Vetëm te poezia “Naim Frashëri” përdor sa e sa farkime të goditura fjalësh, togfjalëshash e frazash shprehësore: Xhurajë dhembshurishte (epitet për Naimin), gojë vjershëtore (= goja e poetit Naim Frashëri), folje pleqërishte, ligjëratë pleqërishte, baltishta tradhtie (moçalishta), mjegull zemërate, Mëmëdheth, zëth, tepërlumtur, fluturim vraparak, çetele të kujtimit, kuvend i zogut (= të folurit e ëmbël shqip), këng’ e tepërlumtur, mjaltë blete parëvere (pranvere), fushore (vend fushor), gjymash (që ecën pas gjurmëve të dikujt), Burri i vërtetë (= Skënderbeu), etj. Lasgush Poradeci është një ansambël gjuhe, letërsie, kulture. Fjalët janë armët më të fuqishme që përdor Lasgushi. Po të qëmtohen ato nga shkrimet e Lasgushit, mund të bëhej një Fjalor i gjuhës së Lasgush Poradecit. Ky fjalor do t’i shtonte leksikografisë shqiptare prurje e vlera të reja.

Një erudit në fushën e filologjisë e të gjuhësisë

Lasgush Poradeci (emri i vërtetë Lllazar Sotir Gusho, 27 dhjetor 1899 – 12 nëntor 1987), është krijues me profil të gjerë e të gjithanshëm: shkrimtar, përkthyes, publicist, studiues filolog, që radhitet ndër poetët më të shquar të lirikës shqiptare: “Farkëtari i poezisë lirike moderne shqiptare” (Mevlan Shanaj), “Kampion i lirikës erotike shqiptare dhe i lirikës atdhetare elitare shqiptare, atleti kampion i fjalës shqipe, disiplinari më i shquar e i shkrirë në të. Asnjëherë shkronjat, leksikografia, fonetika shqipe nuk ka pasur kavalier më skrupuloz se

poeti dhe gjuhëtari gorar, Lasgush Poradeci” (Lasgushi dhe Kosova, një dashuri me ndarjen në mes, “Koha Ditore”, 25.3.2014). Lasgushi ishte një erudit në fushën e filologjisë e të gjuhësisë, që e njihte dhe e shkruante shqipen me themel, si dhe gjuhët e tjera, dhe në gjuhë është ai i tëri. Në maj të 1933 doktoroi me temën “Der verkannte Eminescu und seine volkstümlich-heimatliche Ideologie” (“I paçmuari Eminescu dhe ideologjia e tij popullore-atdhetare”). Në Bibliografinë për jetën dhe veprën e Lasgush Poradecit, të hartuar nga Liliana Verdho (Verdho 1999: 180), shohim se krahas krijimeve të tij në fushën e letërsisë si shkrimtar me krijimtari të gjerë e të pasur, ai do të preokupohej e do t’u sillej edhe problemeve të kulturës së gjuhës shqipe: “Çështja e fjalëve të reja në gjuhën shqipe” – Shqipëria e re, nr. 200-201, 28 nëntor 1924; dhe “Gjuha letrare”/intervistë me Lasgush Poradecin/-Tomori, 28 korrik 1940. E po kështu dhe problemeve teologjike: “Ekskursioni teologjik i Sokratit” – Pararoja, 30.6.1990; mendimit kombëtar: “At Gjergj Fishta vazhdimtar në mendimin e kombit” – Tomori i vogël, 1 kallnor 1943, etj.

Lasgush Poradeci - i vetmi poet shqiptar që mendon, flet dhe shkruan vetëm shqip

Mjeshtri i letrave dhe “babai i prozës shqipe” Mitrush Kuteli në një studim të tij shprehej: “Lasgush Poradeci është poet shqiptar, i vetmi poet shqiptar, që mendon, flet dhe shkruan vetëm shqip. Poezia e Lasgushit është kualitet. Nga 100 vargje të tij, 60 ose 70 janë të tonit madhor. Kur më këndon këngën pleqërishte, Drinin iredent që shkon “mes për mes” Shqipërisë, liqerin, vjeshtën, kroin e fshatit, ka zbritur në jetën e palcës shqiptare”. Këtij vlerësimi për Lasgushin vështirë se mund t’i hiqet ose t’i shtohet qoftë dhe një presje, e aq më pak të shtrohet pyetja “A është poet Lasgush Poradeci?”, – siç e shtronte Krist Maloki, - për çka dhe kishte marrë përgjigjen e merituar të Kutelit dhe të vetë Lasgushit në polemikat e tyre antologjike. Sipas Kutelit, Lasgushi është poet (dichter) “jo pse dua unë, ti ose ai vetë, por pse vepra e tij e bën të tillë” (“Përpyekja Shqiptare” nr. 17; Kastrati 2002: 488). Kurse Lasgushi do të vinte këtë shënim si përgjigje të shkurtër

ndaj Malokit: "Ku e kupton dot ti, Malok, poezinë time!" (Kolovica 1992: 105).

Gjuha te Lasgushi - si verb Perëndie dhe si lingvistikë

Lagush Poradeci është ndër poetët që i zbulonte mrekullitë dhe misteret e shqipes, që krijoi gjuhë dhe poeti që shkroi edhe poezi më të arrira për të lartësuar gjuhën shqipe. Ai përmendet si poeti "që e cenoi ngurtësinë e formave dhe të normave" letrare-gjuhësore (Xh. Lloshi) për të dhënë një shprehje të re të mëvetësishme, atë shqipen lasgushiane. Ashtu siç flitet sot për një shqipe noliane, shqipe kuteliane, po ashtu mund të flitet edhe për një shqipe lasgushiane. Lasgushi krijoi artin e gjuhës poetike. Vetëm te poezia "Naim Frashëri" p.sh. përdor shumë farkime të goditura fjalësh, togfjalëshash e frazash shprehjësore: Xhurajë dhembshurishte (epitet për Naimin), gojë vjershëtore (= goja e poetit Naim Frashëri), folje pleqërishte, ligjëratë pleqërishte, baltishta tradhtie (moçalishta), mjegull zemërate, Mëmëdheth, zëth, tepërlumtur, fluturim vraparak, çetele të kujtimit, kuvend i zogut (= të folurit e ëmbël shqip), këng' e tepërlumtur, mjaltë blete parëvere (pranvere), fushore (vend fushor), gjyrmash (që ecën pas gjurmëve të dikujt), Burri i vërtetë (= Skënderbeu), etj. Ky ndërroi edhe emrin të vet të parë Lllazar Gusho dhe e bëri të tingëllojë aq bukur Lasgush, dhe nga malli për vendin ku kishte lindur i shtoi edhe atë Poradeci, shkurtim i Pogradeci), prapa (Kolovica 1992: 42). Dhe emrin e Pogradecit e bëri të njohur duke i krijuar një jetëgjatësi të përhershme.

Te poezia "Naim Frashëri", Lasgushi për gjuhën shqipe përdor metafora të shumta, këtë gjuhë e quan shpirti i shenj' i kombit dhe Verb i Perëndisë! :

Gjuha: shpirti i shenj' i kombit, që kalon duke kënduar!

Gjuha: zjarr ku djeg me dritë një mendim i frymëzuar!

Gjuha: afsh' i gjall' i jetës! Shpat' e ndritur e lirisë!

Gjuha: yll' i vjershërisë! Gjuha: Verb i Perëndisë!

Lasgushi lëshonte kushtrimin dhe për shkatërrimin që i bëhej gjuhës shqipe:

"Shkatërrim'i shpejt'i gjuhës sot qëndron në vep'r e sipër,
Sot po humb kuvend'i zogut ç'gjithë bukuri që kishte"

E, shkatërimi i gjuhës shqipe vazhdon edhe sot në përmasa edhe më shqetësuese, njëherë duke mohuar standardin dhe pastaj duke ia zënë frymën kësaj gjuhe me frymën e huaj.

Lasgushi – zotërues i mekanizmit të gjuhës

Lasgush Poradeci kishte një potencialitet të madh linguistik dhe vullnet për të mësuar gjuhët, siç e shohim këtë te libri i Petraq Kolovicës “Lasgushi më ka thënë” (Tiranë, 1992) – një libër i vogël, por shumë tërheqës për lexim, ku autori ka shkruar një variant të biografisë së Lasgushit: “C”i tha Lasgushi dhe ç’i thanë për Lasgushin”, e ku gjejmë mendime autentike për gjuhën, artin e gjuhës poetike, për përkthimin, për kulturën, shkurt për shpirtin e vërtetë lasgushian.

Lasgushi në kujtimet e veta na rrëfen interesimin e tij të madh për të mësuar gjuhët e huaja. Kur ishte në Rumani, thotë se ndiqte kurse për të mësuar hebraishten e vjetër për t’i lexuar në origjinal Profetët; kur ishte në Austri, ndoqi një kurs për gjashtë muaj për të mësuar sanskritishten në katedrën që drejtohej nga një sanskritolog i madh, sepse i pëlqente bota indike dhe kultura e saj, s’ngopej me Vedat indike. Kur ishte në Greqi, 16 vjeç djalë, lexonte “Les vie paraleles” (Jetët paralele). Italishten e kishte mësuar kur ishte 16 vjeç, nga një libër “L’italiano”, për 12 ditë mësoi gramatikën italiane dhe zotëronte mekanizmin e gjuhës. Kur erdhi Fan Noli në fuqi, Lasgushit i akorduan një bursë për të studiuar albanologji, në Gjermani, në Berlin, por ai zgjodhi të studionte në Vjenë dhe në Grac të Austrisë dhe t’i përkushtohet tërësisht poezisë. (Ah, sikur të kishte studiuar albanologjinë, do të na kishte lënë studime linguistike si ato të mikut të tij të ngushtë E. Çabejt).

Lasgushi përmend, si një element krenarie, siç mësojmë nga kujtimet e tij që ia ka kishte thënë Petraq Kolovicës, se ai e flet gjuhën shqipe, sepse kishte pasur një stërgjysh me emrin Kastriot, që i qëndroi për njëzetepesë vjet me radhë të njëzet e shtatë ekspeditave të sulltanëve më të tmerrshëm të Turqisë dhe jo vetëm që s’i la të merrnin kryeqytetin e trimërisë – Krujën, por mbrojti edhe qytetin e muzikës – Vjenën, edhe qytetin e dritës, Ville de la lumiere – Parisin (Kolovica 1992: 52).

Lasgushi si hallkë të parë të zinxhirit të traditës sonë përmend Pellazgët! Ata janë të parët tanë. Tani pellazgët s'i përmendin. Edhe Çabej s'i pranon pellazgët si paraardhësit tanë. S'i pranonte as Jokli. Jokli kishte të drejtë, se, si shkencëtar gjuhëtar, nuk kishte prova bindëse që t'i pranonte pellazgët. Po gjuha s'është i vetmi argument" (Kolovica 1992: 58). Me çfarë intuïte të hollë dhe gjykimi të logjikshëm e largpamës e trajton çështjen e prejardhjes së shqiptarëve nga pellazgët - nuk ka prova bindëse gjuhësore në këtë ndërlidhje me pellazgët, po gjuha s'është i vetmi argument".

Lasgushi si hallkë të dytë të një zinxhiri të madh shihte lidhjen e shqiptarëve me Ilirët, kjo jo me romantizëm, por me disa argumente të qëndrueshme që konsistojnë në këtë: "Magnum Iliricum i tha romaku, se kjo Iliri shtrihej që nga burimet e Danubit e deri në Greqi. Perandoria e tmerrshme e Romës, të tërë popujt që nënshtroi i romanizoi. Francezët, spanjollët, u romanizuan. Dakët u romanizuan. Ilirët – jo! As u nënshtruan, as u romanizuan. Prandaj ne sot flasim shqip! (Kolovica 1992: 58).

Hallka e tretë është Skënderbeu ose më mirë Gjergj Kastrioti, lufta e tij madhështore më se njëzet e pesë vjeçare...

Lagushi kishte edhe dashurinë e madhe për Kosovën, si një element tjetër i kulturës së tij identitare kombëtare. Shkroi edhe një poezi a poemë për Kosovën. "Të thuash për kosovarët se janë trima është tepër pak. Ata janë kreshnikë!" (Kolovica 1992: 50).

"Mendime estetike për gegërishten dhe toskërishten – një kontribut në formimin e shqipes standarde"

Lasgush Poradeci ka artikuluar edhe disa mendime estetike për gjuhën. Në esenë e tij "Pse shkruaj?! Dyke bashkuar gegërishten me toskërishten (5.4.2007)", Lasgushi ballafaqon dy entitete gjuhësore–gegërishten dhe toskërishten dhe nga afrimi i veçorive të tyre nxjerr si rezultante formimin e një gjuhe të përbashkët (gegërishte) të "mesme". Këtë e shpreh bukur poetikisht dhe e filologjikisht:

"Gegërishtja ka energji fizike, toskërishtja ëmbëlsi shpirtërore. Duke bashkuar gegërishten me toskërishten, gegërishtja gjithë duke mos humbur forcën, energjinë, fiton dhe harmoni, ëmbëlsi (si gjuhë e "mesme" me karakter geg). Lufton pra forca fizike me harmoninë

shpirtërore, trupi me shpirtin. Forca si një gjë brutale, do të fitojë (lëndërisht) përmbi shpirtin, do të mbetet (mbase) gjuha e “mesme” geqe, sepse gjithnjë forca fiton përmbi shpirtin. Ky fitim është lëndor. Lëndërisht do kemi si gjuhë gegërishten (e “mesme”). Po një gegërishte të shpirtëzuar me influencën e toskërishtes. Shpirtërisht toskërishtja nuk humb, shpirti do duket në ëmbëlsinë, harmoninë, bukurinë e gegërishtes së “mesme”. Sa më e fortë, më e fuqishme, më e shumanshme të jetë toskërishtja në harmoninë e saj, aq më shumë do të ndjehet fryma e saj mirëbërëse në gegërishten (e “mesme”).

Edhe linguistët, si shqiptarë ashtu edhe ata të huaj, kanë qenë të mendimit që zgjidhja për bazën dialektore të shqipes letrare të gjendej me kohë në ngritjen e dialektit jugor të gegërishtes së Elbasanit, – të cilin edhe populli shqiptar e quan si dialekt qendror, dialekt të kuptueshëm në veri dhe në jug, - në shkallën e gjuhës së përbashkët letrare (Barić 1950: 15). Për bazën dialektore të shqipes letrare, këtë qëndrim e kishte shprehur edhe Komisia Letrare e Shkodrës (1916) dhe, më në fund, ky është dhe realiteti i sotëm i shqipes standarde, që është një konvergjencë e dialektit jugor të gegërishtes së Elbasanit dhe toskërishtes veriore. Prandaj, kontestimet që i bëhen formimit të shqipes standarde gjysmë shekulli pas formimit të saj, se kjo gjuhë qenka formuar mbi bazën e toskërishtes nën regjimin dirigjist, janë kontestime donkishotiane, të pabaza, të panevojshme, të pafrytshme, pa mbështetje filologjike e logjike, që çojnë ujë në formimin e standardeve paralele a të një kosovarishteje paralele. Nevoja për një gjuhë të përbashkët kombëtare lind me krijimin e vetëdijes kombëtare dhe jo me krijimin e një shteti të ri të dytë shqiptar të Kosovës.

Lasgushi, me fuqitë e tij, ia nxori në shesh toskërishtes potencialitetin e saj shpirtëror, bekimin e harmonive të saj, duke bërë vargje të përsosur në harmoni.

Fjalët - armët më të fuqishme të Lasgushit

“Fjalët janë armët më të fuqishme që i përdorin njerëzit” (Words are the most powerful drug used by mankind) – shprehet Rudyard Kipling. Kjo thënie mund të përkthehet edhe kështu: Fjalët janë armët më të fuqishme që përdor Lasgushi. Po të qëmtohen ato nga shkrimet e

Lasgushit, mund të bëhej një fjalor i gjuhës së Lasgush Poradecit. Ky fjalor do t'i shtonte leksikografisë shqiptare prurje e vlera të reja.

Lasgushi e njihte gjuhën në thellësitë e saj, si kulturë dhe si traditë, ia njihte mirë shpirtin asaj. Siç thotë edhe Noam Chomsky: “Gjuha nuk ka të bëjë thjesht me fjalët. Është një kulturë, një traditë, bashkimi i një komuniteti, një historie të tërë që i jep jetë vetë komunitetit”.

Lasgushi ka vënë re me të drejtë se fjalë të njëllojta kanë kuptime jo të barabarta nga njëra gjuhë te tjetra, sepse shprehin shpirtra dhe kultura të ndryshme. Kështu fjala “bukë” ka një kuptim më të gjerë, më të thellë, më jetësor në shqipen, sesa p.sh. në gjuhët sllave fjala “hleba”, nënvizon Poradeci dhe sjell këta shembuj që e vërtetojnë këtë: “Ne themi: Haj të hamë bukë, ose keni ngrënë bukë? ose më hahet bukë. Sllavët thonë: Haj të hamë, ose më hahet, kam uri, pra nuk e kanë të domosdoshme ta përdorin fjalën bukë, p.sh. sikurse shqiptarët. Për sllavin buka nuk është gjithë ushqimi, është një pjesë e ushqimit. Për shqiptarin, gjithmonë të varfër, buka shpreh tërë ekzistencën e vetë” (L. Poradeci).

Po kështu edhe fjala “Madamme” në frëngjisht shpreh një respekt e një kulturë tjetër nga ç’ë shpreh fjala zonjë në shqip. Dhe kështu mund të vazhdojmë për shumë fjalë, ku në fushën e fjalorit të çdo gjuhe fjalët kanë specifikat e tyre të gjuhëve përkatëse. Kjo specifikë e veçantë e fjalëve e bën mjaft të vështirë përkthimin.

Gjuha shqipe ka edhe shprehësi të tjera të mëvetësishme të rendit gramatikor, që nuk i kanë të tjera gjuhë, si p.sh. të shprehurit admirativisht (habitorisht):

Qenka bizë nëne!

Qenka djalë nëne!

Kush na paska ardhë?

Ardhka nusja!

Këtë mënyrë të foluri habitorisht nuk e ka asnjë gjuhë tjetër, e ka vetëm sanskritishtja (indishtja e vjetër).

“Ardhka nusja” nuk tregon vetëm që ka ardhur nusja, por që ka ardhur dhe unë s’ë dija dhe çuditëm si paska ardhur, ose si është e mundur që ka ardhur, ose sa mirë që ka ardhur – e ka shpjeguar këtë shumë drejt poeti me dell të fortë gjuhësor L. Poradeci. “Ardhka nusja” është

shprehje e kondensuar që jep shumë kuptime. Kuptimet varen dhe nga tonaliteti i zërit me të cilin flasim.

Lasgush Poradeci është një ansambël gjuhe, letërsie, kulture.

Sa është origjinal e i madh si poet, krijimet poetike të Lasgush Poradecit pothuajse është pamundur të përkthehen në ndonjë gjuhë tjetër. Poeti dhe përkthyesi i njohur maqedonas Gane Todorovski, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së korifeut të fjalës poetike shqiptare, ndërmoi të përkthente një libër bilingual me 30 poezi të zgjedhura në origjinal dhe të rikënduar në gjuhën maqedonase, “Vesë dashurie” & “Ljubovna rosica”, në botim të shtëpisë botuese “Flaka e vëllazërimit” të Shkupit (1999), si shembull të aksionit kulturor pozitiv për afrimin dhe afirmimin e dy kulturave shqiptare e maqedonase te popujt respektivë fqinjë të Ballkanit, dhe megjithëse në punën e tij e kishin ndihmuar edhe poetë dhe përkthyes të shquar si Adem Gajtani e Nikollaj Krizhanovski, përkthimi i poezive të Lasgushit nuk i afrohet origjinalitetit, siç mund të shihet dhe në këto vargje:

Zog'i qiejve

Këng'e lasht' e vjershërisë më pëlqeu aq fare pak...

Do t'j-a marr që sot e tutje si bilbili parëverak

Që nga fund'i vetëvetes do këndoje një mall të ri:

Brenda fushës së junapit që mbleroj me kaq stoli,

Kur po shoh ndaj ryn bilbili e sakaq ze qan nër fletë,

Këng'e e ti më ngjan kulluar posi këng'e Zotit-Vetë.

Nebesna ptica

Peenjeto starovremsko dopadljivo veče ne e

Jas ќе peam, ponatamu, kako slavejot što pee.

Od dno srce mojot kopnež v novi zvuci ќе se sliva:

Srede kitki zelenilo, pokraj vrba mirizliva

Vidov slavej kako vleze i zaplaka toj pod cvetot,

Mi se stori deka Gospod go vospeva milno svetot.

Dihet që përkthimi i poezisë nuk është një punë e lehtë. E si mund të përkthehen ato perla poetike: “Gjuha e zjarrtë”, “Këngë pleqërishte”, “Dremit liqeri”, “Gjarpërushja”, “Kroj i fshatit tonë”, “Zog i qiejve”, një poezi aq e pasur në figura, në ritëm, rimë, pa qenë vetë një poet a një përkthyes i kalibrit të Lasgushit a Nolit!

Mund të thuhet se te Lasgushi gjejmë tre tiparet kryesore të stilit heraklian:

- Densitetin gjuhësor – ngjeshjen e shumë ideve mbi të njëjtën fjalë.
- Rezonancën – pasurimin e vazhdueshëm të temës ose imazhit nga thënia në thënie;
- Renditjen e thënieve – që jep një efekt linear, që të shtyn nga pika në pikë drejt kulmit (Duka 2000: 71).

Lasgush Poradeci me veprën e tij poetike e ridimensionoi gjuhën shqipe, i shtoi kësaj gjuhe vlera të reja, larmi e fuqi të madhe dhe të tingëllojë bukur, i përafroi dialektet në një shqipe të përbashkët letrare, vuri gurë të rëndë në ndërtesën e shqipes letrare. Lasgushi e kishte bërë të veten atë që thoshte një poet, shkrimtar dhe publicist i njohur: “Ta doni gjuhën çdo ditë nga pak. Gjuha nuk ka dikë tjetër më të afërt se ne. Askush nuk mund ta dojë dhe ta ruajë më shumë se vetë ne, ajo është pjesë e historisë sonë, e kulturës dhe traditave tona, dhe për këtë arsye është pjesë e jona.” (Duško Radović).

Gjuha shqipe te Lasgushi gjeti mjeshttrin e filigranistin e saj më të shquar që i dha kësaj gjuhe gjithë atë hijeshi e shprehësi (ekspresivitet), ashtu sikurse dhe shqipja i dha atij emër të jetë pjesë e trashëgimisë sonë letrare e gjuhësore kombëtare.

BIBLIOGRAFI

Barić 1950; Barić, Henrik, Fjalor i gjuhës serbishte ose kroatishite dhe i shqipes, Izdavački Zavod Jugoslovenske Akademije, Zagreb, 1950.

Duka 2000; Duka, K, Spiro, Herakliti i proverbave të urtësisë kozmike, PEGI, Tiranë, 2000.

Kastrati 2002; Kastrati, Sevdai, “Lufta e Penave”, zgjedhje antologjike e polemikës shqipe, Botimet TOENA, Tiranë, 2002.

Kolovica 1992; Kolovica, Petraq, Lasgushi më ka thënë (Shënime nga bisedat me Lasgush Poradecin), Tiranë, 1992. “Përpyekja Shqiptare” nr. 17.

Lasgush Poradeci, Vesë dashurie & Ljubovna rosica, poezi të zgjedhura, (Në 100-vjetorin e lindjes), “Flaka”, Shkup, 1999.

Kolovica 2018; Kolovica, Petraq, Zëri im në arkitekturë, në kulturë, në politikë, Botimet “Kuteli”, Tiranë, 2018.

Verdho 1999; Verdho, Bibliografinë për jetën dhe veprën e Lasgush Poradecit (1922-1998), Studime filologjike, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë Tiranë, 1999.

VALTER MEMISHA

Akademia e Studimeve Albanologjike - Tiranë

DUKURI TË KOHERENCËS LEKSIKORE NË FORMIMIN E FJALËVE NË LETËRKËMBIMIN E LASGUSH PORADECIT

Vepra e Lasgush Poradecit është bërë objekt i studimeve të pandërprera dhe nga prerje të ndryshme. Por Konferenca e sotme tregon dhe një herë se prurjet që kjo vepër mbart dhe vlerat që ajo na ofron, janë të shumta dhe do të tërheqin në mënyrë të vazhdueshme vëmendjen e studiuesve. E gjitha kjo e kushtëzuar edhe nga vetë zhvillimet e shkencave të studimit sot, nga korpuset teorike të cilave u referohet një studiues, si dhe nga metodologjia e metodat bashkëkohore që zbatohen, të cilat në ditët e sotme në kërkimin shkencor në albanologji po zënë gjithnjë e më shumë vend.

Punimi ynë ndalet një fushë të veçantë të veprimtarisë së Lasgush Poradecit, në Letërkëmbimin e tij të përfshirë në botimin “Vepra letrare”, Tiranë, 1990 dhe që mundësohet si një nga fusha ku mund të bëhen kundrime të ngahershme gjuhësore. Edhe pse këtu nuk flitet për krijimtari të mirëfilltë artistike, pohojmë se në letrat e shumta¹ gjejmë të mishëruar një gjuhë ku spikatin të shprehurit mjeshtëror e tërë kulturë dhe ku ndeshen shumësi variacionesh mbresëlënëse në ndërtimin e teksteve (variacione që burojnë kryesisht nga qëllimi i letërshtuesit dhe që kushtëzon formatin e tekstit të ngjeshur / të shkurtër e telegrafik apo formatin shumëfaqësh). Është fakt se brenda këtyre teksteve enden dhe gërshetohen disa tipologji tekstore.

Kostë Çekrezi, më 2017, në veprën “Letra, shkresa fialëtoze” shkruan: “Letra ... është një nga shkrimet e para që mbeten, dhe i lumtur është ai që di të shkruanjë letra të lidhura mirë. Po, arsyeja më e madhe për të cilën një letrë duhet të jetë e shkrojtur mirë qëndron në influencën e madhe që ka në marrëdhëniet shoqërore dhe tregtare të njerësve të shekullit të sotmë. Sikundër oratori i mirë dhe i fortë u a merr mendien

¹ Një pjesë e letrave nuk janë përfshirë në këtë botim, madje këto që kemi në duar, jo rrallë përveçohen për përdorimin e shpeshtë të tripikëshit (...), jo si reticensë e përdorur nga autori, por si prerje teksti nga përgatitësit e botimit. Shih më gjerë Lasgush Poradeci, *Vepra letrare*, Tiranë, 1990

dëgjonjësve dhe i bën të mejtohen dhe të ndiejnë pas dëshirës së tij të çfaqur me fialët e bukura që rrjedhin si mialtë, sikundër i entusias dhe fiton simpathin' e dëgjonjësve të tij, ashtu dhe letra e mirë dhe e fortë kënaq këndonjësën e saj dhe nuk' vonon që të siellë pemët e dëshiruara prej atij që 'e shkruan.'²

Fusha epistolare nuk është objekt i kumtimit tonë e vështuar në tërësinë e vet (kundrimi i teksteve si mesazh dhe si realizim kohezionor gjuhësor), por mjafton një sekuencë tepër e shkurtër, për të zbuluar dorën e mjeshtërit në të shprehur, që shfaqet përmes rimarrjeve e duke e përveçuar emfatikisht përmbajtjen e një letre: “*Si doli kjo këngë e kombit kaq e përhapur dhe kaq e kënduar - më e përhapura dhe kaq e kënduar – më e përhapura dhe më e kënduara nga të gjitha?*” (Himni kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij, f. 357).

Ne jemi ndalur në vëzhgime leksikore e tek-tuk semantike në këtë letërkëmbim, duke veçuar një grup me rreth 330 njësisht leksikore e frazeologjike. Ato janë parë si njësi përbërëse të gjithë fjalorit të veprës së këtij shkrimtari me vend të përdalluar në letërsinë e kulturën tonë kombëtare, por dhe si njësi që kanë peshën e vet në ndërtimin e sintagmave ku ato janë gjurmuar. Pa rënë në interpretime sipas *semantikës kompozicionale*, të quajtur ndryshe *semantika e ndërtimit të thënieve* (një disiplinë shkencore që analizon dhe fillon semantikën e ndërtimit të thënieve në ligjërim) një fushë ku për Lasgush Poradecin janë bërë studime të shumta sidomos në atë të *kompozicionimit* sintaksor e semantik të poezive) dhe sipas *semantikën evaluative* (vlerësim i letrave si tekst), njësitë e analizuara janë parë nga pozitat e *semantikës strukturore* dhe të *semantikës gjeneruese*, edhe pse është gati e vështirë të flasësh për një njësi leksikore, të shkëputur nga jeta e saj në thënie. Në poezinë e Lasgush Poradecit, përkatësisht dhe në letërkëmbimin e tij, shumë njësi leksikore janë krijuar për t'u perceptuar, për t'u shijuar e për t'u vlerësuar vetëm në ndërtimet sintagmatiko-sintaksore që vetëm ai dinte të thurte, duke pasur shpesh (për të mos thënë pandashëm) veçoritë e ndërtimit sintaksor si kompozicionim (një term që në semantikë është futur nga Fregu dhe që nënkupton se kuptimi i një fjalie del nga funksioni semantik i

² *Letra, shkresa fialëtore prej Kost. Çekrezit*, Boston, 1917, f. 6

gjymtyrëve që e përbëjnë dhe e mënyrës së kombinimit të tyre³). Rimarrjet si aliteracione artistike, por dhe rimarrjet gjuhësore sidomos ato gjatë procesit të fjalëkrijimit të tipit *me atë vetull – vetulluar, vetullo- vetullushe, bukuro – bukurushe, fluturo – fluturushe, këngë – e pakënduar, vaj-i pavajtuar, vjershëtor – vjershëkënduar, kombin për ta kombësuar, shqipen për ta shqipëruar, atë durim –të paduruar, ç’foli trimi – i trimëruar, dhe qeshe miturish – moj miturore, dh’u skuqe virgjërisht – moj virgjërore, dhe qeshe dashurisht – moj dashurore, dh’u skuqe nusërisht – moj nusërore* etj., janë një nga mishërimet origjinale e tepër të goditura në krijimtarinë poetike të poetit të shquar. Ne i jemi qasur leksikut të Letërkëmbimit të L. Poradecit për disa arsye:

Së pari: Në projektet e punës afatmesme dhe afatgjata të institucionit ku unë punoj, veçohet dhe *hartimi i Fjalorit historik të shqipes*, një punë që ka nisur me hartimin e Fjalorit të veprave të autorëve të vjetër. Projekti po realizohet pranë Universitetit “Ludwig Maximilian”, Mynih, Gjermani. Në kuadrin e hartimit të këtij fjalori, hartimi i një fjalori të veprës së Lasgushit do të ishte tepër i nevojshëm e i domosdoshëm. Pohojmë këtu se hartimi, tashmë, është një punë e filluar. Shumë njësi leksikore që gjenden në botimin ku jemi ndalur, do të plotësojnë informacionin për çështje të tilla, se a janë fjalë të përdorura e të formuara para tij (dhe sa janë), a janë njësi të qëmtuara në shtypin a letërsinë e kohës apo janë krijime të vetë mjeshtrit (që është në ballë të pasuruesve të leksikut shqipes). Hartimi i Fjalorit të veprës së Poradecit do t’i ndihë, kësisoj, edhe punës hartuese për *Fjalorin thesaurus të shqipes*.

Së dyti: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë është në përfshirë në një proces vrullshëm për grumbullimin e lëndës leksikore, frazeologjike e semantike që do të zgjerojë dhe plotësojë dukshëm kartotekën / korpusin leksikoro-semantik për hartimin e një fjalori të madh të shqipes standarde (një projekt që pritet të fillojë brenda vitit 2020). Leksiku i veprës së Lasgush Poradecit natyrshëm do të zërë vend shumë gjerë në të. Hartimi i Fjalorit të veprës së këtij autori mundëson

³ Shih më gjerë, Jean Pierre Malrieu, *Evaluative Semantics: Cognition, Language and Ideology*, London and New York, 2002, p. 129

dhe qasjen (jo thjesht stastikore, por funksionale e shkencore) se cili është vendi i këtij leksiku në fjalorët shpjegues normativë kombëtarë të shqipes, që janë në përdorim dhe sa mund të jetë hapësira e mundësia e përfshirjes së njërive të tjera në këtë vepër të re.

Në letërkëmbimin e Lasgushit kemi qëmtuar njësi leksikore (tek-tuk edhe disa njësi frazeologjike, të cilat për hir të vërtetës, janë shumë të pakta në numër) që nuk janë përfshirë në fjalorët e derisotëm normativë. Shumë nga këto njësi mund të jenë krijuar prej tij, por duke mos pasur një fjalor për kohën kur kryhet dhe letërkëmbimi, ne jemi tërësisht në një terren të rrëshqitshëm për të përcaktuar me saktësi e me përpikmëri autorësinë e krijimit të tyre. Ndaj formimet i marrim me rezerva, edhe pse ato të farkuara prej tij mjeshtërisht janë me qindra.

Duke u mbështetur në kritere morfosemantike e duke lënë mënjanë ato sintaksore e stilistikore, këto njësi janë parë në marrëdhënien *leksik i Letërkëmbimit* (duke pranuar së shumti fjalëkrijime të këtij autori) / *leksik i shqipes*, përmes konceptit të *koherencë leksikore* (që quhet dhe koherencë e brendshme), term që sipas gjuhëtarit Del Rosario nënkupton se gjuha pranon të pronësojë ata elementë që i shkojnë asaj për shtat dhe të mos pranojë ato që nuk mund të asimilohen⁴. Atëherë shtrohet pyetja: njësitë e veçuara prej nesh a janë krijuar sipas ligjeve të shqipes, a i ka bërë apo i bën ato pronë të vetën shqipja apo janë krijime çastore për efekte e vlerë letraro-artistike dhe si të tilla kanë mbetur në leksikun vetjak të autorit si neologjizma? Në fjalorthin që kemi nxjerrë dhe që shoqëron këtë trajtesë paraqitëse, janë me dhjetëra e dhjetëra, për të mos thënë më shumë, njësitë e farkuara rregullsisht e bukur e që, për mendimin tonë, duhet të kishin zënë vend pa tjetër në fjalorët për të cilët folëm më lart. Koherenca leksikore për njërive të tilla, si *dëshmorësi,-a; flamurtari,-a; veteranëri,-a; paemërsi,-a; mendjeurtë* etj. është e saktë dhe funksionore.

Produktiviteti dhe frytshmëria e realizimeve të larmishme morfosemantike në veprën e Lasgushit (të krijuara prej tij apo të marra nga leksiku i kohës në përdorim) determinohet jo rrallë nga konteksti gjuhësor poetik (janë me dhjetëra studimet në këtë fushë), por vlera të

⁴ Shih më gjerë, J. Byron, *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës, rasti i shqipes, dhe Shkrime të tjera*, Shtëpia botuese "Dituria", Tiranë, 2012, f. 20

realizuara zbulohen dhe nga konteksti tekstor parashtues e argumentues, siç vërehet me prurjet e reja leksikore në letërkëmbim. Dhe këtu hyjmë në domenin e *semantikës diferencuese*. Janë me dhjetëra fjalët që krijohen në tekstet e këtij lloji ligjërimi, të cilat nuk i ndeshim as në gjuhën e poezisë, as në atë të prozës.

Semantika e *modifikimit kontekstor* (që mbështetet në dallimin ndërmjet kuptimit të njësisë së sapoformuar dhe përdorimit sintagmatik) mishërohet në dhjetëra shembuj ilustrues. Koherenca leksikore fjalëformuese shpërfaqet me prurje dhe në këtë fushë, edhe pse shumë njësi leksikore (mendojmë të krijuara prej Lasgush Poradecit), kundruar në marrëdhëniet me leksikun e sotëm normativ të shqipes, mund të mos jenë përfshirë në të. Në kohën kur janë shkruar prej tij shumica dërrmuese e letrave, shqipja kishte zbrazëti jo të vogla në leksikun abstrakt e sidomos në atë dituror. Krijimet e fjalëve të reja që kemi qëmtuar në Letërkëmbim, bëhet sipas gjedheve të njohura dhe me brumin / mjetet fjalëformuese të shqipes. Ky proces i formimit të njësisve të reja mund të ndiqet në shumë autorë në vitet ‘30 të shekullit XX. Mjafton të përmendim këtu punën e jashtëzakonshme për krijimin e leksikut abstrakt në publicistikë nga Gjergj Fishta (vëllimi 9 dhe 10, në korpusin me 10 vëllime të botuara nga Shtëpia Botuese “Fishta”, Lezhë, 2004), në publicistikën e Branko Merxhanit (Branko Merxhani, Vepra, “Plejad”, Tiranë, 2003), të Mit’hat Frashërit (Mit’hat Frashëri, Vepra, 1, 2, Tiranë, përkatësisht, 2017, 2018), të Faik Konicës (Faik Konic, Vëllimi 4 / Letërkëmbimi, “Dudaj”, Tiranë, 2001) etj.

Me vetëdijë kemi përzgjedhur disa grupe paradigmatiche njësisish që paraqesin dukuri të koherencës leksikore (d.m.th. pa kaluar në klasifikime shteruese):

1. Fjala vjen, Lasgush Poradeci ka krijuar me dhjetëra ndajfolje mënyre që i përkasin leksikut abstrakt, ndër të cilat po veçojmë disa të formuara me prapashtesat jo të thjeshta **–(i)sht**, një nga prapashtesat më prodhimore dhe sot në shqipen standarde. Një pjesë e këtyre ndajfoljeve janë të mirëfarkuara, si:

Lartësisht: *Kështu bëri dhe për shqiptarët e Rumanisë në Bukuresht, ku organizoi shoqërinë më të parë mërgimtarëve, të mbushur me lavdi ndaj Atdheut për veprat lartësisht të merituar. Ai mbeti vetëm pak*

*kohë në kryeqytetin rumun pas themelimit të Shoqërisë, duke u kënaqur me mbarëvajtjen shpresëdhënëse të përpjekjeve të komitetit të saj. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 384); **palcërisht** ndajf. fig. në palcë. Shkolla shqip e Pogradecit, e këtij qyteti **palcërisht** shqiptar, i futur në gjirin e maleve si truri në kafkën njeriut, është një nder jo vetëm për Atdheun, po dhe për pogradecarët në mënyrë të veçantë. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 401-402); **rrjedhësisht** ndajf. si rrjedhim, për pasojë. - Nën hijen e këtij miqësimi të ngushtë Naçua i përdori gjithë rastet, ndër bashkëfjalime të ngeshme me Nusret pashanë, për të ffilluar punën e kërkesës, duke mbajtur ditameditë në vërejtje me anën e tij interesimin e sulltanit, i cili **rrjedhësisht** e priti me mirëbesim kërkesën e Naços. (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës, f. 443-444); **shquarësisht** ndajf. në mënyrë të dallueshme, shqueshëm, dallueshëm. - Këto vargje kaq të thjeshta, të vëna në nota, ritmë dhe bashkëtingëllim menjëherë sapo u shfaq rasti, e kanë përmbushur misionin vjershëtor që është **shquarësisht** misioni patriotik i tyre. (Vjershëtori i Kolonisë, f. 378) etj.*

Por një pjesë prej tyre, edhe pse për kohën kanë qenë funksionale dhe janë pjesë e pandashme e me vlera e leksikut vetjak të Lasgushit, sot nuk kanë fituar normësinë për t'u përfshirë në leksikun e shqipes standarde. Koherenca leksikore ka fituar në të mirë të formimeve që marrin parasysh edhe semantikën dhe natyrën morfo-fonetike të temës fjalëformuese:

artistikërisht (sot *artistikisht*): “Vlera e Atdheut”, poezi me frymëzim të ngrohtë, është, siç kujtojmë dhe **artistikërisht**, midis më të bukurave nga gjithë poezitë e volumit. Toni shpirtëror i saj kumbon i plotë dhe i njëjtë që nga vargjet e para... (Vjershëtori i Kolonisë, f. 375-376);

përgjithërisht (sot *përgjithësisht*): Ky është qëllimi i fletorisë, i shtypit të ditameditshëm **përgjithërisht**, ashtu si ka qenë dhe ai i kolonive tona kombëtare të mërgimit. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 414); **mundërisht**

(sot *mundësisht*): Pas asaj ngjarjeje, përpjesëtimet e së cilës vetëkuptohen pa qenë dhe nevoja që të merren nën vështrim hollësisht, Shoqëria mbeti si e shuar, me pendim të pashfaqur, po të ndjerë nga të dy palët rreth qëndrimit të tyre **mundërisht** të mënjanuarshëm; aq sa dhe anëtarët dhe Pleqësia e saj kishin marrë vendimin për mosqenien

më të Shoqërisë, duke redaktuar dhe një procesverbal përkatës. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 394); **etnikërisht** (sot etnikisht): - Titulli “Betimi mi flamur”, që i ka vënë himnit Asdreni, është një koncept dhe një akt e fakt **etnikërisht** shqiptar. (Himni kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij, f.371); **fakterisht** (sot faktikisht): Ti je i mendjes se në nevojë, bota t’apin si ndihmë vërtetim mëshire... “abstrakte” sa të duash” “po - thua ti “**fakterisht**”, me punë, me ndihmë materiale, as të përfill njeri”. (Letra të Lasgush Poradecit, f. 461); **fillimërisht** (sot fillimisht): - Duke marrë parasysh se abetarja u botua në dhjetëmijë copë, kuptohet vetiu përhapja **fillimërisht** e mjaftueshme e saj. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 386); **guximtarisht** (sot guximshëm): Dërgimtarësinë kombëtare të zhvilluar midis rreziqeve më të zeza të kanosjes së vrasjes, Eftim Markua e shpuri **guximtarisht** gjer në fund, duke e mbyllur vetëm me mbylljen e jetës. (Data e parë e fillimit të “Dritës”, f. 432); **gjasërisht** (sot ngjashëm) - Vërtet, asnjë nga shoqëritë e çdohershme, duke mbaruar **gjasërisht**, nuk heshti fare me atë lloj mbarimi ose zëvendësimi. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 415); **jashtërendërisht** (sot jashtëzakonisht): - Po Nikolla Naçua e shkriu pasurinë e Gjergjit thujse tërësisht, sa rrojti, me përpjekjet e pareshtura dhe **jashtërendërisht** të gjalla drejt misionit kombëtar, sikundër shkrinte dhe gjithë të ardhurat e veta që ngriheshin në disa raste, me qindra mijë franga ar nga sipërmarrjet e mëdha shtetërore. (Dhimitër Kovaçi, f. 425); **vendimtarisht** (sot në mënyrë vendimtare). Ajo që i jepte ngjarjes në sytë e të huajve një peshë morali për shqiptarët, ish fakti se Naçua, si i regjistruar nën mbrojtjen e Konsullatës Greke, përbuzi gjithë përkrahjet dhe gjithë favoret lëndore të rrjedhura soje vetiu dhe mbushi **vendimtarisht** qëllimin e tij atdhesor. (Dhimitër Kovaçi, f. 419); **vetëdashërisht** (sot me dashje, me dëshirë) - Duhet të shënojmë, me qenë se flasim mbi Koloninë shqiptare të Rumanisë dhe mbi veprat e theroritë e tyre, se shpenzimet e vajtjes së Vretos për në Egjipt nuk u bënë as prej Qendrës së Stambollit, as prej shqiptarëve të Egjiptit, po vetëm prej shoqërisë idealiste të Bukureshtit e cila, përpara se ta niste për në Egjipt, i dorëzoi Vretos për nevojat lëndore të misionit të tij katërqind franga ar, të dhëna **vetëdashërisht** nga disa anëtarët e saj më të zellshëm.

(Mbi shoqëritë shqiptare, f. 386) etj.

2. Një proces që në Letërkëmbimin e Lasgushit mund të trajtohet *përmes koherencës leksikore*, është dhe *sinonimia fjalëformuese* (kur ka fjalë sinonimike të formuara me mënyra e mjete të ndryshme). Dukuritë janë të larmishme dhe formimet dalin në disa rrafshë që, siç pohuam lidhen dhe me gjendjen e leksikut të kohës dhe nevojën gjithnjë në rritje të shqipes për njësi të reja. Te fusha në studim ndeshen të paktën dy tipe kryesore për këtë shtresë emrash: formimet me prapashtesën – **tar** (nga tema emërore jo të parme e përgjithësisht tema të emrave të veprimit), të tipit **depërtimtar-i** (sot depërtues); **fillimtar** (sot *fillues*); **ndalestar** (sot *ndalues, pengues, frenues*) etj., si dhe formimet me –ës (nga tema foljore në -o-, në trajtën toske të tipit *dëgjonj, mësonj, vazhdonj* etj.), të tipit *dëgjonjës, mësonjës, vazhdonjës* etj.

Frytshmëria e realizimeve të larmishme morfo-semantike është dykaheshe: Formimet e emrave të veprimit me –**tar** që ka krijuar Lasgush Poradeci, shqipja standarde, përgjithësisht nuk i ka ngritur në normë dhe vlera e tyre shihet, së shumti në rrafshin leksiko-semantik plotësues autorial (e mu për këtë, në rrafshin e vetjakësimit gjuhësor të shkrimtarit), sesa në rrafshin leksikor të mbarë shqipes dhe konkurrues me tipe të tjera emrash veprimi. I mëshojmë këtij mendimi, se toskërishtja i kishte ngritur në sistem formimet e emrave prejfoljor të veprimit të tipit **vepronjës**. Nga çdo folje në veprare lehtësisht mund të krijohej një emër veprimi i këtij tipi, emër që dhe semantikisht e morfologjikisht i ruante të drejtpërdrejta lidhjet me temën fjalëformuese foljore. Ndaj dhe formimet me –**tar** në Letërkëmbim, jo rrallë herë duhen parë si formime nën ndikimin e stilit, të një emfaze e të një toni të veçantë, kushtëzuar nga narracioni në fjali. Ilustrojmë:

fillimtar,-e mb. që fillon diçka, që është në fillim të diçkaje, fillues. *Shpirtrat përfaqësonjës të Kolonisë, ata që patën qenë truri i jetës dhe i veprave në organizimin e saj, janë tre: Jani Vretua, i cili derdhi përpjekjen e tij të palodhur jo vetëm në kohën e lëvizjeve më të para, fillimtare, të Kolonisë, kur u themelua në Bukuresht Dega e Shoqërisë e varur prej udhëheqjes së Stambollit...*(Data e parë e fillimit të “Dritës”, f. 431-432); **ndalestar,-e mb.** ndalues, pengues, frenues. - *Ai e redaktoi, pra, kërkesën jo vetëm në gjuhën greqishte, po edhe në gjuhën*

*shqipe, për t'ia përshtatur më mirë qëllimit të tij të dyfishtë: më një anë si lypje e një të drejte që i jepte parimi vetë ungjillor pas fjalëve të Krishtit për ta lutur Zotin çdo komb në gjuhën e vet, dhe më tjetrën anë si një demonstratë politike e një populli, i cili po përgatitej të ndahej nga vargonjtë e shumë **ndalestarë** drejt mëvetësisë së tij kombëtare dhe shtetërore. (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës, f. 444-445); **shoqërimtar,-e mb.** që të të shoqëron, shoqërues; shoqëror. - *Me burrërinë hijerëndë të vendlindjes veriore, ai kish përvetësuar, siç u tha më sipër, dhe natyrën e tij të dytë gazmore, **shoqërimtare**, të bashkëjetesës me elementin tosk aq e duhur për veprim dhe ndikim në gjirin e turmës. (Himni kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij, f. 369); **zotërimtar,-i m. sh. -ë(t)** ai që zotëron diçka, zotërues. *Nikolla Naçua ish njeriu përftonjës i planeve të mëdha, njëkohësisht dhe **sendërtonjësi** praktik i tyre; ai ushtronte vullnetin e tij **zotërimtar** mbi të tjerët gjatë qindvjetëve të historisë, i përfaqësuar prej eksponentëve të saj në botën kombëtare dhe ndërkombëtare. (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës, f. 443) etj.***

Përjasja e formimeve prejëmërore me **-tar** me formimet prejfoljore të tipit **dëgjonjës**, zbulon lehtësisht se emrat e veprimit, karakteristikë e toskërishtes, janë shumë më të pranishëm dhe shumë më asnjanes në informacionin / kumtin në fjali.

këndonjës,-i m. sh. -(it) këngëtar. - *Mos më lër, pra, në baltë edhe kësaj here, dërgoma jetëshkrimin sa më shpejt... sa pa buçitur psallmet - që kësisoj të fillojmë një fillim kulture më të rëndë: një kulturë ku, krah për krah me këngët e vjershëtorit **këndonjësi** njeh dhe vjershëtorin vetë. (Letra të Lasgush Poradecit, f. 479); **vizitonjës,-i m. sh. -(it)** ai që viziton një vend etj., vizitor. - *Aq më tepër se, pikë së pari (siç më shkruan në postallkën e fundit), nuk kthehesh nga banjat, “internacionale”, pa ngjyrë dhe të thata po nga një fshat poetik me zemër të bardhë, që e ndryshon rrobën të paktën 4 herë në mot, - pastaj më duket se bashkë me **vizitonjësin** - vjershëtor të atij çipi natyre ku mbretëron përjetë bujku, sikur dëgjuan një çikë mermërin burimi edhe veshët e mi të shurdhuar nga makinat me një mijë rrota të fabrikave teutone... (Letra të Lasgush Poradecit, f. 464); **flakëronjës,-e mb.** flakërues; nxitës, frymëzues, ndezës. - *Armiqtë e kombit shqiptar u***

tundën së jashtmi kundër shoqërisë dhe kundër tij, si frymë **flakëronjëse** që ish ai i ngjizjes dhe i lëvizjes së saj; kundërshtarët e brendshëm nër shokët e “Dritës” zunë ta ndiejnë me moskënaqje peshën e rëndë të gjallërisë së tij veprimtare; të mësuar siç ishin në ngadalësinë apatike që këshillonte gjindja e radhës borgjeze të tyre, dhe përveç kësaj, pak pas ngjarjes gazmore të themelimit të shoqërisë, kish ardhur dhe ish përhapur në Bukuresht lajmi i tronditshëm i Mansurës. (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës, f. 440); Zgjedhja e Korçës si qyteti kryesor ku duhej bërë i njohur dhe përhapur himni, lidhej me domethënien e saj shumë të veçantë në veprimin atdhetar të kolonive, në radhë të parë për kryevatrën e Bukureshtit, nga gjiri i së cilës edhe kish marrë lindjen dhe udhëtimin ajo kënga **flakëronjëse**. (Himni kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij, f. 366); **përbënjës,-im. sh.** –(it) përbërës, anëtar. *Me kësi përbënjës të flaktë, përkundër punës së përditshme me të cilën ishin zënë të gjithë, siç u shënua në radhët e mësipërme, kori vijonte për të mbarë pa asnjë ndërkaputje, vijonte rregullisht natën po dhe ditëve të diela si dhe ndonjë të kremte rastore gjatë muajit.* (Himni kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij, f. 364) etj.

Sinonimia fjalëformuese në Letërkëmbim ndonjëherë mund të jetë rastësore, më shumë e kërkuar prej nesh sesa si një tipologji krijimi. Dy çiftet e mëposhtme janë tregues i kësaj dukurie:

kombëtarësim,-i m. - *Ata e kuptonin drejtpërdrejt, nga përvoja e përditshme e tyre që kish qenë dhe ajo e prindërve dhe gjyshërve të tyre, se për të shpëtuar Atdheun duhej nisur para së gjithave jo vetëm nga çlirimi i kishës, po njëkohësisht dhe nga **kombëtarësimi** i fesë ortodokse.* (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës, f. 437); - *Dhe atë veprim e filloi nga «a»-ja e nevojës kombëtare, që ishte pika e parë e programit të shoqërisë «Drita»: nga çlirimi dhe kombëtarësimi fetar dhe kishtar.* (Anëtarësia e Naços në Shoqërinë e Kolonisë, f. 437); **kombëtarizim,-i m.** - *Në pjesën më të madhe i detyrohet nxitjes së Naços që kombëtarizimi i kishës u vu, krahas me mësimin shqip dhe në krye të këtij, në programin e shoqërisë.* (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës, f. 438); - *Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës* (Anëtarësia e Naços në Shoqërinë e Kolonisë, f. 437)

rendërisht ndajf. me radhë, sipas rendit. *Kështu dhe tashti për çështjen e çlirimit kishtar të ortodoksizms Naçua vendosi, si **rendërisht**, njëherë e mirë ta kapë demin prej brirësh.* (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës, f. 441) **rendësisht** ndajf. rendërisht. - *Nër to mblihdeshin me zemër, për kuvendim dhe strehim ose mbrojtje, gjithë udhëheqësit, **rendësisht** luftëtarët, për t'u përcjellë prej lutësve të hirshëm të Zotit shqiptar me libër në trajstë dhe pushkë mbi krah drejt qëllimit.* (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 410)

3. Interesante në grupin e fjalëve të veçuara prej nesh nga Letërkëmbimi i Lasgushit janë formimet e emrave abstrakt me **-(ë)si** nga formimet emërore me prapashtesën **-tar**. Duke u mbështetur në temën fjalëformuese si dhe në semantikën e kësaj teme, të tërheq vëmendjen ndjekja e linjës së shkallëzimit apo gradualitetit morfologjiko-semantik (ruajtja e mbartja e semave, si dhe ndryshimi e lindja e semave të reja nga njësia leksikore në njësinë leksikore). Po sjellim si shembull njësi të tipit **dërgimtarësi,-a**: *dërgoj → dërgim → dërgimtar → dërgimtarësh*. Dihet se shqipja nuk ka ngritur në normë formimet e emrave abstrakt nga tema të tilla, por nga mbiemrat prej foljorë të formuar më paranyjëzim e prapashtesën **-shëm** (procesi trigjymtyrësh fjalëformues *folje - mbiemër – emër veprimi (dërgoj → i dërgueshëm → dërgueshmëri)*).

Në Letërkëmbim gjejmë formime me koherencë leksikore të pranueshme nga përdoruesi i gjerë, si: **kohësi,-a** f. periudhë kohore; kohë. - *Kjo kërkesë e vitit 1885, e formuluar zyrtarisht me shkrim, është e para në **kohësinë** e Rilindjes që dokumenton qëndrimin politik të kishës ortodokse, në aspiratat kombëtare të saj pranë qeverisë së Stambollit.* (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës, f. 442); - *Nër to, shoqëria e “Bashkimit” ishte thirrur të përmbushë ajo më e fundmja e **kohësisë** para Ngritjes së Flamurit detyrën e vet kombëtare.* (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 416)

Por nganjëherë gjejmë emra abstraktë të formuar me prapashtesën **-ësi**, që nuk formojnë grup të qëndrueshëm njësisish, sepse edhe në këtë rast, procesi i ngjizjes së njësisë së re ngrihet jo në gjedhe fjalëformuese aktive e prodhuese në shqipe. Përmendim këtu fjalë, si **fjalëtorëshmësi,-a** me kuptimin të *folurit bukur, gojëtari, oratori*. -

Dhe, më së fundi, të vdekjes sime, - vdekje e cila, (i shtrenjti Asdren!), sikundër sheh, po më bën të flas çapraz ose të këndoj “fjalëtorëshmësinë e Pikës). (Letra të Lasgush Poradecit, f. 463); **kryengritësi,-af.** tërësia e kryengritësve; përfaqësuesit më në zë të kryengritësve. - *Në këtë sallë ku u patën lëçitur me mallëngjim për të parën herë vjershat e Naim Frashërit pas dorëshkrimit, të ardhura fshehtazi nga Stambolli, ku merrte pjesë shpeshherë ÇerçizTopulli me Mihal Gramenon dhe Spiro Bellkamenin, kryengritësia e Rilindjes, që vinin të kolonin dimrin në gji të shoqërisë në Bukuresht, duke pritur veshjen me fletë të maleve shqiptare, duke pritur parëverën kur ktheheshin përsëri në Atdhe, këtu u mblodhën tashti burrat e veteranërisë, ata të kryeqytetit dhe të qendrave përfaqësuese, Konstancë, Jash, Brailë etj.* (Himni kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij, f. 361); **mjaftësi,-a** me kuptimin *mjaftueshmëri.* - *Shoqëria e vazhdoi veprimin e saj në qetësi, domethënë pa u ngritur asnjë kundërshtim nga gjiri i anëtarëve mbi mënyrën e punës dhe mjaftësinë e propagandës, gjer në krye të vitit 1886, 21 shkurt.* (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 392) etj.

Po kështu, krahas formimeve të goditura të emrave abstraktë me prapashtesën **-i** (si flamurtari,-a) në grupin e njësive që kemi vjelë gjenden njësi të leksikore që nuk e kanë fituar përbashkësinë e përdoruesve. Kështu, emri **fletori,-a:** *Ky është qëllimi i fletorisë, i shtypit të ditameditshëm përgjithërisht, ashtu si ka qenë dhe ai i kolonive tona kombëtare të mërgimit.* (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 414) (me kuptimin / kuptimet *procesi i të shtypurit a i botimit të një përditshmeje; shtypi i përditshëm; gazetaria*) nuk del si formim me koherencë leksikore, si njësitë e tjera që sot janë ngritur në normë.

4. Në Letërkëmbimin e Lasgush Poradecit qëmtohen njësi mbiemërore prejfoljore me **-shëm,** që mbartin semantikën e mbiemrave të gegërishtes që janë ngritur në normë.

blersh/ëm(i),-me (e) mb. që mund të blihet; që blihet. - *Pasaporta iu dorëzua Nikolla Naços prej Kavazit të Konsullatës Turke, sipas një marrëveshjeje që më parë, pikërisht në çastin e ikjes nga burgu, dhe me atë dokument të blershëm, ku fytyronte nën emrin e rremë Elmas bej, ai u nis drejt për në kufirin greko-turk me qëllim - Stambollin.* (Dhimitër

Kovaçi, f. 421); **vleftësuesh/ëm (i), -me (e)** mb. që ka vlerë; që është i vlefshme, i vlefshëm. - *Po botimet e tyre që mbeten, botimet që mbeten të shoqërisë së Bukureshtit janë vëllimet e vleftësueshme përmbi çastin e ditës dhe të javës dhe të muajit, në traditën e gjatë kulturore të atdheut.* (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 414) etj.

Ka mbiemra të tjerë që nuk vijnë nga një temë prejfoljore, si **zjarrsh/ëm (i), -me (e)** mb. fig. i zjarrtë, i flaktë. - *Nuk i pëlqente ky lloj mbarimi i punërave kaq i qetë dhe paqësor, kaq pasiv, një shoku të ri të Kolonisë, Nikollë N. Naço - Korçës, njeri me temperament, burrë me vendim dhe guxim, dhe “shqiptar i zjarrshëm” i ardhur prej pak kohe nga Mansura e Egjiptit.* (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 392); *Ashtu me të vërtetë pushtohen vashat kullohet dhe lartësohet dhe purifikohet shpirti jonë dashuronjës në përqaftimin e ëmbël të vashës shqiptare, të virgjëreshës timide dhe të guximshme... të heshtur dhe të zjarrshme shqiptare... veçse ky pushtim i përvëlur imi... (Letra të Lasgush Poradecit, f. 485); **shpërjasht/ëm(i), -me (e)** mb. i jashtëm. - *Ndërsa kjo ishte pamja e shpërjashtme e kishës nër festat më të mëdha të saj, 28 Nëntor dhe Shën-Gjergj, përbrenda ajo shkëlqente nga uniformat dhe rrobat e zyrtarëve, po më shumë nga fryma shqiptare që frynte nër zemra. (Himni kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij, f. 372); **gjurmsh/ëm (i), -me (e)** mb. që lë gjurmë. - *Shkaku i mosveprimit të saj të gjurmshëm varet prej gjindjes së udhëheqësve, të cilët s'i jepnin drejtim shpirtëror dhe punë lëndore për të kryer. (Nikolla N. Naço - Korça dhe shoqëria e tij e famshme “Drita”, f. 430) etj.***

Por ka dhe mbiemra që morfologjikisht janë me **-shëm**, por semantikisht dalin me tiparin e përfundimit të veprimit (me semantikën e një mbiemri prejpjesor), madje si temë fjalëformuese kanë një pjesore të dialektit toskë: **druajtursh/ëm(i), -me (e)** mb. i druajtur. - *Sepse nisiativa e “Shpresës” ishte një vendim sa i pabesuar asikohe, aq dhe i guximshëm, duke drejtuar kërkesat shqiptare drejt atje ku kishin qenë dhe ishin më të druajturshme.* (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 412); **mënjanuarsh/ëm (i), -me (e)** mb. i mënjanar. - *Pas asaj ngjarjeje, përpjesëtimet e së cilës vetëkuptohen pa qenë dhe nevoja që të merren nën vështrim hollësisht, Shoqëria mbeti si e shuar, me pendim të*

pashfaqur, po të ndjerë nga të dy palët rreth qëndrimit të tyre mundërsisht të mënjanuarshëm; aqsa dhe anëtarët dhe Pleqësia e saj kishin marrë vendimin për mosqenien më të Shoqërisë, duke redaktuar dhe një procesverbal përkatës. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 394) etj.

Jo rrallë në grupin e mbiemrave me -shëm (që shënojnë mundësi, aftësi etj.) ndeshim ndonjë formim mbiemëror me vlerë të një mbiemri me semantikë vepruesi: **tronditsh/ëm (i), -me (e) mb.** që të trondit, tronditës. *Armiqtë e kombit shqiptar u tundën së jashtmi kundër shoqërisë dhe kundër tij, si frymë flakëronjëse që ish ai i ngjizjes dhe i lëvizjes së saj; kundërshtarët e brendshëm nër shokët e “Dritës” zunë ta ndiejnë me moskënaqje peshën e rëndë të gjallërisë së tij veprimtare; të mësuar siç ishin në ngadalësinë apatike që këshillonte gjindja e radhës borgjeze të tyre, dhe përveç kësaj, pak pas ngjarjes gazmore të themelimit të shoqërisë, kish ardhur dhe ish përhapur në Bukuresht lajmi i **tronditshëm** i Mansurës. (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës. (f. 440)*

Po kështu, edhe ndonjë formim me analogji si formimet e mbiemrave prejpjesorë del me këtë semantikë: **këmbëngulur (i, e)** me kuptimin këmbëngulës. - *Ky ishte një pengim i vështirë për ndërhyrjen e bërë prej “Dritës” së Naços, me atë të drejtë plotësisht të fituar pas aq luftimesh të këmbëngulura drejt kombëtarëzimit të kishës shqiptare. (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës, f. 446)*

5. Po kështu në Letërkëmbim, koherenca leksikore në marrëdhënie të dyanshme si *interferencë e dëshirueshme* dhe si *semantikë diferencuese* mund të shihet edhe te grupi i mbiemrave prejpjesorë që dalin me semantikë polisemike, përjasur me mbiemrat më **-shëm** në gegërishte që mbartin dhe këta semantikë polisemike: **papërmbajtur (i, e) mb.** i papërmbajtshëm. *Thanas Tashko, kryetar, veterani i guximshëm, i papërmbajtur dhe i pathyer në Faium të Egjiptit, i cili pat lënë pas, si trashëgimtare të të gjithë pasurisë së prishur për mëmëdhenë, një familje të shtuar pa strehë shtëpiake dhe një pjellë delikate të shumëdashur, që është bija e tij Tefta Tashko, sopranua korçare e ëmbël e kryeqytetit. (Himni kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij, f. 367); papërshkruar (i, e) mb.* që nuk mund të përshkruhet; i papërshkrueshëm. - ... *Dërgonte me vendim të Komitetit,*

në verën e ardhme të vitit 1885, Thimi Markon në Korçë me mision ndërmjetësimi pranë Dhimogjerondisë dhe mitropolitit Fillotheos Konstandinidhis, duke i porositur që të vihet gjuha shqipe në shkollat greqishte të Korçës, Lakçja i dha Thimi Markos për këtë qëllim, një letër të veçantë të redaktuar pas mendimit dhe dëshirës së Komitetit të Kolonisë - letër që vuri Dhimogjerondinë dhe Mitropolitin në një turbullim dhe vështirësi të **papërshkruar**, mënjandë, sepse, ajo u ra si një bombë e papritur mbi krye me kërkesën që përmbante, më tjetrën anë, sepse ishte shkruar dhe nënshkruar vetërisht prej mirëbërësit të madh korçar, prestigji i të cilit kish qenë rrethi me ar i Komunitetit. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 398); **papërshtatur** (i, e) mb. i papërshtatshëm. Kjo rrethanë e **papërshtatur**, duke bashkëvepruar aty intrigat e armiqve të Naços dhe të kombit shqiptar, bënë që, edhe kësaj here arritja e idealit të tij për themelimin e kishës shqipe, aq afërta prekur pas aq mundimesh, të bëhej prapë e pamundur, për plasjen e zemrave të dhetarëve. (Veprimi i Naços për kombëtarizimin e kishës, f. 446-447); **pavdekur** (i, e) mb. i pavdekshëm. - Sëmundja ime s'kërkon përkrahje me fjalë të zbrazëta, të folura në erë, po ndihmë materiale të vërtetë e të shpejtë, dhe vlera ime si vjershëtor është vlera e pluhurit të **pavdekur**. (Letra të Lasgush Poradecit, f. 476); **pashterur** (i, e) mb. i pashtershëm. Që më 7 Mars 1886, kur u çel shkolla, gjer më 20 Qershor 1902 kur u desh, pas vuajtjesh të skëtërrshme, të mbyllet dhe të pushojë hëpërhë, ajo pat kërkuar një ushqim të panginjur dhe të pashuar lënde mësimi, fletorësh dhe ndihmash të ndryshme shkollore, të cilat plotësoheshin kryesisht nga gjiri i pashterur i Kolonisë. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 404)

Edhe pse koherenca leksikore nuk pranon formime mbiemrash prejpjesorë nga folje jokalimtare, te Lasgushi hasim të tilla që duhet të ishin: **buçitur** (i, e) mb. fig. që ka buçitur, që ka shpërthyer, që ka hovur. Dhe në mbarimin e secilës pjesë të kësaj drame muzikale në miniaturë, ti bën nga një stacion si për të vërejtur që larg ekstazat internnitente të dashurisë, vendos nga një kurorë suspensionit për të lejuar dehjen e ndjenjës së **buçitur** ashtu. (Letra të Lasgush Poradecit, f. 485); **dimëruar** (i, e) mb. fig. **dimëruar** (i, e) mb. fig. i vjetër, që është marrë për shumë vjet me një punë etj. - Kryeredaktor i asaj ishte

z. *Thoma Avrami, veteran tani i dimëruar i veprës së Rilindjes, mësonjës i shkollës së parë shqipe të Korçës në vitin shkollor 1887-1888. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 413); përikur (i, e) mb. i ikur, i larguar nga diku dhe i vendosur në një vend tjetër. - Nga i merrte pra Nikolla Naçua të hollat e domosdoshme të asaj kohe fillestare të gjendjes së tij në Rumani, si mërgimtar i përikur që ishte? (Dhimitër Kovaçi, f. 424)*

6. Në Letërkëmbimin e Lasgushit, siç theksuam më lart, ndeshen emrat e veprimit / mbiemrat të tipit **punonjës** që gjallonin e funksionin natyrshëm në kohën kur ai shkroi dhe krijoi (por dhe sot e kësaj dite në të folmet krahinore të toskërishtes). Kohët e fundit (nën trysinë e letërsisë artistike, sidomos në përdorimet stilemore dygjymtyrëshe) ka filluar që njësi të tilla të kapërcejnë kufizimin hapësinor e ligjërimor dhe gjuha e njësuar të jetë më e hapur dhe për këtë lloj koherence leksikore në fjalëformim. Shpreh bindjen se këtu nuk kemi konkurrime me formimet me **-ues** të ngritura në normë, nuk kemi ngushtim të hapësirave të formimeve modelore nga gegërishtja, por një pasurim stilistikor të gjuhës në përdorim. Sot, mbartësit e arsimuar jugorë të shqipes (por edhe më gjerë) nuk e ndiejnë fare vështirësinë e përdorimit të emrave e mbiemrave me **-ues**. Njësi të tilla bëhen pjesë organike e kompetencës së tyre leksiko-morfologjike lirshëm e me frytshmëri dhe ato në ndërtimet sintaksore hyjnë krejt spontanisht. Ndërtimet e tipit me **-onjës**, duke u nisur nga koncepti i koherencës leksikore, si formime të rregullta në toskërishte, mund të shihen si njësi të specializuara stilistikisht dhe nëse formimet me **-ues** janë pranuar si normë në shqipen standarde dhe krijimi i tyre është një proces i synueshëm, i dëshirueshëm e i pranueshëm dhe rifutja e tyre në përdorim nuk e thyen sistemin dhe ato nuk mund të vlerësohen as sesi si “interferencë e padëshirueshme” në sistemin e formimit normativ të emrave të veprimit në shqipen e sotme.

7. Në Letërkëmbimin e Lasgushit vëren të gjitha mënyrat dhe tipet e fjalëformimit të shqipes kemi përzgjedhur dhe pak fjalë të përbërë, mbartin një koherencë leksikore të saktë e të qartë, dhe që patjetër duhet të zinin vend në fjalorët shpjegues normativë të shqipes. E kemi fjalën për formime si: **lavdirëndë mb.** - *Sapo të jem lehtësuar nga puna*

e rëndë, do ta zgjeroj studimin më tej, kështu që kur të kremtojmë 50-vjetorin e fillimit të shoqërisë së mësimit shqip «Drita» më 1934 (26 dhjetor), t'i japim popullit shqiptar një fytyrë të plotë të mundimeve dhe krijimeve të para të veteranërisë sonë lavdirëndë. (Letra të Lasgush Poradecit, f. 481); **zemërzgjidhur** mb. zemërhapur, bujar. - Vërtet, Kolonia e Bukureshtit ka qenë e gjerë, **zemërzgjidhur** kundrejt vjershëtorit të saj. (Vjershëtori i Kolonisë, f. 379); **mendjeurtë** mb. - Sepse Vretua kishte jo vetëm durimin dhe ëmbëlsinë e karakterit, po ish dhe mendjeurtë dhe i elektrizonte bashkëfolësit dalngadalë si me një magji të pakuptuar. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 385); **mirërregulluar (i, e)** mb. - Ata kishin një kriter propagande kombëtare dhe si të tilla merrnin sa me të dalë udhën e mirërregulluar të tyre. (Mbi shoqëritë shqiptare, f. 405) etj.

Një fushë me interes të pamatë për studimet tona gjuhësore (e më gjerë) është dhe ndjekja e linjës së koherencës leksikore në përkthimtar, një fushë ku Lasgushi e përballi shqipen me gjuhë të tjera me zotësi të pashoqe dhe ku fjala e gjuhës amtare përmes artit të tij fitoi vlera të pamata.

Po i mbyllim këto skicime / vëzhgime në leksikon e Letërkëmbimit të Lasgush Poradecit, vështruar shpesh nga këndvështrimi i semantikës fjalëformuese, duke ripohuar se shkrimtari ynë i madh edhe në këtë fushë tregoi se gjuhësisht është mjeshtër, se e gjithë vepra e tij u mbrujt e ligjëroi shqipërisht.

ISAK SHEMA
Kolegji ILIRIA-Prishtinë

BISEDA MBRESËLËNËSE ME LASGUSH PORADECIN

Në kumtesën kushtuar Lasgush Poradecit, në 120-vjetorin e lindjes, përfshihen kujtime nga takimi me poetin e admiruar, mbresat nga bisedat mbresëlënëse dhe të paharrueshme për jetën dhe krijimtarinë e tij letrare.

Më 6 gusht deri 10 shtator të vitit 1970, me rastin e vizitës sime të parë në Shqipëri, kur me ftesën e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë shkova për qëllime studimi në Tiranë, por edhe në qendra të tjera, u takova me shumë profesorë të Universitetit të Tiranës, me studiues të instituteve shkencore dhe me shkrimtarë. Në mbrëmjen e parë me Jorgo Bulon takuam Ismail Kadarenë, Helena Kadarenë, Dritëro Agollin dhe Sadije Agollin. Të nesërmen ishte organizuar pritja në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ku u takuam me shumë studiues të gjuhësisë dhe të letërsisë. Drejtori i Institutit, prof. Androkli Kostallari dhe bashkëpunëtorët e tjerë, më pritën përzemërsisht. Gjatë ditëve të tjera kishim takime me shkrimtarët: Jakov Xoxa, Fatos Arapi, Sterjo Spasse, Dhimitër S. Shuteriqi, Shevqet Musaraj, Nasho Jorgaqi, Skënder Luarasi, Klara Kodra, Dhimitër Xhuvani, Teodor Laço, etj. Dëshiroja të takohesha me poetin Llazar Sotir Gusho-Lasgush Poradecin.⁵ Profesorin Eqrem Çabej e takova në sallën e leximit të Bibliotekës Kombëtare. Në një kuti të letrës, ku ishte i shkruar emri Çabej, ai më parë la disa skeda shënimesh bibliografike dhe pastaj u afrua dhe u përshëndetëm ngrohtësisht. Profesorin e njihja mirë.⁶

Për të mos penguar lexuesit e tjerë, u ngjitëm një kat më lart, në bufenë e Pallatit të Kulturës. Aty shpalosën kujtimet e mëparshme dhe biseduam për çështje të ndryshme dhe veçanërisht për ato të gjuhësisë dhe të letërsisë. E pyeta për miqësinë që kishte me Lasgush Poradecin, si

⁵ Lasgush Poradeci, Pseudonim i Llazar Sotit Gusho: *Las*, nga tri shkronjat e para të emrit, *Gush* nga mbiemri i tij dhe *Poradeci*, qyteti i vendlindjes që autori i referohej *Poradec*

⁶ Profesorin Çabej e kam takuar shumë vite më parë në kongreset e Asociacionit të Studimeve të Evropës Juglindore, sëpari në Sofje në vitin 1966 dhe pastaj, në tubime të tjera shkencore në Athinë, në Ankara, në Bukuresht etj.

edhe për poezinë “Shok prej zemre - dhe prej gjaku”⁷. Lidhur me çështjen e periodizimit të letërsisë shqiptare me atë rast sqaroi ecurinë që kishte ndjekur dhe, me keqardhje, tha se atë çështje e studimit i kishte lënë cung, pra e papërfunduar.

Eqrem Çabej (1908-1980)

Duke biseduar për krijimtarinë letrare të disa shkrimtarëve shqiptarë të traditës dhe të letërsisë bashkëkohore, foli më shumë për Lasgushin dhe posaçërisht për kohën e kaluar bashkë me të gjatë studimeve në Austri, por edhe për afërsinë që kishte me të gjithnjë. Më tregoi se takohej shpesh herë me mikun e tij të shtrenjtë. Me profesorin Çabej takohehim edhe gjatë ditëve të tjera në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Aty takoja dhe bisedoja me profesorët: Mahir Domi, Shaban Demiraj, Koço Bihiku, Jorgo Bullo, Jani Thomaj, Miço Samara, Seit Mancaku, Bahri Beci, Luan Daka dhe shumë të tjerë, për të cilat kam shkruar në dorëshkrimin “Kujtime”.

Profesorit i shfaqja dëshirën për ta takuar poetin Lasgush Poradeci. I tregova se më parë së bashku me profesor Jorgo Bullo, kam takuar disa shkrimtarë, por jo edhe Lasgushin. Për fat të mirë, dëshira ime u realizua më vonë, kur Lasgushi kishte ardhur në Tiranë. Një ditë tjetër, derisa shikoja katalogun e albanologjisë, hyri në sallë profesor Çabej dhe më ftoi për t’u takuar me shkrimtarin, me këtë krijues të jashtëzakonshëm dhe të adhuruar. Shkuam në lokalin që ndodhej një kat më lart. Ambienti ishte i bukur dhe duke pirë kafe, bisedonim së bashku shumë të gëzuar.

Ai ishte ulur afër dritares dhe rrinte i heshtur, duke parë larg pamjen që i paraqitej nga dritarja. U ngrit me lehtësi dhe u përshëndetëm ngrohtësisht. U gëzova shumë se Lasgushin, që e njihja duke lexuar dhe studiuar veprën e tij poetike, e takova në Shqipëri.

Profesor Çabej i kishte treguar më parë për takimin tonë, prandaj ai e dinte që isha mësimdhënës i Degës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe i Universitetit të Prishtinës, i themeluar më 15 shkurt 1970.

Lasgush Poradeci (1889 - 1987)

Pas përshëndetjes dhe prezantimit të përzemërt, biseda për Kosovën

⁷ Shih edhe : Lasgush Poradeci: *Vdekja e Nositit* , Rilindja, Prishtinë, 1978, f.207.

dhe për zhvillimin e letërsisë zgjoi interesim të posaçëm. Lasgushi tha se ishte njoftuar se kohë më parë është hapur ky universitet dhe se ishte gëzuar shumë. Kosova ka universitet... I tregova se në kuadër të Fakultetit Filozofik, që nga 1960 zhvillon veprimtarinë arsimore dhe shkencore Dega e Albanologjisë (Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe).

Lasgushi pohoi se ka takuar më parë edhe disa profesorë nga Kosova. Ai fliste megjithatë për takime të rralla, siç iu kujtua Konferenca e Studimeve Albanologjike. Për këtë takim ka shkruar edhe në ditarin e vet:

“Tiranë, 12 janar 1968, ora 1 pas mesdite: U takova përpara shkallëve të Pallatit të Kulturës me profesorët shqiptarë kosovarë të Universitetit të Prishtinës (Jugosllavi), të ardhur për të marrë pjesë në Konferencën Albanologjike (me kumtesat e tyre). Ishte aty prof. Ahmet Gashi (kosovar), arsimtar në Shqipëri gjatë 50 vjetëve, i cili i'u tha: "E njihni? Lasgush Poradecin!". Ata sapo dëgjuan emrin tim, me fytyrë të çelur befasisht, më shtrënguan duart dyke më përqaftuar dhe me gëzim më thanë: "A! Lasgushi! Ju jini Lasgush Poradeci? Jini i dashur, jini i adhuruar nga gjithë studentët universitarë shqiptarë të Kosovës dhe Metohisë, nga nxënësit e gjimnazeve dhe të shkollave fillore, nga shqiptarët intelektualë! Jua kemi botuar të dyja librat, *Vallja e Yjve* dhe *Ylli i Zemrës*, jini artist i math!". Edhe shumë fjalë dhe tregime dhe hollësira të tjera më thanë - kur njëri, kur tjetri - për simpatinë aq të madhe siç theshin ata, që paska inteligjenca kosovare për Lasgushin. Konferenca mbahet prej 12-18 janar. Nga profesorët njëri ishte ortodoks, tjetri katolik, tjetri musliman”⁸

Profesor Çabej në vazhdim foli shkurt për angazhimin dhe kontributin e profesor Idriz Ajetit për zhvillimin e albanologjisë. Në fillim të bisedës sonë dëshiroja t'i thoja poetit se poezia e tij lexohet me interesim të jashtëzakonshëm nga studentët, nga nxënësit dhe nga lexuesit e tjerë. Gjatë viteve pesëdhjetë dhe në fillim të viteve gjashtëdhjetë, një përmbledhje të poezive e shumëzonim me shaptilograf dhe e shpërndanim për ta lexuar. Kjo bënte pjesë në materialet e tjera kushtuar shkrimta-

⁸ “https://264517.forumromanum.com/member/forum/forum.php?action=std_show&entryid=1090018175&USER=user_264517&threadid=2)

rëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, por edhe të atyre të mëvonshëm. I përmenda pastaj disa nga botimet e reja. Ai më dëgjonte me interesim dhe më pyeti: Cilët janë poetët e sotëm shqiptarë të Kosovës? Veçuam disa vepra letrare të shkrimtarëve të shquar të letërsisë shqipe, të përfshirë edhe në antologjinë e poezisë shqipe.



Lasgushi gjatë bisedës përmendi se më parë kishte shkruar në gjuhën gjermane një poezi kushtuar Kosovës - Shqipërisë. Për të pohoi edhe Çabej. Të dhënat që sjell më poshtë, atëherë nuk i kam pasur të njohura.

*An Albanien
Große Stunde, dir ich meine
Steig' empor und werde Licht!
Daß sich Stamm dem Stamm vereine!
Bess're Heimat weiß ich nicht.
Haß der Welt und Sklawenschande
Heißt das Leid, das uns geschah:
Nimm dein Kind von Slawenlände
An dein Herz, ALBANIÁ.*

*Për Shqipërinë
Orë e madhe, ty të lutem,
Ngjitu lart edhe shëndri!
Bëj që fis me fis të lidhen,
Átme t'shenjtë më, un' s'di.
Helm i botës, turpa skllave
Quhet dhembja që na ra:*

*Merr tēt bij' prej vënde sllave
N'gjiun tënd, ALBANIÁ."*

Shënim:

Këtë tekst poetik e e kujtuan Lasgushi dhe Çabej. Fjala *Kosovë* në titull është zëvendësuar me *Albania*.


Prof. Kristaq Jorgo ka shkruar për këtë poezi vështrimin: "Për Shqipërinë dhe Kosovën". Ai jep shënimin: "Richard Pichler-i ishte njëri nga dy djemtë e familjes Pichler, në shtëpinë e së cilës jetoi Poeti gjatë viteve të tij të studimit në Grac. Ndryshimi i emrit "Albania", për të cilin flet Poeti, ka të bëjë me faktin se ai vendos në fund të poezisë (për hir të rimës, ndoshta dhe me ndonjë tjetër funksion) këtë trajtë, dhe jo trajtën 'Albanien' të gjermanishtes. Në sprovën shqipëruese parapëlqeva ta le trajtën 'Albaniá', e cila këtu, ashtu si në origjinal, duhet shqiptuar me theks në rrokjen e fundit."⁹

Duke kujtuar kohën e kaluar në Grac (Austri) biseda midis miqve të hershëm, për një qast përfshiu edhe kujtime për studentët e tjerë shqiptarë të asja kohe, me të cilët kishin kaluar gjatë studimeve, siç janë: Skënder Luarasi, Aleks Buda etj. Për mua rrëfimi për këto personalitete të shquara, të cilët i kisha takuar më parë, ishin shumë interesante. Lasgushi për Luarasin fliste me respekt dhe dashuri të madhe.

Tregova se profesor Budën e kisha takuar në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, ndërsa profesor Luarasin e kemi takuar bashkë me profesorin e Universitetit të Prishtinës, Latif Berisha. Nga autori i monografisë "Isa Boletini" kemi dëgjuar rrëfime të ndryshme lidhur me veprimtarinë e tij dhe sidomos për heroin e veprës së tij dhe për Kosovën. Kosova është e pranishme në disa shkrime dhe biseda të Lasgush Poradecit. Të kujtojmë tekstin e tij: "*Do të vijë një kohë, kur do të vemë në dasmë e do të urojmë: Mos e pifshim këtë gotë, po të mos bashkohemi me Kosovën! Dhe do të vemë në vdekje dhe do të ngushëllojmë: Mos e pifshim këtë gotë në mos u bashkofshim me Kosovën... Do të vijë një kohë kur dollia do të fillojë me këto fjalë: Mos e pifshim këtë gotë në mos u bashkofshim me Kosovën.*"

⁹ (<http://redaktori.net/per-shqiperine-dhe-kosoven-del-ne-drite-doreskrimi-i-poezise-ne-gjermanisht-nga-lasgush-poradeci/N'gjiun-tënd,ALBANIÁ.>)

Po ashtu vargjet poetike të tij kushtuar Kosovës në poemën “Mbi ta” i përkushtohen Kryengritjes së Malësisë së Madhe.



Dorëshkrimi i Lasgush Poradecit

“Kaptuam shtatë male rresht

E s’folëm shtatë fjalë,

Kaptuam shtatë male rresht

Malësisë për t’ju falë.

<https://www.gazetaobserver.com/lasgushi-dhe-kosova/>

Dhe poeti vijonte:

Kush është lulja në Ballkan

Që bota i ka sevdanë

Kosova që s’njeh sulltan

Plot difë e kapedanë.

Kosova që bën sulm në zjarr

Posi dragoj me fletë,

Siç bënte sulm ngadhërimtar

Gjergj Kastrioti vetë.

Të sedrës e me shpirt krenar

S’durojnë cen a dhunë

*Tregojnë gjoks në sulm e zjarr
Si shkaba në furtunë”.*¹⁰

Duke lexuar poezinë e Lasgush Poradecit “Zemra e shokut”, në të cilën përjetësohet dashuria, besnikëria, bujaria dhe fisnikëria midis njerëzve, që gjatë jetës i lidh miqësia e vërtetë, m’u përtërinë kujtimet e paharrueshme të takimeve të para me poetin, Lasgush Poradecin dhe me profesorin Eqrem Çabej. Në këtë poezi Lasgushi i drejtohet mikut të dashur:

*“Të kam shok nga koh’ e vjetër
Shok prej zemre -edhe prej gjaku...
Shok të ri me besë plaku
Nuku kam, nuku ke tjetër.
Se ç’do gas e mall të shkretë
M’i ke thënë-emër me emër,
Unë-i mbylla mun në zemër
Gjer sa zemra të mos jetë.*

*Se ti mban në kraharuar
Shenjtërinë-e një dhurate:
Mban në fund të zemrës s’ate
Ç’të kam thënë-i llaftaruar.
Ish e bardhë-e nuku kishte
Dredhëri zemra bujare:*

*Bënte botën zilitare
Zemr’ e bukur shokërishte.*

(“Zemra e shokut”)

Cili ka qenë ky “Shok prej zemre - dhe prej gjaku” i poetit tonë kombëtar? Kujt ia ka kushtuar këtë poezi të frymëzuar dhe të realizuar artistikisht? Me këto vargje i është drejtuar Eqrem Çabej, mikut të shtrenjtë të rinisë dhe të pleqërisë.

Isak Shema (Tiranë, 1970)

Takimi me këto dy personalitete të shquara të gjuhësisë dhe të letërsisë shqiptare shumë vjet më parë, në Tiranë më 1970, më ka lënë mbresa të

¹⁰ Nga Meri Lalaj <https://madame.gazetamapo.al/lasgushi-dhe-kosova/>

pashlyeshme. Me profesor Çabejn për jemi takuar shumë herë, në Shqipëri, në Kosovë dhe në vende të tjera. Gjatë bisedës, përveç të tjerash, ai shpaloste kujtimet e veta për shoqërimin me Lasgushin. Ai fliste edhe për shkrimin e vet të parë për poezinë e këtij poeti të adhuruar. Vështrimi kritik letrar i Eqrem Çabejt “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit”, i shkruar në Graz më 1929 dhe i botuar në Tiranë në shkurt të atij viti në “Gazeta e Re”, për shumë vjet ka tërhequr vëmendjen e lexuesve dhe të studiuesve të letërsisë. “Lasgush Poradeci, ka shkruar Çabej, na hap portën e një jete të re në poezinë shqiptare, një “frisson neuf” siç pat thënë V. Hugo për vjershat e Baudelaireit, lind e rritet në lëmën e këngës shqiptare një stil i ri, të cilin do ta kërkosh më kot ndër poetët e tjerë shqiptarë, po më kot edhe ndër shkrimtarët e huaj nga shkaku i origjinalitetit që shquan këtë poet djalosh.. Këtu ndjenja e mendime që nuk kish guxuar e s’kish arritur kurrkush ndër shqiptarët e pendës t’i shfaqte, këtu një stil i munduar, i cili ndryshon nga shkrimi i një Naimi..., si bie fjala një pjesë beethoveniane nga një mozartiane. Ky është stili i Lasgush Poradecit”. Çabej, duke u bazuar në vlerësimin e vet estetik, me një mburrje të veçantë konstaton praninë e Lasgushit në letrat shqipe. Poezia e tij “ka shumë vjet që tingëllon në veshin e Shqiptarit; po e ngadalshme e si nga larg”. Ai shpreh mendimin se me këtë poezi më parë askush “nuk është marrë estetikisht”. Lexuesit shqiptarë, varësisht nga niveli i formimit të tyre të përgjithshëm letrar “më shumë pëlqejnë do vjersha idilike si “Kroi i Poradecit”. Vetëm disa lexues “shijojnë-thellësitë moderne të tija; një shenjë e cektësisë së shijes shqiptare të sotme”.

PORADECI

Perëndim i vagëlluar mi Liqerin pa kufir

Po përhapet dal-nga-dale një pluhurë si një hije.

Nëpër Mal e nër Lëndina shkrumb' i natës që po bije,

Duke sbritur që nga qjelli përmi fshat po bëhet fir...

E kudó krahin' e gjërë më s'po qit as pipëlim:

Në katund kërcet një portë...në Liqer heshtë një lopatë...

Një shqiponjë-e arratisur fluturon në Mal-të-Thatë...

Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t'im.

Tërë fisi, tërë jeta, ra... u dergj... e zuri gjumi...

Zotëroj më katër anë errësira...

Po tashi:

Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri,

Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shënndaumi

Para se të analizojë poezinë lirike të Lasgushit, Çabej bën një vështrim për literaturën e Shqipërisë së re. Ai vë në dukje “frymën etike (morale)” të saj. Letërsia është zhvilluar në dy periudha kryesore. Në të parën përfshin poetët: Jeronim De Rada dhe Naim Frashëri, që më shumë trajtojnë motivet patriotike, “në jetën dhe në veprën e të cilëve, midis të tjerave, një ide kryesore është flaka e madhe që i ndez për lirinë e Atdheut”. Duke spikatur tiparet e poezisë së tyre, dhe ndryshimet e natyrshme të artit poetik, shquan disa nga karakteristikat e letërsisë shqiptare të romantizmit në krahasim me ato të letërsive evropiane.

Periudhën e dytë të letërsisë Çabej e vlerëson të kompletuar edhe me karakterin humanist bashkëkohor. Në këtë kohë “ideja kombëtare i lë udhën idesë njerëzore... syri i poetit u hap për horizonte më të gjera, vegime më të thella”. Krahas Asdrenit, edhe Lasgushi krijon një poezi novatore. Me këta poetë hapet periudha e dytë, “e cila mund të quhet periudha moderne e poezisë shqiptare”.

Poezia e Lasgushit sipas Çabejt ndryshon nga ajo e Asdrenit dhe e poetëve të tjerë. Thellësia e mendimit të shfaqur është dhuntia artistike e tij. Lasgushi “Është vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipet; në qoftë se kjo nuk është vënë re gjerë tani, shkaku është se më të shumtët nuk e kuptojnë poezinë e tij, e cila me fjalë e mënyra foljesh fare të thjeshta, e shumë herë popullore, arrin të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta. Dhe po të këndohet Lasgushi me dashurinë, do të vërtetohet thellësia e tij e pa shoqe, në mos sot, nga breza që do të vijnë”.¹¹

¹¹ Isak Shema: Eqrem Çabej për Lasgush Poradecin, në “Identitete letrare I”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2015, f. 85-92.

Poezia e Lasgushit është krijim i kohës moderne dhe si e tillë bënë pjesë natyrshëm në poezinë moderne evropiane. Kjo epokë ka njohur poetët e mëdhenjë evropianë, siç janë: Rilke, Stefan George (letërsia gjermane), V. Hygo, Bodleri, Verleni, Mallarme, Rembo, Valery (letërsia frënge), Carduçi, D'Annunzio, Pascoli etj. (letërsia italiane), Sergej Jesenin (letërsia ruse) etj. Lasgushi, sa i përket konceptcionit të krijimit të poezisë “nuk është poet lirik në kuptimin e vërtetë të fjalës: nuk do të gjesh të ëmbla e të buta melodi; më shpesh vjershat e tij janë drama dhe shumë prej syresh tragjedi të vogla; shquan prologun, aktin e parë të dramës, kulmin e dramës, pastaj, si vala e detit e “Këngës pleqërishte”, bie, bie, bie, pasi pat luftuar shpirti i munduar, i munduar më kotë” ...Ideali estetik i dashurisë në poezinë e Lasgushit është origjinal. Pa e njohur mirë Lasgushin dhe jetën e tij, është vështirë të njihen disa nga premiset kryesore të poezisë së tij. Duhet njohur mirë edhe ndikimet letrare nga poezia e poetëve klasikë botërorë, apo nga ajo e poetëve bashkëkohorë. Në këtë labirint të misterit të krijimtarisë letrare klasike dhe moderne Lasgushi është zë i veçantë. Frymëzimi i tij poetik i përket artit, “Prandaj misioni i artit, ka pohuar Lasgushi është të na japë një kënaqësi estetike, që qëndron mbi të gjitha këto mizerje të jetës... Artisti krijon për vete siç këndon edhe bilbili”. Lasgushi ka shprehur bindjen e tij se poezia duhet të jetë shumë e mirë, shumë e lartë, shumë e thellë “që t’i vëmë shpirtit të kombit themele të shëndosha. “Poezia, ka pohuar ai, është divine (yjnore). Prandaj kur shkruan poezi duhet ta keshë shpirtin të shenjtëruar. Çdo poezi duhet të jetë një xhevahir dhe xhevahir duhet të jetë çdo varg i saj dhe çdo fjalë e saj duhet të jetë xhevahir”...

Çabej ka analizuar poezinë e Lasgushit dhe ka shprehur mendimin se ajo është e qartë dhe e realizuar artistikisht. Megjithatë lirika e tij nuk është transparente. Disa poezi të tij nuk kuptohen lehtë “po moskuptimi i lehtë, të themi errësira e disa vjershave të tija, nuk është një e metë. Fundi i fundit çdo thellësi është e errët”.

Vështrimin për poezinë e Lasgushit Çabej e përfundon me vlerësimin e gjithanshëm dhe shumë afirmativ. Megjithatë, ai ka dhënë edhe disa vërejtje dhe për to ka thënë: “Le t’i shërbejnë kuptimit të poezisë së Lasgush Poradecit, ...të cilin një fat i mirë duket sikur ia ka falur

Shqipërisë që të bëhet ai shkrimtar, të cilin Shqipëria do t'ia falë një herë botës”.

Duke përfunduar këtë tekst përkushtimi kujtimesh dhe vlerësimesh për dy figura të ndritura kombëtare, edhe sot me nderime dhe krenari përkujtojmë poetin, Lasgush Poradeci dhe gjuhëtarin, Eqrem Çabej, dy kurora të përjetshme të poezisë dhe të gjuhësisë shqiptare.

JONELA SPAHO
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

**“KAMADEVA” - NJË SIMFONI E DASHURISË QIELLORE
DHE TOKËSORE**

Poema “Kamadeva” e shkruar në një hark të gjatë kohor, konsiderohet si krijimi poetik sintezë e gjithë lirikës lasgushiane me temë dashurinë. Poema e shkruar në vitin 1958, vjen si rezultante e koncentrimin në të, të ndjenjës, mendimit dhe përjetimit, filtruar përmes botës shpirtërore të poetit në një moshë relativisht të pjekur, i cili duke kaluar gjatë në prizmin e përvojave ndjesore, por edhe të ngjizjes së një botëkuptimi eternal për dashurinë, arrin të vërë përmes kësaj poeme kurorën e diamantë në kryet e lirikës erotike shqiptare. Poema është një kulm, një ngjizje harmonike e komponentëve artistikë, estetikë, filozofikë dhe mistikë, që na bën ta shohim ndjenjën në gjithë spektrin e mrekullueshëm të ngjyrave, ndijimeve, tingujve dritë-hijeve që ofron, të cilat nuk kishim mundur t’i konceptonim kaq qartë pa lexuar këtë himn madhështor për dashurinë. Poeti preferoi ta titullonte poemën me emrin e perëndisë indike të dashurisë dhe çuditërisht nuk zgjodhi një emër të njohur të mitologjisë mesdhetare, të cilës dhe i përkiste. Sipas M. Zeqos: ”...përcaktimi i emrit Kamadeva ka të bëjë me formimin kulturor gjermanik të Lasgushit. A ka patur një arsytim të thellë dhe bindës Lasgushi për titullin e poemës së tij me emrin e Hyjit indian të Dashurisë? Këtë nuk mund ta dimë. Ndoshta edhe nuk kemi pse ta dimë. Ndoshta fakti që shqiptarët, si popull indoevropian nuk e kanë të dokumentuar në mitologjinë e tyre antike ilire emrin e një Hyjit të dashurisë e bën më të besueshme pikëpamjen se Lasgushi, qëllimisht, është tërhequr nga emri Kamadeva për të treguar se në mungesën e një emri të ngjashëm, të tillë, tek shqiptarët si pasardhës të ilirëve, mund të përdoret një simbolikë më universale.”

Ndërsa Petraq Kolevica te libri i tij “Lasgushi më ka thënë” aludon për një huazim të emrit “Kamadeva” prej Lasgushit nga një poezi me të njëjtin titull e Emineskut, duke sjellë atë për herë të parë në variantin

shqip.¹² Edhe pse të dy krijimet kanë titull identik dhe shprehin konceptin themelor të poetëve për dashurinë, ato janë krijime origjinale dhe me një strukturë origjinale të shprehjes poetike. Sipas H.Matoshit, ndikimi i kulturës së lashtë indiane në këtë poemë është fare pak i pranishëm, krahasuar me ndikimin që ushtron ajo në krijimin e Emineskut. Te Lasgushi, përveç titullit, elementëve kozmogonikë dhe frymëzimit që e bazon në këtë kulturë, nuk mund të gjenden elemente të tjera karakteristike për dashurinë të konceptuar sipas kulturës së lashtë indiane, ndërsa tek Eminesku krahas titullit dominon koncepti mbi dashurinë që mbështetet tek vedat. Pra të dy krijimet frymëzohen me intensitet të ndryshëm nga kjo trashëgimi kulturore, gjë që iu jep atyre mëvetësi të theksuar.¹³

Konceptimi i Kamadevës deri diku është i njëjtë të dy poetët, pra perëndia e dashurisë që qëllon me shigjetë zemrën e të dashuarve duke i futur në një valle marramendëse, që i ngre në qiell krijesat e pastaj i përplas pa mëshirë përtokë; pra, karakteri kontradiktor dhe i dyfishtë i zotit të dashurisë. Por shtjellimi, strukturimi, stilistika, përmasat janë të mëvetësishme të secili autor. Kamadeva e Lasgushit qëndron hijerëndë, e bukur madhështore, ka tjetër dimension artistik dhe intensitet të jashtëzakonshëm, ku çdo varg ka vlerën e një lingote ari,- siç shprehet Petraq Kolevica të poezia kushtuar kësaj poeme. Lasgushi kishte tezën e tij etniale mbi artin, i besonte fuqisë së artit të vet: “Ne s’pyesim çfarë marrim dhe ku e marrim. Ne pyesim se ç’bëjmë me atë që marrim. Bëmë dot me të një vepër arti? Po? Atëhere ajo që morëm dhe prej nga e morëm zhduket. Bëhet e jona. Ja si bëhet arti!” Ndërsa pikëpyetjes së studiuesve se përse nuk zgjodhi një emër të mitologjisë klasike për poemën e vet, Lasgushi i jep këtë përgjigje: “Unë Lasgushi nuk kam përdorur kurrë në poezinë time emra mitologjike (greke ose romake), jo se jam modernist, as se jam modern, po se dua të jem me ndjenja, me shprehje të përjetshme, dmth përgjithërisht të njerëzishme, humane, të kuptueshme dhe jo se dua të jem modern në poezi. Poezia s’ka as modernizmë as mitologjizmë. Kush i kupton fjalët mitologjike? Veç ndonjë specialist i antikitetit. Lexonjësi

¹² Kolevica, P., Lasgushi më ka thënë, f.188

¹³ Matoshi, H., Poezia e L.Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane, f, 132

do kuptuarshmëri, jo specialshmëri. Mund të përdorim, p.sh., fjalën indike *Kamadeva*, po duhet t'ia shpjegojmë aty për aty lexonjësit, t'i themi se "Kamadeva" në mitologjinë indike është zoti i dashurisë - dhe kuptimi për lexonjësin është imediat."

E shkruar pra në hark kohor të gjatë, filtruar përmes përvojash shpirtërore dhe një arti që sa vjen përsoset dhe lëmohe në çdo fjalë e tingull, poeti ka të drejtë kur thotë: "Jo njëqind po as njëmijë vjet nuk njaftojnë të shkruash për dashurinë. Ato poezi dashurie që mund të shkruhen në moshë të thyer, s'mund të shkruhen dot në të ri."¹⁴

Në rini ndjenja është fluturake, fluide dhe shpesh njeriu nuk arrin të përqendrohet te ajo që ndjen, si dhe të shpjegojë mënyrën si ndjen, ndërsa në moshë të thyer kupton më mirë, ndien më mirë qartëson më mirë konceptet, rrethanat, kohët, i shkrin ato në një dhe arrin të kurorezojë krijimin me këngën e fundit të mjelmës. Kjo është "Kamadeva" një simfoni e dashurisë qiellore dhe tokësore, tokësore dhe qiellore.

Çelësin e interpretimit të poemës në rrafshin filozofik e mistik na jep vetë Lasgushi kur na shpjegon qartë siç di ai të flasë, thjesht e bukur, konceptin e dashurisë tek "Kamadeva": "Koncepti im për "Kamadevën" është më i mirë se ai i Dantes. Në pjesën e parë shihen të rinjtë, dashurohen e shijojnë këtë dashuri, por demoni i së keqes i ndan. Në pjesën e dytë unë e kërkoj të dashurën në qielli. *Kaptoj hapësira pafundësisht të mëdha, duke kaluar me shpejtësi kozmike dhe e gjej. Dashurohemi përsëri, me një dashuri të madhe të shpirtërore dhe unë dua ta afrojmë të dashurën, ta prek, ta puth, ta përqafojmë. Dhe e prek, e puth e përqafojmë, por kjo puthje, kjo prekje, ky përqafim s'më ngop, se s'është tokësor. Këtu është koncepti i ndryshimit të dashurisë sime nga ajo e Dantes për Beatriçen. Prandaj s'më ngop kjo dashuri qiellore dhe zbres përsëri në tokë. Dhe kjo dashuri në tokë që s'më ngop dhe e kërkon dhe në qiell dhe s'më ngop dhe pres ta gjej në tokë, përsëri dhe është vetë natyra e njeriu që kërkon e kërkon dhe s'ngopet kurrë."¹⁵*

Petraq Kolevica dha përcaktimin më të bukur për këtë poemë duke e quajtur një simfoni, nga arkitektura dhe thurja e saj, një simfoni me tone të trishtuara, melankolike, të dhimbshme, të gëzuar, të ëmbla, të

¹⁴ Kolevica, P., Lasgushi më ka thënë, f.132

¹⁵ Po aty, f.119

mrekullueshme, ku shkrihen në një harmoni të përsosur të gjithë instrumentat, secili me të veçantën dhe bukurinë e vet absolute. Ja përse “Kamdeva” mbetet në letërsinë shqipe simfoni e dashurisë qiellore dhe tokësorë.

Vepra merr jetë nga kujtimet e poetit mbi dashurinë, nga terreni kozmik i mallit lasgushian. Poeti e ndërton poemën mbi referime personale, por ajo nuk është vetëm një sintezë e një përvoje të tillë, por e dashurisë dhe e pushtetit të saj mbi njeriun, e nevojës së njeriut mbi të, si ndjenjë e përjetëshme që u jep dhe mban jetën krijesave, si ndjenja më e lartë e harmonisë tokësore, si forcë mikluese permanente e erotikës mbi qenien njerëzore.¹⁶

Lagushi hershëm i ka kënduar dashurisë në të gjitha nuancat dhe shfaqjet e saj me një psikologjizëm të theksuar dhe thellësi mendimi. Dashuria për të të është lajmotivi i jetës, qëllimi dhe bukuria sublime, arsyeja pse jetojmë, arsyeja e krijimit të botës dhe jetës. Sipas filozofisë indike të përshkruara në vedat, lëvizja e pikës zanafillore është “kama” e përkthyer si afsh dëshirë, dashuri, një mall i paanë. Për botën indike kjo është e natyrshme sepse krijimi nuk mund të kuptohet veçse si shpërthim, një tendosje shpirtërore, një dashuri afektive duke kopjuar kështu ekzistencën. “Kama”(dëshira) përbën misterin e ekzistencës së botës. Është shenja e njohjes së vetvetes, është impulsi i progresit është lidhja mes qënies e mosqënies. Pikërisht, kësaj dëshire, këtij malli (sepse edhe në këtë krijim të fundit për dashurinë ai nuk i ndahet fjalës mall) autori projekton dhe ndërton pallatin më madhështor poetik të dashurisë. Kjo poemë vjen si një rezultat logjik dhe artistik i gjithë komponentëve që përbëjnë poezinë e Lasgushit. Duke i besuar fuqisë së artit të vet, duke qënë i bindur në vërtetësinë dhe bukurinë e tij, ai nuk i shmang arketipet artistike të përdorura më hershëm në krijimtari, por i pasuron ato, u jep më shumë vezullim, ngjyra, tinguj dhe muzikalitet. Në këtë poemë ndjenja përthihet në njëmijë prizme duke na shpalosur me madhështi gjithë mozaikun shpirtëror të dashurisë, ku zotëron më shumë e errëta e thellë, e errëta e zbehtë, e verdha e ndritshme e kuqja e gjakut dhe dashurisë, e gjelbra e pyllit e barit, e najazmës, e kuqërremta e gjetheve, të gjitha të vendosura në vendin dhe masën e

¹⁶ Topciu. L., Tekstualizëm dhe stil, f.66-67.

duhur si në një afresk gjigant, të gjitha në një harmoni solide si në një simfoni perfekte.

Qendra e njeriut është uni i tij, prej tij fillon gjithçka që drejton jetët tona dhe marrëdhëniet me realitetin. Autori preferon të mbetet në kufijtë e vetvetes në atë pjesë që është më e bukura, por dhe më e padëshifrueshmja, më dëshirën e përherëshme për t'i dhënë një zgjidhje misterit. Përse ky mall gazehelmprurës, përse në qiell e përsëri në tokë e përsëri nga toka në qiell? Sepse dashuria duke qënë energji eternale qarkullon pandërprerë; ajo zbret nga qielli me ngarkesën e saj divine dhe realiteti e sendërton sipas kufijve të tij të përcaktuar, të cilët shpesh e çënojnë dashurinë, e pengojnë, e deformojnë, prandaj dashuria preferon të largohet përsëri drejt sferave qiellore, për të zbritur përsëri në një formë të re, të rigjeneruar. Për këtë arsye perëndia e dashurise, Kamadeva, herë është ëngjëll e herë demon, herë është dritë e herë errësirë e skajshme:

"Ja shoqëzë tani, / dhe mbrëmja vate, / Po ndehet nj'ag i zi, / Një cipë nate"¹⁷

Poeti përsëri iu referua universit të dashurisë, por pa e lidhur atë drejtpërdrejt me realitetin dhe problemet e tij, si dhe me pengesat reale që i vinin kësaj dashurie si rezultat i normave, patriarkalizmit, mentalitetit të kohës e shumë probleme të këtij lloji. Në këtë krijim Lasgushi e përforcon tezën se nuk ka lirikë të madhe pa dashurinë, duke i kënduar kësaj ndjenjë në fuqinë e saj shpirtërore dhe fizike. Ai vazhdon të zgjerojë qerthullin e konceptit të dashurisë, si një fshehtësi, si një mister e ndonjëherë si llaftar, robëri, por dhe si liri, ëmbëlsi, gaz, drithërimë e bukur prej së cilës regëtojnë qelizat e shpërthen dëshira për jetën:

"O mall! O dashuri, / O yll o djellë, / Sesi më djeg në gji, / në zemër thellë"¹⁸

Poema fillon me të njëjtat vargje dhe mbyllet me të njëjtat, si për të na kujtuar që koha ka kaluar, mosha gjithashtu, por jeta që vjen përmes kujtimit në shfaqjet më esenciale dhe spektakolare të saj, është në gjendje që ta rizgjojë subjektin lirik dhe t'i japë një përjetim të dytë, po

¹⁷ Poradeci L., Poezia, Vepra I, f.309

¹⁸ Po aty, f.329

aq të fuqishëm sa i pari. Jeta me dhimbjen e saj e ashpëron zemrën e njeriut, por dashuria dhe kujtimi i saj janë në gjendje ta zbusin këtë koracë të fortë e të shkojnë drejt e tek thelbi. Poeti shkon me shpirtin zemërak në rrugën ku janë kujtimet, ku jeta e mjerë i ringjallet nga malli, nga kujtimi i dëshirës së ndritur, e cila është buçitëse, gjëmëmadhe, vetmitare, e ngashëryer.

Nga mijëra coprat e ndritshme të kaleidoskopit të dashurisë ai shquan vetëm një, atë më të bukurën, më të mirën, më të ndritshmen, ngarkuar me stoli(fizike dhe shpirtërore): kurm hollë e mesthyer; shtathedhura selvi; e hepura si bari; llëra kulluara; e qëruara si ari; vetull kurorë; kaprollja rritur me mjaltë; sy qengjërushja; fatijëza plot nur, etj.

Lasgushi arrin të krijojë kështu arketipin e objektit të dashurisë, vashën e ëndërrimeve të tij, objektin e dëshirës fizike dhe shpirtërore. Kjo është dashuria e jetës së tij e frymëzuar prej një krijesë të tillë shkëlqimplotë nga stolitë.

Kësisoj, i frymëzuar nga objekti i dashurisë ai krijon përmes kësaj poeme arketipin e së dashurës. Dashuria si ndjenjë eterne që përshkruhet në gjithë oshilacionet e saj psikologjike e dramatike, kthehet, gjithashtu, në arketipin e dashurisë sublime që kalon në të gjitha sprovat e saj, në të gjitha zikzaket, hipjet dhe zbritjet dhe krijesa nuk bën gjë tjetër veçse e shoqëron atë, e ndjek edhe në dritë edhe në terr, edhe në parajsë edhe në ferr.

Në këtë poemë i hasim të gjitha; si konceptimin filozofik dhe përca-ktimin shpirtëror të ndjenjës së dashurisë, ashtu dhe përshkrimin e çastit apo gjendjes psikologjike shpirtërore të heroit lirik. Të habit në këtë poema fuqia poetike për të dhënë thellësinë e mendimit, por dhe alternimin e gjendjeve. Ajo shpesh dhe spontanisht, në mënyrë fluide, siç janë fluidë çasti dhe ndjenja, kalon nga përshkrimi i forcës së dashurisë, në trazimin që sjell dhimbja e nga dhimbja kalon në zemërim, nga zemërimi në kujtim, nga kujtimi në ekzaltim, nga ekzaltimi në mall.

Lumturia dhe trishtimi janë, njëkohësisht, një alegori e autorit për të realizuar synimin e bukur se si mund të përshkohet me një udhëtim të brendshëm hapësira që ndan njerëzit e dashuruar. Dashuria bëhet kështu epiqendra dhe pika e gravitetit të gjithësisë. Kur poetit i mungon

e dashura atij i mungon gjithë bota, prandaj në poemë nuk shohim të gjallojnë njerëz të tjerë përveç vajzës dhe natyrës, që qëndron në sfond dhe i shkon për shtat ndjenjave të subjektit lirik. Meditimi dashuri-shpirt bëhet një raport utilitar, ku erosi si një Ante, fuqizohet nga forca tokësore, magjia dashurore e njerëzve vdekatarë. Të gjitha këto jepen përmes leximit të tipareve mjaft sensuale, siç janë trupat, buzët, sytë, gjinjtë.

Dashuria si ndjenjë që lind në shpirt dhe bie në thellësinë e tij, që provon ligështimin apo forcimin e tij, si ndjenja e afrimit dhe largimit me artikulimin e vet të veçantë, do të këndohet si ndjesi e thellë, por edhe si esencë e jetës. Ajo në këtë poemë ajo shpaloset në kupën qiellore për të provuar fuqinë e zjarrit që nuk shuhet kurrë. Poema hapet e mbyllet në formë përsëritje me 7 strofat e para të saj, të cilat qëndrojnë më vetesi një poezi e veçantë duke pasqyruar idenë kryesore të poemës. Përsëritja mbyllet me vargjet:

*"Sesi më ndjell që larg, / më ndrit përfaqe, / Me dritat varg e varg, / vetëtimtare"*¹⁹

Qënia bëhet e shenjtë nga ndiçimi divin i dashurisë, e cila edhe nëpërmjet kujtimeve është në gjendje të pasqyrojë këtë shkëlqim tek qënia tokësore. Është e vetmja dritë që nuk vdes kurrë që do ta joshë njëriun deri në fund dhe ai kurë nuk do të reshtë së pasqyruari dritën e dashurisë deri në vdekje dhe përtej saj. Poeti ndërton kështu një simbiozë mendimesh që lëvizin nga qiellorja tek tokësorja në mënyrë harmonike dhe të natyrshme. Dhe siç thotë L.Topçiu: "Harmonia sigurohet nga dashuria si parim universal."²⁰. Alternimi i gjendjeve që shkojnë nga trishtimi në harrim, në çmendim, në jashtëkohësi, përsa kohë subjekti lirik është i pushtuar nga dashuria, kalon në një ton elegjiak kur ajo befas humbet, zhduket, shprishet. Duke e ndarë poemën në dy pjesë sipas shpallimit dhe dispozitave të ndjenjës, (në të parën tokësore, në të dytën qiellore) shohim se pjesa e parë luan me ngjyrat dhe me tingujt e pyllit në muzg. Muzika është ajo e natyrës, ngjyrat po ashtu:

¹⁹ Poradeci L., Poezia, Vepra I, f.329

²⁰ Topciu, L, Tekstualizëm dhe stil

"Fërmonte një fërmim, / ndër degë e fletë, / vëngonte një vëngim, / një kumb i fshehtë." dhe :

*"Aq ëndërr e vashëri, / duke përcjellë, / jehonte pyll i zi / me duf të thellë"*²¹

Më pas kemi lojën e ngjyrave: *"Në mbrëmjen q'u përflak, / si prush magjie, / ku zbardhje si zambak, / plot dritë dhe hije"*²²

Duke operuar me tingujt dhe ngjyrat disi të paqarta autori rek të na krijoje idenë e fshehtësisë dhe misterit. Të dy krijesat janë të shpërqëndruara nga elektriciteti me të cilin i ka ngarkuar dashuria "prandaj nga simfonia e trishtuar dëgjohen pasazhe të bukura me melodi të ëmbla dhe sublime të dashurisë."²³

*"Dhe pyll i ndezur n'ar, / q'u tund nga vendi, / gjëmoj tingëllimtar, / si gjëmë ergjendi, / Limeri u mbush përplot me shkrumb e hije, / Ne t'iknim s'iknim dot, / prej kaq magjie"*²⁴

Forca tronditëse e ndjenjës i paralajzoi krijesat si në një magji, ku ngurtësohet trupi për t'i lënë vënd të lirë shpirtit. Ekstaza e dashurisë nuk kërkon shpjegim, ndaj dehja këtu kthehet në mister. Dhe për ta përforcuar kuptimin mistik të kësaj që ndodhi, lexuesi e kupton kryesisht prej ngjyrave tingujve dhe simboleve: *"Një këngë e lart u ndje, / me plot jehona, / Këndonin përmbi ne, / dy shpirtrat tona"*²⁵

Pjesa e parë nis qetë, ëmbël me shfaqjen e vajzës në një muzg të vonë; *"Përmbi kodrinë atje, / Mënjanuar bote, / Mu shfaq plot hare, / fshehtësiplote."*²⁶

Që këtu tonet e muzikës fillojnë e forcohen deri në shpalosjen e plotë të dashurisë si misteri pa fjalë që robëroi krijesat, derisa tonet e ëmbla dhe të bukura të kësaj melodie bashkohen më këngën e korit qiellor që e bekon dhe shpirtërisht këtë bashkim;

*"Plot ëndje, plot hare, / Dorë për dorë, / kënduan përmbi ne, / Çetat qiellore"*²⁷, për dy qenie që u tretën bashkë në një flakë të vetme si dy

²¹ Poradeci L., Poezia, Vepra I, f.307

²² Po aty, fq- 308

²³ Kolevica, P Lasgushi më ka thënë f.179

²⁴ Poradeci L., Poezia, Vepra I, f.309

²⁵ Po aty, fq. 329

²⁶ Po aty, fq. 307

²⁷ Po aty, fq. 313

qirinj flakëbashkuar mes një melodie ku çdo gjë është tretur, mes engjëve në qiej dhe përshëndetjeve të tyre.

Në këtë pjesë të poemës kemi një vegim dantesk. Në vend të martesës së trupave, erotikës fizike, kemi martesën e shpirtërave. Dy shpirtrat u himnizuan në altar, me himne të dlirta, Lasgushi akoma më mistik përfytyron, poetizon vegimin e një përçafimi të lumturuar, të dy shpirtrave me kurorat ceremoniale të martesës. Është dufi që buçet me drithërimë, që zbret në detin e qënies së poetit: “*Që me kurorë i thur, / Zemrat bujare, / Ah ç’bëmë ashtu sikur, / S’bëmë gjë fare?*”²⁸. Me një fjalë ajo që nuk u realizua në tokë, të realizohet në qiell.

Por lumturia e dashurisë është çashtshkurtër. Pas kaq ekstaze dhe harrimi vetë zoti i dashurisë u xhelozua dhe prej qiellit e zbriti dashurinë drejt greminës. Filloi një rënie e cila përfordhet nga tonet elegjiake të poemës. Gjithë atmosfera e poemës shprishet dhe ngazëllimi kthehet në rënkim: “*Gremisen qiell e dhe, / Si na kundrojnë, / Dy shpirtrat përmbi ne, / zën e rënkojnë*”²⁹

Dhimbja tashmë ka kaluar në dimension shpirtëror dhe poeti luan me kontrastet për ta bërë më të lehtë kalimin nga lart, poshtë. Lasgushi e quan Kamadevën “Demon”, me sy si zjarr, që shkëlqen nga bukuria, duke spikatur natyrën e dyfishtë ambigue të erosit: engjëll dhe demon. Tonet dhe ngjyrat që shoqërojnë elegjinë e vargjeve bëhen të rëndë, kumbonjës, dëshpërimtarë. Pra Hyji i Dashurisë, Kamadeva, ka zili dashurinë e pakufishme të dy qënieve tokësore. Ky është një koncept shumë i papritur, madje kapërcen edhe konceptet mitologjike në përgjithësi. Kamadeva del kështu një Hyj i dyfishtë, i së Mirës dhe i së Keqes, një Hyj Androgen. Humbja e dashurisë sjell një kataklizmë:

*“Këputen larg e larg, / Yje dhe botë, / Vërshojnë varg e varg, / Lumenj me lotë”*³⁰

Pas kësaj poema mer një kreshendo dhe fillon pak nga pak ta rritë tonalitetin nga tonet e rënda e të trishtur në tone më të buta. E dashura shfaqet përsëri por këtë radhë zbret prej qiellit, është krijesë krejtësisht

²⁸ Poradeci L., Poezia, Vepra I, f.315

²⁹ Po aty, f..320

³⁰ Po aty, f.. 318

qiellore dhe *"ndezi yj e djej, / të dashurisë, / dhe i vari nëpër qiej, / të gjithësisë"*³¹

Dashuria për Lasgushin është një koncept kozmik. Dashuria e vërtetë është edhe ndarje, ndarja është prania e dashurisë në mungesë. Dashuria universalizohet në botën e shpirtërave. Kuptohet që shpirtrat janë të njerëzve. Kuptohet vetvetiu se figura hyjnore e Kamadevës është varianti Lasgushian i Kamadevës. Një poemë e tillë për dashurinë, në të vërtetë është shkruar vetëm nga Lasgushi në një formë, frymëzim dhe imazh të tillë të pakrahasueshëm me të tjerët.

Poema si një simfoni i përmban të gjitha; tingëllimën e ëmbël të dashurisë, çastet e ndritura të bashkimit, më pas tonet e forta buçitëse të shfaqjes së demonit, që sjell ndarjen, pastaj qetësi, trishtim, muzikë që rrjedh e qetë e që përsëri i ngre tonet me shfaqjen qiellore të sa dashurës. Siç thotë P.Kolevica: "Dhe pasi jemi ngopur me harmoninë e tingujve të ëmbël ja ku ndjejmë të tërë orkestrën të gjallërohet në një finale të madhërishtme: Qajnë violinat, rënkon kontrabasi, buçasin instrumentat frymorë, gjëmojnë daullet, klithin fanfarat"³².

"Ku je ti mall! Ti mall, 'O jeta ! jeta, / Sa larg që zall më zall, / mezi të gjeta."

Pastaj një pauzë dhe pianoforti përsërit meloditë e trishtuara të fillimit. Së fundi disa gishta të bardhë e delikatë gruaje derdhin telat e një harpe. Është harpa e zemrës së poetit. Simfonia mbaron. Kompozitori-dirigjent përshëndet kokëulur, i zbehtë i lodhur"³³

Por jo nuk është më një dashuri tokësore, por shpirtërore. Poeti është në një gjendje transi dhe nuk mund t'i përcaktojë dot kufijtë e ekzistencës:

"Po sot as dhe më s'di, / Jam a s'jam gjallë, / Se mua kurrsesi, / s'ma nxore mallë".

Është ajo që thotë poeti, dashuria qiellore, jashtëtokësore s' më ngop dhe zbres në tokë, por dhe kjo dashuri në tokë s'më ngop dhe e kërkoj në qiell. Kjo është jeta, njeriu sa jeton nuk resht së kërkuari dashurinë gjithë jeta e tij është një kërkim i vazhdueshëm i dashurisë si një udhëtim në kërkim të vetvetes. Prej dashurisë ne njohim veten tonë dhe

³¹ Poradeci L., Poezia, Vepra I, f. 323

³² Kolevica, P., Lasgushi më ka thënë, f.132

³³ Po aty, f. 180

bëhemi më të përsosur duke kaluar në sfidat e vuajtjeve dhe sprovave të jetës, që më së shumti kanë shkak dashurinë, prandaj Lasgushi thotë: “Më shumë më ka tronditur në jetë dashuria më shumë më ka gëzuar në jetë dashuria”.

Si një yll në galaktikë që rend të vrapin e tij të pashuar drejt yllit duke gjeneruar energjinë e dashurisë, i tillë është për ne Lasgushi, e tillë është për ne poezia e tij; një distributor dhe gjenerator i pareshtur dashurie dhe humanizmi.

VILMA PROKO (JAZEXHIU)
Akademia e Studimeve Albanologjike
vilmaproko67@gmail.com

ELVI PROKO
Università degli Studi Roma Tre-Architettura
elviproko@hotmail.com

ÇËSHTJE TË LEKSIKUT TË POEZISË SË PËRKTHYER LASGUSHIANE

Lasgush Poradeci me shqipërimet e një vargu poetësh të mëdhenj evropianë çmohet si një ndër klasikët e përkthimit shqip, duke na lënë një vepër poetike të rrallë për nga larmia e shprehjes dhe e formave. Poezia e përkthyer e Poradecit pati prurje të simbolizmit dhe ndikime të tjera të poezisë evropiane, shpesh të kushtëzuara prej formimit vetjak të poetëve.

Shqipërimet e Lasgushit janë dëshmi e ndërthurjes së ndjenjës së zhvilluar gjuhësore, e njohjes së vazhdueshme të gjuhës shqipe, por edhe e kuadrit më të gjerë kulturor evropian, ku duhej vendosur letërsia shqipe. Elementët gjuhësorë i vë aq bukur në funksion të ruajtjes së origjinalitetit të figurave letrare. Përktheu disa nga kryeveprat e letërsisë botërore si “Eugjen Onjegin” të Pushkinit, lirikat e Lermontovit, të Bllokut, Poemat e Hajnes, të Majakovskit e Miçkjeviçit, lirikat e Gëtes dhe Hajnes, poezi të Lenaut, Brehtit; Hygoit, Mysësë, Bajronit, Shellit, Bërnsit, të Emineskut, etj. Pas punësimit jetëshkurtër pranë Institutit të Shkencave, pararendësit të UT, nisi punë si përkthyes me normë pranë shtëpisë botuese “Naim Frashëri” deri kur doli në pension më 1974. I madhi Kadare ka thënë: “Një njeri madhështor punëtor me normë, absurditeti i madh i kohës!”

Lasgushi është pa dyshim një përkthyes i zoti. Ai e ka pasur përkthimin edhe zanat, edhe art, më mirë të themi se, duke e pasur zanat ka ditur ta shndërrojë në art. Poradeci ka qenë gjithashtu një përkthyes rikrijues, po një përkthyes rikrijues nga ata që jo vetëm përcjellin autorin e përkthyer te bashkatdhetarët, por u vënë përkthimeve të veta vulën e individualitetit poetik të tyre, kështu që poetika e autorit të origjinës rrezatohet edhe nga poetika e përkthyesit.

Lasgushi përkthen një numër të madh poetësh (sipas një pohimi të vetë poetit dhënë Petraq Kolevicës në vitin 1978 ku thuhet se “... gjer më sot, paskam përkthyer nëntëdhjetë mijë vargje!”)³⁴, poetë që u përkisnin kombësive të ndryshme (gjermanë, rusë, rumunë, polakë, anglezë, francezë), periudhave të ndryshme historiko-letrare (midis shek. XIX dhe XX), drejtimeve të ndryshme letrare, romantizëm, realizëm, simbolizëm, imazhinizëm, individualiteteve nga më të ndryshëm poetikë, energjikë dhe luftarakë, të butë dhe të ëmbël. Këta poetë kanë pasur të përbashkët vetëm lirizmin dhe rrënjët në poezinë popullore. Në këtë thelb të vetin, në këtë nyje lidhëse që i bashkon, ata janë të afërt me Lasgushin. Poeti përkthyes, në transformimet që u bëri këtyre autorëve për t’u dhënë një veshje shqipe, gërmoi në thesarin e leksikut të pasur poetik vetjak ku ndërthuren neologjizmat³⁵ dhe fjalët dialektore.

Dy nga gjuhët prej të cilave përktheu Lasgushi qenë ato që ai i njihte thellë, gjermanishtja dhe rumanishtja. Për sa i përket gjermanishtes duhet thënë se kjo gjuhë ka disa afri gjuhësore me shqipen si, bie fjala, përdorimin e rasave dhe një muzikalitet të afërt me atë të gjuhës sonë dhe, pa dyshim, këto afri i kanë vlejtur Lasgushit që guxoi të përkthente një autor gjenial si Gëten dhe një poet aq të shquar dhe të ndërlikuar si Hajnen, gjithashtu edhe një poet pak të njohur, por interesant si Lenaun.

Në lirikat e Gëtes Lasgushi ka mundur të riprodhojë muzikalitetin e origjinalit dhe disa veçori të secilës vjershë. Bie fjala, te “Kushtim” poeti përdor ato fjalë të fjalorit të vet që krijojnë papërcaktueshmëri si *mugëtirë, moskurrë, avullor, mjegullor, valëzuar* dhe një neologjizëm tepër fin si *fillmëndafsh tën*. Kjo vjershë është si kredo poetike e Gëtes. Në një vjershë të tillë si “Nata e parë” ndërthuren dliresia e një sensualiteti i lehtë, gjë që shprehet nga leksiku i zgjedhur, *nusëror, të shenjtëruar, shenjtërim* dhe fjalët që të kujtojnë dritën e zjarrin *ndrin flakë e zbehtë, të shtie flakën, djeg prej puthjeve*.

³⁴ Petraq Kolevica, *Lasgushi më ka thënë ...*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1992, f. 97.

³⁵ Për neologjizmat e Lasgushit shih më me hollësi Klara Kodra, *Neologjizmat në sistemin poetik të Lasgush Poradecit*, f. 177-183, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Kombëtare, 24-2, Prishtinë 2005.

Lirikën “Së zgjedhurës”, Lasgushi e fillon me një shprehje karakteristike shqipe *Dora dorën, buza buzën*. Gjithashtu ai përdor një nga zvogëlimet e tij të parapëlqyera si *lumëthin*.

Në lirikën e freskët “Vizita”, ku gjejmë një motiv që do të zhvillohet te “Fausti” gjejmë fjalën *mitare* që përforcon fjalën *e mitur* për të nënvizuar pafajësinë e vajzës që fle.

Në lirikat e përkthyer nga Hajneja vëmë re disa tipare për të cilët flet studiuesja Nina Krotkih në kumtesën “Lasgush Poradeci përkthyes i Hajnes shqip”, botuar në aktet e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 1995, “kuptimi i plotë i tekstit origjinal, energjia e fortë dhe emocionaliteti”. Studiuesja vëren se Hajne përdor disa stile, dukuri që disa përkthyes s’i kapin³⁶.

Vjersha e shkurtër “Ti ke diamante dhe perla” me refrenin “E dashura ime, ç’do më?” tingëllon si një lirikë popullore shqipe. Lasgushi me mprehtësi përdor neologjizmin e vet “skëterror” në vargjet për ta cilësuar dashurinë, kur thuhet “djajtë e quajnë vaj *skëterror*”.

Në baladën e Hajnes “Donna Klara” që të kujton baladat tona popullore, si Baladën e Kostandinit (djali i dashuruar i shkon në dasmë së dashurës, edhe i vdekur si fantazmë, meqenëse i kishte dhënë besën) takojmë fjalën *prishje* për *vdekje* (ke vendosur *prishjen* time), variantin *kuximtar* për *guximtar* (*kuximtar* që i pate mundur). Në një vend poeti përdor një trajtë jo të saktë të foljes që e largon shumë në kohë (u pat çdukur Don Ramiroja).

Në përgjithësi në lirikat e Hajnes të përkthyer nga Poradeci ndihet lirizmi i magjishëm dhe ironia romantike. Përkthyesi ka mundur të riprodhojë muzikën e origjinalit. Në këto lirika vëmë re edhe variante dialektore si folja *këndovi* në lirikën “Pelerinata e Keviaar-it” (devotshmërisht këndovi: “Lavdi me ty, Mari!”). Lasgushi ka përkthyer edhe poemat e Hajnes me forcë të madhe shprehëse “Gjermania - Përrallë dimri”, “Atta Troll”, 1959, "N. Frashëri. Për këto poema ne mund të përmendim vlerësimin e goditur të Ardian Klosit “...në një gjykim të shpejtë, mund të themi se Lasgushi e ka përkthyer me një saktësi e konçizitet të jashtëzakonshëm lirikun gjerman: herë-herë

³⁶ Nina Krotkih, *Lasgush Poradeci përkthyes i Hajnes shqip*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 1995, f. 119-120.

strofa shqipe arrin të ketë ritmin identik dhe gjatësinë e strofës origjinale, të jetë madje edhe më e shkurtër! Po bukuria e gjuhës pastaj, ngjyrimi i tij toskë, fjalori aq i pasur... Problemi i vetëm i Lasgushit është që ka përkthyer shpejt, i detyruar siç ishte nga varfëria dhe shtytja për të plotësuar normën e Sh.B. “N. Frashëri”. Kjo bën që aty-këtu të ruhen struktura tipike të gjermanishtes, në ndërtime si “një femër mbretërisht e bukur”, “e vështjell një rrobe ephërisht e bardhë”, “pastërtisht e shporra çmendurinë” etj. Lasgushi të lejonte konstrakte aspak shqipe si: *diamante kurore arthmërie, fitim punëtoresh duar, valixha m'u vizitua* (nga doganierët), *i kalorësve kostum i ri, një mbretërore spiritë, fantomërisht, fantastërisht* etj. Shqipërimi i Lasgushit donte më shumë punë, por edhe erudicion pasi p.sh. të gjitha fjalët frëngjisht ishin lënë frëngjisht, pos që emrat e përveçëm ishin lënë të gjithë, me grafi si në origjinal.

A. Klosi vëren se “...janë lënë në frëngjisht thujse gjithë fjalët e origjinalit: *malheur, page, gentilhomme* ose nuk ka kujdes të veçantë për të përdorur ekuivalentet shqipe për fjalët neolatine si *eveniment, fantomë, akcent*, herë-herë ka pakujdesi të tilla si "hyra në vendin jashtë" (do të thotë që "u ula në karrocë në fronin jashtë") ose *I futnja nganj'herë gishtrinj'te mij, / dhe ngjante shpesh nganj'herë*. Ai përdor një krahasim të gjetur kur thotë se “shqipërimi i Lasgushit i ngjan një skulpture të çuditshme, të punuar ku me daltë të hollë e fine, ku me të rëna të trasha”.³⁷

Në zgjedhjen e leksikut bisedor gjejmë shumë shprehje të tipit: *na lënë ujin në dorë, ç'budallenj që jeni, o zog shëmtirë, në më rënç në dorë, ta jep mu në tru, s'ua ka kush ngenë, i ha meraku* etj. Lasgushi është i

³⁷ Ardian Klosi, *Një përrallë dimri në tri variante: Heinrich Heine dhe dy shqipëruetit e tij të mirënjohur, Poradeci dhe Schwartz*, Gazeta “Shekulli”, nr. 2956, 5 maj, 2010, f. 18- 19. Propozimet e tij neologjike, edhe pse të mbetura në inventarin leksikor të stilit vetjak, tingëllojnë intelektualisht elegante. Ja disa shembuj fjalësh, për shumicën e përdoruesve të panjohura: *sheputka, kokonka, tagarkë, pepellashë, qimegjalla* (një lloj krimbi), *torozhen* (një lloj shpendi), *shi tonét* (d.m.th. i butë, Pogradec), *kllanik* (vatër, Pogradec), *rruskudan* (*pallavraxhi*, Pogradec) etj., si edhe disa nga trajtat e shumta të toskërishtes verilindore: *mbesoj, mproj, medje, vojtyje, tashinë* (për tashiti), *i qojtur, i letë, gas, sundovi, ardha, shij* (për shihte), *pshteti, mos u këthe, zëmbak, robe, dërmoj* etj. Shihet qartë që ky autor i ka kushtuar rëndësi të madhe artikullimit gjuhësor të shprehjeve poetike dhe siç e kemi thënë edhe më lart ai ishte mjeshër i artit poetik.

kujdesshëm për të futur në shqipërim fjalë nga qyteti i tij amtar ose për të dhënë një strofë që i pëlqen veçanërisht, e që mund të jetë një situatë lirike, një trishtim dashurie, përshkrim natyre etj.

Lasgushi kujdeset të komunikojë sa më mirë me lexuesin bashkëkohës dhe ta afrojë me të poetin romantik të një shekulli më parë. Në këto përkthime përdoren fjalë me ngjyrim emocionues të dukshëm e me shprehësi të lartë. Poeti në këto dy poema e respekton më së miri metrikën e origjinalit, si katërvargësja tetërrokësh ABAB, ku rimat janë vetëm BB, shpesh në mënyrë lakonike duke i gjetur këto rima pa sforcim të madh pranë origjinalit. Po sjellim ndonjë shembull:

Një vashë e vogël harpës i bij.

Këndonte me zemrën plotë

Dhe zërin fals, po u preka fort

Nga këng' e saj fjalëngrohtë.

Ose

Kur ardha te zonja mëmë, ajo

U tremb prej gazit q'e zuri;

Thërriti befas: "O biri im!"

Dhe të dy duart i thuri.

Nga Eminesku, një nga poetët që e ndjente më pranë, Poradeci ka përkthyer pak lirika, por ato janë perla. Mund të përmendim “Një artisteje”, “Të rinjtë e korruptuar”, “Dëshira”, “Vetmi”, “Jeta”, “O, qëndro”. Te lirika e parë gjejmë neologjizmat e dashura të Lasgushit *fshehtësirë e drithëruar, e trupëzuar*. Ndërsa te “Të rinjtë e korruptuar” gjejmë neologjizma plot forcë shprehëse që bartin patos satirik si *frikosur, makjazhuar, shpirt e palcë djegur, të brazduar*. Këtu ndeshim edhe një ndërtim që tingëllon jo shqip si *me të mavinë kthetër* (ndërtimi i saktë duhet të ishte *me kthetrën e mavijtë*, pra është një liri poetike, por është paksa e tepruar, edhe pse është nisur nga ritmi dhe nga rima). Te “Jeta” ku mbizotëron lirizmi dhe dramatizmi gjejmë fjalë të zgjedhura si *shkëndijohet, e mavijuar, i turbulluar, fluturimtare* dhe fjalën onomatopeike *zhuzhoj*. Te “Dëshirë” përkthyesi gjen neologjizmin e goditur kompozitë *mendimtundur* për të cilësuar korijen (pyllin).

Te “Vetmi” prapë gjejmë fjalët onomatopeike si *cërcërojnë* [bulkthat], *trokëllon* [dera] dhe fjalën kuptimplote *grima* për të shprehur çastet si njësi minimale të kohës (*grima ty të duken vitet/shekuj plot të duken grimat*).

Nga Lermontovi, një poet që edhe ai i qëndron afër shpirtërisht, Lasgushi përkthen shumë lirika, balada e një poemth. Në të gjitha këto poezi përkthyesi përdor një leksik të zgjedhur elitar si *valëftoht*, *tingëllimtare*, (*shtëmbave tingëllimtare* te “Tri palmat”), *shkumbëtar*, *brengime*, *uluronjës*, *vetëmore*, *të etuar*, *i denjshëm*, *përqueshtar*, *ndjenjësishë*, *krenarak*, *lindjak*. Diku përdoret mënyra habitore që rusishtes i mungon, për ta theksuar kuptimin (mos t’i ndahem *paskërkam* dënim). Në një lirikë tjetër përdoret në mënyrë të goditur fjala onomatopeike *llokoçit* (...Tereku - zjen e *llokoçit*” te “Këngë djepi kozake”).

Lasgushi përkthen edhe një poet rus modern, Eseninin. I përkthen poemën “Baladë për njëzetegjashtë”, së cilës ia ka ruajtur ritmin. Edhe këtu leksiku është shprehës *rër’ e lashtë*; *kërcasin kockat*; *pah fshehtësie* [Nata]... e *vërtit hënën*.

Vjersha tjetër “Rusia sovjetike” në përkthimin e Lasgushit ka humbur gjysmën e bukurisë, sepse nuk janë ruajtur rimat. Miskjeviçin, themeluesin e romatizmit polak, Lasgushi që se njihte polonishten e përktheu duke bashkëpunuar me një përkthyes që e riprodhoi materialin origjinal fjalë për fjalë, Qevqep Kambo. Megjithatë, edhe përkthimet tuj nga ky poet origjinal romantik numërohen ndër përkthimet e tij më të mira. Mund të përmendim prej tyre “Ode rinisë”, “Pasiguri”, “Trimi dhe vasha”, “Romantizëm”, “Zhvitezhi”, “Zhvitezhanka”, “Zënbakët”. Edhe në këto krijime poetike ndeshim fjalë të reja të krijuara nga Lasgushi si *gjelbërsi*, *kotësirë*, *thellësirë*. Fjalën e parë e ndeshim tek “Ode rinisë” (...vitet e *gjelbërsisë*).

Në balada si “Zhvitezhi”, “Zhvitezhanka”, “Zënbakët” Lasgushi ka rikrijuar atmosferën e legjendës dhe muzikalitetin e pakrahasueshëm. Në krijimin liriko-epik “Trimi dhe vasha” protagonistët emërtohen me emrat e poezisë popullore shqiptare që kanë zënë vend edhe në krijimtarinë origjinale të Lasgushit. Po të krahasojmë baladat “Zhvitezhi” dhe “Zënbakët” me përkthimet që u bëri Kadareja këtyre

baladave, sipas nesh, përkthimet e Lasgushit qëndrojnë më lart. Në leksik, pranë fjalëve të zgjedhura, diku ndeshim edhe shprehje popullore të vrazhda si *Ma marrtë kokën djalli!* te balada “Zënbakët”. Lasgushi përkthen edhe mjaft krijime të një poeti shumë të ndryshëm nga të mësipërmit, poeti skocez Robert Bërns që është në thelb realist, me një humor të mprehtë popullor. Mund të citojmë si të realizuara “Brigjet e bukura t’Erit”, “Një miu të cilit ia prisha folenë me plug”, “Lutje natën për familinë e një miku të dashur”, baladat “Kthimi i ushtarit”, “E shoqe e qymyrtarit”, “Lutja e Vilit të shentë”, “Meri Morisan”, “Marisë në qiell”, “Findlej”, “Llord Gregorit”.

Mund të thuhet se Lasgushi e letrarizon disi këtë poet, magjia e të cilit qëndron në thjeshtësinë. Mund të vëmë re se disa përkthime të Bërnsit nga Dritëro Agolli ua kalojnë në thjeshtësi krijimeve të tij të përkthyer nga Lasgushi.

Megjithatë, këto përkthimet e fundit kanë fjalor të larmë dhe riprodhojnë në mënyrë të goditur përsëritjet dhe lodrat e fjalëve të origjinalit.

Lasgushi e përktheu “Eugen Onegin” të Pushkinit, duke ruajtur lirizmin e poetit të madh rus. Edhe pse e kritikuan për frymën lasgushiane që u kishte dhënë vargjeve, përkthimi edhe sot çmohet për vlerat e tij. Romani në vargje hapet kështu:

*“Përzënë rrezesh parëvere,
Nga malet fqinj dëborra shkon,
E tatëpjetë me potere
Mbi fusha ujërat i vërshon.”*

Veçanërisht të bukura janë përkthimet e kapitujve “Letra e Tatjanës” dërguar Onjeginit dhe “Gjyshja.”

Letra e Tatjanës vlerësohet si model i paraqitjes me hijeshi të rrallë poetike të botës shpirtërore të gruas, duke e lartësuar Pushkinin në një radhë me mjeshtrit më të mbaruar të fjalës artistike, e për rrjedhojë Lasgushin njëherazi si një poet të vërtetë e përkthyes virtuoz që ndjen shumë hollë çdo fjalë të gjuhës amtare. Me talentin e tij të spikatur ai na shpërfaq një nga veçoritë më karakteristike të talentit të Pushkinit, modestinë e shprehjes poetike për të dhënë të thjeshtën në kufijtë e gjeniales.

*Po marr guximin ç'do deshët më veç shpirtit tim
Që t'ju dëgjoj si kuvendoni
T'ju them një fjalë dhe pastaj
Në zemër veç një mall të mbaj
Veç gjer sërish të më takoni...*

Në variantin shqip të kësaj letre ndeshet shprehja tipike shqipe “Ç'do deshët më veç shpirtit tim?”, që mungon në origjinal, po që e jep më së miri lëmshin e ndjenjave të dashurisë, ndrojtjes dhe guximit, gëzimit dhe vuajtjes që shpreh kjo letër ku një vajzë merr guximin e paparë në atmosferën e fshatit patriarkal rus, t'ia shprehë e para dashurinë një djali të ri. Këtë guxim ia jep vetë pasioni i saj i fuqishëm. Një shtesë tjetër e përkthyesit në krahasim me origjinalin është formula e politesës e përdorur nga Tatjana për të nënvizuar hapin e saj të pazakonshëm “Po marr guximin për t'ju shkruar”, ndërsa në origjinal thuhej thjesht “Po ju shkruaj”.

Është e diskutueshme nëse vërtetësia psikologjike do ta kërkonte apo jo këtë nënvizim të guximit të vajzës së re.

Mbase pikërisht ndrojtja me të cilën ajo luftonte para hapit të vet të guximshëm, mund t'ia sugjeronte një gjë të tillë, apo përkundrazi gjendja e saj e trazuar do t'i largohej çdo theksimi a zbukurimi me fjalë. Natyrisht përkthyesi pati parasysh, jo vetëm vërtetësinë psikologjike, po edhe ritmin dhe rimën që në shqip rrjedhin në mënyrë të natyrshme. (Lasgushi e kishte lëvruar nëntërrokëshin edhe në poezinë e vet origjinale). Muzikaliteti i rusishtes është i afërt me atë të shqipes. Vetë Lasgushi ka pohuar, sipas Petraq Kolevicës: “...shoku filan tha se Homeri s'përkthehet dot shqip në gjatësinë e vargut që ka në origjinal. Kjo do të thotë që ia përkthejmë në një gjatësi vargu tjetër. Kjo është njëlloj sikur të përkthenim Eugjen Onjeginin në tetërrokësh. Kjo do të thotë t'i ndrrosh tonin poezisë, t'i japësh tjetër ton... Po i ndërrove këtë ton, e ndërrove poezinë”.³⁸

S'dihet nëse një variant tjetër i letrës së Tatjanës në shqip do të ishte më i efektshëm se ai i Lasgushit.

Duhet thënë që ky guxim e befason, e mrekullon dhe e tremb edhe

³⁸Petraq Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1992, f. 117.

lexuesin shqiptar, ndonëse është mezi i shek. XX kur e përkthen Lasgushi. Kjo faqe e mrekullueshme e hapur në shpirtin e një vajze nga një poet lirik dhe psikolog kërkonte një penel të veçantë poetik dhe e ka gjetur te Lasgushi, i cili, përveç kësaj, duke qenë vetë një lirik tepër fin dhe i thellë i dashurisë, e kupton në thellësi shpirtin e heroinës së Pushkinit dhe e riprodhon, jo vetëm përmes një ritmi si ai i origjinalit (vargu 9-rrokësh i pazakonshëm në shqip, po që poeti e ka përdorur vetë), por edhe përmes një leksiku të pasur, sa të thjeshtë, aq edhe fin ku asnjë fjalë nuk stonon. Vajzat ruse aristokrate të asaj kohe në shkrim shpreheshin me retorikë dhe artificialitet, kurse Tatjana e rritur pranë popullit nuk di të shtiret. Poeti përdor me mprehtësi fjalën tipike të fjalorit të vet poetik zemërak (*nuk do të më prapsni zemërak*). Aty përdoret edhe shprehja *Qielli* për të treguar Hyjninë, një hyjni dashamirëse që kujdeset për të bashkuar shpirtat binjakë, sipas përfytyrimit naiv të vajzës ende adoleshente dhe fjala *përjetësi* për të shprehur qëndrueshmërinë dhe thellësinë e dashurisë (Jam jotja në përjetësi).

Lasgushi zgjedh me kujdes fjalorin e vet midis thjeshtësisë dhe elitizmit. Edhe në momente të tjera kyçe të poemës si në dyluftimin midis Onjeginit dhe Lenskit, momenti i vrasjes jepet me shprehjen disi elitare dhe të rafinuar *Orë e pavdekshme pat goditur*, kurse origjinali i Pushkinit kishte shprehjen më të thjeshtë *Erdhi / ora e caktuar* “Часы урочные”.

Në përkthimin italisht të studiuesit Ettore Lo Gatto³⁹ jepej thjesht *Tashmë ra ora* “È

ormai sonata l'ora”, duke hequr epitetin, kurse poeti Giovanni Giudici⁴⁰ e përforcon duke e shndërruar në *Ora fatale* “l'ora fatale”.

... Edhe në shpjegimin final midis Onjeginit dhe Tatjanës ku janë ndërruar rolet dhe i riu i lutet për dashuri gruas së re që e refuzon për hir të detyrës martesore, në fjalët kur ajo ritregon dialogun me djalin pas shprehjes së dashurisë së saj në rini, gjendet një fjalë e parapëlqyer

³⁹Alessandro Puškin, *Eugenio Onjéghin*, traduzione, introduzione e note, Firenze, G. C. Sansoni, 1925. *E ormai suonata l'ora, E il poeta senza dir parola, lascia cadere a terra la pistola*.

⁴⁰ *Giovanni Giudici, L'arme, gli amori*, In ricordo di Pia Pera: Puškin, larmegliamori.wordpress.com, 28 luglio 2016.

për poetin, *llaftari* (...për orën plot me *llaftari*) që shpreh tronditjen e papërfytyrueshme të vajzës që gjendet e refuzuar.

Lasgushi në përkthimet e veta shkrin besnikërinë ndaj poetëve që përkthen në rikrijimin e thelbit të krijimeve të tyre me një shndërrim sipas poetikës së vet që i vë vulën lasgushiane dhe qëllimin e vet e arrin përveç mjeteve të tjera edhe nëpërmjet pasurisë së fjalorit të tij, ku zënë vend neologjizmat dhe fjalët e krahinës së tij.

Leksiku poetik përkthimor lasgushian është një oqean i thellë.

BIBLIOGRAFI:

Kolevica, Petraq, *Lasgushi më ka thënë ...*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1992.

Kodra, Klara, *Neologjizmat në sistemin poetik të Lasgush Poradecit*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Kombëtare, 24-2, Prishtinë 2005.

Krotkih, Nina, *Lasgush Poradeci përkthyes i Hajnes shqip*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 1995.

Klosi, Ardian, *Një përrallë dimri në tri variante: Heinrich Heine dhe dy shqipëruesit e tij të mirënjohur, Poradeci dhe Schwartz*, Gazeta “Shekulli”, nr. 2956, 5 maj, 2010.

Pushkin, Aleksandër (Puškin, Alessandro) , *Eugenio Onjéghin*, traduzione, introduzione e note, Firenze, G. C. Sansoni, 1925.

Giudici, Giovanni, *L'arme, gli amori*, In ricordo di Pia Pera: Puškin, larmegliamori.wordpress.com, 28 luglio 2016.

DION TUSHI

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë
Universiteti “Fan S. Noli”
diontu@gmail.com

ARTI DHE FILOZOFIA NË POEZINË LASGUSHIANE

Në këtë referim, do përpiqemi të shpjegojmë raportet midis artit dhe filozofisë në poezinë e Lasgush Poeadecit. Këtu do dalë në pah ndihma e këtyre dy komponentëve të rëndësishëm, në funksion të njëra-tjetrës, për të krijuar jo vetëm art të magjishëm, por dhe mendim sentencial. Kryesisht duke hulumtuar në bibliografi, do ndalemi në mënyrë të veçantë në disa poezi, me përmbajtje të spikatur filozofike, tek “Gjeniu i Anijes”, “Vdekja e Nositit” dhe tek “Ekskursioni Teologjik i Sokratit”, si dy shembuj tipikë të abstragimit të detajuar artistik dhe të divulgimit të përsosur filozofik, respektivisht.

Kështu, tek “Gjeniu i Anijes”, poeti përdor një simbol të lashtë biblik, atë të anijes, që e ka zanafillën nga Dhiata e Vjetër, me varkën e Noes, dhe që qysh në kohërat e Krishtërit Antik, simbolizonte të krishterin dhe kishën, si një bashkësi besimtarësh, të cilët shpëtojnë vetëm brenda saj dhe që ajo nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë, i drejton ata në përjetësi. Pra, ky simbol abstragohet filozofikisht në rastin konkret dhe nënkupton se shpirti i sprovuar në dallgët e jetës kthehet tek e përjetshmja, atje ku i takon, në ambjentin e tij fiziologjik, tashmë i purifikuar. Pikërisht kjo figurë biblike, me peshë filozofike, përdoret si simbol për të krijuar alegorinë tek “Gjeniu i Anijes”.

*Gjeniu i Anijes*⁴¹

*Vështroni si shket sipër valash
E tundet anija me nge? –
Me krismë – e prush prej stërkalash
Mi të shkrepëtriu një rrufe! ...*

*Ti det, brohori fshehtësire!
Kuptim i potershëm, ti det!*

⁴¹ Lasgush Poradeci, Vepra Letrare, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” Tiranë 1990, f. 221.

*...Po heshtje: ndaj valës së nxirë
Gjeniu i Anijes po flet:
Prej zallit që sot po largohem,
Fillova mërgimin e ri;
Hepohem... anohem.... humbohem...
Po sulmin s'e ndal kurrsesi*

.....
*Valim – i anijes së letë
Qetohet, ndalohet, mbaron:
Njeriu i anijes përjetë
Hepohet... anohet valon.*

Gjeniu është shpirti, fryma në konceptimin e tij poetik që si i jep jetë trupit, anijes, dhe si sfidohet duke sfiduar në dallgët e tërbuara, e braktis anijen e cila mbaron, për t'u bashkuar me përjetësinë, ku shkon duke u vuar. Simobli i jetës shprehet shumë bukur së bashku me destinacionin përfundimtar të njeriut që është përjetësia, pasi kryhen misionin e tij në detin e tallazitur. Pikërisht në këtë poezi sentencë, që me mjeshtërinë e fjalës dhe madhështinë e artit, poeti, duke bërë një përjasje poetike, jep artistikisht raportin materie – ndërgjeje. Çështje materie qetësohet, ndalohet, mbaron, pra kthehet në lëndën fillestare, ndërkohë që çfarë është frymë, shpirt, pjesë e ndërgjegjes supreme, hepohet, anohet, valon dhe kalon lart në përjetësi, tek Krijuesi. Ky pra është njeriu: dualiteti i tij psikosomatik, shpirti i pavdekshëm i të cilit kalon në një dimension tjetër, pasi ndahet nga lënda.

Të bën përshtypje se si gjenialiteti i poetit e vendos ashtu siç duhet këtë raport dhe e pozicionon ashtu siç e mendon ai për lexuesin, sidomos për lexuesin e para viteve 90, kur filozofia marksiste fliste dhe propagandonte të kundërtën. Pikërisht poeti, pavarësisht se i lënë në dritëhi- jen e harresës, në një mënyrë paradoksale, që vetëm një personalitet si Lasgushi mund të krijonte, duke patur parasysh censurën, me këtë poezi të bërë shumë kohë më parë, dhe çuditërisht të risjellë në vëmendje atëherë, fliste dhe komunikonte nëpërmjet artit filozofikisht, bile ishte një trumbetues shumë i rrallë i së vërtetës, për ata që kishin veshë dhe dinin të dëgjonin, duke i ngrohur zemrat e njerëzve me art dhe humanizëm, me të vërtetat e mëdha që vetëm një penë e madhe poetike si e Lasgushit, dinte t'i jepte kaq thjeshtë dhe po kaq madhërisht, si të

vërteta të përjetshme, të shprehura bukur, si një prevolues dhe rilevues i mendimit filozofik. Një disidencë reale në një vështrim sinkronik dhe njëkohësisht një art me vlerë të përhershme diakronike.

Kjo poezi, si një shembull tipik i abstragimit të detajuar artistik, siç thamë, është edhe një shprehje e kredos poetike të Lasgushit, se poezia që të mbetet dhe t'i rezistojë kohërave, duhet të ketë një ide të madhe, e cila duhet të shprehet nëpërmjet një force madhështore, origjinale. Pra, poezia duhet të ketë si bosht një filozofi, të shprehur me art. Pak a shumë të njëjtën gjë, që thoshte edhe R. Rolani, tek cikli "Jetë heroike", tek "Jeta e Tolstoit", citoj: "Rrethi i ideve që ushqejnë artin është tepër i kufizuar. Forca e artistit s'është tek ato, por në atë, se si i shpreh ato artisti"⁴².

Po të njëjtën gjë shohim edhe tek poezia "Vdekja e Nositit", ku autori përdor përsëri një simbol të hershëm atë të euharistisë kristiane, që përbën ekstraktin filozofik të poemës. Të kungimit me trupin dhe gjakun e Shpëtimtarit, i cili ndërkohë bëhet shpëtimtar nëpërmjet sakrificës sublime. Pikërisht kaq i duhet poetit dhe merr diçka kaq madhështore dhe të veçantë, për të bërë diçka tjetër mbresëlënëse, për të shprehur kështu sublimen e misionit të tij, misionit të poetit të vërtetë, të cilin e karakterizon dashuria për njeriun.

Vdekja e Nositit⁴³

*Me zjarr ju flas me zjarr.
Në gjirin tim kam hapur varr....
Që t'i jap shpresë dhe t'ja marr...*

*Un' ik liqerit zemërak
Fatlum dhe i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak:
Se vijnë – urtuar zogjtë – e mi,
Dh'u jap ushqim me dashuri –
Një dashuri plot llaftari:
Pa nis ah ! gjirin ta godas...
Dh'e hap ah ! gjirin me një ças...,*

⁴² Dion Tushi, Historia e Letërsisë të Shekullit XX, Korçë 2005, f. 34.

⁴³ Lasgush Poradeci, Vepra Letrare, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri" Tiranë 1990, f. 223.

Dh'i nginj ah ! zogjtë – e vdes me gas!...

Dhe pikërisht autori, nëpërmjet figurës simbol të Nositit, na tregon se ka diçka që qëndron më lart se dashuria, se ndjenja, së cilës ai i ka kënduar më bukur se kushdo dhe pikërisht kjo gjë është sakrifica: sakrifica në emër të një ideali, i cili pranon vetëflijimin në emër të vazhdimësisë, të asaj që është pjesa më fisnike e filozofisë së jetës. Kjo është arsyeja ndoshta që poeti besonte se poezinë nuk e bën as klasicizmi, as romantizmi, as realizmi, as surrealizmi, as natyralizmi, as kubizmi, as *izma* të tjera, apo filozofitë, por poezinë e bën humanizmi!⁴⁴, bile humanizmi altruist në këtë rast.

Nëse do të kemi parasysh poemën “Ekskursioni Teologjik i Sokratit”, do vemë re se kemi të bëjmë me një divulgim të përsosur artistik, të një filozofi të veçantë, Sokratit. Forca sintetizuese e artit, del në pah më mirë se kudo tjetër, tek kjo poemë, ku një filozof i konsideruar si pikë refleksioni në historinë e mendimit filozofik, i cili ndan filozofinë antike në dy pjesë, në filozofinë parasokratike dhe pasokratike, jepet dhe shpjegohet thjeshtësisht deri në detaj. Sokrati është filozofi i parë që i dha karakter antropologjik filozofisë, objekt i studimit të tij u bë njeriu, bota e tij. Gjithashtu ai inaguroi një moral të ri dhe foli për ekzistencën e një Perëndie, në një periudhë polideizmi, ku zërin e Perëndisë e indentifikoi me zërin e ndërgjegjies, tek çdo njeri. E pra, të gjitha këto risi që Sokrati sjell në fushën e mendimit, do t’u shërbejnë epokave që do të vijnë. Të bën përshtypje lakonizmi dhe bukuria e vargut, me të cilat poeti i shpreh të gjitha këto:

Ekskursioni Teologjik i Sokratit⁴⁵

*Filozof Sokrat i vjetër
Kokë e vlershme e Greqisë,
E pat zbritur përmbi tokë
Lëndën e filozofisë.*

*Se filozofia ahere,
Para kohërash antike,*

⁴⁴ P. Kolevica, Lasgushi më ka thënë..., Shtypshkronja Tirana 1992, f. 82.

⁴⁵ Lasgush Poradeci, Vepra Letrare, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” Tiranë 1990, f. 299.

*Nuk qëndrontenë binarë,
Ajo ishmetafizike.*

*Ajo endej nëpër qiej,
Nëpër sferat rrotullore,
S'desh materje, s'ish fizike
S'kish themele natyrore.*

*S'fliste për punët e dheshme
Po për Frymën, për Idenë,
Nuk kish për studim njerinë,
Po kish zotërit, kish fenë.*

*Ti filozofinë antike,
O Sokrat me tru në kokë,
Që prej qiellit e zbritë
Krejt përposh këtu në tokë.*

*Përcaktove dhe Moralin,
Përcaktove Drejtësinë,
Dhe u ngarkove për detyrë
Veç njerinë! Veç njerinë!*

Pikërisht ky kontribut kaq i veçantë, i këtij filozofi, si dhe karakteri humanist i spikatur i veprës së tij, ka tërhequr siç duket vëmendjen krijuese të Lasgushit, për të shkruar me një thjeshtësi dhe precizitet të habitshëm për filozofinë e tij, për ta bërë të kuptueshëm për këdo, duke na dhënë kështu një vepër me disa nivele, ku secili merr aq sa ka mundësi dhe ka predispozicion të marrë, nga mendimi filozofik i Sokratit, por edhe nga vepra poetike e Lasgushit.

Megjithatë, pavarësisht se poeti nëpërmjet ideve të mëdha, krijon poezi të një karakteri elitar filozofik, ai asnjëherë nuk pranon se është një poet filozof. Duke marrë shkas edhe nga një dialog i përcjellë më shumë sinqeritet, nga artisti arkitekt Petraq Kolevica, një mik i poetit, në librin e tij “Lasgushi më ka thënë”, për mendimin tim, një nga librat më të mirë që janë shkruar për Lasgushin, citoj: “Një ditë i thashë: Kam lexuar në Enciklopedinë Larousse pjesën ku flet për letërsinë shqipe. Juve ju quan poet filozof. Lasgushi u inatos, hyri e doli disa herë nga

dhoma dhe më në fund, duke përpjekur portën tha: “Filozofinë e bëjnë filozofët. Unë bëj poezinë! Dhe pas pak: Paska qenë idiot⁴⁶!”

Në përgjithësi, poezia e Lasgushit shquhet për tone filozofike, por siç duket, poeti si parim të tij ka patur të bëjë art, dhe art bën para së gjithash duke strukturuar mendimin poetik dhe duke e ngritur këtë në sferat më të larta: atje ku jeta ndjehet e aureoluar prej artit lasgushian, pikërisht atje ku estetika shprehet magjishëm, atje duket se edhe mendimi filozofik formëzohet natyrshëm si komponent tepër i rëndësishëm i krijimit. Dhe poeti duke i kënduar jetës, deri në dhimbje dhe amëshim, pa e patur ndoshta si qëllim, në procesin spontan dhe metafizik të artit, krijon edhe filozofinë e saj, nëpërmjet ideve të mëdha, kur i këndoi ndjenjës dhe prej saj buroi idili poetik, i cili jo vetëm ndjehet, por edhe perceptohet. Megjithatë artisti krijon art nëpërmjet frymës, ngjyrimi i kësaj fryme është filozofia nga ai udhëhiqet. Pikërisht në rastin e Lasgushit, filozofia nga ai priret është humanizmi. Kjo e afron atë me mendimin dhe filozofinë më të kultivuar dhe bën që ai të duket shpesh ndoshta si poet filozof.

BIBLIOGRAFIA

Lasgush Poradeci, *Vepra Letrare, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”* Tiranë 1990.

P. Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...*, Shtypshkronja Tirana 1992.

Dion Tushi, *Historia e Letërsisë të Shekullit të XX – të*, Korçë 2005.

⁴⁶ P. Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...*, Shtypshkronja Tirana 1992, f. 80.

JONIDA CUNGU & ABDULLA BALLHYSA

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan
Fakulteti i Shkencave Humane
Departamenti i Gjuhësisë

POEZIA LASGUSHIANE SI VEPËR E ARTIT FIGURATIV

Ky punim mëton ta analizojë poezinë lasgushiane sipas një qasjeje të re, duke e konsideruar atë më shumë si vepër e artit figurativ, që luan me dritëhijet dhe ngjyrat, se sa vepër të artit fjalës. Midis përsiatjeve analizuese e përkufizuese që i janë bërë poezisë së Lasgushit nga studiues të shumtë e të ndryshëm, ne do të përpiqemi ta interpretojmë atë si një pikturë. Brenda një telajoje të tillë shumëdimensionale, marrin jetë artistike natyra të qeta e minipeizazhe, të cilat realizohen mjeshtërisht me anë të penelimit e ngjyrimit të fjalës së përzgjedhur poetike.

Metoda përshkruese do të shërbejë për të nxjerrë në pah leksikun e zgjedhur të poetit dhe përdorimin shumëkuptimor të tij. Poeti nuk e përdor fjalën vetëm thjesht matërial parësor për të ndërtuar vargje, jo. Lasgushi me fjalën thur telajon e pikturës me poezi. Kryerja e kësaj simbioze artistike bën realitet (fatlum për artin poetik shqiptar) shkrimet midis poetit dhe piktorit.

Gjuha e përdorur, fjalori poetik dhe metrika, janë elementë të vendosur në qendër të punimit e hulumtimit tonë, kjo, për të pasqyruar imazhin në poezinë lasgushiane.

Do të mbështetemi në potencialin semantik të fjalorit të tij, i cili vjen thellësisht figurativ dhe njëkohësisht i thjeshtë. Për këtë arsye poezia e tij duhet parë në përmasën e madhësisë së vargut dhe poezisë që mbart vargu.

Në analizën vijuese janë marrë si objekt studimi vetëm poezitë e vëllimit “Vallja e Yjeve”.

Në përfundim të punimit duam të theksojmë më tej idenë se Lasgushi si piktor levroi kryesisht portretin dhe pak peizazhe që anojnë më shumë nga “natyra e qetë”. Në poezi ai u mor edhe me peizazhin poetik, duke e konsideruar si vazhdim të krijimtarisë në fushën e artit figurativ.

Hyrje

“Poezia nuk duhet të thotë, por të jetë”

“Ars Poetica”, Archibald Mac Leish (1892-1981)

Midis dilemës nëse do të ishte piktor i madh apo poet i madh, Lasgushi zgjodhi të dytën. Ashtu siç rrëfëhet e bija e tij, Maria, Lasgushi nuk para fliste shumë për pikturat e tij, pasi nuk i konsideronte ato. Ndoshta mund të ketë qenë një brengë kjo dilemë, pasi në çdo poezi të tij ndjehet qenia e poetit piktor. Pavarësisht kulturës së tij për artet figurative, studimeve të ndjekura në këtë fushë, realizimet e disa pikturave të ndryshme, të cilat ruhen me fanatizëm nga familja e tij edhe sot, ka një ndjenjë të veçantë të poetit për pikturën. Ajo ndihet në krijimet e tij, në çdo muzë lasgushiane.

Portreti ishte një nga gjinitë e tij të preferuara, të cilën e lëvroi deri në vitet ‘30- ‘40 e më pas do të ishte e pamundur të vizatonte skicat e tij⁴⁷. Pikturat e tij përgjithësisht nuk janë të titulluara, ndërsa skicat-portret mbajnë emërtimin e individit. Për shkak të gjykimit të tij se portreti ishte gjinia më e vështirë se kërkonte shumë ngjashmëri, vërehet prirja e poetit për arritjen e perfeksionit në çdo krijim.

Është shkruar shumë për Lasgushin, për poezinë e tij, vargun, lirikën e përdorur, ndjenjën, artin poetik. Madje ka pasur përpjekje për ta përkufizuar poezinë lasgushiane në përkufizime të caktuara apo të përkufizuara. Ndoshta është një pamundësi e vërtetë. A mund të përkufizohet një art i lirë, i cili rrëshqet dhe shkrihet sa në aspektin poetik, aq dhe në atë figurativ?!

Poezia, Lasgushi, piktura

Disa nga elementët përbërës të analizës së artit figurativ janë disa syresh, si: masa, hapësira, kontrasti, ngjyra, simetria, kompozicioni, element abstrakt apo figurativ, etj. Ne do përpiqemi ta vëzhgojmë poezinë si një copë arti figurativ, si një pikturë dhe do të fokusohemi te simbioza e elementëve përbërës të artit figurativ me elementët e artit poetik.

Kur lexojmë Lasgushin, kuptojmë se teksti i poezive është konceptuar

⁴⁷ Intervistë e znj. Maria Poradeci. <http://www.pasqyre.al/lajme2/syte-trondites-ne-pikturen-e-lasgush-poradecit/>

si një shumësi tekstesh në të. Nëse nuk do kishim para syve një tekst poetik, por një pikturë, atëherë ajo do të ishte e mbushur me disa minipeizazhe apo shumësi veprimesh artistike njëkohësisht. Kemi interpretuar piktura të ndryshme, i kemi lexuar ato nëpërmjet analizës së elementëve, por te poezia lasgushiane lexojmë poezinë përmes pikturës. Këta elementë realizohen mjeshtërisht nëpërmjet hapësirës që i jep ai në poezi përshkrimi të peizazhit, portretit, personazhit, veprimit dhe fjalës. Kontrasti si element i artit figurativ ndjehet më së tepërmi në vargjet lasgushiane. Fuqia semantike e përdorimit të fjalëve dhe metaforat e përdorura, na vendosin para kontrasteve tërëse për natyrën, njeriun, perfeksionin.

Përballë artit lasgushian nuk dimë nëse gjendemi përpara vargjeve të një peizazhi apo të një pikturë të arrirë (poezia “Poradeci”, “Mëngjes”, “Mbarim vjeshte”, “Dimër”, “Dremit liqeri” etj.). Nëse poeti do t’i kishte shoqëruar krijimet e tij dhe me piktura, nuk do dinim se cili do të ishte më gjeniu, piktori apo poeti. Por, mesa duket bashkëpunimi artistik midis fjalës dhe imazhit nuk ka qenë në konsideratë nga Lasgushi. Apo ndoshta se marrëdhënia midis muzës poetike dhe figurative ka qenë e qenësishme. Është perceptuar se akti i krijimit të Lasgushi ka ndodhur në izolim, për shkak të karakteristikës që shoqëronte natyra romantike e autorit, veçimi.

Imazhi në poezinë lasgushiane paraqitet sa vizual, aq edhe verbal. Aty takojmë vashën, yllin, qiellin, flakën, liqenin, lotin etj., por më së tepërmi në ndjejmë verbalisht imazhin piktoresk para syve tanë: mallin, dashurinë, vrenjtësinë, zjarminë, hapësirën, thellësinë etj. Por në artin lasgushian vërejmë të jenë si pika takimi vizualiteti me verbalitetin. Natyra romantike ia jep mundësinë që ai si poet t’i përgjigjet pikturës dhe si piktor t’i përgjigjet poezisë. Kjo simbiozë artistike duhet konsideruar si një dialog i vendosur midis poetit dhe piktorit, i cili realizohet mjeshtërisht nëpërmjet leksikut të zgjedhur dhe fuqisë semantike të fjalëve. Poeti dhe piktori lasgushian kanë të përbashkët gjuhën e përdorur. Poezia e tij shndërrohet në pikturë. Ajo komunikon me ne njëkohësisht si mesazh dhe si imazh. Poeti përdor fjalët për të konturuar imazhin pamor që përcjellin vargjet dhe në e lexojmë, imagjinojmë, pikturojmë virtualisht meditimin. Përdorimi i fjalëve me kuptim

të plotë leksikor në poezitë e tij, të cilat shquhen për nga denduria e përdorimit, shenjojnë objekte apo sende. Thjeshtësisht ato krijojnë imazhin, figurën.

Vargjet lasgushiane përcjellin disa elementë: elementin poetik, elementin lasgushian dhe elementin pikturë (imazh). E thënë ndryshe, në çdo krijim është Ai, poezia dhe piktura. Edhe pse midis poezisë dhe pikturës ai vendosi një ndarje në heshtje, Lasgushi bashkëpunon njëkohësisht me poezinë dhe pikturën. Ai arrin t'i shkrijë në një të vetme këta dy përbërës, duke realizuar një imazh vizual (ose pikturën), e cila plotëson pamjen me çdo detaj. Ndaj thellësia e vargjeve lasgushiane duhet parë dhe në gërshetimin e dy arteve në një të vetëm. Për të kuptuar imazhin vizual të Lasgushit, nuk është e nevojshme të mbyllësh sytë për të imagjinuar, pasi piktura e tij është e gjallë. Ajo realizohet gjuhësisht përmes fjalorit të tij poetik.

Fjalori poetik lasgushian

Lasgushi dallohet për fjalorin e tij të pasur poetik. Pikërisht leksiku i përdorur, fjala e zgjedhur e bën poetin të qëndrojë midis dy botëve të artit: poezisë dhe pikturës. Ai duket se lëviz lirshëm nga njëra hapësirë artistike te tjetra, duke zgjedhur njësitë leksikore, semantikën e fjalëve, strofën, vargun dhe rimën.

Fjalori poetik lasgushian ka përmasa të jashtëzakonshme semantike. Ai shfrytëzon gjerësinë semantike të fjalës, duke depërtuar në të. Këtë e arrin me përzgjedhjen e fjalëve të thjeshta dhe kuptimplota, por shfaqin përmasa të theksuara konotative. (Nëse vërejmë njësitë leksikore më të përdorura në poezi, si: *mall* – 1 *kuptim*; *zemër* – 9 *kuptime*; *shpirt* – 9 *kuptime*; *sy* – 13 *kuptime*; *dashuri* – 5 *kuptime*; *yll* – 12 *kuptime*; *jetë* – 9 *kuptime*; *këngë* – 5 *kuptime*; *gji* – 10 *kuptime*. Janë të njëjtat njësi leksikore që përsëriten në disa poezi, si: *mall*, *qiell*, *yll*, *zemër*, *gaz*, *shpirt*, *këngë*, *dhembje*, *valë*, *liqer*, *zjarr* etj., por potenciali semantik që përcillet nga është i pakrahasueshëm. Në çdo përdorim të fjalës në varg, ne vërejmë nga një nuancë të ndryshme imazhi vizual, i cili reflektohet me ngjyra të ndryshme. Te poezia “*Rri mbështetem në tryezë*”, fjala “*mall*” vjen në ngjyra të errëta, “pa vjen malli të më ndezë”. Nuanca konotative jep në imazhin vizual të lexuesit tonin e errët të ngjyrave. Ndërsa te poezia “*Ylli*”, fjala “*mall*” vjen me ngjyra të shndritshme, “*yll*

e mall që shëmbëllen”. Poezia e tij përcjell njëherësh dhe mesazhin dhe imazhin.

Poradeci i shfrytëzon mjetet gjuhësore në të gjitha rrafshet: fonostilistik, leksikostilistik, semmantostilistik dhe sintaksostilisti. Do të ishte e pamundur që të merreshin në analizë të gjitha rrafshet në këtë punim, por do të fokusohemi te përdorimi i dialektalizmat dhe neologjizmat, si elementët më frytdhënës për shprehësinë leksikore.

Përdorimi i dialektalizmave paraqet potencial semantik të leksikut të përdorur. Nëse do të vërenim në poezitë e tij, do të listonim: te poezia “Poradeci” – *pipëlim, short, rarë, finosh, urgji*; te poezia “Mëngjes” – *svagullon, nosit, sumbull*; te poezia “Korrik” – *shullëz, zog ardhushi, çinçërron*; te poezia “Mbarim vjeshte” – *shtërg, plorësh, ugare, blatishtë, shtërgan, çoçërr*; te poezia “Zemra e liqerit” – *levorashe, gjeratorë*; te poezia “Vallja e luleve” – *okolleja, syvramuse, shaqiluar*; te poezia “Gjahtori” – *brymarake, shkembe, kollan, takije, silae, ovgjalah, stringë, palcorja, vezmezëja, bush, tumbave, vërzat, krastë, kunëz* etj.

Nëpërmjet përdorimit të fjalëve dialektore poeti vendos një lloj barazie përdorimore me leksikun letrar. Kjo zgjedhje nuk është e rastësishme. Njësi të tilla leksikore mbartin fuqi semantike, e cila shërbehet me një figuracion të përzgjedhur për të arritur lirizmin⁴⁸. Janë këto njësi leksikore të cilat realizojnë kontrastin, i konsideruar njëherësh si element i imazhit vizual (pikturës) dhe si element i peizazhit. Ai realizon një ambient të ngjohshëm me dialektalizmat, jo vetëm se lexuesi është më lehtë i përshtatur me to, por edhe imazhi vizual që përjetojmë na vjen më familjar, më intim.

Përdorimi i neologjizmave ka gjithashtu një peshë të rëndësishme në vargjet lasgushiane. Ai thjeshtësisht organizon njësitë leksikore dhe formëson fjalë me peshë semantike dhe figurshmëri të lartë. Bie në sy veçantia e përdorimit të ndajshesave dhe përftesave, të cilat shpesh herë janë autentike të autorit, duke treguar për neologjizma të personalizura. P.sh.: te poezia “Zog i qiejve” – *parëverak, syri-i-qarë, ças-par-ças, këngëtor-finoshit*; te poezia “Poradeci” – *armiqërishte, thëthimtar, mëmëdhetar, përrallshmë*; te poezia “Mëngjes” –

⁴⁸ Xhevat Lloshi, “Stilistika dhe pragmatika”, Tiranë 1999.

llambaritës; te poezia “Korrik” – *drizëri*; te poezia “Dimër” – *vajtimthin*; te poezia “Dremit liqeri” – *vjeshtërak*; te poezia “Gjumi i shpirtit” – *zemërore, paqtore*; te poezia “Kroi i fshatit tonë” – *ngjyrë-argjendi-lyer*, etj..

Vërehet se neologjizmat nuk janë ndërtuar sipas modeleve prodhuese të gjuhës, por janë ndërtuar për të perceptuar diçka ndryshe. Lasgushi ka pikturuar karakterin e tij unik nëpërmjet neologjizmave. Edhe aty ai ka prekur përsosmërinë me unikalitetin e tij. Këto fjalëkrijime përcjellin njëherësh fuqinë e poetit dhe shprehësinë e imazhit vizual përmes vargut. Çdo krijim i tij është një poezi, një pikturë. Ai mbetet jo vetëm një poet madhështor, por edhe një piktor i madh, i cili e transmeton figurën dhe peizazhin përmes lirizmit të tij.

Dhe në fund duhet ta mbyllim me një citim të Moikom Zeqos, “*Lasgushi është bir i harmonisë dhe mjeshtër i madh. Engjëjt e pikturës janë vërtitur përherë mbi kokën e Lasgushit për t’i vënë atij më shpesh kurorën me gjemba të gjakosur të Krishtit të lirikës. Këto engjëj nuk mund të zhduken asnjëherë. Amen!*”

BIBLIOGRAFI:

Intervistë e znj. Maria Poradeci. <http://www.pasqyre.al/lajme2/syte-trondites-ne-pikturen-e-lasgush-poradecit/>

Jani Thomai, “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, Tiranë 2011.

Lasgush Poradeci, “Vepra letrare”.

Luan Topçiu, “Lasgush Poradeci dhe ligjërimi modern i poezisë shqipe”, nga “Tekstualizëm dhe stil”, në “Ars Poetica”.

Moikom Zeqo, “Lasgushi dhe engjëjt e pikturës”, <http://www.gazetadita.al/lasgushi-dhe-engjejt-e-piktures/>

Nebi Caka, “Leksiku poetik i Lasgush Poradecit”, https://www.researchgate.net/publication/256088737_Leksiku_poetik_i_Lasgush_Poradecit

Moikom Zeqo, “Lasgush Poradeci dhe Kamadeva e dashurisë” <http://www.gazetadita.al/lasgush-poradeci-dhe-kamadeva-e-dashurise/>

Xhevat Lloshi, “Stilistika dhe pragmatika”, Tiranë 1999.

<https://atunispoetry.com/2013/02/03/peizazhi-ne-poezine-e-lasgush-poradecit/>

MAJLINDA BUSHAJ
Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër
bushajmajlinda@gmail.com

QARTËSIA E GJUHËS SHQIPE PËRMES FIGURSHMËRISË POETIKE NË PËRKTHIMET E LASGUSH PORADECIT

Lasgush Poradeci është një nga autorët më të mëdhenj shqiptarë që dallohet për krijimtari të begatë, krahas veprave origjinale dallohet edhe për përkthimet e tij. Poradeci ishte njeri me kulturë të mirëfilltë, njeri i pajisur jo thjesht me kulturë informacionesh, të dhënash, por edhe sidomos me kulturën e të menduarit e të arsyetuarit. Poradeci synon gjithmonë të rikrijojë vlerat ideoartistike të origjinalit në gjuhën amtare, duke gjetur variante të barabarta ose të përafërta. Për t’i ruajtur vlerat artistike të veprës, ai nuk ndalet para asaj që të sakrifikojë fjalët e rimën, qoftë dhe metrin apo vargun. Kjo e bën çdo përkthim të Poradecit të tingëllojë në gjuhën tonë natyrshëm, bukur dhe fuqishëm. Vepra e tij përkthimore dallohet për dendësinë dhe shpeshtësinë e shprehjes, figuracionin letrar-gjuhësor, theksin e veçantë sentimental, shprehësinë e një gjendjeje shpirtërore, ngjyrimet personale etj.

Lasgushi është një nga shkrimtarët tanë që e pëlqen përdorimin e figurave letrare në ligjërim e dallohet për krijime origjinale figurash e për përdorimin e tyre funksional në vepër. Këtu po japim pasurinë gjuhësore përmes figurshmërisë, ku vërejmë se ka shpesh jo vetëm përdorime, por edhe kuptime të figurshme të fjalës. Autori përdor me mjeshtëri figurat letrare dhe gjuhësore si: krahasimi, epiteti, metafora, metonimia, antiteza etj. Shprehësia është kategoria më e rëndësishme stilistike e Poradecit. Atë e arrin edhe me anë të figurave leksikore, dialektalizmave, prapashtesave përkelleluese etj. Fjala shqipe në përkthimet e Poradecit tregoi peshën e saj të vërtetë, zbuloi gamën e gjerë emocionale, pasurinë e nuancave dhe të toneve të brendshme, forcën dhe bukurinë metaforike si gjuhë arti.

Lasgush Poradeci është dhe do të mbetet një nga lirikët shqiptarë më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Kontributi i Lasgushit edhe në botën letrare të përkthimeve është i frytshëm dhe shumë i rëndësishëm. Pora-

deci është ndër ato figura, të cilat kanë spikatur me vlerat e veprimtarisë së tyre në të gjitha fushat, ku janë përfshirë⁴⁹. Në këtë punim po ndalemi te veprimtaria e tij në fushën e përkthimit.

Në veprën e tij përkthimore ai arrin të rijapë kuptimin e tekstit, por dhe ndjenjën dhe tonin e gjuhës, që lidhet me ngarkesën emocionale dhe veçoritë stilistike të origjinalit. Duke iu përmbajtur kësaj metode tek ai gjejmë, krahas përkthimeve me një besnikëri të plotë, pjesë të përshtatura, parafrazime, pasazhe të thjeshtuara, trajta popullore etj.

Lasgushi kishte përvetësuar mrekullisht dijet e nivelet evropiane, që kishte lexuar, kishte studiuar dhe kishte përkthyer disa nga vlerat më të qëndrueshme të poezisë evropiane. *Ai kishte njohuri nga mugëtirat e kulturave më të mëdha botërore, nga lashtësitë, por edhe nga perceptimet e reja moderne të poezisë evropiane të kohës.*⁵⁰

Qartësia e gjuhës shqipe gjen shprehjen nga tiparet përkatëse gjuhësore-stilistike dhe muzikaliteti i vargut që përfton tingëllim muzikor.

Kështu, pasurisë gjuhësore të veprës së Pushkinit ai iu përgjigj me një punë të madhe krijuese e hulumtuese për të hetuar, për të gjetur dhe për të shfrytëzuar aftësitë dhe rezervat e gjuhës amtare. Mjafton të kujtojmë neologjizmat e kalket që krijoi e sidomos numrin e gjerë të kompozitave që ndeshim në përkthimin e tij. Vepra e tij përkthimore dallohet për dendësinë dhe shpeshtësinë e shprehjes, figuracionin letrarogjuhësor, theksin e veçantë sentimental, shprehësinë e një gjendjeje shpirtërore, ngjyrimet personale etj. Fjala shqipe në përkthimet e Poradecit tregoi peshën e saj të vërtetë, zbuloi gamën e gjerë emocionale, pasurinë e nuancave dhe të toneve të brendshme, forcën dhe bukurinë metaforike si gjuhë arti.

Lasgushi është një nga shkrimtarët tanë që e pëlqen përdorimin e figurave letrare në ligjërim e dallohet për krijime origjinale figurash e për përdorimin e tyre funksional në vepër. Këtu po japim pasurinë gjuhësore përmes figurshmërisë në veprën e tij përkthimore A.S. Pushkin, “*Eugjen Onjegin*”, (në vargje në shqip prej Lasgush Poradecit), Tiranë,

⁴⁹ ASHSH, *Fjalor enciklopedik shqiptar* III, Tiranë, 2009, f.2069-2070; Hasan Hasani, *Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001*, f. 353v.

⁵⁰ E. Kabashi, *Lasgush Poradeci dhe kultura shqiptare*, SF, 1-2, 2000, f.12.

2001, në të cilën vërejmë se ka shpesh jo vetëm përdorime, por edhe kuptime të figurshme të fjalës. Autori përdor me mjeshtëri figurat e shqiptimit, figurat e fjalëve dhe të shprehjeve, figurat e sintaksës poetike dhe figurat leksikore, të cilat po i trajtojmë më poshtë.

Figurat e kuptimit

Krahasimi

Krahasimi mbetet një nga mjetet dhe proceset më të efektshme në lirikë, si hapi i parë në lëvizjet e brendshme kuptimore të fjalëve. Ai ka përdorim të gjerë, kryesisht i thjeshtë, por në mjaft raste edhe i zgjeruar. Krahasimet janë përdorur për të shprehur ide, kryesisht përmes asociacionit. Krahasimi ka rëndësi të madhe në letërsi, sepse i jep mundësi shkrimtarit që ta vizatojë më me hollësi sendin, njeriun ose veprimin. Me një krahasim të mirë mund të thuhet shumë gjëra. Krahasimi ndihmon të përftojme një shprehje të re, e cila na e jep mendimin më me gjallëri duke nxjerrë më qartë, më me përkatësi veçoritë e përgjithshme të dukurive.

*Djath'i Lumburgut mezetar/Edhe ananasi **posi jar**. (f.10); M'u çduk rinia plot gëzim/Si **gjurma juaj mbi blerim**. (f.17) etj.*

Përgjithësisht krahasimet e shumta karakterizohen nga vendosja e analogjive me emra konkretë, çka bën që vetë figurat të jenë konkrete dhe të fusin në përfytyrim një sërë figurash të bazuara me imtësi lëndore të botës materiale, veçanërisht objekte a dukuri natyrore ose kafshë nga më të ndryshmet si: ***dritë, këndes, buf, myk, rrebesh, qiell i kulluar, flutur, push, mag, vetëtimë, foshnjë, vëlla, gjurmë, shpërblim, margaritar, çakenj*** etj.

Analiza e hollësishme e krahasimeve na shtyn të dallojmë nga natyra e krijimit dhe funksioni ideoartistik disa grupe.

Krahasime konkrete përgjithësisht të njohura, me burim popullor ose mbi bazën e burimit popullor, të gjendshme në folklor, por edhe në ligjërimin e përditshëm, me një konsumim të relievit artistik si: ***si një i vdekur, si për mort, si foshnj' e dashur, si vëlla i vyer, si një flutur let-e – let etj***. Kështu ai merr një sërë krahasimesh të spikatura dhe krahas kësaj e përpunon figurën letrare. Kështu merr nga ligjërimi objektin a dukurinë me të cilin bën krahasimin, por jo të krahasuarin. *Gjollë –edhe*

shtigje – e vrage’ e shesh,/Çan jargavanët si rrebeshe/Si vetëtim’ e pandaluar (f.71).

Përmes këtij përdorimi vetjak shkrimtari shfrytëzon në ligjërimin e tij konkretësinë, koloritin, qartësinë e imazheve aq të gjalla të përfytyrimeve popullore të cilën Poradeci e shqipëron në mënyrën më të mirë. Në grupin e dytë të krahasimeve të përdorura ndeshim figura të krijuara, mbi bazë analogjish vetjake të autorit, përgjithësisht krahasime intelektuale e të kërkuara, me një qartësi më të vogël se ato të grupit të parë. Në shumicën e rasteve edhe këto krahasime janë konkrete, por këtu futen edhe krahasimet abstrakte si: *si një udhëtar i pirë-i fjetur, si me një mprojës hekuror, posi një vjershëtor e mitur,/si puthja plot me dashuri* etj.

Këto krahasime ndikojnë më shumë në të menduarit e lexuesit sesa në krijimin e përfytyrimeve të drejtpërdrejta. Kjo ndodh mbasi analogjia mbështetet shpesh mbi dukuri jo të njohura nga përvoja jetësore e lexuesit, por mbi përfytyrime të marra me mend, si: *si puthja plot me dashuri, si gjurma juaj mbi blerim, si leckë do na flaknin pas, si vetëtimë e pandaluar* etj.

Antitezat e shqipëruara me mjeshtëri nga Poradeci janë një mjet i fuqishëm letrar për të shprehur në mënyrë emocionale e për të forcuar mendime e ndjenja të kundërta. Antitezat krijohen me fjalë e me shprehje të tëra. *Përpikshëm që ta merni vesh,/Ku trim’i modës trupin e vetë/E vesh, e xhvesh, edhe e rivesh?* (f.13).

Në vepër janë përdorur me mjeshtëri edhe personifikimi, kontrasti, simboli, paralelizmi figurativ etj., të cilat do të jenë objekt i një studimi më të gjerë.

Figurat e shqiptimit

Pyetjet retorike luajnë një rol të rëndësishëm në vepër. Pyetjet retorike që nënkuptojnë pyetjet - përgjigjet mohuese, të cilat duke u shndërruar në pyetje e tërheqin më shumë vëmendjen e lexuesit duke e bërë edhe atë pjesëmarrës të gjykimeve të autorit. Pyetja retorike, është një domethënie si një ndërhyrje emocionale, e cila nuk kërkon përgjigje, por e nënkupton atë nga konteksti.⁵¹ Kjo është një prej figurave më të shpeshta të romantizmit, që ndikon shumë në strukturën e vargut dhe e

⁵¹ Xh. LLoshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Botimet Toena, Tiranë, 1999, f. 95.

ngjyros stilistikisht krejt poezinë.

-Ç'far hyri sot në karantinë/Nga rrësku q'erth, nga mall'i ri?/Erth ver'e pritur në fuqi?/Dhe e pesta ç'bën ? Për zjarre ç'dinë/Nuk ka zi buke, luftë a gjë./Të reja për këtë dh'atë?(f.207).

-Pra kush ka dashur?Kush besuar?/Kush s'do na bëjë tradhëti?/Kush do na matë – i pa munguar/Pas masës s'onë gjithsesi?/Kush kundër nesh s'do kallxojë/Kush do na mprojë-e kujdesojë?/Kush vesin s'do na vërë vesh?/S'do bëhet plot mërzi ndaj nesh? (f. 83).

Përveç surprizës, qortimit, keqardhjes, pyetja retorike ushtron te dëgjuesi ose lexuesi ndikim të fortë emocional, që shkaktohet nga vënia në lëvizje e mendimit të dëgjuesit gjatë procesit të gjetjes dhe të përpunimit të përgjigjes, megjithëse ajo pyetje nuk bëhet për të pritur përgjigje. Kështu emocioni i pashprehur plotësisht nga ligjëruesi me pyetje retorike kalon menjëherë te dëgjuesi a lexuesi dhe rritet në mënyrë përpjesëtimore me përpjekjet që ai bën për t'iu përgjigjur asaj pyetjeje.

Reticenca është figurë stilistike që formohet atëherë kur ndërpritet fraza, mbasi t'i jetë dhënë një ton, që i jep mundësi lexuesit ta kuptojë vetë atë që u la pa u thënë. Reticenca është të këputurit e menjëhershëm të ligjëratës me qëllim që lexuesi, duke u marrë me atë që u la pa u shprehur, ta përqendrojë vëmendjen mbi të dhe, nëpërmjet këtij përqendrimit, mendimi dhe ndjenja e pashprehur të marrë një fuqi më të madhe emocionale.

Kap vetëm hënën gjithë vaj...../Dal.....Krishtë...një njeri; - plot naze (f. 102); Ai veç mua ma kushtoi/Agimin' e jetës plot buçime!..../O shoq' e zemrës që më çmënd,/As eja pranë burrit t'ënd!.....” (f. 130); “Ah! Tajë, bëmë një të mirë...”/-Pra, folë, e dashur, urdhëro.-/”Të mos kujtosh...vërtet...mëshirë.../Po shih...Ah! Mos më kundërshto”.-Ja, për një Zot që kam besuar.-/”kështu, dërgo-e pa kuptuar/Ti nipin me këtë bilet.../Tek ai fqinji...sa më shpet (f.69) etj.

Pasthirrma është një shpërthim poetik i ndjenjave, që shërben për t'i bërë më prekëse fjalët e shkrimtarit ose të personazhit. Ajo shërben për të shprehur ndijime, ndjenja a vullnetin e folësit, por pa i emërtuar ato.⁵² Disa nga pasthirrmat e përdorura më shpesh janë: **o, oh, eh, ah, faleminderit** etj. Më shpesh ndeshen: **ah, o, eh**. Ato janë një mjet i

⁵²ASHSH-IGJL, *Gramatikë e gjuhës shqipe*, I, Tiranë 2002, f. 427.

preferuar i Lasgushit⁵³ dhe shërbejnë për të përforcuar shprehjen poetike.

O Lenski –i mjerë!Duke vuar/Ajo s’e zgjati-atë vajtim.(f. 147); *O miq, ju dhimshet vjershëtori:/Në lule – e shpresë- e lumturi*(f.137); *Eh? një dëfrim plot fshehtësirë/Ajo na kish dhe në tmerim:/Kështu i krijoi natyr’ e lirë* (f. 101).

Mbase fakti që ndeshen kaq dendur dhe i japin ngjyrim të veçantë veprës së tij ka të bëjë me mundësinë e përdorimit të shumëfishtë të tyre. Kështu përmes përdorimit të pasthirmave **ah, o** mund të shprehen dhi mbja, pikëllimi, dëshpërimi në një rast: teksa në rastin tjetër ato mund të jenë mjete përmes të cilave shprehet habia ose frika, mirëpo këto mjete gjuhësore mund të na shërbejnë për ta shprehur a përforcuar, në një kontekst tjetër edhe gëzimin, adhurimin kënaqësinë⁵⁴. Këto dukuri të pasthirmës i ndeshim të përdorura edhe në veprën përkthimore. **Ah**, *miq, ah, miq, ju njoh, ju çmoj! Jo më kot po i kujtoj.* (f.81); **Ah**, *dashuronte-ai i shkreti/Si s’bëjnë më; si pa pushim/Veç shpirt’i marrë – i një poeti/Të dashurojë ka dënim* (f.40); **Ah** *thuj, tajë-e dashur shumë,/Të fshehtën tënde ma rrëfe:/Ke dashur kur ke qën’ e re?* (f.59); **Ah!** *Tajë!po s’më hyn në punë/ Kjo mendja jote plot kuptim* (f.70); *Hyn...Ah, një lajm i pashpresuar:/ Vjen me muzikë i shoqëruar* (f.111) etj.

Ka raste kur Poradeci nëpërmjet përsëritjes së pasthirmave, qoftë brenda vargut, e shtresëzon atë në aspektin emocional. **Ah**, *këmbka ju! Ku shkëlmi – mbettë?/ Ah ku mbi lule vere sot?* (f.17) etj.

Duke i vlerësuar pasthirrat “si përbërës të rëndësishëm për shprehësinë poetike të Lasgush Poradecit”⁵⁵ ato shpalosin ndjenjat e autorit, i japin ngjyrim emocional poezisë e bëjnë gjuhën e tij më të qartë, më të kuptueshme.

O tmer!Më mirë-është për të /Në fshat e pyll përgjithënjë(f.156); *Po shkoj kjo dit’ e vrerit t’im;/O hije e tmerrshme, bëj pushim!* (f.127); *O parverë !o dashuri!/Se çfarë lëngesë- e drithm’ lote* (f. 144); *Ti*

⁵³ H. Matoshi, *Pasthirrat - shprehësia poetike e Lasgushit*, botuar në: Gjurmime albanologjike: seria e shkencave filologjike. -Nr. 32-33, Prishtinë, 02-03, 2005, f. 179-188.

⁵⁴ Po ai, po aty, f. 181.

⁵⁵ Po ai, po aty, f. 188.

lamtumir' o pyll i ri/O qiell tërë bukuri/E lamtumirë, moj naturë!(f. 156); *Pushtime –e lodra, lamtumirë!* (f.41); **Eh** *Tania. Ahere as dëgjuar / nuk kishim ne për dashuri* (f.59); **Oh**, *zog' e tajës, nuku fle!* (f.69); **Eh**, *taja, bijë u plak tashi* (f.70) etj.

Përsëritja është një nga përftesat e sintakës stilistike e cila krijon efekte semantike të shumta. Përmes saj rritet dendësia kuptimore e fjalës së përsëritur në krijimin e imazhit poetik. Format janë nga më të ndryshmet. Në vepër kemi përsëritjen e një lekseme në fund të strofave ose në fillim të vargjeve pasardhëse, por kemi edhe përsëritjet tingullore. Me përsëritjet në nivelin fonologjik, Poradeci përfton njësi të caktuara leksikore duke krijuar një sistem të lidhjeve të motivueshme ndërmjet strukturës fonologjike dhe strukturës semantike, një raport të ndërsjellhtë ndërmjet rrafshit të shprehjes dhe rrafshit të përmbajtjes. Strukturat tingullore në gjuhën e Poradecit janë të larmishme përmes përsëritjes së zanoreve, bashkëtingëlloreve, por edhe zanoreve dhe bashkëtingëlloreve njëkohësisht, por edhe vetë fjalëve.

Lum *i sëmuri! Lum dhe plaku!*

Mbi të ri fati gjith' gati.

Po mua –i ri më vluan gjaku!

Ç'pres un' i ziu? Mërzi, mërzi!... (f.202).

Këto përsëritje janë bërë burim shprehësie dhe përçuese të informacioneve të shumta estetike. Poradeci me këto përsëritje, por edhe me dukuri të tjera përpiqet të japë në gjuhën shqipe harmoninë e formës, harmoninë e figuracionit dhe harmoninë muzikore. Figurat tingullore nuk janë vetëm bartëse të informacionit estetik, por element i rëndësishëm i organizimit të krejt veprës poetike. Ndërthurja e elementëve tingullorë me radhitjen e formave gramatikore që kanë segmente të njëjta tingullore në fund të tyre, është tipar i gjuhës së Poradecit.

Oh, kudo qofsha i caktuar

Më ndonjë kënd prej fatit t'im

Kudo *q'anijen e përvuar*

Do të ma hedhi për pushim,

Kudo *që paqja të më marri,*

Kudo *që të më presë varri,*

Kudo, *kudo me zjarr në gjë*

Do të bekoj gjith' miqt' e mi (f.211).

Përsëritjet e veçanta të zanoreve, bashkëtingëlloreve, rrokjeve ose fjalëve të veçanta bartin informacion të rëndësishëm. Ato paraqiten si shenjues plotësues dhe si të tillë ndihmojnë lexuesin të kuptojë karakterin e tekstit dhe ta përjetojë atë.

Anafora. Përsëritjet leksikore në gjuhën e Poradecit i nënshtrohen një vargu veprimesh stilistike. Ndër më të shpeshtat është anafora. Anafora është përsëritja e leksemës a e grupit të fjalëve në fillim të vargjeve ose fjalive. Anafora, jo vetëm që ka të bëjë me përsëritjen e një fjale në fillim të vargjeve të një strofe, që ndjekin njëra-tjetrën, por krijon efekte shqiptimore. Shfaqja formale e anaforës është e larmishme, duke sjellë pasurinë e semantikës së shqipes. Shumë shprehje poetike janë ndërtuar mbi bazën e anaforës, përmes së cilës janë krijuar efekte të forta. Strukturat semantiko– sintaksore krijojnë mundësinë e lidhjeve paradigmatiche dhe forcën semantike të zëvendësimit brenda strukturës paradigmatiche.

Do them si vishej miku im

Do t'ish guxim me kaq përshkrime (f.15).

Tashi një gjarpër në kujtime,

Tashi pendimi vjen e bren (f.23).

Përsëritja leksikore në formën e anaforës përdoret si mjet për të lidhur vargjet e njëpasnjëshme në fillimet e tyre. Ndonjëherë përsëritja merr formën e lojës poetike, në funksion të stilizimit të vargjeve ku realizohet një shprehësi e lartë.

Epifora. Përsëritjet leksikore në formën e **epiforës**, që rrokin fjalë, fraza a pjesë të fjalisë në fund të vargut ndeshen në gjuhën e Poradecit. Përsëritjet te epifora krijojnë rritje të tensionit e të shprehësisë.

Rusisht, e ndrythnin plot lezete?

Dhe gjuhë e luaj pa lezet

Nuk ish për to si gjuh' e vet? (f. 64).

Një veçori tjetër në gjuhën e Poradecit është përsëritja e fjalëve të njëjta për të spikatur ato më shumë, përsëritet fundi i vargut të parë dhe fillimi i vargut tjetër. Një dukuri e tillë, siç dihet, quhet **anadiplozë**.

Dhe ish i dashuruar...kishte

Pakmos këtë mendim të lum

Lum kush ka besën foshnjërishte (f. 97).

Në shembullin e sjellë, me qëllim të theksimit të një pjese të vargut, në raport me pjesët e tjera, përsëritet fundi i vargut të parë dhe fillimi i vargut tjetër (fjala **lum**). Kjo përsëritje për shkak të pozicionit në varg ka funksion ritmik e organizues dhe, sidomos, funksion semantik. Ajo ndikon edhe në përmbajtjen semantiko-stilistike të këtyre vargjeve dhe të të gjithë kontekstit.

Një formë tjetër interesante e kësaj përsëritjeje është **anadiploza e brendshme** që realizohet në pozicionin e mesëm të vargut: *Ndër vëthë-e vëthkat j-a këputi;/Tashi dhe një këpuck e futi* (f.104); *Ai bën shënjë-e gjithë flasin;/Ai ze pin e pijn' ata;/Ze qesh-e qeshin e buçasin'* (f. 106); *Të vjetrit vjetëruar keq;/Të rinjtë shkarë dhe për dreq.*(f. 22); *Si çupkë çupkat nuk i desh/Me to të lozë e të kacejë* (f. 43) etj.

Figurat e fjalëve dhe të shprehjeve

Metafora. Përdorimi i metaforave është karakteristikë në këtë vepër. Ato janë përdorur jo vetëm për të rritur figurshmërinë e ligjëritimit e ndikimin emocional mbi lexuesin, por edhe për të përqendruar vëmendjen e lexuesit në anë ose dukuri të veçanta që ai do të theksojë në funksion të pikësynimit të tij ideoartistik. Metaforat dallohen për shumëllojshmërinë e rolit që ato luajnë në ligjërim dhe të funksionit të tyre: *Dhe prapë zjen kjo zemra ime;/ Vlon gjak në zembrën q'u mpi*, (f. 19). Shpeshherë metaforat kanë karakter përforcues, gjithmonë mbi bazën e ngjashmërisë, por nga një këndvështrim i ri i veçantë, një veti a një gjendje të një dukurie pa i shtuar mendimit të shfaqur ndonjë vlerë njohëse të re. Kështu p.sh. në metaforën *frutat e zembrës*, vlera njohëse mbetet edhe nëqoftëse shmanget metafora e flitet thjesht për frutat. Por, duke shtuar metaforën, autori ndryshon cilësinë e kumtimit, sepse shkakton te lexuesi një përfytyrim të figurshëm të dukurive për të cilat flet, duke krijuar tek ai njëkohësisht edhe një kënaqësi estetike: *Frutat e shkençës, gas, mjerim* (f.38); *Dëshir' e mall e ëndra plot;/Frutat e zembrës që s'fle dot./* (f.55) etj.

Përmes shumëllojshmërisë së metaforave shkrimtari aktivizon ndijime shqisore te lexuesi, të cilat bëjnë që konkretësia të perceptohet gjallërisht tek ata. Në këtë mënyrë lexuesit e përjetojnë me ndjeshmëri të lartë gjendjen ideoemocionale që kërkon autori. Të tillë janë shembujt

e mëposhtëm:

Kam mundur të mësoj se gratë/ e tundin shpirtin tradhëtisht (f. 75); *T'ia tundim zemrën, përsëri/T'i ndezim zjarr me xheloz* (f. 63); *Më qan me lotë shpirt i ngrat* (f. 68); *S'i-a ftohnin shpirtin djaloshar/të ndezur prej të pastrit zjarr.* (f. 40); *E dirgjej bota në pushim/ e derdhte hëna frymëzim* (f.60) etj.

Metonimia është një lloj metafore ku kalimi i kuptimit realizohet në bazë të raporteve të caktuara logjike. Në vend të një fjale që ka kuptim të caktuar, përdoret një fjalë tjetër, pra kuptim tjetër që ka një farë lidhje logjike me kuptimin e parë. Metonimia është një formë më e dendur e bartjes së kuptimit dhe formë e tillë e bartjes, ku kuptimi i ri fshin kuptimin e parë. Prandaj metonimitë në vepër realizojnë shprehje të fuqishme dhe në pikëpamje kuptimore të pasura.

Duke menduar me gjykim,/Ai kish faj për të dënuar (f. 124); *Kopj' e tablojt me plot shkëlqime,/ "Freischuetz"-i madh n'ekzekutim/Prej një shkollares pa guxim.* (f. 66); *E ka vendosur Qielli vetë,/Jam jotja në përjetësi;/Gjithë jeta ime më pat qënë/Një peng se ty do të takoj* (f. 67) etj.

Sinekdoka ka të bëjë me marrëdhënie varësie midis sendeve, por ndryshe nga metonimia, këto marrëdhënie varësie nuk janë të çfarëdoshme, po lidhje sasiore, (numri, madhësia, vëllimi, përmasat etj). Sinekdoka është një figurë stilistike në të cilën ndryshimi i kuptimit të fjalës ngrihet mbi një marrëdhënie sasiore, d.m.th. jep një kuptim më të gjerë, ose më të ngushtë nga ai që ka fjala në kuptimin e vet kryesor. Kjo figurë ndeshet e përdorur me mjaft mjeshtëri në vepër:-*Të mprojtë Zoti nga dynjaja!-Edhe mëndesha n'adhurim/I bëri plot besim.* (f. 60); *Çdo që ndër naze marrëzije/Bën Londra për hir tregëtije, /Sjell mbi Baltik e nga çdokú/ Merr si shkëmbim katran e dru* (f. 13) *Dhe ja-çmendon kjo bot' e vjetër/Nder e sajdi- një perëndi!* (f. 125); *Mbase-edhe s'dinte bota ç' thesh,/Po sigurisht s'i pritej hovi,/S'desh të përfillte ndonjeri;/Ndaj s'e duronte asnjë fqi.* (f. 91) etj.

Perifraza është një lloj metonimie, sepse me anën e saj kemi emërtimin e një sendi a të një dukurie, me anë të një sendi a një dukurie tjetër, ku në mes tyre ka njëfarë marrëdhënieje varësie. Po, ndërsa te metonimia një send a dukuri emërtohet me një fjalë të vetme, te peri-

fraza ky emërtim bëhet me anën e shumë fjalëve. Perifraza është të emërtuarit e një sendi jo me fjalën e vet përkatëse, po me anën e një shprehjeje të zgjeruar.⁵⁶ Këtë figurë Poradeci e përdor për ngjyrim e individualizim: *Po sidoqoftë, o ti lexonjës, /Ah, dashuronjës in e ri, /Poetin, djalin ëndërronjës, /E vrau me dorë shok'i ti!* (f.139); *Ku vate zjarr' i dashurisë/ E nxitje-e etje-e mall që ndes, /E frika për çdo turp e ves, /E ti yll i fantazisë, /Ti shënjt'e qejve plot hare, /Ti vjersh' e shentë përmi dhe!* (f.137) etj.

Epiteti luan një rol të rëndësishëm në vepër. Nëpërmjet epiteteve përshkruhen karakteristika të personazheve, dukurive, objekteve etj., si: *vargu magjistar, shtatin magjistar, dasmës krenarake, lumi perandorak, muza përgjërore, qarkun fshatarak, vrull të zjarrtë, roj' e shitur, e pabesë, perëndesha madhështore, mallin vajzarak, zemrës durimtare* etj. *E deshte burr'i i dhelpëruar/ Që tek Faublas-i nxu mësim*(f.8); *Gjith dritë e nur, e thither fare/Prej violinës magjistare,* (f.12); *Plot me ndriçime-e ar e zjarr/Shkëlqen pallati zulmëtar* (f.15); *Përplot me frymëzim të zjarrtë /Këndo djëborën madhështor, /E gjithë nurin dimëror* (f.99); *Shkëmbinj kalldrëmi tingëllor/Mbulon qytetin e shpëtuar, /Si me një mprojtës hekuror* (f.206); *Po shpresat, sado dhe të kota, /Më mbajnë të mos dal nga bota, /Fat-zi, me shpirtin zemëarak, /Pa lënë gjurmë sadopak* (f.50).

Eufemizmat janë një veçori e rëndësishme gjuhësore. Ato përdoren për të emërtuar ato fjalë që nuk mund të thuhën me emrin e tyre të vërtetë. Gjuha shqipe krahas pasurisë dhe larmisë së fjalëve dhe njësive frazeologjike nga fusha të ndryshme të jetës shoqërore është e pasur edhe me eufemizma të cilat përdoren për të zëvendësuar ato emërtime që populli nuk dëshiron t'i quaj me emrin e tyre të vërtetë. Po japim disa shembuj të përdorur në gjuhën e Poradecit: *Shtje fall dh'i vjetëri pa zjarr, /Një këmbë jasht' e një në varr* (f. 101); *Plot mall e ëmbla bukuri/ Q'e mbante shpirti im të fshehtë:/Dhe muza vij i falte jetë:* (f. 28); *Dhe se s'do dridheshin aspak/Për nder të tij të derdhnin gjak* (f. 34); *Ç'ka? Çëndr' e tmershme e zotëron! / Ç'do gjë zemër-ftohtin që përton/Në fund të shpirtit e tronditi* (f. 180); *N'atë dëfrim përgjithëmonë, /Harruar miq edhe qytet, /Fest' e mërziqje për lanet.* (f. 91) etj.

⁵⁶ Gj. Shkurtaj, *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, Tiranë, 1988, f. 273.

Ndeshim edhe mjaft tabu në vepër si p.sh.: *Maçok i madh duke gërhitur/Që rrin e lahet në turi:/ I sillte miq me saktësi,/Një vetull hëne kur, pa pritur/ Ajo shij majtazi në qiell,/Ish shenjë se të ligën ndjell* (f. 100) etj.

Tabutë dhe eufemizmat kanë rëndësi edhe për gjuhësinë dhe leksikologjinë historike, ku dukuria e tabusë paraqet interes të padiskutueshëm, meqenëse na jep mundësi të kuptojmë zhvillimin e fjalëve të veçanta dhe zëvendësimin e tyre me fjalë të tjera. Sfera e përdorimit të eufemizmeve është e gjerë. Ata shërbejnë edhe për pasurimin e fjalorit të një gjuhe. Shembuj në formën e urimeve, mallkimeve: *Atë një Zot e pastë ndjerë!/ E kockat mos i paçin zor* (f.151) etj.

Me të drejtë është theksuar se: “Eufemizmat dhe përvetësimi i njohurive për to janë një lojë e vazhdueshme në mes gjuhës dhe shoqërisë. Ato janë një ndër mekanizmat që flasin bindshëm se gjuha, sidomos në aspektin e saj pragmatik dhe kjo nënkupton gjatë përdorimit të saj, nuk mund të paramendohet e shkëputur nga shoqëria.”⁵⁷ Duke i gjurmuar është e mundur të kuptohet *se çfarë ka ndodhur ose po ndodh në gjuhën tonë, mendjen tonë dhe kulturat tona*.⁵⁸

Figurat e sintaksës poetike

Gjedhet e ndërtimit të togjeve e të vargjeve në përkthimet e Poradecit nuk dalin prej skemës së gjuhës shqipe, por brenda këtij ligjërimi ai ka aktualizuar pasuri e larmi të madhe të ndërtimeve sintaksore. Ai parapëlqen të shfrytëzojë zhdërvjelltësinë për të zhvendosur gjymtyrët sintaksore, duke qenë i vetëdijshëm se gjuha shqipe njih gjedhe të pakufishme strukturimi dhe se në këto zhvendosje qëndron shprehësia dhe gjallëria e sintaksës së shqipes. Ai ka treguar se në gjuhën shqipe janë të pranueshme të gjitha zhvendosjet me funksion stilistik. Këtë e provon më së miri përdorimi i **inversionit** i quajtur ndryshe **anasjellë**, që kushtëzohet dëndur nga nevojat e metrit e të rimës, por ka edhe efekte të mirëfillta ideoartistike: *E ju, të reja bukuroshe,/Që natës von rri ju rrëmben /Karoc’ e shpejtë nëpr qoshe* (f. 20); *Ish krenarak vështrim’i ti,-/Dhe shkrivi krahun urtë- e-mbarë* (f.147); *Pamje me kaq thjeshtësi:*

⁵⁷ I. Durmishi, *Eufemizmat si dukuri gjuhësore me karakter sociolinguistik*, Seminari VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2012, f. 266.

⁵⁸H. Rawson, *A dictionary of euphemisms and other doubletalk*, New York, Crown Publishers, 1981, f.1.

/Kjo është e thjeshtëza naturë (f. 99) Trembin të turpshmen dashuri,/Edh' e tërhiqnin përsëri (f. 62); Në dritë ljepuri qyqar/Kur sheh të tmerrëshmin gjahtar (f.73) etj.

Në gjuhën e Poradecit gjejmë tipa të ndryshëm të inversionit. Më të lidhet edhe rendi i kryefjalës, kundrinës, i rrethorëve dhe i mbiemrit në varësi të emrit etj. Në këtë kontekst dalin shprehëse dhe me ngarkesë të madhe emocionale.

Funksioni stilistik i inversionit është aq i fortë, sa që mund të arrihen efekte të forta stilistike edhe në rastet kur nuk përdoret qëllimisht. Efektet stilistike të inversionit janë të shumta në pendën e Poradecit.

*Në dije, s'ish pedant pa vent./ Kish dhe të lumturin talent/Se çfarëdo e prekte letë,/Pa turbullim në bisedim- (f. 5); Dhe ish i thell' ekonomist/Që domethënë, si jurist (f. 6); Dëshmor fatkeq", larg Italisë,/Të ndriçmen jetë plot stuhi/Ndër stepa tej në Moldavi. (f. 6); **Bekuar** qoft' e zi e vaj,/E nat' e ardhme paskëtaj (f. 130); **Im-shoq**, q' ishte m'i ri, më gjet/Kur isha trembëdhjetë vjet,/Dy javë ajo që bëj fejesë/hyri tek ne puna mbaroi,**Im-at** dha fjalën më bekoi. (f. 59); Ai të parën djalëri/ E humbi kot si në shtërngatë,/ Ndër pasione pa kufi (f. 77); Dhe **mendjeçeluri** knjazhnin/Ku lot' e popullit shijovi (f.11) etj.*

Përqendrimi i theksit logjik në njësitë më të vogla të ligjërimit, rrit intensitetin e forcës semantike dhe krijon efekte stilistike të menjëhershme dhe të forta, pas një harmonie të rendit sintaksor në njësitë ligjërimore. Inversioni ka si qëllim të vërë në dukje një fjalë ose një pjesë të periudhës, për të spikatur më mirë ndonjë ide a mendim të caktuar. Përcaktuesi del përpara të përcaktuarit. Kjo ndikon mbi përfytyrimin, e shtyn marrësin të hamendësojë. Inversioni e bën gjymtyrën përkatëse të dallohet, të tërheqë vëmendjen, të fitojë një ngjyrim emocional. Kjo përmbyste nxit përfytyrimin e lexuesit, nxit fantazinë e tij në lidhje me kuptimin e shënuar në një varg.

Shkallëzimi është figurë e sintaksës me të cilën në mënyrë të shkallëzuar përforcohet ose zbutet përfytyrimi, emocioni, mendimi, ideja përmes radhitjes së shprehjeve të përafërta semantike. Janë të shpeshta rastet ku në të njëjtin kontekst gjejmë që të dyja format me shkallëzim ngjites dhe me shkallëzim zbritës.

Në këtë jetë bres-me-bres/Rron e mbaron e bije –e vdes.../Kështu kjo

raca jon' e shkretë/ Ritet e zjen edhe buçet,/Në varr me gjyshërit fundet (f.49); *Mbi male –e fusha fluturim;/Dhe karocarët pa pushim/ Këndoju' e zihen e bërtasin* (f.199) etj.

Në këtë rast shkallëzimi me foljet ka denduri të madhe të paraqitjes. Asnjëra prej foljeve të përfshira në këto vargje nuk është figurative vetvetiu, por në kontekst më të gjerë radhitja e tyre e shkallëzuar është kthyer në qendër të organizimit figurativ. Vlen të theksohet se në morfologjinë përkthimore të Poradecit parimi i shkallëzimit ndërtohet me pjesë të ndryshme të ligjëratës. Në sintaksën e Poradecit fjalitë e përshkallëzuara kanë zakonisht strukturë të qëndrueshme dygjymtyrëshe, ndërsa kuptimet e tyre mbështeten në semantikën e lidhjeve të shkallëzuara, që mund të jenë lidhëzore ose jolidhëzore. Në të gjitha rastet shkallëzimi ka funksion stilistik.

O miq, ju dhimshet vjershëtori:/Në lule – e shpresë- e lumturi,/Që s'harriu dot t'i ndjej'i gjori,/Sa dolli që nga djep'i ti- (f. 137) etj.

Elipsa. Këtë figurë gramatikore e stilistike, që formohet duke lënë jashtë një a më shumë fjalë në një frazë, me qëllim që mendimi të bëhet më i përmbledhur e të shprehet më me forcë, pa u dëmtuar qartësia e tij. Kështu autori lë jashtë foljet dhe krijimi merr një formë më të përshtatshme për përshkrimin e peisazhit, situatave ose karaktereve.

Fjalitë pa folje nuk janë të shumta në gjuhën e Poradecit, por kur ato paraqiten tregojnë shprehjen poetike. Sado e pavarur formalisht fjalia pa folje është patjetër e lidhur ngushtësisht me kontekstin dhe vetëm në kontekst ajo bëhet e plotë. Plotësia e saj dhe lidhja me kontekstin shihet në realizimin e saj të pasur ligjërimor, që del prej kontekstit. Konteksti mbulon mungesën e elementeve të caktuara, në të vërtetë zëvendëson elementet leksikore që mungojnë. Realizimi ligjërimor lidh fjalinë pa folje me kontekstin, ç'është e vërteta ia nënshtron kontekstit. Fjalia pa folje e Poradecit shpreh përmbajtje më të ngjeshur e më të pasur semantike. *Lum i sëmuri! Lum dhe plaku!/Mbi të ri fati gjith' gati.* (f. 202).

Asindet. Termi vjen nga greqishtja **asyndeton** “i palidhur”. Quhet asindet ajo figurë gramatikore, që krijohet kur lihen jashtë lidhëzat ndërmjet pjesëve të një fjalie a të një periudhe, për të bërë që të spikatë më mirë fuqia shprehëse e mendimeve të radhitura njëra pas tjetrës.⁵⁹ këtë

⁵⁹ Gj. Shkurtaj, *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, Tiranë, 1988, f. 257.

dukuri e ndeshim në vepër.

Tund natën klithma për lebet...

Kasollja krisi duk' ushtuar

Tatjana zgjohet e tmeruar...

Ja, dhoma ndrin në qetësi;

Xhamet e ngrira për bukuri (f. 107)

Krahas asinetit në veprën e tij përkthimore gjejmë edhe **polisindetin**, “figurë gramatikore që formohet duke përsëritur lidhëzën bashkërenduese (këpujore ose veçuese) përpara disa emrash, mbiemrash ose foljesh, me qëllim që, duke u lidhur bashkë e gati duke u ngjeshur idetë me njëra pas tjetrës, t’i japin më tepër forcë shprehjes”.⁶⁰ Kështu, në gjuhën e Poradecit ndeshim një numër të madh vargjesh, ku përdoret kjo figurë gramatikore. Me raste të polisindetit kemi të bëjmë edhe kur lidhëza përsëritet brenda të njëjtit varg: *Një mikut mund t’i bësha mi-ke,/Dhe shoqe –e jetës e besnike,/Dhe zonj’ e ndershme për shtëpi.* (f. 67); *S’kish nër qëllime pretendim,/As përkëlletje s’kish nazike,/As hollësi, as fantazi...* (f. 176); *Kjo libër nuk kishte brenda/As vizatime që t’i kënda,/As fantazira-as poezi,/As fjalë plot me urtësi* (f. 108); *Shpërthevi egër ferr’ i zi/E dhëmb’ e kthetëra dhe brirë,/Mustaqe sqep edhe turinj,/Llap’ e përgjakshm’ e bishtërinj/e rrashta plot me ndohtësirë* (f. 107) etj.

Figurat me shtresat leksikore

Shprehësia është kategoria më e rëndësishme stilistike. Bartësja kryesore e saj është figura, e cila për Poradecin është mjet themelor për krijimin e shprehësisë, por përveç figurës një lloj i veçantë i shprehësisë në gjuhën e Poradecit është ajo që realizohet përmes përdorimit të një-sive sinonimike.

Sinonimia është mjet i rëndësishëm i shprehësisë, sepse jep mundësinë e shprehjes së mendimeve në mënyra të ndryshme.⁶¹ Prania e sinonimeve në përkthimet e Poradecit, si fakte të shprehjes që pasqyrojnë në kuptimet e tyre anë të ndryshme të nocioneve dhe japin ngjyrimë emocionale, është tregues i pasurisë së gjuhës, i gjerësisë së leksikut të veprës së përkthyer. Sa më shumë sinonime të ketë gjuha, aq më i pasur

⁶⁰ Po ai, po aty, f.257.

⁶¹ Sh. Islamaj, *Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe*, SF, 4/1986, f.119-123.

është leksiku i saj. Me anë të tyre gjuha shpreh nuancat më të holla, bëhet më e bukur dhe më e qartë. Sinonimet janë një mjet shumë i fuqishëm në vepër. Me anë të tyre shprehet më me saktësi e ngjyrë përmbajtja, bëhet tipizimi dhe individualizimi i figurave. Në vepër ka sinonime të plota, por ka edhe sinonime kontekstuale:

U mbyll e u ndry për dashuri/E s'ka veç natë-e sbratësi. (f. 75). *Kështu, u mplaknë pa pandyer,/E në fund burrit, sikur s'qe,/I hapi varri port' e dyer/I-u sulla një kuror' e re.* (f. 48); *Vështron e sheh dhe kupëton/Se duhet shkuar është von.* (f. 131); *U çduk zilija dhe nakari/Para syve porsi jari* (f. 126) etj.

Antonimet janë fjalë me kuptim të kundërt. Si të tilla ato janë mjete të afta që ndihmojnë për të shprehur me plotësi anët e ndryshme të realitetit. Në gjuhën e Poradecit antonimet përdoren gjerësisht si mjete të fuqishme shprehjeje për të ndërtuar sidomos antitezat, aq të fuqishme dhe goditëse.

Ndaj botën e huaj që se njoh/N'atë gazmend si vijn'e-venë. (f.11); *Kushdo që t'ishe, o lexonjës /Dua prej teje – mik, armik* (f. 195); *Nga thelb' i zemërës së shkret/ Shkurtohen, zgjaten plot lezet* (f. 86); *E kapi-talin mendimtar/Që vdiq, ta ngjallim do kërkon:* (f. 88) etj.

Për rolin karakteristik të antonimeve për shprehjen e gjallë plot emocion e ngjyrë, na flasin këto vargje të shqipëruara: *Përpikshëm që ta merni vesh,/Ku trim'i modës trupin e vetë/E vesh, e xhvesh, edhe e rivesh?* (f. 13); *Vajtje-edhe-ardhjet i-u mallkon/Dhe dërdëllitjen që s'mbaron...* (f. 55); *Një lumturi që s'ka të ngosur./Të rroj, të vdes për nënë të,/Nuk dëshëronja tjetër gjë.* (f. 74) etj.

Frazeologjia e përdorur në përkthimet e Poradecit sjell vlera të mëdha nga përmbajtja, ngjyrimet emocionale, nuanca të holla kuptimesh e përdorimesh, shprehësi të lartë. Kjo i jep ligjërimin të tij poetik një saktësi të madhe e një zhdërvjelltësi të bukur, Njësitë frazeologjike në mënyrë të veçantë formësojnë gjuhën, “shpeshherë japin nuanca më të holla kuptimore sesa vetë sinonimet”⁶². Frazeologjia luan një rol të rëndësishëm në vepër edhe nga pikëpamja stilistike. Ajo më shumë se çdo fushë tjetër është e lidhur me traditën, historinë dhe kulturën e një populli.

⁶² Sh. Islamaj, *Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe*, SF, 4 /1986, f.120.

Frazeologjia është e ndërtuar në formë togfjalëshi, por ka edhe ndërtime me strukturë vargu a fjalie.

S'i-a merrte vesh ky truri i t' et/Dhe jepte tokat për senet. (f. 6); *Shpejt afsh' i zemrës na bren gjinë.* (f.7); *Të të duroj një peng fisnik,/Një peng, më fort që të ket' hije/ Ndaj shpirtit tënd plot bukuri* (f. 2); *Kur i jep bar-rat, i qan hallë,/Po vetvetiu mallkon e pyet:/"Si s'të merr dreqi sa më shpejt!"* (f. 3); *Lenski këtu s'e zgjati më,/Po udhëtoj pa nxjerrë zë.* (f. 53); *Kish dorë –e duelisti plak,/I lik, s'gërmitës, dërdë-llak...*(f. 125); *Dhe bot' e qeshur e urovi;/Kjo na dha kraha, na dha zjarr;* (f. 170); *Sa herë muza përgjërëre/ ma çeli jetën q'u nemit* (f. 171) etj.

Frazeologjizmat shprehin edhe përbuzje, tallje, ironi, sharje, shaka ose përkëlleje, dëshirë, urim, dashuri etj. Ato më shumë se fjalët e konkretizojnë situatën, janë të një shkalle më të lartë aktualizimi, i japin ligjërimin poetik përmbajtjen e kërkuar.

Sa shpejt zu bëhej me dy faqe, (f. 7); *Sa vrer për ta kjo fjal' e keqe!/Sa ngusht' i shtiu ata ndër leqe!* (f. 7); *Ju lutem ndal-ni seç po flas: T'i hapni sytë në çdo ças.* (f. 16); *Ndonse njerzit i dij me gisht/Edh' i përçmonte naturisht.* (f. 37); *Dhe un' e kisha gjith' më krah/"I-a hiqnja veshn' ashtu nga –ca* (f. 164); *Jep mend kur Shteti shkon përpara* (f. 6); *Po shpejt të gjitha i la në bisht* (f. 47); *Të gjithë pak-nga pak mësuam/Ne ndonjëgjë, siç vumë vesh* (f. 5); *Pra? Emr' i bukur, godet mirë,/Veç që, me hir e me pahir* (f. 42); *Ne mbahemi kaq lart me të/Për sy e faqe-e asgjë më* (f. 42) etj.

Në gjuhën e tij përkthimore gjejmë edhe përpunime e përdorime njësishe frazeologjike, të krijuara mbi bazën e një shkallëzimi rritës. Në disa raste, kur nga dy njësi frazeologjike është krijuar një njësi e re si nga ndërtimi ashtu edhe nga kuptimi, njësia e përfutur ruan lidhjet me dy njësitë frazeologjike fillestare, por nuk është e njëjtë me to, p.sh.: *Kudo nga zemra janë pritur,/Me buk e kryp e gaz e nur* (f. 164); *T'i vij dhe fjalës kryp' e bisht/Kur dhimte kryet tmerrësisht*(f.20); *Nga borxhe e gjepura lloj-lloj,/Kush urt' e butë si fitoi/famë dh ear u pat graduar* (f. 174); *Pastajza, pipën duke pirë,/Në ujë e krypë-i përtërirë/ Parajsën si nj' anadollak* (f. 207) etj.

Veçori të ndërtimeve janë: si: ndërrimi i rendit të gjymtyrëve (inversioni), ndërfutja e fjalëve të tjera, zgjerimi a cungimi i njësisë

frazeologjike etj. Po japim disa shembuj: *Kur të merr bota nëpër gojë/(Pranoni) nuk bëhet dot/nër njerëzit me cip' e bojë* (f. 197); *Ma mirte mua mëndjen: çdo/Që kisha unë, nganjëherë/ E jepnja miq a mbani mend?* (f. 94); *E s'binte rëndë ajo në vesh/ me atë liri që shkon e qesh.* (f.181); *Nuk ishe ti, zemr' e zjarrmuar./Nuk ishe, dorën që ma dhe/ Për në lavdi, për në hare?* (f. 171) etj.

Dialektizmat leksikorë si fushë e leksikologjisë, tashmë shihen edhe si fushë e stilistikës, sepse si mjete me prejardhje dialektore, përfshihen në një tekst me një natyrë tjetër për qëllime stilistike. Dialektizmat marrin jo pak funksione në aspektin stilistik, si: përshkrimi i peisazhit të fshatit, të qyteteve të vjetra, për riprodhimin e mjedisit, jetës familjare, për individualizimin dhe karakterizimin e personazheve, për efekte lirike ose komike. Në përkthim ndeshim fjalë të çfarëdo treve të shqipes, kur ato shkojnë në përputhje me parimin e tij “të harmonisë së gjuhës shqipe”.⁶³

Dialektizmat në përkthim shfaqen si mjete të forta stilistike, duke formuar idenë e mendësisë së individualitetit të unit lirik, i cili shërben si urë kalimi drejt kolektivitetit të shoqërisë. Efekti i dialektizmave duhet kërkuar më ngulm në kontekstin poetik, pasi vetëm në kontekst shfaqet më së miri forca leksikore e tyre. Dialektizmat shfaqen si në trajtën leksikore dialektore ashtu edhe në atë formale sipas tipareve fonetiko-gramatikore të gjuhës.

Ato krijojnë efekte të forta stilistike, natyrisht, në raportet kontekstuale të përdorimit. Kjo shumësi dialektizmash i përket të gjitha kategorive leksiko-gramatikore, duke filluar nga emrat, mbiemrat, ndajfoljet, foljet, pjesëzat, pasthirrat, përemrat etj.

Ti, vjersh' e shentë përmi dhe (f. 137); *Fejuar vonë edhe me nge* (f. 116); *Vërtet, ndër cuca krahinore/Ju kini parë ndonj' album* (f. 86); *Kur Ollg' e tij i le kurajë,/Ç'ja çiki flokët me gishtrinj, //T'ia puthi roben në pëqinj*(f.85) etj.

Ndër organizimet sintaksore, është vënë re se ka një rimarrje tepër të dendur të fjalëve, togjeve, fjalive dhe vargjeve të tëra. Bie në sy se përdor shumë **viza bashkuese** ndërmjet fjalëve, ndryshe nga praktika e pikësimit të zakonshëm të shqipes. Këtu në mënyrë të vetëdijshme fut

⁶³ Gj. Shkurtaj, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 127.

një përftesë specifike: shkrirjen e gjymtyrëve në një vazhdimësi të pandërprerë me një lojë të lirë fonetike. Larmia e tyre e mbështet semantikën e përsëritjes së pandërprerë të lëvizjes valëzuese ose ciklike, e cila ka të bëjë me domethënien e motiveve, edhe me konceptimet filozofike të autorit. Përveç rasteve të njohura në gjuhë si **ca nga ca** ndeshim edhe raste të tjera. Po veçojmë ndajfoljen **dalëngadalë** shndërrohet në një fjalë lasgushiane për domethënien e përkthimeve. *Po ja se hënëza tashi/ Ze shuhet dal-nga-dal* (f. 69); *Kush hap-më –hap të ftoh-të e llohë* (f. 174); *Gjith' nër mendime, hap-më –hap;* (f. 140); *Burrat përdrejt; e ca-nga –ca* (f. 111); *E ç'sheh?...rreth masës plot-e plot* (f.105); *A si një flutur let-e –let* (f. 97); *Rrjedh elegjia zall-më- zall* (f. 87); *Të gjithë flisnin vetë – e –vetë* (f. 53) etj. Përsëritja vijëzore është veçori e ligjëritimit popullor që ndeshet dendur në gjuhën e Poradecit.

Kjo lloj përsëritje zakonisht shndërrohet në përftesë stilistike dhe ka funksion përforcimi. *Si desha –ashtu me ato tallaze/T'i –a puthnja këmbët naze-naze* (f.180); *Rreh bukur këmbkat shpejt –e- shpejt.* (f. 12) etj.

Në përkthimet e tij ndeshim fjalët e prejardhura, fjalët e përngjitura dhe kompozitat që janë produkt i një përftese sintaksore shkrimore. Përsa i përket leksikut, Lasgushi sjell një pasuri fjalësh shqipe, që u përgjigjet motiveve të shkrimit. Në mjaft raste kemi shmangje leksikore krijimin e neologjizmave dhe përftesat e posaçme shprehëse. Këtu është pasuria e tij e madhe me veçanti të theksuar individuale. Atë e kënaqim dy prapashtesat njëra pas tjetrës, por edhe veçmas: **-im** dhe **–tar/tor**. *N'atë magji shkatërimtare* (f. 142); *Më sjell mërzitje lëngimtare* (f. 144); *Vështron e pshton duk'e thërritur .../Kot këngëtorin djaloshar* (f. 134); *I rrithte plaga gjakatare/Plot avull nënë kraharor* (f. 135); *Mendime tjetëra, sy-vrarë,/ Në zhurmë e në pushim paqtor/Ma tundin shpirtin ëndëror.* (f. 140) etj.

Emrat me **–onjës** si: *Po sidoqoftë o ti lexonjës/ Ah dashuronjës in e ri,/Poetin djalin ëndërronjës,/E vrau me dorë shok'i ti!* (f. 139).

Si shfaqje e veçantë stilistikore në gjuhën e autorit janë një sërë mbie-mrash të krijuara përmes prapashtesimit, por edhe me ndonjë mënyrë tjetër. *Këto mendime –edh' ëndërimë-/Nga koh' e djepit foshnjarak/ J-a mbushnin jetën me dëfrime/ N'atë veçimin fshatarak.* (f. 43) etj.

Neologjizmat ndajfolje me **-isht/ishte**, zënë një vend të rëndësishëm në përkthimet e tij. *Kur nxinte fletët qetësisht/Të tjera ëndrra, frohtësisht* (f.140); *I bëjnë modërisht frizurë* (f. 165); *Përgjigje s't'ep fisnikërisht*"/Flitej kështu **përgjithërisht**. (f. 33); *T'i vij dhe fjalës kryp' e bisht/ Kur dhimte kryet tmerrësisht* (f. 20); *Lyp verbërisht një lumturi* (f.58); *Ai do shtij te ju magjinë/Duke përshkruar ëmbëlsisht/Ndaj ik koleshka tinëzisht* (f. 99); *Mbi supe boan butësisht,/T'i preki doçkëzën me gisht* (f. 184); **lirisht, çmëndurisht, vazhdimërisht, hollësisht, hundërisht, padrejtësisht** etj.

Lasgushi pëlqen edhe formimet zvogëluese. Shumica e rasteve lidhen me përshkrimin e vashave, me fjalën e tyre. Natyrisht një poeti aq të ndjerë e zemërbutë si Lasgushit nuk mund të mos i duheshin mjetet dhe procedurat e zbulimit a përkëdhelisë për të pasqyruar gjuhën shqipe në përkthim, të shprehura sidomos nëpërmjet zvogëlimit me anën e prapashtesës **-zë**, një formant shumë i spikatur edhe në krijimtarinë e tij.

Lulen e bukur në mëngjes/U shua flakëza që vdes (f. 34); *Pranë Tatjanëzës së re,/ Asaj ëndërimtares s'ime* (f.145); *Si gjithënjë këndon bariu/E thur këpucëzat i ziu* (f. 146); *E zu një zbetësir' e tretur/ Sakaq fytyrëzën e saj* (f. 149); *Ah! Pëllumbeshëza me fletë* (f. 149); *Ata-i përzunë n'atë ças,/E pritnë zonjëzën me gas* (f. 151); *Ajo sheh gjurmmëza me laps* (f. 154); *Mes rrugëzës në Hariton* (f. 162); *Ajo këtu nuk ndjehet mi-rë,/S'ka dhomkëzën si më shtëpi* (f. 163); *S'kupton asnjë seç dërdë-llet,/Edhe të fshehtëzën e vet* (f. 165); *Ze ndreq perukëzën dopak/E pyet për të një gjysmë-plak* (f. 166); *Do fshat e fshatarkësi/ Fush' e lëndinëza dhe pllaja* (f. 168); *Po dritë e hënëzës së zjarrtë/Prej yjeve s'arrihet dot* (f. 168); *Të gjesh në kokërzë të vet,/Pra lamtumirë, paç shëndet!* (f. 195); *Pra mbyll-u në shtëpizë i ngratë* (f. 93); *Pamje me kaq thjeshtësi: /Kjo është e thjeshtëza naturë* (f. 99); **vashëzat, shponjëzat, dhomëz, dritarëzë, doçkëzën** etj.

Nuk mungojnë edhe formimet me prapashtesat **-thi, -ush/e**: *Dhe shoh, duke kërkuar ndjesë,/ Se gjuha e stilit tim mjerush/ Më fort me një mënyrë u mbush* (f. 15); *Nxitimthi vjen u hap tashi,/ thinjur edhe gjyslykosur* (f. 162); *Lenksi mbyll libërthin e kotë,/Merr pendën: zu e vjershë-ron,/Plot mall e zjarr që fluturon* (f. 129); **Lumthi** që vij me murmurim (f. 27); *Një mal çdo erë duk' i pritur/ Qëndronte mbi një*

lumth (f. 31) etj.

Një ëndje të dukshme ndjen Lasgushi edhe për disa krijime prapashtesore, disi më të rralla, si p.sh. fjalët me prapashtesën **-arak**: *Do fshat e fshatarkësi/ Fush' e lëndinëza dhe pllaja* (f.168); etj. Ku autor zvogëlon emra, mbiemra, folje ndajfolje e deri për emra, p.sh.: *Ha shkurtër: këtë gjë zemrake* (f.92); *E hij' e pyllit vjeshtarak* (f.92); *Po vera jonë veriake* (f. 92); *Me belbëzimin foshnjarak* (f.101) etj.

Në përkthimet e Lasgushit vërehet aftësia për të organizuar elementët në një tërësi organike, ku ata përputhen njëri me tjetrin, edhe si zgjedhja e mjeteve për të tingëlluar të përshtatshme për veshin. Tipike është fjala **llaftar/llaftari** dhe fjalët formuara prej tyre si: *Me turfullim e llahtari/Dy kuaj duke hingëllirë /Lëshojnë afsh e shkrumbëzim/ E derdhen udhës fluturim.* (f. 136); *Dhe para valëve mizore/E llaftaruar ndaj kundron/ Ajo u ndal e po qëndron* (f.103); *E tund e shkund një xhelozit,/ Sikur nj' e ftohtë- llaftari* (f.121); *E predikimi...Po tashi/Për orën plot me llaftari* (f.192); *Për pas një trungut u tulit/Guillot-j i zi në llaftarosje.* (f.133); *Del Tania, qeshj' e llaftari/ Shpërthevi egër ferr' i zi.* (f.107) etj.

Magjia në shqipërimin e Lasgushit nuk kuptohet pa fjalët e prejardhura, të përbëra e të përngjitura. Aty Lasgushi shkon pas gjedheve popullore: *shilar, fjalë-ngrirë, bardhëlore, zë-kulluar, mëndje-fryri, jetë-ziu, bujarishte, zemër-ftohtin, shpirt-përvëluar, dorë-sbet, zemër-zjartët, mëndje-fryri, përkëdheloshe, zemërak, majë-mprehtë, brirë-madhështor, shponjësit, frut-shkret, ndjenjë-holla, parëveror, gjëmë-plot, mëndje-çeluri, shpir-murmë, mall-munduar, kokë-pykë, lesh-flori, shpirt-mitur, stekë-harruar* etj. herë mbështetur mbi këto bën shtesa e kalime me dy ose më shumë gjymtyrëshe, zakonisht me vizë që janë konceptuar si një fjalë e vetme: *S'u ndreq aspak ky mëndje -shkarë,/E vete në Tatjan'e ti.* (f.191); *Dhe flokë-zbardhur ish një plak/Që pleqërisht përgaste-ngiste,/Stërholl' e fell' e mendje-mpreht/Po sot për sot më s'ka lezet.* (f.181); *Shpërthen pas rostos plot shijim/Shampanjëzën me shkumbëzim/Nër gota bel- e-trup-hollake* (f.113) etj.

Fjalëformime të tilla tregojnë bindshëm se Lasgushi kërkon të ndikojë me fjalën e vargut të vet, prandaj përzgjedh e krijon ashtu si i pëlqen pa pyetur aspak nëse qëndrojnë fjalët e krijuara prej tij. Ai është kërkues i

së bukurës dhe sipas rastit, e merr dhe e krijon ashtu si i pëlqen më tepër se fjalë janë fjali ose togfjalësha të lidhur me vizë lidhëse e të konceptuar si një fjalë e vetme “*për arsye poetike e jo mirëfilli gjuhësore*”⁶⁴. Të tillë janë shembujt e mëposhtëm: *E shentë shokëri! Naturrë/Dhuratë-plote! Sy-nër-sy* (f. 210); *Në miqësi, në dashuri/Ish një shpirtmitur i paditur* (f. 34); *Çifuti bredhës, një korsar,/Dh'i fshehtë-sirëshmi Sbogar* (f. 56); *Lum kush ka besën foshnjërishte* (f. 97) etj.

Përfundime

Fjala shqipe në përkthimet e Poradecit tregoi peshën e saj të vërtetë, zbuloi gamën e gjerë emocionale, pasurinë e nuancave dhe të toneve të brendshme, forcën dhe bukurinë metaforike si gjuhë arti. Autori përdor me mjeshtëri figurat e shqiptimit, figurat e fjalëve dhe të shprehjeve, figurat e sintaksës poetike dhe figurat leksikore.

Shprehësi të veçantë në gjuhën e Poradecit sjell edhe fjalëformimi, ndajshitesat dhe gjedhet e tipit fjalëformues. Ajo që i bie në sy çdo lexuesi ka të bëjë me fjalët e reja të formuara përmes të gjitha rrugëve të fjalëformimit. Poradeci ka krijuar korpusin e neologjizmave të tyre në një përdorim thellësisht figurativ. Shkallë të theksuar shprehësie bartin ndajshitesat me vlerësim subjektiv. Përftesat stilistike përmes fjalëformimit janë të pranishme në përkthimet e Poradecit. Përftesat më të mëdha stilistike janë krijuar përmes ndajshitesimit sidomos në formimin emrave, mbiemrave prejfolorë e pjesëve të tjera të ligjëratës.

Pasthirrmat si fjalë të pandryshueshme, funksioni parësor i të cilëve lidhet me shprehjen emocionale kanë ngjyrim të fortë e denduri të lartë përdorimi në gjuhën e Poradecit. Ato si shenja ekspresive shprehin ndjenja të ndryshme duke përforcuar shprehësinë e ligjëritimit.

Në ndërtimin e shprehjes poetike për t'iu përshtatur origjinalit, por edhe për të qartësuar domethënien e autorit Poradeci ka shfrytëzuar gjerësisht figurat gjuhësore-stilistike. Dihet se në tekstin letrar njësitë gjuhësore asnjëanëse në kontekste të caktuara marrin kuptime shtesë, ngjyrim të veçanta ose aktualizohen formime të rastësishme, fjalë të reja kuptimi dhe forma nuk ndeshet jashtë tekstit konkret. Në këtë mënyrë Poradeci ka përpunuar lëndën gjuhësore e stilistike duke depërtuar

⁶⁴ Gj. Shkurtaj, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 131.

kështu në shtresat më të thella të fjalës dhe duke kërkuar me ndjeshmëri të rrallë paralelizma mes fjalës së autorit dhe fjalës shqipe me imazhet shoqëruese, me të cilat ka krijuar vlera të reja gjuhësore e stilistike. Në këtë rast vlen të përmendet përdorimi i dialektizmave, arkaizmave etj. Poradeci gjatë përkthimit arrin të rijapë kuptimin e tekstit, por dhe ndjenjën dhe tonin e gjuhës, që lidhet me ngarkesën emocionale dhe veçoritë stilistike të origjinalit. Duke iu përmbajtur kësaj metode tek ai gjejmë, krahas përkthimeve me një besnikëri të plotë, pjesë të përshtatura, parafrazime, pasazhe të thjeshtuara, trajta popullore etj. Gjatë përzgjedhjes dhe përkthimit ai kishte kujdes maksimal në përzgjedhjen e shprehjes të fjalës të përshtatshme në gjuhën shqipe, duke ruajtur kurdoherë natyrën dhe frymën e saj, e duke zbatuar dinamizmin dhe eufoninë përkatëse. Gjatë përkthimit Poradeci asnjëherë nuk ka zbehur apo zvetënuar forcën dhe as zvogëluar bukurinë estetike dhe kuptimore të tekstit origjinal. Përkundrazi, ai ia ka arritur, në mënyrë të pakrahasueshme që të ruajë harmoninë kuptimore dhe estetiko-artistike, dinamizmin dhe eufoninë e teksteve në të dy gjuhët, por në të njëjtën kohë edhe të krijojë apo rikrijojë ndoshta diçka edhe më specifike në gjuhën shqipe. Përkthimi i veprës së Pushkinit nga Poradeci do të duhej të cilësohej si shqipërim rikrijues artistik, i cili paraqet kontribut të jashtëzakonshëm dhe të çmuar të Poradecit në historinë e kulturës dhe të gjuhës sonë.

BIBLIOGRAFI⁶⁵

A.S. Pushkin, *Eugjen Onjegini*, (në vargje në shqip prej Lasgush Poradecit), Tiranë, 2001.

Emin Kabashi, *Lasgush Poradeci dhe kultura shqiptare*, SF, 1-2, 2000, f.5-14.

Gjovalin Shkurtaç, *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, Tiranë, 1988, f. 259.

Gjovalin Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 1999.

Hysen Matoshi, *Pasthirrmat - shprehësia poetike e Lasgushit*, botuar në: Gjurmime albanologjike: seria e shkencave filologjike. -Nr. 32-33,

⁶⁵ Këto janë disa nga literaturat kryesore të përdorura, të tjerat janë cituar gjatë punimit.

- Prishtinë, 02-03, 2005, f. 179-188.
- Jani Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.
- Jani Thomai, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989.
- Jani Thomai, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992.
- Shefkije Islamaj, *Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe*, SF4/1986, f.119-123.
- Stefan Prifti, *Elipsa në gjuhën shqipe*, SF, 3, 1963.
- Stefan Prifti, *Elipsa në sintaksën shqipe*, SF, 3, 1966.
- Xhevat Lloshi, *Lirizmi i lirikut Lasgush*, SF, 1-2, 2000, f.15-35.
- Xhevat Lloshi, *Shkrimtari dhe gjuha*, në: Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës, I, Tiranë, 1973, faqe 329-334.
- Xhevat Lloshi, *Shqipja – gjuhë e hapur dhe dinamike*, Tiranë, 2011.
- Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001.

ELONA BIBA (ÇEÇE)
Universiteti " Fan S. Noli " Korçë
Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë

POZICIONI I PJESËVE TË NËNRENDITURA PËRCAKTORE, KOHORE DHE SHKAKORE NË STRUKTURËN E VARGUT DHE POEZISË SI NJË VEÇORI E STILIT TË LASGUSH PORADECIT

Në tërësinë e mjeteve stilistikore, mendojmë se struktura sintaksore e poezisë, e parë sot, në kuadër të gjuhësisë të tekstit, luan një rol parësor. Edhe poezia e Lasgush Poradecit, poetit, krijimtaria e të cilit ende nuk është studiuar sa duhet, nga ky këndvështrim, mund të vlerësohet, se mbart një veçori thelbësore lidhur me pozicionin e pjesëve të nënrenditura përcaktore, shkakore, të cilat funksionojnë si gjetje stilistikore jo vetëm në kuadër të strukturës së vargut, por edhe të të gjithë poezisë, e cila në shumë raste funksionon si një periudhë.

Nga analiza, arritëm në përfundimin: fakti që pjesët përbërëse të poezisë, strofat a e gjithë poezia, formojnë periudha flet në mënyrë të padiskutueshme për konceptin e Lasgushit për poezinë, si një krijim lirik, por që karakterizohet nga kohezioni që në rastin tonë është bashkëlidhja e trajtave kohore e mënyrore të foljeve që përbëjnë bërthamat e pjesëve, qofshin këto kryesore apo të nënrenditura.

Gjithashtu, ndërtimi i këtyre stilemave me mjete sintaksore, konkretisht me *pozicionin e pjesëve të nënrenditura* i jep poezisë së Lasgushit një nga tiparet thelbësore të domosdoshme, koherencën tematike.

I. Hyrje

Çdo poet me stilin e tij është i papërsëritshëm, por Lasgush Poradeci me stilin e tij spikat si një poet mbresëlënës.

Natyrisht, në tërësinë e mjeteve stilistikore, mendojmë se struktura sintaksore e poezisë, e parë sot, në kuadër të gjuhësisë së tekstit, luan një rol parësor. Pikërisht, duke e parë çdo poezi nga ky këndvështrim, mund të themi, se një veçori thelbësore është *pozicioni i pjesëve të nënrenditura përcaktore, shkakore*. (Dhe kur flasim për pozicionin

kemi parasysh vendin e këtyre pjesëve në kuadër të të gjithë tekstit poetik (të cilin e konsiderojmë si periudhë), jo thjesht rendin e pjesëve). Më poshtë po renditim rastet e përdorimit të këtyre pjesëve që janë objekt i analizës sonë.

II. Pjesa e nënrenditur përcaktore

Në poezinë “*Je ulur fort*”:

1-Pjesa e nënrenditur përcaktore është vendosur, në trup të pjesës kryesore, lidhore, mjeti lidhës është përemëri lidhor. Kjo ndodh brenda një strofe katërvargëshe.

Kujtimi im

(Paraprijësi) 1. Në qetësi **esht'** ishtë prej rrufeje,
2. Në ças llaftare zjarr e flakë **vete**.

a. që më s'ëe jep të qetë,

b. q' u llaftaris pas teje,

2-Në poezinë “Kur në flakë” konstatojmë se paraprijësi për çdo pjesë është i ndryshëm, (veprojnë dy paraprijësa) dhe se bëhet fjalë për një paralelizëm sintaksor në ndërtimin e dy strofave.

Po çdo ëndërr

(Paraprijësi)

Duke rënë prej së lartash posi pikë zemërate

T'i përshkohet për së thelli bukuris' së qenies sate.

a. që më shfaqet prej skëterrës së pafund

çdo mendim i llaftaruar

(Paraprijësi)

Duke rënë prej së lartash posi pikë zemërate

T'i përshkohet për së thelli bukuris' së qenies sate.

b. që më dhemb e më përtund,

Në poezinë “*Kamadeva*”:

3. Pjesa e nënrenditur përcaktore është vendosur pas pjesës kryesore. Pra rendi është i drejtë. Veçoria e ndërtimit është se e gjithë strofa funksionon si pjesë e nënrenditur, (ka vetëm një folje).

të mjerën jetë

(Paraprijësi) a. *Ku silleshin të dy,*

*me të baritur,
me dëshirim në sy
me shpirt të ndritur*

b. *Ku regetin dhe sot*

*me ato kujtime,
buçimi gjemëplot
i zemrës sime.*

4. Në poezinë “Kur në flakë”: E veçanta në përdorimin e pjesës së nënrenditur përcaktore qëndron që ato janë tri pjesë të nënrenditura dhe midis tyre kanë vendosur raporte barazie, pra lidhje bashkërenditëse.

O! fytyr’ e vjershëruar (Paraprijësi) Të të ndjej aq fare pranë,- të më jesh aq shumë larg...

a. që më mbush me dëshërim!

b. Q’i fal gaz përjetësie dashuris’ së zemrës sime!

c. Që më bën kur ment’ e mia regëtijnë varg e varg

5. Në poezinë “Malli”:

Syri i bukur (Paraprijësi) Do me lerë a von a shpejt, a,që t’u mvrenjt
(Rendi i anasjelltë)

Syri yt (Paraprijësi) Do me lerë a von a shpejt b.që më lëndon

Do me lerë a von a shpejt, Strofa pasuese (Rendi i drejtë)

Do me lerë a shpejt a von,

Syri i bukur që t’u mvrenjt

Syri yt që më lëndon.

Në këtë rast, do të veçonim, përveç faktit që dy vargje janë pjesë të nënrenditura (brenda dy strofave), paraprijësi përsëritet duke krijuar një “kornizë”, konkretisht në strofën e parë ai ndodhet në vargun një, dy, kurse në strofën pasuese në vargun tre, katër.

III. Pjesa e nënrenditur kohore

Në poezinë “Në flakë”:

1. Duke u nisur nga fakti se këtu mjetet lidhëse janë vetëm lidhëzat, natyrisht që do të përqëndrohemi vetëm në rendin e pjesës kohore në lidhje me pjesën kryesore apo kombinimin me një pjesë tjetër të nënrenditur. Konkretisht kemi dy pjesë të nënrenditura kohore me raporte bashkërenditje midis tyre, të cilat i paraprijnë pjesës kryesore.

Prej skëterrës se pa matë më del bot’ e ëndërruar

a. Kur në flakë të qiririt zë mendonem net-për-net

b. Dh’e ndjej shpirtin e kulluar nëpër dritën që më tret

2. Tek “Të ritë e viteve të mi”: pjesa e nënrenditur kohore vendoset në pozicionin e drejtë, pas pjesës kryesore.

Të ritë e viteve të mi,

M’a fryri fati zall më zall:

Sesi çkelqenjë në stoli

Kur më pat zën’ i pari mall!

3. Po ashtu edhe në poezinë “Maja e Çelur”

Pjesët janë të bashkërenditura, por të lidhura në mënyrë asindetike. Gjithashtu, vlen të përmendet që mjeti lidhës shoqërohet edhe me pjesë-zën që, e cila i jep vlerën e njëkohësisë së veprimit të këtyre pjesëve me veprimin e pjesës kryesore:

Lulet lulëzuan

me të parë djellë që kur janë mbjellë: që kur u përzyen

me rër’ e me ujë,

4. Gjithashtu, kemi rastin kur pjesa e nënrenditur kohore pasohet nga pjesa e nënrenditur kushtore, duke vendosur marrëdhënie nënrenditëse me pjesën kryesore, e cila vjen pas 4 njësisish (fjalish) që funksionojnë në dy vargje. Konkretisht:

Në poezinë: “**Kur të më jesh e zemëruar**”

Kur të më jesh e zemëruar, më shpirt të vrarë-e varfnyjak,

N’e mbajç në zemër zembëratën, prej helmit t’ënd s`do heq aspak;

*S`do psherëti n`e lënç të vdesë,a në `m`a thënç,në mos m`a thënç
Mjafton një mvrejtje-e buzës s`ate, që të më bësh të prishem mënj.*

5. Te “Lodra e dashurisë”: realizohet kombinimi i pjesës së nënrenditur përcaktore me atë kohore.

Me lot, Paraprijësi) Kuptova dashurinë Paraprijësi)

Që s`thahen dot. Që lot – Kur shemb:

Por këtë strukturë e vërejmë edhe në poezinë: “**Kush ta fali bukuri-në**”:

Pëllumbeshë pendëshkruar,

Bubu! plumb në kraharuar

Kur të pashë për të vluar, Plumb që vret dyke gjëmuar!

6. Edhe llojet e tjera të pjesëve të nënrenditura i nënshtrohen të njëjtit synim të mjeshtrit: të marrin vlerë stilistike në struktura, p.sh.: te “Maja e çelur” kemi përdorimin e pjesës së nënrenditur rrjedhimore, po në kuadër të të gjithë periudhës, ashtu si edhe në rastet që sapo analizuam.

*Sa më rënd' i mbante
rrënj' e balt' e nxirë
dh' i tërhiqte e s'i ndante
për në fundësirë*

*dhe sa m'i padukur
edhe sa m'i zjarrtë
ishte sulm' i bukur
për në qiejt' e lartë,*

*aq me lirë e fshehur,
dh' aq më me ngadale
rritnin pa pandehur
sulmin e pandalë:*

III. Pjesa e nënrenditur shkakore

1. Në poezinë “Prandaj” pjesa e nënrenditur shkakore paraprin vargjet. Në këtë rast kemi ndërtim sintaksore paralele.

O, prandaj të dua,

Se të desha vetë,

Se të desha prapë,

Dhe t’u nqasa prapë,

Dhe të putha prapë-

Dhe t'u nqasa vetë,

Dhe të putha vetë-

Dhe të humba largë,

Dhe të ndoqa largë,

Dhe të gjeta largë-

për të ruajtur nënrenditjen autori përsërit lidhëzën *prandaj* (lidhëz bashkërenditëse), që natyrisht i shkon për shtat numërimit të fakteve.

Se të gjeta grua,

Dhe të desha grua,

Dhe të putha grua-

Prandaj.

2. Në poezinë, “Zemra e shokut” si një stilemë funksionon ky ndërtim. Një strofë katërvargëshe shërben si pjesë kryesore e dy pjesëve të nënrenditura shkakore, të cilat midis tyre kanë marrëdhënie bashkërenditëse. Por edhe këto pjesë funksionojnë si strofa. Pra këtu marrëdhënien nërenditëse e shohim në kuadër të të gjithë poezisë.

Të kam shok nga koh' e vjetër

shok prej zemre edhe prej gjaku Se çdo gas e mall të shkretë Se ti mban në kraharuar

shok të ri e me besë plaku m'i ke thënë emër më emër shenterinë e një dhurate nuku kam, nuku ke tjetër

unë i mbylla mu në zemër

V. Në përfundim të kësaj analize do të theksonim:

1. Nuk është rastësi që në kuadër të periudhave mbizotëron pjesa e nënrenditur përcaktore. Ajo ka vlerën e një cilësuesi që mbart veprim dhe si e tillë ka një denduri më të madhe përdorimi.

2. Më pas vjen shprehja e raporteve kohore në lidhje me veprimet.

3. Një denduri me të ulët ka përdorimi i pjesës shkakore me vlerë konstatuese të faktit që, gjithashtu, lidhet me një veprim a gjendje konkrete.
4. Fakti që e pjesët përbërëse të poezisë strofat a e gjithë poezia, formojnë periudha flet në mënyrë të padiskutueshme për konceptin e Lasgushit për poezinë, si një krijim lirik, por që karakterizohet nga kohezioni që në rastin tonë është bashkëlidhja e trajtave kohore e mënyrore të foljeve që përbëjnë bërthamat e pjesëve, qofshin këto kryesore apo të nënrenditura.
5. Ndërtimi i këtyre stilemave me mjeteve sintaksore, konkretisht me pozicionin e pjesëve të nënrenditura i jep poezisë së Lasgushit një nga tiparet në thelbësore, koherencën tematike.
6. Mpleksja e këtyre veçorive krijon një tipar të stilit lasgushian për sa i përket aspektit sintaksor. Kjo është një nga meritat e këtij poeti, gjë që ka përcaktuar edhe jetëgjatësinë e veprës së tij.

BIBLIOGRAFI

- Adam, Jean-Michel, *Element de linguistique textuelle, Theorie et pratique de l'analyse textuelle*, Mardaga, 1990
- Charolles, Michel et al. (1986). *Research in Text Connexity and Text Coherence: A Survey*. Hamburg: Buske.
- Graffi, Giorgio, Scalise Sergio, *Le lingue e il linguaggio*, Bologna 2003.
- Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988.
- Nobili, Claudia Sebastiana, *Il lavoro della scrittura*, Milano, 1999.
- Pozzato, Maria Pia, *Semiotika e tekstit, shblu*, Tiranë, 2005.
- Shkurtaj Gjovalin, *Kultura e gjuhës*, Tiranë, 2006.
- Shkurtaj Gjovalin, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004.
- www.teksteshqip.com

LUAN TOPÇIU
Asociația Liga Albanezilor din România, ALAR
Shoqata Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë, ALAR
București, ROMÂNIA
ltopciu2002@yahoo.com

LASGUSH PORADECI DHE LIGJËRIMI MODERN I POEZISË SHQIPE

Me ardhjen e Lasgush Poradecit në letërsinë shqipe, ajo pati mundësinë të hyjë në qarqet e gjera të letërsisë universale. Është e vërtetë se kur shfaqet ky lloj ligjërimi në letrat shqipe, letërsia romantike paraqitet si një dukuri e konsoliduar, ligjërimi romantik ishte i konkurruar nga tipe të fuqishme çliruesish lirikë. Ligjërimi romantik duke filluar nga Byron-i, Shelley apo Novalis dhe deri tek Hugo-i, Heine, Lenau, Charl Cros, Eminescu apo Naim Frashëri nuk ka pasur kurrë një karakter të njëtrajtshëm. Kur shfaqet Lasgush Poradeci si poet në Europë, ishin botuar poetë si Baudelaire, Verlaine, Rimbaud, Mallarmé dhe Leconte de Lisle, Rilke, Stefan George që fiksojnë tiparet aq të ndryshme të ligjëritimit poetik modern. Të gjithë këta poetë dhe shumë të tjerë të papërmendur, që hodhën idenë e modernitetit në poezi mund të shkruhen në të njëjtën “matkë stilistike” me poetin shqiptar Lasgush Poradeci.

Me Poradecin, lirika shqiptare mund të konsiderohet si një dukuri evropiane. Shpirtin modern dhe evropian të këtij poeti do ta ndjenin intelektualët shqiptarë që në vitet ‘30. Eqrem Çabej do të shprehej kështu: *“Poezia moderne në Europë: Në Gjermani është çudi se ka qenë një shkrimtar i lindur që më 1770, Hoelderlin, i cili në jetën e tij letrare fort të shkurtër ka nxjerrë harmoni që u afrohen këtyre të sotmeve. Në kohët e fundit, Rilke, Stefan George e disa të tjerë përfaqësuesit e vjershës moderne gjermane. Në Francë filloi fryma e re me disa vjersha të V. Hugoit, e lulëzoi me Baudelaire (Fleurs du mal), Verlaine, Mallarmé, Rimbaud, Valéry etj. Në Itali, DaAnnunzio e Pascoli e rritën pemën e re të vjershës moderne të mbjellë prej Carduccit. Në Rusi, prozatorët e të cilës kanë influencuar të gjithë Europën, nga vjershëtorët, ai që mori më famë në kohët e fundit, është*

djaloshi i vdekur Sergei Jessenin. Ja pra, poetët që janë produkt i kohës moderne, bir i së cilës është dhe Lasgush Poradeci.”

Lasgush Poradeci në realizimin e veprës poetike si trajtë bazale të tij pati disiplinën shpirtërore dhe qartësinë e vetëdijes artistike. Tek ai bashkohen gjenialiteti poetik me inteligjencën kritike (shih: *Lasgushi më ka thënë...* mendime kritike të shkruara nga Petraq Kolevica, letërkëmbime, shkrime kritike mbi letërsinë, pikturën, muzikën).

Lasgush Poradeci dëshmoi se mbetet një nga majat e lartë e poezisë shqipe, kurse vetë shekulli në të cilin jetoi do të mbetet i markuar prej hijes së tij. Jeta dhe vepra e tij përbëjnë një short për poezinë shqipe dhe për gjithë kulturën shqiptare në përgjithësi. Me emrin e tij, tashmë të shndërruar në simbol, çdo shqipfolës, në mënyrë gati të pavetëdijshme, ka parasysh emancipuesin më të madh të lirikës sonë kombëtare, reformatorin që e ngriti poezinë shqipe në kuota evropiane. Prania e një poeti me të tilla përmasa në një letërsi kombëtare jep mundësinë për të dalë me dinjitet në hapësira kontinentale dhe botërore. Lasgush Poradeci është një poet dhe një dukuri letrare, një mit dhe një short. Lindi vetëm një vit para vdekjes së Naim Frashërit, një shekull më parë, dhe do të jetonte deri më 1987, duke dominuar me artin e tij gjithë këtë shekull, duke ndarë shekullin XIX, të markuar nga letërsia romantike naimiane, nga shekulli XX, shekulli i letërsisë postromantike e moderne që mund ta quajmë lasgushiane. Poeti nuk shkroi shumë - është autor i dy përmbledhjeve të jashtëzakonshme me poezi, që botohen në Rumani, gjegjësisht “*Vallja e yjeve*”(1933) dhe “*Ylli i zemrës*”(1937). Vepra e tij është e pakët për nga sasia, por e pamasë për nga cilësia, përqendrimi, përmbajtja filozofike, thellësia e mesazhit lirik, rezonanca e brendshme muzikore, puriteti i vargjeve, thellësia e mesazhit lirik, rezonanca e brendshme muzikore, aftësia për të plasticizuar vizione koherente të botës - elementë që i hasim në disa nga bashkëkohësit e tij evropianë që konsiderohen si forca novatore të dorës së parë. Vepra poetike e Lasgush Poradecit është e paluajtshme dhe e paprekshme, sepse ajo është e ndërtuar mbi një sistem solid ideor, formal, stilistik - cilësi që krijojnë autonomi dhe mëvetësi. Poeti parapëlqeu të përpunojë dhe përsosë temat që ai propozoi sesa të shkruante poema të reja. Është folur gjatë kohës nga kritika letrare, madje vepra

është akuzuar për shterpësi. Por në realitet është fjala për një pjellshmëri të intensitetit, që zgjerohet dhe konsolidohet në thellësi, bash në pikën ku ndodhi dikur evadimi. Ai aktivizon vullnetin për përsosmëri artistike, sepse vetëm pjekuria e formës siguron karakterin mbivetjak të shprehjes. “*Ylli i zemrës*” nuk do të jetë një album i thjeshtë, por një tërësi organike, me fillimin e saj, zhvillimin e artikuluar dhe fundin. Ky vëllim poetik përbën librin me arkitekturën më të rreptë në letërsinë shqipe, i krahasueshëm në letërsinë botërore me *Les Fleurs du Mal* të Baudelaire-it. Gjithçka që shkroi poeti më pas i ka konceptuar që të përshtaten dhe zhvillohen me kuadrin që ai skicoi në vitet ‘30. Fakti që Lasgush Poradeci e renditi në mënyrë arkitektonike vëllimin “*Ylli i zemrës*” dëshmon nga njëra anë distancimin e tij nga romantizmi, nga ana tjetër demonstroi rolin që luajnë forcat formale. Ato ishin më tepër sesa një ornament i thjeshtë, më shumë se sa një elegancë e jashtme.

Në këto poezi hierarkizohen tema, ide, fjalë, simbole që lidhen dhe harmonizohen në një ansambël. Tërësia e veprës është një strukturë artistike që ka synuar ndërtimin e një universi që ngërthen në vetvete të gjitha zonat shpirtërore të poetit, por dhe të njeriut në përgjithësi. Ky univers poetik, kjo masë tërësore, siç është vepra poetike, karakteri strukturor i saj, lejon të qarkullojnë shenjat poetike nga një nivel në tjetrin, nga një rrafsh kuptimor në një tjetër, nga një zonë shpirtërore në një tjetër.

Për të depërtuar në shpirtin e një poeti duhet të kërkohet në veprën e tij fjalët që shfaqen më dendur. “*Fjala do të përkthejë obsesionin*” do të shkruajë Baudelaire. Në këtë fjali të poetit francez gjejmë një parim të shkëlqyer për të interpretim. Mëshimi e temave në poezinë e Lasgush Poradecit, të pakta në numër, por intensive, na lejon të gjejmë qendrat e zjarrit në fjalët me denduri maksimale. Janë fjalë-çelëse që mund të ndahen lehtësisht në dy grupe të mëdha. Por poeti ynë dallohet për disonancat leksikore, për oksimoronin, për bashkimin dhe konfrontimin e këtyre grupeve të mëdha (*ëmbëlsi-vrerore, liri-robëri, dhimbje-gas, helm-gas, lumturi-mjerim*) për atë gërshetim të sendeve apo tipareve që nuk përputhen me njëra tjetrën në mënyrë normale. Mbetet i rëndësishëm fakti se poezia, megjithë tejkalimet e saj, është që nga fillimi deri në fund lasgushiane. (Në një sistem të mbyllur brenda gjuhës shqi-

pe). Lasgushi bën pjesë në autorët që njihet e dallohet lehtësisht. Shumë poezi në fillim të lënë përshtypjen e pasteleve të thjeshta, ku peizazhi nuk është tjetër gjë veçse zhvillimi i një krahasimi me bazë morale.

Poeti së pari “përshkruan”, pastaj “interpretion”. “Filozofia” të lë përshtypjen se njëherë për njëherë është e ndarë nga “poezia”, një shkrimje e tyre e plotë ndodh vetëm më pas. Në fakt, spekulimi zhvillohet në një kuadër të caktuar i skicuar paraprakisht: peizazhi pothuaj parandien “fshetësirën” që mbart.

Tek “*Ylli i zemrës*” hasim një magji të pastër të gjuhës shqipe, të forcave magjike të tingujve, në radhitjen e objektivë, në radhitjen logjike, afektive dhe madje gramatikore. Që nga Novalis deri tek Poe dhe Baudelaire, reflektimi u përqendrua mbi prosedenë përmes së cilës gjeneza e tekstit lirik të tejkalojë sferën e temave dhe motiveve, duke rezultuar përtej tyre, madje në mënyrë ekskluzive, nga mundësitë kombinuëse të tingujve të gjuhës dhe nga vibracionet asociative të domethënive leksikore. Poeti mbështetet në mënyrë konsekuente në magjinë e gjuhës, një tipar konstant i lirikës moderne, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë tingëllore dhe asociative të fjalës duke çlidhur përmbajtje të errëta pa kuptim, por dhe fuqi misterioze, magjike, të tingëllueshmërisë së pastër. Rrjeti i tensionit të poemave lasgushiane përbëhet nga energji analoge që njeh vetëm muzika. Kjo poezi do të dallohet për figurat tingëllore, për vijimin e gradëve të intensitetit, për lëvizjet absolute, ngjitëse dhe zbritëse, në alternancë midis akumulimit dhe shkarkimit.

Çdo trajtim i veprës lasgushiane, pavarësisht nga metoda e zgjedhur, duhet të marrë parasysh faktin se vetë poeti në gjithë krijimtarinë e tij ka qenë i prirur nga *ideali i unitetit*, koherencës së universit artistik. Megjithë tendencat për etapizime nga historianët e letërsisë, klasifikime sipas kriteresh të ndryshme, poeti mundi të rezistojë si *autor i sintezave të mëdha lirike*. Në këtë univers nënshtresohen dhe panteizmi dhe tokësorja, kozmogonikja dhe hedonistikja, parnasiana dhe folklorikja, romantikja dhe hermetikja, efemerja dhe e përjetshmjatë - të infiltuara në këtë botë me përkatësi autentike. Paradoksit, midis asaj që poeti ka shkruar pak nga njëra anë dhe ka jetuar aq gjatë nga ana tjetër, mund t’i jepet përgjigje se poeti arriti të shprehë poetikisht një sistem të tërë poetik, korrelativ dhe koherent në të gjitha hallkat përbërëse të tij.

Racional dhe ndjesor, piktoral dhe muzikor, onirik dhe real, mjeshtër fin i fjalës shqipe, filozof dhe folklorik, peizazhist dhe dramatik. Poradeci krijon kështu një nga veprat më komplete dhe më komplekse në letërsinë shqipe.

Me Lasgush Poradecin ndodh në fakt një modifikim struktural në retorikën e poezisë shqipe. Nëse deri tek Poradeci ligjërimi kishte një patos të jashtëm, nëse mesazhi poetik konfigurohej në një sasi të madhe informacioni të transmetuar lexuesit, përmes autorit të vëllimit “*Vallja e yjeve*”, lirika interiorizohet duke u bërë, në radhë të parë, shprehja e një gjendjeje vetëdijeje që bëhet konkrete përmes një gjuhe me ngjyrim afektiv.

Vendi i poetit Lasgush Poradeci në letrat shqipe gjithmonë ka qenë i pakënaqshëm, sepse vepra e tij, që në momentin e shfaqjes së saj, ka qenë një provokim për letrat shqipe, duke zgjuar reagime të skajshme, por veçanërisht më i fyer dhe më i pavlerësuar do të mbetet në regjimin totalitarist e stalinist të Enver Hoxhës. Në historinë e letërsisë, hartuar nga Akademia e Shkencave, poeti studiohej në grup, në autorët e viteve ‘30, gjë që bëhej më shumë për të krijuar ndjesinë e vdekjes, përmes një harrimi të dhunshëm. Vetë personaliteti i Lasgush Poradecit ishte kontradiktor, në rini shkroi për vdekjen (kritikët, duke e konsideruar tejet të sëmurë, nxituan të jepnin definicione për të), në pleqëri, kur regjimi përpiqej ta harronte me çdo kusht-ai shkruante brilantet më të vyera për dashurinë, si për të nënvizuar më fort dhe një herë ekzistencën dhe vitalitetin e tij. Prania e magjisë, erotikës, universalizmit, modernitetit dhe njëherazi e frymës autoktone, do të bëjnë që poezia e Lasgush Poradecit të kaplojë gjithë shekullin e XX dhe të bëhet tejet i vështirë për t’u klasifikuar dhe etiketuar.

Në letrat shqipe deri tek Poradeci nuk ekzistojnë projekte kaq të stërholla, që krijojnë një pasqyrim aq të thellë të erosit njerëzor. Erosi është i projektuar më së tepërmi në ujërat e ëndrrës. Onirikja tek Lasgush Poradeci nuk është vetëm një prosede letrare, por dhe një model pjellor i njohjes, i kuptimit të ekzistencës, një pikënisje për përfitimim e raporteve të çuditshme midis reales dhe ideale, individuale dhe kozmike, vdekjes e jetës dhe, mbi të gjitha, midis erosit dhe qenies njerëzore. Gjuha metaforike e ëndrrës është më sintetike, më e përqendruar, ajo

nuk ka asgjë të përbashkët me konceptet racionale. Ëndërritja i fal dashurisë së projektuar në fëmijëri një androgjenitet të pastër, përsosuri, pafajësi të gjesteve, mekanikën e lëvizjeve. Poeti në ëndërr barazon me një sondim vendimtar në thellësinë e qenies së tij, duke angazhuar vetë themelet e qenies, pikërisht atje ku ka humbje tërësore të ndërjegjes individuale, duke kaluar në rrafshet më të thella të unit dhe bash atje ku uni nuk ekziston më, aty ku është shkrirë me madhësinë e kozmosit.

Poezia e Lasgush Poradecit është krijuesja e një hapësire kombëtare. Idilet e përmallshme të një jete të pastër, mendimet filozofike, kënga për vendlindjen dhe posaçërisht për liqenin marrin jetë në një mjedis morfologjikisht të pastër shqiptar. Gjuha shqipe është vetëdija e ndër-dija e tij dhe e gjithë kombit shqiptar. Mbi të gjitha Poradeci ka bindjen se gjuha shqipe mund të shprehë në mënyrë të plotë gjithë spektrin emocional poetik. Ai e quan *Ligjëratë pleqërishte*, *Frymë e gojës shqiptare*, *Këngë e orës shqiptare*, *Fjala jonë pleqërishte*, *Kuvendi i zogut* etj. Nga këto sintagma e formula poetike poeti njeh lashtësinë e gjuhës shqipe (*Ligjëratë pleqërishte*), identitetin etnik (*Frymë e gojës shqiptare*), aftësinë muzikore të shqipes (*Kuvendi i zogut*). Në gjithë krijimtarinë e tij poeti bën përpjekje të vazhdueshme për reformimin e gjuhës së pastër shqipe, ai lektiset pas frymës, dëlirësisë dhe bukurisë së shprehjes së kulluar të popullit, krijon e modelon sipas gjedhesh popullore, ndaj poezia e tij është objekt arti dhe një vlerë e çmueshme, bukurtingëllimi harmonik i së cilës është i një rafinamenti të jashtëzakonshëm. Përjetimi intensiv intelektual, shpirti evropian, reflekse të kulturës së poetit, të bashkuar me elementë të poezisë orale, mitike e kombëtare, krijojnë një aliazh të veçantë, një armaturë nga ngrihet një vepër solide me trajta origjinale. Nëse në rastin e shumë shkrimeve nozioni “*univers poetik*” shpesh është i pavend e i parakohshëm, sepse nozioni si i tillë është shumë i gjerë, kur vjen fjala për një poet si Lasgush Poradeci, ai duket tepër i ngushtë. Ideja profetike e prof. Çabejt “... të këtij djaloshi, të cilin një fat i mirë duket sikur ia ka falur Shqipërisë, që të bëhet ai shkrimtar, të cilin Shqipëria do t’ia falë njëherë botës.” ende nuk është realizuar, sigurisht jo për ndonjë dyshim në vlerat e poetit. Shkaku i parë është i disa përkthimeve josinkronike dhe të dobëta, dhe shkaku i dytë, sipas mendimit tonë, nuk është përkthyer në

një gjuhë të qarkullimit ndërkombëtar, në një datë të afërme me botimin e poezive në shqip, për të konkurruar me poezinë europiane të momentit, me Ungaretti-n, Claudel-in, Rafael Alberti-n, Georg Träkl, Seferis etj. Mungesa e shpërndarjes sinkronike e ka penguar poezinë shqipe në dialogun pjellor me Europën.

Lasgush Poradeci duke bërë pjesë në peizazhin modern evropian, mbart dhe tipare moderne që do të dallohen në jetën kulturore të kontinentit. Ligji që përcakton stilin e konceptuar si “vizion” nuk gjenerohet nga subjekti apo tema e veprës, dhe as nga gjuha artistike tradicionale. Ai shpreh konceptet e vetë autorit. Këtu e ka origjinën një dukuri që u bë më e njohur në pikturë. Duke filluar me Cézanne-in u mësua me atë që piktori të rimarrë të njëjtin motiv, të varfër nga domethënia, sepse nuk është kjo gjëja që i interesonte, por eksperimentimi i mundësive të veta stilistike. Picasso e kopjoi shumë herë “*Dreka në bar*” të Manet-së duke e transformuar gjithherë. Shpikja e motiveve zhduket, interes paraqesin kërkimet formale. Këto synojnë të krijojnë një organizëm autonom, të krijuar tërësisht nga përbërësit e tablosë, pa elementë nga realiteti i jashtëm. Në këtë mënyrë jo vetëm që ngushtohet numri i motiveve, por motivi vetë shfaqet si pjesë e një ushtrimi për variacione. Përftesa mund të ndeshet dhe në poezi. Valéry ka shkruar, se për atë poezia është gjithmonë “ *të prodhuarit variacione mbi të njëjtin subjekt*”.

Në mjaft poetë evropianë hasim variacione të një poezie. P.-J. Jouve ka botuar poezitë e tij në dy variante, Guiellén, R. Queneau, etj. Lasgush Poradeci shkroi e botoi për poezinë “*Lamtumirë*” pesë variante, për poezinë “*Më zu një mall dhe sot*” dy variante dhe dhjetëra variante poezish të pabotuara. Ky fenomen eminent modern ka mbetur i pakuptuar nga disa studiues shqiptarë. Prof. Qosja do të shkruante: “*Tue pritë frymëzimin, poeti Lasgush Poradeci mbetet pa shkruar më tepër, mbetet pranë variantave të të njëjtit motiv.*”

Me veprën e Lasgush Poradecit, poezia shqipe njohu praninë e pikturës dhe muzikës në ndërtimin e lirizmit poetik më shumë se çdoherë më parë. Në horizontin e kulturës kombëtare, vepra poetike e Lasgush Poradecit ngrihet më lart se kurrë dhe pa asnjë ekuivok, më e vlerësuar

dhe më e dashur se kurrë më parë, ndihet më pranë dhe më e nevojshëm se asnjëherë tjetër.

LASGUSH PORADECI SI PËRKTHYES

Në këtë kumtesë do të trajtojmë Lasgush Poradecin si shkrimtar i përkthyer në gjuhët e huaja dhe si përkthyes i shkrimtarëve e shkrimeve të kalibrit të lartë evropian.

Për fjalorin e Lasgushit, Kuteli vë në dukje se, zgjedhja e fjalëve, kalitja dhe radhitja e tyre pasqyrojnë shkallën e ndjesisë artistike të një shkrimtari. Elementët kryesorë, tipikë, të fjalorit janë fjalët e lashta e të rralla të papërdorura para tij në literaturën e kultivuar, fjalët e thurura nga dy e tri bashkë sipas shpirtit të gjuhës shqipe dhe fjalët e reja të nxjerra nga fjalët e vjetra sipas harmonisë së shqipes, të cilat e kanë burimin, përveç tjerash, edhe nga letërsia popullore apo shkrimet e vjetra të shqipes (Kupitori, Kristoforidhi...). Lasgushi jo vetëm ka ripërtërirë gjuhën shqipe, por edhe i ka dhënë ngjyra të reja, ndriçim të ri e gjallëri të re. Asnjë nga këto fjalë të thurura në mënyrë analitiko-sintetike nuk mund të përkthehet në një gjuhë të huaj. Ato pasqyrojnë ndjenja e konceptione krejt shqiptare, të cilat Lasgushi na i shqipëron me një mjeshtëri të pakapërcyeshme.

Lasgushi që mendonte se poeti lindet kurse gjeniun e krijon puna, gjatë gjithë shekullit të tij mori dhe dha kulturë. Poeti, i cili misionin poetik e ngrit në kulmin e aftësive krijuese të njeriut.

Poradeci është poeti që njohu dhe mori prej poetëve të mëdhenj evropianë elementë të poetikave të tyre duke i ndërthurur me një frymë origjinale.

Lasgush Poradeci si përkthyes dhe si i përkthyer

“Ta bësh librin e përkthyer një instrument humanizmi, paqeje dhe përparimi - kjo është punë fisnike”, Pierre-François Caillé (1907-1979), Themelues dhe kryetar i parë i Federatës Ndërkombëtare të Përkthyesve. *“Gjuha e evropianëve është përkthimi”*, pëlqen të thotë Umberto Eco. *“Përkthimi bashkon dy lloje gjuhësh, që njerëzimi mban brenda vetes: Natyrën dhe Kulturën”*. Jean-Claude Gémard. *“Shkruaj, sepse më*

pëlqen të më lexojnë. Shkruaj, sepse besoj si një fëmijë në pavdekësinë e bibliotekave dhe në vendin që do zenë aty librat e mi” -Orhan Pamuk
“Të gjithë marrin jetë prej FLAKËS që ndrin, asnjë s’kujton ZJARRIN që patë djegur. Sepse POETI nuk rron jetën e vdekur të vet, po jetën e pavde-kur të Kombit të vet. Përpara së gjithash është POEZIJA. Ajo formon shpirtin e kombit. Një libër me një roman është një libër bashkëbisedimi, ndërsa një libër me poezi është një libër formimi... Prandaj duhet të shkruajmë poezi jo të mirë, po shumë të mirë, jo të lartë po shumë të lartë, shumë të thellë, shumë të gjerë, që t’i vemë shpirtit të kombit themele... të shëndosha”- *Lasgush Poradeci*
“*Gegërishtja ka energji fizike, toskërishtja ëmbëlsi shpirtërore*”

Lasgush Poradeci

Për fjalorin e Lasgushit, Kuteli vë në dukje se, zgjedhja e fjalëve, kalitja dhe radhitja e tyre pasqyrojnë shkallën e ndjesisë artistike të një shkrimtari. Elementët kryesorë, tipikë, të këtij fjalori janë fjalët e lashta e të rralla të përdorura para tij në literaturën e kultivuar, fjalët e thurura nga dy e tri bashkë sipas shpirtit të gjuhës shqipe dhe fjalët e reja të nxjerra nga fjalët e vjetra sipas harmonisë së shqipes, të cilat e kanë burimin, përveç tjerash, edhe nga letërsia popullore apo shkrimet e vjetra të shqipes (Kupitori, Kristoforidhi, etj.). Kuteli cilëson se Lasgushi jo vetëm ka ripërtërirë gjuhën shqipe, por edhe i ka dhënë ngjyra të reja, ndriçim të ri e gjallëri të re. Asnjë nga këto fjalë të thurura në mënyrë analitiko-sintetike nuk mund të përkthehet në një gjuhë të huaj. Ato pasqyrojnë ndjenja e konceptione krejt shqiptare, të cilat Lasgushi na i shqipëron me një mjeshtëri të pakapërcyeshme.

Lasgushi e kultivon formën poetike si askush para tij, por edhe pas tij: ai jo vetëm që i arrin majat e vjershërimit në letërsinë shqipe, por edhe qëndron në to edhe sot e kësaj dite. Shumëkujt, duke shikuar vetëm këtë anë të ndritshme të poezisë së tij, iu kanë lëbyrur sytë dhe nuk kanë arritur të shohin se çfarë fshihet pas këtij shkëlqimi, pas kësaj përso-smërie të formës dhe pa të drejtë e ka marrë Lasgushin vetëm vargëzues të pashoq, duke ia mohuar pjesërisht apo edhe plotësisht cilësitë e një poeti të mirëfilltë.

Lasgushi që mendonte se poeti lindet, kurse gjeniu e krijon puna, gjatë gjithë shekullit të tij mori dhe dha kulturë. Poeti, i cili misionin poetik e ngriti në kulmin e aftësive krijuese të njeriut, duke e barazuar Krijuesin me Zotin, pati mosmarrëveshje me qarkun kulturor dhe letrar shqiptar, që e kërkonte letërsinë ose me mision njohës ose me shërbim në ideologjinë shoqërore. Poradeci është poeti që njohu dhe mori prej poetëve të mëdhenj evropianë elementë të poetikave të tyre duke i ndërthurur me një frymë origjinale.

“Lasgush Poradeci është njëkohësisht edhe një artist i vërtetë i kalibrit evropian. Ai ndërthurte forcën ndjellëse të fjalës së Charl Bodlerit (Charles Baudelaire), filozofinë estetike të formës dhe elegancën e hollë të Stefan Georges (Stefan George), humanizmin dhe filozofinë e Naim Frashërit dhe pavdekshmërinë kozmike të mjeshtrit të tij, Mihai Emineskut”.

Pas Çabej dhe studiues të tjerë kanë parë në poetikën e Poradecit elementë të poetikave të disa poetëve evropianë. Çabej e rendit Lasgush Poradecin përkrah poetëve që përfaqësonin poezinë moderne evropiane, si Hoelderin, Rilke, Stefan George (Gjermani), V. Hugo, Baudelaire, Verlaine, Mallarmé, Rimbaud, Valéry (Francë), S. Esenin (Rusi), duke e përfshirë poetikën e shëh si produkt të kësaj letërsie.

Në gazetën “Drita” Ismail Kadare boton një shkrim për Lasgushin. Ndër të tjera aty thuhet se: “Në njëqindvjetën e tij, ai i është i nevojshëm si rrallëherë Shqipërisë së sotme. Sepse, sot, kjo Shqipëri e përbaltur, e zhytur në mllef dhe grykësi vulgare, më shumë se kurrë ka nevojë për lartësim shpirtëror, për pastërti dhe qiellësi sublime. U mbushëm njëqind vjet që Shqipërisë i lindi poeti idealist që do ta quante veten ‘zog i qiejve’”.

Lasgushi fillësen e krijimit poetik e ka lajmëruar më herët. Eqrem Çabej i tregon P. Kolevicës se kur ishin në Grac, Lasgushi i recitoi rrobaqepësit të tyre, tetë vargje në frëngjisht dhe i kërkoi të gjente autorin. “Më në fund rrobaqepësi i dëshpëruar u dorëzua. S’e gjej dote, tha. S’ke si ta gjesh,-i tha Lasgushi, se këtë e kam bërë unë”. (Kolevica, 1992: 41) Poezitë e Lasgushit nuk janë njohur dhe lexuar vetëm nga lexuesit shqiptarë të atdheut, por edhe nga lexues shqiptarë të Greqisë, Rumanisë apo Austrisë, posaçërisht në Bukuresht, ku edhe janë botuar

një syresh i mirë i tyre, si dhe dy veprat poetike të Lasgushit “Vallja e yjeve” dhe “Ylli i zemrës”. (Poradeci, 1933: 119)

Lasgush Poradeci “Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullor-atdhetare”. (Studim gjenetik duke pasur parasysh lidhjet me kulturën gjermane). (Poradeci, 2009: 216) Doktoratura e punuar dhe mbrojtur nga L. Poradeci në Grac të Austrisë. Me këtë punim Lasgush Poradeci mori në Universitetin e Graz, Austri, titullin “Profesor Doktor i Shkencave Filologjike”. Lasgushi aty bën një studim të letërsisë së krahasuar, për poetin më të madh rumun të të gjitha kohërave, por edhe një ndër më të mëdhenjtë e kulturës universale, Miahai Emineskun. Këtu, Lasgushi trajton motivin e një ylli të humbur në gjithësi (Emineskut), drita e të cilit, për sa kohë në qiell ishte e padukshme për shkak të largësisë së madhe, na mbrin, vetëm pas mijëra shekujsh, atëherë kur ajo ishte shuar prej kohësh. Me ideologjinë e tij, përfshin gjithësinë e shpirtit rumun në zgjim e sipër, e megjithatë ideali i tij kulturor nuk arriti të kuptohej tërësisht. Përmbajtja artistike e krijimeve ngrihet mbi nivelin e rëndomtë kulturor të bashkëkohësve, thuhet ndër të tjera në përmbledhjen e punimit të doktoraturës së Lasgushit. *Amaneti i Çabejit: Lasgushi i përkthyer* (Shyta, 2015: 94)

Është fakt që shumë nga poetët tanë më të mirë janë të vështirë për t’u përkthyer në gjuhë të huaja, madje disa janë klasifikuar dhe si të papërkthyeshëm për shkak se struktura e shkrimit është përputhur me strukturën e dialektit, sikundër ka të tjerë poetë që përkthehen shumë lehtësisht. Analizat rreth veprës letrare të Lasgush Poradecit na japin mundësinë t’u hedhim një vështrim të shkurtër edhe shkrimeve që janë dhënë për këtë problem nga studiues të brendshëm dhe të jashtëm. Rreth përkthimeve dhe mënyrës sesi u prit Lasgush Poradeci në disa prej gjuhëve të huaja të botës na informojnë të dhënat e mëposhtme. Llazar Gusho alias Lasgush Poradeci, pa fillimisht dritën e leximit përmes një dorëshkrimi në gjuhë të huaj, në Rumani më 1921. Lexuesit e saj mund të kenë qenë shumë pak në numër. Mbase kanë qenë të shumtë. Nuk dihet. Teksti në gjuhën rumune është shijuar nga lexues sporadikë. Poema në dorëshkrimin e poetit Poradeci, i dhurohet arkivit të Muzeut Historik Kombëtar nga familjarët e tij. Emocion dhe lirizëm atdhetar mbetet boshti i poemës në dorëshkrim. Poema ende ekziston e

papërkthyer nga origjinali. “Gjetja e saj, përbën burimin kryesor të vazhdimësisë letrare të shkruar nga Lasgushi, kur ai jetonte dhe studionte në tokën rumune”.⁶⁶ Poema pasuron së tepërmi arkivin personal të poetit. Karakteri atdhetar spikat në vargjet e saj përgjatë strofave që është shkruar. “Poema ka prezantuar autorin në një konkurs jashtë vendit, ndërsa tani ajo përbën një vlerë të madhe letrare”.⁶⁷ Teksti origjinal në rumanisht iu dhurua nga e bija, Muzeut Historik Kombëtar si dhe faksimilja e origjinalit të poemës. “Prej të dhënave kohore ky krijim artistik është poema e parë e shkruar nga Lasgush Poradeci, përkrah vjershërimeve të tij. Kjo gjetje mbetet një zbulim i rrallë artistik për të përmbyshur veprën e një liriku si Poradeci”.⁶⁸ Poezitë e mjeshtërit të vargut shqip shijoheshin edhe në gjuhë të huaj. Ekzaktësisht në vitet 1948-1955 kemi dy botime antologjike të cilët përfshinë brenda tyre poezinë lasgushiane të përkthyer më 1948-ën dhe 55-ën. Gjithçka në plotë gjashtë vjet diferencë. Pas tre vjetësh, më 1959-të, kemi një tjetër botim antologjik të poezisë së L. Poradecit. Më pas në vitin 1967-të, sërisht kemi një tjetër botim antologjik të poetit, që vjen pas shtatë vjetësh mospublikimi në gjuhë të huaj. Përsëri dy vjet pushim dhe në vitin 1970 vjen një tjetër botim antologjik ku përfshihet poezia e Lasgushit. Pas plot pesë vjetësh heshtjeje në letrat ndërkombëtare, Lasgush Poradeci botohet në antologjinë e vitit 1976. Më 1979-të, pas dy vjetësh botohet një tjetër antologji poetike në të cilën përzgjidhen poezitë e tij, antologji poetike që pasohet me atë të vitit 1988, e cila vjen pas tetë vjetësh heshtimi për poezinë e Poradecit. Këto të dhëna dëshmojnë se Lasgush Poradeci ka qenë i botuar në botë, në periudhën komuniste. Përkthyesit janë të ndryshëm në të gjitha herët, kjo në varësi të gjuhës dhe vendit me të cilët shteti monist lindor kishte marrëdhënie diplomatike.

Vitet bosh të mosbotimit në gjuhë të huaj, të Poradecit poet, janë të vogla në krahasim me 50-vjetët e diktaturës, vite të cilat kanë luhaturë të mëdha në varësi të egërsisë së bishës totalitare. Kështu më 1948-tën,

⁶⁶ Anonim, Gazeta “55”, -Nr. 136, 24 maj, 2003, f. 21.

⁶⁷ K. Harka, Lasgush Poradeci: Një poemë e fituar nga një konkurs i humbur, në: “Albania”, -Nr. 120, 24 maj, 2003, f. 20.

⁶⁸ I. Shabani, Zbulohet poema e parë e poetit lirik Lasgush Poradeci, në: “Panorama”, -Nr. 301, 28 maj, 2003, f. 12-13.

kemi antologjinë poetike që përfshin Lasgushin, të botuar në Leipzig të Gjermanisë nga Maximilain Lambertz. Përkthimi është vetëm në gjuhën gjermane dhe përmban poezi, prozë dhe drama.⁶⁹ Më 1955 përsëri Maximilian Lambertz sjell një antologji poetike në gjuhën gjermane. Teksti i përzgjedhur është në shqip dhe gjermanisht. Përmban poezi dhe prozë.⁷⁰ Rumania, saktësisht kryeqyteti, Bukureshti, në vitin 1959 është ndalesa e radhës në përkthimin e poezisë së Lasgushit. Një grup përkthyesish do të sjellin për rumunët poezinë shqipe në një antologji. Në përbërje të saj është edhe L.Poradeci, njeriu që Rumania i mundësoi dy botime letrare.⁷¹ Antologjia e vitit 1963 mban firmën e Ernest Koliqit. Përmban poezi dhe është botuar në Milano të Italisë. Përfshin një poezi të Lasgush Poradecit.⁷² Botimi antologjik i vitit 1970 vjen sërish si botim në italisht nga qyteti i Milanos. Vëllimi përmban poezi dhe prozë të përkthyer në italisht, mes tyre edhe poezi të Lasgushit.⁷³ Më 1976 lexuesve italianë, dhe jo vetëm atyre që jetojnë në Itali, u jepet një tjetër antologji poetike, këtë herë me poetë bashkëkohorë. Poezitë janë në shqip dhe në anglisht. Në botim ka poezi të Lasgushit.⁷⁴ Në Boteborg të Gjermanisë më 1979, botohen poezi autorësh shqiptarë, mes tyre edhe Lasgush Poradeci dhe poezia e tij.⁷⁵ Më 1979 Lasgush Poradeci vjen në gjuhët shqip dhe frëngjisht, në një cikël poetik. Lexuesi francez ka patur rastin ta shijojë poetin kombëtar shqiptar në gjuhën frënge. Lasgush Poradeci vjen në këtë përkthim interesant sa edhe në gjuhën e vendit të tij. Poezitë e përkthyer janë: “Matin”; “Pogradec”; “Fin d’automne”; “Hiver”; “Balladë”; “Le bateau

⁶⁹ M. Lambertz, Albanisches lesebuch: miteinführung in die albanische Sprache: II. Teil. Texte in Deutschen übersetzung. -Leipzig: Otto Harrassowitz/ 1948. -302 f.

⁷⁰ M. Lambertz, Lehrgang des Albanischen: Teil II. Albanische Chrestomathie. Berlin: Veb Deutscher Verlag der Wisschaften/ 1955. -251f.

⁷¹ M. Sirbulescu, R. Polizu-Micsunesti, I. Marinescu, T. Gheorghiu, G. Dumitrescu, I. Olteanu, H. Gramescu, G. Naum, I. Acsan, D. Botez, G. Demetru Pan, G. Dan, T. George Maioreescu, -Bucuresti: Ed. De Stat Pentru Literatura si Arta/ 1959. -202f.

⁷² E. Koliqi, Antologia della lirica albanese: versioni e note a cura di E. K-Milano: Vanni Svheiwiller, 1963. -318f.

⁷³ E. Rossi, E. Koliqi, N. Ressuli, G. La. Valle, G. Schiro, J. Kodra, I. Parrino, E. Capuano, A. Guzzetta, Antologia delle letterature del Sud-Est Europeo. -Milano: Fratelli Fabbri Editori, 1970. - 399f.

⁷⁴ B. Pogoni, Contemporary Albanian Poems. -Napoli: s.n., 1976. -117f.

⁷⁵ U. Qvick, O. Och, Albansk poesi. -Goteborg: Forlaget Rallardos, 1979. -221f

et son drapeau”; “Le genie du bateau”. “Mëngjes”; “Pogradec”, “Fund vjeshte”; “Dimër”; “Zemra e liqenit”; “Balladë”; “Anija dhe flamuri i saj”; “Fati i anijes”.⁷⁶

Një tjetër antologji poetike që përfshin Lasgushin, është ajo e përgatitur nga Robert Elsie në Hildesheim-Zurich-New York, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.⁷⁷ Viti 1993 shton numrin e lexuesve në gjuhë të huaj, përmes një botimi tjetër antologjik. Janë këto vite që enden mes fundit diktatorial dhe fillimit të erës së lirisë, e cila mungoi në Shqipëri për pesëdhjetë vjet. Ndërkaq, duhet theksuar se Poradeci tani përkthehet dhe botohet lirshëm jashtë ish-kufirit territorial të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Këto janë vite të cilët do përkojnë me vendosjen e sistemit pluralist në vend. Kemi tre botime antologjike të tjera më pas: një në vitin 1996, një në vitin 1998 dhe një tjetër në vitin 2002. Vitet e demokracisë sjellin tjetërsim të politikës botuese antologjike. Ajo është në favor të famës dhe vlerës që përcjell në botë emri i madh i një poeti të harruar a vdekur qyshkur në diktaturë. Heshtja për pak vjet e përkthimit lasgushian nëpër botë vjen si rezultat i enteve të ndryshme botuese dhe politikave të tyre për të fituar materialisht nga përkthimi i poetit në botë. Poezitë e përkthyer këso vitesh nuk janë të angazhuara dhe caktuara në mënyrë redaksionale plot censurë, por të përzgjedhura nga një vullnet i lirë redaktorësh a entesh botuese. Më 1993, kohë kur Realizmi Socialist pushoi së ekzistuari, vjen botimi i një antologjie të lirë poetike, përsëri nën kujdesin e Robert Elsie, mikut të shqiptarëve dhe Shqipërisë. Aty përfshihet poezia e Lasgush Poradecit, ndërsa vërehet përzgjedhja e lirë poetike nga hartuesi i antologjisë.⁷⁸ Gane Todosovski e sjell poetin e Pogradecit në gjuhën maqedonase. “Le të lindë njeriu”. 10 poetët shqiptarë (Poradeci; Noli; Migjeni; De Rada; Serebbe; N. Frashëri; N. Mjeda; Çajupi; Asdreni...). Nga L. Poradeci janë përzgjedhur poezitë: “Dimri”; “Dremit liqeri”; “Mëngjes”; “Zemra e liqerit”; “Korrik”; “Gjuha e zjarrtë”; “Kroji i fshatit tonë”; “Vate prilli”;

⁷⁶ L. Poradeci, Les lettres albanaises. Nr. 2, 1979, f. 207-215.

⁷⁷ R. Elsie, E. A. Gleich, Anthologie albnischer Lyrik vom 16. Jahrhundert bis zur Gegenwart/. Hildesheim-Zurich-New York: Olms Presse, 1988. -303f.

⁷⁸ R. Elsie, Anthology of modern albanian poetry: An elusive eagle soars. London&boston: Forest Books, 1993. -XX, 213f.

“Vallja e luleve”; “Vdekja e Nositit”;⁷⁹ Botimet në Maqedoni e risjellin poetin e liqerit, Lasgushin shqiptar, në një botim dygjuhësh maqedonisht-shqip, përgatitur nga një grup përkthyesish jashtë kufirit shtetëror. Botimi është i vitit 1996 dhe është ralizuar në Strugë, nën kujdesin e bibliotekës Merijani. Botimi nderon figurën e Lasgushit dhe prezantohet si një urë bashkëjetese mes shqiptarëve dhe maqedonasve, në kuadër të festivalit ndërkombëtar “Netët strugane të poezisë, 1996”. Ali Aliu, Lasgush Poradeci, Gane Todorovski, Mateja Matevski, Resul Shabani, Paskal Gilevski, Svetllana Hristova-Jociq, Fatbardha Kabashi-Shehu, Xhevat Limani, Grigor Cullufe, Jordan Danillovski, Afërdita Cajani, Tashko Sirillov.⁸⁰ Antologjitë poetike vijnë të botohen jashtë atdheut, duke i ngritur një aureolë ndërkombëtare edhe poetëve shqiptarë veçmas, viganit Lasgush Poradeci. Aleksandër Zoto ndërton një të tillë fillimisht në poezi dhe një botim tjetër në prozë më pas. Lasgush Poradeci do jetë pjesë e radhës, që lexuesit të huaj i serviret për lexim.⁸¹ Po ky vit, 1988, sjell edhe katër poezi të përkthyer në gjuhën frënge të Lasgush Poradecit. Ato janë të botuara vetëm në frëngjisht: konkretisht: “Pogradeci”; “Fin d’automne”; “Hiver”; “Le coeur du lac”.⁸² Lasgush Poradeci përkthehet, botohet shqip për lexuesit shqiptarë në Maqedoni e më gjerë në këtë rajonin shqipfolës të ballkanit. Libri titullohet “Vesë Dashurie”. Poezi të zgjedhura nga Gane Todorovski e Nikola Koço Fidanoski. Biblioteka Valët. 1999, Shkup, Maqedoni.⁸³ Në vitin 2002 në Bolonja të Italisë botohet antologjia poetike e radhës, ku mes autorëve shqiptarë përfshihet edhe Lasgush Poradeci. Antologjia hapet me poezi nga liriku i madh i shqipes.⁸⁴ Poema në dorëshkrimin e poetit Poradeci titullohet “Poemë”, i dhurohet arkivit të Mu-

⁷⁹ G. Todorovski, *Le të lindë njeriu. 10 poetët shqiptarë, Shtëpia botuese e librit MM, Skopje 1992*, fq. 105-119.

⁸⁰ *Sovremena poezija na Albanija-Poezia Bashkëkohore e Shqipërisë*, Struga: SVP, 1996. -182f.

⁸¹ A. Zotos, *Anthologie de la poesie albanaise*, -Chambery: Edit. Comp “Act” 1998. -388 f.

⁸² L. Poradeci, *Les lettres albanaises*, 1988, f. 172-174

⁸³ L. Poradeci, *Vesë Dashurie*. Biblioteka Valët, 1999, Shkup, Maqedoni

⁸⁴ E. Grassi,-R. Sportelli, *In forma di palore: Poeti della terra d’Albania: (Poetare e pensare),/. – Bologna, -Nr. Secondo e terzo, aprile-settembre 2002. -446 f.*

zeut Historik Kombëtar.⁸⁵ Zbulimi përmbush veprën e lirikut Lasgush Poradeci.⁸⁶ Ardian Christian Kyçyku, prezanton “Antologji poetike shqiptare. Një alfabet i poezisë shqipe”. Poezitë e përzgjedhura vijnë dygjuhëshe rumanisht-shqip. “Poradeci”; “Vdekja e Nositit”; “Ylli”; “Dremit Liqeri”; “Fund vjeshte”; Antologjia jep informacion për jetën dhe veprën e poetit, fq. 174⁸⁷ Botimi studimor “Miti i Lasgushit”, me titull në origjinal “The Myth of Lasgush” publikon poezi të përkthyer të poetit. Në fund të tij janë dhënë disa shënime për përkthyesin Kapurani dhe janë bërë disa referenca. Kryehallkë e këtij zinxhiri është ylli në këtë botim.⁸⁸ “Lasgushi ynë është ndër poetët më të mëdhenj të kontinentit tonë”-thuhet në përkthim.⁸⁹ Kapurani në këtë monografi prezanton një studim serioz. “Kam shpënë në vend një amanet të Çabejt, për t’ia falur botës Lasgushin e madh”⁹⁰ Përmes mikrokozmosit poetik, më tej krijohet kozmosi letrar i vjershëtorit, për t’u përjetësuar përgjithmonë brenda mitit madhështor allalaspashjan. Kapurani, sqaron se do ta vijojë punën e tij me studime të tjera. Vendin kryesor do ta zërë treshja N. Frashëri, L. Poradeci dhe I. Kadareja. Për studimin e tij shtysë kryesore ka qenë vetë poezia e Lasgushit. Falë njohurive tona për poetikën moderne, u mora edhe me Lasgushin,-nënvizon ai. Në fillim përkthen poezinë “Ylli”. Aty kishte rima akustike, rrëfen Kapurani. Pastaj përkthen për një muaj gjithë poezitë përfaqësuese të Lasgushit. Kështu hyra në shtëpinë poetike të tij dhe preka me dorë poezinë, -vijon ai. “Lasgushi nisej nga përmasa madhore, kozmogonike... Pra nga qielli, kalon te ylli dhe kështu me radhë...”⁹¹ Kapurani

⁸⁵ L. Poradeci, Poemë. Përkth. Dionis Bubani, Gazeta “Panorama”, -Nr. 301, 28 maj, 2003, f.13.

⁸⁶ M. Zeqo, Një poemë e panjohur e Lasgush Poradecit, Gazeta “Koha Jonë”, -Nr. 149, 2 qershor 2003, f. 10.

⁸⁷ A. Ch., Kyçyku, Antologji poetike shqiptare. Një alfabet i poezisë shqipe. Editura Priviera, Bucuresti 2003, ph. 118-121.

⁸⁸ A. Kapurani, The Myth of Lasgush, Leicestershire: Upfront, 2004. -306f. Bibliogr. f.305-306.

⁸⁹ A. Kapurani, Lasgushi ynë ndër poetët më të mëdhenj të kontinentit, në: “Ballkan”, -Nr. 1345, 20 korrik, 2005, f. 19.

⁹⁰ A. Kapurani, Si e bëra anglez... Lasgushin e madh. Intervistë me autorin e librit në anglisht The Myth of Lasgush (Miti i Lasgushit). Interv. Ben Andoni, në: “Korrieri”, -Nr. 206, 28 gusht, 2005, f. 11.

⁹¹ Po aty, -Nr. 207, 29 gusht, 2005, f. 13.

ndërkaq, deklaroi se do të realizojë të tjera përkthime të veprës poetike të Lasgushit. Kjo vepër mbetet një nga studimet më të rëndësishme për krijimtarinë poetike të Poradecit. “Ai krijoi me veprën e tij një kozmografi pa kufi, sirrallëkush. Lasgushi ka aftësinë t’i përthithë elementet në unitete më të vogla. Për shembull: tek ylli, tek kroi i fshatit, tek e dashura. Tek këto unitete është një mikrokozmos i tërë. Ky është boshti i parë, i organizuar estetik...”⁹² Lasgush Poradeci në vitin 2005 përkthehet në italisht me dy poezi të vetme. “Pelicano”; “Pogradeci”. Poezitë janë përkthyer në Italisht nga Shpëtim Doda.⁹³ I njëjti përkthyes, Shpëtim Doda sjell Lasgush Poradecin edhe në gjuhën spanjolle me poezinë “Pelicano”⁹⁴ Në vitin 2009-të publikohet doktoretura e shumëpërfolur në rrethet e ndryshme intelektualësh, e Lasgush Poradecit. Copëza të saj të përkthyer ishin botuar kohë më parë në shtypin shqiptar të pas viteve 2000. “Der Verkante Eminescu und seine Volkstumlich – Heimat-Liche Ideologie”. (Eminesku i ignoruar dhe ideologjia e tij populllore-vendase) In Universitate Litterarum Graecensi. Në Universitetin e Letrave të Grazit. Graz, Austri, 24 maj, 1933; MAI MCM XXXIII; Me këtë punim Lasgush Poradeci mori në Universitetin e Grazit, Austri, titullin: “Profesor Doktor i Shkencave Filologjike”. Lasgushi sjell një studim të letërsisë së krahasuar, për poetin më të madh rumun të të gjitha kohërave, por edhe një ndër më të mëdhenjtë e kulturës universale, Mihai Emineskun. “Këtu Lasgushi trajton motivin e një ylli të humbur në gjithësi (Emineskut), drita e së cilit, për sa kohë në qiell ish e padukshme për shkak të largësisë së madhe, na mbrin ne vetëm pas mijëra shekujsh, atëherë kur ajo ish shuar prej kohësh. Me ideologjinë e tij përfshin tërësinë e shpirtit rumun në zgjim e sipër, e megjithatë ideli i tij kulturor nuk arriti të kuptohej tërësisht dhe aty për aty. Përmbajtja artistike e krijimeve ngrihet mbi nivelin e rëndomtë kulturor të bashkëkohësve”, thuhet ndër të tjera në përmbledhjen e punimit të doktoraturës së Lasgushit. Megjithëse më sipër u ndalëm realisht në përkthimet e disa poezive të

⁹² E. Gjika, Anastas Kapurani, The myth of Lasgush (Miti i Lasgushit), London 2004, në: “Studime filologjike”, -Nr. 3-4, 2005, f. 189 – 191.

⁹³ L. Poradeci, Poeteka, (Revistë), -Nr. 1, prill, 2005, f. 68.

⁹⁴ L. Poradeci, “Albania”, -Nr. 100, 1 maj, 2005, f. 16.

Lasgush Poradecit, duket se nuk ndjanë të njëjtin mendim për to albanologët, gjermani Hans Joachim Lanksch dhe suedezi Ullmar Qvick. “Simbas meje, ligjërimi poetik i Lasgushit asht aq specifik saqë përkthimet e teksteve të tij i ngjajnë ritregimit të përmbajtjes së tyre dhe jo poezisë së tij, gja që do me thanë që rezultati asht tejet i vorfun. Nji Zot e din ndoshta ka me lindë dikur-diku edhe përkthyesi i Lasgushit”⁹⁵, - thotë albanologu gjerman, Hans-Joachim Lanksch. Për albanologun suedez Ullmar Qvick, “Problemi kryesor me poezinë e Lasgush Poradecit është gjetja e një forme të përsosur, sepse Lasgushi ishte mjeshtër i formës dhe do të ishte gabim të bëhej një interpretim formalisht i dobët, një mohim i talentit të këtij poeti të madh!”⁹⁶

Përsa i përket botimeve të plota të veprës letrare të L. Poradecit në vite, mund të themi se botimi nën kujdesin e Frida Idrizit është i tillë për Shqipërinë, pasi përmban poezi, fotografi, publicistikë dhe letërkëmbim të autorit. Ndërkaq në Kosovë më i plotë, është botimi që realizohet nën kujdesin e Sabri Hamitit. Mund të themi se botimi i vitit 2009, është një libër i plotësuar me poezi të papërfshira në botimet e mëparshme. Përmendim tituj si: “Hapja e shkollës”; “Redaktorëve të mij”; “Era e Perëndisë”; “Dr. Bashos” etj. Por, konstatojmë se botimi mbetet i cunguar pasi në të nuk janë futur dy baladat e poetit për Muharrem dhe Reshit Çollakun, shkruar më 1974. Saktësisht “Muharrem Çollaku” (Baladë e Kalasë së Poradecit) dhe “Reshit Çollaku” (Baladë poradecare). Këto balada gjenden të botuara në librin e përgatitur nga F. Idrizi.

Horizonti pritës në Kosovë, dikur Federatë e ish-Jugosllavisë, sot shteti më i ri ballkanik, gjithmonë ka dëshmuar simpati e dashuri për veprën e Lasgush Poradecit. Katër botime në harqe kohore të ndryshme janë dëshmia më e plotë e përthithjes së librit nga lexuesi në tregun kosovar. Ndërkohë nuk përjashtohet përsëri mundësia e ribotimit të poezisë së L. Poradecit në shtetin e Kosovës. Pritshmëritë mbeten të mëdha. (L. Poradeci “Vepra letrare”, Tiranë, 1990; L. Poradeci “Vdekja e Nositit”, Prishtinë, 1986; L. Poradeci “Poezia”, Vepra 1, Tiranë, 2009)

Përkthimet e poezisë së L. Poradecit, si edhe e vërejmë, kanë plotësuar

⁹⁵ Gazeta “Mapo”, e hënë 27 shkurt 2012, f. 14-15.

⁹⁶ Po aty, f. 14-15.

deri diku amanetin e Çabejt, që poetin t'ia falim botës. Vepra e Lasgush Poradecit, pjesërisht, është përkthyer në disa gjuhë të huaja, si në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, spanjisht, rumanisht, maqedonisht, sigurisht që do të vijojë edhe në të ardhmen të përkthehet në të tjera gjuhë të botës. Këto përkthime kanë zgjuar interes të veçantë, madje për disa prej tyre janë shkruar shënime, është bërë recension, vështrim kritik, madje edhe ndonjë studim i mirëfilltë si ai i Anastas Kapuranit.

L Poradeci ka lexues të përbotshëm falë përkthimit në gjuhë të huaj, të poezisë së tij.

BIBLIOGRAFI

Ilir Shyta: Receptimi i poezisë së Lasgush Poradecit , Tiranë,2015
Botohet në: “Drita”, 26 dhjetor, 2000, f. 10-11.

P. Kolevica, Lasgushi më ka thënë..., Shtëpia botuese “8 nëntori”, Tiranë, 1992, f. 41.

L. Poradeci, Vallja e yjve. Shtypur në “Albania”, Kostancë, 1933, -119f.

L.Poradeci: Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullor-atdhetare. Tiranë, Argeta LMG, 2009, -216f.

Anonim, Gazeta “55”, -Nr. 136, 24 maj, 2003, f. 21

K. Harka, Lasgush Poradeci: Një poemë e fituar nga një konkurs i humbur, në: “Albania”, -Nr. 120, 24 maj, 2003, f. 20.

I. Shabani, Zbulohet poema e parë e poetit lirik Lasgush Poradeci, në: “Panorama”, -Nr. 301, 28 maj, 2003, f. 12-13.

M. Lambertz, Albanisches lesebuch: miteinführung in die albanische Sprache: II. Teil. Texte in Deutschen ubersetzung. -Leipzig: Otto Harrassowitz/ 1948. -302 f.

M. Lambertz, Lehrgang des Albanischen: Teil II. Albanische Chrestomathie. Berlin: Veb Deutscher Verlag der Wissechaften/ 1955. -251f

M. Sirbulescu, R. Polizu-Micsunesti, I. Marinescu, T. Gheorghiu, G. Dumitrescu, I. Olteanu, H. Gramescu, G. Naum, I. Acsan, D. Botez, G. Demetru Pan, G. Dan, T. George Maiorescu, -Bucuresti: Ed. De Stat Pentru Literatura si Arta/ 1959. -202 f.

E. Koliqi, Antologia della lirica albanese: versioni e note a cura di E. K-Milano: Vanni Svheiwiller, 1963. -318f.

- E. Rossi, E. Koliqi, N. Ressuli, G. La. Valle, G. Schiro, J. Kodra, I. Parrino, E. Capuano, A. Guzzetta, *Antologia delle letterature del Sud-Est Europeo*. -Milano: Fratelli Fabbri Editori, 1970. - 399f.
- B. Pogoni, *Contemporary Albanian Poems*. -Napoli: s.n., 1976. -117f
- U. Qvick, O. Och, *Albansk poesi*. -Goteborg: Forlaget Rallardos, 1979. -221f.
- L. Poradeci, *Les lettres albanaises*. -Nr. 2, 1979, f. 207-215.
- R. Elsie, E. A. Gleich, *Anthologie albnischer Lyrik vom 16. Jahrhundert bis zur Gegenwart/*. Hildesheim-Zurich-New York: Olms Presse, 1988. -303f.
- R. Elsie, *Anthology of modern albanian poetry: An elusive eagle soars*. London&Boston: Forest Books, 1993. -XX, 213f.
- G. Todorovski, *Le të lindë njeriu*. 10 poetët shqiptarë, Shtëpia botuese e librit MM, Skopje 1992, f. 105-119.
- Sovremena poezija na Albanija-Poezia Bashkëkohore e Shqipërisë*, Struga: SVP, 1996. -182 f.
- A. Zotos, *Anthologie de la poesie albanaise*, -Chambery: Edit. Comp "Act" 1998. -388f.
- L. Poradeci, *Vesë Dashurie*. Biblioteka Valët, 1999, Shkup, Maqedoni.
- E. Grassi,-R. Sportelli, *In forma di palore: Poeti della terra d'Albania: (Poetare e pensare)/*. - Bologna, -Nr. Secondo e terzo, aprile-settembre 2002. -446f.
- L. Poradeci, *Poemë. Përktth. Dionis Bubani*, Gazeta "Panorama", -Nr. 301, 28 maj, 2003, f.13.
- M. Zeqo, *Një poemë e panjohur e Lasgush Poradecit*, Gazeta "Koha Jonë", -Nr. 149, 2 qershor 2003, f. 10.
- A. Ch., *Kyçyku*, *Antologji poetike shqiptare*. Një alfabet i poezisë shqipe. Editura Priviera, Bucuresti 2003, ph. 118-121.
- A. Kapurani, *The Myth of Lasgush*, Leicestershire: Upfront, 2004. - 306f. Bibliogr. f. 305-306.
- A. Kapurani, *Lasgushi ynë ndër poetët më të mëdhenj të kontinentit*, në: "Ballkan", -Nr. 1345, 20 korrik, 2005, f. 19
- A. Kapurani, *Si e bëra anglez... Lasgushin e madh*. Intervistë me autorin e librit në anglisht *The Myth of Lasgush (Miti i Lasgushit)*. Interv. Ben Andoni, në: "Korrieri", -Nr. 206, 28 gusht, 2005, f. 11.
- E. Gjika, *Anastas Kapurani, The myth of Lasgush (Miti i Lasgushit)*, London 2004, në: "Studime filologjike", -Nr. 3-4, 2005, f. 189 – 191.
- L. Poradeci, *Poeteka, (Revistë)*, -Nr. 1, prill, 2005, f. 68.
- L. Poradeci, "Albania", -Nr. 100, 1 maj, 2005, f. 16.

- L. Poradeci, *Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullor-atdhetare*. (Studim gjenetik duke pasur parasysh lidhjet me kulturën gjermane), Tiranë, “Argeta LMG”, 2009, -216f.
- L. Poradeci. Një fatos i veteranërisë shqiptare. Fytyra urdhëronjëse dhe aktiviteti heroik i kryeveteranit Nikoll N. Naço Korça. Botim i veçantë i fletores Shqipëria e re, Kostancë. Shtyp, “Albania”, 1932.
- Ch., Baylon & X. Mignot: *Komunikimi, Shtëpia botuese, Logos A, Shkup, 2004, 335f*
- E. Gjikaj: *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit, Shtëpia botuese dhe studio letrare Naim, Tiranë, 2010, -214f.*
- R., H. Jauss: *Esperienza estetica ed ermeneutica letteraria, volume I, Il Mulino, Bologna, 1987, -420p.*
- V. Hygo: *Arti dhe populli. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: V. Hygo: Pjesë të zgjedhura. Tiranë, “Naim Frashëri”, 1952, f. 29-30.*
- A., S. Pushkin. *Puscinit (4maj); I. I. Puscinit. Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Pushkin A. S. Lirika, Tiranë, 1949, f. 21-23.*
- N., I. Vapcarov: *Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Vapcarov, Nikolla. Vjersha të zgjedhura. Tiranë, 1952, f. 69-70.*
- J. W. Goethe: *Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Goethe, Johann Wolfgang von. Poezi. Tiranë, “Naim Frashëri”, 1962, -192 f.*
- V. Hygo: *Ndëshkimet. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci. Në librin: Hygo, Viktor. Ndëshkimet. Tiranë, “Naim Frashëri”, 1975; -264 f.*
- Sharl Le Kont, D., L. Mesditë. *Poezi. Shqipëruar nga Lasgush Poradeci. Në librin: Poezi franceze. Tiranë, 1984, f. 361-362.*
- Eqrem Çabej: *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit. Gazeta e Re. -Nr. 94, Tiranë, 22 shkurt, 1929, f. 3.*
- Mitrush Kuteli: *Poetika e Lasgush Poradecit. Në: Përpjekja shqiptare. - Nr. 17, 1938, f. 243.*
- Mitrush Kuteli: *Disa fjalë mbi vjershat e reja të Lasgushit. Në librin: Kuteli Mitrush. Shënime letrare. Vëllimi i I. Tiranë, 1944, f. 22-32.*
- Ibrahim Rugova: *Me zjarr ju flas me zjarr - Me shpirt e mendje te e bukura u prarua me bukurinë - Lasgush Poradeci, 1899. Poezi. Në librin: Rugova Ibrahim. Prekje lirike. Prishtinë, 1971. f. 173-182.*
- Sabri Hamiti: *Figura kosmike: Vallja e yjve. Në librin: Hamiti Sabri. Variante. Prishtinë, 1974, f. 94-99.*

PRURJE FJALËFORMUESE NË LIRIKËN LASGUSHIANE

“Lasgush Poradeci është poeti i parë modern shqiptar dhe një nga lirikët më të mëdhenj të shekullit XX në Shqipëri, *i cili mendon, flet dhe shkruan vetëm shqip,*” - do të shprehej Kuteli në parathënien e vëllimit me poezi “Ylli i zemrës”. Ai ka qenë dhe do të mbetet mjeshtër i poezisë shqiptare, sepse askush tjetër si ai, nuk mundi ta përdorë aq cilësisht gjuhën shqipe, gjë që duket në përzgjedhjen tepër sqimatore të mjeteve gjuhësore, që ofronte shqipja në atë kohë. Autori shfrytëzon jo vetëm materialin e pasur gjuhësor, me shtresime krahinore, historike, kulturore të zonës së Pogradecit, të cilin e ka shumë për zemër, por shpeshherë i kapërcen kufijtë, duke iu drejtuar shqipes në një shtrirje më të gjerë e më të thellë. Lirikën lasgushiane e hijeshojnë një shumësi fjalësh të rralla, duke dhënë kështu një ndihmesë të madhe në pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe, veçanërisht nëpërmjet fjalëformimit. Ato janë krijuar natyrshëm si rrjedhojë e njohjes së mirë të shqipes nga ana e autorit dhe tingëllojnë kaq bukur edhe sot në gjuhën poetike.

Për këtë punim kemi vjelë një numër të konsiderueshëm lirikash dhe nga një qëmtim i detajuar i tyre kemi konstatuar që në fjalëkrijimet e tij u është dhënë përparësi dy tipeve kryesore të fjalëformimit: prejardhjes, kryesisht asaj prapashtesore, me formante qoftë nominale, qoftë verbale, si edhe kompozimit. Këto fjalë janë ndërtuar sipas gjedheve fjalëformuese të shqipes, duke përdorur ndajshitesat më prodhimtare të saj. Fjalëkrijimet e tij, “të qëndisura” me aq kujdes, janë ndër më të bukurat dhe me shumë interes për t’u studiuar jo vetëm nga ana stilistike, por edhe gjuhësore.

Punimi synon të evidentojë njohjen e thellë gjuhësore të Lasgush Poradecit, aftësinë e tij për të përzgjedhur formantet fjalëformuese apo aftësitë fjalëkrijuese, pasi merakun kryesor i poetit ishte kujdesi për formën. Pikërisht këto aftësi i japin origjinalitet krijimtarisë së tij duke

e bërë autorin një ndër ndihmësit kryesorë në pasurimin e gjuhës letrare shqipe. Një nga përbërësit më domethënës që e dallon poezinë e Poradecit nga krijimet e poetëve të tjerë është pikërisht gjuha e poezive. Shpeshherë të duket sikur fjalori i tij poetik përkon shumë me atë të Naim Frashërit, pasi është i njëjti kujdes për ta mbajtur të pastër gjuhën shqipe. “Lasgush Poradeci, - shprehet Çabej, na hap portën e një jete të re në poezinë shqiptare, një “frisson neuf” po lind e rritet, siç pat thënë Hygoi për vjershat e Bodlerit, një stil i ri, të cilin do ta kërkosh më kot ndër poetët e tjerë shqiptarë, po më kot edhe ndër shkrimtarët e huaj nga shkaku i origjinalitetit që e shquan këtë poet djalosh. Ç’ë ndryshon nga të parët është thellësia, është vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipet, në qoftë se kjo nuk është vënë re gjer tani. Shkaku është se më të shumtët nuk e kuptojnë poezinë e tij, e cila me fjalë dhe mënyra foljesh fare të thjeshta e shumë herë popullore, arrin të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta. Dhe po të këndohet Lasgushi me dashuri, do të vërtetohet thellësia e tij e pashoqe, në mos sot, nga brezat që do të vijjnë. Por, moskuptimi i lehtë, errësira e disa vjershave të tij, nuk është një e metë përkundrazi, një element i gjithë shkrimeve të thella në botë, që prej poemave indiane, Kuranit e gjer më sot. Fundi i fundit, çdo thellësi është e errët. Dhe faji s’është aq i gjeniut sa i publikut mendjeshkurtë”⁹⁷.

Gjuha e përdorur në lirikën lasgushiane është gjuha e një autori, i cili jo vetëm që e dashuronte thellësisht gjuhën shqipe, por mund të thuhet gjithashtu se është gjuha e një njohësi shumë të mirë të fjalëve të vjetra, po aq sa edhe gjedheve të ndryshme të fjalëformimit shqip. Ai, si një filolog i kujdesshëm krijoi një mori fjalësh të reja dhe kryesisht një numër të konsiderueshëm kompozitash të papërsëritshme në llojin e tyre. Lasgushi ka fjalorthin e tij tipik, që nga fjalët e lashta e të rralla, të papërdorura përpara tij në gjuhën poetike e deri te fjalëkrijimet e mrekullueshme të ndërhuara nga dy apo tri tema bashkë, duke e përtëritur shqipen dhe duke i dhënë asaj kuptime të reja.

Ja disa sintagma kompozita tepër interesante:

⁹⁷E. Çabej, “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit”, Gazeta e Re, nr. 94, Tiranë, shkurt, 1929, f. 3.

*gushë-e llërë-e gjë-bardhoshe; malli-i-djegur-durim-plot;
jetë-e-vdekje-përqaftuar; gushë e gjë-stolisura;
mes-hollë-këputura; ndjenjë-fuqi-zjarr;*

Këto fjalë në pjesën më të madhe, nuk janë të përdorimit të përditshëm dhe figurat poetike që ato krijojnë janë karakteristike vetëm për stilin lasgushian, të cilat tregojnë edhe një herë mundësitë e panumërta fjalëformuese të shqipes.

Asnjë nga këto ndërtime të krijuara në mënyrë analitiko-sintetike prej tij, nuk mund të përkthehet në asnjë gjuhë të huaj. Ato pasqyrojnë ndjenja e koncepte krejt shqiptare, perla, të cilat Lasgushi i ka thurur me kaq finesë e mjeshtëri. Për të shprehur mendimet dhe ndjenjat, Poradecit i duheshin shprehje dhe mjete të reja, të cilat, fatkeqësisht gjuha shqipe nuk i kishte, si një gjuhë ende e brishtë, e palëruar në ato vite kur shkroi poeti ⁹⁸. Si një njohës i mirë i shqipes, atij i duhej ta punonte dhe latonte vetë shqipen për të krijuar mjete e fjalë të reja, duke sjellë kështu një ndihmesë të pazëvendësueshme edhe në pasurimin e fjalorit të gjuhës së sotme shqipe. Madje një pjesë e këtyre fjalëkrijimeve përdoren kryesisht në fjalorin poetik edhe sot e kësaj dite dhe tingëllojnë kaq bukur.

Është pikërisht, pasuria dhe larmia e shtresave të ndryshme leksikore, delikatesa në përzgjedhjen e fjalëve, shumëllojshmëria e fjalëkrijimeve, e formanteve fjalëformuese dhe e mjeteve shprehëse stilistikore, që e ka bërë të vështirë studimin e gjuhës së veprës së plotë të Poradecit, si një nga shkrimtarët më përfaqësues të toskërishtes letrare ⁹⁹.

“Por, Lasgushi nuk është vetëm një lëmues fjalësh e shprehjesh poetike, i dhënë pas efektsh të ngjallues dhe pas rimash, sikundër është konstatuar sa e sa herë më parë. Ai është edhe një qëmtues i palodhshëm i kuptimeve të fjalëve”, - do të shprehej Sabri Hamiti ¹⁰⁰.

Mjafton që të shohësh me vëmendje katër vargjet e mëposhtme që të kuptosh se si luan ai me fjalën, si edhe të njohësh figurat qendrore të poezisë së Lasgushit. Vajza në poezinë e tij është motër, shoqe, grua.

⁹⁸ Xh. Lloshi, “Vështirë stilistik për mjetet e shprehjes në gjuhën shqipe”, Gjuha jonë, 1981, nr.1. f.13.

⁹⁹ Gj. Shkurtaç, “Pesha e gjuhës shqipe”, Tiranë 2009, f. 23.

¹⁰⁰ S. Hamiti, “Studime letrare”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 21, Prishtinë, 2003, f. 442.

Te fjala *motër* poeti i drejtohet së dashurës *o motër e ëmbël*. Këtu fjala *motër* nuk është në kuptimin që kemi sot për të, por *motër* prej *mater* që është emërtim i vjetër i vashës si grua, si nënë dhe si shoqe.

zjarr-e-mall-e-yll-e-emër-pa-emër,
vashë-edhe-shoqe-e-motër-e-dashurisë,
nuse-edhe-grua-femër-varr-në-zemër,
varr-edhe-zjarr-e-flak'-e-perëndisë.

Me Lasgush Poradecin, lirika shqiptare mund të konsiderohet si një dukuri evropiane për nga niveli i ligjërimit poetik origjinal. Ai paraqitet si një poet me shpirt modern dhe evropian. Tek universi poetik i Poradecit hasim, si te rrallëkush në poezinë shqipe, një magji të pastër të gjuhës shqipe.

Kemi vjelë shterueshëm me dhjetëra poezi të tij, të botuara në vëllimet “Vallja e yjve” dhe “Ylli i zemrës”. Më tepër se gjysma e poezive të Lasgushit janë këngë për dashurinë. Kjo dëshmon që poeti gjatë gjithë shekullit të vet krijues ka shkruar vjersha dashurie.

Duke analizuar këto fjalëkrijime sipas tipave leksiko-fjalëformues vihet re, se mbizotërojnë fjalët e prejardhura dhe fjalët e përbëra, të cilat janë pak ose aspak të njohura dhe me anë të rigjallërimit apo rifreskimit të tyre, ai ndihmon në pasurimin e gjuhës letrare duke zgjeruar gjedhet fjalëformuese dhe kuptimore të tyre.

Zgjerimi i kuptimeve i jep ngjyrimet emocionale dhe një shprehësi tjetër ligjërimit. Në lirikën e tij, Poradeci ka përdorur shumë struktura dy apo trifjalëshe, ku jepen pranë e pranë dy a më shumë fjalë që shënojnë cilësi ose veprime. Shpeshherë struktura të tilla i vëmë re dendur te Naim Frashëri, ndonëse nuk mungojnë edhe në gjuhën e folur.

qeshe *miturisht*, moj *miturore*; Qeshe *dashurisht*, moj *dashurore*; dh`u skuqe *virgjërisht*, moj *virgjërore*; Dh`u skuqe *nusërisht*, moj *nusërore*; me sy më *vetullon* moj *syvetullushe*; në krah më *fluturon*, krahfluturushe; fërmonte një fërmim; Vengonte një vengim; dashuroja dhe llaftaroja; zemër-lule-e-verë, gas-e-vrer-përherë, zemër-kopsht-me-erë, zemëra-skëterrë, etj.

Siç e shohim poeti bën bashkë kategori të ndryshme leksiko-gramatikore, por që mund të përfshihen brenda së njëjtës strukturë, për

shkak të raporteve kuptimore që kanë midis tyre. Kemi ndërtime ndajfolje + mbiemër, folje + mbiemër, folje + emër, folje + folje, etj. Gjymtyrët përbërëse të strukturave të mësipërme janë shumë të afërta kuptimisht vetëm brenda një konteksti të caktuar.

Jo më kot Kuteli e quante Lasgushin një kulm vigan, i cili ka për të zotëruar për shumë kohë me hijen e vet literaturën dhe mendimin shqiptar. Është pikërisht leksiku i pasur, që flet qartë për pasurinë gjuhësore të veprës së tij¹⁰¹.

Fjalëkrijimet e tij, të krijuara duke përdorur të gjitha modelet fjalëformuese të shqipes, janë ndër më të bukurat dhe me shumë interes, jo vetëm për gjuhën artistike, por edhe për atë letrare. Shumë prej tyre kanë hyrë tashmë në fjalorët e shqipes e shumë syresh presin të hyjnë. Gjuha e tij sjell pasurim të shqipes në të gjitha planet: kuptimor, stilistikor e fjalëformues. Tek ai vëmë re shkrimtarin që zotëron më së miri gjuhën amtare dhe veçanërisht të folmen juglindore të saj, gjë që i lejon atij të shfrytëzojë mjeshtërisht mundësitë e saj shprehëse.

Këto fjalëkrijime janë të shumta dhe të arrira nga ana gjuhësore, kryesisht mbiemra, prej të cilëve denduri më të lartë kanë ata që janë formuar me anë të prejardhjes prapashtesore.

Ja disa formante fjalëformuese sipas dendurisë së përdorimit:

***Me prapashtesën -tar/-tare:**

mall përgjimitar, dashuri përvëlimentare, shkëlqen vezëllimtare, sy dëshpërimtarë, në valthin blerimtar, buçim durimtar, vajtimtar, ti zbret vetëtimtare, tingëllimtar, pyll buçimtar, m'u rrëfeve zilitare, shkrepëtimtare, vrapëtare, lezetar, mëshirëtare, etj.

Formimet e prejardhura qoftë emërore, qoftë mbiemërore me prapashtesën -tar/-tare, kanë si temë fjalëformuese emrat prejfoljorë me -im, ndonëse kemi vjelë edhe shumë raste ku tema fjalëformuese është një fjalë e parme, gjegjësisht emër, si: zilitare, vrapëtare, mëshirëtare, lezetar, etj.

***Me prapashtesën -isht:**

llaftarisht, qiellorisht, lavdërisht, dhembshurisht, pleqërishte, tmerrisht, shokërishte,

¹⁰¹M. Kuteli, Fjala e editorit, "Ylli i zemrës", Bukuresht, 1937, f. 139-180.

Me këtë prapashtesë kemi evidentuar neologjizma ndajfoljore mënyre të formuara prej temash emërore, të parme ose jo. Po kështu kemi ndeshur edhe neologjizmin emëror *djellishtë*, të formuar nga një temë emërore, që Lasgushi e përdor me funksion vendor, për të emërtuar një copë vend që e zë shumë dielli.

***Me prapashtesën - thi:**

Bien në sy edhe disa fjalëkrijime ndajfoljore, të cilat shprehin një kuptim më të intensifikuar të fjalës. Autori herë mbështetet te mënyrat e njohura popullore e dialektore të fjalëformimit dhe herë në gjedhe të reja ¹⁰².

Të tilla janë disa përftesa stilistikore, si: *arithi, capthi* (ngritur mbi dy këmbët e parme), *fillthi* (vetëm), *linkthi* (me vrap), *njatythi, njëmenthi* (i sigurt), *tanithi, ëmbëlthi, kikithi* (kur ecën në majë të gishtave të këmbës), *qirithi* (ngritur mbi dy këmbët e prapme), etj.

Siç e shohim, këto formime ndajfoljore janë modele tipike të ekonomizimit gjuhësor të shqipes.

*** Me prapashtesën -të:**

Duhet thënë se Lasgushi tregon ndjeshmëri të lartë ndaj leksikut figurshëm, saqë arrin të figurativizojë edhe fjalët më të zakonshme të shqipes, siç janë mbiemrat lëndorë:

i zëmbaktë, e shkretëtirtë, i shkëmbtë, i qielltë, i vrulltë, e prushtë, e akullt, e zbardhylët, i sedeftë, i shëllirtë, etj.

Do të ishte me interes për fjalorët e shqipes përfshirja në ta edhe e këtyre fjalëkrijimeve mbiemërore, të cilat më së shumti janë neologjizma stilistikore.

Lasgushi është shumë i kujdesshëm edhe në përdorimin e mbiemrave të përbërë. Këta lloj mbiemrash, siç ka vënë në dukje profesor Jani Thomai, “kanë më shumë karakter të përgjithshëm sesa karakter të ngushtë popullor dhe se ky tipar i tyre shfaqet si i tillë edhe në veprat e shkrimtarëve të tjerë” ¹⁰³.

Fjalët e krijuara prej tij janë kompozita të formuara kryesisht nga bashkimi i dy apo më shumë temave, një pjesë e të cilave kanë hyrë në gjuhën shqipe.

¹⁰² Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 1995, f. 291-292.

¹⁰³ J. Thomai, “Teksti dhe gjuha”, Tiranë, 1992, f. 94-95.

Dihet se mbiemrat e përbërë ekzocentrikë përdoren shpesh në krijimtarinë gojore dhe në gjuhën e folur dhe Poradeci, duke qenë një shkrimtar që në bazë të krijimtarisë së tij ka pikërisht këtë regjistër, i përdor dendur ata për të treguar cilësi fizike, shpirtërore e mendore të personazheve, ndërkohë që përdorimi i tyre sjell jo vetëm shprehësi stilistikore, por edhe ekonomizim të gjuhës.

Mjeshtëria fjalëformuese e tij arriti deri në përsosmëri me krijimin e neologjizmave me anë të kompozimit, duke e pasuruar kështu në një masë të dukshme fondin e fjalëve të krijuara me këtë tip fjalëformimi me njësi të reja leksikore, mjaft prej të cilave janë bërë pronë e gjuhës së sotme letrare ¹⁰⁴.

Në përgjithësi, këto kompozita janë krijuar sipas gjedheve ekzistuese në gjuhën shqipe, por kemi vënë re edhe nga ato që u largohen shumë këtyre gjedheve.

Nëse do të analizonim strukturën morfologjike të kompozitave të krijuara nga autori, vëmë re këto nëngrupe:

* kompozita të formuara nga emër + mbiemër:

hapa-lehtë, sy-qielltë, vetëtim-naltë, kurm-holla, lesh-verdhën, cullufeverdhë, fustan-bardhën, mes-hollë, gjëmë-plotë, hir-ploteja, magji-plotë, fshehtësi-plote, gojë-plote,

Këto të fundit kanë si gjymtyrë të dytë të njëjtin mbiemër *i plotë*.

*kompozita të formuara nga emër +emër: *gji-qumshtuar, sy-qengjërushë, sy-vetullushë, krah-fluturushe; fat-mirushe, vetull-kurorë, zemër-valë, sy-sorkadhe, verbim-magjie*

* kompozita të formuara nga emër + pjesore:

zemërë-thyer, mes-thyer, flakë-bashkuar, flakë-zhuritur; shigjetë-helmuar; shtat-lëkundura, lumturi-dehur, llërë-kulluar, zili-përskuqur, laqe-derdhur, sy-perënduar, buzë-puqur, hije- ndritur, etj.

Kompozitat e krijuara kanë vlerë të veçantë edhe në rrafshin stilistik. Ato marrin nuanca kuptimore dhe vlera të caktuara shprehëse, sepse brenda kontekstit ligjërimor ato shërbejnë për të dhënë tipare të personazhit. Herë-herë autori i emërzon këta mbiemra kontekstualisht.

Ndonëse më të rralla, në poezinë e Poradecit kemi evidentuar edhe disa

¹⁰⁴A. Kostallari, "Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese", Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, nr. I. Tiranë, 1972, f. 95.

kompozita të mrekullueshme trigjymtyrëshe, që i kemi hasur edhe në prozën e Kadaresë, si: *buzë-gjak-qershije, shtat-hedhura-selvi, vaj-erë-lyer, mes-hollë-këpu-tura, gushë-e-gji-stolisura, gushë-e llërë e gji-bardhoshe*, etj, përshkrime të papërsëritshme, nëpëmjet të cilave Lasgushi na jep tërë bukurinë e jashtme fizike dhe brendinë e ndjenjës së asaj: “*Kurmhollës si gargi*”.

Vetëm duke u fokusuar te poema “Kamadeva” (emri i hyjit të dashurisë në mitologjinë indiane), si poema më e çuditshme dhe më e pakrahasueshme për dashurinë, kemi vjelë një pjesë të mirë të këtyre neologjizmave. Pra, gjuha e Lasgushit është gjuha e mundësive të pafundme fjalëformuese dhe e nuancave të pafundme semantike.

Fjalët e përbëra ose ato të bashkëngjitura janë mënyra më domethënëse e shprehjes gramatikore të kuptimit. Struktura morfologjike e fjalës ndryshon gjatë zhvillimit historik, prandaj duhet patur parasysh dinamika e zhvillimit gramatikor të fjalës dhe ndryshimet që pëson ajo nga ana kuptimore¹⁰⁵.

Poradeci ka krijuar me një korrektesë gjuhësore për t’u admiruar fjalë apo kuptime të reja fjalësh, të cilat e pasurojnë së tepërmi ligjërimin e tij artistik, por edhe leksikun e shqipes në përgjithësi.

Poezia e tij është vërtet aq e shqipëruar sa e asnjë tjetri para dhe pas tij. Ai është jo vetëm një pasues i Naimit në pasurimin e gjuhës dhe pastrimin e saj nga fjalët e huaja dhe të panevojshme, por ai e çoi atë më tej. Lasgushi ka një shqipe të ndryshme nga të tjerët para dhe pas tij.

Vetëm po të ndeshesh me disa fjalëkrijime, kryekëput shqip, nga fjalorthi i tij i veçantë, si: *i llaftaruar, llaftarisht, tingëll llaftarije, parë-verak, i përrallshëm, pleqërishte, e shkundërmuar, dhembshurisht, tmerriisht, i vagëlluar, shokërishte, fshehtësirë, zemërak, smirak, hidhërake, hidhatake*, etj, e kupton menjëherë unin poetik të Lasgushit, që e dallon nga të tjerët edhe për kuptimin e thellë që kanë poezitë e tij. Kemi të bëjmë me një poet të pazakonshëm,-do ta quante Kadareja, të jashtëkohshëm për kohën kur shkroi, sepse ndoshta ishte i parakohshëm në krahasim me shumë të tjerë të asaj kohe që shkruanin poezi në letërsinë shqipe.

¹⁰⁵ A. Xhuvani, “Kompozitat”, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, nr. I. Tiranë, 1972, f. 69.

Në të kuptuarit e poezisë së tij kanë vështirësi jo vetëm lexuesit e thjeshtë, pra lexuesit e rëndomtë, por dhe studiuesit e tij, ata që merren një jetë të tërë me poezinë në përgjithësi dhe me poezinë e Lasgushit, në veçanti. Jo se Lasgushi përdori një fjalës jo shqip, por pse përdori pikërisht një të tillë shumë shqip, mëse të veçantë, të palexuar më parë ndër poetët e tjerë, madje me fjalë të moçme, duke u dhënë kuptim të thellë e mbase edhe të ri. Nuk i kishte fajet Lasgushi për këtë moskuptim të poezisë së tij, por fajet i kishte “publiku mendjeshkurtë”, i pamësuar deri atëherë me një vjershërim të tillë, që nuk arrinte të kuptonte filozofinë e thellë poetike lasgushiane, poetikën filozofike të kë-tij poeti me përmasa europiane e mbase edhe botërore ¹⁰⁶.

Leksiku, mrekullisht i pasur, është treguesi që shpërfaq në mënyrën më të qartë pasurinë gjuhësore të veprës së tij dhe që tregon se sa mirë e njeh ai gjuhën shqipe dhe potencialet e saj fjalëkrijuese, gjë që i krijon edhe mundësinë për të krijuar pamjen e një shkrimtari tejet origjinal. Poezinë e tij e hijeshojnë me praninë e tyre një sërë fjalësh të rralla për gjuhën letrare.

Ndihmesa më e madhe e Lasgush Poradecit në pasurimin e gjuhës letrare shqipe qëndron, në prurjet e leksikut, në fushën e fjalëformimit dhe në prurjet në fushën e figurshmërisë dhe frazeologjisë, duke krijuar fjalë që burojnë nga gjuha e popullit.

Ai është poet me vlera të vërteta europiane, në qoftë se do ta krahasonim me ndjeshmërinë fjalësore të Sharl Bodlerit, prandaj Çabej ishte i bindur kur shkruante, *se lirika lasgushiane një ditë do t'i flasë botës*.

Ndonëse poezia e tij nuk përkthehet lehtë, koha po e provon se Çabej ka pasur të drejtë. Lasgushi e skalit fjalinë, e zgjedh fjalën shqipe dhe e shpreh atë me figura lehtësisht të kuptueshme. Rëndësia e poezisë së Poradecit qëndron në reformimin që ai i bëri lirikës shqipe si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Ai sollti një model krejt të ri të lirikës në poezinë shqiptare, duke përdorur magjinë e gjuhës, duke sjellë fjalëkrijime, neologjizma të papërsëritshme dhe duke u mbështetur gjerësisht në folklor. Lasgush Poradeci la një vepër të madhe dhe ishte e mbeti, para së gjithash, mjeshtër i shquar i fjalës shqipe. Ai është si vera, sa më shumë të shkojnë vitet aq më i këndshëm bëhet.

¹⁰⁶ Sh. Rrokaj, “Çështje të gjuhës shqipe”, nr. 2, Tiranë, 2009, f. 14.

BIBLIOGRAFI:

Çabej, E., “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit”, Gazeta e Re, nr. 94, Tiranë, shkurt, 1929.

Shkurtaç, Gj., “Pesha e gjuhës shqipe”, Tiranë, 2009.

Kostallari, A., “Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese”, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, nr. I. Tiranë, 1972.

Rrokaj, Sh., “Çështje të gjuhës shqipe”, nr. 2, Tiranë, 2009.

S. Hamiti, “Studime letrare”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 21, Prishtinë, 2003, f. 442.

Kuteli, M., Fjala e editorit, “Ylli i zemrës”, Bukuresht, 1937.

Thomai, J., “Teksti dhe gjuha”, Tiranë, 1992.

Xh. Lloshi, “Vështrim stilistik për mjetet e shprehjes në gjuhën shqipe”, Gjuha jonë, 1981, nr.1. Xhuvani, A., “Kompozitat”, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, nr. I. Tiranë, 1972.

NELI NAÇO

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
nelinaco@hotmail.com

ETNIKJA SI FILLESË: PIKËVËSHTRIMI DHE VEND- NDODHJA NË POEZINË “PORADECI”

Poezia lirike “Poradeci” e Lasgushit përbën një nga poezitë më interesante ku kryqëzohen ide dhe koncepte të rëndësishme që kanë të bëjnë me formimin letrar të Lasgush Poradecit. E vështruar shpeshherë në këndvështrime të ndryshme poezia ka lejon shtresëzimet interpretative që mund t’i bëhen në kohë të ndryshme. Nga një pikëpamje kjo poezi është nga poezitë më origjinale të Lasgush Poradecit.

Poezia “Poradeci” është e vetmja poezi e Lasgushit që artikulon qartësisht vende dhe një topografi reale në hapësirë. Poradeci, Liqeri, Mali i Thatë, Shëndaumi, Drini, janë pika hapësinore prej ku lexuesi mund të orientohet në këndvështrimin e tij panoramik duke iu përafuar pikëqëndrimit dhe pikëvështrimin që poeti si një përshkrues perfekt ka zgjedhur për të realizuar vështrimin e tij ndaj vendlindjes dhe ndaj atdheut në një mënyrë që pakkush e ka parë. Ky këndvështrim është interesant sepse kthen interpretimin në një rrafsh fillestar aty ku fillon poezia, në vendndodhjen e poetit, prej nga ai sheh këtë topografi interesante. Poeti nuk artikulon ku është, por artikulon çfarë sheh dhe ne mund të imagjinojmë vendndodhjen e tij afërsisht ose ekzaktësisht duke e nisur interpretimin e poezisë së tij nga kjo topografi që ai rrëfen. Luan Topçiu shkruan: “Ndonëse poezia rrok në mënyrë tejet të përcaktuar natyrën e vendlindjes me Liqerin, Malin e Thatë, fshatin e lëndinat, atmosferë e pangatërrueshme me asnjë vend tjetër gjeografik, autori gjen mënyrën që përpos përshkrimit të një përkatësie shqiptare të peizazhit, të bëjë edhe lidhjen e këtij peizazhi me të gjitha trojet etnike nëpërmjet lumit Drin.”¹⁰⁷

Një nga qëllimet autoriale të Lasgush Poradecit me sa duket ka qenë që

¹⁰⁷ Luan Topçiu, *Tekstualizëm dhe Stil (mbi veprën poetike të Lasgush Poradecit)*, botimet “Light”, Bukuresht 2003.

kjo topografi reale, sipas tij edhe topografi shpirtërore, të jetë e verifikueshme realisht, e pandryshueshme dhe “e përjetshme”. Ai vetë ka zgjedhur emra që do të jenë afatgjatë në memorijen kombëtare. Në të dy variantet e poezisë emrat bazalë kanë mbetur të paprekur nga ripunimi i tekstit poetik.

Një çështje e rëndësishme për të zhvilluar mendimin në këtë rrafsh ku jemi duke e shqyrtuar poezinë është pikëvështrimi që ka zgjedhur autori për të dhënë narrativën e peizazhit që ai sheh. Me gjithë interpretimet simbolike që mund të marrë poezia, në këtë rrafsh fillestar që jemi duke shqyrtuar ka një realitet antropologjik i cili nuk është për tu nënvleftësuar në realizimin e poezisë. Ka një pozicion faktik të unit përshkrues, rrëfimtar, i cili mund të quhet i verifikueshëm. E theksojmë së qëllimi autorial është i dallueshëm në zgjedhjen e këtij pikëvështrimi. Fjala pikëvështrim në rastin tonë nuk është përdorur ekzakhtësisht si në narrativën e fiksionit, por është përdorur në mënyrë të ngjashme me konceptin kinematografik, kjo fjalë, po ta artikuloj ndryshe, është e përdorur më tepër në një kuptim quasi regjisorial në poezi. Mënyra se si ndodh narrativa përshkruese është e ngjashme me atë që mund të quhet syri i kamerës.

Tre drejtëza imagjinare që kalojnë nga qendra e objektit të vëzhguar dhe syrit të poetit na tregojnë vendndodhjen e tij. Këto mendime mbështeten në argumentat e mësipërme që mbështesin faktin se autori i poezisë ka si synim ndërtimin e një simbolike në poezi, por pa e shkëputur nga një bazë reale hapësinore, pa e shkëputur nga topografia reale e hapësirës, pa e shkëputur nga identiteti bazal i saj. Distancat dhe hijet e tyre në poezi janë një përmasë antropologjike në vargjet e poezisë.

Drejtëza e parë do të kalonte nga syri i poetit dhe perëndimi i diellit që po ndodh. Meqënëse këndi i vështrimit është tejet i gjerë, fokusimi i pamjes pra është i gjerë, le të zgjedhim si një pikë orientuese diellin që po perëndon, ose më saktë qendrën e tij si pikën e parë dhe e dyta është syri i poetit. Njohja e hapësirës na sugjeron që poeti është distant, i larguar nga Poradeci dhe jo brenda në qytet. Ai sheh Liqerin pa kufir, sheh perëndimin mbi qytet, sheh tokën dhe qiellin. I ndodhur në qytet, poeti do të ngrinte kokën për të parë perëndimin, mund të shihte fare afër syrin e diellit, por nuk mund të shihte atë që e quan:

Shkrumb' i natës që po bije,

Dyke zbritur që nga qjelli përmi fshat po bëhet fir...

Pamja e tij është e gjerë, sheh Liqerin dhe kërkon kufijtë e tij me vargun: *Perëndim i vagëlluar mbi Liqerin pa kufir.*

Një vend paksa i lartë ka mundësi të jetë vendndodhja e tij. Pika e vështrimit të tij është pikërisht me qytetin përballë, në drejtim të perëndimit dhe me një kënd të gjerë shikimi prej nga syri i unit poetik mund të rrokë edhe pamjen e liqenit, dhe shkrumbin e natës.

Në një varg tjetër poeti shprehet:

Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal të Thatë...

Drejtëza që orienton shikimin e poetit tashmë është e orientuar në një tjetër drejtim ajo sheh Malin e Thatë, por sheh edhe shqiponjën. Si në rastin e parë mund të arsyetojmë në një mënyrë të ngjashme. Nëse poeti do të ndodhej në Pogradec ai sigurisht mund të shihte qartë në mënyrë të pangatërrueshme Malin e Thatë, volumet e tij që janë të lexueshme dhe që dominojnë horizontin përmbi liqen, por mund të themi me siguri që kurrsesi nuk mund të shquante në këtë distancë një shqiponjë, apo një lloj tjetër shpendi. Vështrimi i tij në këtë rast rreh për nga lartësia. Pamja është më e afërt se pikëvështrimi i parë.

Në pikëvështrimin e tretë vështrimi vjen e mblidhet, që prej largësisë, drejt vendit ku ndodhet uni poetik:

Po tashi: Dyke nisur udhëtimin mes për mes në Shqipëri, Drini plak e i përmallshëm po mburon prej Shëndaumi.

Prej perspektivës, e cila ka tre faza, vështrimi vjen e mblidhet deri tek burimi i Drinit, në Shëndaum. Tre fazat e kësaj perspektive janë, se pari viset e largëta shqiptare që poeti nuk i sheh, por i shquan mentalisht, vende të largëta ku Drini kalon, të shprehura me sintagmën: “mes për mes në Shqipëri”, së dyti vende që poeti kalon prej intuitës mentale në një shquarje deri diku të lëvizjeve rrjedhëse të lumit, hyrja e lumit në liqen shprehur me sintagmën: “Drini plak dhe i përrallshëm” dhe së treti, poeti shquan qartë burimin e Drinit që “buron prej Shëndaumi”. Kjo është dhe sintagma e tretë që shpreh një shikim të qartë të poetit për burimin e lumit Drin. Vendi ku buron Drini shquhet, sipas këtij leximi të poezisë, fare qartë ai është pranë poetit. Kjo drejtëz e tretë, që kalon nga burimi i Drinit në syri e poetit, na tregon që poeti

është aq pranë Shëndaumit sa mund të shohë burimin e Drinit. Le të themi thjesht që burimi i lumit është poshtë këmbëve të tij. Vështrimi i tij nga rrafshi ku ai qëndron është i ulur poshtë drejt burimit, drejt tokës.

Kemi tri “sekuenca të pikëvështrimeve” duke përdorur këtu një term të përkthyer nga anglishtja “point of view shots”. Këto tri sekuenca kanë një statikë nga mënyra sesi poeti e ndërton pikëvështrimin. Por, secila prej tyre ka edhe një dinamikë cilësore të përbrendshme. Nata po bie nga universi, shqiponja fluturon, Drini buron nga Shëndaumi. Statika dhe dinamika janë fjalë që shprehin një marrëdhënie të së dukshmes dhe të padukshmes, të së qartës dhe të fshehurës. Ato janë të lidhura kështu me vendndodhjen dhe hapësirën e poezisë dhe lëvizjen e brendshme të saj, të pashtershmen e lëvizjes.

Autori, sipas këndvështrimit tim, ndërton një skenë të madhërishtme të veprimit dramatik, por ky veprim dramatik mungon. Veprimi dramatik, i paartikulluar në veprime, qëndron në momente të tensionuara, që do të thotë se ky veprim dramatik mbetet në hyrje, ose në krijohet në mungesë të veprimit të vet. Më mbështet një thënie e Robert Scholes i cili thotë:

“Çdo element i ndashëm i një narrative mund të thuhet se ka subjektin e tij, sistemin e tij të vogël të tensionit dhe zgjidhjes i cili kontribuon qoftë edhe një cikël në sistemin kryesor.”¹⁰⁸

Nga ky këndvështrim do të artikuloja pa frikë, uni poetik që rrëfen përshkrimin është në Shëndaum. Kjo nuk do të thotë mekanikisht që poeti e ka shkruar poezinë atje, por do të thotë që këndvështrimi i tij real ose, dhe kjo është më e rëndësishmja, që këndvështrimi i tij mental është i tillë. Uni poetik që po rrëfen përshkrimin ndodhet atje.

Këto shenja gjuhësore dhe antropologjike njëkohësisht, na tregojnë se poeti e sheh këtë hapësirë si një qendër të qendrës. Vendndodhja e tij është qendra e universit. Ai e sheh botën të ndërtuar në këtë mënyrë, atdheu është qendra e universit. Vendndodhja a vendlindja e poetit është qendra e qendrës së këtij universi. Nëse do të zbulojmë shenja të tjera të ndërtimit struktural të poezisë së tij do të vërejmë të njëjtën gjë.

¹⁰⁸ Robert Scholes, James Phelan, Robert Kellogg, *The nature of Narrative*, Oxford University Press, 2006, faqe 239

Kjo poezi është e vendosur me kujdes në ciklin poetik, Vallja e dherit – zemra e dherit. Vallja e dherit, vendi ku buron kënga e lashtë, ku ndodh kjo lojë e dritëhijeve, ku zhvillohet aksioni poetik, buron nga Zemra e dherit, e artikuluar prej nesh si qendra e qendrës.

Në një kontekst tjetër rrëfimtari, në një prozë eseistike Poradeci e quan vendlindjen: “qytetth palcërisht shqiptar, i futur në gjirin e maleve si kafka në trurin e njeriut”¹⁰⁹

Shenjëzimi i qendrës bëhet këtu me sintagmën “palcërisht shqiptar”. Shqiptarja është qendër, por palca është qendra e qendrës.

Mircea Eliade ka ndërtuar një strukturë interpretuese, ai thotë:

“Simbolizmi arkitektonik i Qendrës mund të formulohet si më poshtë:

1. Mali i Shenjtë – ku Qielli dhe Toka takohen – është vendosur në qendër të botës.
2. Çdo tempull ose pallat – dhe si vijim, çdo qytet i shenjtë apo vendbanim mbretëror – është një Mal i Shenjtë, dhe kështu mbetet një Qendër.
3. Duke qenë një *Axis Mundi*, qyteti i shenjtë ose tempulli i shenjtë vështrohet si një pikë takimi e qiellit, tokës dhe ferrit.”¹¹⁰

Idetë e Lasgush Poradecit do të thojnë nga kjo masë arsyesimesh dhe faktesh janë ide që i përkasin fare qartë, në këtë fazë të analizës poetike, etnocentrizmit, tipar ky i rëndësishëm i romantizmit, letërsisë së mbarsur me mitologji romantike, mitologjizimit romantik. Që në këtë fazë duhet të nisemi ne për të interpretuar simbolin e Lasgush Poradecit dhe pastaj do të mund të arrijmë në përfundime edhe më të qarta.

Një dimension i katërt i hapësirës kërkohet prej Lasgush Poradecit dhe ky dimension është ai i cili duhet të eksplorohej. Dimensionin shpirtëror që i jep edhe të ashtuquajturën përmasë mistike poezisë së tij. Fillimi i eksplorimit të saj fillon me vargjet: “*Futet zemra djaloshare mund në fund të shpirtit tim*”.

Pashko Gjeçi shkruan për zanafillën e këtij hulumtimi shpirtëror lasgushian duke marrë si shembull të njëjtin varg. Edhe ai është i mendimit që Lasgushi endet në një dimension të thellë të vetvetes:

¹⁰⁹ Lasgush Poradeci, *Vepra 2*, Onufri, Tiranë, 1999, faqe 176.

¹¹⁰ Mircea Eliade, *Cosmos and History, The myth of the Eternal Return*, Harper Torchbooks, New York 1959, faqe 12.

“Në sa Leopardi, para kundrimit të një hapsine të pambatun, qi përmbledhë në vedi një kohë t’amshueme, humbë personalitetin, dhe hudhet jashtë, në pakufi, si hyllë i shkimun, Lasgushi ban një veprim të kundërt: thellohet, rranjësohet brenda vedit.”¹¹¹

Peizazhi që e shoqëron atë është real dhe mediativ njëkohësisht, pjesë e dimensionit të katërt të poezisë. “*Tërë fisi, tërë jeta, ra, u dergj, e zuri gjumi, zotëroi më katër anët errësira...*”

Ky shqyrtim në i bërë në kuadrin e një kërkimi quasi antropologjik e rinis interpretimin e poezisë së Lasgush Poradecit në një formë tjetër. Prania e vendeve që janë reale në poezi na bën të mendojmë për një marrëdhënie të cilën është e rëndësishme ta marrësh në shqyrtim, sepse prej saj mund të zbulohen tipare të rëndësishme të postromantizmit të Lasgush Poradecit në nivele më të gjera. Vendndodhja e poezisë, marrëdhënia e saj me hapësirën, pikëvështrimi që ka zgjedhur poeti për të vëzhguar botën, zberthen, le të themi, në një farë mase, edhe konceptime të reflektuara në poezi të tjera të Lasgush Poradecit.

BIBLIOGRAFI

Luan Topçiu, *Tekstualizëm dhe Stil (mbi veprën poetike të Lasgush Poradecit)*, botimet “Light”, Bukuresht 2003.

Robert Scholes, James Phelan, Robert Kellogg, *The nature of Narrative*, Oxford University Press, 2006, faqe 239

Lasgush Poradeci, *Vepra 2*, Onufri, Tiranë, 1999, faqe 176.

Mircea Eliade, *Cosmos and History, The myth of the Eternal Return*, Harper Torchbooks, New York 1959, faqe 12.

Pashko Gjeçi, “*Poradeci i Lasgushit*”, në Revistën “Shkëndija”, Nr, 3, 1943, faqe 43.

¹¹¹ Pashko Gjeçi, “*Poradeci i Lasgushit*”, në Revistën “Shkëndija”, Nr, 3, 1943, faqe 43.

MERITA GJOKUTAJ-SHEHU
Departamenti i Letërsisë
Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
merigjokutaj@yahoo.com

TRINIA EKZISTENCIALE E JETËS, QIELLI, TOKA DHE NJERIU, NË POEZINË E LASGUSH PORADECIT

Lasgush Poradeci ka lënë pas një krijimtari të bukur, e cila ka fituar zemrën e lexuesit dhe ka tërhequr vëmendjen e disa studiuesve të kulturës sonë si: Eqrem Çabej, Sabri Hamiti, Ismail Kadare, Shaban Sinani, Emin Kabashi, Floresha Dado, etj.

Pothuajse të gjithë këta studiues janë të mendimit se arti i poezisë së Lasgushit është një nyjetim i natyrshëm dhe evoluim logjik i kapërcimit nga romantizmi në realizëm. Poezia e tij është pa dyshim një nga poezitë më magjepse, më impresionuese, më frymëzuese, e cila për nga gjetjet artistike, forma poetike, muzikaliteti, ndërtimi harmonik i vargjeve, metrika e ndjekur, metaforat e përdorura me aq mjeshtëri, si dhe stili, e identifikojnë si lirikun më të madh të muzës shqipe.

Lasgushi u përpoq të krijonte sistemin e vet poetik. Talentit të tij të pakundërshtueshëm, diti t'i bashkëngjitë punën e pikërisht këtu qëndron shkak i jetëgjatësisë së sigurt të veprës së tij ndaj kohës. Ai nuk bëri përmbledhje poezish, por libra poetikë me një strukturim tematiko-strukturor. Kjo gjë shihet fare qartë në dy librat e lirikës së tij me emërtime e ndarje në cikle, të cilat mund të shkrihen ose të bashkohen.

“Vallja e Yjeve” / Zog i Qiejve, Vallja e Qiellit, Vallja e Dherit, Vallja e Yjeve, Vallja e Përjetësisë, Vallja e Vdekjes, Kur nuk ndjehesh fare mirë.

“Ylli i Zemrës” / Zemra e Qiellit, Zemra e Dherit, Zemra e Jetës, Zemra e Vdekjes, Kush ma njohu dhembshurinë.

Këto dy vëllime na bëjnë të kuptojmë se poezia për Lasgushin është produkt njerëzor i një bote të brendshme, është nostalgji, kujtesë, ëndërr, mall, dashuri, harmoni, përsosje. Sipas tij poezia i takon intuitës, imagjinatës, moralit, frymëzimit, zemrës, shpirtit, dashurisë, dritës, përjetësisë.

Si e tillë poezia e tij pati një komunikim jo të zakonshëm me lexuesin

dhe kritikën e kohës. Poezia e Lasgushit ka dy mënyra jete: një që e bën së bashku me lexuesin dhe një që e bën jashtë fuqisë së tij, për t'i kapur të gjitha interesimet e saj. Si e tillë ajo të imponon pak fjalë interpretimi dhe analize. Këtu qëndron vështirësia themelore e shqyrtimit dhe e komunikimit me këtë poezi. Asaj i kanë hije krahasimet, por që nuk i përfill në bërthamë ato, sepse mbi të gjitha është poezi e vetvetes, pastaj e gjithësecilit.

Të dy vëllimet poetike: "Vallja e Yjeve" dhe "Ylli i zemrës", jo rastësisht me këta tituj, shënojnë dhe zbulojnë një përmasë të prekshme për çdo lexues dhe studiues, shënojnë dhe zbulojnë sistemin poetik të Poradecit, që është vendosur midis tokës dhe qiellit, prej nga ku lëshon imazhet si sy gjigant i tokësore dhe qiellore, me zërin e tij, tashmë vetëm si misionar i artit. Orvatet të tregojë se poeti nuk i ka shkëputur lidhjet me qielloren, sepse prania e yllit e lajmëron më së miri se vetë njeriu, shpirti dhe fryma e tij, janë frymëzim i qiellore, por edhe gjurmë e prekshme e tokësore, pra kemi një situatë të veçantë të marrëdhënies së qiellore-tokësore-shpirtërore.

Qielli, toka dhe njeriu, janë trinia ekzistenciale e jetës në poezinë e tij.

E në funksion të kësaj trinie do të veçoja:

Lasgushi këndon në një dekor stilistik të madhërishëm, këndon për qiellin dhe zotin, për dherin e kombin, për dashurinë e vashën, për të lartat e mendimit, jetën metafizike dhe përjetësinë.

Lasgushi solli në qendër të poetikës së tij qenien njerëzore, në përmasat e saj shoqërore dhe intime: në përmasën e jetës shoqërore- atdhetarin, në përmasën e jetës intime- zemrën njerëzore, botën e brendshme të qenies, ëndrrat, ankthet, aspiratat e dyshimet. Në planin artistik, i shprehu konfliktet shoqërore dhe ato brenda qenies me anë të kontrastit të fuqishëm, ku bashkohen tragjikja me komiken, e bukura me të shëmtuarën, sublimja me grotesken.

Lasgushi i këndoi tokësore, jetës konkrete të shqiptarëve, ambientit shqiptar, jetës së bariut dhe bujkut, flet për dimrin, për korrikun, për liqenin e vendlindjes së tij, përmend vende e data të rëndësishme të popullit, sepse kështu historia do të vazhdojë të kujtohet. Gjejmë në tekstet e tij poetike Skënderbeun, Ismail Qemalin, Naimin, Asdrenin etj.

E ndritshmja, e tejdukshmja, qartësia shpesh ka pranë të errtën, mistikën, të pazbulueshmen. Gëzimi i jetës, pasioni i zjarrtë tokësor gërshe-tohet me sublimen, qielloren; rebelimi dhe sakrifikimi altermohet me tërheqjen e vetminë, që është një protestë pasive, një mënyrë e veçantë ekzistence.

Kuptimi i jetës përfshihet brenda yllësisë, ndaj Ylli shndërrohet në kryefigurën më përfaqësuese të vëllimeve “Vallja e yjeve” dhe “Ylli i zemrës”. Ajo lidhet me dashurinë por, njëkohësisht është edhe simbol i shumanshëm, është dashuri për vendin e tij, për njeriun e mirë, është dashuri për gjuhën, për tokën, për vendlindjen e atdheun. Në mendjen e poetit gjithçka ndriçon si yll. Në vargun “*Një yll përjetësie u ndes në shpirtin t’im!...*”¹¹², ylli simbolizon lindjen e diçkaje të re, rilindjen e fenomeneve natyrore, lindjen e dashurisë në zemrën heroit, në zemrën e poetit, lindjen apo përlindjen e shpresës. Duke e interpretuar figurën e yllit dhe vallen e tij hapësirës së paanë, poeti kërkon ta zotërojë kozmosin, hapësirën, njeriun.

Yll e mall që shëmbëllen,

Drejt pres zemërës së qetë,

Vjen e ndrin e shkon nga vjen,

*Rrëzë qjelli, rrëzë jete.*¹¹³

Edhe **malli** është një figurë e rëndësishme e poezisë së Lasgushit. Malli është dëshirë e zjarrtë, është dashuri, është dhembje. *Mall o mall! që vjen e shkon!...*, malli largohet por nuk zhduket, është gjithmonë i pranishëm në jetën e njeriut. Ai ka mall për njerëz të dashur, për vendin e tij, çka e bën shumë të ndjeshëm. Largimi shpirtëror nga një qenie e dashur shqipton dhembjen e ndarjes por edhe dëshirën për një bashkim të ri, e cila vërehet në vargjet: *T’a nisim duke pushuar mërgimin zemërak ..!Më hidhur do t’na dhembti largimi jon’i ri.*

Poezia e tij endet midis tokësore dhe qiellores. Rëndësi për Lasgushin ka edhe përjetësia e vdekja, sepse ato janë pjesë të njeriut, të jetës së tij, madje i jep mundësi lexuesit që me anë të poezive të tij të bësoj në vetëvete se çdo gjë që lind edhe vdes. Në ciklin “**Vallja e përjetësisë**” në vëllimin “**Vallja e yjeve**” me pesë poezitë përkatëse:

¹¹² L. Poradeci, Një yll përjetësie, Vepra 1, Onufri, 1999, f. 75

¹¹³ Po aty, Ylli, f. 131

Lënda dhe jeta, Fryma dhe qëllimi, Ndjenja dhe njeriu, Njeriu dhe zoti, Përjetësija, bën përpjekje që të kapet cikli i krijimit të botës, duke nisur nga forma më primitive e materies deri në shkallën e saj më të lartë të zhvillimit, në shpirt, duke kaluar nëpër shkallët: **Lënda, Fryma, Ndjenja, Njeriu, Përjetësia**. Të përshkruar nëpër një subjektivitet të theksuar të krijuesit, në të vërtetë janë shkallë të gjendjes së shpirtit-Zotit. Zoti i Lasgushit nuk është zoti teologjik, por zoti që si në çdo gjë të natyrës është edhe në vetë njeriun. “*Sapo Zoti më dha jetë:/ më dha jetë-e më la vetë.../ Pa e pyet dhe vet e ti/ Të mosbindurin njeri,/ Dhe për zemrën që ju thye/ I kërkoj një arësye/ Ç’ke që vuan, o njeri?/ Ç’ke që bret me dhemshuri?/ Ç’ke që djek posi qiri?.... Po njeriu ndaj e dëgjonte,/ Hapte gojë- e kuvëndonte/, Kuvëndonte më të qarë,/ Me zembrim, me shpirt të vvarë...*”¹¹⁴

Ajo çka të bie në sy veç të tjerave është edhe se Lasgushi krijimin e tij e mbështet në katër figura kozmogonike: Qielli, Dheu, Ajri e Zjarri, të cilat bëhen tema të përhershme të poezisë së tij.

Lasgushi, ka në poezi edhe plot qenie mitologjike. *Lajmësi qiellor, fryma e Zotit, Zoti vetë, Zeusi, perënditë, kamadeva, dragoi, kuçedra, demoni* janë vetëm një pjesë e universit poetik, me të cilat krijoi një simbolikë mitologjike. Veçori e Lasgush Poradecit në këtë proces është se për këto figura në asnjë rast nuk paraqiti thjesht një rrëfim mitologjik. Prej tyre ka marrë thelbin përfaqësues të një miti dhe e ka përdorur si simbol të një dukurie jetësore. Mjafton të përmendim poezitë me titull: *Mbi ta, Ndjenja dhe njeriu, Atje lartë në Mal të Thatë* ku ç’mistifikon krishtin dhe e sjell të ngrejë një kishë për të shenjtëruar shpirtin e dy të dashuruarëve.

*Atje lart në Mal’ të Thatë
Zoti-Krisht bëke një kishë.
N’atë kishë ç’paske brenda:
Qenke trim edhe vasha:
Trim, ç’paske dhëndëruar,
Vasha ç’paske nusëruar,
Zotin ç’paskan lavdëruar,
Jetën ç’paskan trashëguar,*

¹¹⁴ Po aty, Ndjenja dhe njeriu, f. 105

*Shpirtin ç'paskan shenjtëruar*¹¹⁵

Autori i heq krishtit aureolën hyjnore, veshjen mistiko-fetare, e zbret nga qielli në tokë, e bën njeri në jetën e tokës.

Në mbyllje do të theksoja se, poetika e Lasgushit na prek me bukurinë e ndjenjës së saj, me transparencën e një bote poetike brenda një kornize të bukur estetike. Fryma e thellë emancipuese e krijimtarisë së tij në përmbajtje dhe në formë, e bëjnë një nga poetët tanë më të mëdhenj, që do të vazhdojë të lexohet me endje, jo thjesht për rëndësinë që pati krijimtaria e tij në kohën e vet, por sepse ajo edhe sot është shumë pranë nesh. Qielli, toka dhe njeriu, janë trinia ekzistenciale e jetës, njëherazi edhe e poezisë, që i dha forcë dhe emër Poradecit. Në këtë mënyrë Lasgushi krijoi një mit të ri, mitin e përjetësisë së tij.

BIBLIOGRAFI

L. Poradeci, *Vepra letrare 1*, Onufri, 1999

Sh. Sinani, *Lasgush Poradeci dhe kodi poetik popullor*. Sf. Nr. 3-4. Tiranë 2000.

E. Kabashi, *Lasgush Poradeci dhe kultura shqiptare*. Sf.1-2. Tiranë 2000.

E. Gjikaj, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit*. Tiranë 2010.

¹¹⁵ Poradeci, L. "*Vepra letrare*". Nr. 1. Tiranë 1990. f. 119.

EMINE SHABANI
Universiteti i Tetovës
emine.shabani@unite.edu.mk

FILOZOFIA E POEZISË SË LASGUSH PORADECIT

Poezia filozofike e Lasgush Poradecit, përmban foljet poetike të ndërfutura në domenin e mendimit të tij filozofik, të cilat shpërfaqin dëshirat, vuajtjet, meditimet, dhimbjet, ankthin, qofshin ato personale, njerëzore apo mbarëkombëtare, siç i kemi te *Fryma dhe qëllimi, Njeriu dhe Zoti, Përjetësia, Naim Frashërit, Gjeniu i anijes, Vdekja e Nositit, Kënga pleqërishte*, etj.

Poezi lirike nën petkun e së cilës spikat poezia gnomike, me motive të shumëllojta që herë-herë thonë fjalë të fuqishme “*E kjo fjalë e perëndishme, ky kanisk pa shëmbëllim Këjo vallë diamandësh na-u pat lënë trashëgim*”¹¹⁶ Ku vjershëron për veprën e Naimit dhe arrin ta kuptojë atë në qenien e tij...

Gjuha është identiteti i një populli, fryma, ekzistenca, e kaluara e cila është edhe e ardhmja e tij! Gjetjet figurative të Poradecit janë të dhembshura, të fuqishme e të urta dhe herë-herë kanë krahë dhe e ngrenë këtë element të shenjtë në qiell pranë Perëndisë: “*Shpirt i shent i kombit, zjarr ku djeg me dritë, shpat’e ndritur e lirisë, Verb i Perëndisë*”¹¹⁷ Lagush Poradeci poeti disident, i cili e luftoi një sistem të mykur e të ndryshkur fund e krye, i cili e dëmtoi bërthamën e identitetit të një kombi-gjuhën, ai e nënvizon këtë në poezinë *Naim Frashërit*, përmes lirikës së tij gnomike, me fjalët-armë të mprehta e të goditura, të rimuara, me ngjyrimë psikologjike, intime të thella e të individualizuara, që shprehin forcën shpirtërore të poetit.

Në një gjendje izolimi social, intelektual dhe krijues, Poradeci nuk dorëzohet, ai ka model brezat e mëparshëm, ky model i arketipit kolektiv, e mban gjallë qenien krijuese të poetit, çdo rrethanë toksike e sublimon me poezi të papërsëritshme, me figura të gjalla, të goditura dhe plot

¹¹⁶ Lasgush Poradeci, (1978), *Vdekja e Nositit*, Rilindja, Prishtinë, f. 73.

¹¹⁷ Lasgush Poradeci, (1978), *Vdekja e Nositit*, Rilindja, Prishtinë, f. 75.

frymë atdhetare, dashuri ndaj gjuhës, qenies dhe identitetit i cili dalëngadalë po e humb bukurinë dhe pastërtinë që kishte në kohën e Naimit. Poradeci në poezinë kushtuar Naimit, nëpërmjet figuracionit të fuqishëm, toneve poetike dhe paraqitjes së lartë artistike, himnizon përpjekjet e Naimit për pasurimin e gjuhës shqipe dhe njëkohësisht shpreh zhgënjimin e dëshpërimit sepse kjo punë e ky mund po shembet pa mëshirë nga pasardhësit e poetit të madh të Rilindjes:

*Sot po humb kuvend i zogut ç'gjithë bukuri që kishte
Pa lëngon e nis të shembet folja jonë pleqërishte
E në breng të kaq rrëmuje psherëtiu dhe u shua fare
Duke rënë posi pika kën'g e orës shqiptare.¹¹⁸*

Nga poezia shohim qartë sistemin distopik-nihilist në të cilin jeton autori, ai është i izoluar, i shmangur nga çdo lloj veprimtarie e fryme që nuk është e lirë, autoktone, ashtu siç e ëndërruan dhe e dëshiruan dhe më në fund u zhgënjyen. Poeti përdor efekte kontrastive me një spërkatje ironike, duke i mbushur edhe me perceptimet tona situatat e pafundme, që dalin përgjatë rifitimit të vetëdijes se pësimi është mësim. Pas një dimri vjen një dimër tjetër, që sjell një ndryshim tërësor të kuptimit, se tani shpërthen jo një pranverë, por një dimër i ri, që lë gjurmë në shpirt të bylbylit. Siç janë vargjet e Mjedës:

Por vaj! Se 'i dimën tjetër

*Paske, o bylbyl i shkreti;
Pa da ty zemra t'treti
Mbas vajit që t'rrethon. [...]
A thue po kjan, se çerdhen
Ta ka shkatrrue skyfteri?
A thue po kjan, o i mjeri,
Se me rrnue gjallë s'ke mel? ¹¹⁹*

Në vargjet e Nolit ka një mallëngjim të çiltër me motiv artistik, në poezinë *Anës lumejve*, ku spikat një meditim dhe midis këtij meditimi i duket sikur dëgjon një psherëtimë që i premtion kthimin në atdhe, *pres një shenjë, e pres një dritë*, shpresën se mileti po gatitet dhe ai do të kthehet në atdhe, por e gjithë kjo është vetëm një besim i përmbledhur

¹¹⁸ Lasgush Poradeci, (1978), Vdekja e Nositit, Rilindja, Prishtinë, f. 72.

¹¹⁹ Ndre Mjeda (1978), Vepra, Rilindja, Prishtinë, f. 47.

në vetvete, një ëndërr e shuar.

*ëndërronj pa funt, pa shpresë,
anës Elbë-s, anës Spree-së.*

[...]

*që do kthehemi njëherë,
pranë vatrës, pranë punës,
anës Vjosës, anës Bunës.*

Migjeni, e përshkruan plot ndjesi trishtimi e mallëngjimi ndarjen nga atdheu, këtë ndarje acar si era që shkund gjethet, ashtu shkunden shpirtat e tyre, nga trangu i atdheut, kjo është pafundësi e figurës poetike, një krahasim me efekte të mahnitshme, që e shoqëron një paraqitje e lartë përtej fuqisë së fjalës së shprehur njerëzore. Thelbi estetik i vargjeve, qëndron në figurën e përsëritur të shpirttrave, që bien, shkunden, duan, enden, në viset e perëndimit që shkëlqen dhe ndriçon në mrekullinë e tij.

*Mbrame një erë e ftohtë acar fryni nga ana e maleve,
i shkundi shpirtët tonë - bashk me gjethe të kësaj vjeshte
Shpirtët tonë me një dashni tragjike ato vise i duejnë. [...]*

Enden shpirtët tonë nëpër vise të përendimit të mrekullueshëm.

Vargjet e Gjergj Fishtës dhe poezitë e Mjedës, Migjenit, Nolit, pohojnë njëra-tjetrën në mallin e shpresës së kthimit në atdhe, ndjejnë në zemër ngrohtësinë e të vatrës së shtëpisë dhe tokës mëmë dhe trishtimin e ndjesinë e errët se ndoshta nuk do ta shohin sërish vendlindjen.

Pikërisht në këtë mundim dhe trishtim, ruhet thelbi fisnik i dashurisë ndaj atdheut dhe idealit për përjetësi të tij. Vargje që vijnë spontanisht, kur poeti largohet nga atdheu dhe mallëngjimi e trishtimi që shprehen me figura të gjalla e të goditura, plot admirim për natyrën e bukur e të pakrahasueshme që zhduket dalëngadalë para syve të tyre, shoqërohet me frikën se a do ta shohin edhe një herë atë.

*Kam me ndije të tjera gjuhë
Në të tjera vende e të tjera qytete...
Vendin tem ma skam me pa...*

Ashtu si shumë rilindës, që gjuhën, kombin, vendin e konsideronin si një tërësi, edhe Lasgushi i këndon gjuhës shqipe që për interesa të disa njerëzve-poetëve, apo poetëve-deputet po varej.

Analiza strukturore e veprës poetike, nxjerr në pah edhe shumë aspekte tjera si njohja receptive e kontekstit shoqëror dhe vetëm njohja e këtij konteksti, mundëson leximin e gjurmëve metaforike dhe metonimike të cilat i lanë shkrimtarët në poezitë e tyre.

Poezia e Lasgushit në përgjithësi përmban vërtetësi psikologjike dhe koherencë artistike. Ajo gjithashtu përmban elemente tragjike anaforike nga njohja tek mosnjohja, “*anagnosisi i Arsitotelit bashkë me peripetinë-kthesën që është kuptim më potencial për sigurimin e efektit tragjik*”¹²⁰

*E kështu filloj të ngrihet nga varrishtat e çdo ane
Përmbi gjuhën shqip të gjallë një mumi egjiptiane
Po ti drith-u o! Komb i lashtë, me-atë zembërën e gjërë
E në gas të dridhmës s’ate le të tundet bot’e tërë!*¹²¹

Poezia Poradecit dhe gjithë krijimtaria e tij, nuk mund të kuptohet dhe interpretohet pa njohur rrethanat politike dhe historike të konflikteve, mosmarrëveshjeve, mes të huajve dhe ato brenda shqiptare, ajo është rezultat i këtyre rrethanave.

Dashuria ndaj gjuhës, kombit, janë elementi kryesor që e shtyjnë në krijimin e poezive, prozës e përkthimeve, ndërsa thelbësorja e sublimimit në veprat e tij, është ngritja mbi të zakonshmen, të rëndomtën, nga gjërat negative dhe agresive krijon vepra madhështore, duke përdorur ironinë, krahasimin, paradoksin antitezën, metaforën dhe figura të tjera që i japin gjallëri, dritë dhe zë poezive të tij.

Kuptimi i brendshëm i poezisë, fryma që e gjallëron, dhimbja, malli, stolitur me figurat e antitezës, figurave të gjalla e të goditura që e përbëjnë thelbin e poezisë dhe një shkrimi shpirtëror të poetit, që nuk janë tjetër veçse një ofshamë e brendshme shpirtërore më tepër energjetike-shpirtërore se logjike, që kishte sakrifikuar për t’ia ndërruar kahen e historisë së shqiptarëve dhe në anën tjetër, melankolia si forcë shtytëse që e frymëzon për ta përpunuar dhimbjen, me një lëvizje të penelit në pëlhurën poetike të ekzilit, të një ekzili brenda atdheut, në mes atdheut e mëmëdheut, tokës mëmë por i huaj dhe i privuar nga esenca e atdheut gjuha, kuptimi, ndjenja, Poradeci i krijon poezitë të spërkatura me një

¹²⁰Prins, Xh. (2001), Recnik na naratologija, Detska Radost, Shkup, f. 98.

¹²¹Lasgush Poradeci, (1978), Vdekja e Nositit, Rilindja, Prishtinë, f. 75.

ironi të re, unike.

*“Çu ndërtua bres pas brezi, bje greminë më një ças
Ku këndoj bilbili kombit, grifsh e huaj çirret pas,
Me përbrëndjen e shkrumbosur një poet, një deputet,
Flet e çflet e vret e pret për një të vet virgjinitet...”¹²²*

Lasgushi ishte një poet jashtëzakonisht inteligjent, pothuajse pa paralele në shpejtësinë me të cilën kapi, përpunoi dhe vendosi koncepte filozofike dhe kritike në veprën e tij. Qëllimi im këtu është të vë së pari gjërat e para: Cili është ndikimi i menjëhershëm i leximit të një fragmenti nga Lasgushi? Dhe me cilat tipare e identifikojmë fragmentin si Lasgushian në mënyrë të veçantë?

Mendimi qëndron prapa asaj që ai mendon. Ky mendim merr nën mbikëqyrje, nën mbrojtjen e tij të kaluarën dhe të ardhmen, së cilës i rri mbi krye vazhdimisht një rrezik i qenësishëm, një vuajtje.

*Nga Toskëri e Gegërija
Shpesh e më shpesh patm' ëndëruar
Si ndrin me famë Shqipërija
Mes ligësish armiqërishtë
Stolismë lulen e vullnetit
Sbuluam gur margaritari
Prej fundit thëthimtar të detit
E m'çkëlqyer se sa djelli*

Figurat *valle diamantesh, gur margaritari*, shenjojnë gjuhën e pasur shqipe, me arkaizmat e saj, më të ndritshëm se dielli paraqesin ngjitje plot admirim e frikë, plot besim në vetë ndrojtjen *mes ligësish armiqërishtë stolismë lulen e vullnetit*, është një thurje e admirueshme plot hutim në fitoren dhe triumfin e vet, ku mjeshtëria e fjalës dhe vargut ka arritur maksimumin e rrjedhshmërisë dhe fuqisë poetike.

Fasada ironike, satirike dhe herë-herë sarkastike, që u ka dhënë poeti vargjeve e mbështjell mënyrën e saj analitike e kritike, si dhe zhvendosjen kohore e antitezën:

*Po ti mbeç me hir të shentë, bard i lindur ndër pallate,
N'atë varr ku të pat mbyllur dhemshuri' e zemrës sate!*

¹²² Lasgush Poradeci, (1978), Vdekja e Nositit, Rilindja, Prishtinë, f. 74.

Poeti shtron me shije të zgjedhur artistike vargjet ironike, si revoltë e një drame ndaj zhbërjes së gjuhës, me figura të gjalla e të goditura:

Ç' ndriti Lushnja trimërore-po ç'u err dhe vetvetiu...

*Se ç'u mbush me kapedanë, po me mendje çilimiu.*¹²⁴ ...

Ai është rojtar xheloz i këtij thesari dhe e do atë, është kjo dashuri që e lidh me tokën, gjuhën, këtë dhuratë shumë të çmuar e të lashtë-pleqërishte. Te kjo thellësi antitezash e paradoksesh, te këto vargje qëndron thelbi estetik, kjo kontradiktë *me zemër luani mbrohet toka* dhe me *skistër kruhet ajka e gjuhës*, japin përshtypjen e dhimbjes mes figurës së nderuar të poetit dhe shndërrimit të skajshëm të asaj që po ndodh para syve të tij.

Fjala artistike si formë ekspresive dhe mbrojtje ndaj një kohe të ngarkuar me *helm e prishmë*, është sublimim i poetit ndaj errësirës, ndaj të huajës.

Në fjalim të shqiptarit, kush përqeshi, kush gajasi?

Kush më tha se gjuh'e sotme shëmbëllen me zë larasi?

O ta njoha prej së largu buzëqeshjen e shëmtuar

*Ti demon i shkretëtirës që kalon me vaj në duar.*¹²⁵

Motivi mbizotërues i poezisë, janë përfytyrimet kundërshtuese, figurat e antitezës, paradoksit, mënyra filozofike shprehjesh, ndërthurje të goditura ngjarjesh kronologjike të historisë, patosi dhe fryma lirike që mbizotëron fund e krye në çdo poezi të tij. Duke skicuar karakterin naimian, poeti sjell motivin e lashtë të paraardhësve tanë, me shprehjet *këngë që pat qarë me harmoni divine*, në këtë vend të pambrojtur godet fati, ai është fshehtësirë që kalon me fat në duar, ai është njoll e zezë, që mbetet pasi shuhet një yll. Është krismë vetëtime, është demon shkretëtire, me vaj në duar, është vetëdije me sy lugati, sprijë dhe, poeti i bën autopsy kësaj krijese duke e identifikuar me shkrepje vetëtimash tragjizmi, shëmtie e ironie. Poeti bën pyetje retorike për absurdin e vetëdijes së përmbysur, për mendimin e errët në mes të së vërtetës, e

¹²³ Lasgush Poradeci, (1978), Vdekja e Nositit, Rilindja, Prishtinë, f. 75.

¹²⁴ Lasgush Poradeci, (1978), Vdekja e Nositit, Rilindja, Prishtinë, f. 74.

¹²⁵ Lasgush Poradeci, (1978), Vdekja e Nositit, Rilindja, Prishtinë, f. 72.

gjithë poema është meditim i trishtuar i filozofisë poetike, një hov që e shkund shpirtin e tij, keqardhje plot ankth.

Duke reflektuar ndikimin e vizionit artistik të Naimit, Lasgushi herë-herë bën pyetje retorike duke filluar me interpretime psikologjike, me ato projektme në të dukshmen e proceseve të padukshme të përtej varrit! Këto vargje janë një fryt i rrallë i shijes së zgjedhur, ku interpretimi i saj nuk mund të jetë qasje e gjithkujt, - “ajo është këshqjellë e fshehtë për të cilën lexuesi duhet ta gjejë çelësin”¹²⁶

Vallë dergjja jot-e fellë pat pushim e lumtëri? ,

A t'ju çduk dobare gjumit e përjetshmeja zi?

N'atë varr ku për së fundi mort'i keq të zu në rrasë,

*Të çkëlqeu pakmos së largu fush'e ndriçm'e Qerbelasë?*¹²⁷

Thurja e admirueshme e poemës, dhe thelbi estetik i saj, qëndron në vargjet elegjiake për copëzimin, shqyerjen, ndotjen dhe vdarjen e gjuhës naimiane, e pleqërishte, asaj që është aq e lartë, e papërshtueshme, hyjnore. Rrëfimi në lirikën e Poradecit është me figura të qëlluara e të fuqishme, herë-herë me zgjatjen e amplitudës së anakronike, me të cilën është e mbuluar koha e rrëfimit dhe me rrëfimin e munguar ose (maksimalisht të mbuluar). Ndërmjet shpejtësisë së rrëfimit krijohet elipsa që është mjaft e pranishme në poezitë e Lasgushit, sidomos ajo frontale e cila ve ndërprerje në vazhdimësinë kohore, (me kërcimin e një ose disa momenteve kohore)¹²⁸

Bota e ndryshon figurën e saj-tempora mutantir, et nos mutamur in illis (lat.-kohët ndryshojnë dhe ne ndryshojmë bashkë me to). Se ne e njohim atë vetëm në formën e figurës sonë psikike të brendshme dhe, kur kjo e fundit ndryshon, nuk është gjë e lehtë të konstatojmë se çfarë është ndryshuar-vetëm bota, vetëm ne, apo edhe bota bashkë me ne.¹²⁹

Liria intelektuale është rezultat i mendjes që ka njohuri të qartë për motivet abstrakte ose konkrete të veprimit. Kjo ndodh kur mendja nuk është e preokupuar me pasione ose substanca të cilat do ta kishin ndry-

¹²⁶ Zdenko Skreb&Ante Stamac, (1986), Uvod u knjizevnost, Globus, Zagreb, f. 512.

¹²⁷ Lasgush Poradeci, (1978), Vdekja e Nositit, Rilindja, Prishtinë, f. 71.

¹²⁸ Xherald Prins, (2001), Fjalori narratologjik, Detska Radost, Shkup, f. 42.

¹²⁹ Carl Gustav Jung, (2010), Ese mbi gjurmimin e pavetëdijes, Fan Noli, Tiranë, f. 218.

shuar.¹³⁰

Krijimi është një punë serioze dhe autorët jo rrallë, në histori e kanë paguar me jetë. Fati tragjik i artistit është paga për aktin krijues. *Fati dhe jeta e shkrimtarit është fond i artë i vlerës së krijimit të tij*¹³¹. Kjo duket qartë në fatet e shumë shkrimtarëve të realizmit socialist: Lasgush Poradecit, Mitrush Kutelit, Xhevahir Spahiut, Bilall Xhaferit, Martin Camajt, Visar Zhiti, Petro Marko, etj.

Jeta e rëndë, puna krijuese e ndërprerë në mes, ose braktisje e saj nën presion, kërcënim, e censurim, mosrealizimi deri në fund i veprave të tyre artistike, mosrealizimi i ideve, vite të vjedhura, janë dukuri e shumë shkrimtarëve të letërsisë artistike në gjithë botën.

Studiuesi rus Berxhajej, mërzinë dhe mallëngjimin e përshkruan si veçori të lirikës, që i përket të kaluarës dhe shpreh sinqeritet, ndërsa tmerrin si kategori estetike e lidh me përjetësinë, shkrimtar të tmerrit ai e quan Dostojevskin¹³²

BIBLIOGRAFI

- Poradeci, Lasgush (1978), Vdekja e Nositit, Rilindja, Prishtinë.
Mjeda, Ndre (1978), Vepra, Rilindja, Prishtinë.
Prins, Xh. (2001), Fjalori i narratologjisë, Detska Radost, Shkup.
Migjeni, (1978), Vepra, I, II, Rilindja Prishtinë.
Noli, Fan (1964), Sulm e lot, Nolit, Beograd.
Fishta, Gjergj (2001), Vepra, Dukagjini, Pejë.
Shopenhauer, Artur, (1999), Bota si vullnet dhe përfaqësim, Plejad, Tiranë.
Jefferson, A. Robbey, D. (2004), Teoria Letrare Moderne, Albas, Tiranë-Tetovë.
Borev, Jurij (2008), Estetika, Makedonska reč, Shkup.
Jakobson, R. (1966), Lingvistika i poetika, Nolit, Beograd.
Bašlar, G. (1969), Poetika prostora, Nolit, Beograd.
Jung, Carl Gustav (2010), Ese mbi gjurmimin e pavetëdijes, Fan Noli, Tiranë.
Kant, Immanuel, (1990), Mbi të bukurën dhe të madhërishmen, Rilindja, Prishtinë.

¹³⁰ Arthur Shopenhauer, (1999), Bota si vullnet dhe përfaqësim, Plejad, Tirane, f. 4.

¹³¹ Jurij Borev (2008), Estetika, Makedonska reč, Shkup, f. 482.

¹³² Jurij Borev (2008), Estetika, Makedonska reč, Shkup, f. 120.

Flakron Shabani (2019), Temë magjistrature, Vizioni i së ardhmes në veprat distopike të Georg Orwell-it dhe Aldous Huxley-it, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup.

LULJETA ADILI-ÇELIKU
l.adili@ukim.flf.edu.mk
Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” Shkup
MERAL SHEHABI-VESELI
m.shehabi@seeu.edu.mk
Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë

FJALËFORMIMET PARASHTESORE DHE PRAPASHTESORE TE DISA POEZI TË LASGUSH PORADECIT

Në këtë punim janë mbledhur në një vend krijimet ndajshtesore të Lasgushit të gjetura në vepren e tij me poezi “Ylli i zemrës”. Lasgushi e ka ndier rëndësinë e krijimit të fjalëve me ndajshtesa, prandaj gjejmë në poezinë e tij një numër të madh fjalësh të prejardhura të kësaj natyre, fjalë parashtesore dhe prapashtesore, rrugë kjo e nisur nga shkrimtarët shqiptarë pararendës. Ai do të mbetet i famshëm dhe i përjetshëm me krijimet e tij gjuhësore, sidomos për fjalët të përngjitura dhe të përbëra nga më të çuditshmet, por gjithmonë gjuhësisht korrekte, për fjalët e përbëra të ngjitura me vizë në mes, për fjalët me prapashtesa si: -ushe, -anjak. Poezia e tij është është burim studimit, si letrar ashtu edhe gjuhësor. Janë të bukura dhe të veçanta fjalët ndajshtesore dhe janë në numër të madh, sidomos krijimet me prapashtesën –im dhe –je. Prej fjalëve parashtesore më i pasur është grupi me –pa, pastaj me –për, etj.

Në punim fjalët janë të grupuara në bazë të ndajshtesës me të cilën janë krijuar fjalët dhe çfarë kanë për rrënjë ose temë të njëjtat. Është përdorur metoda analitike, në fillim i kemi fjalët me parashtesa për të vazhduar me fjalët me prapashtesa.

HYRJE

Llazar Gusho, ai që më vonë do njihet me emrin artistik Lasgush Poradeci, lindi në vitin 1899 në Pogradec. Jeta e tij u shtri në një periudhë gati 90-vjeçare, duke prekur periudha politike dhe letrare të ndryshme. I quajtur “romantiku i fundit” nga disa dhe i vetëshpallur “zog i qiejve”, poeti i vargut: “Më pat lindur vendi i zotit e bëj punën e njeriut”, do mbetet gjithmonë i madh për ta nxënë romantizmi dhe po aq i madh për t’u vendosur te realizmi. Ndoshta ashtu si edhe vetë

qenia e tij fizike e cila nuk i takonte asnjëherë asnjë kohe, edhe poezia e tij do të mbetet e tillë: e të gjitha kohërave dhe e asnjëres njëkohësisht. Lasgushi na del përpara si një ndër shkrimtarët më të koklavitur që njih gjithë historia e letërsisë shqipe; dhe jo vetëm aq, ai është filozof, publicist, njohës i sa e sa gjuhëve të huaja dhe përkthyes i shkrimtarëve me renome botërore, piktor dhe erudit. I rritur dhe i shkolluar në qytete të ndryshme, duke studiuar me dhjetëra shkolla njëkohësisht dhe duke mësuar në po aq gjuhë të huaja, Lasgushi i solli letërsisë jo vetëm lirizmin e rafinuar, por edhe vulën e rëndë që bart njohësi dhe eruditi i madh.

Zëri i tij mbeti unik dhe besnik ndaj vetes, duke nëpërkëmbur dhe duke shpërfillur si kohën e mbretërisë dhe vetë mbretin, ashtu edhe periudhën komuniste në krye me diktatorin e saj. Lasgushi mund të bartë fare lehtë titullin: i shpërfilluri shpërfillës, dhe në këtë togfjalësh përmbli-dhet marrëdhënia e tij me kohën ku jetoi dhe epokat që i ranë për pjesë t'i kalojë. Ndonëse në fillim qe kaq i pranishëm në qarqet dhe klubet letrare dhe i trumbetuar si një ndër poetët që letërsia shqipe do t'i dhuronte letërsisë së përbotshme, më vonë kaq i tërhequr nga sytë e publikut, i lënë në harresë, i dënuar në heshtje dhe përçmim, sidomos nga qeveritarët smirëzinj dhe meskinë të kohës. Natyrisht, kjo ishte në sipërfaqe, se në thellësi, aty ku sendet ruajnë thelbin, Lasgushi mbeti gjithmonë ai, i madhi, ashtu si e mendonte veten: sovran i vargut lirik, erotik, intim, plot pasion, i thjeshtë po i rrahur mirë, i tjetërlojtë. Ai që me aq lehtësi mund të shkruante një poezi kushtrimi, aq lehtëazi mund t'i shkruante Drinit apo liqenit të Pogradecit. Pa përmendur këtu lavdet për dashurinë, si për atë tokësoren, të zakonshmen, që takohet në rrugë, apo për vajzat që mbushin ujë te kroi i fshatit, po edhe për atë të mbi-kësojetshmen, që nuk vdes kurrë, malli për të cilën është si ai malli i yjeve që ndizen dhe digjen flakë për njëri-tjetrin.

Duke lënë anash të gjitha llojet e mundshme të konformizmit, qoftë letrar apo jashtëletrar, Lasgushi rrëzon përdhe gjithë normën e deriatëhershme poetike, ndërsa mjeti magjik me të cilin e arrin këtë është pikërisht gjuha e tij. Një shekull mbi tokë, një shekull patriark i poezisë shqipe, i lirikës së rrahur mirë, i vargjeve të shkurtra dhe të gjata, perandor i vargut shqip; ai që gjithë jetën kishte mësuar në gjuhë të

huaj, por që i kthyer në vendlindje, krijoi perlat e lirikës shqipe duke nisur me të edhe poezinë moderne shqipe.

Fjalëformimet ndajshesore

Parashtesimi

Në gjuhën shqipe dallohen mbi njëzet parashtesa, por vetëm një pjesë e tyre janë bërë prodhimtare¹³³. Lasgushi, veprën e të cilit e kemi për objekt studimi, e ka ndier rëndësinë e krijimit të fjalëve me parashtesim dhe kanë krijuar një numër të madh fjalësh të prejardhura të kësaj natyre, fjalë parashtesore. Por, ne nuk mund të vërtetojmë se cilat janë krijime të tij e cilat nuk janë. Ne i kemi analizuar të gjitha fjalët parashtesore të gjetura në poezitë e tij të veprës “Ylli i zemrës”

Parashtesat që janë hasur në këtë vepër janë: *për-, pa-, mos-*.

Zakonisht me anë të parashtesimit nuk ndërrohet kategoria leksiko-gramatikore, po kemi një kuptim të ri, pra kemi lëvizje leksiko-semantike të po asaj kategorie, po e përdorur me një ngjyrim tjetër¹³⁴.

Më poshtë kemi fjalët parashtesore të hasura në poezitë e Lasgushit.

Krijime me parashtesën –për:

a) Mbiemra prejfoljorë (nga një folje e prejardhur me parashtesën për-):

i /e përlotur (krh.folja përlos/përlothem- për-+emri lot); i / e përflakur (krh. folja përflak- për- + emrin flakë)

b) Fjalë me temë foljore:

përmbys (krh.për-+ folja mbys); përhap (krh. për- + hap); përndris (krh. për- + folja ndris); përdredh (krh. për- + folja dredh); përqas (krh. për- + folja qas); përshkruaj (krh. për- + shkruaj), përvëloj (krh. për- + folja v(ë)loj).

Krijime me parashtesën -stër

stërnip (stër+ emri nip) , stërmadh (stër + mbiemri i,e madh (e)) dhe një fjalë e cila njëkohësisht është edhe me parashtesim edhe me prapashtesim, fjala stërgjyshërishte (stër+ emri gjysh+ -ishte), stërkalë (që në fakt është emri konkret i derivuar nga folja stërkas).

¹³³ Gramatika e gjuhës shqipe I. Tiranë, A.Sh.Sh., 1995, faqe 133.

¹³⁴ Jani Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, Botimet Dudaj, 2005, faqe 147.

Krijime me parashtesën -pa

a) Emrat me pa- :

padija (krh. pa- + emrin dija); paanësi (krh. pa- + emrin anë+si);

b) mbiemrat i gjejmë të prejardhur nga një emër dhe akoma më shpesh nga një mbiemër prejfoljor, ndonëse tek-tuk ndonjë mbiemër jo prej-foljor.

i/e papandehur (krh. pa- + mbiemri prejfoljor pandeh/pandehur); i/e pafaj (krh. pa- + faj); i/e i/e pashijuar (krh. pa- + folja shijoj/ shijuar); i/e pasharë (krh. pa- + folja shaj/ sharë); i/e palëpirë (krh. pa- + folja lëpij/ lëpirë); i/e pazembruar (krh. pa-+ folja zembroj /zembruar-varianti dialektor i foljes zemëroj); i/e pakuptuar (krh. pa- + folja kuptoj/ kuptuar); i/e pahirë (krh. pa- + emri hir); i/e pashuar (krh. pa- + folja shuar); i/e palënduar (krh. pa- + folja lëndoj/ lënduar); i/e pavajtuar (krh. pa- + folja vajtoj/ vajtuar); i/e paçmuar (krh. pa- + folja çmoj/ çmuar); i/e pashembëllyer (krh. pa- + folja shëmbëllej/ shëmbëllyer); i/e pashtruar (krh. pa- + foljen shtroj); i/e pakënduar (krh. pa- + foljen këndoj/ kënduar); i/e pashijuar (krh. pa+ foljen shijoj);i/e palëmpirë (krh. pa- + folja lëpij/lëpij/lëmpirë); i/e palëmueshëm/me (krh. pa- + mbiemri i/e lëmueshëm/me); i/e paçmuarshëm/me (krh. pa- + i, e çmuarshëm/ me- zgjerim i mbiemrit i, e çmuar me prapashtesën – shëm/me); i/e pamëshirshëm (krh. pa- + i/e mëshirshëm/me). Tre mbiemrat e fundit janë në fakt mbiemra të formuar në mënyrë të përzier, kemi aty parashtesën pa-, rrënjën e fjalën, që është një emër ose një mbiemër prejfoljor, dhe prapashtesën –shëm. Kjo formë fjalëformimi është kaq e shpeshtë dhe kaq pasuruese në gjuhën shqipe.

Krijime me parashtesën -mos

Në poezinë e analizuar kemi arritur të gjejmë vetëm katër fjalë me të, dhe atë tre mbiemra dhe një emër abstrakt.

a) Emri me mos-: mosgjë (krh. parashtesa mos- + emri gjë).

b) Mbiemrat me mos+ folje në pjesore: i/e moskuvenduar (krh. parashtesën mos- + foljen kuvendoj/ kuvenduar); i/e mosfjalosur (krh. para-shtesën mos-+ foljen fjalos/ fjalosur); i/e mosbindur (krh. parashtesën mos- + foljen bind/bindur).

Krijimet prapashtesore

Prejardhja prapashtesore është mënyra e formimit të fjalëve të reja me anë të prapashtesash që bashkohen me tema fjalësh¹³⁵. Tema e një fjalë mund të jetë e parme, e prejardhur, e përbërë ose e përngjitur. Siç e përmendëm edhe më lart fjalët të formuara me prapashtesim janë më të shumta edhe në gjuhën shqipe, por edhe të fondi i fjalëve të analizuara në këtë punim.

*“Prapashtesat në përgjithësi kanë funksion klasifikues, d.m.th. ato bashkë me kuptimin e ri që japin temës së cilës i ngjiten, përcaktojnë edhe pjesën e ligjëratës ku hyn fjala e re”*¹³⁶

Më poshtë kemi analizuar fjalët prapashtesore të hasura në poezinë e Lasgushit.

Fjalët me prapashtesën –im

Te Lasgushi kemi gjetur një numër të mirë të fjalëve me prapashtesën –im. Lasgushi del si vazhdues i traditës për pasurimin e gjuhës me anë të formimit të fjalëve të reja. Përveç fjalëve të gjetura në letërsinë e traditës, te Lasgushi kemi edhe përshkënditje të veta dhe vula e tij krijuese duket qartazi. Edhe këtu, në gjuhën e Lasgushit, sikurse në gjuhën shqipe, foljet e zgjedhimit të parë, foljet me –oj, me përjashtime të vogla edhe foljet me –ej, marrin këtë prapashtesë fjalëformuese, ndër më prodhimtaret në gjuhën shqipe.

P.sh.: shëmbëllim (krh. foljen shëmbëllej+ -im); vështrim (krh. foljen vështroj+ -im); gëzim (krh. foljen gëzoj+ -im); dëshirim (krh. foljen dëshiroj+ -im); burim (krh. foljen buroj+ -im); mjerim (krh. foljen mjeroj+ -im); ëndërrim (krh. foljen ëndërroj+ -im); shkëndijim (krh. foljen shkëndijon+ -im); fjalim (krh. foljen fjaloj+ -im); kullim (krh. foljen kulloj+ -im); rënkim (krh. foljen rënkoj+ -im); perëndim (krh. foljen perëndoj+ -im); përpilim (krh. foljen përpiloj+ -im); udhëtim (krh. foljen udhëtoj+ -im); harrim (krh. foljen harroj+ -im); lavdërim (krh. foljen lavdëroj+ -im); fluturim (krh. foljen fluturoj+ -im); ngashërim (krh. foljen ngashërej+ -im); këndim (krh. foljen këndoj+ -im); pushim (krh. foljen pushoj+ -im); dëgjim (krh. foljen dëgjoj+ -im); trashëgim (krh. foljen trashëgoj+ -im), shoqërim (krh. foljen

¹³⁵ Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, A.Sh.Sh, 1995, faqe 63.

¹³⁶ Ibid, faqe 31.

shoqëroj+ -im); çfrenim (krh. foljen (ç)frenoj+ -im); gjykim (krh. foljen gjykoj+ -im); pasqyrim (krh. foljen pasqyroj+ -im); mblerim (krh. foljen (m)bleroj+ -im); thellim (krh. foljen thelloj+ -im); pipëllim (krh. foljen pipëllon+ -im); kushttrim (krh. foljen kushtroj+ -im); agim (krh. foljen agon+ -im); zotërim (krh. foljen zotëroj+ -im); çqetësim (krh. foljen çqetësoj+ -im); ëndërrim (krh. foljen ëndërroj+ -im); vështrim (krh. foljen vështroj+ -im); zbardhëllim (krh. foljen zbardhëllon+ -im); dyshim (krh. foljen dyshoj+ -im); bashkim (krh. foljen bashkoj+ -im); shkrepëtim (krh. foljen shkrepëtin+ -im); tingëllim (krh. foljen tingëlloj+ -im); mendim (krh. foljen mendoj+ -im); kuptim (krh. foljen kuptoj+ -im); mërgim (krh. foljen mërgoj+ -im); vetëtim (krh. foljen vetëtin+ -im); ndërrim (krh. foljen ndërroj+ -im); valim (krh. foljen valojoj+ -im); dënim (krh. foljen dënojoj+ -im); ushqim (krh. foljen ushqej+ -im); mjerim (krh. foljen mjeroj+ -im); shërim (krh. foljen shërojoj+ -im); hidhërim (krh. foljen hidhërojoj+ -im); kujtim (krh. foljen kujtojoj+ -im); mallëngjim (krh. foljen mallëngjejoj+ -im).

Fjalët me prapashtesën -je:

a) Emra abstraktë me prejardhje prejfoljore:

vuajtje (folja vuaj/ vuajtur + je); vërejtje (folja vërej/ vërejtur+ je); bërtitje (folja bërtas/ bërtitur+ je); pulitje (pulit/ pulitur + je); pamje (folja shoh/ varianti dialektor verior i pjesores- pamë + je); çmallje (folja çmall/ çmallur+ je), heshtje (folja hesht/heshtur + -je), dhembje (folja dhemb/dhembur + -je); psherëtitje (folja psherëtij/psherëtitur + -je);

Kemi gjetur edhe një fjalë e cila është emri prejfoljor të një foljeje të përbërë: buzëqeshje (krh. folja buzëqesh+ je).

Fjalët e formuara me prapashtesën -(ë)ri :

a) Emrat e krijuar nga emra:

Vajzëri (krh. emrin vajzë+ -ri); nusëri (krh. emrin nuse+ -ëri); fjalëri (krh. emrin fjalë+ -ri), vjershëri (krh. emrin vjershë+ -ri); trimëri (krh. emrin trim+ -ëri); toskëri (krh. emrin toskë+ -ri); gegëri (krh. emrin gegë+ -ëri); djalëri (krh. emrin djalë+ -ri); shokëri (krh. emrin shok+ -ëri); mizëri (krh. emrin mizë+ -ëri); zhurmëri (krh. emri zhurmë+(ë)ri).

b) Fjalët e krijuara nga mbiemrat:

madhëri (krh. mbiemrin i/e madh(e) + -ëri) varfëri (krh. mbiemrin i/e varfër+ -ëri);

Dhe natyrisht, në këtë vazhdë klasifikimi, do përmendim fjalën marrëzi (krh. i/e marrë+ -ëzi);

Fjalët e formuara me prapashtesën me – (ë)si :

a) Fjalët e krijuara nga emra:
gjuhësi (krh. emrin gjuhë+ -ësi); therorësi (krh. emrin theror+ -ësi);

b) Fjalët e krijuara nga mbiemrat:
poshtërsi (krh. mbiemrin i/e poshtë+ -ësi); ligësi (krh. mbiemrin i/e lig+ -ësi); vogëlsi (krh. mbiemrin i/e vogël+ -ësi); paanësi (krh. mbiemri i/e paanë+ -ësi); dëlirësi (krh. mbiemri i/e dëlirë+ -ësi);

c) Fjalët e krijuara nga ndajfoljet:
përjetësi (krh. ndajfoljen përjetë+ -ësi); lartësi (krh. ndajfoljen lart + -ësi); përjashtësi (krh. ndajfoljen përjashtë + -ësi); përbrëndësi (krh. ndajfolja përbrënda+ -ësi).

Fjalët e formuara me prapashtesën me –shëm/ shme –shëm:

a) Mbiemrat e formuar nga emrat:
i/e vetëtish/ëm(e) (krh. emrin vetëtimë* + -shëm); i/e potersh/ëm(e) (krh. emrin potere+ -shëm); i/e tmerrsh/ëm(e) (krh. emrin tmerr + -shëm); i/e përrallshëm (krh. emrin përrallë + -shëm); i/e harmonishëm (krh. emrin harmoni + -shëm); i/e madhërishëm (krh. emrin madhëri + -shëm); i/e perëndishëm (krh. emrin perëndi +-shëm); i/e vetëdijshëm (krh. emrin e përbërë vetëdije+ shëm).

b) Mbiemrat e formuar nga foljet: i/e përmallshëm, (krh. pjesorja e foljes përmall/përmallur+ shëm); i/e përbuzshëm (krh. pjesorja e foljes përbuz/përbuzur+ shëm);

c) Mbiemrat e formuar nga ndajfoljet dhe në mënyrë të përzier: i/e për-jetshëm/me (krh. ndajfoljen përjetë + -shëm); Këtu do përmendim edhe mbiemrat që janë karakteristikë për gjuhën e Lasgushit dhe që, me sa duket, të paktën disa prej tyre, janë gjetje e tij kryekëput; i/e përmbi-varrshëm (krh. përcaktori përmbi varr + -shëm); i, e pamëshirshëm (krh. parashtesa pa + emri mëshirë + -shëm); i/e palëmueshëm (parashtesa+ pjesorja e foljes lëmoj/lëmue+ shëm); i/e përvojshëm (krh. parashtesa për+ emri vaj+ shëm).

Fjalët e formuara me prapashtesën -eshë:

Te poezitë e analizuara kemi hasur vetëm tri fjalë me këtë prapashtesë si: pëllumbeshë (krh. emrin pëllumb+ -eshë); perëndeshë (krh. emrin perëndi+ -eshë); mikeshë (krh. emrin mik+ -eshë).

Fjalët e formuara me prapashtesën –ës:

a) Emra e formuar nga emrat:
vetëditës (krh. emrin vetëdije+ -ës),

b) Emra e formuar nga foljet:
ndalës (krh. foljen ndal+ -ës); trashëgonjës (krh. foljen trashëgoj + ës),
kjo është prapashtesa –ues, varianti toskë i saj.

Fjalët me prapashtesa -anjak

Me këtë prapashtesë kemi gjetur të njëjtën fjalë varfanjak (krh. mbiemrin i varfër + -anjak).

Fjalët me prapashtesa -arak

Te Lasgushi haset mbiemri brymarak/e (krh. brymë + -arak) dhe vjeshtarak (krh. emri vjeshtë + -arak).

Fjalët e formuara me –or :

a) Fjalët (mbiemrat) me –or të formuara nga emrat:
mëngjesor (krh. emrin mëngjes+ -or); qiellor (krh. emrin qiell+ -or);
zemëror (krh. emrin zemër+ -or) madhështor (krh. emrin madhështi+ -
or); malor (krh. emrin mal+ -or); pikëlor (krh. emrin pikël+ -or);
gazmor (krh emrin gaz(m) + -or); dasmor (krh. emrin dasmë+ -or);
vjeshtor (krh. emrin vjeshtë+ -or); helmor (krh. emrin helm+ -or); veror
(krh. emrin verë+ -or); vajzëror (krh. emrin vajzëri+ -or).

b) Fjalët me –or të formuara nga mbiemrat: mitor (e) (krh. mbiemrin i mitur+ -ore); fjalën gjelbëror (e) (krh. mbiemrin i/e gjelbër).

Fjalët e formura me prapashtesën –ar:

Fjalët e gjetura me këtë prapashtesë janë me tema emërore, mbiemërore dhe foljore. E këtij grupi është fjala llaftar/llahtar, dhe të gjitha derivatet e mundshme të saj: llaftari, llaftari, është qendrore në veprën e Lasgushit. Është një nga fjalët me karakteristike dhe me të përdorshme të tij.

a) Fjalë me temë emërore:
djaloshtar (krh. emrin djalosh+ -ar); botar (krh. emrin botë + -ar); katu-
ndar (krh. emrin katund + -ar); laftar (krh. llaht? + -ar);

b) Fjalë me temë mbiemërore:
mitar (krh. mbiemrin i/e mitur + -ar);

c) Fjalë me temë foljore:
ledhatar (krh. foljen ledhatoj + -ar).

Fjalët e formuara me prapashtesën –tar:

Fjalët e mëposhtme, pothuajse pa përjashtim mund të merren edhe si emra, edhe si mbiemra. Dhe është e natyrshme që të mund të lakohen lirshëm edhe në gjininë femërore.

dëshmitar (krh. emrin dëshmi + -tar); pishtar (krh. emrin pishë +-tar); lajkatar (krh. emrin lajkë +-tar); gjakatar (krh. emrin gjak + -atar/varianti i zgjeruar me -atar); çpërblimtar (krh. emrin çpërblim/ shpërblim + -tar); zyrtar (krh. emrin zyrë + -tar); luftëtar (krh. emrin luftë + -tar); udhëtar (krh. emrin udhë + -tar); mendimtar (krh. emrin mendim + -tar); vërbimtar (krh. emrin vërbim + -tar), magjisttar (krh. emrin magji +-tar); vetëtimtar (krh. emrin vetëtim + -tar); mendimtar(e) (krh. emrin mendim + -tar/e); dyshimtar(e) (krh. emrin dyshim + -tar/e).

Fjalët e formuara me prapashtesën –ëz:

Prapashtesa me e përdorshme me kuptim përkëdhelie dhe zvogëlimi për gjininë femërore është prapashtesa –zë. Në poezitë e analizuara gjejmë vetëm emra dhe tek-tuk ndonjë mbiemër që fare mirë mund të emërohet me këtë prapashtesë, si: pushkëzë (krh. emrin pushkë + -zë), këngëz (krh. emrin këngë + -zë), vashëz (krh. emrin vashë+ (ë)zë), mesditëz (krh. ndajfoljen mesditë + -z); leshverdhëza (krh. emrin leshverdhë + -z); shoqezë (krh. emrin shoqe + -zë); hapëz (emri hap/e + zë); thembërz (emri thembër + (ë)zë); gropëz (krh. emrin gropë+ (ë)zë); shkollëz (krh. emrin shkollë + -z); hapëz (krh. foljen hap + ëz); napëz (krh. emrin napë + -z); lundërz (krh. emrin lundër + -z); gunëz (krh. emrin gunë + z); kunëz (krh. emrin kunë + -z).

Fjalët me prapashtesën –ush (e):

Fjalët me prapashtesën –ushe me temë emërore: plakush (krh. emrin plak + -ush); trimush/e (krh. emrin trim + -ushe); gjarpërushe (krh. emrin gjarpër + -ushe);

a) Fjalët me prapashtesën –ushe me temë mbiemërore:

bardhushe (krh. mbiemrin e bardhë + -ushe); vogëlushe (krh. mbiemrin e vogël + -ushe); mjerushe (krh. mbiemrin e mjer + -ushe); sylarush(e) (krh. sylarë+ ushe (e)).

Fjalët me prapashtesën –osh/e:

a) Fjalët me prapashtesën –oshe me temë emërore: trupëroshe (krh. emrin trup + -osh/e);

b) Fjalët me prapashtesën –osh/e me temë mbiemërore:

vogëlosh/e (krh. mbiemrin i vogël + -osh/e); fatmiroshe (krh. emrin i përbërë fatmir + -osh/e);

Fjalët me prapashtesën –isht:

Te Lasgushi me -isht kemi hasur ndajfoljet me tema emërore dhe mbiemërore: dhemshurisht (krh. emrin dhemshuri + -isht); tmerrisht (krh. emrin tmerr + -isht); lirisht (krh. emrin liri + -isht); miturisht (krh. mituri + -isht); madhërisht (krh. madhëri+ isht); çmendurisht (krh. emri çmenduri+ isht); gjeratorisht (krh. emrin gjeratore + -isht).

Përveç që kemi emra, me këtë prapashtesë kemi hasur edhe mbiemra që janë karakteristike për gjuhën popullore. “Disa mbiemra të panyjshëm me *-ishte* të gjuhës popullore kanë dalë nga ndajfoljet me *-isht* me anë të mbaresës *-e* të mbiemrave femërore.” Të tilla formimi janë:

pleqërishte (krh. emrin plak/ pleqëri + -ishte). Fjala pleqërishte nuk e ka kuptimin vendi se ku rrinë pleqtë, por ka kuptimin e mbiemrit, e vje-tër, që i takon kohës së shkuar; stërgjyshërishte (krh. emrin stërgjyshër + prapashtesa ishte), gjithashtu edhe ky mbiemër i Lasgushit nuk e ka kuptimin vend stërgjyshërish, por ajo që u takon stërgjyshërve; shokërishte (krh. emrin shokëri + -ishte); armiqërishte (krh. emrin armik + -ishte); dhemshurishte (krh. emri dhembshuri + -ishte).

Fjalët e formuara me prapashtesën –të:

i/e hirtë (krh. emrin hi/ hiri + -të); i/e shkretëtirtë (krh. emrin shkretëtirë + -të); i/e brrytlë (krh. emrin bërriyl + -të); i, e shkrepëtimtë (emri prejfoljor shkepëtim + -të); i, e zbetë (krh. folja zbeh + -të).

Përfundim

Lasgushi me një shekull jetë siguroi përjetësi në letrat shqipe. Studiuesit e gjuhës së tij që qëmtuan fjalët e tij duke i analizuar ato sipas formimit të tyre, janë dëshmuar të zhdërvjelltësisë dhe korrektësisë së tij gjuhësore, njohjes së thellë të ligjeve të shqipes dhe krijimin e fjalëve të reja duke u mbështetur në gjedhet ekzistuese të cilat megjithatë nuk e penguan atë të shkëlqejë me përzgjedhjen e duhur dhe përfitimin stilistik të vargjeve tij. Lasgushi e kishte gjetur më në fund minierën nga ku do të nxirrte stolitë e tij dhe kjo minierë ishte gjuha shqipe.

Krijimet lasgushiane e vulosën pavdekësinë e poetit, gjuhës i dha fjalë me një bukuri të veçantë ndërsa letërsisë poezi “himne”.

Punimi mëton që të ndihmojë në fushë të studimeve gjuhësore në përgjithësi e në fushë të fjalëformimit në veçanti në gjuhën shqipe.

BIBLIOGRAFI:

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Tiranë, 1973

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe. Tiranë, 1976

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Fjalori i gjuhës shqipe. Tiranë, 2004

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Gramatika e gjuhës shqipe I. Tiranë, 1995

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Gramatika e gjuhës shqipe II. Tiranë, 1995

Çabej, Eqrem. Studime gjuhësore III, Prishtinë: Rilindja 1977

Hysa, Enver. Formimi i emrave në gjuhën shqipe. Tiranë: A.Sh.Sh., 2004

Islamaj, Shefkije. Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1985

Islamaj, Shefkije. Gjuha e Jakov Xoxës. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2000

Kasnci, Miranda. Fjalëformimi në veprat e gjergj Fishtësh. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2000

Kostallari, Androkli. Pjetër Bogdani dhe gjuha letrare shqipe. Tiranë 1998

Krifca, Mirlinda. Dialog me poezinë e Lasgushit. Shkup: Vatra, 2000.

Lafe, Emil. Fjalori për pastërtinë e gjuhës shqipe, Tiranë, AShSh, 1998

Latifi-Xhanari, Lindita. Mbi mënyrën e fjalëformimit në veprën e Kadaresë

Lyons, John. Semantics. Cambridge University Press, 1977

Mulaku, Ragip. Parashtesat e prapashtesat në gjuhën shqipe në shkrimet e vjetra. Prishtinë: 1998.

Poradeci, Lasgush. Ylli i zemrës. Prishtinë: Rilindja, 1990.

Poradeci, Lasgush. Vepra I. Tiranë: Onufri, 1999.

Poradeci, Lasgush. Vepra II. Tiranë: Onufri, 1999.

Nesimi, Remzi, Gramatika e gjuhës shqipe. Shkup: 1999.

ETILDA KALIVACI
KLARA KODRA
etilda.kalivaci@hotmail.com
klarakodra@yahoo.com

MBI VLERAT STILISTIKORE TË LEKSIKUT DIALEKTOR DHE VETJAK TË LASGUSH PORADECIT

Në gjuhën e çdo poeti, dhe aq më tepër në gjuhën e një autori të shquar, realizohet një harmoni midis mesazhit dhe formës që lind vepra, të cilat i qëndrojnë kohës.

Në gjuhën e poetëve të mëdhenj, në radhën e të cilëve përfshihet edhe Lasgush Poradeci, çdo fjalë ka vendin e vet dhe karakterin e vet të papërsëritshëm që u përgjigjet mendimit, ndjenjës, tablove objektive të realitetit në mëvetësinë e tyre apo të ndërthurura mjeshtërisht njëra me tjetrën.

Gjuha poetike e Lasgushit përbën ende një thesar shumë pak të gërmuar nga studiuesit, me përjashtim të Mitrush Kutelit që e analizoi atë me mprehtësi me anë të metodës stilistike, dhe tani së fundi nga mjaft studiues që e kanë parë në këndvështrime të ndryshme.

Edhe autorja Klara Kodra i ka kushtuar një ese të shkurtër neologjizmave të këtij poeti dhe vendit të tyre në sistemin e tij poetik. Poradeci nuk i ka vënë për detyrë vetes, si Naimi dhe De Rada, krijimin e një gjuhe kombëtare që u mungonte ende në kohën e tij bashk-atdhetarëve, detyrë që, në thelb, do të realizohej nga Naimi, ndërsa nuk do të mund të vihej në jetë për arsye objektive nga De Rada. Ky poet i viteve 30-të në krijimtarinë e vet përqendrohet te gjuha poetike vetjake së cilës i jep një forcë shprehëse të jashtëzakonshme, një kolorit që e afron me pikturën me kombinime të efektshme hije-dritash dhe një pasuri të veçantë tingëlluese. Poezia e Lasgush Poradecit mishëron me muzikalitetin e vet karakteristik, ëmbëlsinë e gjuhës shqipe në një kryqëzim midis popullores dhe elites.

Rilindësit janë dalluar prej kultit të fjalës shqipe. Edhe Lasgushi, poet modern, e ka trashëguar këtë kult dhe përpiket ta zhvillojë potencialitetin e gjuhës shqipe, në atë kohë ende e papërpunuar mundësitë e saj shprehëse, duke krijuar një leksik poetik ku zënë mjaft vend nga një

anë fjalët krahinore që buronin nga populli, nga tjetra neologjizmat që krijon ai vetë. Po në gjuhën poetike të Lasgushit, krahas kombëtares, ndihet universalja, çka e ngre këtë gjuhë dhe poezinë që ajo mishëron në nivel evropian dhe universal.

Poradeci shfrytëzon pasurinë e tingujve të shqipës (plot tridhjetë e gjashtë) që e bëjnë tepër të veçantë këtë gjuhë midis simotrave europiane; veçon ëmbëlsinë e kësaj gjuhe që në leksikon e zakonshëm ndërthuret me rreptësinë; përzgjedh fjalët me ngjyrim emocional. Nga ana tjetër pasqyron një gamë të pasur ndjenjash dhe disa nocione të thella filozofike.

Lasgushi nuk u takon atyre poetëve që shkruajnë thjesht në të folmen e vendlindjes; ai zgjedh nga thesari i fjalëve krahinore ato që i duhen për të shprehur nuanca të veçanta emocionale dhe stilistike dhe i lartëson, duke i bërë pjesë të leksikut të vet poetik. Një fjalë krahinore e leksikut të Lasgushit që do ta veçonim, meqenëse ajo ngritur në lartësinë e fjalës-çelës, është *liqer*. Kjo fjalë e rotacizuar ka një ëmbëlsi e fluiditet që i mungojnë fjalës së zakonshme *liqen* në sajë të kombinimit të tingullit të butë *l* me tingullin e ashpër *r*.

Kjo fjalë endet në tërë krijimtarinë e Lasgushit si simbol i peizazhit të vendlindjes, si metaforë – simbol e lëngët. Ajo ka kuptime të ndryshme simbolike të cilat përpiqet t'i shpjegojë me mprehtësi dhe intuitë studiuesi Luan Topçiu kur pohon se “liqeri” lasgushian është vendi i pasqyrimin të botës reale dhe irrealë, antike dhe kozmike. Nëpërmjet këtij objekti ai ngre në nivel simbolik dy elemente: thellësinë dhe qartësinë.

Një tjetër kuptim që gjeneron në mënyrë simbolike kjo fjalë-temë është dhe ai i pushtimit të kthjelltësisë në thellësi. Në rrafshin piktorik është një kryeimazh, ku sillen kritike subjekte, personazhe¹³⁷.

Bashkohemi me këto interpretime të tij dhe shtojmë që, përmes kësaj fjale-temë ose fjalë çelës, poeti gjeneron një varg metaforash dhe simbolesh që rrezatojnë tërë krijimtarinë e tij. Këtu Lasgushi është i afërt me simbolistët dhe parnasianët, ithtarë të kultit të fjalës dhe spikat në letërsinë shqiptare, ku për një kohë të gjatë ka mbizotëruar karakteri qëllimor.

¹³⁷ L. Topçiu, *Tekstualizëm dhe stil*, Bukuresht, 2000, f. 170, 171.

Si një alkimist poeti ka marrë fjalën dialektore dhe përmes gurit filozofik të artit të tij e ka shndërruar në flori.

Në fakt fjala *liqer* është nga fjalët më të bukura dhe kuptimplote të leksikut lasgushian. Atë e ndeshim në disa prej kryeveprave të tij lirike, si: ‘Poradeci’, ‘Mëngjes’, ‘Dremit liqeri’, ‘Vdekja e nositit’, Kjo fjalë, jo vetëm krijon efekte eufonie dhe harmonie, po pikturon një imazh fluiditeti dhe tejdukshmërie përmes të cilit realiteti i zakonshëm ngrihet në lartësinë e poezisë.

Fjala çelës *liqer* është një simbol polivalent që lidhet me peizazhin e vendlindjes së Lasgushit, gjithnjë i pranishëm në nënvetëdijen e tij, me dashurinë dhe krenarinë e tij për bukurinë e kësaj vendlindjeje, me elementin *ujë* si element të brendshëm të vetëdijes njerëzore, simbol i pjellorisë, i përtëritjes së vazhdueshme, i amësisë.

Ky imazh lidhet me panteizmin e Lasgushit, me idenë e shkrirjes së njeriut me natyrën dhe Perëndinë që për poetin është një me natyrën. Fjala e zakonshme *liqen* nuk do të arrinte në krijimin e ndjenjës metafizike që ka arritur, përkundrazi te Lasgushi kjo fjalë është tek ai simbol dhe metaforë *obsesion*, krijuese e tablove, mendimeve, ndjenjave të panumërta që shkrihen me perceptimin objektiv të realitetit.

Një tjetër fjalë e afërt nga rëndësia me këtë fjalë çelës, edhe ajo dialektore, por që në poezinë e Lasgushit është shndërruar në një fjalë elitare të rafinuar, është *llaftari*, variant i fjalës *llahtarë* ose *llahtari*. Për çudi, si vëren studiuesi i sipërcituar, Topçiu, kjo fjalë tek Lasgushi i largohet kuptimit të origjinës, shprehjes së *tmerrit*, po “ngërthen në vetvete mjaft kuptime dhe e vendosur në kontekste të ndryshme poetike del sa e beftë aq edhe e ngjeshur”¹³⁸. Kjo fjalë gjeneron edhe mbiemrin *i llaftaruar* dhe foljen *llaftaron* me kuptime të afërta.

Këto fjalë lasgushiane ndryshojnë nga variantet e zakonshme *i llahtarshëm* dhe *llahtarisem* që ruajnë kuptimin origjinal.

Fjala e lartpërmendur arrin te poeti lartësira të paimagjinueshme fantazie dhe force shprehëse, shpreh *bukurinë e tmerrshme* të dashurisë – pasion ose *tmerrin metafizik* të pafundësisë. Edhe kësaj radhe, një fjalë si gur i zakonshëm i rrugës është shndërruar në gur të çmuar.

Një tjetër fjalë krahinore me interes të veçantë është fjala *junap*, variant

¹³⁸ Po aty, f. 158.

dialektor i fjalës pak të njohur *hunap*, një lloj shelgu i butë. Kjo fjalë spikat në florën poetike të Poradecit. Jo më kot poeti i drejtohet atdheut, duke e identifikuar me këtë bimë.

“*Tungjatjeta, tungjatjeta!*”

Vend, o vend ku çel junapi!”

Fjala *junap* zotëron një ëmbëlsi tingëllore që i vjen nga gjysmë bashkëtingëllorja nistore *j* dhe që fjala standarde nuk e ka, prandaj është e qartë arsyeja që autori e zgjedh dhe e përdor në poezinë e tij. Lasgushi përdor edhe fjalët dialektore *djellë* dhe *pikovi* që, me gjatësinë e tyre më të madhe në krahasim me fjalët e zakonshme *diell* dhe *pikoi*, krijojnë një jehonë që e përforcon muzikalitetin.

Në poezinë e Poradecit janë të pranishme edhe plot fjalë të tjera krahinore, si *kufir* që zotëron një lloj papërcaktueshmërie në krahasim me fjalën letrare *kufi*, *zembër* që përdoret bashkë me variantin fonetik letrar *zemër*, thjesht për efekte muzikore, fjalën *valomë* që e zgjeron dhe fuqizon kuptimin e fjalës së zakonshme *valë* si dhe fjalë që thjesht krijojnë larmi: *mejtimi*, *levorashe*, *shkitur*, *vilar*, *vramuz*.

Shkaqet kryesore të përzgjedhjes së fjalëve dialektore nga poeti janë stilistike dhe lidhen me larminë, forcën emocionale dhe muzikalitetin e rrallë të poezisë së tij. Këto fjalë varg s’ia ulin nivelin kësaj poezie, përkundrazi kontribuojnë në ngritjen e saj në nivele të larta. Leksikun e vet artistik që i shmanget, sipas ligjeve të poezisë, gjuhës së zakonshme (vetë Lasgushi pohonte se rregullat fonetike, morfologjike, sintaksore a drejtshkrimore qofshin, nuk vlejnë për poetët¹³⁹), autori e plotëson me fjalët e krijuara vetë, pra, me neologjizmat që ai i ndërton kryesisht nga brumi i shqipes duke shmangur fjalët nga gjuhët e tjera dhe duke parapëlqyer përftesat e krijuara me bazë prapashtesore dhe në ngjashmëri me Naimin dhe De Radën, fjalët kompozita që ndahen në reale dhe grafike. Sipas Kutelit, “neologjizmat e Lasgushit” pasqyrojnë njohuritë dhe mundësitë e shumta të shqipes si dhe artin e thellë të poetit”¹⁴⁰.

Poradeci ndërton gjithashtu një varg neologjizmesh me parashtesën - *për* që zotëron dhe sot një vitalitet gjenerues. Përftesat me prapashtesa

¹³⁹ Shih: Petraq Kolevica “Lasgushi më ka thënë”, Tiranë 1990, f. 133-134.

¹⁴⁰ M. Kuteli, *Poeti Lasgush Poradeci (Vëzhgim kritik)*, Bukuresht, 1937.

mund t'i ndash në disa degëzime semantike-strukture. Në gjuhën e poetit spikasin për denduri fjalët me prapashtesën *-uar*, si: *fatuar*. Fjalët e këtij grupi janë nga më të parapëlqyerat e Lasgushit dhe shpesh përftojnë rimat që te poeti nuk janë kurrë të sforcuara dhe artificiale dhe nuk zëvendësohen nga asonancat. Mund të kujtojmë ironinë me të cilën nobelisti Pirandelo polemizonte me një autor që e quante rimën artificiale, duke e futur në radhët e atyre që i kërkojnë rimat nëpër fjalorë.

Këto neologjizma krijohen nga poeti për vlerën e tyre tingullore, për të krijuar jehonë e nënvizuar mesazhin. Të ngjashme me to janë fjalët me prapashtesën *-or*, *-tor*: *veror*, *zemëror*, *fjalëtor*, *paqtor*, *hijesor*, *vajzëtor*, edhe këto shumë të dashura për poetin.

Mund të përmendim një ko incidencë kuptimplotë: edhe autori rilindës Santori parapëlqente këtë grup nga neologjizmat e veta. Mendojmë se vlera e këtyre fjalëve qëndron në bukurtingëllimin e tyre dhe në një lloj elitizmi që ua shton forcën shprehëse.

Një grup i veçantë është ai i neologjizmave të krijuara me prapashtesën *-ak* që në atë kohë s'e kishte kuptimin pejorativ që ka fituar sot, përkundrazi u jepte fjalëve një lartësim, një sublimim siç kërkojnë neologjizmat lasgushiane: *zemërak*, *vjeshtarak*, *lotak*, *varfanjak*, *krymarak*, *vraparak*. Këto fjalë si ato të grupit me *-uar* përdoren shpesh për efekte tingëllore, si rimëformuese. Disa fjalë janë krijuar me prapashtesën *-ushe* dhe kanë kuptim përkëdhelës dhe vendin e vet në lirikën erotike të Lasgushit, si: *vetullushe*, *fluturushe*. Ka edhe fjalë me prapashtesën *-ar*: *vetëtimtar*, *mitar* etj. Një grup më vete e përbëjnë fjalët me prapashtesën *(s)-irë*: *vetësirë*, *ndryshmësirë*, *fshehtësirë*, *fundësirë*, fjalë me ngjyrim emocional që shprehin nuanca të ndryshme kuptimi dhe janë në thelb tepër elitare, aq sa s'kanë gjetur përhapje, po kanë bashkë me shumë të tjera, tipike për leksikun lasgushian, funksionin e të shprehurit të ndryshimeve të tilla të mendimit dhe ndjenjës, që është shumë e vështirë të mishërohen me fjalë. Poeti me intuitë u ka gjetur mishërim tingullor.

Një grup tjetër fjalësh, edhe këto tepër elitare që dëshmon për fantazinë krijuese gjuhësore të poetit dhe njohjen e tij të ligjeve të brendshme të shqipes janë foljet përemërore të llojit: *botësoj*, *qiellësoj*, *kombësoj*,

shqipësoj.

Po t'u rikthehemi neologjizmave të ndërtuara me parashtesë, të larme dhe plot forcë shprehëse e thellësi janë fjalët e krijuara me parashtesën - për: *përshëndet, përkund, përmendet, i përhiqshëm, i përmallshëm, i përkohshëm*, midis të cilave dallojnë emrat e rrallë *përbrendësi, përjashtësi, përbrendje*, fjalë tipike lasgushiane. Këto fjalë e zotërojnë nganjëherë vendin e vet sinonimik, po kanë një kuptim më të thellë dhe intensiv se fjala binjake siç ndodh me fjalët *përjashtësi, përbrendësi, përgjithëjetë, përbuzshëm, përhumbet*.

Kompozitat dallohen në fondin e fjalëve të reja të krijuara nga Lasgushi për forcën e tyre sintetike dhe dinamizmin e tyre. Ato përbëhen jo vetëm nga dy elemente përbërëse, siç ndodhte te poezia e Naimit, po edhe nga tri e më shumë fjalë të bashkuara dhe të shkruara dhe në shumicën e rasteve luajnë rolin e epiteteve që vizatojnë profile ose portrete. Disa prej tyre fiksojnë gjendjen shpirtërore. Të gjitha këto fjalë, të krijuara me fantazi dhe guxim nga brumi i shqipes, kontribuojnë në atë që në krijimtarinë poetike të Lasgushit të ndihet një shkrirje e arteve e ëndërruar nga romantikët, afrimi i poezisë me muzikën, pikturën, skulpturën. Poezia e Lasgushit, siç e thamë, ka pikëtakime me poezinë e drejtimeve simboliste dhe parnasiane¹⁴¹, është një poezi që shquhet për shkallën e lartë të muzikalitetit, plasticitetit dhe dinamizmit dhe në këtë kontribuojnë kompozitat e tij, të mirëfillta ose grafike. Mund të përmendim fjalët *baluke-prera* që vizaton portretin e një vajze moderne, *gushë -e llërëgji bardhoshe* që nënvizon një tipar të trupit të vajzës, *bardhësinë*, një *bardhësi* që shkëlqen, *shtat-vërtitura-selvi* që vizaton profilin e një bukurosheje truphollë dhe të shkathët, *trup-lëkundurapallua* që e vizaton vajzën në lëvizje, *leshra- cullufe- dredhur* që evidencën bukurinë e një pjese të trupit të vajzës siç janë flokët në formën e tyre, fjala e ngjashme me të, *vashë-leshëra-floriri* nënvizon përkuandrazi ngjyrën e flokëve dhe përdoret nga poeti për të karakterizuar vajzën. Ka dhe fjalë që shprehin konceptin përparimtar të dashurisë te Lasgushi, ku kulti i gruas shkrihet me vështrimet e saj si shoqe e motër ("vashë – edhe shoqe – e motër e dashurisë/ Nuse dhe grua femër - varr

¹⁴¹ Vetë poeti s'ka pranuar kurrë të jetë simbolist, po mendojmë se është fjala për një rast ku poetika teorike ndeshet me poetikën që buron nga frymëzimi krijues.

- në zemër”).

Ndeshim edhe fjalë që shkrijnë portretin fizik me portretin moral të vajzës, duke nënvizuar thjeshtësinë dhe ndrojtjen e saj, si *sy-vështrim-derdhurën-përdhe*. Ka dhe fjalë që nxjerrin në dukje elemente të veçanta të portretit fizik femëror përmes optikës së heroit lirik si *gjak-qershije*, epitet – kompozitë që vizaton buzët e vajzës në ngjyrën e tyre të kuqe flakë, duke e bërë të ndihet lëvizjen e hollë të gjakut që e përshkon, duke i krahasuar me lëngun plot shije të qershisë, me një sensualitet të lehtë dhe fin, ose *gji-mbuluruara si krua*, që e vizaton gjirin e plotë të vajzës, duke e lidhur me amësinë e ardhshme sipas konceptit të shëndetshëm popullor të dashurisë. Ka edhe fjalë që i shmangen konkretësisë vizive dhe përkundrazi krijojnë një atmosferë fluiditeti dhe fshehtësie, si: *bilbil-finoshi*, ose *hije-lehtë, fshehtësiplotë, magjiplotë, flakëzhuritur, shigjetheluar*.

Në përftesat grafike, kur lidhja e fjalëve nuk arrin një shkrim të plotë, elementi i veçuar shihet në kuadrin e së tërës përmes një nyje lidhëse emocionale *e-ëmbra-mi shoqe shumë* (që e ndan vashën e dashuruar nga të tjerat) ose fjalët që e krijojnë kompozitën vizatojnë një tablo të gjerë kozmike, si: *flakë e dritë e bardhë, një qiell e thell e butë- ah!*

Ndodh që këto përftesa të lidhin dukuri të kundërta si *jetë e vdekje përqaftuar*. Një dukuri e veçantë është ndarja grafike me vizë e një fjale të plotë siç ndodh te vjersha “Po qan vasha në shtëpi”, në vargjet e fundit *ler- më-ni, merr-më-ni, ther-më-ni* ku bashkimi i fjalëve e ka zëvendësuar copëzimi për shkak të thellësisë dhe intensitetit të ndjenjave. Studiuesi Topçiu e shpjegon këtë dukuri, duke pohuar se “nga emocioni i lartë njeriu ‘humbet gojën’ dhe shqiptimi i fjalëve në rrokje... shënon gjendjen dramatike”¹⁴². Pra, fjala që ngjan si atom i pandashëm, këtu ndahet nga poeti përmes një truku gramatikor, vizës lidhëse, në pjesëzat e saj fonetike për të fuqizuar gjendjen shpirtërore. Tomashevski pohon se në poezi “fjalët e reja në sajë të një ligji që ai e quan ‘të traditës leksikore..., depërtojnë me vështirësi në strukturën e saj”.

Ne do të shtonim se poetët e mëdhenj thyejnë me magjinë e fjalës së vet tërë ligjet. Poezia e Lasgushit pasuronte fushën leksikore me fjalë

¹⁴² L. Topçiu, vep. e cit., f. 195.

elitare nga vetë burimi i gjuhës popullore shqipe, të thithura nga burimi i gjallë apo të krijuara nga vetë poeti. Shumë më vonë, poetët e avangardës të '60-ës do të estetizonin fjalorin teknologjik si Kadareja, ose fjalët e gjuhës së përditshme si Agolli.

Lasgushi qe një nga pjesëtarët e avangardës të viteve '30, pranë Nolit, Migjenit, Koliqit. Me gjuhën e vet poetike, komponentë të rëndësishëm të së cilës ishin fjalët dialektore dhe neologjizmat, ai do të arrinte lartësira. Në veçanti te ndjenjat dhe mendimet, ai përfton një muzikalitet të pakrahasueshëm dhe një thellësi të rrallë filozofike.

LITERATURË E CITUAR

Luan Topçiu, *Tekstualizëm dhe stil*, Bukuresht, 2000.

Petraç Kolecica, *Lasgushi më ka thënë*, Tiranë, 1990.

Mitrush Kuteli, *Poeti Lasgush Poradeci (Vëzhgim kritik)*, Bukuresht, 1937.

ERIS RUSI
Universiteti “Fan S. Noli”
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
eris.rusi@gmail.com

RRETHRROTULLIMI EROTIK: LIRIZMI I IMAZHEVE NË POEZINË E LASGUSH PORADECIT

Ky punim do të ndalet në horizontin krijues të njërit prej poetëve më përfaqësues e të dashur të letërsisë shqipe, Lasgush Poradeci, duke depërtuar në elementët e modernitetit të krijimtarinë e tij, në vizionin që i mundësohet lexuesi përmes përdorimit metaforik të gjuhës dhe në ndjesitë që depërtojnë përbrenda e lidhen me intimitetin e ndjenjave. Punimi në fjalë do të ndalet mbi një element që e bën të veçantë poezinë e Lasgush Poradecit: tejkohësia e imazhit erotik dhe lirika e dashurisë në përfytyrimin krijues të tij. Erosi është një imazh që mbështjell përfytyrimin poetik që në kohët e hershme, por mënyra se si e shohim të pranishëm në poezinë e Lasgush Poradecit është realizuar në nivelet më të larta artistike dhe zë fill nga vetë trajtat e shumëfishta që dashuria mund të marrë në vargjet poetike. Përmes këtij punimi do të fokusohemi tek lirizmi i imazheve në poezinë e Poradecit, në ndërthurjen e qasjes së dashurisë, pasionit dhe meditimit vetmitar, të treja këto shtigje që adresojnë tek shpirti i vetë individit. A ka filozofi në lirikën e dashurisë së Poradecit, e deri ku pasioni i nënshtrohet gjykimit dhe arsyes, do të jenë disa nga pyetjet që pritet të marrin përgjigje përmes shtjellimit të temës në fjalë. Lasgush Poradeci, i cilësuar si poeti idealist në parathënien e veprës së botuar pas vdekjes së poetit, nga Ismail Kadare, mbetet “Zog i qiejve” ku më të mirët prekin përjetësinë.

Shtegu i modernes dhe shekulli i ri XX

Nocioni i modernes zgjerohet dhe fikson konceptet e tij krijuese në fillim të shekullit XX. Modeli që filloi të përshtatej dhe të orientonte kulturat më të mëdha evropiane, vjen dhe në vendin tonë në format e një letërsie, ku kishte nisur gradualisht të krijohet dhe të bëhet e

qëndrueshme një kulturë letrare e ngjashme me atë të vendeve të tjera evropiane.

Rasti i shekulli të njëzetë, përkon pikërisht me mundësinë e letërsisë shqipe për t' u afruar dhe për të zvogëluar distancën me letërsinë e tjera evropiane. Nëse do na duhej të bënim një rrugëtim të shkurtër kohor, patjetër do të ndërmendnim distancat dhe vonesat e letërsisë shqipe, ku lëvizje letraro-kulturore që në Evropë ishin përmbyllur shekuj më parë, në Shqipëri mbërrinin me një jehonë të vonë, nisur edhe nga rrjedha, shpesh e turbullt e historisë së Shqipërisë, ku vonesa për të patur tekste të shkruara në gjuhën shqipe, ka qenë element i rëndësishëm frenimi¹⁴³. Me nocione "moderne" u ilustrua në letërsi shfaqja e një dukurie të re letrare në sistemin e vlerave, që përthyer në stile, në forma e trajta të shkrimit, e formatime letrare, domethënë paraqitet si theksimi i një vlere letrare, më të avancuar në krahasim me modelet pararendëse të shkrimit letrar artistik. Në fusha të ndryshme të artit dhe letërsisë, modernia mbulon përmasa të ndryshme semantike, estetike dhe stilistike, që dalin edhe në formë edhe në përmbajtje autonome. Risia dhe modeli i ri i letërsisë që vjen me përfaqimin e modernes në Shqipëri, ndryshe nga modelet pararendëse letrare, përfshin brenda tekstit letrar elementë të përhapur në letërsinë evropiane të kohës, që deri atëherë proza jonë s'i kishte njohur, apo që i kishte vetëm në fazën embrionale.

Modernia, kështu merr ngjyrimë duke u paraqitur edhe si shenjë e një ndryshimi, e një ecjeje para, që shfaqet në mënyrë refuzuese ndaj tradicionales. Duke u ikur modeleve të mëparshme tradicionale, trajtat e shkrimit të ri shpëputen nga letërsia e shekullit XIX dhe reflektojnë elementë që i mungonin letërsisë së Rilindjes me tipare thellësisht romantike.

Nga pikëpamja e shndërrimeve letrare, fillimi i shekullit XX në letërsinë shqipe është një kohë veçanërisht e dallueshme për disa arsye:

¹⁴³ Pra me mbarimin e shek. XIX mbyllet letërsia e Naimit dhe një periudhë e letërsisë shqiptare. Në këtë drejtim mund të vendoset një prerje ndërmjet letërsisë së Naimit (romantike) dhe letërsisë që nis me brezin e 1900-ës, ku hyjnë Çajupi, Asdreni, Konica, Fishta, Noli e Skëndoja, me një letërsi përgjithësisht romantike. Në të parën mbizotëron ideja kombëtare; në të dytën ideja shoqërore apo ideja njerëzore (Sabri Hamiti, "Letërsia moderne shqipe", 1998)

më 1900 vdes Naim Frashëri; po në këtë vit boton shkrimet e para Gjergj Fishta, kurse vetëm një vit më parë lind Lasgush Poradeci¹⁴⁴. Në letërsi nocioni i modernes u zhvillua nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shek. XX, dhe shquhej me karakteristika të shumta, që nga theksimi i individualitetit kreativ e deri te shfaqja e dukurive të reja, thyerja e rregullave letrare e stilistike, ndaj edhe prurja autonome e fenomeneve letrare, në forma dhe përmbajte të re letrare, ligjërimore dhe stilistike e estetike.

Përkufizimin letërsi moderne shqiptare e ka bërë i pari Eqrem Çabej, më 1929, në shkrimin e tij “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit”. Çabej e sheh modernitetin e Lasgushit në stilin e tij krejt të ndryshëm nga shkrimi i Naimit. Poezia e Lasgushit si lirikë me thellësi e dramatikë të brendshme karakterizohet nga *mendime të thella, ndjenja labirintike, ide njerëzore*.¹⁴⁵ Pra kemi të bëjmë me nevojën dhe kushtet e ndryshimit në letërsi. Ka një tentativë për të ikur, për t’iu shmangur traditaciones e për të kërkuar format e reja letrare, ato që shëmbëllojnë dhe reflektohen përballë pasqyrës moderne evropiane të shekullit XX.

Krijimtaria shihet si eksplorim, e kjo nënkupton nevojën për të shtegtuar e për të ndërmarrë udhëtimin që deri vonë, pat munguar ishte ngadalësuar në letrat shqipe. Si ilustrim atëherë, a ka më mirë se të sjellim këtu dëshirën për të ikur, për t’u drejtuar e larguar tutje, drejt skajeve, drejt botës që akoma nuk është eksploruar akoma, në kufijtë e ëndrrës a të jetës që ende nuk ka marrë ngjyrën e hidhur të zhgënjimit? E kjo s’ka si të mos vijë në formën e saj ideale, nga një autor i fantastikes evropiane *par excellence*, Dino Buxati, që njërin nga tregimet më përfaqësues të tij, e mbyll në këtë mënyrë:

“Le të bëhet ç’të bëhet, o lajmëtar, ti çoje kumtin që unë nuk do të vij, e

¹⁴⁴ Pra me mbarimin e shek. XIX mbyllet letërsia e Naimit dhe një periudhë e letërsisë shqiptare. Në këtë drejtim mund të vendoset një prerje ndërmjet letërsisë së Naimit (romantike) dhe letërsisë që nis me brezin e 1900-ës, ku hyjnë Çajupi, Asdreni, Konica, Fishta, Noli e Skëndoja, me një letërsi përgjithësisht romantike. Në të parën mbizotëron ideja kombëtare; në të dytën ideja shoqërore apo ideja njerëzore (Sabri Hamiti, “Letërsia moderne shqipe”, 1998)

¹⁴⁵ Në fushën e letërsisë moderne shqiptare, sipas Çabejit, hyjnë përkthimet e Nolit, ndërsa Asdreni bën kalimin në poezinë moderne shqiptare, shkruan ky autor në një tjetër studim të tijin, më 1936 (Sabri Hamiti, “Letërsia moderne shqipe”, 1998)

s'ka nevojë të dukesh më këtu përsëri. Këtë mbrëmje u ndjekam vërtet mirë, megjithëse mendimet e mia valëzojnë nga pak, e kam marrë vendimin që të nisem (Por a do të jem i aftë ta bëj? Mos ndoshta shpirti im do nisë ankimin, do të zbehet, në momentin e duhur do të fillojë të dridhet, apo ta fshehë kokën mes flatrave të zbehta, duke mërmëritur që s'do vazhdojë dot më përpara?)”¹⁴⁶

Harkimi i ëndrrës dhe erosi poetik

Nisur nga ajo çka e bën të papërsëritshëm figurën e Erosit që nga antikiteti, fillimisht do të mundohemi të sjellim në vëmendje imazhin që kishte ky mit që nga Platoni. Në veprën “Simpoziumi” të Platonit që është një për dialogëve më të famshëm të shkruar prej tij, tema kryesore lidhet me dashurinë dhe Erosin. Vetë Platoni mendonte se Dashuria ishte më e hershmja e Perëndive dhe ajo që meritonte më tepër respekt, që ishte në gjendje të shtynte njerëzit, të gjallë e të vdekur, në kërkim të virtytit dhe të lumturisë.

Pa dyshim që ky përfytyrim mijëvjeçar, ka ardhur deri në ditët tona duke ndryshuar në mënyra të ndryshme, shpeshherë radikale dhe kontradiktore, sipas shoqërive që kanë pasur qasje të ndryshme mbi dashurinë dhe erosit, megjithatë në shumicën e herëve është shoqëruar nga ideja e lumturisë dhe e kërkimit të virtytit, sepse dashuria arrin që të përthithë më të mirën tek njeriu dhe t’ia bëjë më të lehtë harkun e ëndrrave që atij i mbushin përfytyrimin.

Nga dialogët e Platonit, në veprën “Simpoziumi” është Sokrati ai që rrëfen se Erosi është një ndërmjetës midis njerëzve dhe hyjnive, lindja e tij ka lidhje me lindjen e Afërditës, hyjneshës së dashurisë dhe të bukurisë. Erosi është një pothuajse-Zot, por edhe një qenie demoniake, vendbanimi i zakonshëm i të cilit është pikërisht shpirti i njeriut, atje ku Erosi bën të ngjallet dëshira, më saktë dëshira për bukurinë të cilën njeriu nuk e zotëron.

Na intereson të shohim trajtesën e Erosit si një qenie demoniake, e cila arrin të kapë skutat më të skajshme të shpirtit të njeriut dhe të ngrejë tallaze të cilat përmbytin mendjen dhe nuk lënë asnjë vend tjetër përveç

¹⁴⁶ Dino Buzzati, *Sessanta racconti*, në *Opere scelte*, a cura di Giulio Carnazzi, Milano 1998 cit., f. 643

përfytyrimin.

Qënie demoniake, erosi i cili është edhe mish edhe gjak dhe që gjen vend në kraharorin e poezisë së Lasgushit, shtrihet në metaforë dhe e mbush përfytyrimin e poezisë plot me imazhe që janë të rralla dhe me një forcë të ndjeshme përfytyrimi.

Mbretëria e zemrës

*Kur hapet perëndimi pas maleve përposh
Ti vjen o motr' e ëmbël në shpirt të më qëndrosh
Ti zbret vetëtimtare, e fellë- edhe më fellë;
në fund të zemrës sime, fundoset posi një djellë;*

*fundoset posi një djellë që vdes në perëndim.
Dh'ahere prej skëterrës ku – i humbe shpirtit t'im,
ku dyke perënduar më le me gisht në ballë....
Nga-dal e magjiplotë ti shkrep si yll i gjallë....*

*Sesa një natë – e errët po mbretëron tashi!
Sesa po dirgjet bota me një pushim të zi!
Sesa me reze t'arta, sesa me lumturime
Ti po ckëlqen o motër, në fund të semrës s'ime!¹⁴⁷*

Ka një trazim që shqetëson zemrën përtej kufirit të metaforës dhe të simbolit, imazhi që na paraqitet është ai i ditë-natës, ku dashuria si një demon, tërheq dhe shtyn prej vetes, lind dhe perëndon, është e mbështetur me të dyja këmbët mbi dhe', por edhe e ajërt njëkohësisht. Ky lloj përfytyrimi, në këtë poezi të Lasgushit, ofron në mënyrë të përgjithësuar mënyrën se si lumturia tokësore, humbet dhe shndërrohet në një kërkim për lumturinë, nga momenti i parë kur zemra nuk është e qetë.

Kemi një vokacion, një thirrje për dashurinë, me një lirizëm që të godet dhe ku fjalët janë të rumbullakosura me imazhet e të lëvizshmes dhe të palëvizshmes, të një gjendjeje të përhershme që mbetet e tillë për sa kohë zemra është e shtrënguar të dashurojë.

¹⁴⁷ Lasgush Poradeci, Vepra I, Onufri, Tiranë, 1999, f. 81

Kritika mbi Lagushin dhe simbolika e vargut të thellë

Në shkurt të vitit 1929, në Graz të Austrisë, Eqerem Çabej boton një shkrim kritik mbi krijimtarinë e Lagush Poradecit, ku mes të tjerash shprehet kështu për poetin:

Ç'e ndryshon nga të parët, është thellësia... Ay është vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipet: në qoftë se kjo nuk është vënë ré gjer tani, shkaku është se më të shumë nuk e kuptojnë poezin' e tij, e cila me fjalë e mënyra foljesh fare të thjeshta, e shumë popullore, arrin të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet me të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta. Dhe po të këndohet Lasgushi me dashuri, do të vërtetohet thellësia e tij e pashoqe, në mos sot, nga brezat që do të vijnë¹⁴⁸.

Çabej hap rrugën shkrimeve kritike dhe parasheh një të ardhme të ndritur letrare për Poradecin, por ajo që na intereson, është dallimi I menjëhershëm I një lloji shkrimi jo horizontal, por vertikal, ku lexuesi nuk pengohet, por përthithet dhe depërton brenda një realiteti të ri, të mbushur me metafora që rrinë varur mbi kokë, I rrethuar nga një simbolikë që është e kuptueshme sepse flet me një gjuhë të njohur, por që mbetet e misterhme për sa kohë asnjëri nuk e interpreton dot vetëm në një lloj mënyre.

Në hapësirën e ndërmjetme janë imazhet, ato që të mbushin përfytyrimin dhe të lënë hapësirë jo vetëm të ndjesh, por sidomos të shohësh atë që këmbëngul të shprehë poeti:

Kur të më jesh e zemëruar

*Prej largësirës së paanë kalon durimi mot-me- mot...
Pas kaqë kohë dhembshurije, ndaj vendi- i lum as eja sot!
Në gjirin tënd të llaftuar m'a lerë mendjen ta humbas,
Të ndjej si zemra më gatohet plot me dëshirë e plot me gas.*

*Ti buzëqeshmë ziliqare e më ckëlqe si vetëtim,
e më vështro me sy pëllumbi drejt mun në fund të shpirtit tim;
se gazi i kthjellët i lumtërisë që çel si lulja në mëngjes*

¹⁴⁸ Botuar së pari në "Gazeta e re", 22 shkurt 1929

*si lule – e pastër do më mbijë në kraharuar mun në mes...*¹⁴⁹

Këto vargje ofrojnë një kulminacion, në momentin kur poeti sintetizon kthinat e brendshme të shpirtit me ndjesitë që ofron dashuria; imazhi i të dashurisë është i pandarë nga ideja e dhimbjes dhe e humbjes, që mund të kompensohet vetëm nga kërkimi i së vërtetës, sepse tek e vërteta fshihet dashuria, e kjo mund të gjendet veçse thellë në fund të shpirtit.

Kjo bën që mendimi të zhvillohet përmes ndjesive, të cilat ofrojnë një cilësim nga e përgjithshmja tek e veçanta të çdo elementi të dashurisë. Fjala hulumton mbi aftësinë e marrëdhënies së dashurisë, e cila duhet të zhvillohet nëpërmjet këngës së poetit, që në fakt është këngëzimi i zemrës së tij.

Pamja që shtrihet në këto vargje vë në skenë trupin e krijimit në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke i dhënë kështu ngjyrim gati të prekshëm, fizik, që mund të përfytyrohet lehtë. Poeti përfiton nga imazhet e përdorura dhe përçon lëngimin e zemrës së dashuruar, zëri i tij hyn në sfondin e krijuar duke i dhënë ngjyrim përfytyrimit. Duhet thënë se e kapur nën këtë dritë, edhe poezia bëhet e gjallë dhe lejon që imazhet të kërcëjnë e të rrotullohen në përfytyrimin e lexuesit. Nuk kemi vetëm depërtim në botën e brendshme, as ndjekje të dilemës që pret të zgjidhet dashuria, as mbingarkesë dhe tepri në listimin e ndjesive intime.

Jemi përballë një poezie që këngëzon e lehtë dhe e prekshme me duar, fjalët marrin një forcë të tillë grafike ku shihet të skalitet përshkrimi, pejzashi, ylli i perënduar dhe largësia e paanaë, gazi i lumturisë dhe lulja e mëngjesit. Impulsi i poetit duket sikur është të bëjë poezinë një ngjarje artistike totale, duke kapërcyer, duke dale dhe thyer kornizën e ngushtë të faqes ku janë të fiksuara vargjet. Për herë të parë moderniteti i veprës së poetit shpjegohet edhe me *sistemin e strukturimit* të mesazhit poetik, me prishjen e rrjedhës së perceptimit normal të realitetit, me marrëdhëniet midis rrafshit të jashtëm, sipërfaqësor dhe rrafshit të brendshëm thelbësor¹⁵⁰.

Për rrjedhojë poezia krijon ndjesinë që mund të përftohet nga admirimi

¹⁴⁹ Lasgush Poradeci, *Vepra I*, Onufri, Tiranë, 1999, f. 132

¹⁵⁰ Floresha Dado, vep. cit. f. 27

i një tabloje ku imazhet, jeta e të dashuruarve, natyra që flet, dhimbja dhe dyshimet, dashuria që fryn kraharorin dhe pulson ëndërrimet, bëhen pjesë e një arti që komunikohet rrufeshëm dhe në mënyrë të shumëfishtë. Nuk kemi më një dimension të vetëm, por një kolazh që prish rrjedhën e një drejtimtë dhe shpaloset në të gjitha drejtimet.

Flakë-Gremina e poetit

*Kur në flakë të qiririt zë mendohem net-për net
Dhe e ndiej shirtin e kulluar nëpër dritën që ëm tret,
Prej skëterrës së pamatë më del bot' e ëndërruar
Vetëm ti, o im e dashur net-për net më ri larguar.*

*Po çdo ëndërr që më shfaqet prej skëterrës së pa fund,
Çdo mendim i llaftaruar që më dhemb e më përtund,
Duke rënë prej së lartosh posi pikë zembërate,
T'i përshkohet për së thelli bukuris' së qenies sate¹⁵¹.*

E pathëna është përplot e mbushur me përfytyrimin që mundëson lidhjen dhe identifikimin e pjesëve me njëra tjetrën. Shprehja poetike merr një energji vizive ku bota e krijuar lartohet përmes imazheve që dalin nga përfytyrimi imagjnativ dhe kapërcejnë atë që mund të ishte thjesht një paraqitje e brendshme e vargëzimit poetik. Njëkohësia por dhe vënia përballë e të ëndrës me zhgëndrën, e ditës me errësirën, e dhimbjes me dashurinë, përmbush atë vizion poetik ku erosi shtyn drejt skëterrës, e cila nuk tremb e nuk ka konotacion negativ, por është një lloj sfide ku përdëllimtarët duhet të vozitin me shpirt të trazuar.

Kjo bën që faqja e krijimit poetik të Lasgush të thyhet, të mos jetë diçka e rregullt, që ndjek koordinimin metrik të poezisë, por të sjellë një rrëmujë, një kaos të ëmbël si vetë dashuria.

Lasgush i vjen natyrshëm shkruajë në thellësi e të prekë kaosin, me një botësi imazhesh ku tingujt e dashurisë nuk janë të përhershëm, sepse dashuria nuk është dot e përhershme.

Kjo bën që intimiteti i të dashuruarit të zhvishet në thelb, e frika që del në sipërfaqe të mos mbetet thjesht e tillë por të jetë edhe emocion, edhe forcë, edhe tronditje.

¹⁵¹ Lasgush Poradeci, Vepra I, Onufri, Tiranë, 1999, f. 179

Pra natyra dhe ndjenja i bashkojnë njerëzit, por ndjenja është ajo që i diferencon, të gjithë mund të mendojnë përherë të njëjtat gjëra, por askush nuk ndjen në të njëjtën mënyrë; sinqeritet do të thotë manifestim i menjëhershëm dhe besnik i ndjenjave intime vetjake. “*Drejt botës së brendshme të zemrës të çon rruga misterioze*”: është Novalis ai që tregon kështu një nga shtigjet kryesore të intimes njerëzore. Brendia e njeriut, thelbi i ndjenjave, vatra ku ndizen e marrin flakë përjetimet, cilësohet si shtysa që vë në lëvizje forcat misterioze të botës. Poezia që këndohet atëherë merr formën e një mërmërimë të ëmbël shpirti, është tentativë për të treguar dhe nxjerrë në pah intimen dhe dimensionin sublim të erotizmit njerëzor.

Këtë lloj vetërrëfimi, Poradeci e përcjell nëpërmjet mendimeve, sjelljeve, lëvizjeve, përjetimeve deri tek “*Gremina*” e poezisë së tij:

*Ti sot as qesh as qan,
Ri larg e qetë.
Në shpirtin t'ënd ti mban
Një faj për jetë.
Një dashuri me gas,
Siç fryri era,
E zure shpejt në ças,
E le përhera.
U ngrove-ashtu sa mund,
As shumë-as pakë,
S'të ndriu përdrejt në fund
E bardha flakë:
Më ndriu e griu e shkriu
Ah mua zjarri!
U mvarrësh un'i ziu
Mi buzë varri!
E nuk më dhemb aspak
Një vdekje-e gjallë,
Ndaj qava lot me gjak,
Si në përrallë¹⁵²;*

¹⁵² Po aty, f. 278

Luan një rol të madh shkathtësia dhe mënyra e zhdërvjellët e formulimit të vargjeve, që duket sikur kërcejnë dhe harmonizohen me dhimbjen, me greminën ku shihet teposhtë skëterra, por vdekja e gjallë nuk dhemb; veçmas në këtë poezi *pamja, gjesti, pasioni, ëndrra, përjashtësia, përbrendësia; të gjitha kthehen në metaforë.*

Erosi ofrohet si një dashuri në paplotësinë e saj absolute, e fjalët tërheqin mbi vete edhe pasqyrimin imagjativ të kësaj ndjenje të që qesh, e qan, e zjen!

Përfundime

Në përfundim, mund të themi që në dritën e këtij punimi mbi poezinë e dashurisë së L. Poradecit, me interes mund të jetë tentativa për të parë një përfaqësimin figurativ të fjalës nëpërmjet imazheve. Krijimi letrar shndërrohet në një paraqitje të drejtpërdrejtë figurative të imazheve. Poeti përpiqet ta bëjë gati fizik përshkrimin dhe imagjinatën poetike në vepër. Nisin të bëhen të dukshme dhe të mbushen e të marrin formë edhe ndjenjat, lirizmi i dashurisë dhe përjetimet shpirtërore të protagonistëve kryesorë. Fillon të deshifrohet nevoja urgjente për t'i dhënë ndjesinë e entuziazmit dhe të gazit të përhershëm rinisë, dashurisë dhe jetës. Është një rrugëtim në shtigje ku dashuria përthyeret në ëndrrën e së bukurës që nuk njeh perëndim.

Për rrjedhojë poezia krijon ndjesinë që mund të përftohet nga admirimi i një tabloje ku imazhet, jeta e njerëzve, natyra që flet, dhimbja dhe dyshimet, dashuria që fryn kraharorin dhe pulson ëndërrimet, bëhen pjesë e një arti që komunikohet rrufeshëm dhe në mënyrë të shumëfishtë. Nuk kemi më një dimension të vetëm, por një kolazh që prish rrjedhën e njëdrejtimtë dhe shpaloset në të gjitha drejtimet. Ky është momenti kur poezia afrohet me origjinën e saj, me poezinë popullore, ku shija e thjeshtësisë mbart brenda imazhe të shumëfishta e plot gjallëri, konkrete dhe të prekshme.

BIBLIOGRAFIA

Dino Buzzati, *Sessanta racconti*, në *Opere scelte*, a cura di Giulio Carnazzi, Milano 1998 cit., f. 643

Lasgush Poradeci, *Vepra I*, Onufri, Tiranë, 1999

Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, 1998

MELEQ SHOPI
melishopi64@gmail.com
ALMA BRAZHDA
brazhdaalma@gmail.com
Universiteti “A. Xhuvani” Elbasan

LASGUSH PORADECI DHE VENDI I TIJ NË SHTYPIN PERIODIK TË KOHËS

Lasgush Poradeci, poeti bashkëkohës, i cili u shkëput nga letërsia tradicionale, i dha kulturës shqiptare, vendin e vet midis kulturave të tjera evropiane. Krijimtaria e tij përmes dy përmbledhjeve të jashtëzakonshme do të ndrisë figurën e tij prej talenti të rrallë në gjininë lirike, duke latuar fjalën e bukur dhe të ëmbël shqipe. Të shkruash për këtë shkrimtar dhe jo vetëm si i tillë, por edhe si mendimtar krijues e kritik do të duheshin rreshta pafund. Poradeci i brujti letrat shqiptare me një element ekzotik të panteizmit mistik, duke sjellë të çka ai e quante metafizike të shkrimeve krijuese.¹⁵³ Krijimtaria e Poradecit hedh një metafizikë nga gjendjet shpirtërore të rënda të ekzistencës tokësore në sferat e larta të së madhërishmesh, në burimin e të gjitha energjive krijuese. Nisur nga veprimtaria e tij letrare, vendi që zë Lasgush Poradeci në shtypin periodik të kohës, duke u nisur dhe nga prerjet tematike të krijimtarisë së tij, vjen në një mënyrë të jashtëzakonshme. Përmes hulumtimeve dhe gjurmimeve në shtypin periodik të kohës Lasgushi na shfaqet si poet, si estet romantik, publicist, përkthyes, mendimtar, etj. Vepra komplekse e Lasgushit, në të cilën ai shfaqet si *artist*, si *kritik letrar* dhe si *teoricien arti* të çon të mendosh jo vetëm cili është raporti midis këtyre prirjeve krijuese tek ky autor, por aty ku Lasgushi është poet ai shfaqet njëkohësisht edhe si mendimtar dhe nga ana tjetër teoricien, i cili zbulon konceptet dhe trajtimet e tij teorike në mënyrë po aq poetike¹⁵⁴.

Shkrimet e para të Lasgushit në shtypin periodik i ndeshim që në vitet 1922. Pikërisht në këto vite ne hasim pjesë nga krijimtaria e tij të botuara në gazeta e revista të asaj kohe. Në këtë periudhë tek ***Dodona***

¹⁵³Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë, 1997, f. 316

¹⁵⁴Floresha Dado, *Studime filologjike*, nr. 1-2, Tiranë, 2000, f. 37

1922, nr.1, Lasgushi na vjen me poezitë “*Dora e jote ledhatarja*”

Dora- e jote ledhatarja, është e zbehtë si qiri

Dora- e jote ledhatarja ka shëndrimin’ e dëborës

*Kurr t’a ndjeu magjin’ e pastër që të shtrydheshe prej dorës.....*¹⁵⁵

Po ashtu Poradecin e ndeshim dhe me poezi të tjera në këtë periudhë në revistën Dodona, si: “*Krujt’ e Poradecit*” (në shtyllë popullore), “*Ti po vjen që prej së largu*”, “*Shpirtit*”(odë).

Gjatë viteve 1922 Lasgush Poradeci na vjen si poet e si estet romantik edhe nëpërmjet poezive: *Kanga e bilbiblit, Kur mbështetem në tryezë, Korrik...* etj, të cilat i gjejmë në revistën *Dialëria* 1922, nr.18-19.

Kanga e bilbiblit

Ligjërata shekullore...më pëlqen aq fare pak ...

Do këndoq që sot e tutje si bilbili prendverak,

*Do t’j-a marr gjith me të dhemshur, gjith i mjerë e ja se qysh*¹⁵⁶

Prania e emrit të Lasgushit vihet re që në numrat e parë të revistës Dodona, por shpeshia e krijimeve të tij do të jetë e dukshme në vitet ‘22-’24 tek *Dialëria, Mbleta, Dielli, Shqipëri’ e Re* etj.

Për Lasgushin e nga Lasgushi ka një numër të madh artikujsh të botuar në vitin 1924, ku një interes të madh shfaqet për të botuar edhe artikuj në të cilët përshkruhet pikëllimi dhe dhimbja, filozofia e zhgënjimi që e karakterizonte mendimin e poetit. Po ashtu në këtë vit tek *Shqipëri’ e re*, Lasgushi vjen me pikëpamjen e tij në shkrime gjuhësore për gjuhën shqipe, të tilla, si: “*Çështja e fjalëve të reja në gjuhën shqipe*”. Në këtë artikull ai do të shprehet se ...*në ç’masë gjuhët mundin dhe duhet të zhvillohen pas normës të përbashkët, dhe gjer në ç’masë s’duhet dhe as që mundin. Ç’normë ndjek në kohë të ndryshme formimi i fjalëve të një gjuhe dhe cili është shkaku i ndryshimi të saj individual.*¹⁵⁷ Madje, në një intervistë e zhvilluar me këtë shkrimtar original, ai do të shprehet edhe për *Gjuhën letrare*¹⁵⁸ ...Është vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipet; në qoftë se kjo nuk është vënë re gjer tani, shkaku është se më të shumët nuk e kuptojnë poezinë e tij, e cila me fjalë e mënyra foljesh fare të thjeshta, e shumë herë popullore, arrin të koncentrohet aq

¹⁵⁵Lasgush Poradeci, *Dodona*, nr. 1, Costanca-Romania, 1922, f. 21

¹⁵⁶Lasgush Poradeci, *Dialëria*, nr. 18-19, Vjenë, 1922, f. 11

¹⁵⁷Lasgush Poradeci, *Shqipëri’ e re*, nr. 200-201, Tiranë 1924, f. 4

¹⁵⁸ Lasgush Poradeci, *Tomori*, 28 korrik, 1940

sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta...¹⁵⁹ Dhe ky citim i shkëputur i prof. Çabejt e vërteton më së qarti vlerat e normës së gjuhës shqipe dhe origjinalitetin e saj të përdorur me aq mjeshtëri nga autori në veprat e tij. Dukuritë fonetike në sfondin e një analize stilistikore, shprehin pozicionin e tij si kritik, herë i drejtimit stilistik, herë impresionist, por që vlerëson edhe elementin përmbajtësor të veprave. Letërsia që Lasgushi krijon, si dhe konceptet teorike mbi të shprehin në një farë mënyre lidhjen e ndërsjellë midis spontanitetit krijues dhe gjykimit teorik, i ngritur ky mbi një përjetim thellësisht subjektiv.¹⁶⁰

Përveç krijimeve e shkrimeve të vetë Lasgush Poradecit, në shtypin periodik janë të shumtë edhe artikujt rreth jetës dhe krijmtarisë së këtij shkrimtari, madje edhe analiza të mirëfillta letrare të veprave të caktuara të tij. Tek *Shqipëria e Re 1929* gjejmë një artikull të Dhionis Miçiacio *mbi disa komente quasi-kritike mbi vjershat e Lasgush Poradecit*.¹⁶¹ Poradeci në këtë periudhë kohë ishte shkrimtar, i cili njihej, studiohej dhe përkthehej, madje ishte dhe model krijimi dhe frymëzimi. Tek artikulli “*Poradeci i Lasgushit*” Pashko Gjeci do të krahasojë mënyrën sesi e sheh natyrën Poradeci dhe sesi Leopardi¹⁶².

“*Në ket rasë asht i cuditëshem qindrimi i poetit t’onë. Nësa Leopardi, para kundrimit të nji hapsinë të pambatun, qe përmbledhë në vedi nji kohë tamshume, humb personalitetin dhe hudhet jasht në pakufi, si hullë i shkimun, Lasgushi ban nji veprim të kundërt: thellohet, rranjësohet mbrenda vedit. Futet zemra djalosharë mun në fund të shpirtit t’im*”.

Në vitet **1929-1936** tek *Albania, Gazeta e Re, Shqipëria e Re, Liria kombëtare, Laboremus, Besa, Minerva, Illyria, Kuvendi kombëtar, Arbënia, Përpjekja shqiptare... etj.*, gjejmë artikuj të shumë shkrimtarëve, studiuesve, kritikëve të letërsisë e të artit, mbi Lasgush Poradecin dhe krijimtarinë e tij. Ndër emrat që mund të veçojmë mbi atë çka kanë shkruajtur mbi Poradecin mund të përmendim: *E. Çabej, M. Kuteli, Dh. Shuteriqi, K. Maloki, S. Spasse, A. Kuçi, M. Kruja, A.*

¹⁵⁹ Eqrem Çabej, *Gazeta e re*, Nr.94, Tiranë, 1929, f. 3

¹⁶⁰ Floresha Dado, *Studime filologjike*, nr. 1-2, Tiranë, 2000, f. 38-39

¹⁶¹ Dhionis Miçiacio, *Shqipëria e Re*, nr. 367, 1929, f. 2-3

¹⁶² Pashko Gjeci, *Shkëndija* 1940, f. 43

Logoreci, S. *Shundi...etj.* Në këta artikuj përshkruhen, por edhe bëhen komente rreth veprave më të rëndësishme të shkrimtarit në periudha të ndryshme të jetës së tij dhe shpesh krahasohet dhe me shkrimtarë të tjerë tjerë të nivelit botëror.

Një nga artikujt me shumë vlerë dhe që e trajton figurën e L.Poradecit dhe krijimtarinë e tij në një aspekt të veçantë është ai i bërë nga E. Çabej “*Mbi poezinë e Lasgush Poradecit*” në *Gazeta e re* 1929.

Vështrimi kritik letrar i Çabejt mbi Lasgush Poradecin për shumë vjet ka tërhequr vëmendjen e lexuesve dhe studiuesve të letërsisë. Lasgush Poradeci shkruan Çabej *na hap portën e një jete të re në poezinë shqiptare, një “frisson neuf”, siç pat thënë V. Hygo për Baudelairein, lind e rritet në lëmën e këngës shqiptare një stil i ri, të cilin do ta kërkojmë më kot ndër poetët e tjerë shqiptarë, po më kot edhe ndër shkrimtarët e huaj, nga shkaku i origjinalitetit që shquan këtë poet djalosh.*¹⁶³ Para se të analizojë poezinë e Lasgush Poradecit, Çabej bën një vështrim për literaturën e Shqipërisë, ku letërsia është e zhvilluar në dy periudha kryesore. Në periudhën e parë përfshin poetët J.de Rada dhe N. Frashëri, duke spikatur tiparet e poezisë së tyre dhe ndryshimet e natyrshme të artit poetik. Ndërsa periudhën e dytë të letërsisë Çabej e vlerëson të komplikuar dhe me karakter humanist bashkëkohor, ku krahas Asdrenit përfshin dhe Poradecin. Poezia e Lasgushit është krijim i kohës moderne dhe si e tillë bën pjesë natyrshëm në poezinë moderne evropiane. Pa e njohur mirë Lasgushin dhe jetën e tij, është vështirë të njihen disa nga premiset kryesore të poezisë së tij. Duhet njohur mirë dhe ndikimet letrare nga poezia e poetëve klasikë botërorë apo nga ajo e poetëve bashkëkohorë. “*Prandaj misioni i artit, ka pohuar Lasgushi, është të na japë një kënaqësi estetike, që qëndron mbi të gjitha këto mizerje të jetës...Artisti krijon për vete siç këndon edhe bilibili. Poezia, ka pohuar ai, është divine (yjnore). Prandaj kur shkruan poezi duhet ta kesh shpirtin të shenjtëruar.*” Çabej gjatë analizimit të poezisë së L.Poradecit ka shprehur mendimin se ajo është e qartë dhe e kuptueshme dhe vlerësimin e tij përfundon me vlerësimin e gjithanshëm dhe shumë afirmativ “*Le t’i shërbejë kuptimit të poezisë së Lasgush Poradecit,...të cilit një fat i mirë duket sikur ia ka falur*

¹⁶³Eqrem Çabej, *Gazeta e re*, nr. 94, Tiranë, 1929, f. 2

Shqipërisë që të bëhet ai shkrimtar, të cilin Shqipëria do t'ia falë një herë botës”.

BIBLIOGRAFI

Bibliografia Kombëtare e Periodikut Shqip 1922-1940, Tiranë.

Bibliografia Kombëtare e Librit Shqip, Nr 1-4, Tiranë

Biblioteka Kombëtare, portali i katalogëve online
<http://www.bksh.al/Katalogu/library>.

Çabej, Eqerem. *Mbi poesin e Lasgush Poradecit*, Gazeta e Re, nr. 94, 1929.

Dado, Floresha. *Lasgushi midis poezisë dhe teorisë së artit*, në Studime filologjike, nr.1-2, 2000.

Elsie, Robert. *Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë, 1997.

Gjeçi, Pashko. *Poradeci i Lasgushit*, në Shkëndija, nr.1, 1940.

Hamiti, Sabri. *Testamenti poetik i Lasgushit*, në Fjala, nr.22, Prishtinë, 1979.

Kolevica, Petraq. *Nga bashkëbisedimet me Lasgushin*, në Nëntori, nr.12, 1987.

Lafe, Emil. *Fir një fjalë lasgushiane?*, në Studime, nr.3, Prishtinë, 1997.

Plasari, Aurel. *Poetika e Lasgush Poradecit*, në Drita 1997.

Poradeci, Lasgush. *Çështja e fjalëve të reja në gjuhën shqipe*, në Shqipëria e Re, nr.200-201, 1924.

Xhiku, Ali. *Lasgush Poradeci një poet pasromantik*, në: Nga romantizmi rrjedhave të realizmit, Tiranë, 1989.

VALBONA SINANAJ
Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë
ASA, Tiranë
valbona.sinanaj@gmail.com

VEÇORI TË GJUHËS E TË STILIT NË VEPRËN POETIKE TË PORADECIT

Lasgush Poradeci është poeti i parë modern shqiptar dhe një nga lirikët më të mëdhenj shqiptar të shekullit XX që shquhet jo vetëm për ndjeshmërinë e tij krijuese, por edhe për ëmbëlsinë poetike dhe harmoninë e vargjeve. Krijmtaria e tij poetike dallohet për aspektin filozofik, patriotik dhe erotik. Ai jo vetëm që nuk u largua nga shpirti i gjuhës së tij, por e pasuroi dhe e përpunoi atë me fjalë të reja, duke e gjallëruar dhe duke i dhënë ngjyra shqipes. *Gjuha duhet të jetë gjuha e popullit dhe karakteri i poezisë duhet të jetë medoemos, karakteri i tij – thotë ai. Për Lasgushin mjetet gjuhësore më të çmueshme, fjalët e shprehjet e qëlluara të domosdoshme për poezinë gjenden në të folmet e popullit. Bukuritë e gjuhës – shprehet ai – e fuqinë e pashoqe të figurave i kam gjetur më shumë në popull.*

Qysh më 1929, Çabej shkruante se *poezitë e tij të gjera e plot gremina ishin si tragjedi të vogla, me stil të rëndë e ziplot, dhe dalloheshin nga ato të Naimit siç ndryshonte muzika bethoveniane nga ajo e Moxartit. Çabej e shpall “poet të madh shqiptar e europian, të cilin një fat i mirë duket sikur ia ka falur Shqipërisë, që të bëhet ai shkrimtar, të cilin Shqipëria do t’ia falë një herë botës”.*

Studimi i natyrës së të bukurës ka filluar që në antikitetin grek dhe vazhdon edhe sot. Estetika është disiplina filozofike mbi ‘të bukurën’, e cila lindi në fillim të shek. XIX. Sipas saj, në art çdo gjë është relative, ndërsa e bukura është absolute, madhështore, e përjetshme. Fillimi i shek. XX është periudha ku zënë fill disa disiplina gjuhësore, një ndër të cila është edhe semiotika. Dy themeluesit e semiotikës, Sosyri dhe Pirsy dallojnë nga njëri-tjetri, i pari ka parasysh funksionin shoqëror të

shenjave, ndërsa i dyti funksionin logjik të tyre. Sipas Pirsit shenja është një lidhje treshe *shenjë-objekt-interpretues*.

Shek. XX e zgjeroi hapësirën e interpretimit, duke përfshirë në të, si tekstin edhe lexuesin. Shek. XXI ka nisur me mëtimin e rinovimit të koncepteve për vetë procesin e përfutimit të vlerave në bashkë-marrëdhëniet mes autorit, tekstit dhe lexuesit, duke i përcaktuar ato bashkë-marrëdhënie si proces komunikues, dhe vlerat e përfutura në atë proces si të kushtëzuara nga ligjësitë e diskursit letrar¹⁶⁴.

Wittgensteini (një nga themeluesit e pozitivizmit logjik, vitet '30 të shek. XX) thekson se ka një larmi funksionale të thënieve gjuhësore; për të, "gjuha nuk është vetëm një mjet për të përshkruar botën, por ajo është gjithmonë e lidhur me një kontekst veprimi". Historia e gjuhës nuk i nënshtrohet parimit të brendshëm; ajo ecën paralelisht me historinë kulturore e shoqërore të një populli dhe është dëshmia më besnike e tyre. Ai e krahason gjuhën me qytetin që rritet në mënyrë të shkallëzuar, ja si shprehet:

*Gjuha jonë mund të cilësohet si një qytet i vjetër; një shteg rrugësh dhe sheshesh, shtëpish të vjetra dhe të reja, e me shtëpi me pjesë të shtuara në kohë të ndryshme; dhe e gjitha rrotullohet nga një rrjetë e re kalimesh me rrugë të drejta dhe të rregullta dhe shtëpish të njëtrajtshme*¹⁶⁵.

Me këtë citat ai kërkon të shpreh thelbin historik të gjuhës duke marrë parasysh edhe aspekte të jashtme. Për të, format gramatikore të komunikimit nuk janë të fiksuara e të përcaktuara, por përthyhen sipas funksioneve të ndryshme dhe përfutjnë me kohën një domosdoshmëri të tyren. Pra, të flasësh për gjuhën, si një qytet me një qendër dhe me një periferi do të thotë ta përqëndrosh vëmendjen në marrëdhënien që lidh gjuhën me format e jetës së njerëzve dhe me rregullat që e drejtojnë. Ligjërimi përbën një formë të jetës sonë dhe se një nga funksionet krye-sore është edhe transmetimi i kulturës dhe i së bukurës. Gjuhësia e ka zbuluar parimin e individualitetit të pamohueshëm të faktit estetik, atëherë kur ka pranuar se fjala në realitet është të folurit,

¹⁶⁴ Plangarica, T. *Variant leximi i poezisë "Kristal" të I. Kadaresë, Variant leximi i poezisë "Kristal" të Kadaresë*, Botuar në përmbledhjen me studime "Kadare, leximi dhe interpretimi", Onufri, 2016, f. 3.

¹⁶⁵ Wittgenstein, L. *Hulumtime filozofike*, Tiranë, 2002, f. 18.

dhe se nuk ka fjalë krejtësisht të njëjta. Të folurit është krijim i vazhdueshëm, ajo që shprehet një herë me anë të fjalës, nuk përsëritet veçse me riprodhimin e asaj që ka qenë prodhuar më parë. Përshtypje gjithnjë të reja i lënë shteg ndryshimit të vazhdueshëm të zërave e të domethënieve ose shprehjeve të reja¹⁶⁶.

Gjuhësia dhe shkencat e ligjërimit shënuan kalimin prej përqendrimit të tyre në objektin gjuhë, në studimin e akteve të ligjërimit. Teza themelore e estetikës kroçiane është: *Arti është intuitë*; që do të thotë paraqitje, shfaqje, që realizohet nëpërmjet shprehësisë. Për të, shprehësia është aktivitet dhe jo objekt. Arti shprehet nëpërmjet të vetmit realitet që është shpirti.

Koncepti i idealizmit mbi gjuhën tek B. Croce dhe K. Vossler është i lidhur ngushtë me natyrën e gjuhës poetike, e cila shihet si një bashkim midis intuitës dhe imazhit si shfaqje. Duke analizuar elementet që përcaktojnë efektet e veçanta të një poezie të arrirë, ata vlerësojnë se ajo organizohet si një strukturë e hapur, e pasuruar me kuptime e interpretime të reja. Poezia shihet si një aktualizim i një mundësie të tipit *poetika aristoteliane*, sepse ajo është një hapje ndaj qenies dhe kuptimit të vetë kësaj qenieje. Mjaft studiues bien në një mendim kur pohojnë se me idealizmin estetik u hodhën edhe themelet e stilistikës gjuhësore. Gjeniu krijues në gjuhë nuk ishte gjë tjetër veçse shkrimtari e kryesisht poeti, të cilët krijojnë një gjuhë estetikisht ndryshe nga ajo e përditshmja.

Për De Radën, *kultivimi i së bukurës është kërkesa më e lartë e çdo veprë arti...Edukimi i shpirtit me të bukurën është një punë e lodhshme dhe e gjatë sa edhe vetë jeta, dhe se poezia, kënga, zbulon dhe paraqet me qartësinë më të madhe dhe në mënyrë më të gjithanshme kuptimin dhe rendin e sendeve, ajo qëndron mbi artet e tjera reprezentative*¹⁶⁷.

Për Poradecin, *arti është diçka e pakapur, një frymë që del nga zemra dhe prapë atje në zemër hyn. Rri në zemër, del prej saj, dhe prapë atje brenda futet. Sepse arti është këngë, dhe kënga është shpirt, dhe shpirt*

¹⁶⁶ Kroçe, B. *Estetika si shkencë e shprehjes dhe e gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 1998, f. 193, 194.

¹⁶⁷ De Rada, J. *Parime të estetikës*. Në Jeronim De Rada, *Vepra letrare* 3, Tiranë, 1987, f. 276.

është zemra¹⁶⁸.

Sipas Lloshit, *letërsia është arti i fjalës në kuptimin e një pune mjeshtërore me visarin gjuhësor. Artisti i fjalës krijon e derdh objekte estetike gjuhësore. Letërsia na jep modelet më të bukura të ligjërimin, ajo përbën shfaqjen estetike të shqipes*¹⁶⁹.

Teksti poetik si qëllim kryesor ka informacionin poetik, kumtimin poetik. Ai ndryshon nga çdo tekst tjetër pikërisht për shumësinë dhe për pakufijshmërinë kuptimore që ka ose që mund të ketë. Këtë gjë nuk e kushtëzojnë vetëm gjuha e zgjedhur, leksiku i pasur, leksemat me nuanca e ngarkesa kuptimore të shumënduarshme e ndërsjellë e fjalëve, dhe e kuptimeve të tyre të ndërlidhura e të varura midis tyre si dhe me njësitë e tjera më të mëdha ose të vogla të tekstit, që brenda sistemit përkatës bëjnë të veçantën, por dhe tërësinë unike shprehëse poetike¹⁷⁰.

Fjalët e harmonizuara në poezi pasqyrojnë format e shpirtit; përftojnë lidhje të reja, si nga kuptimi edhe nga tingëllimi, vishen me ngjyrimë të tjera, vendosin asociacione të reja. Fjala në poezi përcjell një mesazh, një vlerë humane, pasi ajo bart një vlerë artistike. Realiteti i ri që krijohet nëpërmjet vargjeve është një realitet artistik i pasur, i përftuar nga uni e nga ndjenjësimi individual-subjektiv i krijuesit.

“Gjuha mbetet sovrani i njeriut. Gjuha na bën shenjë, dhe është ajo që e para dhe e fundit, përcjell drejt nesh qenien e diçkaje. Vendosja e korrespondencës që e bën njeriun të dëgjojë me të vërtetë thirrjen e gjuhës, është pikërisht ajo thënie që flet në elementin e poezisë. Sa më shumë poetike është vepra e një poeti, aq më shumë të thënërit e saj është e lirë: më e hapur ndaj të papriturës, më e gatshme për ta pranuar”¹⁷¹.

Poezia është arti që i këndon shpirtit. Lexuesi i përjeton ndjesitë dhe emocionet në poezi nëpërmjet njësisë leksikore, duke e ndezur kureshtjen dhe vëmendjen e tij gjatë leximit.

¹⁶⁸ Muhametaj, E. *Mendimi letrar shqiptar 1939-1944*, Tiranë, 2008, f. 596 (S. Morava. *Nga intervista e Tomorit, flet princi i lirikës shqiptare, Lasgush Poradeci*)

¹⁶⁹ Lloshi, Xh. *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005, f. 241.

¹⁷⁰ Berisha, N. A. *Rëndësia e letërsisë arbëreshe për ruajtjen dhe pasurimin e botës dhe e shpirtit arbëresh*, në “Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë”. Luigi Pellegrini Editore, Cosenza, 2008, f. 13.

¹⁷¹ Hajderger, M. “*Poetikisht ku banon njeriu*”, Leksione dhe konferenca, Tiranë, 2003, f. 122.

Roli i poetit dhe i lexuesit në procesin e interpretimit është i dallueshëm: poeti vendoset në raport preferencial me botën që e rrethon (përvojat, ndjesitë, emocionet, idetë, përjetimet që i ngjall një realitet), ndërsa lexuesi me “botën e tekstit” ndërton “subjektin” e vet. Një vepër poetike është e arrirë kur bota e ngjizur në tekst nxit lexuesin të ndërtojë subjektin e vet¹⁷².

“Më së paku – thotë Plangarica - përballë tekstit poetik lexuesi përvijon natyrshëm dy qëndrime: i qaset tekstit për kënaqësi e merr prej tij përjetime estetike. Teksti poetik përçon qartazi një shqetësim poetik, poetizon këndshëm një ndjesi, që spikat dukshëm dhe pa mëdyshje nëpërmjet shenjimeve a njësive leksikore që në përdorim përftojnë figuracion tërheqës, që mban të ndezur vëmendjen dhe kureshtinë e lexuesit përgjatë të lexuarit. Në tekst njësitë gjuhësore, qysh tek ato fonetiket e prozodiket e deri tek ato më të zgjeruarat, sintaksore, ngjallin e formësojnë efekte të vazhdueshme, ngjizin realitete brenda tekstore përmes paraqitjeve mendore që rezonojnë lehtësi me ato që lexuesi i konservon dhe i ruan në zonat aktive të kujtesës së tij, e për më tepër, i vlerëson si mundësi të njohjes, por sidomos të vlerësimeve a të qëndrimeve të tij estetike të botës, që e tërheqin dhe e joshin, dhe pa vështirësi e bëjnë një ‘unë’ Tjetër në procesin e të lexuarit dhe përftimit të përjetimeve”¹⁷³.

Për Bonafante në veprën “Për një lexim pragmatik të poezisë” (1992): “Procesi i leximit të një krijimi poetik nuk është thjesht një përjetim e kënaqësi estetike, por nëpërmjet tij zbulojmë vlerat që mbart e përçon; është një proces që parakupton qëndrimin aktiv të lexuesit, i cili plotëson, ndërton, rikuptimëson thëniet në diskurs, mbush lakunat/zbrazëtitë e natyrshme e të qëllimshme tekstore dhe përvijon si poeti “subjektin” e tij. Është një proces i natyrshëm sepse “poeti e di që *mund* të jetë i lexuar dhe lexuesi që *duhet* të lexojë... Poeti dhe lexuesi janë në këtë rast agjentë të komunikimit letrar dhe bashkëkrijues të situatës së të thënit. Përmes hapësirës së mundshme enonciative, kjo mënyrë e të

¹⁷² Marrë nga Plangarica, T. *Kadare, leximi dhe interpretimi*, Onufri, 2016, cituar sipas Monte, M. *Auteur, locuteur, éthos et rythme dans l'analyse stylistique de la poésie*, në “Stylistiques?”, Press Universitaires des Rennes, 2010, f. 325.

¹⁷³ Po aty.

lexuarit duhet të krijojë elementet e diskursit që bartin kuptimin dhe ngjizin mesazhet”¹⁷⁴.

Prirja drejt formave të reja letrare, individuale dhe gjallëruese spikat autorët e estetikës moderne, si Konica, Koliqi, Kuteli, Migjeni dhe Lasgushin. Prirja për të krijuar një stil vetjak lidhet me atë që quhet modernizëm (ndonëse ky nuk u konceptua asnjëherë si shkollë estetike), p.sh. Lasgushi ishte i vetëdijshëm për të krijuar stilin e tij vetjak jashtë çdo kanonizmi estetik¹⁷⁵.

Në përvjetorin e 120-të të lindjes së Poradecit do të trajtojmë disa veçorive të gjuhës dhe të stilit të poezisë së tij, konkretisht të poemës *Kamadeva*, në “Veprën 1”, Onufri, 1999.

Lasgush Poradeci është poeti i parë modern shqiptar dhe një nga lirikët më të mëdhenj shqiptar të shekullit XX, që shquhet jo vetëm për ndjeshmërinë e tij krijuese, por edhe për ëmbëlsinë poetike, harmoninë e vargjeve dhe stilin e tij vetjak. Në vargjet e tij përmbledhet një botë e tërë ndjenjash dhe mendimesh, puna e 25 viteve. Ai është njohës i thellë i shqipes, jo vetëm që nuk u largua nga shpirti i gjuhës së tij, por e pasuroi dhe e përpunoi atë me fjalë të reja, duke e gjallëruar dhe duke i dhënë ngjyra shqipes. *Gjuha duhet të jetë gjuha e popullit dhe karakteri i poezisë duhet të jetë medoemos, karakteri i tij – thotë ai*¹⁷⁶.

Qysh më 1929, Çabej në një artikull të tij, pasi e përqaste me poetë të shquar të kohës si Rilke, D’Anunzio etj., shkruante se *poezitë e tij të gjera e plot gremina ishin si tragjedi të vogla, me stil të rëndë e ziplot, dhe dalloheshin nga ato të Naimit siç ndryshonte muzika bethoveniane nga ajo e Mozartit. Çabej e shpall poet të madh shqiptar e europian, të cilin një fat i mirë duket sikur ia ka falur Shqipërisë, që të bëhet ai shkrimtar, të cilin Shqipëria do t’ia falë një herë botës*¹⁷⁷.

Ndër pohimet e Kutelit për Lasgushin veçojmë: *Frymëzimin poetik Lasgushi e quan pikë së pari një frymëzim të fjalës. Ai e ka përtërirë*

¹⁷⁴ Marrë nga Plangarica, T., në *Prania në prani (Sprovë për një lexim pragmalinguistik të poezisë “Kur të jesh mërziur shumë”*, në “Dritëro Agollit (Studime kushtim në 85-vjetorin e lindjes)”, Tiranë, 2017b, Botues Grand Prind, f. 275.

¹⁷⁵ Dado, F. *Identifikimi i poetikave në plan teorik dhe historiko-letrar*, Onufri, Tiranë, 2019, f. 22.

¹⁷⁶ 14 qershor 1972. Nga një bisedë e tij në Pogradec.

¹⁷⁷ Poradeci, L. *Vepra I*, Onufri, 1999, f. XIX.

shqipen, duke i dhënë ngjyra të reja, ndriçim të ri e gjallëri të re. Ai është i vetmi poet shqiptar, që mendon, flet e shkruan vetëm shqip. Magjia e fjalës së tij i detyrohet artit të radhosjes në vargje, e sidomos harmonizimit të saj me përmbajtjen. Përmes fjalorit, Lasgushi shquhet haptas nga të gjithë poetët e tjerë të shqipes”¹⁷⁸.

“Ligjërimi lasgushian – thotë Lloshi – është një ligjërime i veçantë poetik, me përpunime të rafinuara të fjalës e stërhollime stilistike, me shmangie gjuhësore e përftesa që ndikojnë mbi ndjenjat e perceptimit dëgjimor të lexuesit, me eksperimente të lindura nga kërkesa këmbëngulëse për vetëshprehje”¹⁷⁹.

Poezinë e Poradecit e zotëron një ndjeshmëri e madhe muzikore e cila arrihet nga fakti, se ky poet ishte mjeshtër në përdorimin e fjalës shqipe dhe i strukturës së testit. Poradeci është poeti me shpirt modern dhe europian. Poezia për të është emocion, ndjenja e derdhur në vargje; sipas tij, *artisti duhet të jetë i singertë deri në fund të shpirtit të tij dhe se poezia duhet të jetë personale*. Ai u frymëzua nga jeta shqiptare, nga folklori, kënga pleqërishte, vallja e luleve, nga trimi e vasha, nga dashuria si ndjenjë universale, nga liqeni magjik “Poradeci” i tij. Poradeci ishte i pajisur me një kulturë të gjerë; njihje filozofinë sokratike, filozofinë klasike gjermane, vedat indiane, Gëten, Pushkinin, Lenau, poezinë e Budit, Bogdanit dhe Naimit, por mbi të gjitha njihje gjuhën shqipe, të cilën e ngriti në shkallën më të lartë të një gjuhe të zjarrtë poetike. Konceptimi i ndjenjës së dashurisë në poemën “Kamadeva”, është thujse i njëjtë me atë të Dantes tek “Komedia hyjnore”. Dashuria si ndjenjë, si një fuqi e magjishme përjetohet deri në skajet më të thella të qenies shpirtërore. Poezia erotike pavarësisht nëse nisët nga një përjetim personal, ku zakonisht poeti vendos veten në rolin e heroit lirik, ndërton një ideal ku në qendër të të cilit vendoset vajza e dëshiruar. Në këtë poemë, Lasgushi shenjzton ambientin ku lind dashuria e tij për vajzën, të cilën ai e quan *yll, djell, mall, dashuri*, e cila i shfaqet *përmbi kodrinë*, duke e harmonizuar bukurinë e saj fizike me ato të natyrës, konkretisht me *pyllin e ndezur n’ar*, nga takimi i dy të dashuruarve. Fillimisht dy shpirtrat e dashuruar njihen e shijojnë

¹⁷⁸ Lloshi, Xh. *Lirizmi i lirikut Lasgush*, në SF, Nr. 1-2, Tiranë, 2000, f. 17.

¹⁷⁹ Po aty, f. 16.

dashurinë, por në fund e keqja i ndan:

Dhe mjaft, Demon,

Demon zili-përskuqur,

tmerrësisht ti urdhëron:

mjaft buzë-puqur!.

Në vazhdim, Poradeci e kërkon dashurinë në qiell, për ta puthur, prekur e përqaftuar të dashurën e tij, por këto nuk mjaftojnë dhe nuk e ngopin, sepse është tokësor: këtu qëndron edhe dallimi midis dashurisë së poetit tonë me atë të Dantes për Beatricën. Në ndryshim nga Dante që e humb të dashurën e tij dhe nëpërmjet një udhëtimi imagjinar e kërkon në qiell duke e adhuruar dhe i kënduar me një dashuri platonike, Poradeci i këndon jo vetëm bukurisë fizike, por edhe asaj shpirtërore, sepse është njeri dhe jo engjëll. Atë nuk e ngop as dashuria tokësore dhe as ajo qiellore, kjo tregon se dashuria për njeriun është një fuqi e pashtershme, ai kurrë s'ngopet, prandaj vazhdimisht e kërkon atë. Për Lasgushin gjëja më e bukur në jetë është dashuria; ai thotë: “*Unë besoj në dashurinë. Në jetë më shumë më ka tronditur dhe më ka gëzuar dashuria*”.

Gjuha e përdorur në këtë poemë është e magjishme, e pasur dhe e zbukuruar me simbole, metafora, elizione, sinonime, fjalë të përbëra etj. Fjala poetike dhe forca e tingujve në këtë poemë zotëron vlera që të çojnë në shtigje të reja përzgjedhjesh stilistike. Lasgushi përveç fjalëve metaforike që i merr nga brumi i shqipes si: *yll, diell, mall, dashuri, zemër, ëmbëlsi*, përdor edhe vargje fjalësh apo fjalë të përbëra të marra nga gjuha e popullit si: “*sy-vetullushe, krah-fluturushe, shtat-hedhura-selvi, llërë-kulluar, gjë-qumështuar, vetull-kurorë, zili-përskuqur, buzë-puqur, zëmërë-thyer, shigjetë-helmuar, sy-qëngjërushë* etj. Përcaktimi i veprimeve dhe i përshkrimeve në këtë poemë bëhet përmes fjalëve me prapashtesat: *-(ë)si; dlirtësi; -isht; miturisht, virgjërisht, qjellorisht, lavdërisht, dashurisht, nusërisht; -tar(e); përgjimitar, përvëlimentare; -ak; zëmërak; -or(e); miturore, virgjërore, dashurore, nusërore; -(ë)rim; kuqërim, pipëlim, rëgëtim, pështjellim*, si dhe prapashtesat zvogëluese; *lundrëzën, klithmëz, syçkëza,; shoqëzë, vogëlosh*, etj.

Në këtë poemën folja ka një denduri të madhe përdorimi në ligjërimin poetik të Poradecit, si për anën semantike të saj po ashtu edhe për larmishërinë e formave gramatikore. Po shkëpusim vetëm disa vargje nga poema për të treguar se si përdorimet foljore; *qeshe, u skuqe, u çquan, skuqur, pushtuar, ndriçuan, u tund, gjëmoj, u mbush, ne t'iknim s'ikim, zu, u ndje, këndonin* etj., përforcojnë rrëfimin poetik duke krijuar një përfytyrim të gjallë e të zjarrtë të gjendjes emocionale të heroit lirik me vajzën që e dëshiron marrëzisht, por edhe të mjedisit ku takohen të dashuruarit (*pylli, limeri, qielli, hënë e yll*), i cili përfshihet dhe gërshetohet kaq magjishëm me përjetimet e dy të rinjve.

Dhe *qeshe* miturisht
Moj miturore
Dh' *u skuqe* virgjërisht
Moj virgjërore

Dhe *skuqur* që të dy
Pa gojë e fjalë
Vështruar sy-ndër-sy
Zemërë-valë

Dhe *ngrirë*, o dashuri
Pa *kuvënduar*
Pushtuar gji-për-gji
Sy-perënduar

U *çquan* hënë e yll
Në mug të vonë
Ndriçuan n'atë pyll
Takimin t'onë;

Dhe pylli *i ndezur* n'ar
Q' *u tund* nga vëndi
Gjëmoj tingëllimtar
Si gjëmë ërgjëndi.

Limeri *u mbush* përplot

Me shkrumb e hije
Ne t'ikim s'ikim dot
Prej kaq magjije.

Ja, posi n'ëndërrim
lumturi-dehur
Në qiell një murmurim
Zu pandehur.

Një këng'e lart'u ndje,
Me plot jehona:
Këndonin përmbi ne
Dy shpirtrat tona.¹⁸⁰

Në lirikën e Poradecit ndryshohen trajtat morfologjike, shndërrohen fjalët fonetiksht, neologjizmat zgjerohen e shtrihen, ndërtimet sintaksore përngjiten e shkrihen, kuptimet mjegullohen dhe të gjitha bashkë njehsohen për t'ia lënë vendin një mbretëreshe: harmonisë. Magjia e ligjërimin të Lasgushit është një magji me gjithë shqipen për ta bërë atë të tingëllojë e ëmbël, e rrjedhshme, delikate, elegante¹⁸¹.

Për pasurimin e shqipes me fjalë të reja, poeti u mbështet në pasurinë leksikore të gjuhës së popullit të tij. Për Lasgushin mjetet gjuhësore më të çmueshme, fjalët e shprehjet e qëlluara të domosdoshme për poezinë gjenden në të folmet e popullit. *Bukuritë e gjuhës* – shprehet ai – *e fuqinë e pashoqe të figurave i kam gjetur më shumë në popull*. Ai ishte adhurues i fjalëve arkaike, i shprehjeve filozofike popullore, po aq sa dhe i fjalëve të reja në gjuhën shqipe.

Vepra poetike e Poradecit mbetet emocionuese me një gjuhë të rrjedhshme, të pasur me fjalë e shprehje të bukura, shpesh herë popullore. Muzikaliteti e rrezatimi metaforik që karakterizon vargjet e saj, i mbështjell me lirizëm vlerat e natyrës njerëzore (pasionet, forcën e dashurisë, origjinalitetin, dramën jetësore etj.). Poezia e tij zhvillohet në truallin dhe shpirtin e popullit shqiptar, ajo është e lartë, e thellë dhe gjerë; është një gur i çmuar në thesarin e trashëgimisë shpirtërore të

¹⁸⁰ Poradeci, L. vep. cit. f. 298, 299.

¹⁸¹ Lloshi, Xh. vep. cit. f. 34.

shqipes. Këto janë disa veçori të krijimtarisë së Poradecit që dëshmojnë pasionin dhe punën e një poeti këmbëngulës e të madh. Misioni i veprës së tij poetike është t'i transmetojë lexuesit kënaqësi e mesazhe estetike nëpërmjet gjuhës së zjarrtë shqipe.

Po e mbyllim këtë trajtesë me fjalët e tij:

*Të gjithë marrin jetë prej flakës që ndrin, asnjë s'kujton zjarrin që pat djegur, sepse poeti nuk rron jetën e vdekur të vet po jetën e pavdekur të kombit të vet. Poezia formon shpirtin e kombit. Romani është një libër bashkëbisedimi, ndërsa poezia është një libër formimi. Prandaj duhet të shkruajmë poezi jo të mirë, por shumë të mirë, jo të lartë, por shumë të lartë, shumë të thellë, shumë të gjerë, që t'i vëmë shpirtit të kombit themele të shëndosha*¹⁸².

BIBLIOGRAFI

- Berisha, N. A. (2008). *Rëndësia e letërsisë arbëreshe për ruajtjen dhe pasurimin e botës dhe e shpirtit arbëresh*, në "Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë". Luigi Pellegrini Editore, Cosenza
- Dado, F. (2019). *Identifikimi i poetikave në plan teorik dhe historiko-letrar*, Onufri, Tiranë
- De Rada, J. (1987). *Parime të estetikës*. Në Jeronim De Rada, Vepra letrare 3, Tiranë
- Hajderger, M. (2003). "Poetikisht ku banon njeriu", Tiranë
- Kroçe, B. (1998). *Estetika si shkencë e shprehjes dhe e gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë
- Lloshi, Xh. (1978). *Poeti dhe figura*, në "Nëntori", 1978, Nr. 11, Tiranë
- Lloshi, Xh. (2000). *Lirizmi i lirikut Lasgush*, në "Studime Filologjike", Nr. 1-2, Tiranë
- Lloshi, Xh. (2005). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë
- Muhametaj, E. (2008). *Mendimi letrar shqiptar 1939-1944*, Tiranë
- Poradeci, L. (1999). *Vepra I*, Onufri
- Plangarica, T. (2016). *Kadare, leximi dhe interpretimi*. Botuar në përmbledhjen me studime "Kadare, leximi dhe interpretimi", Onufri
- Plangarica, T. (2017). *Prania në prani (Sprovë për një lexim pragmalinguistik të poezisë "Kur të jesh mërziur shumë"*, në "Dritëro Agollit (Studime kushtim në 85-vjetorin e lindjes)", Tiranë
- Wittgenstein, L. (2002). *Hulumtime filozofike*, Tiranë

¹⁸² Poradeci, L. vep. cit. f. 7.

PANDI BELLO
Korçë
pandibelo@yahoo.com

LASGUSHI DHE MUZIKA

Origjina e njëjtë e muzikës me letërsinë, lidhja e tyre përmes elementëve të dallueshëm lehtë, por dhe të atyre më pak të dallueshëm, ka bërë që ato të perceptohen shpesh si të pandara. Prej këtij buron fenomeni i paraleleve letraro-muzikore, i cili përfaqësohet, së pari nga shkrimtarët që treguan interes për artin e tingujve. Idetë e këtyre shkrimtarëve për letërsinë dhe artin dalin jo vetëm nga analiza e fenomenit letrar, por edhe nga gjykimet për kompozitorë, vepra dhe fenomene specifike të muzikës. Mjafton të përmendim emra të tillë si Lev Tolstói, Stendal, Romain Rolland dhe Thomas Mann, apo Fan Noli, Faik Konica dhe Vlad Zografi nga shkrimtarët shqiptarë, përkatësisht studimet, shkrimet dhe veprat e tyre në sferën muzikore, për ta parë në një formë të plotë dukurinë përkatëse.

As Lasgush Poradeci nuk ka qenë indiferent ndaj artit të tingujve. Siç shkruan miku i tij, arkitekti dhe përkthyesi Petraq Kolevica në librin “Lasgushi më ka thënë”, poeti që në djalëri, në liceun rumun të Manastirit i binte flautit, ndërsa kur shkoi në liceun francez, në Athinë, mësoi të luante në klarinetë. I etur për dije, kur ishte student në Bukuresht ai studioi edhe në shkollën e lartë të muzikës dhe të teatrit, ndërsa nga fundi i viteve 70 të shekullit të kaluar Lasgushi do ta impresiononte thellë një këngëtare të Operas së Tiranës, kur këndoi para saj, shumë korrekt, serenatën siçiliane ‘*O Lola ch’ai di latti la camisa*’, nga opera Cavaleria Rusticana e Pietro Mascagnit. Poeti e vlerësonte kompozitorin verist italian dhe kujtonte shpesh mbresat e papërsëritshme që i pati lënë një nga koncertet e drejtuara prej tij, që ai e pati dëgjuar në sallën e koncertit.

Lasgushi njihte veçoritë e gjuhës muzikore, përktheu dhe shkroi vargje për pjesë vokale që u kënduan dhe u inçizuan nga sopranoja Tefta Tashko Koço.

“Serenatën e Schubert-it- Kënga ime ndaj nat’here e kishte përkthyer

Asdreni, por nuk ishte e përshtatshme për t'u kënduar dhe unë e përktheva përsëri për Teftan”.

Kështu i tregonte poeti dirigjentit Eno Koço në fillim të pranverës së viti 1978.

Lasgushi shkroi edhe vargjet e romancës “*Kur më vjen burri nga stani*”, mbi një motiv arvanitas, me muzikë të kompozitorit Kristo Kono.

Në vitin 1937 Tefta Tashko Koço ndodhej në Itali për të incizuar në pllaka gramafoni repertorin e saj të njohur. Sjellja e Lasgushit në këtë çast ishte sjellje e një fisniku. Ai nuk pranoi pagesën që i ofroi shoqëria diskografike “Columbia” për vargjet e këngëve që këndonte Tefta. Përveç mirënjohjes që Tefta i shprehu poetit, ato ditë ajo i shkruante: “Veçanërisht spirituale janë dy couplet-et e *Kur më vjen burri nga stani*”. (Citohet sipas: Eno Koço – Tefta Tashko Koço dhe koha e saj, Dituria 2000, f.177).

Lasgushi kishte mjaft miq muzikantë bashkëkohës si Tefta, Efthim Kovaçi, Kristo Kono, Jorgjia Filçe –Truja dhe më të rinj si Tonin Harapi etj. Për Teftën ai i ka deklaruar djalit të saj Enos: “Unë s’jap informata për Teftan, unë jap zemrën. Ne ishim shokë, jo miq”. Ndërsa muzikologu Spiro Kalemi, në monografinë për Tonin Harapi, sjell edhe këtë fragment nga kujtimet e kompozitorit për Lasgushin: “Vinte shpesh mëngjezeve dhe më gjente duke i rënë pianos në shtëpinë e kulturës. Ulej afër dhe dëgjonte symbyllur. Më thoshte se kishte kompozuar edhe ai vetë këngë...”. Në këtë kohë Tonini ndodhej në Pogradec dhe kompozonte operan e tij “Zgjimi” me libret të doktorit dhe shkrimtarit Misto Marko. Me vargje të Lasgushit ai kompozoi dhe romancat: “*Kur m’u rrite vogëloshe*”, “*Mora shoqezën për krahu*” dhe “*Kush po shkon ashtu*”.

Një pjesë e shqiptarëve kanë filluar ta njohin poezinë e Lasgushit nga interpretimet e shkëlqyera të Teftas, të romancave “*Fryn veriu*” dhe “*Kroi i fshatit tonë*” të Efthim Kovaçit, si dhe “*Kur më vjen burri nga stani*” të Konos. Zëri i saj i bukur, teknika e lartë vokale, frazimi i përsosur, pastërtia e shqiptimit, forca shprehëse dhe aftësia për ta emocionuar dëgjuesin i bënë këto pjesë, pra edhe poezitë e tyre, të dashura për të gjithë. Në këto shembuj është arritur një përputhje

absolute e frymës dhe estilit poetik me ligjërimin muzikor. Këtu, në këtë bashkim intim të fjalës me tingullin, mund të ndihet se malli është prezent, është më se i prekshëm. Uni lirik i ndjeshëm dhe psikologjikisht i thellë, në këto shembuj është i shprehur në formë të lartë, jo vetëm në vargjet e poetit, por edhe në meloditë perkatëse. Poezia në këto shembuj i ka dhënë melodisë fillin e një energjie të përshtatshme, por melodia më pas i ka shtuar poezisë një horizont të ri, të lehtë për t'u imagjinuar. Në këto romanca shumëkush mund të njohë dhe të shijojë tingullin muzikor autokton dhe elegant të melosit të këngëve të krahinës së Korçës. Për këto shkaqe poezitë e mësipërme mbeten edhe ato më të dëgjuarat dhe mundet më jetëgjatat.

Lasgushi kishte edhe mjaft miq të tjerë në Korçë. Kur ndodhej i sëmurë në sanatoriumin e Gratz-it në Austri, Shoqëria Muzikore “Lyra”, më 24 mars 1928 dha një koncert me tri pjesë në ndihmë të tij. Në koncert u interpretuan vepra klasike për solistë, kor dhe orkestër, si dhe disa pjesë nga Banda e Bashkisë. Dirigjent i orkestrës dhe i bandës ishte Paskal Anibali, ndërsa me korin punuan Ilo Mosko dhe Jorgji Kroi.

Kur qëllonte të ndodhej në Elbasan ai ftonte këngëtarin dhe violinistin popullor Isuf Myzyri të luante krijimet e tij. Kështu ai shkroi 9 këngë nga repertori i këtij bard të këngëve të Elbasanit dhe e vlerësoi atë në shtypin e kohës. Mirëpo kur meditonte këndonte me zë të ulët këngët e vendlindjes, ato këngë që i pati dëgjuar në vogëli.

Lasgushi zotëronte një kulturë dhe një ndjeshmëri estetike të admirueshme dhe kjo gjë e bënte të aftë të jepte gjykime me vlerë, të qëndrueshme dhe profesionale edhe për probleme të muzikës. “Nga muzika jonë popullore – thoshte ai – më e mirë është ajo e sazexhinjve të Korçës. Muzika popullore shkodrane dhe e Shqipërisë së Mesme është me influencë nga muzika turke. Origjinale është edhe kënga labe, por është e egër. Këngët e sazexhinjve të Korçës i kanë të gjitha intonacionet e një muzike të kultivuar”. Kështu pohonte poeti në një nga bashkëbisedimet e shumta me Petraq Kolevicën.

Lasgush Poradeci është i pari që shkroi një historik të Himnit Kombëtar në studimin e tij “Himni Kombëtar-“Flamurit pranë të bashkuar” dhe gjeneza e tij” ai bën një analizë të plotë të rrethanave social-historike, psikologjike dhe artistike të lindjes dhe të përhapjes së

këngës për flamurin. “Dhe himni në këtë mënyrë i shqipëruar-shkruante ai –i ngjitur dhe mi krahët e lehta të muzikës fluturonjëse, u vendos të shpiket me qëllim përhapjeje në Korçë – qendër dhe zemër e kolonive kombëtare, mëma e kryevatrës së Bukureshtit”.

Njohës i vërtetë dhe veprues aktiv në gjirin e atdhetarëve, sa kohë jetoi në kryeqytetin rumun, poeti na shpjegon fenomenin në fjalë në kuptimin fizik dhe metafizik dhe ve në dukje rëndësinë e kësaj kënge për shqiptarët në fillim të shek. XX. “Për anëtarët e Korit Kishëtar shqiptar të Kolonisë ishte melodia faktori më me rëndësi...Anasjelltas qëndron çështja në Shqipëri. Këtu pranimi dhe përhapja e himnit i detyrohet së pari fjalëve, shprehjeve të shqipes; i detyrohet derdhjes krejt kombëtare që iu kish dhënë atyre Asdreni ...”,- shkruante Lasgushi në këtë studim.

Megjithë konkurset për një himn të ri në kohën e mbretit Zog dhe konkurset e herëpashershme pas luftës çlirimtare kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë, kjo këngë patriotike e korçarëve të emigruar, pasi ushtoi për katër vite me radhë, para shpalljes të pavarësisë së vendit në mbledhjet dhe manifestimet me karakter patriotik në Korçë, mbetet edhe sot Himni ynë Kombëtar, pikërisht në sajë të ndikimit të tij në ndërgjegjen shqiptare, ashtu si e karakterizon liriku ynë i madh.

Lasgushi është një ndër ata artistë për të cilët krijimi në fushën e artit mbetet një enigmë. Duke u përpjekur të gjejë misterin e krijimit ai pyet pa marrë përgjigje: “Ç’do Beethoveni që shkon rrugës si i çmendur duke kompozuar e duke lëvizur duart?”.

Lasgushi kishte një vesh të ndjeshëm muzikor dhe meditonte shpesh për botën e tingujve. Atë e tërhiqte edhe muzika e Beethovenit edhe ajo e Schubert-it, por edhe ajo e një prej përfaqësuesve të mëdhenj të avangardës së shek. XX, siç ishte Igor Stravinskij.

Duke u nisur nga kultura e madhe, si dhe nga ndjeshmëria e veçantë për të bukurën, pra edhe në muzikë poeti nuancon nga pozitat e estetikës, me detaje të stërholluara përshtypjen që i krijon romanca “*E mora shoqezën për krah*”, të cilën Kristo Kono e kompozoi mbi vargjet e tij. Letra që poeti i dërgon kompozitorit për këtë rast është një prozë muzikore shumë e frymëzuar. Të duket sikur poeti nuk është vetëm ai që ka krijuar vargjet, por edhe melodinë. “Ti s’ke bërë vetëm një vijë

melodike, por një interpretim. Një interpretim elokuent pa folur gjë. Ke muzikuar një mister që ringjall së fellash dashurinë, që tund prej fundesh universin e zemrës sime duke kënduar”. Kështu i shkruante ndër të tjera poeti kompozitorit korçar.

U bë kohë që kur poeti kaloi në një jetë tjetër. Kjo kohë ka qenë e mjaftueshme për të menduar dhe për të ndërtuar portretin e tij real. Me pamjen në dukje të ngrysur, ironik dhe me sytë plot iskra, ai thellë-thellë ishte një njeri i denjë. Ecte me një lloj solemniteti dhe mbi të gjitha ishte i lirë. Liria që ia mbante shpirtin plot e bënte mendimin e tij inteligjent. Kultura e gjerë që e mori gjatë studimeve në Bukuresht dhe në Gratz e bënte të menduarit e tij tërësisht original.

“Esenca e poezisë lirike – thotë – Lasgushi – është muzika shpirtërore dhe muzikën shpirtërore e bën toni shpirtëror dhe tonin shpirtëror e bën drithma shpirtërore, lëkundja, tronditja shpirtërore, kurse tronditjen shpirtërore, domethënë me një fjalë neologjie, emocionin shpirtëror e bën, as më shumë as më pak përveç se frymëzimi i brendshëm poetik, i cili duket dhe ndihet dhe kuptohet prej vetiu dhe drejtpërdrejt në transfigurimin emocional të idesë ose ndjenjës ose pamjes aktuale të poetit”.

Nga ky arsyetim del se për këtë poet marrëdhënia e poezisë me muzikën është thelbësore, në mos ekzistenciale. Lirizmi i tij poetik është lirizëm muzikor dhe vargu i tij është një rresht muzikor. Lasgushi, pra, është i pari kompozitor lirik i poezisë tek shqiptarët. Kënga e tij e poezisë është këngë e harmonisë hyjnore dhe kjo harmoni është posaçërisht muzikore.

Dominantja shpirtërore në poezinë e tij është malli me valenca të shumta, një ndjenjë e përhershme, tunduese dhe munduese si në vargjet që vijojnë:

Mall' i zemrës s'ime : këngë - e vaj – bashkuar :

Këngë – e pakënduar : vaj – i – pavajtuar :

Posi shpuz' e zjarrit nënë gji mbuluar.

Përfytyrimi i mallit në këto vargje, por dhe përfytyrimi i tij në përgjithësi në poezinë e Lasgushit është thjesht një ton muzikor, një melodi e shpirtit njerëzor.

Emocioni lirik në poezinë e këtij poeti ngjan me një muzikë të brendshme, për dashurinë apo për natyrën. Murmurima e liqenit, gurgullima e kroit, kënga e bilbilit, zhurmat, fjetja e natyrës, por edhe zëri i trompetës e bëjnë vargun lasgushian tepër auditiv. Edhe muzgu i mbrëmjes që bie mbi liqen e kthen gjithçka përreth në një imazh që mund të thuhet se tingëllon e kthen liqenin në një jehonë të lehtë dhe të errët që shuhet dalëngadalë, derisa hesht, ashtu si në poezinë nokturn me titull “Poradeci”:

Perëndim i vagulluar mbi Liqerin pa kufir.

Po përhapet dal-nga-dalë një pluhurë si një hije.

Nëpër Mal e në Lëndina shkrumb’ i natës që po bie,

Dyke sbritur që nga qjelli përmbi Fshat po bëhet fir ...

Ritmi dhe rima, prania e tingujve konsonantë e thekseve etj., janë mjetet bazë të melodizmit të poezisë së Lasgushit. Harmonia muzikore e poezive të tij është një harmoni spontane dhe buron jo vetëm nga elementet që u përmendën, por nga stili i tij në përgjithësi, i cili mund të cilësohet si një stil elegant, nga ekspresioni i tij orfeik.

Teksa instrumentet muzikorë shfaqen rrallë, zëri i njeriut, me vetitë e tij magjike e bëjnë muzikën e poezive të tij të prekshme. Në rastin e Lasgushit fjala është tingull. Mirëpo jo vetëm fjala. Tek Lasgushi edhe heshtja në brendësi të ligjërimit (hija e fjalës, siç e quan poeti dhe filozofi Lucian Blaga) ka vlerë muzikore, pra edhe ajo tingëllon.

Nganjëherë tonaliteti i poezisë së Lasgushit mund të imponohet edhe vetëm nga mënyra e përdorimit të një zanoreje si në rastin e përdorimit të zanores -o në poezinë “Gjeniu i anijes”:

Valimi i anijes së letë

Qetohet, ndalohet, mbaron:

Gjeniu i anijes përjetë

Hepohet ... anohet ... valon

Semantika e tekstit këtu nuk i mjafton autorit për të krijuar një imazh emocionant. Muzikaliteti i zanores -o dhe ushtrimi i saj e kanë pasuruar ndjenjën poetike.

Në krijimtarinë e këtij poeti, në mjaft raste hasim disa gjini që janë po aq letrare sa edhe muzikore. Për shembull për poezinë “Të ritë e viteve të mi” autori shënon edhe një nëntitull “Këngë”. Por kënga për Lasgushin është edhe një koncept i traditës të krijimeve popullore në Shqipërinë Juglindore si gjini ndoshta e lindur këtu, por e lindur gjithashtu edhe tek kulturat fqinje, pra kënga e vjetër, apo kënga pleqërishte. Më tepër se kaq, në vjershërimin lasgushian kënga është vetë poezia, si në poezinë me titull “Lamtumirë”:

*Pra këngët që vanë-e më s'janë
Përmythen me mall në mërgim.
I ngrysur mjerimesh pa anë
Vdes Yll'i të riturit t'im*

Në poezi të tjera nga ky autor ndeshim edhe emërtimet: Vaj, Valle dhe Marsh. Kuptimi muzikor i këtyre poezive është i padyshimtë. Shpeshherë gjuha muzikore e poetit është e fakturës popullore. Këtë gjë e shohim jo vetëm në këngën pleqërishte, por edhe në poezitë pastorale, në romancat, baladat dhe në rapsoditë e tij. Në rapsodinë popullore me titull: “Bjenë telat” përveç frymës epike në përmbajtje shohim të mishëruar në formë të “simfonizuar” strukturën dhe logjikën e pasuruar të një kënge popullore :

*Dh'atëhere ... nënë mal ...
Nisi kënga me-nga-dal ...;
Nisi këng' e shenjtëruar.
E j-a mori me të shtruar ...;
E j-a drodhi me të qarë ...
E j-a zjeu ... j-a hoqi zvarë ...;
E pastaj si më s-u ndje,
Zu të ngrihet që përdhe
Gjith' më nge ... e gjith' më nge ...;
E pastaj filloj të ritet ...
E të ngjitet ... e të ngjitet ...*

Në poemën Kamadeva fjala krijon një gamë të begatë idesh, ngjyrash dhe pamjesh sa që me gjithë tiparin kryesor-erotizmin të ndjejmë dridhjet e një lirizmi filozofik:

*Plot ëndje, plot hare,
Dorë-për-dore,
Kënduan përmbi ne
Çetat qjellore;
Gjëmuan yj e qjej
Nga gung'e lartë,
Kumbuan tej-për-tej;
Me tinguj t'artë;*

Mjafton të lexosh këtë poemë dhe të konstatosh se veshi i brendshëm muzikor i poetit dallohej për ndjeshmëri të pazakontë. Kjo poemë është rezultat i frymëzimit të poetit nga poezia me pesë strofa Kamadeva e mjeshtërit të tij të përherëshëm, poetit romantik rumun Mihai Eminescu, si dhe e ndikimit të këtij poeti tek Lasgushi në zgjimin e interesit për filozofinë dhe traditën letrare indiane.

Misto Marko, mik i poetit, më ka treguar se për Lasgushin deklamimi i poezive të Eminescut ishte një rast për të ndierë kënaqësinë e papërsëritshme që e sjell poezia e lartë. Edhe Misto Marko ishte një adhurues i Eminescut. Kështu, herë pas here, në shëtitjet përgjatë liqenit, në Pogradec, ata me radhë do të thoshin vargjet e këtij poeti në gjuhën rumune. Lasgushi e njihte gjuhën rumune në atë nivel sa të shkruante vargje në atë gjuhë, siç është rasti i Poemit të Shën Naumit. Në poemën “Vallja e yjve” Lasgushi i jep një kuptim kozmik dashurisë. Ashtu si përvëlohen yjet digjet edhe zemra djaloshare:

*Sesi ndritesh përsëri!
Sesi ndizesh përsëpari!
Sesi djeg me dashuri
Posi yll margaritari! ...
Dashuri Heu! mall i ri!
Dashuri! këng' e durimit!
Ti liri! Ti robëri!*

Ti valim i shkrepëtimit!

Karakter i intim e i ngrohtë i mendimit, ekzaltimi dhe përsëritja e veprimeve, vrapimi mistik i yjeve që ndjekin njëri tjetrin në vetminë kozmike edhe këtu ka, përveç të tjerave edhe një kuptim melodik. Në rastim e këtij poemi mund të bëjmë një paralele me poezinë *La steaua* (Gjer te ylli) të Mihai Eminescut, me shënimin se tek poemi i Lasgushit përmasat janë krejtësisht të tjera, pra mjaft më të gjëra. Po ashtu tingulli i nuancuar thekson kantabilitetin e gjuhës shqipe. Këtu bëhet fjalë jo vetëm për ritmin, rimën natyrale tipike për autorin, por edhe për pasurinë e gjuhës poetike.

Në këtë mënyrë poeti transformon një dukuri pamore në një akustikë abstrakte kozmogonike. S'do mend se që ta dëgjosh këtë lloj muzike duhet ta lexosh me përqëndrimin e duhur poemin, sepse varet shumë se si lexon, duhet të zotërosh një kulturë një ndjenjë dhe një imagjinatë muzikore që spikat. Vargjet e lexuara në këtë mënyrë na bëjnë të mundur ta kuptojmë plotësisht poetin.

Lasgush Poradeci e ka përpunuar aq imtësisht nga aspekti i tingëllimit vargun sa që poezitë e tij e venë para vështirësive cilindro që provon të shkruajë muzikë me to. Të kompozosh muzikë me vargjet e tij duhet të zotërosh një talent melodik dhe një frymëzim të madh. Shprehja e Lasgushit: "... unë vetëm violinës di t'i bie!" bën prezente jo vetëm faktin se për poetin muzika e poezisë është një realitet fizik, por ajo përcakton edhe natyrën e tonusit muzikor të vargjeve të tij.

Letërkëmbimi i poetit me të shoqen dhe me miqtë është një tjetër dëshmi e muzikalitetit që karakterizon shkrimin lasgushian, një pasuri e prozës muzikore në gjuhën shqipe. Në një letër që i shkruan Asdrenit më 13 shkurt 1926 nga Gratzi, ai midis të tjerave i thotë: "A do që të ndjesh një kënaqje të lehtë në fundin e zemrës, duke dëgjuar nga zëri i të tjerëve muzikën e bukur të veprës sate të shkruar mirëbërëse? Muzikën, po! Sepse brenda mu në valët e zeza me ushëtimë të egër të atij deti pa anë ku gjendesha unë që më 1921 e tëhu, ndihmat e tua të panumëruara morale dhe materiale reprezentonin me të vërtet vlerën e një harmonie gjer atëherë të padëgjuar për veshin tim".

Pra, poezia dhe muzika në shkrimet e Lasgushit ndodhet kudo. Fjalori i tij poetik, stili i tij individual është i pranishëm në çdo gjë të rëndësishme që ai ka shkruar, pavarësisht nga gjinia apo lloji letrar.

Tomas S. Eliot ka thënë se: “Muzika e poezisë nuk është diçka që ekziston e ndarë nga kuptimi i saj. Përndryshe do të kishim poezi me një bukuri të madhe muzikore, por pa asnjë kuptim dhe poezi të tillë nuk kam hasur asnjëherë.”

Lidhur me këtë ide Mitrush Kuteli që në vitin 1937 në studimin *Cateva observatiuni asupra scrierii ALBANICA a d-lui Dr. Anton B.Y. Balota*, pra “Disa vërejtje mbi studimin ALBANICA të zotit Dr. Anton B.Y. Balota” ka theksuar se “...muzikaliteti i vargjeve të Lasgush Poradecit nuk mund të jetë i pavarur nga fondi i poezisë, madje ai përbën një kusht parësor të vlerës poetike”.

Nga sa u tha këtë poet mund ta shohim si një melodist të lindur. Magjia e poezisë së tij qëndron pikërisht në njëjtësimin fonologjik të fjalës me tingullin. Variantet e këtij njëjsimi janë më shumë. Në poezitë e tij me frymë dhe strukturë popullore, pra ato që kanë lindur nga një spiritualitet i njohur vendas, si atmosfera rustike e Pogradecit edhe tonaliteti është autokton. Në poezi të tjera, përveç joneve të melodikës të shqipes ndihet edhe një melos gracioz romantik, i cili mund të konkretizohet, bie fjala, me mbresat që na shkaktojnë meloditë e Schubert-it.

Ideja poetike dhe substanca muzikore në vargjet e këtij poeti gjenden në një sintezë të plotë dhe unitare. Por, duke i krahasuar ato me poezitë e poetëve të tjerë shqiptarë do të dallojmë se tek Lasgushi kjo marrëdhënie mishërohet që në lindjen e vargjeve, pra në gjenezën e poezisë.

Duke qenë poeti që i ka kënduar më bukur, më me mall dhe më me zjarr vajzës ai mbetet poeti i dashurisë. Mirëpo në këtë mënyrë Lasgushi është njëkohësisht, gjithmonë edhe poeti i rinisë. Ndikimi emocional dhe psikologjik i poezive të tij edhe sot është i tillë sa që megjithë progresin e letërsisë shqipe pas botimit të veprës të tij poetike, ai të pranohet si poeti më i madh që kanë nxjerrë shqiptarët.

VLERËSIME TË LASGUSH PORADECIT PËR VEPRËN LETRARE TË FISHTËS

Lasgush Poradeci, njëri ndër lirikët tanë më të shquar të të gjitha kohëve, shfaq një varg mendimesh për estetikën dhe poetikën e letërsisë, përkatësisht për veprën letrare e për rëndësinë e saj, si dhe për ndikimin e shumanshëm që ajo mund të bëjë në marrësin. Mendimet e tij mbështeten mbi një bazë teorike të qëndrueshme dhe në përvojën e tij krijuese, prandaj si të tillë edhe sot janë aktuale. Kjo përlligj një fakt të qenësishëm: poetët e shquar nuk janë bërë të tillë rastësisht, po në bazë të leximit, të dijes që kanë grumbulluar për letërsinë dhe jetën dhe për përkushtimin e jashtëzakonshëm që kanë treguar në punën e tyre krijuese.

Në punimin “Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar” Poradeci jo vetëm përlligj një dije të thellë të njohjes së letërsisë e të veprës së Fishtës, po theksoi dhe disa nga veçantitë e lirikës në përgjithësi e të lirikës së Fishtës në veçanti si dhe rëndësinë e saj në ndikimin dhe pasurimin e shpirtit të marrësit. Në mënyrë të veçantë Lasgushi vështroi burimësinë dhe origjinalitetin e veprës së Fishtës dhe ndriçoi disa nga përbërësit kryesorë si gjuhën poetike, sistemin e të shprehurit poetik, që bëjnë shpirtin e poezisë dhe e bëjnë veprën e tij të rëndësishme dhe Fishtën poet të madh.

Pikëpamjet për letërsinë dhe natyrën e saj, në mënyrë të veçantë për poezinë¹⁸³, Poradeci i shfaq në disa vepra dhe punime: “Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullore – atdhetare” (Studim gjenetik

¹⁸³ Revista “Fjala”, Viti XII, nr. 22, 15 dhjetor 1979 botoi disa punime të rëndësishme kushtuar veprës poetike të Lasgush Poradecit.

duke pasur parasysh lidhjet me kulturën gjermane)¹⁸⁴, “Lasgushi më ka thënë...Shënime nga bisedat me Lasgush Poradecin¹⁸⁵”, “Poezi, et coetera...¹⁸⁶” dhe “Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar¹⁸⁷”.

Në këto vepra dhe punime ai shprehu disa nga qenësitë e artit të fjalës, brenda tij dhe të poezisë. Kështu, duke folur për veprën e poetit të shquar rumun, Emineskut, ai veçoi sidomos gjuhën dhe formën që autori i jep veprës së vet, si përbërës thelbësorë, për arsye se nga ata varët vlera dhe ndikimi estetik i saj në marrësin. Këtë mendim Poradeci e konkretizon kur bën fjalë për poezinë “La steaoa...” të Emineskut, e cila dallohet për mënyrën e shtjellimit dhe të shprehurit të mëvetësishëm dhe të tërësisë së idesë: “[...] Imazhet e përgjithshme në fund të fundit janë të njëjta në të gjithë botën, dhe një mendje që krijon vepra artistike mund të na tërheqë vëmendjen me veprën ‘e saj’ kur ajo arrin që t’i gatuajë këto imazhe të përbashkëta dhe të përgjithshme në një formë karakteristike, ku rëndësi vendimtare ka trajtimi individual i intuitës estetike. Kur flasim për Shopenhauerin merita e artistit nuk qëndron ‘në lëndën për të cilën ai ka menduar’ për të, por në ‘formën, d.m.th. përpunimin e lëndës, pra çfarë ai ka menduar për të¹⁸⁸”.

Brenda letërsisë si art i fjalës, Poradeci e çmonte sidomos poezinë, me të cilën merrej duke e ngritur lirikën shqipe në majat e saj. Sipas tij ajo është krijesë e hyjnishme dhe se ai që e krijon duhet të jetë i mbujtur më cilësi hyjnore: “Poezia është divine (hyjnore). Prandaj, kur shkruan

¹⁸⁴ Prof. dr. Lasgush Poradeci (Lazar Gusho), *Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullore – atdhetare*. Studim gjenetik duke pasur parasysh lidhjet me kulturën gjermane. Argeta LMG, Tiranë 2009.

¹⁸⁵ Petraq Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...Shënime nga bisedat me Lasgush Poradecin*. Botimi i dytë i plotësuar. “Toena”, Tiranë 1999.

¹⁸⁶ Lasgush Poradeci, *Poezi, et coetera...* Në Ibrahim Rugova. Sabri Hamiti, “Kritika letrare. Tekste. Shënime. Komente”. Rilindja, Prishtinë 1979, f. 413 – 423. Për herën e parë punimi u botua në “Shkëndija” gusht 1940. Shih për datën e botimit të këtij punimi në Lasgush Poradeci, *Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*. Në At Gjergj Fishta. Shkëndija, 1941, f. 21.

¹⁸⁷ Lasgush Poradeci, *Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*, pun. i përm., f. 20 – 30.

¹⁸⁸ Prof. dr. Lasgush Poradeci, *Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullore – atdhetare*, vep. e përm., f. 29.

poezi, duhet ta kesh shpirtin të shenjtëruar. Çdo poezi duhet të jetë një xhevahir dhe xhevahir duhet të jetë çdo varg i saj dhe çdo fjalë e saj duhet të jetë xhevahir¹⁸⁹”.

Në punimin sa të veçantë aq dhe të rëndësishëm “Poezi, et coetera....¹⁹⁰” Lasgush Poradecit e pasuroi dhe e thelloi në shumë aspekte konceptin e tij estetik dhe poetik për veprën letrare dhe sidomos për poezinë. Poezia është krijesë poetike që flet vetë për vetën e saj dhe se me rëndësi të veçantë është kur poeti dëshmon mëvetësinë e gjuhës që përdor dhe mënyrën e të shprehurit në tekstin e vet: “A ka realizuar, prej asaj lënde brute, një vepër *origjinale të re, të fuqishme, plot ekspresivitet vetjak?* “Imitimi” - relevojnë “eruditët”!; *krijimi i ri - relevon poeti!* Kështu them unë. Krijimi i ri, prej lëndës së vjetër... Asnjë, nga gjithë veprat artistike me jetë të përbotëshme, s’është ‘origjinale’; trupi i tyre është i ‘huaj’; vetëm *shpirtin*, them unë, s’i-a-u disputon dot njeri. As njeri, them unë, as perëndi. Njeriu, them unë, është më pak se Perëndija më shumë se njeriu, po shpirti *lith* njeriun me perëndinë dyke valuar madhërisht midis dyve: ja! Ky është, them unë, *shpirti* i veprave artistike të vërteta, *qënia metafizike* e artistit *ri-krijonjës*, e *tretur në veprën - rikrijonjëse të tij!*¹⁹¹”.

Sipas Poradecit, në artin e fjalës forma, përkatësisht struktura gjuhësore poetike, ka rëndësi kryesore; ajo është përbërësi që i jep shpirtin poezisë, i jep origjinalitetin secilës krijesë poetike dhe secilit poet¹⁹².

“Pra, duhet jo fabula, po Gehalt, Fond, një fond, përmbajtje sa e lartë aq dhe e thellë dhe e fortë. Kjo përbën bazën për fillimet e një poezie, d. m. th. një dashuri e ndjerë thellë, një dashuri për atdhe, për liri etj. Kushti i dytë është ky:

¹⁸⁹ Petraq Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...* Shënime nga bisedat me Lasgush Poradecin, vep. e përm., f. 89.

¹⁹⁰ Lasgush Poradeci, *Poezi, et coetera....* Në Ibrahim Rugova. Sabri Hamiti, “Kritika letrare, pun. i përm., f. 413 – 423.

¹⁹¹ Lasgush Poradeci, *Poezi, et coetera....*, pun. i përm., f. 416 – 417.

¹⁹² Në shpalosjen e tipareve të lirikës Poradeci vë në dukje: “Lirika qëndron shumë lart dhe shumë fellë, nuk shtrihet as gjerë as gjatë, ajo domethënë thjeshtësisht frymëzim. Një vepër, që ka frymëzim, që ka tronditje shpirtërore, është lirike vetvetiu. Për një shumicë njerëzish që nuk mund të ndjejnë ata vetë, nga vetëdija e tyre frymëzimin, me fjalë të tjera tingëllin, tonin e qendrës, lëkundjen dhe tronditjen shpirtërore të një vepre, për ata s’ka lirizëm¹⁹²”. Shih Lasgush Poradeci, *Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*, pun. i përm., f. 20.

Kësaj përmbajtje, të dish t'i japësh një formë të përsosur. Pa këtë formë të përsosur artistike, sado e lartë dhe e thellë dhe e fortë të jetë ndjenja, rezultati është zero. Sepse:

Kunst heist Form (Art do të thotë formë).

Po të mos ketë një formë të përsosur që në kompozimin e përgjithshëm deri në çdo varg e në çdo fjalë, poezia s'del mirë.

Kushti i tretë është ky: Kjo përmbajtje dhe formë që ke gjetur duhet të jepen nëpërmjet një stili të ri, origjinal, të panjohur përpara. Dhe ky stil jep individualitetin e artistit ¹⁹³”.

Këto veçanti të letërsisë dhe brenda saj të poezisë, Poradeci i qëmton dhe i ndriçon në veprën poetike të Fishtës ¹⁹⁴: në poezinë lirike, në atë epike, përkatësisht në “Lahutën e Malcís” (të cilën Fishta nis ta shkruajë në fillim të shekullit XX dhe e mbaroi më 1937, kur dhe u botua) dhe për poezinë satirike.

Pikëpamjet kryesore për poezinë e Fishtës, Poradeci i shprehu në punimin “Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar”, ku thekson disa nga veçantitë e lirikës në përgjithësi e të lirikës së Fishtës në veçanti, shpalos burimësinë dhe origjinalitetin e artit të Fishtës, transfigurimin poetik që gjen zbatim sidomos në “Lahutën e Malcís” dhe rëndësinë e saj në ndikimin dhe pasurimin e shpirtit të marrësit, të dëgjuesit ose të lexuesit. Poradeci shkruan: “Thua se gjithë vepra e tij, në krye të së cilës dhe veçanërisht për sa po merremi ne këtu përmbi çdo tjetër konsiderim Lahuta, është konceptuar dhe trajtuar nga një frymëzim i realitetit të prerë shqiptar. Shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar – ky është si të thesha monopolariteti gjenetik i artit të Fishtës, kështu do t'i thesha me dy krahasime paralele gjithë poezisë që na ka falur ky vigan i kombit: në të cilën duket sikur këndon ose lufton vëndi dhe jo fjala, dhe e cila duket sikur është mbërthyer ose shpërthyer prej tokës dhe jo prej fjalës ¹⁹⁵”.

Në rrafshin konkret të vëzhgimit të lirizmit të Fishtës, Poradeci veçon:

¹⁹³ Petraq Kolevica, *Lasgushi më ka thënë...Shënime nga bisedat me Lasgush Poradecin*, vep. e përm., f. 86 – 87.

¹⁹⁴ Shih për veprën letrare të Fishtës librin: Anton Nikë Berisha, *Vepër e qenies dhe e qenësisë sonë. Vëzhgime mbi artin poetik të Fishtës*. “Shpresa” & “Faik Konica”, Prishtinë 2003.

¹⁹⁵ Lasgush Poradeci, *Gjergj Fishta lirik...*, pun. i përm., f. 24.

“Fishta e ka veshur lirizmën e tij të vërtetë si tërë kryeveprën epike në një stil thelbësisht original të shkukur për rrënje nga trupi dhe nga truri i racës, dyke fituar me këtë atavizmë artistike gjithë të drejtat e përjetësisë ndaj Kombin- anasjelltas dyke i dhënë Kombit privilegjin e mburrjes dhe të mbështetjes së kurdoherëshme mi Këngëtorin e math të fateve të tija ¹⁹⁶”.

Duke e shpalosur edhe më tej natyrën dhe qenësinë e lirikës, Poradeci vë në dukje “Esenca e poezisë lirike është muzika shpirtërore, dhe muzikën shpirtërore e bën toni shpirtëror, dhe tonin shpirtëror e bën drithma shpirtërore, lëkundja, tronditja shpirtërore – kurse tronditjen shpirtërore, domethënë, me një fjalë neologjije, emocionin shpirtëror e bën as më shumë as më pak përveç se frymëzimi i brëndshëm poetik i cili duket dhe ndjehet dhe kuptohet prej vetiu dhe drejt-për-drejt në transfigurimin emocional të idesë ose ndjenjës ose pamjes aktuale të poetit. Këto i shkruaj në themelin e vërejtjes plot dashuri të një së vërtete shpirtërore, të asaj që, pjesërisht, them se kam gëzimin të ndjej dhe unë si punëtor i thjeshtë po i etuar për art dhe harmoni në çaset kur më këndon shpirti; kjo e vërtetë kuptohet vetëm nga një pjesë e fisit njerëzor, pikërisht nga ajo e cila është pajosur prej nature dhe është edukuar prej lëçitjes dhe studimit me ndjenja poetike, me mundësinë e shijimit artistik të brëndshëm. Të tjerët – profesorë, didaktë, eruditër, teorikas, mundohen me vëzhgimet e tyre voluminoze mi poezinë, të themeluara në methudhën shkatërronjëse të analizës, të kuptojnë dhe të kapin sadopak një të njëmijtën pjesë nga vlera poetike e vërtetë e një vepre dyke patur si përfundim kapjen e vetëm të një së-miliontës pjesë të saj. Sepse kapjen esenciale e ka vetëm poeti si dhe ay numur i paktë i të iniciuarve me shijen letrare ose poetike ¹⁹⁷”.

Sipas Poradecit ajo që e përcakton dhe i jep vlerën kryesore lirikës së Fishtës është gjuha, sistemi i të shprehurit poetik, që bën shpirtin e poezisë së tij: “Me një butësi dhe njomësi fjalësh, me një tingëll këngëtor, ay na ka shfaqur regëtimën e fshehtë për ne të engjëjvet fluturakë që e rrethonin, dyke i-a prekur me gishtërinj prej rezesh djelli, ndonëse rrallë, gamën e kordhëzave të holla të lirës. Dhe këtë butësi

¹⁹⁶ Lasgush Poradeci, po aty, f. 30.

¹⁹⁷ Lasgush Poradeci, po aty, f. 23 – 24.

dhe njomësi gjithnjë të shfaqur me fjalën plot, me pamjen reale, me fytyrat konkrete që shihen me sy dhe preken me dorë: Vasha e Nazaretit vjen lart prej shkretëtire ndaj Jordanin, dyke lëshuar përçark hiret e saj të perëndishme¹⁹⁸”. Poradeci e çmon sidomos gjuhën e veçantë që përdor Fishta: “Kështu, e mbujtur prej lëndës shqiptare: substanciale, realiste fund-e-krejt, kish për të dalë kënga e Fishtës, me një gjuhë që të ngop/ që është gjuha mashkull e Zotërve të Shqipërisë:

Ká me dalë kanga dikúr

E kahdo qi shqypja t’flitet

– Kjo e mashkulla giûhë hyjnish-

Ká me u kndue nder burra t’ dheut.

(Zana e Vizitorit)

Në këtë gjuhë mashkull, me të cilën është ndërtuar dyke hedhur gur përmi gur dhe shkëmb përmi shkëmb stili elementar i Fishtës, ay pat shprehur një ton të ri të zemrës i cili, me valën kur e kur minore, të përgazëshme ose hirplote, qëndron si në diskordancë kundrejt karakterit përgjithësisht të rreptë të poezisë së tij¹⁹⁹”.

Natyrën e gjuhën dhe mënyrën e të shprehurit në poezinë e Fishtës Poradeci e lidh dhe me veçantinë dhe harmoninë tingëlluese: “Po tashi, më në fund, vjen si kompensim antipoli i këtyre veçanërive kakofonike, të transpozuar, tashi, në një harmoni energjije, në muzikën sui generis të stilit artistik të Fishtës, një muzikë e akcidentuar plot fjalë të realitetit, plot fytyra të naturës, plot shprehje dhe krahasime të fizikës dhe të tokës, dhe që është origjinaliteti më i bukur i tij, realizimi më i vetëkuptimshëm i fjalorit epiko-lirik shqiptar²⁰⁰”.

Duke e thelluar vëzhgimin e tij për lirikën e Fishtës përballë shqiptimit të realitetit konkret, Poradeci shkruan: “Nga këto fytyra duket, si një fjalë ose shprehje realiteti, ka fuqi të transformojë gjithë vargun dhe strofën në emocion artistik të stërhollë. Shpiegimet përkatëse ndihmojnë për një kuptim dhe shijim të tyre. Ato i shërbejnë mëndjes profane, të painiciuarve në tempullin e artit. Po zemra që di të ndjejë vetë, dhe veshi që di të dëgjojë vetë magjinë poetike nër tingujt e saj,

¹⁹⁸ Lasgush Poradeci, po aty, f. 25.

¹⁹⁹ Lasgush Poradeci, po aty, f. 25.

²⁰⁰ Lasgush Poradeci, po aty, f. 28 – 29.

syri që di të shohë vetë shfaqjet dhe pamjet e çkëputura drejt-për-drejt prej naturës për të na reveluar metafizikën e artit të poetit që quhet lirizmë – ajo zemër dhe ay vesh dhe ay sy më s'kanë, tashi, për ç'nevojë t'a duan shpiegimin estetik ose filologjik, sepse tashi poeti sjell njëren pas tjetrës të radhosura me shumicë, me tepërim gjithë fytyrat e elementit konkret të realitetit që përdor në atelierin e tij. Dhe kësisoj harrin të derdhi, përmjet atij elementariteti, një poezi me ton lirik të përplotë ²⁰¹”.

Në vazhdim të konkretizimit të ndriçimit të të veçantës së gjuhës e të stilit të Fishtës, Poradeci thekson: “Po ana e vërtetë, e rëndë, e stilit të Fishtës, pjesa me të vërtetë Fishtore që domethënë forcë dhe fuqi dhe energji dhe naturë e pandryshuar, realitet tokësor dhe dinamizmë titanike e poezisë së tij, ajo anë që e qojta mbesoj me përshtatësi dyke perdorur shprehjen *shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*, ajo përbën sasinë e madhe, që i përmyt të gjitha, të veprës së tij siç është çfaqur kryesisht në *Lahuta e Malcís*. Dhe pikërisht në *Lahutë* gjinden shëmbëllat më të bukura të gjithë këtij stili, të këtij stili të rëndë, të dhëshmë, shkëmbor... ²⁰²”.

Poradeci vërejtë dhe një përbërës të rëndësishëm të veprës poetike të Fishtës: ndërlihdjen e të përshpirtshmes, hyjnores, me atdhedashurinë, këtij njësimi që kishte zënë fill me shkrimtarët tanë të vjetër, Buzukun, Budin, Bogdanin: “Gjithë vepra poetike dhe shoqërore e At Gjergj Fishtës u pat zhvilluar rreth postulatit fetar dhe kombëtar. Me të vërtetë, ku ka ide dhe ndjenjë më të madhe, më të denjëshme për t'a derdhur dhe kënduar në art, sesa ideja e Zotit, ideja e Atdheut! Këto thema Fishta i përplavduroj si artist dhe si njeri dyke realizuar të dy atributet e përjetëshme, luftonjësinë dhe mendonjësinë, të besimit fetar ku ish kushtuar, të cilin ay e rrethonte përhera me fytyrën mistikërisht të adhurar të Atdheut; kështu që Ecclesia militans në përqafim me një atdhedashuri të përvëlur pat gjetur shprehjen aq shpesh në vargjet e tij, veçanërisht me fjalën që është bërë si urdhërim i gjallë në kulturën edukonjëse të letrave shqiptare: Shqiptari prej race, është vetë Shqiptari i Fishtës sa të jetë jeta, Shqiptari i përjetshëm, siç ka qënë, siç do të

²⁰¹ Lasgush Poradeci, po aty, f. 26.

²⁰² Lasgush Poradeci, po aty, f. 28.

jetë: Ay i cili për Fe dhe Atdhe e bën vdekjen siç e ka patur zakon gjithnjë – si me le. Feja e përqaftuar kësimeñyre me idenë e Atdheut përbën bipolaritetin e Qëndrës tokësore-qiellore të zemrës së poetit midis nesh dhe për të cilën ay na la, si trashëgim, testamentin e tij të zjarrshëm me fjalët që na flasin në fundin e vetëdijes s’onë ²⁰³”.

Gjithë kjo shtrihet në një rrafsh e përmasë të gjerë: “Dhe kështu në shprehje të panëmëruara të veprave të tija, të mbushura kudo dhe në çdo rast me frymëzimin e fjalës së perëndishme dhe të atdheshme të qëllimit të tij prej misionari. Kulminimi i këtij misioni është ndritja e njeriut shqiptar me anën e principit fetar meditativ: Ecclesia meditans dërgon Verbin e përjetshëm në strofat që përmbledhin esencën e Saj, ndritjen e njeriut, për t’a bërë të përsosur dyke e afruar ndaj Zotin [...] Një sërë shkrimesh dhe vjershash i ka kushtuar Fishta drejt-për-drejt ose tërthorazi këtij ideali fetar, për mbajtjen dhe lartësimin e të cilit ay pat veshur që në vogëlinë më të njomë gunën e thjeshtë me litarin e Shën-Françesku ²⁰⁴”.

Në vijim të vështrimit rreth “Lahutës së Malcís ²⁰⁵” të Fishtës, Poradeci thekson: “[...] gjejmë transfizikën e krijimit, kriterin e math të një veprë origjinale. Gjejmë - tronditjen e re. Dhe para kësisoj, mësojmë se dhe në përfytyrimin e Lahutës kemi lirizmë, krijim të ri nga një tronditje e re shpirtërore. Prova dhe këtu? shënja? Shkruaj me këtë rast për ata që e duan poezinë, që janë lindur vetiu me shijen letrare, dhe për këta është një gëzim i lartë estetik të marrin vesh tashi të mosmarrurënvësh dhe të ndjejnë të mosndjenjurshmen në vetitjat primordiale të veprës së artit. Kur Át Pal Dodaj, më i pari Provinçjal shqiptar i Urdhërit Françeskan dhe shoku i pandarë gjer në vdekjen e Fishtës prej dyzeteshtatë vjetësh dhe dy muaj, e pyeti Marash Ucin edhe të gjallë dyke i lëçitur rapsodinë omonime të Lahutës që si i duket, a është ‘ashtu’? – fatosi i përlavduruar në atë Këngë i-u përgjigj me modestinë lakonike të institucionit të tij: diçka ka shtuar. Kjo diçka është

²⁰³ Lasgush Poradeci, po aty, f. 22.

²⁰⁴ Lasgush Poradeci, po aty, f. 22.

²⁰⁵ Eqrem Çabej, duke bërë fjalë për rëndësinë dhe vlerën e veprës epike të Fishtës, përveç të tjerash, thekson: “Lahuta e Malcís është së fundi vepër vetiake e poetit, vepër arti e plotë, e përsosur dhe e përkryer në vetveti”. Shih Eqrem Çabej, *Epika e Gjergj Fishtës*. Në “At Gjergj Fishta”. Shkëndija, 1941, f. 30.

transfigurimi poetik, shtesa e gjeniut, frymëzimi dhe tipizimi lirik i gjithë poemit. Në mënyrë të dukur (të dukshme) na e çfaq përfytyrimin e tipizuar kësisoj të Lahutës forma, së cilës Fishta i ka dhënë një shërtim me vargje dhe fragmente dhe pjesë lirike të rralla, dyke i-a ndërruar dhe pasuruar përmbajtjen si pas një urdhërimi ndjenjor të lartë. Gjer edhe stili dhe fjalori është shpesh herë subjektiv, i vetëkrijuar. Një frazë dhe një epitete, një cilësim i rastit e përjashton rrëfimin panjepady nga nevojësia e tij obiective, dyke e futur me parapëlqim, siç ngjan kjo me këngët t'ona popullore, në subiectivizmen e zakonëshme të poetit²⁰⁶,

Poradeci e përforcon këtë mendim të tij dhe shton: “Dhe ja sesi: dyke invokuar në vënd të Lahutës ndihmën e Orës së tij së mirë, dy-fish e bën poeti lutjen e tij: Më një anë ay kërkon dhuratën e ëmbëlsisë, të butësisë, më tjetrën anë atë të fuqisë dhe rreptësisë së fjalës poetike [...] Kështu: butësi dhe forcë, jo tjetër. Pse? Sepse kjo ka lidhje me esencën e gjithë poezisë së Fishtës, të gjithë krijimit të tij poetik, epizmë ose lirizmë ose dramatismë qoftë. Sepse esenca, natura e fellë e poezisë rrëfenjëse ose këndonjëse ose vepëronjëse e tij është puthosur me tokën dhe vëndin, me zemrën dhe frymën e popullit shqiptar prej gjirit të të cilit ay doli, dua të them u shkëput sikundër shkëputet një copë prej një tërësisje²⁰⁷”.

Brenda “Lahutës së Mlacís” Poradeci vëren dhe përmasën e thellë të lirizmit: “Po përmi të gjitha këto Lahuta e tërë në koncepcionin e saj ka një karakter që s’i përshtatet as epopesë as poemit epik të regullshëm, klasik, që çquhen nga një obiectivizmë e plotë në tratimin artistik ose në vajtjen e vepërimit, dyke qënë një poem çquarësisht epiko-lirik: epikë obiective ku ndërhyjnë në çdo rast pjesëmarrja e shpirtit të poetit, me derdhjet lirike të vetëkuptuarshme dhe të pamunguarshme të tija²⁰⁸”.

Lasgushi e çmon lart dhe satirën e Fishtës, që bën njërën nga pjesët më të rëndësishme të krijimtarisë së tij poetike: “Nuk duhet harruar trumbat me gjemba e satirave, *Anzat e Parnasit*, të mbushura me një

²⁰⁶ Lasgush Poradeci, *Gjergj Fishta lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*, pun. i për., f. 21.

²⁰⁷ Lasgush Poradeci, po aty, f. 24.

²⁰⁸ Lasgush Poradeci, po aty, f. 21.

shfryerje mendimtare të tharbët, të tmerrshme, dhe të cilave Fishta - më rrëfen At Pali - iu jepte për veten e tij më shumë rëndësi sesa Lahutës²⁰⁹,

Pra, në satirën fishtiane del ajo që thotë Poradeci: *“Krijuesi kombëtar i vetëdijshëm prej kombësije shqiptare të pavetdëshme”*, i cili nuk kurseu asgjë për ta bërë edhe atë të vetëdijshme, që është synimi kryesor i gjithë veprës së tij poetike.

²⁰⁹ Lasgush Poradeci, po aty, f. 21.

Po sjell këtu dhe mendimin e Ernest Koliqit të shfaqur më 1956: “Vishkullen e sarkazmit Fishta e përdori me qortue shqiptarin dhe me nxitë të rrahi udhen e drejtë të qytetnís dhe fisnikoi në vepër të vet prirjen e talljes që nganjihërë ndër ne shtihet në punë me vra zemra dhe me përtrí ngatrrësia e dasina. Gjuha shqipe sikur asht e pasun në skaje e fraza ku idhnimi e mënjia shfrejnë me ma të madhen gjallní, ashtu ka mundsí të lakohet e të përkulet në shprehje dykuptimshe, ku xhixhillon ironia e ku fjala në mbrendinë e vet që duket e mitun përmban thumbin ma shporrues”.

MATILDA PARLLAKU
Departamenti i Gjuhës Shqipe
Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
Universiteti i Tiranës
collakumatilda@yahoo.fr

**TË PËRKTHESH SI LASGUSHI.
KUR PËRFTESAT STILISTIKE RRAFSHOJNË DALLIMET
MES PËRKTHYESIT DHE AUTORIT**

Fakti që Lasgushi përktheu nga gjuhë të ndryshme, madje me shumë dashuri e xhelozri për shqipen është i njohur jo vetëm nga ai vetë, nëpërmjet intervistave për periodikët e kohës, por edhe nga punime të botuara nga studiues të ndryshëm të veprës së tij. Mendojmë që është me interes, që nëpërmjet këtij studimi të sjellim një këndvështrim specifik në lidhje me përftesat stilistike të shfrytëzuara nga Poradeci gjatë përkthimit të poezive nga gjuha frënge. Duke lexuar përkthimet e tij të bën përshtypje se si ato mund të jenë kaq të ngjashme me poezitë e krijuara nga vetë ai dhe bëhesh kureshtar ta krahasosh variantin e përkthyer me origjinalin në gjuhën frënge. Pikërisht kjo është metoda që do të na ndihmojë gjatë këtij studimi për të njohur aftësitë e Lagushit si përkthyes dhe si njohës shumë i mirë i gjuhës burimore dhe sidomos asaj amtare, për të realizuar variantin që ka në dorë lexuesi. Korpusi që do të shfrytëzojmë për këtë studim përbëhet nga poezitë e përkthyer prej tij nga frëngjishtja dhe të botuara përkatësisht në dy vëllime të ndryshme, njëri në vitin 1975 dhe tjetri në vitin 1984. Nëpërmjet rezultateve që do të nxirren nga ky studim do të mund të kuptojmë vlerat e një poeti përkthyes që, kur realizon një përkthim të vargëzuar sipas stilit të tij, e bën poezinë e përkthyer, siç shprehet ai, “*që të ketë pak Shqipëri brenda*”.

1. Poet i talentuar, përkthyes profesionist

Është shkruar shumë për vlerat e çmuara të Lasgush Poradecit si poet, por edhe për vlerat e veprave të tij. Por ai është nga ata autorë, për të cilët ka gjithmonë për të thënë. Në fakt, për përkthimet e tij ka (shumë) pak shkrime, madje më tepër, për këtë angazhim ka folur ai vetë.

Të gjitha vlerësimet e studiuesve apo kritikëve të Lasgush Poradecit veçse ia kanë shtuar vlerat poezive të tij, duke i bërë lexuesit gjithnjë e më kureshtarë për t'i lexuar e rilexuar dhe të tjerët, më të etur për t'i shijuar apo analizuar nga ana gjuhësore apo stilistike këto vepra me vlera letrare. Të shkruara në periudha të ndryshme historike dhe letrare, këto vargje poezish përkatësisht poemash do të paraqitnin mjaft vështirësi, duke u lexuar në të njëjtën periudhë kohore, por poemat e V. Hygosë, ndihen shumë aktuale pikërisht prej mjeshtërisë së poetit përkthyes Lasgush. Ja një nga zgjedhjet e tij më të goditura që përkon me aktualitetin, sidomos në ditët e sotme:

*“Meqë n`humnerë është i drejti,/ Meqë i jepet krimi skeptri,/ Meqë çdo e drejtë është tradhtuar,/ Shnderimi i atdheut t`adhuruar; ... Meqë çdo shpirt po dobësohet,/ Meqë ecet zvarrë, meqë harrohet,/ E Madhja, e Bukura, e Vërteta,/ Dëshmorët në varret e veta; ... Të dua, mërgim! Dhëmbje, të dua!/ Trishtim, je diadem për mua!/ Të dua o varfëri e shënjtë!/ Bri meje si statujë e vrënjtë./... Liri, – krenaria e mërguar,/ Kushtim, - i madhi i internuar.”*²¹⁰

*Puisque le juste est dans l`abîme,/ Puisqu`on donne le sceptre au crime,/ Puisque tous les droits sont trahis,/ Le déshonneur de mon pays; ... Puisque toute âme est affaiblie,/ Puisqu`on rampe, puisqu`on oublie,/ Le vrai, le pur, le grand, le beau,/ Et ceux qui sont dans le tombeau; ... Je t`aime exil! Douleur, je t`aime!/ Tristesse, sois mon diadème!/ Je t`aime, altière pauvreté!/ Qui vient s`asseoir à mon côté./ Toi, liberté, fière exilée,/ Et toi, dévouement, grand proscrit!*²¹¹

Janë të rrallë ata që mund t'i përfaqësojnë e t'i shprehin të dyja poetin dhe përkthyesin: “S’ka gjuhë që s’mund të përkthehet, po ka poetë që s’dinë të përkthejnë, ashtu siç ka poetë që s’dinë të bëjnë poezinë. Po a ka gjuhë më pak poetike, -thotë ai, se frëngjishtja, që i ka të gjitha fjalët oksitone? Po mos ka pengesë kjo gjuhë që të nxjerrë poetë aq të mëdhenj? Ku pyet poeti! Dhe ca më pak shqiptar! Se shqipja ka mundësi të pakufishme për të krijuar dhe për të përkthyer. Ajo ka fjalë

²¹⁰ *Meqë n`humnerë është i drejti*, në V. Hygo, *Ndëshkimet*, e përkthyer nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, (titulli i origjinalit “Les châtements”), Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1975, f. 82.

²¹¹ https://poesie.webnet.fr/lesgrandsclassiques/Poemes/victor_hugo/puisque_le_juste_est_dans_labime

të shkurtra, të gjata, oksitone, paroksitone, proparoksitone, ç'të duash ka!"²¹²

Poezitë e tij, Poradeci i ka shkruar përkatësisht në vitin 1933 - "Vallja e yjeve" dhe në vitin 1937 - "Ylli i zemrës". Ndërkohë, poezitë që ka përkthyer janë shkruar nga shkrimtarë në periudha të ndryshme, konkretisht: V. Hygo i ka shkruar në vitet 1852-1853, kurse poezitë në gjuhën frënge, të zgjedhura nga autorë të tjerë që kanë jetuar në periudhën kohore nga 1818 deri më 1933, mund të jenë përkthyer rreth viteve '60, kur përkthimi për Poradecin ishte një mënyrë jetese, nga ana financiare, por një kënaqësi e përhershme shpirtërore që e bënte të përhumbej mes përkthimit dhe rikrijimit.

Arsyen pse ka qenë mjaft përzgjedhës në poezitë që ka përkthyer e shpjegon vetë në një intervistë për shtypin e kohës: "Unë njëherë si Lasgush, nuk kam përkthyer kurrë asgjë, se kam qenë xheloz. ... Poezitë që kam zgjedhur unë për të përkthyer, kanë pasur gjithmonë një Shqipëri aty brenda."²¹³

Ndoshta ky ka qenë edhe një nga qëllimet e Poradecit që, duke u dhënë frymën shqiptare poezive që përktheu, jo vetëm tregoi njohjen e thellë të gjuhës shqipe, por edhe e pasuroi atë me forma e shprehje të reja. "Kur zotëron gjuhën tënde, edhe poezia e përkthyer, del e madhërishtme. Pa gjuhën tënde, s'ka; laj duart dhe shko. [...] Poezinë që përkthen duhet ta krijosh shqip. Përkthe, të themi, një poezi gjermane, franceze, italiane, angleze. Kur e përkthejmë atë në shqip, ne i japim frymën shqiptare. [...] Edhe unë kam përkthyer ndonjë poet të rëndësishëm, po ia kam tundur, ia kam shkundur mustaqet. Domethënë i kam dhënë frymën shqiptare."²¹⁴

"U ngrysi! dhe ra një natë e thellë, natë e nxirë;/Hij` e paanë krahët mbi botën i ka

shtrirë./ Në pallatet e qeshur, prej topave të mpruar, / Në shtretër kadifeje, mëndafshi të paçmuar..."²¹⁵

²¹² *Dy portrete të Lasgushit*, 23-25 korrik 1985.

²¹³ A. Plasari, *Që vargu të dalë shqipërisht*. Përkthimet e Lasgushit, në, Nëntori 12/1987, f. 117.

²¹⁴ Po ai, po aty, f. 118.

²¹⁵ "Është natë", në V. Hygo, *Ndëshkimet*, e përkthyer nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese "Naim Frashëri", (titulli i origjinalit "Les

Mbi dhé të duhemi me zjarr. Të duhemi pa u ndarë.

Mos beso se do rrosh në varr. Të duhemi që më parë.

*Pluhurat kur t'i bashkojmë, era ka për t'i marrë.*²¹⁶

“Të tëra,- thotë Poradeci, përkthyesi duhet t'i zgjidhë vetë, t'i krijojë vetë. T'i dalin prej shpirtit, prej zemrës. Pastaj, duhet të kesh kulturë. Se flasim për poezinë, apo jo? Dhe përkthyesi duhet të njohë mirë poezinë e përbotshme. ... Se poezia është vetë kulturë. Si mund të flasësh për kulturën tënde duke mos njohur kulturën e përbotshme?”²¹⁷

Këmbëngulja për të vënë në dukje një veçanti (njohjen e gjuhës shqipe) që duhet të ketë një përkthyes i një gjuhe të huaj, na bën të kuptojmë, jo vetëm rëndësinë që Poradeci u jep përkthimeve të mira, por sidomos na bind, nëpërmjet këtij pohimi, për shkallën e lartë të njohjes e të zotërimit të gjuhës shqipe, bindje e cila përforcohet duke lexuar poezitë e përkthyerat prej tij.

*Unë asnjë ditë s`kam menduar/ Se mund të jesh një qenie e vdekshme./
Parajsës të kam përngjasuar,/ Çdo gjëje q`i thonë e përjetshme.*²¹⁸

“Ai që përkthen duhet të dijë shumë mirë gjuhën shqipe. Sidomos kur përkthen një poezi. ... Po, po. Po duhet të dish gjuhën tënde njëherë. Se s`mund ta japësh atë bukuri të gjuhës së huaj në gjuhën tënde, kur nuk zotëron gjuhën tënde njëherë, kur s`ia di tërë sekretet, tërë bukurirat, tërë hollësitat, tërë. Të jesh pra njohës i madh i gjuhës tënde.”²¹⁹

2. Përkthime apo rikrijime të poetit - përkthyes

Pohimi i tij i mëposhtëm përlligj çdo ngjashmëri mes këtyre dy llojeve të poezive, përkatësisht të krijuarës dhe të rikrijuarës prej tij: “Ai

châtiments”), Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1975, f. 69: “*C`est la nuit; la nuit noire, assoupie et profonde./ L`ombre immense élargit ses ailes sur le monde./ Dans vos joyeux palais gardés par le canon/ Dans vos lits de velours, de damas, de linon, ...*” <https://www.poesie-francaise.fr/victor-hugo/poeme-c-est-la-nuit-la-nuit-noire.php>

²¹⁶ *Duhet të duhemi*, Paul Fort në Poezi franceze (Nga fillimet deri në ditët tona), (Përgatitur dhe pajisur me shënime nga P. Misha), Shtëpia botuese, “Naim Frashëri”, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1984, f. 453.

²¹⁷ A. Plasari, *Që vargu të dalë shqipërisht*. Përkthimet e Lasgushit, në, Nëntori 12/1987, f. 121.

²¹⁸ *Asnjë ditë s`kam menduar*, në Poezi franceze (Nga fillimet deri në ditët tona), (Përgatitur dhe pajisur me shënime nga P. Misha), Shtëpia botuese, “Naim Frashëri”, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1984, f. 456.

²¹⁹ A. Plasari, *Që vargu të dalë shqipërisht*. Përkthimet e Lasgushit, në Nëntori 12/1987, f. 117.

(individualiteti krijues) do të ndihet dashur pa dashur. Se ti do të japësh autorin, po, do s`do, do të japësh edhe veten tënde në përkthim. Një njeri me kulturë, për shembull, do ta kuptojë: këtë e paska përkthyer Lasgushi.”²²⁰

*Oh! kroi i lotëve të mi/ Që m'i vërshonte sytë e qarë! / Më ndryshe, vallë, pleqëri,/ Që vjen tani duke u tharë? / Oh! flok-argjend! zhubra të shkreta! / Unë i pranoj, u bëhem fli,/ Veçse duke më plakur jeta,/ Të mos më shterren sytë e mi!*²²¹

“Ti mund të zësh të përkthesh një poezi ditë e natë dhe prapë s`të del e mirë. Se s`ke talentin e poezisë, që është një mister, një sekret, një gjë e panjohur, një gjë që s`ka rregulla, s`ka ligje. [...] Poezia nuk të pyet a je poet. Edhe kur kam bërë unë ndonjë përkthim, poezia nuk më ka pyetur mua në jam poet, apo jo. Sepse poezia ka sekrete të mëdha. Poezia është kolosale.”²²²

*O ju, kufoma flisni! Kush pra ju masakroi? / E kujt është ajo dorë që me thikë ju shpoi? / Emrat? – Pafajësi, dliresi, nder, virtyt./ - Dhe kush ju theri? – Kisha. – Ti atje, emri yt? / - Jam besimi publik. – Dhe kush t`i nxori syt? / - Betimi. – Po ti tjetra, në gjak e mbytur? / - Unë, Më quanin Drejtësi. – Dhe kush të bëri dhunë? – Gjykatësi.*²²³

“Nëse - ashtu siç sugjeronte Humboldt-i – të përkthesh do të thotë jo vetëm të bësh lexuesin të kuptojë gjuhën dhe kulturën e origjinës, por edhe të pasurosh gjuhën tënde, atëherë nuk ka dyshim që çdo përkthim [...] derisa e bën gjuhën e vet të shprehë diçka që ajo më parë nuk dinte ta bënte [...], e kultivon atë.”²²⁴

Pikërisht këtë ka bërë Poradeci me përkthimet e veta, duke vënë në shërbim të përkthimeve, talentin e vet si poet në radhë të parë, e pastaj edhe si përkthyes poezish; njohuritë e gjuhës amtare, përkushtimin dhe

²²⁰ Po ai, po aty, f. 120.

²²¹ *Lotët*, në Poezi franceze (Nga fillimet deri në ditët tona), (Përgatitur dhe pajisur me shënime nga P. Misha), Shtëpia botuese, “Naim Frashëri”, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1984, f. 384-385.

²²² A. Plasari, *Që vargu të dalë shqipërisht*. Përkthimet e Lasgushit, në, Nëntori 12/1987, f. 122.

²²³ *Ballafaqime*, në Ndëshkimet, V. Hygo, E përkthyen nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 197, f. 71.

²²⁴ U. Eco në *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Sh. Botuese “Dituria”, përkthyen M. Ymeri dhe A. Ylli, Tiranë, 2006, f. 325.

durimin për t'i rishikuar variantet e përkthyer aq herë sa ato të arrinin në më të mirin që lexojmë sot.

Matieu Guidère²²⁵ sjell opinionin e një filologu rus, njëkohësisht teoricien i përkthimit, E. Etkin sipas të cilit “Çdo përkthyes paraqet një hierarki unike përballë çdo poeme. Ndërkohë përkthimet shumëfishohen dhe hyn në veprim individualiteti i përkthyesit.”²²⁶ “Nëse, duke e kaluar poemën në një gjuhë tjetër, nuk ruajmë gjë tjetër veç kuptimit dhe imazheve, nëse lëmë mënjanë tingujt dhe përmbajtjen, nuk do të mbetet gjë nga kjo poemë. Absolutisht, asgjë”.²²⁷

E kundërta e kësaj ka ndodhur me përkthimet e Lasgush Poradecit, sepse ai ka shfaqur individualitetin e tij si krijues duke sjellë edhe në poemat e poezitë e përkthyer thujse të njëjtat veçori gjuhe e stili të veprave të veta, sigurisht, pa cenuar në thelb stilin e autorëve të veprave që përktheu.

Të tilla janë përftesat e shfrytëzuara për shprehësi si: ndryshimi i trajtave të fjalëve në fund të vargut për të arritur rimën; *Me frikë dorën tënde mbi llozin ti e ve/ Se ligji q'u dhunua prej tyre – është atje*.²²⁸; ndërtimin e disa mbiemrave prejpjesorë, jo sipas normës gramatikore: (mbi letrën) *e njolluar*, (prej kujdesit) *brenjës*, (në pallatet) *e mpruar*; apo edhe mbiemra tipikë, që duke i lexuar kupton që janë nga dora e Lasgushit: (helm) *gjelbërimtar*, (zemra) *e furtunshme*, (himne) *buçimtarë*, (thonjtë) *tmerrimtarë*, (lule) *shpellore*, (natë) *e gremisur*, (kandile) *e dridhshme*, *purpurore*, (natyrë) *vetëdijeqruar*, (me pamjen) *vajtimitare*, (kasollet) *jetënxira* etj.

Sipas U. Eco-s duke përkthyer, thuhet *thujse* e njëjta gjë. Problemi i *thujse* bëhet me sa duket qendror në përkthimin poetik, deri në kufirin e rikrijimit kaq gjenial që, nga *thujse*, kalohet në një gjë kryekëput

²²⁵ M. Guidère, *Introduction à la traductologie (penser la traduction: hier, aujourd'hui, demain)*, De Boeck supérieur, Broché: 27 janvier 2016.

²²⁶ E. Etkin, *Une traductologie de la poésie est-elle possible? La traduction du poème*. në, *Un art en crise. Essai de poétique de la traduction poétique*, Lausanne, L'âge d'Homme, 1982, f. 90.

²²⁷ E. Etkin, *Une traductologie de la poésie est-elle possible? La traduction du poème*. në, *Un art en crise. Essai de poétique de la traduction poétique*, Lausanne, L'âge d'Homme, 1982, f. 11.

²²⁸ *Atij që kërkon të shkëputet*, në *Ndëshkimet*, V. Hygo, E përkthyer nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 197, f. 173.

tjetër, një gjë tjetër që me origjinalin ka vetëm një borxh, thotë ai, moral.²²⁹

Nuk është e lehtë të jepet një gjykim përfundimtar, në lidhje me mënyrën se si Poradeci ka arritur të realizojë këtë lloj ngjashmërie, gjithmonë duke respektuar stilin e autorit, sa e ka pasur të mundur, sepse ka mendime të ndryshme në lidhje me parimin e besnikërisë në përkthim dhe respektimin e stilit të autorit nga ana e përkthyesit.

“Të lexosh një poemë, do të thotë ta tradhtosh paksa atë. Përkthimi nuk është teknikë riprodhimi, por një art, domethënë një veprimtari që krijon diçka duke u nisur nga diçka tjetër.” Duke u konsideruar si i tillë, përkthimi ngatërrohet me shkrimin dhe përkthyesi bëhet autor me të drejta të barabarta: “Nuk ka përkthim, por krijim dhe madje krijim në saje të të qenit absolutisht letrar.”²³⁰

Në kushte të tilla përkthyesi provon një ndjenjë lirie të krijimit, të tillë si ajo që përdor poeti. Për të mos u ndier i burgosur nga origjinali, Etkin propozon që fokusi të mos jetë një aspekt i veçantë i poemës dhe as vetëm kuptimi, tingujt apo imazhet. Duhet thjesht të jesh i ndërgjegjshëm që “teksti formon një të tërë dhe ai [përkthyesi] duhet t’i japë sërish kësaj tërësie, në gjuhën e vet, funksionin e saj, duke respektuar formën dhe mendimin.”²³¹

Për realizimin e një përkthimi kaq të arrirë që, më shumë se vetëm përkthim i thjeshtë, është një rikrijim i poezisë, që ruan përmbajtjen, kuptimin dhe prek vetëm pak stilin e autorit të poemave, duke e përafuar paksa me të vetin. A është e pranueshme kjo?

Sipas U. Eco-s nuk duhet të jetë kështu, sepse: “Ka përkthime që e pasurojnë në mënyrë të mrekullueshme gjuhën në të cilën përkthehet dhe se, në raste që shumë syresh i shohin fatlume, arrijnë të thonë më

²²⁹ U. Eco në *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Sh. Botuese “Dituria”, përkthyer M. Ymeri dhe A. Ylli, Tiranë, 2006, f. 296.

²³⁰ Cituar sipas M. Guidère, *Introduction à la traductologie (penser la traduction: hier, aujourd’hui, demain)*, De Boeck supérieur, Broché: 27 janvier 2016, f. 53. “E. Etkin, në *Une traductologie de la poésie est-elle possible? La traduction du poème*. në *Un art en crise. Essai de poétique de la traduction poétique*, Lausanne, L’âge d’Homme, 1982.”

²³¹ E. Etkin, *Une traductologie de la poésie est-elle possible? La traduction du poème*. në *Un art en crise. Essai de poétique de la traduction poétique*, Lausanne, L’âge d’Homme, 1982, f. 261.

shumë (apo sjellin më shumë efekte) se origjinali. [...] Një përkthim që arrin të “thotë më shumë”, mund të jetë një vepër e shkëlqyer në vetvete, por nuk është një përkthim i mirë.”²³²

Edhe sipas Ali Dhrimos, “...përkthimi është vërtet krijimtari letrare, por ai nuk mund të njëjtësohet me krijimtarinë e lirë letrare, ka vetëm një ngjashmëri me të. Pse jo? Sepse përkthyesi duhet të na japë me besnikëri përmbajtjen e veprës origjinale, me të gjitha veçoritë e stilit të autorit përkatës, me ngjyrimet kuptimore e emocionuese që ka përdorur ai, me figuracionin e veçoritë e tij. Nganjëherë, në vend që të riprodhojë stilin e autorit, përkthimi del me stilin e përkthyesit.”²³³

Për të përligjur, në njëfarë mënyre, përngjasimin që Poradeci është përpjekur [se duhet pohuar me forcë dhe bindje vështirësia e rikrijimit pas procesit të përkthimit] t`u bëjë poezive që përktheu, me krijimet e veta, na vjen në ndihmë sërish një nga opinionet e shprehura nga Etkin-i në lidhje me llojin e përkthimit në vargje. Ai e klasifikon si një nga katër llojet e përkthimit që mundësojnë të përcaktohet me saktësi natyra e ndërhyrjeve që bën në tekst përkthyesi: “Përkthimi në vargje ka për qëllim të zëvendësojë origjinalin për lexuesin që nuk e njeh gjuhën nga e cila përkthehet dhe të transmetojë tek ai, në tërësi ose pjesërisht, të njëjtën përshtypje që origjinali jep (p.sh.) tek një anglez. Ky është përkthimi artistik në vargje”.²³⁴

3. Përftesa stilistike të përftuara gjatë përkthimit

Veçantinë e stilit të L. Poradecit e ka theksuar E. Çabej, sipas të cilit: “Lasgush Poradeci na hap portën e një jete të re në poezinë shqiptare, një “frisson neuf”, siç pat thënë V. Hygoi për vjershat e Bodlerit, lind e rritet në lëmën e këngës shqiptare një stil i ri, të cilin do ta kërkosh më kot ndër poetët e tjerë shqiptarë, po më kot dhe ndër shkrimtarët e huaj nga shkaku i origjinalitetit që shquan këtë poet djalosh. ... Kush nuk mundet nga magjia e kësaj gjuhe?”²³⁵

²³² U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Sh. Botuese “Dituria”, përkthyen M. Ymeri dhe A. Ylli, Tiranë, 2006, f. 117.

²³³ A. Dhrimo, *Gjuha dhe përkthimi*, në *Gjuha jonë*, 1984/2, f. 16.

²³⁴ Po ai, po aty, f. 211.

²³⁵ *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit, në veprën “Eqrem Çabej” të Sh. Demiraj*, Sh. Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1990, f. 169-170.

Ne kemi marrë në shqyrtim vetëm disa nga poezitë e përkthyer dhe gjithashtu u kufizuar vetëm në disa nga përftesat stilistike, të cilat, duhet thënë, janë të shumta në poezitë e L. Poradecit.

“Roli i dijeve stilistike është i pazëvendësueshëm gjatë përkthimit... *Përftesat* (në vend të huazimit: “procédé”) ... janë përpunime plotësuese që u bëhen mjeteve e lidhjeve gjuhësore parësore, janë alternativa kundrejt lidhjeve të zakonshme ose edhe lidhje të panjohura më parë.”²³⁶

Nga shqyrtimi i poezive të përkthyer kemi konstatuar që sipas terminologjisë së P. Newmarkut, Poradeci ka kryer një **përkthim besnik**: i cili, “ka për qëllim prodhimin e kuptimit të saktë kontekstual të tekstit burimor brenda normave dhe rregullave të sistemit gramatikor të gjuhës së përkthimit. Termat kulturore ruhen por ruhet masa e “normalitetit” gramatikor dhe gjuhësor (devijime nga norma e gjuhës burimore) në përkthim.”²³⁷

Konstatojmë se Poradeci është përpjekur t'i qëndrojë besnik origjinalit, sidomos në ritmin dhe llojin e rimës, për të cilën herë pas here ka sakrifikuar edhe fjalë, togje fjalësh apo vargje të tëra. Ruajtja e llojit të rimës që ka poezia në origjinal i ka imponuar ndonjëherë edhe kalimin e foljes kallëzues në vargun tjetër për të ruajtur edhe gjatësinë e vargut, edhe rimën:

Mospërkthimi i disa fjalëve (ndonjëherë edhe vargjeve të tëra), apo, nëse mund ta quajmë edhe një lloj “humbjeje”²³⁸ nga teksti origjinal mund të justifikohet nëse bazohemi tek arsyetimi që i bën kësaj çështjeje U. Eko: “Të përkthesh, do të thotë gjithnjë “të lëmosh e të hedhësh tutje” disa prej rrjedhojave që fjala në origjinal i përmbante. Në këtë kuptim, duke përkthyer, nuk thuhet kurrë e njëjta gjë. [...] Pra, rregulli duhet të jetë i tillë që edhe kur jemi të tunduar për ta bërë këtë, s`mund të pasurojmë asnjëherë leksikon e autorit. Për fat të keq,

²³⁶ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 25.

²³⁷ P. Newmark, *A Textbook of translation*. New York, London, Toronto, Sydney, Tokyo. Prentice Hall. 1988, f. 46.

²³⁸ Term i huazuar nga U. Eko në *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Sh. Botuese “Dituria”, përkthyer M. Ymeri dhe A. Ylli, Tiranë, 2006, f. 99-112.

ndonjëherë përkthyesi është i detyruar të veprojë ndryshe.”²³⁹

*Un immense frisson émeut la plaine obscure./ C'est l'heure où Pythagore, Hésiode, Epicure,/ Songeaient; c'est l'heure où, las d'avoir, toute la nuit,/ Contemplé l'azur sombre et l'étoile qui luit,/ Pleins d'horreur, s'endormaient les pâtres de Chaldée. “Là-bas, la chute d'eau, de mille plis ridée,/ Brille, comme dans l'ombre un manteau de satin”*²⁴⁰

Në përkthim, këto shtatë vargje janë përmbledhur nga Poradeci në vetëm katër:

*“Një dridhmë e madhe tund fushën e errtë. Është ora / Kur ëndërronin Epikuri e Pitagora. / Atje përposh, ujëvara, ndër mijë drithërime, / Shkëlqen, ashtu si një hije ndrin një mantel santine.”*²⁴¹

Kundrinori në origjinal është kthyer në kryefjalë në përkthimin e Poradecit; *kallëzuesi emëror* me të cilin fillon vargu i dytë në origjinal, tek përkthimi është sjellë nga Poradeci me të njëjtën gjymtyrë fjalie, por është vendosur në fund të vargut për efekt rime, sepse në vargun e dytë, në poezinë e përkthyer, emri i personazhit me të cilin rimon ky fund i vargut të parë, është renditur i fundit në radhë dhe, madje emri i njërit prej personazheve të origjinalit “Hésiode” as nuk është përkthyer fare.

Ndërkohë që “*manteau*” (pallto), e ka përkthyer *mantel*, tek i njëjti varg, përsëri për të ruajtur rimën, ka vendosur të mos e përkthejë fare fjalën e fundit (e ka lënë në frëngjisht), duke i ndryshuar edhe shqiptimin (nga *satën* në *santine*). Por, në të njëjtën kohë foljen “*brille*” që në variantin origjinal është përdorur vetëm një herë në krye të vargut, në përkthim e ka përdorur dy herë për gjatësinë e vargut: një herë duke e përkthyer “shkëlqen” dhe herën e dytë “ndrin”.

Kallëzuesin që, në variantin origjinal është në vargun e tretë, Poradeci e ka vendosur në vargun e dytë, para personazheve që numërohen, ndërkohë që vazhdimi i vargut të tretë dhe vargjet 3 dhe 4 të sipërcituara

²³⁹ U. Eco në Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi, Sh. Botuese “Dituria”, përkthyen M. Ymeri dhe A. Ylli, Tiranë, 2006, f. 99, 101.

²⁴⁰ V. Hugo, *Aube*, Jersey, le 28 avril 1853 (burimi – <http://www.unjourunpoeme.fr/poeme/aube-2>)

²⁴¹ Agimi, në Ndëshkimet, V. Hygo, E përkthyen nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 197, f. 151.

nuk janë sjellë fare në përkthimet.

Edhe për poezitë e përkthyer ka të njëjtën vlerë si për poezitë e krijuara, pohimi i Xh. Lloshit që "... te Lasgushi merr epërsi jo perceptimi i veçantë i elementëve në këto përftesa, por tingëllimi i tyre i përbashkët me një efekt tërësor, ai sjell njëjtësimin e vargjeve, përfitim të një toni të përgjithshëm, mbisundues, i cili bashkëshkrin edhe elementet fonologjike."²⁴²

- Shtimi i zanoreve, kryesisht –ë-së: "**nënë** mbulesë këmbësh prej martre ziabeline,/ dhe **nënë** renë e bardhë, të butë museline,/ Pas perdeve që fshehin **nënë** palën e vet..."²⁴³

- bjerja e zanoreve dhe zëvendësimi i saj me apostrofin: "*Qëndro! ajo është atje, nga thik' e tyre e shqyer,/ Dh' harrojnë e qeshin,/ Nga fat' i tyre duke u larguar,/ Ç'far'! do ta tradhetojë,/ Kët' hajdut tru-thatë ti ta mohosh kërkon,/ Atë që t'admiron e të nderon! Ng'ajo – nepërkë më me vrer!/ Ti q'asaj krahun duke i thyer...*"²⁴⁴

- apo shkrimi i fjalëve me viza bashkuese: *me ëndrra kot-më-kot, "Peshkopi dhe xhelati zemër-qen,/ O gjumë-rëndë, gjumë-zi!/ Martirë, lamtumirë! Anijet-burg vozitin,/ Dhe nënat flokë-thinjur psherëtitin"*²⁴⁵, "*Emiri mendimtar-xhanan,/ Që burnus-bardhë, i zbet' si hije/ Ai i hijshmi prift-ushtar/ Ky burrë është Cezar-banditi*"²⁴⁶

Sipas Xh. Lloshit: "Stilemat mbiemërore shtrihen ndërmjet dy skajeve: nga njëra anë janë cilësorët stereotipë. ... Në skajin tjetër janë epitetet e papritura ose që bashkojnë fusha pa shoqërim të zakonshëm në përvojën tonë."²⁴⁷ Në përkthimet e tij, Poradeci përveç **anaforës**, **apostrof**, **enumeracionit** apo edhe disa përftesa të tjera që janë arritur të ruhen edhe në përkthim njësoj si në variantin origjinal, **epitetet**, **anasjellat** (ndonjëherë edhe **krahasimet**) janë përftesa tipike individuale nga të cilat, epitetet i ka veçori të stilit të vet, si përftesë e parapëlqyer.

²⁴² *Lirizmi i lirikut Lasgush*, SF 2000/1-2, Viti LIV (XXXVII), f. 23.

²⁴³ *Është natë*, në Ndëshkimet, V. Hygo, E përkthyer nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 197, f. 69.

²⁴⁴ *Atij që kërkon të shkëputet*, Po aty, f. 173-175.

²⁴⁵ *Popullit*, Po aty, f. 75-77.

²⁴⁶ *Orientale*, Po aty, f. 116-118.

²⁴⁷ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 71.

*Honi idhnak, brrurim zemërak, afsh të hidhur, spiuni i përshëndetur, gazmor e i shëmtuar, të çuditshmin destin, e ftohta histori*²⁴⁸; *krimet të mallkuar, triumf të ndytë.*²⁴⁹ *Syvëngëri i shkretë, qiellin vezullues, të ngushtin ballë e turp të zi, t`ulëtin gjakësor.*²⁵⁰

Gjatë analizës krahasuese konstatuam që Poradeci në variantin e përkthyer, në një pjesë të rasteve, ka ruajtur të njëjtat përftesa stilistike që ka përdorur edhe autori i poezisë së krijuar në frëngjisht, V. Hygo, nga i cili i ka përkthyer pjesën më të madhe të poezive.

E tillë është **përftesa nëpërmjet grafemikës**, apo shfrytëzimit të llojeve të ndryshme të shkronjave: të mëdha, të pjerrëta apo me lloj tjetër shkrimi në tekst për ta dalluar nga fjalët e tjera. Poema “*Të gjithë largohen*”, (vetëm) titulli i së cilës është përkthyer ndryshe nga ç`duhet të ishte, sepse në origjinal është “*Tout s`en va*” (Gjithçka largohet), ka një strukturë si skripti i një drame, ku personazhet kanë nga një tekst për të lexuar/interpretuar. E njëjta strukturë është ruajtur edhe në përkthim nga Poradeci, me të vetmin ndryshim jo thelbësor nga origjinali, ku emrat e “personazheve” janë me shkronja të mëdha, në variantin e përkthyer Poradeci i ka lënë vetëm shkronjën e parë të madhe:

*Arsyeja Po shkoj./ E drejta Dhe unë shkoj./ Nderi Po nisem në mërgim./ Përçmimi Unë mbetem i tërë.*²⁵¹

*LA RAISON Moi, je me sauve. / LE DROIT Adieu ! je m'en vais. / L'HONNEUR Je m'exile. LE MÉPRIS / Je reste.*²⁵²

Ndër përftesat stilistike gjatë përkthimit të poezive të përkthyer nga L. Poradeci konstatuam disa, duke filluar me **përsëritjen**. Përsëritje të fjalëve apo edhe togjeve brenda së njëjtës poezi janë shfrytëzuar për të vënë në dukje jo vetëm dinamikën e përmbajtjes, por edhe kanë shërbyer, nëpërmjet përballjes me njëra-tjetrën, për të theksuar kundërvënien, **kontrastin** e dy ngjarjeve brenda ngjarjes.

²⁴⁸ *Apoteozë*, në Ndëshkimet, V. Hygo, E përkthyer nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 197, f. 103-105.

²⁴⁹ *Ai qesh*, Po aty, f. 106.

²⁵⁰ *Orientale* Po aty, f. 116-118.

²⁵¹ *Të gjithë largohen*, në Ndëshkimet, V. Hygo, E përkthyer nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 197, f. 168.

²⁵² <https://www.poesie-francaise.fr/victor-hugo/poeme-tout-s-en-va.php>

Në poezinë “Mulliri” përsëritja si përfitesë është sjellë nga Poradeci nëpërmjet foljes “vërtitem”, në vetën e tretë, në kohën e tashme, me të cilën fillon vargu i parë, përsëritet sërish po në të njëjtën formë në vargun e tretë dhe po me të mbyllet edhe poezia, në vargun e fundit të së cilës ai ka sjellë, jo vetëm të njëjtën formë të kësaj foljeje, por edhe përcjelloren e saj: “Mulliri gjith` vërtitet, ngadalë në mbrëmëherë, / ... Vërtitet dhe pëlhura, si në llum vere e ngjyer, / ... Mullirin që vërtitet e vdes duke u vërtitur.”²⁵³

E njëjta formë foljore përsëritet sërish edhe në vargun e tretë dhe në vargun e fundit, pa ndryshuar strukturën: “Le moulin tourne au fond du soir, très lentement, / Il tourne et tourne, et sa voile, couleur de lie, ... / Le vieux moulin qui tourne et, las, qui tourne et meurt.”²⁵⁴ Brenda së njëjtës poezi përsëritet emri “krahët” në vargun e parë të strofës së dytë dhe në vargun e tretë të po kësaj strofe; folja “dremit” dhe mbiemri që formohet prej saj “e dremitur”; dhe gjatë gjithë poezisë vihet në **kontrast** aktiviteti i pandalshëm, i lodhshëm e stërmundues (deri në “vdekje”) i mullirit me *nemitjen* dhe *heshtjen* (që, në fakt, janë sinonime të njëra-tjetrës), me *shuarjen* e natyrës, deri edhe me rraskapitjen e reve, me dremitjen e fushës së pamatë.

Kjo lloj përsëritjeje sintaksore (si në këtë rast apo të tjera të ngjashme në poezi të tjera), ku gjymtyra e përsëritur merr rol të veçantë kuptimor është shpjeguar nga Xh. Lloshi si paralelizëm i figurshëm, në kuptimin që sintaksa i shërben paraqitjes paralele të një ngjarjeje njerëzore me një dukuri të natyrës.²⁵⁵

Kontrastin, siç u përmendet edhe më sipër, e gjejmë edhe në poezinë “Vogëlushja lulëshitëse” në të cilën, thuajse çdo varg që ndjek të mëparshmin përmban në vetvete këtë përfitesë:

Moi chaudement vêtu, toi bien emmitouflée;/Sous le manteau, sous la voilette et sous les gants,/Quand soudain jusqu'à nous une enfant presque nue; Et c'était monstrueux, cette enfant de sept ans/Qui

²⁵³ *Moulin*, Emile Verhaeren, në Poezi franceze (Nga fillimet deri në ditët tona), (Përgatitur dhe pajisur me shënime nga P. Misha), Shtëpia botuese, “Naim Frashëri”, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1984, f. 398.

²⁵⁴ <https://paroles2chansons.lemonde.fr/auteur-emile-verhaeren/poeme-le-moulin.html>.

²⁵⁵ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 89.

*mourait de l'hiver en offrant le printemps.*²⁵⁶

*I veshur lehtë unë, ti ndër gëzofë e strukur, Me cipën e fytyrës, dorashkat e manton, kur befas na del para një vajzë gjysmë e zhveshur. Dhe ish gjë e përbindshme, kjo shtatëvjeçare e mjerë. Që dridheshe prej dimrit teksa falte pranverë.*²⁵⁷

Një nga përftesat e përdorura nga Poradeci është edhe **përkalimi** (*enjambement*) “Përftesë metrike/ritmike që konsiston në kalimin në vargun pasardhës të një apo më shumë fjalëve/gjymtyrëve të domosdoshme për kuptimin e vargut paraardhës.”²⁵⁸

“Oh, unë e di ...”²⁵⁹: “... jo duke qenë ju bashkëfajtorë / të krimeve të ndotur, që vetë unë i kam parë”, ku përcaktori me drejtim i emrit “bashkëfajtorë”, edhe pse për të plotësuar kuptimin duhet të ndodhej brenda së njëjtës fjali (sepse i tillë është funksioni i përcaktorit, që bashkë me gjymtyrën emërore nga varet, të formojë një takt ligjërimor), pra në të njëjtin varg me të, ai është kaluar qëllimisht në vargun tjetër, njësoj si në poezinë origjinale:

“... Non, tant que vous serez complices / De ces crimes hideux que je suis pas à pas”²⁶⁰

*Meqë në qoshet afishohet/ Shnderimi i Atdheut t`adhuruar.*²⁶¹

Përkalimin si përftesë Poradeci e ka përdorur edhe në poezitë e krijuara prej tij, si më poshtë: “Ish e bardhë – e nuku kishte/ dredhëri zemra bujare”²⁶², ku kundrinori i shprehur nga emri “dredhëri” ka dalë

²⁵⁶ “La petite marchande de fleurs”, <https://www.poetica.fr/poeme-1178/francois-coppee-la-petite-marchande-de-fleurs/>

²⁵⁷ *Vogëlushja lulshitëse*, në Poezi franceze (Nga fillimet deri në ditët tona), (Përgatitur dhe pajisur me shënime nga P. Misha), Shtëpia botuese, “Naim Frashëri”, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1984, f. 383.

²⁵⁸ *Enjambement*: “Procédé rythmique consistant à reporter sur le vers suivant un ou plusieurs mots nécessaires au sens du vers précédent.”, *Le petit Robert, Dictionnaire de la langue française*, 27, Rue de la Glacière, 75013, Paris, France, avril, 1999, f. 767.

²⁵⁹ “Oh, unë e di...”, në *Ndëshkimet*, V. Hygo, E përkthyer nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 197, f. 62.

²⁶⁰ “Oh! Je sais qu'ils feront des mensonges”, www.poesie-francaise.fr Les châtiments, Jersey, le 13 novembre 1852.

²⁶¹ *Meqë n`humnerë është i drejti*, në *Ndëshkimet*, e përkthyer nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, (titulli i origjinalit “Les châtiments”), Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1975, f. 82.

²⁶² *Zemra e shokut*, L. Poradeci, në *Vepra 1*, Onufri, 1999, f. 203.

në vargun tjetër; apo në poezinë tjetër ku në vargun tjetër kalon kryefjala: “*Kështu rrjeth duke kënduar/ Ëndr’ e zemërës së shkretë*”²⁶³ Këto shmangie të vetëdijshme, siç shprehet Xh. Lloshi, rimarrja e kryefjalës dhe kundrinës në fjalinë që vijon ... kanë rol të veçantë në lidhjen e tekstit dhe përbëjnë një tipar dallues stilistik²⁶⁴ Raste të tilla të ruajtjes së kësaj përftese nga origjinali janë edhe këto që po sjellim më poshtë:

“*Engjëlli shpatë-zjarr u hap të dy kanatat / E portës fort të lumtur, të tmerrshme e ngjyrë-zjarrtë*”²⁶⁵ ndërkohë që vargjet në origjinal (pavarësisht pranisë edhe të përftesave të tjera) janë: “*L`ange au glive de feu leur ouvre à deux battants/ La porte bienheureuse, effrayante et vermeille*”²⁶⁶

Transposition që është termi i huaj për përftesën përkthimore **zhvendosje** (që nga disa studiues quhet edhe një lloj *teknike përkthimi*) që shfrytëzohet gjatë përkthimit me mjeshtëri nga Poradeci. **Zhvendosjen sintaksore** si përftesë e përmend (pa e trajtuar) Xh. Lloshi: “Kur kemi një vargëzim njësisht tonale, rolin e vatrës kryesore të informacionit e merr pozicioni fundor. [...] por, kur nuk bëhen dot thënie të gjata, gjënë më të rëndësishme e thonë në fillim [...] Prej kësaj lindin edhe zhvendosjet sintaksore”.²⁶⁷

“Me *zhvendosje* duhet kuptuar kalimi i njëres prej pjesëve të ligjëratës në një tjetër që vjen prej saj ose me prejardhje, ose me plotësim, nëse fjala e prejardhur nuk ekziston.”²⁶⁸

E. Tupja, i shton përkufizimit të *zhvendosjes* edhe informacionin për rrafshin gramatikor në të cilin ndodh si përftesë: “Zëvendësim i një pjese të ligjëratës në tekstin origjinal me një pjesë tjetër ligjërata në

²⁶³ *Përqaqimi*, L. Poradeci, në *Vepra 1*, Onufri, 1999, f. 204.

²⁶⁴ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 95, 96.

²⁶⁵ *Afrohi, të devotshmit...*, në *Ndëshkimet*, V. Hygo, E përkthyer nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 197, f. 43.

²⁶⁶ *Approchez-vous. Ceci, c'est le tas des dévots*, www.poesie-francaise.fr.

²⁶⁷ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, SHBLU, Tiranë, 2001, (botimi i dytë), f. 62.

²⁶⁸ *La transposition*, J. Darbelnet, *French Review*, Vol. 23, N° 2, December, 1949, p. 115. https://www.jstor.org/stable/382108?seq=1#page_scan_tab_contents “Par transposition, il faut entendre le passage d'une des partie du discours à une autre qui en est, soit dérivée, soit obtenue par supplétion si le dérivée n'existe pas.”

tekstin e përkthyer, proces i cili realizohet në rrafshin morfo-sintaksor.”²⁶⁹

Pas rishikimit të kujdesshëm dhe përpunimit me mjeshtëri të vargjeve për të përfutur rimën dhe figurshmërinë, pa dyshim që vargu del më i kuar, por ne jemi duke analizuar *zhvendosjet sintaksore* dhe këmbimet e gjymtyrëve që kanë ndodhur nga ky proces dhe duket se pas kësaj zhvendosjeje, ndryshon struktura sintaksore e fjalive që përbëjnë secilin prej vargjeve.

“Zhvendosja është një nga përfitesat, prej së cilës pasurohen dhe bëhen më të manovrueshme gjuhët, duke krijuar në një tjetër kategori leksikore një formë me kuptim të barasvlerëshëm.”²⁷⁰

Në dy vargjet e mëposhtme të një poezie të përkthyer nga L. Poradeci:

“*Ti flet: “Perandoria të tundet ka filluar;/ ka shpresë pak për ngadhënjim!”*”²⁷¹ gjatë përkthimit kanë ndodhur *disa zhvendosje*.

Nëse e krahasojmë me origjinalin: “*Maintenant il se dit: L'empire est chancelant / La victoire est peu sûre.*”²⁷², përveç ndryshimit të vetës së tretë të përemrit vector me atë të vetës së dytë dhe mospërfshirjes në përkthim të *rrethanorit të kohës*, të shprehur me *ndajfoljen “maintenant”*, konstatojmë se *kallëzuesin emëror* të ndërtuar me foljen këpujë *jam* në vetën e tretë dhe mbiemrin *e lëkundshme, e pasigurt - “est chancelant”*, e ka zëvendësuar në përkthim me një gjymtyrë tjetër që është *kallëzuesi i përbërë*: -“*ka filluar të tundet*”, ku foljes gjysmëndihmëse: “*filloj*” që tregon fillimin e veprimit e cila është në kohën e kryer të mënyrës dëftore i është paravendosur folja bazë: “*tundem*” në mënyrën lidhore, si pjesa e dytë e kallëzuesit të përbërë, duke përbërë në vetvete një përfitesë, konkretisht një **anasjellë/inversion**.

²⁶⁹ E. Tupe, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Shtëpia botuese Onufri, Tiranë 2007, f. 74.

²⁷⁰ *La transposition*, J. Darbelnet, *French Review*, Vol. 23, N° 2, December, 1949, p. 115. https://www.jstor.org/stable/382108?seq=1#page_scan_tab_contents “C’est surtout par la transposition que les langues s’enrichissent et s’assouplissent, en créant dans une autre catégorie lexicale une forme de sens équivalent.”

²⁷¹ *Atij që kërkon të shkëputet*, në *Ndëshkimet*, V. Hygo, E përkthyer nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 197, f. 173.

²⁷² *À un qui veut se détacher*, <https://www.poesie-francaise.fr/victor-hugo/poeme-a-un-qui-veut-se-detacher.php>

Në thelb jemi brenda së njëjtës gjymtyrë fjalie, por secila prej tyre është e ndërtuar me pjesë të ndryshme ligjërata, ndaj bie në sy zhvendosja. Në vargun e dytë kemi një ndryshim të të gjithë strukturës sintaksore, sepse ndërkohë që në variantin origjinal fjalë për fjalë do të kishim:

“Fitorja është pak e sigurt” që mund të thuhej edhe *“Nuk është e sigurt fitorja”*, për të ruajtur strukturën *kryefjalë+kallëzues* (në formën pohore ose mohore), konkretisht si pjesë ligjërata: *emër+folje+ndajfolje+mbiemër*; ndërkohë që në përkthim struktura e vargut përbëhet nga: *folje+emër+ndajfolje+parafjalë+emër*, duke ruajtur në përbërje vetëm ndajfoljen *“pak”* dhe duke e sjellë emrin *“fitorja”* me një sinonim që ka kuptim edhe më të përforcuar (fitore e plotë, sipas fjalorit të gjuhës shqipe) *“ngadhënjim”*, por që përkthehet si një *kundrinor me parafjalë* i shprehur me emër në rasën kallëzore me parafjalën *për*.

“Pjesët e ligjërates që i nënshtrohen përftesës së zhvendosjes/transpozicionit janë përgjithësisht kategoritë leksikore: emri, mbiemri, folja, ndajfolja më tepër se sa mjeteve shërbyese që janë lidhëzat dhe parafjalët.”²⁷³

“Me sapunin e vjetër, jezuitik, dinak / E lajnë epokën tonë që nuk beson aspak / Dhe finjë u japin njerëzit që i djegin përmbi zjarr / Gazeta e tyre e shkruar me helm gjelbërimtar”; përkundrejt:

*“Avec le vieux savon des jésuites sournois / Ils lavent notre époque incrédule et pensive / Et le bûcher fournit sa cendre à leur lessive / Leur gazette, où les mots de venin sont verdis / Est la seule qui soit reçue au paradis.”*²⁷⁴

Që në vargun e parë të sjellë këtu konstatojmë që, për efekte stilistike, por edhe të rimës, e ka kthyer një *përcaktor me drejtim* që tregon *sapunin* që përdoret nga *jezuitët tinzarë, dinakë* në një epitete, sepse

²⁷³ *La transposition*, J. Darbelnet, *French Review*, Vol. 23, N° 2, December, 1949, p. 115. https://www.jstor.org/stable/382108?seq=1#page_scan_tab_contents “Les parties du discours qui se prêtent à la transposition sont généralement des catégories lexicales: nom, adjectif, verbe, adverbe plutôt que ces ligaments grammaticaux que sont les conjonctions et les prépositions.”

²⁷⁴ *Approchez-vous. Ceci, c'est le tas des dévots*,

<https://paroles2chansons.lemonde.fr/auteur-victor-hugo/poeme-approchez-vous-cest-le-tas-des-devots.html>

është një përcaktor me përshtatje i shprehur me mbiemër që fiton cilësi të veçanta duke iu prapavendosur emrit *sapun*.

Në vargun e dytë zhvendosja që ndodh gjatë përkthimit është: një mbiemër "*incrédule*" këmbëhet me një fjali të nënrenditur përemërore lidhore "*që nuk beson aspak*", kurse mbiemri tjetër "*pensive*", homogjen me të parin, nuk është përkthyer fare, për shkak të rimës. Në tri vargjet e radhës që mund të ishin përkthyer, normalisht, pa iu nënshtruar një rikrijimi apo një kujdesi të veçantë për të krijuar rimën dhe ruajtur përmbajtjen: "*Turra e druve u jep hirin për finjën e tyre*"²⁷⁵ / *Gazeta e tyre, ku fjalët prej helmit janë gjelbëruar / Është e vetmja që do të pranohet në parajsë*"

Përfundime

Në këtë punim modest për një personalitet kaq të shquar të letrave shqipe, siç është L. Poradeci, duke mbajtur parasysht edhe hapësirën e kufizuar të një konference përkujtimore, u përpoqëm të sjellim vetëm disa nga vlerat e tij si përkthyes, një angazhim më tepër shpirtëror nga ana e tij, duke e përqendruar vëmendjen vetëm në një pjesë të përkthimeve të tij, vetëm në ato poezi që ai ka përkthyer nga gjuha frënge.

Këto poezi, për të cilat vetë Poradeci shprehet që i ka zgjedhur vetë (poezitë dhe autorët punimet e të cilëve ka dashur të përkthejë) që janë të tematikave të ndryshme dhe të shkruara kryesisht nga V. Hugo, por disa prej tyre edhe nga autorë të tjerë, duke i lexuar me ëndje krahas me poezitë e krijuara, këtë herë me synimin për të vënë në dukje mjeshtërinë e tij si përkthyes mjaft i zoti, si njohës mjaft i mirë i gjuhës shqipe dhe i gjuhës frënge në të njëjtën kohë, por edhe si njohës i mirë i letërsisë botërore.

Sigurisht që poezitë e përkthyerat me të cilat punuam, na japin shumë mundësi për t'i analizuar, duke i parë jo vetëm si produkt i një përkthimi dhe as vetëm nga ana stilistike, por edhe nga këndvështrime të tjera që mund të jenë objekt i punimeve të tjera në të ardhmen.

²⁷⁵ "Ujë i valuar me hi të sigur, që përdoret për të larë rroba", Fjalor i gjuhës shqipe, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2006, f. 274.

Së fundi mund të themi me plot gojë që, të përkthesh si Lasgushi do të thotë të njohësh shkëlqyeshëm si ai, jo vetëm mjeshtërinë e krijimit të një poezie të bukur, por edhe të dyja gjuhët: atë burimore a të nisjes dhe atë të mbërritjes ; do të thotë të shfrytëzosh me mjeshtëri përftesat stilistike dhe teknikat e përkthimit, me qëllim që jo vetëm përkthimi, por edhe rikrijimi të justifikojë ndonjë “*tradhti*” të pashmangshme gjatë këtij procesi.

BIBLIOGRAFI

Arapi, F., *Shënime mbi lirikën e L. Poradecit*, SF 1978/4.

Çabej, E., *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit*, në veprën “Eqrem Çabej” të Sh. Demiraj, Sh. Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1990.

Darbelnet, J., La transposition, French Review, Vol. 23, N° 2, December, 1949.

Dhrimo, A., *Gjuha dhe përkthimi*, në Gjuha jonë, 1984/2

Eco, U., *Të thuash gati të njëjtën gjë*, përvoja përkthimi, Sh. Botuese “Dituria”, përkthyen M. Ymeri dhe A. Ylli, Tiranë, 2006

Etkin, E. *Une traductologie de la poésie est-elle possible? La traduction du poème*, në “Un art en crise. Essai de poétique de la traduction poétique”, Lausanne, L’âge d’Homme, 1982.

Feka, Th., *Fjalëkrijimi si mjet poetik në veprën e L. Poradecit*, SF 2013/1-2

Fortino, I. C., *Shënime filologjike për një botim kritik të veprës së L. Poradecit*, SF 2003/1-2

Gashi, O., Lasgushi dhe Alfred de Muse (Pikat e takimit të poezisë së Lasgushit me romantikë si Pushkini, Lermontovi, Hygo, de Muse. Simpoziumi “Lasgush Poradeci dhe vepra e tij” organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe IGJL i ASHSH me rastin e 100-vjetorit të lindjes së L. Poradecit, 18-20 nëntor 1999

Gjikaj, E., *Veçori të lirikave filozofike të L. Poradecit në vështrim krahasues*, SF 2006/1-2

Gjikaj, E., *Një klasifikim i receptimit kritik të poezisë së Lasgush Poradecit*, SF2008/1-2

Hygo, V., *Ndëshkimet*, e përkthyen nga origjinali Lasgush Poradeci dhe Sotir Caci, Sh. Botuese “Naim Frashëri”, (titulli i origjinalit “Les châtiments”), Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1975.

Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, SHBLU, Tiranë, 2001, (botimi i dytë)

Lloshi, Xh., *Lirizmi i lirikut Lasgush*, SF 2000/1-2, Viti LIV (XXXVII)

- Lloshi, Xh., *Paraqitja e vlerave të shqipes artistike*, Gazeta Telegraf, 11 nëntor 2015
- Plangarica, T., *Lëvizja poetike dhe stili i poezisë së Lasgushit*. Simpoziumi “Lasgush Poradeci dhe vepra e tij” organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe IGJL i ASHSH me rastin e 100-vjetorit të lindjes së L. Poradecit, 18-20 nëntor 1999
- Newmark, P. *A Textbook of translation*. New York, London, Toronto, Sydney, Tokyo. Prentice Hall.
- Plasari, A., *Që vargu të dalë shqipërisht: Përkthimet e Lasgush Poradecit në: Nëntori*. -Nr. 12/1987, f. 114-124.
- Podrimja, A., *Poezitë e fshehta që përkthente Lasgushi*, në: Ballkan. - Nr. 120, 8 qershor, 2005, f. 19.
- Poezi *franceze* (Nga fillimet deri në ditët tona), (Përgatitur dhe pajisur me shënime nga P. Misha), Shtëpia botuese, “Naim Frashëri”, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1984.
- Smaqi, L., *Lasgushi dhe simbolistët evropianë*, në librin: Letërsia si e tillë. Tiranë, “Toena”, 1996, f. 337-340
- Shehri, Dh., *Çështje të strukturës në poezinë e Lasgush Poradecit*, në: Aleph. -Nr. 9, 2000, f. 278–282.
- Shkurtaj, Gj., *Nëpër labirintet e stilemave lasgushiane*, Simpoziumi “Lasgush Poradeci dhe vepra e tij” organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe IGJL i ASHSH me rastin e 100-vjetorit të lindjes së L. Poradecit, 18-20 nëntor 1999
- Shyti, I., *Receptimi i poezisë së L. Poradecit*, disertacion për marrjen e gradës shkencore Doktor, udhëheqës shkencor Dh. Shehri, Tiranë, 2015
- Verdho, L., *Bibliografi për jetën dhe veprën e L. Poradecit*, SF 1999/3-4
- Xhaferaj N., *Vështrim i figurave stilistike në traditën shqiptare dhe në trajtimet bashkëkohore*, udhëheqës Xh. Lloshi, 2015
- Xhaxhiu, M., *“Disa shënime rreth jetës dhe veprës poetike të Lasgush Poradecit”*, në Kritikë e studime letrare, Tiranë 1975
- Xhiku, A., *Lasgush Poradeci Një poet romantik*, në librin: *Nga romantizmi rrjedhave të realizmit*. Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 1989, f. 131-141.
- Zoto, A., *Forma dhe norma të preciozitetit në poezinë e L. Poradecit*, SF 2001/1-2

MERAL SHEHABI-VESELI

Universiteti i Evropës Juglindore-Tetovë

m.shehabi@seeu.edu.mk

LULJETA ADILI-ÇELIKU

Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”- Shkup

l.adili@flf.ukim.edu.mk

KOMUNIKIMI LETRAR I LASGUSH PORADECIT NË POEZINË *BALADË* BAZUAR NË TEORINË E LEXUESIT

Komunikimi letrar si premisë për krijime poetike u shkon për shtati shumë autorëve, të cilët krijojnë relacione të tilla, për t'i krijuar veprat e tyre poetike. Letërsia popullore, është dhe do të jetë burim i pashtershëm ku do të pijnë ujë shumë autorë të periudhave pasuese letrare. Ashtu, do të jetë edhe rasti edhe me Lasgush Poradecin, i cili ka thënë që *“asnjë poet s`mund të krijojë pa studiuar poezinë popullore të paktën të vendit të vet”*. Me mbështetjen në poezinë popullore autorët do të pasurojnë veprat e tyre me motive tema dhe ngjarje, me të cilën arrijnë që të përvetësojnë të vjetrën me synimin e vetëm që poezia të mund të shprehet në mënyrë e saj më të përsosur. Ata materialin e marrë e përpunojnë dhe me mjeshturinë e tyre e rikrijojnë në mënyrë origjinale. Lasgushi është njëri nga poetët, i cili poezinë artistike e sharton në *trungun e traditës popullore*. Poezia popullore si paratekst shkrihet dhe njëjtësohet me poezinë e Lasgushit kështu që kjo i mundëson lexuesit të jetë vrojtues i këtyre relacioneve intertekstuale, për ta lartësuar edhe më shumë poezinë origjinale. Raporti intertekstual i poezive të Lasgushit bëhet i qartë në disa raste nga titulli, që jepet si e dhënë metatekstuale. Pavarësisht mënyrës dhe formës me të cilën komunikon autori, me letërsinë popullore dhe me elementet e kësaj letërsie, atë e vendosin në grupin e njerëzve të pazakonshëm ose më mirë të themi në botën e yjeve, nga ku ndjen obligim dhe përgjegjësi të *përgjigjet për çdo gjë*.

HYRJE

Intertekstualiteti, shpesh, diskutohet si pasojë e leximit të marrëdhënieve ndërmjet teksteve. Prandaj, mund të theksohet, se nuk është

me rëndësi kapja dhe njohja e këtyre raporteve, sa është e rëndësishme, mënyra me të cilën mund të lexohen këto raporte intertekstuale. Kjo aludon në leximin aktiv si element mjaft i rëndësishëm për pikasjen e marrëdhënieve intertekstuale. Me aplikimin e teorisë së intertekstualitetit në analizat teoriko-letrare të veprave, konstatojmë që mbështetja në një poezi apo në një vepër më të hershme apo të njëkohshme nuk ia humb vlerën dhe origjinalitetin veprës në fjalë por përkundrazi ajo i mundëson veprës që të lexohet në më shumë dimensione dhe në mënyrë të shumanshme. Në këtë studim do të merret për bazë teoria e lexuesit sipas *M. Riffater-it*.

Teoria e lexuesit sipas M. Riffater-it

Michael Riffaterr, vend të rëndësishëm i kushton edhe lexuesit, atij që duhet ta njohë këtë lidhje intertekstuale. *“Intertekstualiteti është shquarja, nga ana e lexuesit, e raporteve ndërmjet një vepre të dhënë dhe veprave të tjera që i kanë paraprirë apo pasuar. Këto vepra të tjera përmbajnë intertekstin e së parës.”*²⁷⁶ Ai vë përball njëra-tjetrës intertekstualitetin e rastësishëm dhe atë të detyruar, derisa lexuesit i ndan në të ditur, që janë në gjendje të njohin raportin intertekstual dhe ata që i quan të rëndomtë, që nuk do të mund t'i njohin raportet e tilla. Nëse ky raport, sipas tij, nuk do të arrihet të njihet apo të përcillet, atëherë ai kthehet në letër të vdekur. Pra, lexuesi, i cili ka përgatitje paraprake dhe kulturë të leximit, është ai, i cili e zbulon raportin e tekstit me një tekst të mëhershëm ose të njëkohshëm.

Sipas Riffaterrit, të përkufizosh intertekstualitetin nga leximi që mund t'i bëjmë, paraqet një rrezik të dytë: rreziku i subjektivitetit të përqsasjeve të bëra. Intertekstualiteti mund të mos kapet, ngaqë lexuesi nuk di ta pikas dhe njoh; por interteksti mundet, gjithashtu dhe anasjelltas, të zmadhohet, sepse kujtesa e lexuesit të ditur, teje të kultivuar, mund të hyjë në punë më shumë nga ç' duhet; lexuesi do të ketë prirje t'i mvesh tekstit referencat e tij të veta dhe të shohë si një dukuri intertekstualiteti të detyruar diçka që nuk është ndoshta veçse një vegim krejt i pasigurt.

²⁷⁶ Nathalie Piegay Gros, *Poetika e intertekstualitetit*, përkth. Urim Nerguti, Prishtinë, Parnas, 2011, f. 28.

Kur përmendet Lasgushi të shkon mendja tek arti poetik, poezia e tij. Lasgushi dhe poezia e tij janë njehtësuar dhe kanë përfunduar në botën e yjeve në gjithësi. Krijimtaria poetike e Lasgushit jetoi në heshtje në kohën kur ishte gjallë poeti, por tani po ajo poezi jeton dhe ngritet në piedestalin më të lartë duke konkuruar edhe veprat e poetëve të njohur botërisht. Lasgush Poradeci erdhi në letërsinë shqipe në kohën kur populli shqiptar nuk ishte i përgatitur që ta konceptoj si të tillë. Ai pati komunikim shumëdimensional me lexuesit dhe studiuesit e poezisë së tij. Kjo papjekuri letrare e lexuesit të kohës së tij na kujton edhe qeverisjen e Nolit dhe sjelljen e demokracisë në kohën kur horizonti i pritjes nuk ishte i gatshëm për ndryshime apo risi të tilla demokratike, apo në rastin e Lasgushit, lexuesi nuk ishte gatshëm për konceptime poetike. Mbase kjo gjendje e konceptimit të veprës së tij në kohën kur jetonte nuk do ta shqetësojë autorin, pasi sipas Lasgush Poradecit, “*Artisti i madh krijon për vete. Misioni i artistit është të na japë kënaqësi estetike. Arti është më i fortë se natyra më i përsosur*”.²⁷⁷

Poezia balladë dhe poezia popullore

Sado që poezia e Lasgushit ndryshon nga poezitë e Naimit dhe pararendësve të tij, përsëri në disa drejtime mund të themi që ai me mbështetjen e poezisë së tij në letërsinë popullore, njëkohësisht komunikon edhe me poetët pararendës, të cilët gjejnë mbështetje në këngët popullore, të tillë janë autorët: De Rada, Naimi, Çajupi etj. Dëshira për t’u larguar nga poezia popullore, me sa duket do ta afrojë poetin në poezinë e tij më të bukur *Ballada*. Askush nuk mundet t’i ikë të vjetrës plotësisht që ta krijoj të renë. Pasi, çdo gjë është thënë, dëgjuar dhe shkruar shumë kohë më parë. Strumbullari i poezisë është i ngjashëm me këngën popullore, e cila sipas terminologjisë së Zherar Zhenetit paraqet hipotekstin për të krijuar poezinë e tij më të bukur me frymë popullore. Poetit në këtë *Balladë* mbështetet në një këngë popullore nga rrethi i Pogradecit “Fryn veriu në Mal të Thatë”, si edhe në një këngë tjetër popullore ku gjen frymëzim autori për ta shkruar poezinë *Balladë*. Studiuesja Mirlinda Krifca në librin “Intertekstualiteti në poezinë shqipe mes dy luftrave botëroë”, ka venë paralele mes

²⁷⁷ Sabri Hamiti, *Letërsia modern shqiptare*, Prishtinë, Albas, 2000, f. 80.

këngës popullore dhe poezisë së Lasgushit, ku del në pah edhe identiteti i poezive por edhe veçantitë e saj. Lasgushi shkruan poezi dashurie duke gërshetura në to ndjenjën magjike me modernitetin, universalizmin dhe të gjithë këta duku u mbështetur në frymën autoktone në poezinë popullore të vendit të vet. Poezia Balladë është e strukturuar në gjashtë pjesë, dhe në jesën e parë katër vargjet e para dëshmojnë për identitetin e tyre me poezinë popullore.

Kjo poezi që në titullin e saj është e shoqëruar me të dhënë metatekstuale që është e shkruar në frymën e poezisë popullore. Shenjëzimi i tillë i ndihmon lexuesit, që më lehtë të gjejë referencën e kësaj poezie. Autori, nuk ka frikë të na drejtoj tek origjinali, apo më mirë të themi tek poezia ku gjen mbështetje, pasi me një ndryshim të vogël në vargun e fundit të saj krijon vargun më poetik dhe me tone të larta dhe të llahtarshme. Ai në vend të fjalës *shtrydh* përdor fjalën *ngroh* që arrinë të bart emocione tek lexuesi për ecurin e zërit të brendshëm të autorit. Varg ky që flet shumë për stilin, origjinalitetin dhe individualitetin e vet autorit. Pasi siç shprehet edhe vet Lasgushi “Do ta marr se s’kam frikë se mos më thonë plagjiat. Poeti s’pyet se ç’merr dhe se nga e merr. Shikon ç’bën. Bën vepër arti....Ajo që mori u bë e tija”²⁷⁸ Vargjet në vijim dëshmojnë atë që poezia Balladë me këtë ndryshim bëhet vetëm e tija.

Kënga popullore

Në të shtënça dot në dorë

*Do të shtrydh si shuk dëborë,*²⁷⁹
I, f. 60)

Poezia Balladë

Në të shtënça moj në dorë

Do të ngroh si top dëborë. (Vepra

Dashuria në konceptin lasgushian, nuk është dashuri e thjeshtë, por ajo dashuri merr përmasa më të gjëra duke qenë dashuri universale. Kjo dashuri në veprimtarinë e Lasgushit merr forma të ndryshme, por një nga format e dashurisë deri në llahtari e gjejmë me mbështetjen e tij në poezinë popullore. Kjo poezi që është krijuar në “frymën popullore” na ndihmon që ne si vrojtues bashkëkohorë të poezie së tij, në një kohë krejt të ndryshme, nga koha e tij, të gjurmojmë për ekzistencën e materialit parësor që ka qenë edhe frymëzim i poetit. Në këtë rast

²⁷⁸ Petraq Kolevica, Lasgushi më ka thënë, Tiranë, 8 Nëntori, 1992, f. 99.

²⁷⁹ Mirlinda Krifca, Intertekstualiteti mes dy lufrave botërore, Shkup, Fakti, f. 147.

lexuesi është faktor i rëndësishëm për deshifrimin e raportit të një teksti me një tekst tjetër. Nga vet fakti që autori e ngroh vashë dhe nuk shtrydh na jep shenja se kjo dashuri nuk do të përfundojë si në poezinë popullore

Kënga popullore

“...*Vasha plasi mbrëmanet,*
Trimi plasi në mëngjes...”²⁸⁰

Ballada

Trimi ç`paske dhëndëruar
Vasha ç`paske nusëruar,

Synimi i vetëm i poetit në frymëzimet e tija nuk është plotësisht e njëjtë me poezitë popullore që janë përdorur si hipertekste. Duke nisur nga parimi, që çdo libër flet për një libër tjetër, ose çdo poezi lind nga një poezi tjetër, atëherë edhe poezia *Balladë* lind dhe u krijua nën petkun e poezisë popullore. Mjeshtëria dhe gjenialiteti i një autori qëndron në atë që autori është i vetëdijshëm për ndjekjen e poezive që ka si hipertekste, por njëkohësisht edhe di të largohet nga origjinali duke thurur vargje ndër më të bukurat ku dënohet mëkati i bërë në një vend të shenjtë siç është kisha dhe, ky mëkat më pas fiton kahje të ndryshme nga origjinali dhe kurorëzohet me martesë. Me nota optimizmi e përfundon poezinë duke ikur versionit origjinal. Lasgushi nuk e sheh te arsyeshme që të rinjtë, të dënohen në kishë për mëkatin e bërë por ata i shpërblen ashtu siç ndodh shpesh në kisha kurorëzimi i dashurisë me martesë.

Sipas M. Krifcës, “...plotësimi në mënyrë antitetike poezinë e përparme, përkatësisht hiperksti në mënyrë antitetike e plotëson hipotekstin e vet, paraqitet dukuria, të cilën Blumi e quan Tesera”²⁸¹

Duke mos dashur t'i largohet poezisë popullore të vendit të vet personazhet e poezisë *Balladë* i emëron si Trimi dhe Vasha, janë këto personazhe që jemi mësuar t'i dëgjojmë në letërsinë popullore. Jo vetëm elementet që kanë karakter shenjëzues për pikasje të raportit të teksteve mes tyre por edhe përshkrimet e karakteristikave të Vashës, gjejnë adresën në përshkrimet që i bëhen vashës në poezinë popullore. Ajo është *bel-hollë, sy-gjumashe, buzë gjak-qershije, sy-mëshqerë*, ashtu siç na përshkruhet *Vasha* e përsosur dhe e idealizuar, s`do mend që trimi venitet nga insistime permanent gjatë stinëve të ndryshme që ta

²⁸⁰ *Ibid.*, f. 148.

²⁸¹ *Ibid.*, f. 149.

pushtojë e ta shtrydh si molla. Duke qenë se dashuria është esenca e jetës së Lasgushit, duke besuar në të verbërisht me të drejt shprehet se: “*Më shumë më ka tronditur në jetë dashuria, më shumë më ka gëzuar dashuria*”.

Moderniteti dhe teoria e intertekstualitetit

Lasgush Poradeci, duke qenë autorë që i takon modernitetit ai në poezitë e tij bart elementë modernë. Ai përdor një stil të ri në ndërtimin e poezisë së tij ku në çdo fjalë investon duke qenë konciz dhe duke zgjedhur fjalët me shumë precizitet. Nuk mund të gjendet autorë në letërsinë shqipe me të cilin mund krahasojmë, por as në letërsitë tjera nga shkak i origjinalitetit që shpreh në poezitë e tij. Kuteli ka thënë për Lasgushin: “Arti i tij i detyrohet vetëm e vetëm artit mjeshtër të veprës Lasgushiane, e cila prej shumë vitesh e ka robëruar me bukuritë e saj të pashoqe në letërsinë shqipe.” Me tetorinë e intertekstualitetit, e cila mund të aplikohet edhe tek vepra e Lasgushit, kemi tentuar që të nxjerrim në pah mbështetjen në poezinë popullore apo në atë që i pëlqen autorit për frymëzimin e tij, dhe më pas të dëshmojmë që kjo teori nuk ia zbeh vlerën veprës së tij poetike, por ajo i mundëson që vepra e tij të fitojë më tepër vlera. Rol të rëndësishëm luan edhe poeti me aftësinë e tij, i cili merr dhe përpunon atë që e ka përvetësuar në mënyrë sa më poetike dhe me atë të krijoj vargje dhe poezi që do të mbeten në përjetësi. Eqrem Çabej, me të drejtë e shpallte “*poet të madh shqiptar e evropian, të cilin një fat i mirë ia ka falur Shqipërisë ...të cilin ...Shqipëria do t’ia fal njëherë botës*”²⁸².

Përfundim

Lasgushi, shkruante sepse besonte se poezitë e tij do të vazhdojnë jehonën e tyre, me dekada e me shekuj, ai kishte konceptin dhe vizionin ashtu ai siç do të shprehet edhe Orhan Pambuk: “*Shkruaj sepse besoj si një fëmijë... në vendin që do të zënë aty librat e mi*”.

Lasgushi, i cili në poezi shpall një formë të re të shprehjes edhe kur këndon femrën, por edhe kur këndon dashurinë, “*Dashuri heu mall i ri!*”, dëshmon që ai në vete ka besimin forcën dhe gjenialitetin që të

²⁸² Lasgush Poradeci, *Vepra 1*, Onufri, Tiranë, 1999, f. 19.

shpreh me aq përkushtim këtë dashuri përmes poezisë. *Një përndritje një luks i lodhur e përshkon tejmbanë këtë poezi.*²⁸³ Nga natyra e poetit mbase shumë gjëra mbeten enigmë pasi “*kodin zbërthyes e mori me vete në varr*” por përsëri mendojmë që ekzistonte besimi që një ditë do t’i jepej vlera dhe pozita e duhur në letërsinë shqipe, por edhe më gjërë në letërsinë ballkanike si poet i mirëfilltë modern i të gjitha kohrave. Së fundmi, Lasgushi me poezinë e tij na dëshmoi se *ç’mrekullira mund të bëheshin në letërsi në gjuhën shqipe.*²⁸⁴ Poeti i përjetësisë dhe poet, i cili dinte kur është koha që të heshte me qëllim që të dëgjohet poezia e tij.

BIBLIOGRAFI

- Hamiti, Sabri. *Studime letrare*, Seksioni i gjuhësisë dhe i letërsisë, Libri 21, Prishtinë, 2003.
- Hamiti, Sabri. *Letërsia moderne shqiptare*, Tiranë, 2000.
- Gros, P. Natali. *Poetika e intertekstualitetit*, përkth. Urim Nerguti, Prishtinë, Parnas. 2001.
- Kadare, Ismail. *Vepra*, Onufri, Tiranë, 2009.
- Krifca, B. Mirlinda. *Intertekstualiteti në poezinë shqipe mes dy luftërave botërore*, Fakti, Shkup, 2005.
- Poradeci, Lasgush. *Vepra 1*, Onufri, Tiranë, 1999.
- Poradeci, Lasgush. *Vepra 2*, Onufri, Tiranë, 1999.
- Kolevica, Petraq. *Lasgushi më ka thënë*, Tiranë, 8 Nëntori, 1992.
- Veseli, SH. Meral. *Aspekte të intertekstualitetit në letërsinë e Rilindjes kombëtare*, Tezë doktorati, 2017.

²⁸³ Ismail Kadare, *Vepra*, Onufri, Tiranë, 2009, f. 199.

²⁸⁴ *Ibid.*, f.196.

AFRIM A. REXHEPI
Departamenti i Kulturologjisë
Universiteti “Shën Cirili e Metodi” Shkup
aa_redzepe@yahoo.com

ESTETIKA E MARTIN HEIDEGGER-IT DHE POEZIA E LASGUSH PORADECIT

Estetika e Heidegger-it në raport me estetikën subjektivistë të Kantit, është antiestetikë. Sipas tij, arti është poezi, kurse poetikja është diktati i qenies i pozicionuar në gjuhë. Në projektin e tij për desubjektivizimin e shijes, Heidegger distancohet nga nocionet thelbësore të estetikës subjektivistë siç janë shprehja e përvojës dhe afektiviteti. Më saktë, nocionet shënojnë konfrontimin pozitiv midis gjuhës së poezisë dhe ekzistencës së subjektit. Formula e tij *Unë nuk e flas gjuhën, por gjuha më flet, më shpreh mua*, shënon faktin që gjuha nuk është shprehje e subjektit, por i paraprin subjektit. Pra, gjuha, është fenomeni më i rrezikshëm që skajshmërisht lidh tokën - qiellin, kaosin – kosmosin, mikrokosmën - makrokosmën etj. Një ndërlidhje e mundshme oksimoronike që realizohet përmes një ndërlidhje sublimate të të kundërtave, zbulon të vërtetën e objekteve, zbulon të fshehtën e qenies apo siç shprehet Poradeci, të fshehtën e të fshehtës. Në kontekst, Heidegger i ka interpretuar ata poet të cilët mendojnë (Helderlin, Rilke, Rembaud etj.), ata poetë të cilët në veprat e tyre, poezia ishte problemi më i madh. Në tekstin e tij *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit*, Eqrem Çabej shprehet: Ai i ngjan poetëve si Helderlin, Rilke, Trakl etj.

Është tejet intriguese estetika e Kantit kur bën pozicionimin e parametrave të vlerësimit të kategorive estetike me strukturë subjektive. Sintagma terminologjike shqisa e unifikuar, tregon në faktin që ne posedojmë shqisë të përbashkët në perceptimin e gjërave. Mirëpo, ekziston edhe një moment tjetër që lidhet me pyetjen epokale, ekziston pyetja: Ç’është ajo që i bashkon aftësitë tona shqisore? Kanti theksoi shqisën unitare, pra shqisën e përbashkët (sensus communis) që zakonisht shpjegohet përmes një strukture transhendentale. Mirëpo ekziston edhe kundërthënia sepse shqisa është çështje e strukturës empirike.

Shqisa është pasive, shqisa nuk është aktive. Por imazhi, pra shenja e dhënë, është gjithmonë në lëvizje, është dinamike, është në proces, është metaforë e një semiotike të gjallë që ç’do herë përsëritet nga e para. Në kontekst, si metaforë, imazhi mund të evokojë një herë të vetme e nëse përsëritet kalon në rendin simbolik, bëhet simbol.

Prandaj, në poezitë e Poradecit, është e nevojshme që metafora të kuptohet si fenomen njohës më i gjerë se simboli në kuptimin që simboli mund të bëhet metaforë dhe metonimi (nëse metafora definohet si izotop i metonimisë), e metafora dhe metonimia nuk mund të bëhen simbol. Nga *Fjalori i simboleve*, mund të verifikojmë dhe të interpretojmë kuptimet simbolike të figurës Nositi, mirëpo asnjëherë nuk do të mund ta përcaktojmë figurën simbol Nositi ashtu siç është krijuar në poezinë e Poradecit. Prandaj, nëse duam të depërtojmë në thellësitë e poezisë së Lasgushit, është e nevojshme të pranohet fakti që metafora nuk është vetëm një figurë stilistike por edhe një fenomen gjuhësor tejet i zgjeruar. Prandaj vlen të thuhet që poezia e Poradecit kërkon një praktikë të atillë teorike ku simboli, oksimoroni, sinestesionit dhe shenja-ikonë, së bashku janë fenomene metaforike, e metafora imazh-transmetues i vlerave estetike. Pra, metafora është një instrument gnoseologjik për t’i afruar dallimet, kurse rezultati i dallimeve të përafuara është oksimoroni, figurë kjo që ndërlidh leksemat opozitare si metafora emëruese. Oksimoroni është fenomen më i fuqishëm gjuhësor që tregon vijën deri ku mund të shkojnë predikatet dhe atributet. Në kontekst, ka një fenomen metaforik që zhdruk vijën ndarëse të leksemave. Është sinestesionit si një oksimoron ekstrem ku kontaktohen dy sema që nuk mund të zbërthehen më tutje. Të atilla janë: ngjyra, tingulli, aroma, përjetimet përmes prekjeve etj.

“Nëse fjalët përmes të cilave i emërojmë ngjyrat, janë elementet e fundit që shprehin një kuptim, është e logjikshme që nuk mund të krijohen metafora sepse brenda në tekst, nuk ka semema. Ato duhet të kërkohen jashtë tekstit. Pra, problemi i sinestesionit, i takon psikologjisë”.(Cohen, 1968: 27)

Sipas shembullit të simbolistëve, poezia e Poradecit dallohet për krijimin e efekteve sinestetike të cilat mund të dekodohen nga jashtë me ndihmën e kodeve të përcaktuara socio-kulturore. Prandaj themi që

poezinë e Poradecit duhet lexuar përmes një metafore tejet të zgjeruar, përmes një metafore që në vete ngërthen simbolin, oksimoronin, sinestesionin dhe shenjë - ikonë.

Suma summarum, e shoh të arsyeshëm të vë në funksion të elaborimit idenë epokale të Lyotard. “Modernizmi ishte në kërkim të asaj *që nuk mund të shfaqet*, edhe atë përmes formës estetike si një plotësim i asaj *që nuk mund të shfaqet*”. (Malpas, 2002: 25)

Fakti që u kthye në kohë për të studiuar filozofinë dhe estetikën parasokratike, Heidegger arriti të afrojë filozofinë dhe estetikën metafizike, më afër ekzistencës. Është merita e tij që e definoi hermeneutikën si strukturë të qenies e realizuar apo e vetëpozicionuar përmes gjuhës, përmes asaj gjuhe të thjeshtë, pragmatike, të gjallë. Estetika e Heidegger-it, në raport me estetikën subjektiviste të Kantit, është antiestetikë. Sipas tij, arti është poezi, kurse poetikja është diktati i qenies i pozicionuar në gjuhë. Në projektin e tij për desubjektivizimin e shijes, Heidegger distancohet nga nocionet thelbësore të estetikës subjektiviste siç janë shprehja e përvojës dhe afektiviteti. Më saktë, nocionet shënojnë konfrontimin pozitiv midis gjuhës së poezisë dhe ekzistencës së subjektit. Formula e tij *Unë nuk e flas gjuhën, por gjuha më flet, më shpreh mua*, shënon faktin që gjuha nuk është shprehje e subjektit, por i paraprin subjektit. Pra, gjuha është fenomeni më i rrezikshëm që skajshmërisht lidh tokën-qiellin, kaosin–kosmosin, mikrokosmën – makrokosmën etj. Një lidhje e mundshme oksimoronike që realizohet përmes një ndërlidhje sublime të të kundërtave (p.sh. dhembshurisht e ëmbël), zbulon të vërtetën e objekteve, zbulon të fshehtën e qenies apo siç shprehet Poradeci, të fshehtën e të fshehtës. Në kontekst, Heidegger i ka interpretuar ata poet të cilët mendojnë (Helderlin, Rilke, Rembaud etj.), ata poet të cilët në veprat e tyre poezia ishte problemi më i madh. Në tekstin e tij *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit*, Eqrem Çabej shprehet: Ai i ngjan poetëve si Helderlin, Rilke, Trakl etj.

“Në Gjermani, është çudi se ka qenë një shkrimtar i lindur që më 1770, Holderlin, i cili në jetën e tij letrare fort të shkurtër ka nxjerrë harmonira që u afrohen këtyre të sotmeve. Në kohët e fundit Rilke, Stefan George e disa të tjerë, janë përfaqësuesit e vjershës moderne gjermane... Ja, pra, poetët që janë produkt i kohës moderne, bir i së

cilës është dhe Lasgush Poradeci”. (Çabej, Mbi poezinë e Lasgush Poradecit)

Në fakt, Heidegger, artin e definon përmes estetikës ontologjike, ngjashëm me Nikolai Hartmann i cili duke e ndarë veprën artistike në dy plane, në planin material dhe në planin metafizik, themeloi estetikën ontologjike. Në kontekst, edhe Heidegger veprën artistike e ndan në dy plane, por tek Heidegger-i planet nuk lidhen njëra me tjetrën, ato përplasen në dy faktorë fundamental: toka dhe bota, toka dhe qielli, kaosi dhe kosmosi. Gjithnjë sipas Heidegger-it, vepra artistike është zbulim sublim në të cilën zhvillohen përplasjet midis kategorive të kundërta.

Ngjashëm me Heraklitin, i cili logosin e definoi si një shkrim funksionale të të kundërtave. Pra, arti krijohet në momentin kur shfaqet çastit sublim, kur zbulohet ndritësimi i gjërave të fshehura, kur materia kalon, shndërrohet në energji. Në këtë mënyrë, zbulohet e vërteta e të vërtetës, në përplasje, në dridhje, në tension të thellë, ndritësohet fshehtësia e qenies. Pra, e vërteta është objektive dhe ekziston si e tillë.

Sipas Heidegger-it, poezia është gjuha e parë e popujve, e poetët barinj të që ruajnë qenien. Poetët, jo vetëm që janë në ekzistencë, por ata ndodhen në fillesat e saj. Në kontekst, parashtrahet pyetja, Kush e krijon të vërtetën apo fshehtësinë e fshehtësisë? Të vërtetën nuk e krijon poeti sepse poeti është subjektiv, e vepra artistike nuk është objekt fizik, është vepër arti në të cilën e vërteta shfaqet spontanisht. Kjo do të thotë se vepra e artit nuk është shprehje e artistit por është shprehje e të vërtetës që natyrshëm pozicionohet në vepër. Heidegger mendon që artistët e mëdhenj shkrihen me artin e tyre, saqë vepra e artit shndërrohet në një lloj depersonalizimi a indiference. Pra, arti është ontocentrik. Me vet faktin që ne pozicionohemi para imazhit, e vërteta ontologjike si akt sublim, ndodh midis ne dhe veprës. Në këtë mënyrë, ne i përfitojmë bindjet më të thella për ekzistencën, për gjërat që janë ç’do ditë me ne, brënda nesh dhe për ne.

Në Estetikë, realizimi i kritikës subjektive, funksionalizohet përmes tre elementeve kyçe të subjektivitetit: përvoja shqisore, kënaqësia dhe e bukura. Tendenca e Heidegger-it është që elementet kyçe të distancohen nga arti me qëllim që të del në sipërfaqe pastërtia ontologjike e gjërave. Ideja fenomenologjike e Husserl-it, kthimi kah bota e jetës,

kah e vërteta e të vërtetës, është në funksion. Kjo është kështu sepse në estetikën tradicionale është e njohur hegjemonia e subjektit.

Desubjektivizimi i shijes realizohet duke i mohuar nocionet kyçe të estetikës subjektive siç janë: shprehja e përvojës së shijes, përjetimi dhe e afektiviteti. Në këtë mënyrë funksionalizohet përvoja e të vërtetës që ndryshon nga përvoja metafizike, dominante kjo e estetikës subjektive. Në kontekst, forca e poezisë së Poradeci, është në gjithpraninë apo në plotninë e saj në raport me konkretin në të cilën shfaqet përjetësia e të kundërtave ekstreme siç janë: toka – bota, toka – qielli, kaosi – kosmosi, pikëllimi – gëzimi etj. Shembull tipik është figura e Nositit që në vete ngërthen simbolikën dhe oksimoronin, është një figurë (metaforë) semiotike e gjallë që nuk pranon diktatin e metafizikës ndaj materies apo objektit. Perceptimi i kësaj figure vetëflijuese nuk mundet të jetë subjektive. Figurën e Nositit, nuk mund ta perceptojmë si një të vetme. Estetiku mund ta perceptojmë në lëvizje apo si një figurë oksimorone që manifeston ndërlidhjet. Në dukje, pikëllimi dhe gëzimi:

Pa nis ah! gjirin t'a godas

Dh' e hap ah!- gjirin më një ças...,

Dh'i nginj ah! zogjtë – e vdes me gas!...

(Poradeci, 1990)

Pra, jo si figurë metafizike, por si një figurë në lëvizje që krijohet nga ndërlidhjet tensionale, si një figurë sublimë dhe historike. Në fakt, figura e Nositit është formë estetike tragjike, në thelb e bukur që lëviz kah sublimja, është ai krah i sistemit të kategorive estetike që ka herë tensionohen me objektin fizik, pra me botën, por kurrë nuk e dominojnë, thjeshtë janë pjesë përbërëse e ritmit të saj.

Tani, të kthehemi tek Heidegger-i. Antiestetizmi i tij, është ngushtë i lidhur me kuptimin që është problematik me nocionin perceptim estetik (aisthesis). Duke e përjashtuar një nocion të tillë, ai distancohet nga disa “modernistë” të cilët veprën artistike e perceptojnë si fenomen subjektiv, si aisthesis të pastër thellë të inkorporuar në rrafshin shqisor të artit. Nëse estetika bazohet në kategorinë perceptim, atëherë përveç recipientit, është e nevojshme të funksionalizohet edhe ekzistenca e subjektit krijues. Në shkrirjen e ekzistentëve, rezulton relativiteti kohor,

ku arti humb në aktualitet. Që do të thotë se arti ngadalë por sigurt vdes në kohë por mbetet funksionale vepra në përjetësi. Pra, arti nuk mund të ekzistojë në formën e dhënë të objektivitetit historik. Në kontekst, parashtrohet pyetja, Çfarë ndodh me artin, me poezinë, kur kategoria e saj thelbësore perceptimi, përjashtohet nga modusi i saj? Çfarë ndodh nëse vepra dislokohet nga elementet e subjektivitetit, pra nga krijuesi, recipienti dhe perceptimi? Ndodh funksionalizimi i ontocentrizmit, ku shijuesi tërhiqet nga akti sublim, nga e vërteta e të vërtetës apo nga fshehtësia e fshehtësisë. Pra, zbulohet qenia për tjetrin dhe qenia në ndërlidhje me tjetrin, si përjetësi historike.

Ses' dashuronja – as un' as ti,

Po dashuronte dashurija:

Një dashuri – një fshehtësi

M'e e fshehur sesa fshehtësija

(Poradeci, 1990)

Poezia e Poradecit është fenomen i till që vetvetiu e vendos të vërtetën e qenëzuar. E, ç'ndodh me marrësin? Përmes kontaktit sublim, marrësi e tejkalon subjektivitetin duke “qëndruar” në ekstazë. Edhe pse shndërron në një lloj transmittuesi, përsëri mbetet pjesë integrale e të vërtetës objektive. Sipas Heidegger, kontaktin nuk e interpretojmë si procedim kognitiv apo perceptiv i subjektit në botën objektive. Kontakti është aq thellë i rrënjosur saqë dikotomia subjekt - objekt shkrihet. Në veprën artistike, kontakti nuk ekziston, kontakti apo çasti i përshkënditur, zhvillohet midis ne dhe veprës duke kështu u rizbuluar e vërteta ontologjike. Në kontekst, poezia e Poradecit përmes rizbulimit thelbësor të gjërave ekzistuese, tregon në faktin që ne në mënyrë implicite, jemi pjesë e konstituimit të botës. Duke e parafrazuar estetikën e Heidegger-it në poezinë e Poradecit, kemi parasysh faktin që kontakti është zero por nuk është hiçi, janë kuptime këto të fshehura nga tradita, e që bëhen të dukshme përmes kontaktit sublim. Pra, poezia e tij, në esencë është sublime, sepse gjërat e fshehura nga tradita i bën të dukshme, i ndritëson ato në botërat tona historike. Në funksion ideja sublime e artit Lasgushjan: Të shfaqet, të bëhet e dukshme ajo që nuk mund të shfaqet. Poezia e Poradecit, efektuizon me estetikën e sublimes. Poezia e tij, distancohet nga figurimi, është poezi që krijon efekte të kënaqësisë

estetike, edhe atë vetëm atëherë kur shkakton dhimbje. Në poezinë e Poradecit, ndjenja e sublimes, është ndjenjë që subjektivisht e përjetojmë, por ndjenja sikur është enigmatike, gati e pazbërthyer sepse frika e shtuar dhe egzaltimi që shkaktojnë ndjenjën sublime janë enigmatike dhe të vështira për tu përçuar tek ndjenjat e moralit. Dhe krejt kjo për faktin që estetika e sublimes e artit Lasgushjan, është afeksion i thellë që njëkohësisht përçon kënaqësi dhe dhimbje. Figura e Nositit, duke qenë formë estetike, është një projektion i tillë sublim. Në kontekst, në poezinë e tij, ekziston përpjekja që të shfaqet ajo që nuk mund të shfaqet edhe atë përmes asaj poezie të shndërruar në këngë, përmes përpjekjeve sublime të poetit i cili bashk me Heidegger-in besojnë që poezia është projektion i ndërlidhjeve oksimoronike e materialit gjuhësor, e shndërruar në formë estetike, pra jo në poezi, por në këngë.

“Jo më kot flitet për “këngë”, pasi bëhet fjalë për një lloj ekzekutimi i cili ç’do herë është i papërsëritshëm, dhe sidoqoftë buçet përsëri unicitetin e tij gjithmonë në forma të reja. Nga një larmi komentesh të papritur përshkënditet një çast i pezulluar, në të cilën shfaqet një “prani” e re, që bën pjesë tek ne. Është një lloj miqësie me gjërat e jetës, një intimitet.”. (Gadamer, 2008: 347)

Në analogji me citatin, në funksion mendimi i Lasgush Poradecit, “Pse duhet të jetë poezia e fortë, potenciale, e përsosur? Sepse vetëm dyqe qënë potenciale, ka fuqinë me vete që të transmetohet më tej, që të transformojë potencialitetin e jetës dhe racës më tej në të ardhmen njerëzore...sepse vetëm gjuha shqipe (e derdhur në poezi) me tingujt frymorë dhe lëndorë ka mundësi të shprehë harmoninë specifike të poezisë sime...”. (Poradeci, 1990)

Shndërrimi i poezisë në këngë, është formë estetike që shënon fillet dhe themelon e ndritëson gjërat diku të humbura në kohë. E në fillim ishte fjala, ishte fjala sublime e zanafillës. Fjala që poetët e shndërrojnë në këngë dhe fjala përmes së cilës shpirtërisht gjithçka regjenerohet. Sa bukur shprehet Heidegger, në esenë e tij të njohur *Përse janë të nevojshëm poetët?* “Poetët janë qenie të kohshëm të cilët duke i kënduar perëndisë së verës, gjurmojnë gjurmët e perëndive të humbura,

dhe duke qëndruar në gjurmët e tyre, ata, qenieve të përkohshme, u ndritësojnë rrugën e rikthimit”. (Heidegger, 2000: 57)

Nganjëherë poetët edhe nuk mund ta realizojnë tendencën epokale, por ata vazhdimisht qëndrojnë dhe gjurmojnë gjurmët. Dhe pikërisht, një përpjekje e tillë, është sublime. Janë sublime, janë të madhërishtme fjalët e Poradecit, “sepse vetëm gjuha shqipe (e derdhur në poezi) me tingujt frymorë dhe lëndorë të saj ka mundësi të shprehë harmoninë specifike të poezisë sime”. (Poradeci, 1990)

Interpretimi i estetikës së Hajdegerit në poezinë e Poradecit, tregon në faktin që:

- janë ekzistentë impulset e para të estetikës fiziologjike, e që shumë më vonë, në estetikë, do t’i konkretizojë filozofi Gilles Deleuze;
- përforcon bindjen e Çabejit që poezia e Lasgushit ka një emocion shpesh të përafërt me ekstazën;
- përforcon bindjen, atë të Moikom Zeqos që Lasgushi e ka emancipuar poezinë shqipe ndërmjet një estetike, si pakkush në të gjithë shekujt letrarë të Shqipërisë.

BIBLIOGRAFI

Cohen, Jean. (1966) Structure du langage poetique, Paris.

Çabej, Eqrem. Mbi poezinë e Lasgush Poradecit // [www. google.com](http://www.google.com)

Gadamer, Hans – Georg. (2008) Historia e Filozofisë, Plejad, Tiranë.

Inwood, Michail. (2007) Martin Heidegger - Një hyrje e shkurtër, Plejad, Tiranë.

Inwood, Michail. (2000), A Heidegger Dictionary, Blackwell Publishers.

Liotard, Jean-François. (1984) The Postmodern Condition, University of Minnesota Press.

Malpas, Simon. (2002) Jean-François Lyotard, London and New York.

Poradeci, Lasgush. (1986) Vdekja e Nositit, Prishtinë.

Poradeci, Lasgush. (1990) Vepra Letrare, Tiranë.

Hamiti, Sabri. (2000) Letërsia moderne shqiptare (Gjysma e parë e shekullit XXI), Albass, Tiranë.

DONIKA BAKIU
Universiteti i Evropës Juglindore, FGJJK
db20787@seeu.edu.mk
Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut

HISTORIZMAT, HUAZIMET DHE NEOLOGJIZMAT NË DISA POEZI TË LASGUSH PORADECIT

Çdo shkrimtar i madh hyn në një marrëdhënie të caktuar me gjuhën e kombit të tij. Veprat letrare të shkrimtarëve cilësorë bëhen domosdoshmërisht objekt studimi nga gjuhëtarët për vetë vlerat që ato sjellin në këtë fushë. Gjuha e një shkrimtari mund të studiohet me anë të metodave të ndryshme. Në këtë punim kemi marrë për studim neologjizmat, historizmat dhe huazimet në disa poezi të Lasgush Poradecit.

Neologjizmat janë fjalë ose shprehje që ka hyrë rishtazi në gjuhë për të shënuar një send a një dukuri të re dhe që ende ndihet si e tillë. Historizëm- fjalë a shprehje që ka dalë nga përdorimi i gjallë, sepse sendi a dukuria që shënon ajo i takojnë një periudhe historike të kaluar. Huazime- Fjalë a njësi tjetër gjuhësore, që është marrë prej një gjuhe tjetër dhe përdoret në gjuhën amtare.

Hyrje

Për poezinë e Lasgush Poradecit janë bërë studime të shumta, sidomos tri dekadat e fundit që kanë sjellë përfundime e konkluzione të ndryshme, duke e vlerësuar lartë atë për motivet, temat, stilin, e gjuhën e trajtuar. Poezia e tij disponon vlera të padiskutueshme ideo-artistike, figuracion të pasur, shprehje të rrallë e ligjërime me një gjuhë të përzgjedhur që vetëm Lasgush Poradeci mund ta bënte. Në këtë punim kemi bërë analizën e disa poezive të Lasgush Poradecit. Ai si poet përdor neologjizmat, historizmat dhe huazimet. Lasgushi nuk e ndan poezinë në mënyrë skematike sipas motiveve kryesore, por në bazë të frymëzimit dhe të konceptimit që ka ai për secilin cikël. Aty dallohen poezitë e peisazhit, poezitë e dashurisë dhe poezitë filozofike. Në thelb të gjitha poezitë e tij janë poezi meditative- filozofike. Krijimin e tij Lasgushi e mbështet në katër figurat elementare: qiellin, dheun, ujin e zjarrin, të cilat janë temat e përhershme të poezisë së tij.

Historizmat në disa poezi të Lasgush Poradecit

Historizmat, janë përdorur në një periudhë të caktuar kohe dhe sot hasen kryesisht në letërsi ose në veprat shkencore që flasin për atë periudhë, si heshtë, shqytë, kumbara, breshana, aga, vergji, pasha etj. Si arkaizmat edhe historizmat janë fjalë të vjetëruara dhe nuk përfshihen në leksikun e gjuhës letrare.²⁸⁵ Historizëm është fjalë a shprehje që ka dalë nga përdorimi i gjallë, sepse sendi a dukuria që shënon ajo i takojnë një periudhe historike të kaluar. “Gjuha mund të krahasohet me një qytet të vjetër, ku bashkekzistojnë rrugica dhe sheshe, shtëpi të reja dhe të vjetra, shtëpi me pjesë të ndërtuara në kohë të ndryshme dhe rreth tyre një numër i madh lagjesh të reja periferike, me rrugë të drejta e të parregullta e me shtëpi standarde.”²⁸⁶ Historizmat nuk janë në numër të madh disa që kemi arritur t’i gjejmë janë: *silah*-brez i gjerë lëkure, që shërbente për të mbajtur armët e brezit; *ovgjalë*-fashë pëlhure me të cilën mbështillen armët e vajosura; *stringë* – lloj pushke e vjetër; *gjqy helenik*, *frëngji* -arkaizëm.

Huazimet në disa poezi të Lasgush Poradecit

Huazimi ka ardhur si nevojë e njerëzimit për të komunikuar mes folësve të shteteve të ndryshme. Huazim është fjalë a njësi tjetër gjuhësore, që është marrë prej një gjuhe tjetër dhe përdoret në gjuhën amtare. Përballja e parë me fjalët e huaja ka qenë nga leksikografët në shekullin XVIII. Kur mbledhnin materialin për fjalorë, ata nuk dinin si t’i klasifikonin këto fjalë, pasi mendimet e para të tyre ishin të ndryshme. Hugo Schuchardt²⁸⁷ ishte i mendimit se nuk ka gjuhë që është plotësisht e papërzier. Antoine Meillet²⁸⁸ huazimin e quan dukuri të natyrshme, kryesisht huazohen elementë leksikorë dhe thuajse nuk ka gjuhë pa huazime. Schönfelder²⁸⁹ thoshte se përzierja e gjuhëve bëhej me ndikim të njëanshëm ose bilateral të dy apo të më shumë gjuhëve. Ky ndikim

²⁸⁵ Mustafa Ibrahim -Leksikologji me sematikë I-II, Tetovë 2014, f. 106.

²⁸⁶ Wittgenstein, Ludwig, Prototractus: En Early Version of Tractatus Logico-Philosophicus, London Routledge/ Kegan Paul, 1971, f. 20.

²⁸⁷ Hugo Schuchardt, Slavo – Deutesch und Slavo – Italianisches, Graz, 1884 sipas Vesel Nuhiu, Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, f. 15.

²⁸⁸ Antoine Meillet, Linguistique historique et linguistique gènèrale, Paris, 1921 dhe 1936 sipas Vesel Nuhiu, Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, f. 17.

²⁸⁹ Karl-Heinz Schönfelder, Probleme der Wölker und Sprachmischung, Halle, 1956, sipas Vesel Nuhiu, Ndikimii anglishtes në gjuhën shqipe, f. 17.

shprehej jo vetëm në leksik, por edhe në përmbajtjet fonetike, morfologjike dhe sintaksore. Pra, deri në shekullin XIX është përdorur termi gjuhë të përziera, por më vonë u hodh poshtë pasi fjala “përzierje” nuk dukej e përshtatshme, dhe filloi të përdorej termi huazim gjuhësor. Bloomfield-i huazimin gjuhësor e përcaktonte si marrje të elementeve gjuhësore dhe dallonte dy tipa huazimesh: atë kulturor (kur elementet e huazuara vinin nga një gjuhë tjetër e largët) dhe dialektor (kalimi i fjalëve nga një dialekt në tjetrin). Huazimet që kemi gjetur në poezitë e Lasgush Poradecit janë: *pazar, katran, nur, nam, pekmez, mavijuan, tallaz, selvi,fiqir, xhelat, zeher, halldup turkoshak, vatan, avitet, zuzar, anadollak, sahat, allçak, batare, mejdan, karakoll, katalla, azgan, kasak, sollak, jatagan, filis, çollak, xhade, sumbulla, resurrectionjallje*.

Neologjizmat në disa poezi të Lasgush Poradecit

Neologjizëm vjen nga greqishtja *neos*=i ri, *logos*=fjalë. Justin Rrota i përkufizon kështu neologjizmat: “Janë neologjizme njato fjalë a mënyra të reja, qi nuk i bën gjuha, për arsye ma së fortit se janë qitun pa mendue e pushue mirë. Flitet këtu vetëm për njato fjalë e të thanme të reja, të trajtueme pa marrë parasysh natyrën e gjuhës shqipe, e të përkthyme krejt si janë në një gjuhë të huaj.” Sterjo Spasse jep këtë përkufizim: “Neologjizmat janë fjalë e të folme të reja”.

Neologjizmat krijohen me shumicë, kur bëhen ndryshime të mëdha e të shpejta në jetën e shoqërisë. Neologjizmat i krijon vetë populli ose dhe shkrimtarët: Neologjizmat formohen prej fjalësh që i ka vetë gjuha. P. sh. gjatë Rilindjes u krijuan ndër të tjera këto neologjizma: ndërgjegje, përgjegje, përemër, mbiemër, fletore etj. Neologjizmat krijohen edhe nga shkrimtarët, kur duan të shprehin me forcë të re ndonjë dukuri. Megjithatë thesari i gjuhës popullore jep shumë mundësi për të mënjeluar krijimin e fjalëve të reja të panevojshme.

Neologjizmat që kemi gjetur në disa poezi të Lasgush Poradecit janë : *klithmëz, mitare, gjymashë, korijëza, plëngëtore, zemërgjare, shërëmti, bredhuar, ëmbëlzaj, zhurmëri, shfreu, kulmit, thëmbërzat, këtejeza, ashtuzë, këtuzë, kështuzë, zhurmëria,hepohem*.

Shembull: ‘ ‘ Dhe ika, ika posi hije / Duke kënduar e **bredhuar**/ Përmi

shkëmbinjtë ndaj pata parë/Të gdhendur **ëmbëlzaj** një emër.²⁹⁰

Neologjizmat “shfren”, “valomë”, “i uluruar”, rrisin peshën semantike të poezisë duke na bërë të kuptojmë se megjithë dëshpërimin që mbart, kjo ndjenjë është veçanërisht e bukur. Në poezitë e Lasgush Poradecit ka mjaft fjalëkrijime, që edhe janë kritikuar në kohën e tij, por që e kanë bërë shqipen e kohës më të zhërvjellët. Ky shkrimtar është përpjekur edhe të ndikojë për pastërtinë e shqipes përgjithësisht, p.sh. ka bërë: *paemërsi* për *anonimat*, *i paemërshëm* për *anonim*, *jashtërendësisht* për atë që sot kemi si *jashtëzakonisht*.²⁹¹ Lasgush Poradeci përdor kompozita poetike prej tri pjesësh: *leshëra-cullufedredhur*; *shtat-lëkundura-pallua*; *qepallë-dendur-tatëpjetë* etj.

Si përfundim mund të themi se gjatë studimit arritëm të gjejmë në poezinë e Lasgushit historizma, historizma, huazime dhe neologjizma. Poezia e Lasgush Poradecit, për motivet, stilin, gjuhën e bukur shqipe, figurën origjinale, formën e re individuale dhe ndjeshmërinë re, është karakteristike dhe e veçantë në letërsinë shqipe.

BIBLIOGRAFI

Antoine Meillet, Linguistique historique et linguistique générale, Paris, 1921 dhe 1936 sipas Vesel Nuhiu, Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, f. 17.

Hugo Schuchardt, Slavo – Deutesh und Slavo – Italianisches, Graz, 1884 sipas Vesel Nuhiu, Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, f. 15.

Karl-Heinz Schönfelder, Probleme der Wölker und Sprachmischung, Halle, 1956, sipas Vesel Nuhiu, Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, f. 17.

Lasgush Poradeci, Vepra 1, Poezia, Tiranë 2009 .

Mustafa Ibrahim, Leksikologji me tematikë I-II, Tetovë 2014, faqe 106

Xhevat Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, Albas, 2005, faqe 124.

Wittgenstein, Ludwig, Prototractus: En Early Version of Tractatus Logico-Philosophicus, London Routledge/ Kegan Paul, 1971, fq. 20.

²⁹⁰ Lasgush Poradeci, Vepra 1, Poezia, Tiranë 2009, f. 276.

²⁹¹ Xhevat Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, Albas, 2005, f. 124.

SALI BYTYÇI
Instituti Albanologjik - Prishtinë
BEDRI ZYBERAJ
Kolegji AAB
salibytyqi@yahoo.com
bedrizyberaj@hotmail.com

BOTIMI DHE STUDIMI I POEZISË SË LASGUSH PORADECIT NË KOSOVË

Pothuaj po aq sa i është kushtuar vëmendje poezisë së De Radës, të Naimit apo Migjenit në Kosovë, pas Luftës së Dytë Botërore, e sidomos që nga fundi i viteve '60 e tutje, poezisë së Lasgush Poradecit i është kushtuar një vëmendje e veçantë jo vetëm në botimin, por edhe në studimin e saj.

Poezia e Lasgushit gjatë kësaj kohe pati disa botime, për të u shkruan nga artikuj të veçantë e deri te monografitë studimore. Këtu vlen të përmenden studimet e Rexhep Qosjes, të Mensur Raifit, Sabri Hamitit, Rexhep Ismajlit, Emin Kabashit, Hysen Matoshit, Shefki Sejdiut etj. Këto studime për këtë poezi variojnë prej atyre klasike e deri te ato që mbështeten në teoritë moderne letrare.

Në studimet e tyre kritike, kritikët shqiptarë të Kosovës kanë ndërtuar profilin krijues të Lasgushit dhe vendin që zë ai në letërsinë shqipe (Rexhep Qosja, Emin Kabashi, Sabri Hamiti), kanë parë raportet e poezisë së tij me krijues të tjerë (Rexhep Qosja, Rexhep Ismajli), kanë shqyrtuar raportet e poezisë së Lasgushit me poezinë evropiane (Rexhep Qosja, Hysen Matoshi), ose janë përpjekur t'i bëjnë një studim psikanalitik krijimtarisë së Lasgushit (Mensur Raifi) etj.

Hyrje

Studimet për poezinë e Lasgush Poradecit në Kosovë janë shkrime që trajtojnë një poezi të vetme, disa poezi që kanë një bosht të përbashkët estetik, shkrime që trajtojnë aspekte të kësaj poezie, që merren me anën tingullore të saj, që trajtojnë metrin apo figuracionin, e deri te studimet monografike që përfshijnë tërë poezinë e tij.

Studiuesit kosovarë kanë dhënë kontributin e tyre në studimet lasgushjane. Ata, duke u mbështetur në metoda të ndryshme, kanë trajtuar aspekte të ndryshme të poezisë së Lasgushit dhe kështu kanë arritur të ndriçojnë anë të ndryshme të poezisë së tij.

Në këtë shkrim ne do të merremi kryesisht me historinë e botimit dhe të gjykimit kritik të poezisë së Lasgushit në Kosovë, nga botimi i parë i plotë i poezisë së tij në Prishtinë e deri në vitet 2000.

Në pjesën e parë do të flasim për historikun e botimit të poezisë së Lasgush Poradecit në Kosovë, ndërsa në të dytën për kritikën që është shkruar për këtë poezi dhe larminë e saj.

I. Botimi i poezisë së Lasgushit në Kosovë

Botimi i parë i poezisë së Lasgush Poradecit në Kosovë është bërë në vitin 1968, nga poeti Murat Isaku, dy vjet pas rënies së regjimit i cili në popull njihet si “Koha e Rankoviçit”. Në shënimin që jep në fund të librit, redaktori i këtij botimi thotë se në fillim kishte menduar të botoonte vetëm një pjesë të poezive të Lasgushit, duke bërë edhe një version me poezi që sipas bindjes së tij kanë më shumë vlerë, po në bisedë me kolegë të Entit të Botimeve Shkolllore, ishte vendosur që në një libër të përfshihen pothuaj të gjitha poezitë e poetit, “me qëllim që sa më lehtë dhe drejtpërdrejt të perceptohet delli i tij letrar” (S.B&B.Z).

Ky libër i botuar nga Murat Isaku përfshin pothuaj të gjitha poezitë e dy vëllimeve të Lasgush Poradecit: “Vallja e yjve” dhe “Ylli i zemrës”, ndërsa radhitja e poezive është bërë, siç thotë në shënim, sipas subjekteve dhe afinitetit të përmbajtjes.

Libri ka 23 faqe parathënie, 94 poezi, tirazhi 2000 kopje, madhësia: 15,5x22 cm.

Botues: Enti i Botimeve Shkolllore i Republikës së Serbisë, reparti – Prishtinë, rr. “Beogradi”, 2a, pa nr.

Parathënia që i paraprin librit të Lasgush Poradecit, e shkruar nga Murat Isaku, është e ndarë në shtatë pjesë, në të cilat, ky i fundit, i prezanton lexuesit figurën jetësore dhe poetike të Lasgush Poradecit.

Në pjesën e parë të parathënies prezanton jetën e Lasgushit, shkollimin, angazhimin e tij në Rumani, e pastaj edhe në Korçë e Tiranë. Shkruan për fillet e para poetike të poetit, që datojnë aty nga vitet 1915-16, në

kohën e Luftës së Parë Botërore dhe më pas flet për kontekstin e krijimit, për botimin e poezive të tij në shtypin e kohës etj.

Në pjesën e dytë, trajton botimin e veprës së Lasgushit: “Vallja e yjve”, dhe studimin e Kutelit. Jep të dhënat për përmbajtjen e këtij vëllimi, i cili ishte botuar 17 vjet pasi poeti kishte krijuar e botuar në shtypin e kohës, për historinë e botimit të të dy përmbledhjeve të Lasgushit etj.

Në pjesën e tretë, trajton kritikën letrare, e cila veprën e Lasgushit e ka vështruar nga aspekte të kundërta estetike dhe, për rrjedhojë, ka arritur edhe në konkluzione të kundërta. Këtu shkruan për studimin e Gaetano Petrotës për poezinë e Lasgushit, si dhe për qëndrimet e kundërta të Mitrush Kutelit e Krist Malokit për këtë poezi. Sipas Murat Isakut, Kuteli i jep përparësi anës formale të poezisë së Lasgushit: llojit të metrikës, fjalorit poetik, trajtave të strofave. Isaku thotë se Kuteli për poezinë e Lasgushit e mbështet kritikën në poezitë e tij më të bukura artistikisht, e nuk merret me poezitë e dobëta të tij. Ndërsa, sipas Isakut, tani “asht koha që Lasgushin,, ta studjojmë nga të gjitha kandet, tue e çlirue kësisojit prej hipotezave të dogmave estetike dhe prej paragjykimëve tradicionale”.²⁹²

Në pjesën e katërt, që është edhe pjesa më e gjatë, flet për kohën në të cilën ka krijuar Lasgushi – Lufta e Parë Botërore. Në këtë pjesë flet për vëllimin poetik “Ylli i zemrës”, të cilin e trajton cikël pas cikli; motivet që trajton poeti: poezitë për liqenin, për gjuhën, poezitë erotike etj.

Poezinë e Lasgushit e konsideron autobiografi të poetit; të, “atij njeriu që dallgët e stuhisë e kanë përplas nëpër vendet e Europës pa mbështetje materjale dhe pa dashurinë e ngushtë të ndonjërit”.²⁹³

Poezinë lirike të Lasgushit e krahason me poezitë erotike të paraardhësve të tij, me të De Radës, Naimit, Çajupit, si dhe e thekson ndikimin e Lasgushit nga poezia popullore. Lidhur me këtë ai konstaton se “Lasgushi asht ma i afërt me De Radën dhe Naimin se sa me Çajupin, i cili poezisë erotike i dha landë dhe shpirt konkret”,²⁹⁴ për të përfunduar se “Te Lasgush Poradeci përjetimet e dashunisë në poezi shkrihen në

²⁹² Murat Isaku, Lasgush Poradeci (shih: Lasgush Poradeci, Poezia. Enti i botimeve shkollore i Republikës së Serbisë, reparti – Prishtinë 1968, f. 8).

²⁹³ Po aty, f. 10.

²⁹⁴ Po aty, f. 11.

fluska kujtimi”.²⁹⁵ Sipas Isakut, poezia e Lasgushit është e kthyer nga perëndimi, ai mbetet poet i dashurisë së perënduar.

Në pjesën e pestë shtjellon ndërtimin e veprës së Lasgushit, kompozimin e saj në cikle. “Të pesë kaptinat së bashku, siç pamë ma nalt, krijojnë arkitekturën organike të poezisë së Lasgushit”.²⁹⁶

Në pjesën e gjashtë, trajton anën formale të poezisë së Lasgushit. “Derisa Migjeni revolucionarizon mbrendinë e saj, tue e lidhë ate me fatin e turmave, Lasgush Poradeci tehun e vëmendjes ia kushton përkryemjes së formës virtuoze, tue inkuadrue në këtë mori faktura të reja”.²⁹⁷, thotë Isaku, duke vazhduar më tej të trajtojë metrin, ritmin, llojin e lirikave, figuracionin dhe gjuhën e poezisë së Lasgushit.

Në pjesën e shtatë dhe të fundit, shkruan për individualitetin letrar të Lasgush Poradecit, për rrugën jetësore që ka kaluar poeti dhe për ndikimin e teorive formaliste të kohës në të cilën ka krijuar ai. “Te asnji shkrimtar tjetër në letërsinë shqipe influksi i huej letrar nuk gërshetohet me traditën kombëtare si te Lasgush Poradeci”.²⁹⁸, për të përfunduar se “Ai (Lasgushi, vërejtja jonë S.B.&B.Z.) krijon një kryeurë vizionare ndërmjet zenitit dhe trollit, ujit dhe yjve, hanës dhe valëve, mallit dhe dritës, shpresës e dhimbjes, flakës dhe akullit, atdheut dhe mërgimit, vuajtjes dhe liqenit, popullit dhe vetes”.²⁹⁹

Murat Isaku ka shkruar një parathënie të frymëzuar, jo rrallë të përshkuar nga një gjuhë figurative. Ai veçon poezinë e lartë nga ajo e dobët, pastaj si edhe kritikë të tjerë të pas Luftës së Dytë Botërore, kritikon rendjen e Lasgushit pas formës në dëm të përmbajtjes.

Pas botimit të këtij vëllimi poetik, poezia e Lasgushit u botua edhe në “Antologjinë e lirikës shqipe”,³⁰⁰ të përpiluar nga profesor Rexhep Qosja, më 1970. Në këtë antologji, në të cilën poetët shqiptarë nga Jeronim de Rada e deri te Moikom Zeqo, janë përfaqësuar me nga 2 deri në 18 poezi, Lasgush Poradeci është i dyti, pas Asdrenit, me 12

²⁹⁵ Po aty, f. 12.

²⁹⁶ Po aty, f. 19.

²⁹⁷ Po aty, f. 19.

²⁹⁸ Po aty, f. 22.

²⁹⁹ Po aty, f. 24.

³⁰⁰ Rexhep Qosja, Antologjia e lirikës shqipe (botimi II). Enti i Mjeteve dhe i Teksteve i Krahinës Socialiste Autonome, “Rilindja”, Prishtinë 1978.

poezi.

Kur flet për poezinë shqipe të viteve njëzet të shekullit XX, duke e krahasuar me Nolin e Ali Asllanin, profesor Rexhep Qosja thotë për Lasgushin: “Me ndryshim prej tyre, ai shkoqet, pothuaj plotësisht prej problematikës sociale dhe trajton një përmbajtje më të përshtatshme për planetarizëm idesh, ndjenjash, vizionesh”.³⁰¹ Sipas Qosjes poezia e Lasgushit përkon me poezinë e Asdrenit, po edhe ndryshon nga ajo. “Porsi poeti gjerman, Shtefan George, apo edhe poeti austriak Hugo de Hofmanstal, Lasgushi është ithtar i një simbolizmi estetik, i painteresuar për tematikën shoqërore, sociale dhe etiko-morale”.³⁰² Për dallim nga poezia e Asdrenit, në të cilën gjenden elemente të parnasizmit e të simbolizmit, sipas prof. Qosjes, këto elemente “në poezinë e Lasgushit marrin forma më të qarta dhe shpesh më të njëanshme” (XXVIII). Për Qosjen Lasgushi është nxënës shpirtëror i simbolistëve, në disa prej poezive të tij më të mira siç janë “Vdekja e Nositit”, “Lundra dhe Flamuri” dhe “Gjeniu i Anijes”, trajtohen edhe ide abstrakte, në të cilat realizon mesazhe universale.

Në pjesën për Lasgushin, Qosja veçon prirjen e Lasgushit për pastërtinë e gjuhës shqipe, për inovacionet gjuhësore, për zgjerimin e mundësive shprehëse të gjuhës shqipe, si dhe për kontributin e tij për “një aktivizim të ri, melodik, muzikor dhe kuptimor të interpunksionit” (XXVIII). Fjalën e tij profesor Rexhep Qosja e përmyll me krahasimin që i bën Lasgushit me poetin e madh francez dhe botëror, Bodlerin: ashtu si Bodleri që me “Lulet e së keqes” deshi të shkruajë një “Komedi Hyjnore” franceze, Lasgushi me vallet e tij donte të shkruante “Komedinë Hyjnore” shqiptare “duke bërë sintezën e tërësisë ekzistenciale, fizike dhe shpirtërore të shqiptarëve” (XXIX); dhe se me Lasgushin përfundon edhe tendenca e artizmit të lartë në poezinë shqipe, që, sipas Qosjes, një gjë e tillë ishte e domosdoshme.

Dhjetë vjet më vonë, më 1978, poezia e Lasgush Poradecit u botua nga Sabri Hamiti, në një kohë kur poezia shqipe e Kosovës kishte pësuar një ngritje si në sasi, ashtu edhe në cilësi. Vitet '70 ishin vitet e modernitetit të poezisë shqipe të Kosovës, në të cilat edhe poezia e

³⁰¹ Po aty, f. XXVII.

³⁰² Po aty, f. XXVII.

Lasgushit kishte dhënë kontributin e saj. Ky vëllim përfshin 3 poezi apo variante poezish, më shumë se vëllimi poetik i botuar më 1968: “Malli i vjershëtorit”, “Kur qajnë motrat vëllanë” (Vajë në kadencë popullore) dhe “Më zu një mall dhe sot”, variantin e dytë të kësaj poezie.

Botimin e këtij vëllimi Sabriu e shoqëroi me një shkrim eseistik 28 faqesh, dhe me 10 faqe shkrime të tjerëve për Lasgushin, ndërsa në fund, në “Shënime”, jep të dhëna për jetën e poetit dhe botimin e veprës që nga vitet ‘30, e deri te botimet pas lufte në Tiranë e Prishtinë, përmes të cilave lexuesit përpiqet t’ia prezantojë sa më të plotë Lasgushin jo vetëm me poezinë e tij, por edhe me ato që i kanë thënë të tjerët për të dhe me të dhëna për botimin e veprës së tij.

Në “Shënime”, ndër të tjera Sabri Hamiti informon lexuesin se: “Mbas vitit 1937 Lasgushi shkroi ndonjë vjershë në revistën ‘Përpyekja shqiptare’ dhe pas vitit 1941 botoi disa vjersha në gazeta e revista të asaj kohe.

Në këto vitet e fundit Lasgushi botoi disa vjersha të reja në gazetën ‘Drita’ dhe në revistën ‘Nëntori’ në Tiranë.

Me rastin e gjashtëdhjetëvëtorit të lindjes së poetit, më 1956 (?) u botua në Tiranë një vëllim me titull ‘*Lirika*’, që përmban vjersha të zgjedhura të Lasgushit. Vëllimin e ka përgatitur Muzafer Xhaxhiu.

Më 1967(?) Enti për Botimin e Teksteve në Prishtinë nxori vëllimin me titull “*Poezia*”, që përmban shumicën e vjershave të Lasgushit, të përgatitura për shtyp nga Murat Isaku.

Në vitin 1970, në serinë e veprave të zgjedhura *Poezia shqipe*, u botua në Tiranë një zgjedhje e vjershave të Lasgushit.

Pos botimeve të përmendura, edhe pse kurrë nuk ka pushuar interesimi i lexuesit shqiptar për fuqinë dhe bukurinë e poezisë së Lasgushit, vepra e tij nuk është botuar, (ri)botuar kurrë e plotë. Detyrën e rëndë të një botimi të tillë e merr mbi vete nxjerrja e këtij vëllimi”.³⁰³

Më poshtë thotë se pasi nuk kishte mundësi t’i kishte poezitë e Lasgushit të botuara gjatë Luftës dhe pas saj, ka vendosur të përmbledhë të gjitha poezitë e Lasgushit të botuara në dy vëllimet e botuara në vitet tridhjetë, “Vallja e yjve” dhe “Ylli i zemrës”. Libri është përgatitur

³⁰³ Lasgush Poradeci, Vdekja e Nositit. “Rilindja”, Prishtinë 1978, f. 222.

duke ruajtur titujt e cikleve e të vjershave dhe duke i shkrirë në një tërësi, me synimin që Lasgushi ta ndiejë veten sa më mirë në këtë mënyrë të komponimit të veprës së tij poetike”.³⁰⁴ Sa i përket këtij botimi, vlen të theksohet kompozimi që i bëri poezisë së Lasgushit Sabri Hamiti në vëllimin “Vdekja e Nositit”, në të cilin përfshiu lirikën e poetit të të dy vëllimeve, “Vallja e yjve” dhe “Ylli i zemrës”, duke e shkrirë në një vëllim poetik.

Por, sipas Mensur Raifit, i pari ishte Mitrush Kuteli që kishte propozuar që kur të botohet vepra e plotë e Lasgushit, në krye të saj, në vend të parathënies të vendosej poezia programatike e poetit “Zog i Qiejve”, ndërsa ciklet e tjera të librit të parë e të dytë të bashkohen e të formojnë tërësi më të mëdha, sipas logjikës së brendshme të tyre.³⁰⁵ Një botim të tillë të poezisë së Lasgushit e bëri Sabri Hamiti, por askund nuk e cek se mënyra e tillë e kompozimit të poezisë së Lasgushit ishte ide e Kutelit, e jo ide origjinale e tij!

Vëllimi poetik “Vdekja e Nositit”, pat edhe një ribotim, me 1986. Po në këtë vit, studiuesi dhe përkthyesi Mensur Raifi ka botuar një libër që kishte objekt studimi tre poetët modernë të letërsisë shqipe me titull “Lasgushi, Noli, Migjeni”, ku po ashtu, përveç një numri poezish të Lasgushit (11) kemi dhe disa të dhëna biobibliografike për të si dhe një vështrim kritik prej 18 faqesh.

I njëjti botim, një vit më vonë (1987), do të botohet në gjuhën serbe me titull “*Tri moderna albanska pesnika*”, ku numri i poezive të Lasgushit të përkthyer në gjuhën serbe, nga 11 që ishte në botimin shqip, arrin në 20 poezi.

Me 1990, Sh.B, *Rilindja* e Prishtinës ka (ri)botuar “Yllin e zemrës”. Në vitin 1979, me rastin e 80-vjetorit të lindjes së poetit, Lasgushit i është kushtuar një gjysmënumërsh tematik i revistës “Fjala” (XII/ 79, 15 dhjetor), në të cilin i kanë botuar shkrimet e veta Mensur Raifi, Ibrahim Rugova e Sabri Hamiti.

Po ashtu, në fund të vitit 1999, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Lasgush Poradecit, në Prishtinë është mbajtur një simpozium shkencor, por punimit e atij simpoziumi nuk janë botuar deri më tani.

³⁰⁴ Po aty, f. 223.

³⁰⁵ Mensur Raifi, Lasgushi, Noli, Migjeni. “Rilindja”, Prishtinë 1986, f. 14.

II-Studimi i poezisë së Lasgushit në Kosovë

Edhe kritika letrare që është shkruar në Kosovë, veprën e Lasgush Poradecit e ka pasur në fokus të interesimit të vet. Ndër kritikët e parë që e trajtojnë poezinë e Lasgushit, në Kosovë, është profesor Rexhep Qosja, në një studim të zgjeruar me titull: “Vallet poetike të Lasgush Poradecit”, të botuar në revistën letrare “Jeta e re”, në numrin dy dhe tre të vitit 1967, e të cilin një vit më pas, me titullin “Lasgush Poradeci”, e botoi në librin e tij të dytë: “Dialogje me shkrimtarët” (1968). Në këtë libër, që është edhe libri i parë serioz i tij, në të cilin Qosja shfaqet si kritik që e trajton letërsinë shqipe në mënyrë integrale, krahas krijuesve të tjerë, trajtohen shtatë poetë shqiptarë, nga Zef Serembe e deri tek Enver Gjerqeku, ndërsa poezia e Lasgush Poradecit trajtohet pas poezisë së Ndre Mjedës e para poezisë së Migjenit.

Studimi i Qosjes për poezinë e Lasgushit është i ndarë në tetë pjesë: “Poeti dhe letërsia shqipe”, “Trajta dhe koha”, “Poetika romantike e frymëzimit”, “Peisazhi dhe kuptimi i tij simbolik”, “Domethënia e mallit dhe e harmonisë kosmike”, “Mbi botën dhe njohjen e saj”, “Kreacioni dhe vdekja” dhe “Gjuha, simboli dhe kulti i muzikës”.

Ky është një studim në të cilin autori bën përpjekje të japë një gjykim në të cilin do të përfshihet në tërësi poezia e Lasgush Poradecit dhe do të përcaktojë vendin që zë ai në letërsinë shqipe.

Poezinë e Lasgushit, Qosja e trajton duke e përqasur me poezinë e paraardhësve të saj, me poezinë e Rilindjes, si fazë të fundit të saj dhe si paralajmërim të “mohimit” të saj që ndodh më pas me Migjenin. Po në të njëjtën kohë, e trajton edhe në raport me poezinë evropiane të kohës, përkimet dhe mospërkimet e poezisë së Lasgushit me të. Përveç që trajton ndërlidhjet e poezisë së Lasgushit me poezinë romantike shqiptare, si dhe me poezinë evropiane, Qosja vë në pah edhe individualitetin e papërsëritshëm të Lasgushit.

Në përgjithësi, kritika e Qosjes për poezinë e Lasgushit është në mes kritikës sociologjike dhe asaj psikologjike. Ikja nga shoqëria apo nga realiteti shoqëror, sipas Qosjes, e çon poetin në imagjinatë dhe për pasojë, e gjithë poezia e Lasgushit është rrjedhojë e ikjes së autorit të saj nga realiteti dhe strehimi në guaskën e tij, prej nga e sheh botën dhe jetën.

Koha kur krijon Lasgushi është “*nji kohë ku në botë ngjanë revolucione të vërteta të formës estetike – aty rreth Luftës së Parë Botërore, e sidomos mbas saj, kur poezia e proza janë fusha të vërteta eksperimentesh dhe provokimesh ma të mëdha të intuitës kreative*”.³⁰⁶ Por, Lasgushi, sipas Qosjes, kur të krahasohet me poezinë shqipe të kohës, është militant i invencioneve, por në krahasim me poezinë evropiane ai qëndron prapa.

Qosja konstaton se për poezinë e Lasgushit, për vendin që zë ai në “hierarkinë e shkrimtarëve shqiptarë”, janë dhënë mendime të ndryshme që ndonjëherë nuk përkojnë mes njëri-tjetrit, sepse kritikët janë nisur nga kriteret e ndryshme: nga forma apo nga tradita dhe thesari popullor. Sipas Qosjes, në kohën kur Mitrush Kuteli “me sensibilitetin e tij të shquem dhe kulturën mjaft të gjanë letrare, thonte se ai kap kulmin e literaturës shqipe e vargjet e tij hyjnë ndër poezitë ma të bukura botënore, ndonjë tjetër e kundronte me skepsë të madhe këtë krijimtari”.³⁰⁷ Paradoksaliteti në vlerësimin e Lasgushit është i kushtëzuar “nga vetë koha, nga ndërrimi i pikëpamjeve, i strukturave e superstrukturave, shijes e ndjeshmënisë së njerëzvet”.³⁰⁸ Një gjë të tillë Qosja e shpjegon me fatin tragjik të shqiptarit, të cilit, të gjendur “orë e çast në zgripin historik”, i duhet të ndërrojë edhe shijen letrare. Poezia e madhe i qëndron kohës dhe rënia e kureshtjes ndaj poezisë së Lasgushit e vë në dyshim vlerën e poezisë së tij, por, sipas Qosjes, poezia e Poradecit nuk ka ngelur jashtë antologjive dhe historisë letrare të popullit tonë.

Qosja përmend vërejtjet që i janë bërë Lasgushit, i cili në vend që të identifikohet me vuajtjet e popullit, është mbyllur në “kullën e fildishtë”! Pra, ia kanë parë për të madhe poetit se nuk është angazhuar si Migjeni, Mjeda apo Çajupi, “pse nuk ka marrë materie më konkrete, porse u asht kushtue temave të përgjithshme”.³⁰⁹ Lasgushi “Ndër njerëzit s’don vetë të jetë dhe ikën qëllimisht prej atmosferës së tyne skëterrike, kurse në botën metafizike ndien kotësinë e ekzistencës së

³⁰⁶ Rexhep Qosja, Dialogje me shkrimtarët (botim i dytë). “Rilindja”, Prishtinë 1979, f. 140.

³⁰⁷ Po aty, f. 135.

³⁰⁸ Po aty, f. 136.

³⁰⁹ Po aty, f. 136.

vet. Plevatjen e tij shpirtnore, atë absurdin emocional e ekzistencial që e ndien ai, e provojnë mirë edhe temat e tij”.³¹⁰

Në vazhdim, trajton tematikën e poezisë së Lasgushit: poezitë mbi procesin krijues, mbi gjenezën e frymëzimit, poezitë në të cilat evokon të kaluarën, këngën e popullit, këngën pleqërishte, historinë e kombit, besimin e tij, pastaj poezinë erotike, si dhe poezitë ku rikapitulon të menduarit filozofik, në të cilat nuk përjashtohen elemente të gnoseologjisë moderne, po as të asaj religjioze, lidhur me fazat e krijimit e të zhvillimit gradual, progresiv, të njeriut si në planin fizik, ashtu edhe në atë intelektual. “Në fund, trajton edhe problemin e vdekjes me ç’rast krijon një antitezë logjike ndaj përsiatjevet dhe metafizikës së botës shpirtërore dhe emocionale të njeriut”³¹¹, -thotë prof. Qosja.

Në gjykimin për poezinë e Lasgushit, Qosja shërbehet me ligjin e progresit të vazhdueshëm i cili, sipas tij, e qiti në hije famën e dikurshme të këtij poeti dhe tani vlera e poezisë së tij është më tepër historike, se aktuale.

Qosja në trajtimin kompleks që i bën poezisë së Lasgushit, përpiqet ta analizojë atë në mënyrë sa më objektive. Arsyen e mosafinitetit të lexuesit me poezinë e Lasgushit nuk e kërkon vetëm te kjo poezi, po edhe te lexuesi, njëri prej të cilëve është edhe vetë ai: “Prandaj edhe ne të gjithëvet që jemi mësu, për shkak të pozitës specifike historike, ta shikojmë edhe letërsinë në mvarësi nga mbrauajtja e saj nga fenomenet e jetës aktuale dhe aspiratat e njeriut, na duket disi e ftohtë dhe e pagjak kjo poezi”.³¹² Po sipas Qosjes, poezitë e Lasgushit “janë specifike edhe përkah materia që e trajtojnë, edhe përkah mënyra specifike e trajtimit të kësaj materie.”

Pra, nëse kjo poezi e kritikut dhe bashkëkohësve të tij u duket e pagjak, kjo nuk është për faj të saj, po të mosafinitetit që ka lexuesi ndaj kësaj poezie. Këtu, Qosja trajton lexuesin si pjesë të veprës: të njëjtën vepër, në kohë të ndryshme lexuesi e përjeton ndryshe. Në leximin dhe gjykimin e poezisë së Lasgushit ndikon konteksti i leximit: lexuesi që është

³¹⁰ Po aty, f. 137.

³¹¹ Po aty, f. 137.

³¹² Po aty, f. 137.

krijuar me një poezi tjetër, me poezi që e trajtojnë botën fizike, nuk është në gjendje ta ndiejë poezinë metafizike.

Përse u arratis poeti prej realitetit?

Sipas Qosjes, përgjigjia në këtë pyetje, shpjegon poezinë e Lasgushit.

Përse Lasgushi i bën ato reminishenca në lëmin e historisë dhe të të menduarit filozofik, përse i thur të gjitha ato variante motivit erotik dhe përse trajton temën e vdekjes?

Edhe poezia e Lasgushit është në dialog me kohën dhe realitetin e saj shoqëror, po Qosja ndalet më gjatë te çështja se përse Lasgushi trajton pikërisht këto motive universale dhe përse është aq indiferent ndaj realitetit dhe çfarë na del ajo indiferencë.

Për ta shtjelluar më tej këtë çështje, Qosja kalon nga kritika sociologjike në kritikën psikologjike, përmes së cilës përpiket të depërtojë në poetikën e Lasgushit. Largimi i Lasgushit nga realiteti është vetëm një pozitë prej së cilës ai e sheh këtë realitet. “Vjershat e tij janë krijue në një atmosferë specifike të historisë sonë moderne dhe janë të mbryjtuna prej karakteristikës së saj të tëhuajimit të njeriut mbas dëshprimit pse pamvarësia e fitueme me aq vuajtje nuk solli ate që pritte pjesa dërmuese e popullit”.³¹³ Po çdo largim sipas Qosjes është një kthim i tërthortë, është negacion i vetes, dhe edhe krijimet më fantastike kanë një lidhje me realitetin. “Tek Lasgush Poradeci kemi të bëjmë me mashtrime optike: realiteti asht vu në pasqyrë”.³¹⁴ Zbehtësinë e realitetit në poezinë e Lasgushit e gjen si pasojë të largimit të pasqyrës nga rrezet që lëshon jeta e rëndomtë. “Lasgush Poradeci kapet në vallet ritmike të yjvet për t’ia lehtësue peshën e randë kaosit të vet shpirtnor”.³¹⁵ Pra, e mohon këtë “botë”, që është e përkohshme, për ta afirmuar “tjetrën”, të gjithëkohshmen.

Qosja poezinë e Lasgushit e gjykon gjithnjë duke e përballur me realitetin dhe vlerat e saj apo jovlerat, sipas tij, shkojnë krahas përfilljes së realitetit ose ikjes prej tij dhe pothuajse në vazhdimësi e kritikon estetizmin që haset në poezinë e Lasgushit. “Njeriu realizohet në shoqëri, porse Lasgush Poradeci si poet orvatet të realizohet në vetminë e tij

³¹³ Po aty, f. 138.

³¹⁴ Po aty, f. 139.

³¹⁵ Po aty, f. 139.

artistike, meqë nuk mund të gjejë veten në jetë”.³¹⁶

Sa i përket qëndrimit ndaj gjuhës, Qosja e sheh Lasgushin si pasardhës të Naimit. Lasgushi, sipas Qosjes, ka dhënë një kontribut të madh për gjuhën shqipe, duke e pastruar nga fjalët e huaja, por edhe duke krijuar fjalë të reja dhe kompozita fjalësh.

Sipas Qosjes, poezia e Lasgushit e ka vendin në poezinë shqipe dhe mungesa e saj do të krijonte zbrazëti në kontinuitetin e saj. Edhe pse poetët dhe lexuesit e sotëm nuk e përjetojnë këtë poezi, “asht e pamundshme të mos pranohet domosdoja e fjalës së tij në zodiakun e literaturës shqipe”,³¹⁷ për të përfunduar se “Lasgushi në poezinë shqipe asht një hallkë e natyrshme, që ven spontanitetin, që lidh rrjedhën e krijimtarisë letrare tek ne gjatë kthesës që bahet prej një drejtimi e rryme të shfrytzueme, gati të shterur ma, nga fryma tjetër diç më e freskët. Poezia e tij mbetet si një vazhdë e kryem edhe e sjellun deri në pikën e fundit e tëhollimit formal e versifikacionit, prozodisë dhe figuravet të plejadës së romantikëve tanë”.³¹⁸

Me temat për vdekjen dhe idealin, për jetën dhe njohjen e saj, Lasgushi dyzohet në mes romantikut dhe klasicistit, por sipas Qosjes, në poezinë e Lasgushit mund të hasim edhe botëkuptime anakronike, që nuk përputhen me nivelin teorik-estetik të kohës dhe të letërsisë sonë. E quan të vonuar në raport me zhvillimin e ideve evropiane, po edhe bir të momentumit të vet, të atmosferës së përgjithshme shoqërore, të nivelit të kulturës shqiptare.

Lasgushi krijon në çerekun e parë të shekullit të njëzet, kur letërsia shqipe duhet të përjetojë diçka të re dhe Lasgushi ia dha këtë të re, por letërsia shqipe ishte shumë e njomë dhe e papërgatitur ta pranojë e ta përvetësojë trajtën e shqetësuar, simfonike dhe të hermetizuese të poezisë së dekadentëve francezë e të tjerë, apo epigoneve të tyre. “*Kështu edhe poezia e Lasgush Poradecit çfaqet si një hibrid i të resë dhe të vjetrës dhe ven në dukë dialektikën e zhvillimit spontan të literaturës sonë kombëtare*”.³¹⁹, konstaton Qosja.

³¹⁶ Po aty, f. 140.

³¹⁷ Po aty, f. 140.

³¹⁸ Po aty, f. 140-141.

³¹⁹ Po aty, f. 143.

Në poezinë e Lagushit Qosja has edhe elemente të filozofisë ekzistencialiste. Të tilla elemente i has në poezitë në të cilat poeti përsiat për njeriun, për jetën dhe vdekjen etj., ndërsa dallon prej romantikëve, sepse nuk është i angazhuar si ata, se nuk apostrofon motivin patriotik si ata, po edhe pse nuk është i dëshpëruar si ata dhe se derisa romantikët gjejnë prehje në vegimet e ardhmërisë, ky gjen prehje imagjinatave duke krijuar poezi.

Lasgushi krijon sipas filozofisë idealiste, sidomos sipas filozofisë platoniste, po është i ndikuar edhe nga filozofia mesjetare. Frymëzimi hyjnor i sjell idenë, ndërsa forma është produkt i punës së pareshtur. Ai ndërgjegjen e vet të rebeluar e hesht duke krijuar efekte muzikore, sepse ai e do formën: “Ai e don muzikën sikurse parnasistët dhe ndikesat që ia sjellin këtë dashuri shihen qartë në poezinë e tij”.³²⁰ Lasgushi nuk i zbulon format e raporteve të njeriut me realitetin shoqëror, por do të krijojë një realitet të ri imagjinativ dhe se “intuita tek Lasgushi asht e lidhun në radhë të parë për formën”.³²¹ Që nuk sheh kë të vuajë në tokë, arsyeja e Lasgushit është se atdheun e tij e sheh prej lartësisë, ndërsa zbehtësia e poezisë së Lasgushit është se ai i ka ndërprerë lidhjet me realitetin.

Sipas Qosjes, Lasgushi sheh në mjegull sepse izolimi në të cilin ndodhet, nuk e lë të shohë qartë; në këtë izolim bën përjashtim vetëm natyra, po edhe atë e jep përmes simbolesh. Për poezinë e peizazhit, Qosja thotë se Lasgushi ka afinitet naimjan ndaj panteizmit, nga vijnë edhe elemente të panteizmit artistik në botëkuptimin e tij. “Në natyrën e tij nuk gjindet kush të vujë. Por, mos të harroni, vuen ai vetë në atë guaskën e tij, ai asht pjestar i shoqënisë prej së cilës ikën”.³²² “Peizazhi i tij asht i leçitun elementesh sociale, ndonëse ai që e krijon i qaset pse e nxit vetëdija sociale”.³²³

Lasgushi në poezinë e tij pothuaj kudo bën periodizime; në jetë, në kohë, në natyrë, kudo sheh cikle dhe krijon cikle, ritëm e harmoni të paskajshme.

Edhe poezitë erotike të Lasgushit, sipas Qosjes, nuk janë të frymëzuara

³²⁰ Po aty, f. 144.

³²¹ Po aty, f. 167.

³²² Po aty, f. 151.

³²³ Po aty, f. 151.

nga dashuria, po nga ndjenja e kotësisë. “Fati i poezisë dhe artit përgjithësisht që nuk e mbështet frymëzimin mbi objektet e materjen konkrete asht i tillë: prej hijes nuk mund të reflektojë fuqia e fjalës”.³²⁴ Nga psikologjia, për shpjegimin e poezisë së Lasgush Poradecit, Qosja kërkon edhe ndihmën e psikanalizës. Lasgushi nuk është poet religjioz, po është poet abstrakt dhe shfrytëzon deri në maksimum teorinë e simbolistëve mbi sugjestionin poetik.

E meta e studimit të Qosjes qëndron në faktin se, pothuaj krejt poezinë e Lasgushit, e sheh të krijuar prej guaskës, pa shkuar përtej saj.

Në fakt, poezia e Lasgushit shkon përtej guaskës, përtej vetmisë, përtej kështjellës në të cilën thuhej se ishte mbyllur poeti; ajo shpërthen prej Uni poetik të Lasgushit i cili ishte jo vetëm i veçantë e i thellë, po edhe i papërsëritshëm.

Një studiues që është marrë gjatë me poezinë e Lasgush Poradecit, është Sabri Hamiti, i cili shkrimet e tij për Lasgushin i ka filluar në vitin 1971, tre vjet pas botimit të veprës së Lasgushit në Prishtinë, ndërsa i ka përmbledhur në librin me titull “Lasgushi qindvjeçar”,³²⁵ në vitin 1999, në të cilin e ka futur edhe studimin “Vdekja e Nositit”, të cilin ia kishte vënë si hyrje poezisë së Lasgushit në vitin 1978 (f. 26-71).

Në shkrimet e tij eseistike për Lasgushin, Hamiti trajton raportet e poezisë së Lasgushit me frymëzimin, me traditën, me kritikën letrare, me realitetin, me angazhimi, me gjuhën etj. Kritika e Sabri Hamitit për poezinë e Lasgushit më shumë është kritikë eseistike reaguese-apologjetike, që në momente të caktuara ka shenja të kritikës pozitiviste. Hamiti i kritikon mendimet e të tjerëve, duke i përballë ato me mendimin e vet, që është gjithnjë “në favor” të poetit. Kryesisht, kjo kritikë është reaguese ndaj kritikës së Rexhep Qosjes por, duke e ndjekur hap pas hapi rrjedhën e studimit të këtij të fundit, shkon përtej reagimit.

Ndërsa Qosja thotë se frymëzimi i Lasgushit është idealist, Hamiti kur shkruan për poezinë “Shpirti”, thotë se në të poeti tematizon frymëzimin poetik, i cili zbret nga lartësia dhe se gabojnë ata kritikë që thonë

³²⁴ Po aty, f. 153.

³²⁵ Sabri Hamiti, Lasgushi qindvjeçar. “Faik Konica”, Prishtinë 1999.

se Lasgush Poradeci “ka pikëpamje idealiste për frymëzimin poetik”.³²⁶ Ndërsa qenësia poetike e Lasgushit qëndron në frymëzimin e tij kryesisht metafizik, pothuaj gjithë përpjekjet e Sabri Hamitit shkojnë drejt asaj që poezinë e Lasgushit ta kthejë në frymëzim tokësor, edhe në rastin e çështjes së frymëzimit të këtij poeti! Hamiti e zbret poezinë e Lasgushit nga trajtimi i temave të larta, metafizike, në temat fizike, pra edhe në poezitë në të cilat shpreh mendimin e tij për frymëzimin, sipas Hamitit, Lasgushi trajton çështje konkrete, e jo abstrakte! Shkurt, e profanizon poezinë e Lasgushit, duke filluar që nga frymëzimi!

Kritika e Sabri Hamitit për Lasgushin është kthyer në kritikë apologjetike për këtë poet. “Ideologjia e censurës së poezisë është gjithnjë dinake: Lasgushi është kritikuar si poet i vetmisë personale, i përmbylljeve personale, i mendimeve ezoterikë, i spekulimeve filozofike; nga ana tjetër, Lasgushi *i rebeluar, i pezmatuar, ai që kacafytet me realitetin, është heshtur*” (kursivi është imi, S.B.).³²⁷

Sipas Hamitit, “krijimi në të vërtetë është histori shpirtërore e shkruar e krijuesit”³²⁸ ai është *i barazuar me jetën*, dhe se është udha e vetme kundër harrimit, për t’u arritur përjetësia. Për të, edhe rimat e poezisë së Lasgushit, si: 1. *unë/ furtunë/ dhunë/ punë*; 2. *shkruar/ përvëlur/ pasqyruar*, shprehin situata të jetës dhe sugjerojnë realitetin: “Herën e parë shprehin situatën e ngushtuar e të rëndë, herën e dytë një përpëlitse dhe ngulm në procesin krijues, dhe janë të krijuara me zanore të mbyllura. Do të thoshim, këto paraqesin apo sugjerojnë **realitetin**”.³²⁹

Lasgushi i Hamitit është revolucionar, sepse sipas këtij të fundit, ai në poezinë e vet mediton se mundja e vdekjes nuk bëhet duke ikur, po duke u ballafaquar me të dhe se nëpërmjet krijimit arrihet pavdekësia.

Në poezinë e Lasgushit vjersha “*nuk shkruhet për të ndodhurën, po e ndodhura është në vetë procesin e krijimit*”.³³⁰ Më tej, për fundin e poezisë “Gjeniu i anijes”, thotë se “Këtu mbaron ligjërimi për të ndodhurën dhe përkushtimin”.³³¹

³²⁶ Po aty, f. 10.

³²⁷ Po aty, f. 99.

³²⁸ Po aty, f. 75.

³²⁹ Po atY, f. 74.

³³⁰ Po aty, f. 128.

³³¹ Po aty, f. 129.

Po kështu vepron edhe kur trajton poezitë kozmogonike të Lasgushit: “Si përgjithësim i parë mund të thuhet se Poeti përmes valles së yllit në këtë poezi dhe funksionit të tij poetik don ta humanizojë kosmosin, hapësirën, njerëzimin”;³³² për të, ylli “është një figurë poetike e humanizuar që zë fill ‘me dashuri’”;³³³ në poezinë e Lasgushit “ngrihet hetueshëm një kërkesë poetike; të humanizohet hapësira e kosmosit, dhe mbi të gjitha të shenjohej një hapësirë njerëzore, ku afirmohet ndjenja më fisnike, *Dashuria e afëria*, që u kundërvihen *urrejtjes e vetmisë*”.³³⁴

Edhe kur trajton poezinë “Përjetësia” Sabri Hamiti vjen në përfundimin se “pikërisht krijimet më të suksesshme poetike janë ato që në vete mbajnë lidhjen e *fortë me jashtësinë dhe konkretësinë*”.³³⁵

Studimin eseistik “Vdekja e Nositit”,³³⁶ që ia vë si hyrje librit poetik të Lasgushit, Sabri Hamiti e ndan në dy pjesë: I. Shqiptimi i poezisë (1. Hyrje për interpretim, 2. Koha, Vendi, Gjuha, 3. Kënga e durimit, 4. Ligjërata mbi përjetësinë, 5. Vdekja e ëmbël, 6. Arti poetik); II. Fusnota (copëza nga gazeta e libra, nga pasthënie të veprës së Lasgushit, nga Buletini shkencor i Institutit Pedagogjik të Shkodrës, nga studimi i Qosjes për Lasgushin, nga pasthënia e Rexhep Ismajlit për vëllimin poetik të Mihai Eminescut). Në fund, vëllimin poetik të Lasgushit Poradecit e pajis me “Shënime”.

Interpretimin e poezisë së Lasgushit, Sabri Hamiti e nis me citimin e tri vargjeve të poezisë “Zog’ i qiejve”, e cila është vënë në ballë të veprës “Vdekja e Nositit”. Sipas Hamitit, këto tri vargje janë program orientues poetik i poetit. Në to theksohet individualiteti i poetit, kontinuiteti i shkrimit shqip, janë vargje çelës për të hyrë në temat, interesimet poetike dhe gjuhën e poezisë, ndërkaq thyerja që do ta bëjë Lasgushi në lirikën shqipe, nuk është shkëputje nga kontinuiteti i poezisë shqipe. Në vazhdim citon vargun e Lasgushit: “Asohere-e ndjej si foli: Të jam falë, -o Zoti im!”, të cilin e shpjegon kështu: “Në këtë fushë të

³³² Po aty, f. 15.

³³³ Po aty, f. 15.

³³⁴ Po aty, f. 18.

³³⁵ Po aty, f. 25.

³³⁶ Sabri Hamiti, Vdekja e Nositit (shih: Lasgush Poradeci, Vdekja e Nositit “Rilindja”, Prishtinë 1978. f. 7- 35).

shenjëzimit të poezisë Zoti nuk është *Zoti religjioz*, por një shkallë e lartë e përqëndrimit të qenies, është përqëndrim e jo frymëzim, temë e këndimit qenieplotë, të pacopëzuar. Ky përqëndrim e sjell krijuesin në rrugën e leximit të thellë të *realitetit*, që del si zbulim i rishëm shpirtëror, identifikim me kërkimin e parreshtur dhe nisje në rrugën ima-gjinatave poetike”.³³⁷

Sabri Hamiti, duke shkëputur vargje të veçanta nga poezia “Zog’ i qiejve”, përmes kritikës psikologjike, bën përpjekje të zbulojë burimin e poezisë së Lasgush Poradecit. Përmes fjalëve-figura të poezisë së Lasgushit, *bukuritë e dashuritë*, gjen ndërlidhjen e poezisë së tij me poezinë e Naimit.

Në pjesën e dytë të këtij shkrimi, interpretimin e poezisë së Lasgushit, Hamiti e nis me poezinë “Kënga pleqërishte”, që sipas tij, bashkimi me këngën e lashtë sjell identifikimin me vendin e lashtë, për të vazhduar: “Të kësaj fryme janë një cikël vjershash në të cilat Lasgushi këndon *jetën konkrete të shqiptarëve*. Në këto vjersha nuk ka abstragime të fuqishme poetike, po teksti del si poetizim i një jete, një idile të rrallë, të përmallshme dhe shpesh të prishur”.³³⁸ Këto poezi i krahason me poezitë e Naimit: “Vetëm se iluzionit (vizionit) të jetës së pastër e të qetë të Naimit (romantik), tashti i kundërvihet ndjenja e dhembjes dhe e pikëllimit të poetit, i cili edhe nëse nuk është i revoltuar ende sa duhet, ai është i përmalluar dhe i dëshpëruar”.³³⁹

Sipas kritikës së kohës, virtyt i poezisë ishte angazhimi në përgjithësi, sidomos ai social dhe, duke i dal në mbrojtje poetit prej atyre që ia “mohonin angazhimin social”, Sabri Hamiti insiston me çdo kusht për ta demantuar këtë “mohim” dhe konstaton se edhe poezia e Lasgushit është e angazhuar. Angazhimin social të poetit e gjen në strofën e dytë të poezisë “Poradeci”, të cilën e interpreton kështu: “Komenti i këtyre vargjeve na thotë shumë për angazhimin social të Lasgushit, të cilin ia kanë mohuar dhe ia mohojnë edhe tash së voni shkrimet kritike mbi veprën e tij”.³⁴⁰ Pastaj e elaboron “angazhimin social” të Lasgush Poradecit, që e gjen në poezinë e lartpërmendur, ku: “Frymimi i jetës, të

³³⁷ Po aty, f. 8.

³³⁸ Po aty, f. 11.

³³⁹ Po aty, f. 11.

³⁴⁰ Po aty, f. 12.

cilën e shenjëzon kjo vjershë është ngushtuar. Frika se do të prehet ky frymim është e madhe. Krahina nuk lëviz, është e përmbyllur në një amulli ku mungon dija e aksioni”.³⁴¹ Në vazhdim, një gjendje e tillë që mbyl lëvizjen dhe frymëmarrjen kushtëzon migrimin, migrimin fizik dhe shpirtëror, ikjen ose mbylljen e tmerrshme në zjarrin e vetvetes, ndërsa vargun “Tërë fisi, tërë jeta ra... u dergj... e zuri gjumi...”, e komenton “ku shënjohej apatia, sëmundja, përtacia shpirtërore, gjithnjë në një zotërim të errësirës”,³⁴² për të konkluduar “Do të thotë se kjo poezi e fuqishme kurrsesi nuk guxon të interpretohet si poezi përshkruese e liqenit e as e idilës, siç do të jetë bërë ndonjëherë”.³⁴³

Kështu, duke menduar se po ia ngre nivelin poetik, Sabri Hamiti e migjenizon Lasgushin! Sigurisht në këto përfundime Hamiti arrin për shkak se nuk ia di kuptimin fjalës “u dergj”. Sipas mendjes së tij, “u dergj” do të thotë “lëngon”, “u sëmur”, ndërsa te Lasgushi kjo fjalë do të thotë “fjeti”, “ra”, “e zuri gjumi”!

Sipas Sabriut, poezitë si “Poradeci”, janë poezi për vendin e shqiptarëve, ndërsa poezitë në të cilat përmendet Skënderbeu, Ismail Qemali, Naimi, Asdreni janë poezi për historinë e shqiptarëve, në të cilat “poeti do të bëjë një udhëtim imagjnativ nëpër të kaluarën e shqiptarëve duke u revoltuar në një faqe të kësaj historie”.³⁴⁴ Po cila është ajo faqe në të cilën revoltohet poeti, këtë askund nuk e thotë kritiku! “Këtë revolt e shpalon në një mënyrë të fuqishme dhe të çuditshme për mënyrën e shkrimit të tij në poezinë “Naim Frashërit”.³⁴⁵

Sa i përket gjuhës së Lasgushit, Sabri Hamiti gjen ngjashmëri të këtij të fundit me Naimin. “Kohës së shkuar i përgjigjet një shqipe pleqërisht e pasur dhe e pastër, ndërsa të tashmes një shqipe e mbushur me ‘fjalë barbare’”.³⁴⁶ Temat që shtrohen në poezinë e Naimit dhe të Lasgushti, si *Ligjëratë pleqërishte*, *Frymë e gojës shqipëtare*, *Këngë e orës shqiptare* etj., sipas Sabriut “po prisheshin” dhe prishja e tyre do të thotë edhe prishje e kombit!

³⁴¹ Po aty, f. 12.

³⁴² Po aty, f. 12.

³⁴³ Po aty, f. 13.

³⁴⁴ Po aty, f. 13.

³⁴⁵ Po aty, f. 13.

³⁴⁶ Po aty, f. 14.

Sabri Hamiti kundërshton ata që thonë se poezia e tij nuk karakterizohet me një shqipsi në motive, në tema, në ide.

Sipas S. Hamitit lidhja e Lasgushit me Naimin nuk ka të bëjë vetëm me rendin e dy përfaqësuesve të mëdhenj të dy periudhave letrare. Lindja e Lasgushit në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, sipas tij shënon një prerje të letërsisë shqipe: “në atë të Naimit, ose romantike, dhe në atë të Lasgushit ose pasromantike e moderne”.³⁴⁷

Jo një herë S. Hamiti bie në kundërshtim me veten, si p.sh.: “Është arti art, sepse nuk është natyrë, duke theksuar teoritë moderne për krijimin poetik individual”,³⁴⁸ në faqen tjetër: “I gjithë kërkimi poetik ka qëllim krijimin e bukur natyral, sepse natyra s’është as amorale, as morale, pra edhe poezia është e liruar nga ngarkesa ideologjike”.³⁴⁹ Tani, këtu shtrohen disa dilema pa përgjigje se arti a është natyrë apo nuk është natyrë, i natyrshëm apo i panatyrshëm, natyral apo artificial?!

Për poemën “Ekskursioni teologjik i Sokrati”, Hamiti thotë se “Sokrati me urtinë dhe me habinë e vet shtron pyetje e merr përgjigje rreth Utopisë nga Kryeshtetasi, Kryegjygtari e Kryeprifti. Secili ia pranon haptas në tempull se **nuk beson** në idhulltarinë e Zeusit, as në utopinë negative, po **besimi** i tyre është një lojë për të gëzuar jetën tokësore, duke maskuar sjelljen e vet përpara popullit e turmës. Më në fund Sokrati vërteton se vetëm turma beson në idenë utopike, **jo pse ka ndërgjegjen, por pse në të besojnë tri shkallët e para të pushtetit**”.³⁵⁰ Edhe këtu është e njëjta situatë: besojnë apo nuk besojnë tri shkallët e pushtetit?!

Në studimin e Hamitit hasen edhe mendime që së pari gjenden në studimin e Qosjes “Lasgush Poradeci”, të analizuar më lart: “Përderisa Bodëleri hyn në librin e vet ‘Lulet e ligësisë’ me një vjershë kushtuar *lexuesit*, Lasgushi hyn në vallet e veta poetike me një vjershë kushtuar *krijuesit*”.³⁵¹ Po ka edhe mendime me të cilat i kundërvihet mendimit të Qosjes, i cili, më parë, theksonte përpjekjet e pareshtura të Lasgushit

³⁴⁷ Sabri Hamiti, Lasgushi qindvjeçar. “Faik Konica”, Prishtinë 1999, f. 105.

³⁴⁸ Po aty, f. 115.

³⁴⁹ Po aty, f. 116.

³⁵⁰ Po aty, f. 100.

³⁵¹ Sabri Hamiti, Vdekja e Nositit (shih: Lasgush Poradeci, Vdekja e Nositit “Rilindja”, Prishtinë 1978, f. 9).

ndaj formës, të shprehura në variantet e poezive të tij, të cilat i ndërlihd me parnasizmin: “Lasgushi veneron që poezia nuk krijohet me ide, por me emocione. Në këtë mënyrë poeti përjashton mendimet, që në kultin e kërkimit të tij për formën e përsosur, *shohin një formalizëm të tipit parnasist*”.³⁵²

Si të metë të poezisë së Lasgushit Qosja e thekson tëhuajëzimin e tij, qëndrimin e tij në guaskë, i veçuar nga realiteti, nga hallet e njerëzve, nga problemet njerëzore të kohës së tij, ndërkaq, S. Hamiti, bën të kundërtën, kur e migjenizon Lasgushin,

Qosja te Lasgushi kërkon Migjenin, prandaj ia zë për të madhe atij që nuk është marrë me realitetin objektiv, duke harruar se Lasgushi është Lasgush, e nuk mund të jetë Migjen, Sabri Hamiti kalon në ekstremin tjetër, e kërkon dhe e gjen, te Lasgushi, Migjenin!

Kritika e Sabri Hamitit më shumë është një kritikë impulsive, në të cilën vargjet poetike të Lasgush Poradecit “përkthehen” në imazhe prej të cilave mendohet se e kanë burimin, si: “Në zemrën e vendit nis bubullima e të jetuarit intenziv, që mbledh më vete ngazëllimin e dëshirën e pasosur, edhe humbjen e pësimin, si dhe mashtrimet e ëmbla”,³⁵³ apo “Në shkallë të përpëlitiëve shpirtërore, në zgjatjen e një të jetuari intenziv nëpër gjakime-dëshirime-pësime lind kënga”.³⁵⁴

Vende-vende kjo kritikë merr trajta reaguese ndaj mendimit të kritikëve të mëparshëm të poezisë së Lasgushit, e në radhë të parë ndaj kritikës së Rexhep Qosjes.

Mensur Raifi, në monografinë e tij “Lasgushi, Noli, Migjeni”,³⁵⁵ trajton këta tre poetë, si tre përfaqësues të së njëjtës epokë letrare, siç e quan ai, pasromantike, moderne, të cilët, edhe pse nuk e kanë lexuar njëri-tjetrin në tërësi, “kanë synime dhe tipare të përbashkëta karakteriale”.³⁵⁶ Këta poet Raifi i trajton duke i përballur me njëri-tjetrin si tri faqe të një trekëndëshi apo si tri maja të letërsisë shqipe në mes dy luftërash botërore.

³⁵² Sabri Hamiti, Lasgushi qindvjeçar. “Faik Konica”, Prishtinë 1999, f. 116.

³⁵³ Sabri Hamiti, Vdekja e Nositit (shih: Lasgush Poradeci, Vdekja e Nositit “Rilindja”, Prishtinë 1978, f. 9.)

³⁵⁴ Po aty, f. 9.

³⁵⁵ Mensur Raifi, Lasgushi, Noli, Migjeni. “Rilindja”, Prishtinë 1986.

³⁵⁶ Po aty, f. 11.

Studimi i tij “Nositi i Lasgushit” vjen pas dy botimeve që i ishin bërë poezisë së Lasgushit në Kosovë, pas studimeve të Rexhep Qosjes, të Sabri Hamitit etj., pas botimit të poezisë së Lasgushit në antologji të ndryshme etj., prandaj është edhe më i sintetizuar, me tendencë për të gjetur rrugë të reja në studimin e kësaj poezie.

Letërsinë romantike, që ishte në shërbim të rilindjes kombëtare, Raifi e fut në modelin prometejan, ndërsa letërsinë pasromantike, në modelin orfik e, deri diku, edhe narcistik. Në këtë studim, Raifi Lasgushin e vendos në kohë: 1915-1937, thotë se ka shkruar diç më shumë se 100 poezi të cilat i ka botuar në dy vëllime poetike, se midis poezive të tij ka poezi me vlera antologjike, “me bukuri të paparë e të padëgjuar në gjuhën shqipe, me harmoni e melodi të vargut, me metaforikë të papërsëritshme”.³⁵⁷

Edhe Raifi e përsërit konstatimin e kritikëve të mëparshëm se Lasgushi vetërealizohet me ikjen nga realiteti, duke shtuar se ai kalon “në burrërinë e ëndërrimeve *bashlarjane*”.³⁵⁸

Flet për kontekstin kohor e hapësinor, shoqëror e psikologjik, të krijimtarisë së Lasgushit. Në Shqipërinë e cunguar të pas pavarësisë, shqiptarët fillojnë të përballen me krijimin e vetes së tyre dhe në këtë krijim e vetëkrijim të tyre “madhështia bëhet jo vetëm temë e preferuar oratorike për të arritur efekte dhe qëllime të caktuara, po ajo është edhe mënyrë e të menduarit e gjithëpranishme, mënyrë e të jetuarit dhe e vetëpranimit, ajo thithet tok me ajrin dhe natyrisht e gjen edhe shprehjen e vet letrare”.³⁵⁹ Duke konkluduar se ky mit “ka lindur dhe është zhvilluar si antitraumatuzëm kombëtar”.³⁶⁰

Me këtë, M. Raifi jep hapësirën në të cilën kanë krijuar poetë si Noli, Lasgushi e Migjeni. Në një hapësirë me trashëgimi lindore, këta poetë, sipas Raifit, pranojnë kryesisht ndikime të mendimit perëndimor, lexojnë Niçen, frymëzohen për mesianizëm etj. Pra, mendimi perëndimor shartohet në një mjedis lindor, në të cilin jetojnë dhe veprojnë këta poetë. Ideali për Lasgushin është të jetë “poet i pastër, “zog i pastër”,

³⁵⁷ Mensur Raifi, Lasgushi, Noli, Migjeni. “Rilindja”, Prishtinë 1986, f. 13.

³⁵⁸ Po aty, f. 7.

³⁵⁹ Po aty, f. 8.

³⁶⁰ Po aty, f. 9.

bilbil e pelikan...”,³⁶¹ “ai do ta jepte krejt të kaluarën dhe historinë për hir të një poezie të vërtetë të pastër”;³⁶² për të “madhështia është në të jetuarit e pastër si poet”;³⁶³ prej saj krijon entuziazmin e vet, jetesën estetike, mënyrën për të marrë frymë e për të ekzistuar. Ai, duke u identifikuar me poezinë, e mitizon atë. Krijimtarisë së këtyre poetëve, po edhe të gjendjes shpirtërore të shqiptarëve u jep shpjegim psikologjik: “Ribalancimi i forcave bëhej kësisoj në favor të çështjes së madhësisë, përkatësisht të qëndresës në vetëforcimin dhe vazhdimësisë ekzistenciale të përgjithshme, domethënë në favor të çështjes kombëtare të filluar me vrullin glorifikues të Rilindjes dhe të vazhduar me konsolidimin e forcave në kohën e pavarësisë”.³⁶⁴

Në fund, Raifi e trajton edhe lexuesin e poezisë së Lasgushit, për të cilin thotë se ka pasur qëndrim kontradiktor ndaj veprës poetike të Lasgushit. Sipas tij, Lasgushi “e ka përtërirë dhe e ka pasuruar ligjërimin poetik shqiptar duke kënduar të menduarit metafizik mbi dashurinë dhe vdekjen, mbi vetësakrificimin dhe vetëflijimin në krijimtarinë poetike”;³⁶⁵ *Lasgushi shkruan poezi të pastër, simboliste*.

E kundërshton mendimin e kritikës letrare shqiptare, e cila, duke mos e njohur veprën e Lasgushit, thotë se fjala dhe mendimi poetik te ky poet paraqiten si dekadente jo në kuptimin letraro-historik po si gjykim vlerësues, “kur ideologjizohen dhe etiketohen me manierizëm, formalizëm, idealizëm, misticizëm”.³⁶⁶ I ashpër është me kritikën sipas së cilës Lasgushi “shkruan ‘lehtë’, ‘shpejt’, se përsërit veten, se është frymëshkurtë, se tematika e tij është e ngushtë, e kufizuar, artificiale, e sëmurë, se kjo është shenjë e sterilitetit dhe artificialitetit krijues, pastaj se është ‘monovalent’, pa ‘kolorit kombëtar’, tip ‘femër’ i krijuesit, se i mungon vetëdija kombëtare, se nuk është poet social (siç), se vuan nga idetë misticiste dhe fataliste dhe inkonsekuenca të ngjashme”.³⁶⁷

Ndërsa për shkrimin e poezive në variante Raifi thotë se një gjë e tillë

Mensur Raifi, Lasgushi, Noli, Migjeni. “Rilindja”, Prishtinë 1986, f. 10.

³⁶² Po aty, f. 10.

³⁶³ Po aty, f. 10.

³⁶⁴ Po aty, f. 12.

³⁶⁵ Po aty, f. 13.

³⁶⁶ Po aty, f. 14.

³⁶⁷ Po aty, f. 15.

vërteton energjitë e pashtershme të poetit dhe se ajo që kritika e quan dobësi të tij, ajo është në të vërtetë virtyti i tij më i fortë. Sipas Raifit, zellin e Lasgushit për të krijuar variante të pafundme të poezisë, do ta nënshkruante edhe Pol Valeri, sepse bukuri poetike të përfunduar nuk ka. Për përtëritjen e përdorimit të fjalëve dhe të shprehjeve të vjetra në ligjërimin poetik shqiptar, sidomos të fjalëve të përngjitura dhe sintagmatike, Raifi thotë se “Lasgushi “në mënyrë të vet e përvetësoi mësimin e Malarmesë se ‘duhet dhënë domethënie më të pastër fjalëve të fisit’”³⁶⁸.

Ndërsa për kohën e formimit të Lasgushit, Raifi thotë se ai “u formua si poet në kohën kur në poezinë shqiptare ‘forma quhet formalitet, metrika prozodi e silabizëm, ndërsa retorika emfazë e gojëtarisë që s’kanë të përpjekur me esencën... të poezisë lirike të vërtetë’”³⁶⁹ (Shënim: Fjalët në thonjëza nuk tregojnë të kujt janë, ndoshta të Lasgushit, pasi më poshtë citon mendimin e Lasgushit për poezinë).

Në këtë studim Mensur Raifi trajton edhe dëmin që ia bën analiza poezisë. Sipas tij, “Analiza është metodë shkatërruese në qasjen dhe të kuptuarit e poezisë sepse ajo e zbërthen tërësinë në vend se ta rikonstrukttojë në plotësinë dhe bukurinë e saj; poezia e vërtetë nuk analizohet, por kuptohet e përjetohet” etj.³⁷⁰

Trajtimin më konkret për poezinë e Lasgushit e nis me analizimin e poezisë “Zog’ i Qiejeve”, në të cilën sipas Raifit, poeti shpreh një thyerje me traditën romantike të poezisë dhe paralajmëron burime dhe frymëzime të reja. Kjo poezi Raifit ia përkujton poezinë “Bekimi” të Boderit, e cila sipas tij flet për origjinën hyjnore të poetit, po me një dallim se te Lasgushi Zoti dhe Hyjnia janë simbole të bukurisë së përkryer poetike.

Preokupimet tematike të Lasgushit, sipas Raifit këndohen në frymën e disa elementeve teknike të simbolizmit. Junapi, shelg i butë, është simbol i urtisë, i paqes, i bollëkut dhe i famës në traditën antike: “Gjakimi për bukuri e mendim kombinohen me shprehje, ndijime, figura me shqisa të të pamit, të të dëgjuarit dhe të të nuhaturit, ndërsa të gjitha

³⁶⁸ Mensur Raifi, Lasgushi, Noli, Migjeni. “Rilindja”, Prishtinë 1986, f. 16.

³⁶⁹ Po aty, f. 16.

³⁷⁰ Po aty, f. 16.

këto bashkë derdhen në një përjetim ekstatik të krijimtarisë e cila është subtitulli i të përjetuarit të botës materiale”.³⁷¹

Shumë poezi të veta Lasgushi i këndoi në variante, në të cilat Raifi i gjen disa prej konstanteve të kësaj poezie, përmes të cilave përpiqet të depërtojë në motivin kryesor nxitës të këngëtimit të poetit. Këtu përmend disa poezi që i ka krijuar në variante si “Lamtumirë”, “Më zu një mall edhe sot”, “Ri me shëndet”, të cilat kanë frymëzim të njëjtë dhe në të cilat subjekti poetik këndon largimin, ndarjen nga Vasha, të braktisurit, vetminë, dhembjen e vjetër të fshehur etj. Në këto raste “është fjala për kompleksin e një ndjenje të këfillë në të cilën gjithnjë është i pranishëm *ankthi* se subjekti poetik do të jetë i braktisur nga objekti i dashurisë së madhe të pasionuar!”³⁷² Po kurrë dashuria nuk qortohet, nuk mallkohet. Ajo madhërohet si nxitëse e të shkruarit të poezisë dhe e të jetuarit si poet: “Ajo glorifikohet si parim i (vetë) realizimit, i përjetësisë”.³⁷³ Realizimi i dashurisë do të ishte mbarim i dashurisë dhe i vjershërimit, sepse vuajtja dhe durimi në vuajtje janë alibi për madhështinë. Këtu e gjen bipolaritetin bodlerian si tension poetik, si gurrë e pashtershme e poezisë së tij.

Dashuria te Lasgushi është vetëm ideja e caktuar e dashurisë: vasha e trimi janë një qëndrim mbi dashurinë, ata nuk vuajnë për njëri-tjetrin, po vuajnë për dashurinë. Edhe poezitë kozmogonike i konsideron si zgjatim të poezisë së dashurisë, sepse edhe gjithësia ka lindur nga dashuria. Ajo është e parealizueshme, nuk besohet në dashurinë si realizim, por në dashurinë si një pritje plot afsh, pasion, dashuri ekstatike, vetëprivim i llahtarshëm, mungesë e trishtueshme etj., për të arritur në konkluzionin se “Ky është kompleksi i të braktisurit”.³⁷⁴

Prej të gjitha realizimeve të mundshme të dashurisë, Raifi te Lasgushi dallon dy forma: në bukurinë e përkryer të vetëflijimit dhe në përjetimin ekstatik të botës materiale.

“Vdekja përjetohet në mënyrë ekstatike, si një çast i njëmendët jetësor dhe jetëdhënës, kjo është vetërealizim i plotë nëpërmes të vetëflijimit të

³⁷¹ Mensur Raifi, Lasgushi, Noli, Migjeni. “Rilindja”, Prishtinë 1986, f. 18.

³⁷² Po aty, f. 19.

³⁷³ Po aty, f. 19.

³⁷⁴ Po aty, f. 22.

tjetrit, për krijim-ta-ri, për krijimtari, për të vazhduar jetën”;³⁷⁵ “të jetuarit e momentit vetanak, është modeli i vërtetë i Ubermensch-it niçean, të arriturit e shkallës më të lartë të integritetit dhe superioritetit moral”³⁷⁶

Në poezinë e Lasgushit Raifi gjen korrespondime bodleriane “Korrespondimet dhe ngjashmëritë bodlerjane janë dhënë pothuajse me tinguj magjikë në një ritëm të papërsëritshëm të fjalëve dhe shprehjeve”.³⁷⁷

Ndërsa njohja është e paanshme dhe njohje përfundimtare nuk ka. “Mosnjohja e vetvetes nxit krijimtarinë në procesin e gjatë e të mundimshëm të të kërkuarit të vetvetes në nivelin e formacioneve reague, të substituteve, të racionalizimeve, ndërsa kur të arrihet qoftë edhe vetëm vetënjojha kalimtare, jetëshkurtër dhe e pjesërishme, pas së cilës sakaq e pavetëdijshmja përsëri dhe më gjerësisht e përfshin personalitetin, kjo është mbarimi. Dhe Lasgushi pushoi së shkruari”.³⁷⁸

Studimin për poezinë e Lasgushit, Raifi e përfundon me analizën që i bën poezisë “Kush ma njohu dhembshurinë”, për të cilën thotë se është e vetmja vjershë e Lasgushit me karakter autobiografik. Kuptimi i kësaj poezie, sipas Raifit, është se njerëzit nuk ndahen në të varfër e të pasur, në të dobët e të fortë, po nga dhënia dhe marrja e dashurisë. Kthimi i dobësisë personale në të kundërtën e saj, pra në heroizëm, madhështia e tillë nuk është larg prej pastërtisë dhe fuqisë shpirtërore të koncipuar në mënyrën niçeanë. Në fund thotë se nga vargjet e Lasgushit të lexuesi lindin asociacione që të kujtojnë domethënien bashlardjane të kompleksit të Empedoklit, i cili e bën festë fuqinë e tij dhe nuk e pranon dobësinë

Edhe Rexhep Ismajli është marrë me poezinë e Lasgushit. Në pjesën e tretë “Eminesku – Lasgushi”, të studimit “Poezia e Mihai Emineskut”,³⁷⁹ në të cilën trajton raportet në mes poezisë së Emineskut dhe Lasgushit, në hyrje thotë se poezia e Lasgushit zë një vend të veçantë në poezinë shqipe për vlerat artistike si dhe për metafizikën e saj. Edhe Ismajli përsërit se Lasgushi u formua në frymën e pasromantizmit, të

³⁷⁵ Mensur Raifi, Lasgushi, Noli, Migjeni. “Rilindja”, Prishtinë 1986, f. 23.

³⁷⁶ Po aty, f. 23.

³⁷⁷ Po aty, f. 27.

³⁷⁸ Po aty, f. 29.

³⁷⁹ Rexhep Ismajli, Shumësia e tekstit. “Rilindja”, Prishtinë 1980, f. 145.

simbolizmit e parnasizmit, po që kishte njohuri të përgjithshme për letërsinë e përbotshme të të gjitha kohëve. Po ashtu, Ismajli cek se burim i pashtershëm i poezisë së Lasgushit ishte poezia popullore, si dhe poezia e Naimit dhe ajo e Rilindjes.

Sa i përket Emineskut, Lasgushi poezinë e poetit rumun e ka njohur që në bankat e shkollës. Po ashtu cek se poezia e Lasgushit të kujton poetin frëng, ose siç e quan Ismajli, “mbasromantikun frëng”, Charles Baudelaire, sidomos në organizimin e përmbledhjes dhe të cikleve, po jo rrallë të kujton edhe Emineskun. Ndërsa Eminesku kishte shkruar vjersha pa ndonjë sistem të caktuar, Lasgushi kishte bërë të kundërtën, duke organizuar poezinë e vet në një sistem poetik e metafizik.

Pika e parë që e afron Lasgushin me Emineskun si tërësi është kozmogonia, që të dytë e huazuan edhe si tematikë, edhe si realizim nga vedat. Për Lasgushin thotë se i njihte më mirë vedat dhe se një kohë kishte studiuar sanskritishten, po frymën e vedave në letërsinë shqipe e kishte futur indirekt edhe Naimi përmes panteizmit. Edhe procedurën e mbështetjes së lirikës së vet në lirikën gojore Lasgushi nuk e kishte mësuar nga Eminescu, po nga rilindësit, si edhe nga romantizmi në përgjithësi.

Sipas Ismajlit, një afri fryme në mes këtyre dy poetëve Vehbi Bala e vëren në vjershat e natyrës dhe të liqenit, po këto vjersha nuk janë të afërta vetëm midis këtyre dy poetëve, po këto gjenden edhe te shumë poetë të tjerë evropianë, sidomos te romantikët dhe parnasistët, të cilët Lasgushi i njihte mirë. Sa i përket ndërtimit të brendshëm të vargut, Lasgushi ndiqte modelin e poezisë popullore, po edhe të Naimit, dy tipare prej të cilave janë përsëritja e fjalëve dhe e sintagmave brenda vargut “me qëllim që të krijojë ritëm dhe përgjigja sintagmatiko-kompozicionale e dy a më shumë termave për të krijuar dhe sugjeruar koncepte që nuk mund të jepen me një term”.³⁸⁰

Pika e dytë për të cilën Lasgushin e kanë quajtur huazues, pa e precizuar burimin, është ndërtimi i tipit sintagmakompozita, po sipas Ismajlit edhe këto e kanë burimin te poezia popullore shqiptare. Të ngjashme, po më të thjeshta, këto sintagmakompozita i gjejmë edhe te Naimi. Ismajli trajton fjalë e sintagma për të cilat thuhet se Lasgushi apo

³⁸⁰ Rexhep Ismajli, Shumësia e tekstit. “Rilindja”, Prishtinë 1980, f. 165.

Asdreni i kanë huazuar nga Eminesku, si fjalën “mall”, në rumanisht “dor” etj. Si përfundim, Ismajli thotë se si Asdreni, ashtu edhe Lasgushi e njihnin mirë poezinë e Eminescut, po nuk mbetën në raport me të vetëm në një shkallë ndikimi, sidomos kjo vlen për Lasgushin. “Sistemi poetik i Lasgushit për shumë gjëra është i afërt me atë të Emineskut, por ka edhe dallime shumë esenciale. Bie në sy gjithsesi epërsia e Lasgushit për sa i përket fortësisë së këtij sistemi. Përsa i përket metafizikës nuk përkojnë shumë, por nuk mund të thuhet se nuk kishin afinitet (afëri) shpirtëror”.³⁸¹ Përkimet në mes këtyre dy poetëve, Emineskut e Lasgushit, Ismajli i gjen me burim te romantizmi evropian në përgjithësi, te folklori i popujve përkatës dhe te vedat e filozofia budiste.

Shumë elemente që merren si të përbashkëta midis Lasgushit e Emineskut janë në radhë të parë kauzalisht të përbashkëta me Naimin dhe letërsinë e Rilindjes ose me romantizmin dhe pasromantizmin evropian, si dhe me folklorin, prandaj edhe përkojnë mes tyre. Ndërsa vedat dhe filozofia teozofike e afrojnë Lasgushin me Emineskun, po rezultatet janë të ndryshme se edhe shkalla e njohjes së tyre ishte e ndryshme. Te Eminesku kjo filozofi është përthyer përmes prizmit të romantikut, ndërsa te Lasgushi përmes prizmit të pasromantikut dhe simbolistit.

Në gjuhë Eminesku, Asdreni e Lasgushi u detyrohen burimeve pjesërisht të përbashkëta të formimit siç janë: situatës gjuhësore pak a shumë analogjike të të dyja gjuhët, afria mes dy gjuhëve etj.

Sipas Ismajlit është pikëshikim i njëanshëm ai i cili çdo gjë te poetë si Asdreni e Lasgushi e shpjegojnë përmes ndikimit rumun dhe sipas tij, kjo do të thotë se “komparativistët tanë ende nuk janë liruar nga konceptionet dhe psikologjia centriste që i vret vlerat”.³⁸²

Përveç këtyre studimeve, në Prishtinë, u mbrojtën edhe dy tema magjistrate për poezinë e Lasgush Poradecit, “Lasgush Poradeci”, e Emin Kabashit, dhe “Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane”, e Hysen Matoshit.

³⁸¹ Rexhep Ismajli, Shumësia e tekstit. “Rilindja”, Prishtinë 1980, f. 172.

³⁸² Po aty, f. 174.

Emin Kabashi, studimin monografik “Lasgush Poradeci”,³⁸³ e ka ndarë në tri pjesë: në të parën trajton jetën e Lasgushit, në të dytën shkrimet letrare, shkrimet për figurat të rëndësishme të Kolonisë shqiptare të Bukureshtit, po edhe për ditarët e Lasgushit, ndërsa në pjesën e tretë, që është edhe pjesa qendrore e kësaj monografie, trajton poetikën e poezisë së Lasgush Poradecit.

Studimi tjetër monografik, i mbrojtur si temë magjistrature në vitet ‘90, është ai i Hysen Matoshit, “Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane”.³⁸⁴ Autori studimin e ndan në gjashtë pjesë: “Studimet krahasimtare në letërsinë shqipe”, “Vendi i Lasgushit në letërsinë shqipe”, “Lasgushi dhe parnasistët”, “Lasgushi dhe simbolistët”, “Lasgushi dhe Eminescu” dhe “Lasgushi – përkthyes i letërsisë evropiane”. Edhe pse edhe para Matoshit kishte përpjekje krahasimtare në mes të poezisë së Lasgushit dhe poetëve të veçantë evropianë, ky studim krahasues i poezisë së Lasgushit me poezinë evropiane, është studimi më i gjerë dhe më gjithëpërfshirës, por edhe më i rëndësishëm sa i përket ndriçimit të raportit Lasgushi – letërsia evropiane.

Përfundim

Kritikat që i bëheshin Lasgushit, me theks të veçantë në ato që u botuan në Kosovë, konsistonin në qëndrimin se ai nuk u mishërua me gjendjen dhe vuajtjen e popullit siç kishin vepruar shumica e krijuesve të tjerë para tij dhe pas tij, por u mbyll në “kullën e fildishtë” etj. Edhe Qosja e kritikon poetin për këtë mbyllje, për mosndierjen me njerëzit, që nuk e prekin vuajtjet e tyre, të cilat do të duhej t’i kapte me intuitën e vet dhe t’i amshonte në poezi. Prerjen e raporteve me realitetin Qosja e gjykon si të metë të poezisë së Lasgush Poradecit.

Metoda sociologjike e pengon Qosjen të depërtojë në qenësinë e poezisë së Lasgushit, ndërkaq ndodh e kundërta kur e përdor metodën psikologjike, atëherë arrin të depërtojë më thellë në të fshehtat dhe bukuritë e artit lasgushian.

³⁸³ Dr. Emin Kabashi, Lasgush Poradeci. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1997.

³⁸⁴ Mr. Hysen Matoshi, Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2000.

Sabri Hamiti, në shkrimet e tij, e problematizon poezinë e Lasgushit jo duke depërtuar në thellësitë e saj, po më shumë duke e përfolur atë dhe, ndonëse ka shkruar në vazhdimësi për poezinë e Lasgushit, gjykimi i tij sikur është i dënuar të ngelet në sipërfaqe të kësaj poezie pa mundur kurrë të depërtojë në thellësinë e saj. Nga shkrimi në shkrim, përgjatë dekadave, Hamiti i rimerr të njëjtat të dhëna, i rithekson sikur t'i theksonte për të parën herë, i problematizon pa shtuar diçka të re.

Konkluzioni i Hamitit për poezinë e Lasgushit është se kjo poezi del nga konkretja/ nga konkretësia, nga e ndodhura, nga jeta, realiteti, jashtësia, e jo e kundërta: nga abstraktja, imagjinata, ëndrra. Në thelbin e saj qëndron fizikja e jo metafizikja. Edhe në poezinë kozmogonike, sipas Hamitit, qëllimi i Lasgushit është të humanizojë kozmosin, po edhe Zoti i Lasgushit nuk është Zot religjioz!

Koha kur shkruan kritikë për poezinë e Lasgush Poradecit Qosja dhe Hamiti ishte koha e Migjenit, kohë e cila të dy këta kritikë i rrëmben, prandaj edhe kritika e Kutelit për poezinë e Lasgushit ishte më e lartë se e këtyre të dyve, sepse Kuteli nuk shkruan për poezinë e Lasgushit në kohën e Migjenit, po shkruan për poezinë e Lasgushit në kohën e Lasgushit!

Ndërkaq, Mensur Raifi përmes metodës psikanalitike të analizës së poezisë së Lasgushit, hedh dritë të re në poezinë e tij. Koha kur shkruan poezi Lasgushi është koha e Frojdit, e Niçes etj., prandaj edhe ndikimi i tyre në Lasgushin, në një mënyrë apo në një tjetër, ka ndodhur. Po ashtu, nuk munguan edhe studimet komparativiste që i bëhen poezisë së Lasgushit, sepse në këtë poezi kryqëzohen filozofi e poetika të ndryshme letrare të kohës së tij, por edhe të para kohës së tij, të cilat e shenjojnë këtë poezi.

Literatura

- Hamiti, Sabri. -Lasgushi qindvjeçar. “Faik Konica”, Prishtinë 1999;
Ismajli, Rexhep. -Shumësia e tekstit. “Rilindja”, Prishtinë 1980;
Kabashi, Dr. Emin. - Lasgush Poradeci. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1997;
Matoshi, Hysen. -Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2000;

Poradeci, Lasgush. -Poezia. Enti i botimeve shkollore i Republikës së Serbisë, reparti – Prishtinë 1968;
Poradeci, Lasgush. -Vdekja e Nositit. “Rilindja”, Prishtinë 1978;
Raifi, Mensur. -Lasgushi, Noli, Migjeni. “Rilindja”, Prishtinë 1986;
Qosja, Rexhep. -Antologjia e lirikës shqipe (botimi i dytë). Enti i Mjeteve dhe i Teksteve i Krahinës Socialiste Autonome, “Rilindja”, Prishtinë 1978
Qosja, Rexhep. -Dialogje me shkrimtarët (botim i dytë). “Rilindja”, Prishtinë 1979;

BESIM MUHADRI
Universiteti i Gjakovës, “Fehmi Agani”
besim.muhadri@uni-gjk.org

STUDIMI I VEPRËS SË LASGUSH PORADecIT NË KOSOVË

Lasgush Poradeci është njëri ndër lirikët më të spikatur të letërsisë moderne shqipe. Ndonëse që në fillim pati vlerësime të ndryshme, madje kontraditore duke u kontestuar nëse ishte poet, megjithatë, Lasgush Poradeci, siç do të shprehej Eqrem Çabej, mbetet “poeti që hapi portën e një jete të re në poezinë shqiptare”.

Në kohën kur në Shqipërinë socialiste, poeti edhe mund të ishte harruar dhe kur vdiq më 1987 njerëzit jo pa arsye shprehnin habi, ngase kishin pandehur që moti të vdekur, poezia e tij në Kosovë vazhdonte të botohej dhe të studiohej në mënyrën me të thellë dhe të gjithanshme. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është jehona dhe studimi në Kosovë i veprimtarisë letrare të poetit tonë të mirënjohur.

Në këtë studim në shqyrtim do të kemi studimet dhe vlerësimet e studiuesve kosovarë në lidhje me veprën e Poradecit në kohë dhe periudha të ndryshme. Veçmas do të ndalemi te studimet dhe vlerësimet e akademik Rexhep Qosjes, të botuara në periodikun e kohës e më pas në librin “Dialogje me shkrimtarët”, të akademik Sabri Hamitit, qoftë te studimi i botuar në vëllimin “Vdekja e Nositit” e më pas edhe si libër më vete “Lasgushi qindvjeçar”, të Emin Kabashit te monografia “Poetika e Lasgush Poradecit), të Kujtim Shalës “Shekulli i letërsisë” dhe “Vepra e vetmisë”, si dhe të ndonjë studiuesi tjetër.

Studimi i veprës së Lasgush Poradecit në Kosovë

Lasgush Poradeci (1899-1987) është autor i vëllimeve poetike “Vallja e yjeve” (1933) dhe “Ylli i zemrës” (1937), të cilat vepra e bënë atë njërin ndër lirikët më të shquar të modernes shqipe. Poezia e tij u lexua më shumë ëndje dhe u vlerësua lart nga kritika letrare e kohës, ndonëse, autori i saj, herë-herë, edhe u kritikua, apo u kontestua nëse ishte poet

apo jo³⁸⁵, por kjo nuk u bë pengesë që poeti ynë të merrte edhe vlerësimet më të larta për artin e tij dhe talentin e tij prej poeti të lindur.

Një prezantim të dhe lexim të vrullshëm poezia e Lasgushit do të ketë edhe në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore, ku, përveç që u prezantua nëpër antologji dhe libra shkollorë, ajo u bë edhe objekt studimi dhe trajtimi i shumë krijuesve dhe studiuesve shqiptarë të Kosovës, ndërsa për të u mbrojtën edhe tema magjistrature e disertacione doktoratash. Për të shkruan akademik Rexhep Qosja dhe shkrimtari Murat Isaku³⁸⁶, në mes të viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar, por edhe Sabri Hamiti, Mensur Raifi³⁸⁷, Ibrahim Rugova³⁸⁸, Rexhep Ismajli³⁸⁹, Ali D. Jasiqi³⁹⁰, Emin Kabashi³⁹¹, më vonë edhe Hysen Matoshi³⁹², Kujtim Shala e të tjerë. Për poezinë dhe poetikë në përgjithësi të Lasgush Poradecit në Kosovë do të mbrohen tema të magjistraturave e të doktoraturave, të cilat më vonë u botuan si libra të veçantë. Kjo tregon për interesimin e madh të studimit të veprës së lirikut tonë të shquar.

Për leximin, studimin dhe vlerësimin e veprës poetike të Lasgush Poradecit në Kosovë, do të merremi në vijim të këtij teksti, duke veçuar mendimet e akademikëve Rexhep Qosja e Sabri Hamiti, si dhe të studiuesve Emin Kabashi e Kujtim Shala.

³⁸⁵ Maloki, Krist. Kritikë letrare: A asht poet Lasgush Poradeci?. Në librin: Rugova, Ibrahim; Hamiti, Sabri. Kritikë letrare (Pjesa e parë). Prishtinë, 1979, f. 228-262; 264-266.

³⁸⁶ Isaku, Murat. Lasgush Poradeci: Shënime. Në librin: Isaku Murat. Poezi. Enti i Botimeve Shkollore i RS të Serbisë. Repa, Prishtinë, 1968, f. 3-25

³⁸⁷ Raifi, Mensur. Konceptioni i poetit mbi poezinë. Nr. XII, Prishtinë, 15 dhjetor, 1979, f. 1, 3.

³⁸⁸ Rugova, Ibrahim. *Prekje lirike*. Prishtinë, 1971. f. 173-182.

³⁸⁹ Ismajli, Rexhep. *Simbol i njohur i poezisë së qëlluar*: Nositi i Alfred de Musset dhe Vdekja e Nositit e Lasgush Poradecit. *Fjala*. -Nr. 11, Prishtinë, nëntor, 1969 dhe 4. Eminesku – Asdreni – Lasgushi. 5. Eminesku dhe Lasgushi. Në librin: Ismajli Rexhep. Eminesku. Ylli i dritës. Prishtinë, 1976, f. 61-74.

³⁹⁰ Jasiqi, Ali D. *Baticat dhe zbaticat e një poeti*. Rilindja, 28 shtator, 1968, f. 12. 1969 dhe “Poezia popullore dhe lirike e Lasgush Poradecit”. *Pesha e fjalës*. Prishtinë, 1971, f. 225-242.

³⁹¹ Emin Kabashi, *Lasgush Poradeci. Jeta dhe vepra*, Instituti Albanologjik Prishtinë, Prishtinë, 1997.

³⁹² Matoshi, Hysen. *Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane*. Prishtinë, 2000.

Qasja e Rexhep Qosjes ndaj poezisë së Poradecit dhe qëndrimi i tij ndaj autorit

I pari në Kosovën e pasluftës së Dytë Botërore, i cili do të shkruajë për poezinë e Lasgush Poradecit, është Rexhep Qosja. Në shkrimin “Lasgush Poradeci”, të botuar në vitet gjashtëdhjetë në formë vështrimi dhe analize kritike letrare prej 42 faqesh, të botuar pastaj në librin e tij të njohur “Dialogje me shkrimtarët”³⁹³, do të merret në mënyrë të gjithanshme me veprën poetike të Lasgush Poradecit. Në shkrimin e tij, i cili më vonë zgjoi reagime të shumta, Qosja veprës së Lasgushit i qaset në aspektin diakronik dhe sinkronik, duke vënë poetin përballë letërsisë shqipe dhe herë-herë duke shfaqur edhe dilemat nëse Lasgushi ishte ai siç ishte cilësuar ose nënvlerësuar. Qosja e sheh poetin dhe poezinë e tij në kontekstin e letërsisë shqipe, duke spikatur trajtat e tij poetike dhe kohën kur u shkrua poezia, poetikën romantike lasgushiane dhe frymëzimin, peizazhin dhe kuptimin simbolik, domethënien e mallit dhe harmonisë simbolike, pikëpamjet e poetit mbi botën dhe njohjen e saj, kreativitetin lasgushian dhe mendësinë e tij për vdekjen si dhe aspekte gjuhësore e stilistike pa anashkaluar dot edhe muzikalitetin dhe karakteristika të tjera që përshkojnë poezinë e këtij poeti.

Që në fillim të analizës së tij, Qosja njofton lexuesin e asaj kohe mbi mendimet dhe vlerësimet e shumta që ishin dhënë mbi poezinë e Lasgush Poradecit dhe kualitetet e saj artistike, për vendin që duhet të zërë poeti në hierarkinë e shkrimtarëve shqiptarë, ku siç dihet, ai ka pikëpamje kontradiktore, të cilat ndoshta jo pa qëllim përkojnë me kritikën zyrtare të kohës në Shqipërinë e asaj periudhe. Qosja është i mendimit se poezia e Lasgush Poradecit ka diçka paradoksale edhe në zanafillën, edhe në fatin e vet të mëvonshëm, por ky paradoks sipas tij është i kushtëzuar nga vetë koha, nga ndërrimi i pikëpamjeve, i strukturave e superstrukturave, shijes e ndjeshmërisë së njerëzve etj. Kur e thotë këtë, Qosja e ndërlidh atë edhe me fatin tragjik të shqiptarëve, i cili duke qenë shpesh në zgripin e historisë, duke ndërruar edhe rrugën e fatit, jo rrallë, thotë ai “ka ndërruar edhe shijen, gjë që ndërlidhet edhe me fatin e poezisë së Lasgushit dhe të “shijeve” për të, pra të ndërrimit

³⁹³ Rexhep Qosja, *Dialogje me shkrimtarët*, “Rilindja”, Prishtinë, 1969 dhe më 1979 (botimi i plotësuar)

të konceptit për poezinë e tij, për vlerat e tij e madje dhe deri në akuza se përse poeti ishte mbyllur në “kullën e fildishtë” dhe nuk dëgjonte fare për vuajtjet dhe peripecitë e popullit të tij, sikurse që për shembull kishin “reflektuar” disa bashkëkohës të tij³⁹⁴.

Sipas Qosjes, vjershat e Lasgushit janë specifike edhe për nga materia dhe mënyra se si ato e trajtojnë atë materie. Studiuesi kërkon që ato të shikohen nga një kënd i posaçëm për t’u vërejtur se sa ato qëndrojnë në dialog me kohën dhe realitetin e saj shoqëror. Ndërkaq, në pyetjen se përse u arratis poeti nga realiteti, Qosja duke kërkuar çytjet psikologjike të hermetizmit shpirtëror të poetit, kërkon të shikohet mos vallë arratisja e tij është trajtë e tëhuajimit të tij ose një mohim i tërthortë i realitetit shoqëror dhe normave të tij të kohës, për të arritur te përfundimi se “largimi” i Lasgushit nga realiteti shoqëror është vetëm një pozitë e posaçme prej nga ai kundron shoqërinë dhe individin në mesin e saj dhe se “vjershat e Lasgushit janë krijuar në një atmosferë specifike të historisë sonë moderne dhe janë të mburjtura prej karakteristikës së saj të tëhuajimit të njeriut mbas dëshpërimit pse pavarësia e fituar me aq vuajtje nuk solli atë që priste pjesa dërrmuese e popullit”³⁹⁵.

Për vargun e mirënjohur të Lasgushit: *Bukuri! Tmerisht e dashur, llaftari! Tmerisht e bukur.*

Qosja nuk gjen tjetër shpjegim, përpos atij formal, duke kërkuar shkaqet psikologjike të ikjes nga jeta dhe mesi i njerëzve për të parë se përse poezia e tij është meditim ku shprehet Uni i krijuesit gjatë kërkimeve të tij abstrakte.

Pritja e frymëzimit hyjnor, e lë Lasgushin pa shkruar më tepër poezi

Lasgush Poradeci shkruan në një kohë kur në botë ngjajnë revolucione të vërteta të formës artistike, kur poezia dhe proza janë fusha të vërteta eksperimentimesh dhe provokimesh të mëdha të intuitës kreative. Sipas Qosjes, në përfaqje me trajtat dominuese të letërsisë shqipe, Lasgushi është militant i inovacioneve, por karshi atyre evropiane është shumë mbrapa. Megjithatë, Qosja është i mendimit se poezia e tij, mbetet një vazhdë e kryer dhe e sjell deri në pikën e fundit e tëhollimit formal e

³⁹⁴ *Vepra e cituar*, f. 136.

³⁹⁵ *Po aty*.

versifikacionit, prozodisë dhe figurave të plejadës së romantikëve tanë...”³⁹⁶

Ndërkaq, duke folur për aspektin ose filozofinë e frymëzimit poetik të Lasgushit, Qosja pohon se “Lasgush Poradeci pandeh së frymëzimi është i një origjine hyjnore, se vjen prej së larti në shpirtin e njeriut dhe se nuk ka të bëjë fare me jetën dhe raportet konkrete të njeriut me realitetin shoqëror. Prandaj, sipas Qosjes, pjesa dërrmuese e vjershave të tij janë disi të ftohta, dhe sot nuk mund të kenë efektin emocionues që mund të kishin dikur. Pritja e frymëzimit hyjnor, pohon studiuesi, e lë Lasgushin pa shkruar më tepër poezi, duke qëndruar pothuajse pranë varianteve të të njëjtit motiv”³⁹⁷.

Kur flet për peizazhin dhe simbolikën në poezinë e Lasgush Poradecit, Qosja bie në vlerësimet e atyre që Lasgushin e konsiderojnë një poet të mbyllur brenda mureve të Kullës së fildishtë ose të Kështjellës së tij misterioze. Megjithatë, *Qosja e pranon se Lasgushi është poeti i parë shqiptar që, përkrah Serembes dhe Faik Konicës, fut me sukses në poezi peizazhin e liqenit dhe të detit.*

Qosja në shumë raste na del kontradiktor me ato që thotë në lidhje me poezinë e Lasgushit. Përderisa njëherë thotë se ai shikonte nga perspektiva e mbylljes në kullën e fildishtë ose kështjellën misterioze dhe se kishte një shpërputhje me realitetin, herën tjetër konkludon se “Lasgushi shikonte me sytë e piktorit, por shkruan me shqisën auditive të kompozitorit. Ose se “ai zë momentet më të spikatura të *nënës natyrë*, qoftë kur ajo hesht e pushon, qoftë kur tërbohet e buçet dhe i fikson gjatë hijeshisë së tyre ma të madhe se sa kënaqen reciprokisht”.

Domethënia e mallit dhe e harmonisë kozmike

Tëhuajsimin lasgushian Qosja e gjen edhe te poezitë e dashurisë. Duke lexuar poezitë e Lasgushit me motiv dashurie, ai krijon përshtypjen se aty ato nuk janë të frymëzuara prej dashurie, por vetëm prej një ndjenje kotësie dhe se poezia e motivit erotik e Lasgushit nuk është poezi që i kushtohet imperativave fiziologjike të njeriut dhe se poeti aty ruan konvencat e një morali gati puritan. Malli i Lasgushit sipas kundrimit të Qosjes “nuk është mall i mërgimitarit, nuk është as mall i Serembes, as i

³⁹⁶ Vepra e cituar, f. 140-141

³⁹⁷ F. 145

Çajupit, ai i Filip Shirokës, por është mall i njeriut që nuk e ka realizuar esencën e vet, kuptimin e vet ontologjik”³⁹⁸.

Si mendimtar, Qosja Lasgushin e sheh si eklektik, në psikologjinë e të cilit pikasen ndikesa të pikëpamjeve heraklitiane mbi katër elementet, por edhe të botëkuptimeve religjioze mesjetare. Kur flet për botëkuptimet e Lasgushit për botën dhe njohjen e saj, Qosja arrin në përfundime se Lasgush Poradeci nuk zbulon format e marrëdhënieve të njeriut me realitetin shoqëror, por dëshiron të krijojë një realitet të vetin imagjnativ, prandaj poeti mendimtar ka pikëpamjet e veta ndaj botës, etikës, njeriut, jetës, shoqërisë, sistemeve shoqërore.

Poet i parë i simbolit

Dihet se Lasgush Poradeci është njëri ndër poetët, i cili i kushton një kujdes të veçantë gjuhës, duke nxjerrë nga harresa shumë fjalë të vjetra, por njëkohësisht duke krijuar edhe shumë kompozita fjalësh të cilat janë të stilit të tij poetik që e veçon nga të tjerët. Megjithatë, edhe në këtë kontekst, Qosja, krahas anëve pozitive, gjen edhe anët negative, sepse poeti pogradecar sipas tij “nuk qe në gjendje të gjente sensin e masës”³⁹⁹. Këtë fenomen ose orvatje lasgushiane, Qosja e konsideron si një e metë e madhe që e shpuri atë drejt esteticizmit.

Mirëpo, megjithatë, Qosja e pranon se Lasgush Poradeci është poet që tregon ndjenjë jashtëzakonisht të rafinuar për nuancat gjuhësore, si poet i parë i simbolit, të gjetur me mjeshtëri në gjuhën tonë. Sipas Qosjes “Vargu poetik i Lasgushit është një *varg i përkujdesur deri në maksimum* dhe, sikur njeriu të gjykonte vetëm sipas mjeshtërisë së shfaqur në këtë pikëpamje, atëbotë atij do të duhej dhënë një prej vendeve më të larta të letërsisë shqipe

Duhet thënë se, Qosja, edhe pse i mohonte shumë aspekte të poezisë së Lasgushit, ai pranon se Lasgushi është një poet pa të cilin letërsia shqipe do të ishte e varfër dhe se janë pikërisht vlerat antologjike të poezisë së tij që e bëjnë atë të zërë vend të merituar në hierarkinë e shkrimtarëve shqiptarë”

Poeti i parë modern shqiptar dhe liriku më i madh i shekullit XX

Në vitin 1979 ishte 80-vjetori i lindjes së Lasgush Poradecit. Në këtë

³⁹⁸ R. Qosja, *vepra e cituar*, f. 154.

³⁹⁹ F. 172.

vit në Prishtinë, redaksia e botimeve të “Rilindjes” i boton përmbledhjen “Vdekja e Nositit”⁴⁰⁰, në të cilën ishin përfshirë të dy vëllimet poetike të Lasgushit, të botuara në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar. Botimi shumë i bukur edhe në aspektin teknik, ishte redaktuar dhe përgatitur nga Sabri Hamiti, i cili edhe kishte bërë një parathënie të thuktë, për poezinë e Lasgushit, ku shpërfaq konsideratat dhe mendimet e tij më brilante për poezinë lasgushiane. Këto mendime për poezinë e poetit pogradecar, të cilat i kishte filluar shumë më herët, Sabri Hamiti do t’i zgjerojë dhe thellojë edhe në vitet në vazhdim.

Më 1999 Hamiti boton librin me titull “Lasgushi qindvjeçar”⁴⁰¹, libër që vjen me rastin e 100-vjetorit të lindjes së poetit. Është një libër i sajuar nga shkrime të shkruara ndër vite, ndërkaq aty përfshihet edhe parathënia brilante e botuar tridhjetë vite më parë. Sabriu për Lasgushin do të shkruajë edhe te libri shkollor “Letërsia moderne shqiptare”⁴⁰², ku, në 18 faqe tekst, do të elaborojë tërë krijimtarinë poetike të Lasgush Poradecit, ndërkaq poetin do ta cilësojë si *poetin e parë modern dhe lirikun më të madh shqiptar të shekullit XX*.⁴⁰³

Librin e tij “Lasgushi qindvjeçar” Hamiti e hap me shkrimin “Bukuri tmerisht e dashur”, i marrë nga vargu i famshëm i Lasgushit të shkëputur nga poezia e tij e njohur “Dritë fshehtësije”, në të cilin, siç thotë Hamiti “shprehet relacioni i krijuesit me veprën e vet”. Duke u marrë me këtë varg të njohur të poetit, Hamiti si duket më tepër është marrë me të për të kundërshtuar pikëpamjet e Qosjes, i cili në vitet gjashtëdhjetë e cilësonte si një varg formal..... Sipas Hamitit, Qosja “duke mos arritur të marrë as kuptimin e parë të vargut, është kënaqur të thotë se këtij vargu nuk mund t’i gjenden shpjegime të tjera, pos shpjegimeve formale”⁴⁰⁴. Hamiti pohon se në këtë linjë gjenden edhe të tjerë, e me këtë rast ai përmend Alfred Uçin, i cili në librin e tij “Estetika, Jeta, Arti” pikërisht te ky varg i Lasgushit do t’i gjente elemente dekadentizmi” dhe më të cilin konstatim ai nuk pajtohet, sepse te vargu i

⁴⁰⁰ Lasgush Poradeci, “Vdekja e Nositit”, “Rilindja”, Prishtinë, 1979 (Ribotim në vitin 1986).

⁴⁰¹ Sabri Hamiti, “Lasgushi qindvjeçar”, “Faik Konica”, Prishtinë, 1999.

⁴⁰² Sabri Hamiti, “Letërsia moderne shqiptare”, “Alb-ass”, Tiranë 2000.

⁴⁰³ Po aty, f. 79.

⁴⁰⁴ Sabri Hamiti, “Lasgushi qindvjeçar”, “Faik Konica”, Prishtinë, 1999, f. 8.

famshëm i Lasgushit ai sheh të ndeshen dy kuptime: e bukura dhe nocioni i saj lasgushian llaftaria. Sipas Hamitit, kuptimi i parë i këtij vargu është ajo që poetët kërkojnë në krijim, kurse kuptimi i dytë shpreh mundin për ta krijuar të parën”.⁴⁰⁵

Në studimet e tij për veprën e Lasgushit, Hamiti i qaset veprës së këtij poeti, si në aspektin analitik, ashtu edhe në atë vlerësues, për të arritur në konkluzione tepër të sakta dhe vlerësuese për poezinë e këtij poeti të shquar të letërsisë sonë. Sipas Hamitit, poezia e Lasgushit solli një ndjeshmëri të re në letërsinë shqipe, një kërkim të thellë gjuhësor e formal dhe një figurë të paparë. Prandaj, ajo pati një komunikim jo të zakonshëm me lexuesin e kritikun e kohës, herë-herë duke marrë epitetin e princit të poezisë shqipe e herë-herë duke u vënë në pikëpyetje të të qenit poet. Hamiti mendon se mohuesit e veprës së Lasgushit u shtuan në kohën e pasluftës së Dytë Botërore, pra në kohën kur kritika e socialrealizmit e anashkaloi dhe madje e qiti në harresë të dhunshme poezinë e tij bashkë me poetin, i cili u mënjanua duke jetuar dhunshëm vetminë e tij, por gjithmonë duke menduar për letërsinë dhe duke shkruar edhe poezi. Këtë e dëshmojnë edhe tri poemat e tij *Mbi ta, Kamandeva* dhe *Ekskursionin teologjik i Sokratit*, kur poeti i moshuar dhe i heshtur për sa decenie kishte krijuar këto tri vepra të mëdha poetike që ishin të ndërlidhura me poezinë e tij të rinisë, por tash me një trajtë formale më të zgjeruar.

Duke përmbyllur mendimin e tij për poezinë e Lasgushit, gjithnjë duke pasur parasysh edhe padrejtësitë që iu kishin bërë poetit, Hamiti, pohon se “Gjenialiteti i tij poetik e njohu frymëzimin poetik si përqendrim, e njohu gjuhën poetike si gjuhë të zjarrtë e gjuhë të zemrës, e njohu bukurinë e krijuar si bukuri llaftare, e njohu formën poetike si gjetje nëpërmjet punës titanike”. Sipas këtij njohësi të thellë të veprës së Lasgush Poradecit, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë, “gjeniu shqiptar njohu vetveten në botën shqiptare kulturore dhe u bë një protagonist i saj, me rikrijimin e kësaj bote në veprën e vet, duke krijuar nga lirika e vet bashkëkohësinë që komunikon me të gjitha kohët. Dhe meqenëse gjeniu shqiptar, nëpër variante të shumta arrin të zbulojë formën origjinale poetike, sistemin e vet poetik, ai arriti që të bëhej

⁴⁰⁵ At, f. 9.

“poeti i parë modern shqiptar dhe liriku më i madh i shekullit”⁴⁰⁶.

Në Kosovë për veprën e Lasgush Poradecit kanë shkruar edhe studiues e kritikë të tjerë të njohur. Libri “Lasgush Poradeci”⁴⁰⁷, i Emin Kabashit, i botuar vite më herët, përkatësisht në vitin 1997, por i mbrojtur si temë magjistrature në vitin 1979, ndonëse i një rëndësie të veçantë për jetën dhe veprën e poetit tonë të shquar, për shkak të rrethanave të kohore dhe situatës së atëhershme në Kosovë, edhe mund të mos jetë vërejtur. Kur lexon këtë libër, lexuesi merr informacione të mjaftueshme, mjaft interesante dhe shumë të rëndësishme si për jetën, ashtu edhe për veprën e Lasgush Poradecit. Studiuesi Kabashi, kur flet për fëmijërinë dhe rininë e hershme, për shkollimin fillor, atë të mesëm por edhe të lartë të Lasgushit e madje edhe për familjen e poetit, ai në këtë kontekst sheh formimin arsimor, kulturor dhe njerëzor të poetit (*Poetika e jetës*).

Sipas Kabashit, me monografinë për Nikoll Naço-Korçën që Kabashi e klasifikon si *poetikë e stilit romantik*, Lasgushi, bashkë me krijimin e portretit të Nikoll Naço-Korçës, kishte krijuar në të njëjtën kohë, edhe testamentin e lëvizjes së studentëve që kishin themeluar Pelerinatën e Gjakut. Emin Kabashi i konsideron si shkrime të një niveli mahnitës njohuritë e Lasgushit për tekstin e veprës së Naimit,⁴⁰⁸ shkrimin për Fishtën si “poetikë e shkrimit romantik për poezinë”, ndërsa çështjet që trajton ose shtron Lasgushi aty, i cilëson si shkrime të cilat nuk janë kapërcyer as sot.⁴⁰⁹

Në kapitullin e fundit të monografisë së tij, të cilin e ka titulluar *Poetika e poezisë*, Emin Kabashi në mënyrë shumë serioze dhe të gjithanshme i qaset krijimtarisë poetike të Lasgushit, për të ardhur në konkludime tepër interesante dhe të sakta se: “Kënga e Lasgushit, në radhë të parë, është traditë me përmasë historike dhe jetësore ose edhe një përtëritje e vazhdueshme dhe këmbëngulëse që flet edhe nëpërmjet

⁴⁰⁶ Sabri Hamiti, “*Letërsia moderne shqiptare*”, Alb-ass, Tiranë 2000, f. 95. I njëjti shkrim gjendet edhe te libri “Lasgushi qindvjeçar”, por një pjesë e tij dhe te parathënia e librit “Vdekja e Nositit”, botim i dytë i plotësuar, “Rilindja”, Prishtinë, 1986.

⁴⁰⁷ Emin Kabashi, “Lasgush Poradeci”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997.

⁴⁰⁸ E. Kabashi, vepra e cituar, f. 77.

⁴⁰⁹ Aty, f. 79.

shpërnderimeve të vargut. Sipas tij, poezia e Lasgushit, më tepër është një vizion, sesa realitet, që kthehet përherë si krijim artistik, për ta prekur terrenin burimor të frymëzimit... Apo se “poezia e Lasgushit është një shtjellë e përkryer dhe një bashkëjetesë e mirëfilltë e realitetit si përmasë kohore e historike dhe si përmasë krijuese në poezinë tonë...”⁴¹⁰

Lasgushi -Sokrat i vjershës së vet

Kujtim M. Shala, në librin e tij “Vepra e vetmisë”, i cili është një libër me lexime dhe interpretime letrare, krahas leximit të “shenjave letrare Fishtës, Hamitit, Buxatit etj., ai merret edhe me “leximin e shenjave letrare të Lasgushit”. Me këtë rast në laboratorin e analizës së studiuesit është teksti poetik i Lasgush Poradecit “Ekskursion teologjik i Sokratit”, i shkruar në vitin 1978 ose në “epokën e tij të heshtjes”. Sipas Shalës, “*Ekskursionin...* është vepra që prish me gjëmim heshtjen e Lasgushit.”⁴¹¹

Sipas Shalës, stilistikisht dhe kompozicionalisht, *Ekskursionin...* ka formën e anketës, për nga modusi/ statusi - vjershë alegorike, ndërkaq skema e ndërtimit formal/ teknik e poezisë është artikuluesi. Sipas shtresimit alegorik Shala është i mendimit se teksti i Lasgushit shtrihet në një alegori totale dhe si i tillë hyn në lidhje të drejtpërdrejtë me kohën kur u shkrua. Ndërkaq, kur flet për vetminë lasgushiane ose mbylljen dhe heshtjen e tij, ai është i mendimit se, vetmia e Lasgushit ka qenë jo vetëm metafizike, por edhe konkrete, sociale. Sipas Shalës Lasgushi është ose ishte poet i mbyllur, i cili nga vetmia “ka lexuar” ambientin e kohën kur jetoi, duke shkruar *Ekskursionin teologjik* të Sokratit, i cili lidhet pikërisht me njerëzit e asaj kohe dhe me rendin në të cilin jetonin. Duke e identifikuar Lasgushin me Sokratin ose me figurën themelore të vjershës, Shala Lasgushin e cilëson si Sokrat të vjershës së vet ose si një Sokrat shqiptar të shekullit XX”⁴¹².

Përfundime

Siç shihet, në Kosovë poezia e Lasgushit është lexuar dhe studiuar pareshtur në kohë dhe periudha të ndryshme. Është lexuar dhe është

⁴¹⁰ Kabashi, *vepra e cituar*, f. 106.

⁴¹¹ Kujtim M. Shala, *Libri i vetmisë*, “Buzuku”, Prishtinë, 2005, f. 45.

⁴¹² Kujtim Shala, “Libri vetmisë”, f. 99-100

botuar, por edhe është studiuar edhe në ato momente kur poeti në Shqipëri ishte mbuluar me heshtje që ishte më tepër se vrasje, sesa një mohim. E pamë se leximi i veprës së tij ishte lexim i gjithanshëm dhe me një analizë të gjithanshme. Edhe në ato raste kur ajo u kritikua, nuk u mohua, por u thanë variante të cilat në pjesët e tyre përmbyllëse e lartësonin dhe e vlerësonin poezinë dhe poetin në versione zyrtare dhe jozyrtare që përkonin edhe me brendinë e veprës.

U kritikua heshtja e tij dhe mospërputhja me realitetin konkret të shoqërisë shqiptare në kohën kur u shkrua poezia e tij, por në asnjë mënyrë nuk u kritikuan dhe mohuan veçantitë dhe veçoritë e poezisë së tij, ndërsa poeti, pa asnjë ngurrim, u quajt si poeti modern dhe liriku më i madh shqiptar i shekullit XX.

Pa dyshim, poezia e tij dhe vetë autori u adhuruan nga të gjithë ata që në Kosovë kishin pasur mundësinë ta lexonin. Vepra e tij ishte futur në radhën e literaturës së domosdoshme në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës, kurse në Universitet, në degët e Gjuhës dhe të Letërsisë shqipe, ai do të ketë vendin e vet të merituar të shkrimtarëve të letërsisë moderne shqipe.

BIBLIOGRAFI

Rexhep Qosja, “Dialogje me shkrimtarët”, “Rilindja”, Prishtinë, 1979 (botim i dytë)

Sabri Hamiti: “Lasgushi qindvjeçar”, “Konica”, 1990

Kujtim Shala: “Shekulli iu letërsisë”, “Buzuku”, 2006

Emin Kabashi, “Lasgush Poradeci- monografi”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1997

Kujtim Shala, “Vepra e Vetmisë”, “Buzuku”, 2005

Lasgush Poradeci Vdekja e Nositit” botim i dytë i plotësuar), “Rilindja”, Prishtinë, 1986

ERMELINDA KASHAH
Universiteti “Eqrem Çabej”
Gjirokastrë, Albania
ekashahu@gmail.com

E VEÇANTA E POEZISË SË LASGUSHIT

Vështirësia më e madhe në studimin e një poezie qëndron në vetë specifikën e saj, e cila si gjini letare ka një sovranitet të padepërtueshëm vetë. Kjo poezi është krijimtari që shijohet, interpretohet dhe krijohet si një shpirt i shenjtëruar. Lasgushi është konsideruar nga kritika letrare si poeti i parë modern shqiptar. Poradeci shfaqet i formuar e me aftësi të larta impresionuese. Ky objektivitete dhe mprehtësia shkencore shfaq një varg përcaktimesh me vlerë, sepse vështirësia më e madhe në studimin e një poezie qëndron në vetë specifikën e saj dhe drejtohet si princip i lashtë sa vetë mosha e njerëzimit. Poezia e tij jetohet në një kohë ku jo rrallë demonstron fuqia. Poeti kish besim në besimin dhe triumfin e së vërtetës njerëzore. Dehumanizmi i njeriut të caktuar, pendesa, dhembja për endjen, përgjegjësia intelektuale, janë disa nga refrenet e këtij tipi poezie.

Të dashur kolegë, profesorë të nderuar!

Së pari, ju përshëndes të gjithëve që na dhatë mundësinë të shkëmbejmë çdo mendim tonin në këtë podium serioz me bashkëpunëtorë të suksesshëm, ideatorë dhe studiues të kësaj fushe.

Së dyti, kjo konferencë shënon ngjarje kulmore të botës shkencore që meriton vëmendje, ndijim intelektual dhe nderim, kur dihet fare mirë se me gjuhën është e lidhur pasuria e patjetërsueshme e këtij dheu. Por ne sot, ulim perden dhe kuptojmë se sa më shumë ikin vitet, aq më shumë spikasim dritë mbi thelbin e kësaj çështjeje, mbi poezinë e poetit të madh, Lasgushit. Dua të theksoj se poezia e Lasgushit është në thelb të hapësirës universale-letrare dhe kulturore. Lasgushi foli pak ose aspak në poezinë e tij në shtypin e kohës dhe dukej se nuk u përgjigjej kritikave apo zhurmës që bëhej rreth emrit të tij, duke menduar që poezia e vërtetë nuk shpjegohet. Sipas tij, ajo ose është poezi, ose jo.

Në letërkëmbimet e tij, sidomos me Kutelin, gjejmë shumë material për të kuptuar se si e shpjegonte dhe si e ndiqte Lasgushi poetikën e tij apolitike. Ai ka në terësi natyrën e tij metafizike të përjetshme⁴¹³. Qetësia qiellore është vetëm në poezinë e Lasgushit, si një mjet për të krijuar një ishull të bukurisë së përjetshme. Poezia e tij është krenaria e një enciklopedisti, e një intelektualit vigan që pasi ka bredhur botën mbarë, bindet se nuk ka gjë më të bukur nga gjuha amtare. Si racë rilindasi, kuptoi se poezia fillon nga thellësitë, nga një pikë mistike në humbëtirat e liqenit, dhe zgjerohet në galaktikat yjore për t'u hapur pafundësisht.⁴¹⁴ Se me ç'dashuri të pafund ka formësuar ai tiparin e qenësishëm të poezisë së tij, duket në vargjet më poshtë:

*Dhe t'a shoh të pasqyruar
Vetëveten fije-fije
Fije-fije poezie
Që mban erë Shqipërie.*

Lasgushi shfaqet e mbetet një kulm vigan, i cili ka për të zotëruar shumë kohë me hijen e vet letraturën dhe mendimin shqiptar. Bëhet fjalë për një art i cili përcillet si model i mëvetësishëm, vlerësohet prej tij jo si e metë, por si akademi arti dhe morali. Në një vepër letrare që studiohet në të gjitha nivelet, është vështirë të mos gjendet ndonjë element i veçantë. Poeti hyri në letërsinë tonë, ku si formë e poetikës së tij ngrihet niveli artistik, poet i lartësive dhe thellësive pa fund. Kjo formë e poezisë nuk është e re në poetikën e këtij poeti, sepse një pjesë e rëndësishme është dhe poetika e këtij peisazhi, simbiozë kjo që ka nuancat e një mozaiku dhe koloriti të ngjyrave. Në poezinë shqipe ka një vend të posaçëm, sepse përmes rikonceptimit gjuhësor të botës dhe të njeriut, ajo i jep tekstit poetik distancën asociative, natyrën thelbësisht dhe shumësisht të interpretueshme, duke nxjerrë në pah modelin e simbolit dhe të fjalorit poetik vetjak të artistit. Metafizika e mbijetesës së thelbeve dhe akoma më esencialisht, ajo e kërkimit të kuptimit, si logjikë e mbijetesës, na kujton se një nga motivet kryesore të krijimit artistik është padyshim nevoja jonë për të ndjerë se jemi esencialë në

⁴¹³ Lasgush Poradeci, vepra IV, Albpaper, Tiranë, 2010, f. 51-54.

⁴¹⁴ B. Matraxhiu. "Krim dhe ndëshkim i një poeti", Nëntori, nr. 1, 1991.

marrëdhënie me botën. Kjo poezi niset dhe mbërrin në përmasa të shumta të të kuptuarit të botës. Vështruar nga pikëpamja e shtrirjes së saj si konceptim dhe si estetikë, ajo paraqitet si një hartë katërdimensionale. Subjekti lirik vetzbulohet në gjendje të ndryshme psiko-emocionale.

Thuhet se dashuria poetizon gjithësinë. Erosi i shpenguar nga paragjykimet shqiptare dhe arkaike, zbulohet me dritë-hije të njëmendta, me kundërshti të brendshme vetjake, pse jo tërheqje të vrullshme të çastit, pa fshehur shtirjen dhe mospërfilljen. Ky lajmotiv i përfituar në poezinë e Lasgushit, është si mishërim i zërit të vetëdijendriçuesit.

Poeti paraqet një pamje të veçantë të vendlindjes së tij, i cili ngjyros pamjen e kësaj vendlindjeje dhe shpalos përshkrimin e bukurive, e sidomos të anëve më karakteristike. Objekt i pafund frymëzimi është dhe liqeni, ku zemra e poetit ndizet dalëngadalë kur dalin yjet. Përmes poezive, edhe pa e njohur drejtpërdrejt autorin, mund t'i bësh asaj portretin. Kjo do të thotë që poezia e shkrimtarit nuk të zhgënjën. Përkundrazi, çdo situatë, sado e vështirë, përcillet me qetësi, ekulibër dhe paqe.

Kujtojmë këtu vargjet e poezisë “Gjahtari”, ku për ta ndryshuar këtë pamje të zymtë të peisazhit dimëror, monotonia dhe heshtja dimërore thyhet me përgatitjen për gjah. Përshkrimi i gjahtarit përfundon me gaz dhe hare. Citoj:”Poezia që të përshtatet është poezia, ajo që nuk të përshtatet nuk është poezi, duhet të vdesë, të mos rrojë, sikundër dhe s’rron po humbet.⁴¹⁵

Si një zë i veçantë dhe i mëvetësishëm, apo dhe si poet modern, vetë Lasgushi ka treguar se asnjëherë nuk i kanë munguar lexuesit apo adhuruesit e skajshëm të krijimtarisë. Kjo tregon që arti i tij i është përshtatur shijes së lexuesit.

Si një univers me tërheqje gravitacionale, ka tërhequr dhe mjaft studiues të tjerë. Si një princ përballë princëve, poezia e tij u pa me të drejtë si një ekulibër dhe faktor emancipimi në letërsinë tonë. Kujtojmë këtu, studiuesin Aurel Plasari ku përmend qasjet që i bën Poradecit me Bodlerin dhe Emineskun. Sipas tij i ka impresionuese. Erërat që frynin brenda shpirtit të poetit fluturuan drejt shtrëngimit që ndjeu, që kurrsesi

⁴¹⁵ Lasgush Poradeci, Poezia, vepra 1, Shtëpia botuese Albpaper, Tiranë, 2009, f. 7

nuk u dha në gjendjen e tjetërsimit si artikulum i heshtjes së dhimbshme, sepse vetëm kjo e shpëtonte poetin nga tjetërsimi. Poezia me specifikën e saj mbetet një “realitet i dysishëm”, ndonëse nisët nga një referencë kohore dhe reale, nga konfrontimi i asaj që dëshiron dhe asaj që realisht ka, nëpërmjet lirisë që i jep vargu. Ai nuk e përmend kurrë në vjershat e tij, nuk shkroi për shembull vargje të tilla si: në vdeksha i ri më varrosni këtu apo atje, tundim ky që një poet me fatin e tij, vështirë se do t’i bënte ballë.

Kujtojmë këtu vjershat e titulluar: “Ku vemi shpesh”, “Zemërimi jonë”, “Maja e çelur”, “Zemra e shokut”, “Më zu një mall”, “Po qan vasha në shtëpi”, “Ëndërr ziliqare”, etj

Citoj...

“Po nis ah! Gjirin ta godas

Dhe hap ah ! gjirin më një cast..

Dhe nginj ah ! zogjtë e vdes me gaz”

Nositi, zogu i gjolit me ujë të pastër kristal, çan gjoksin për të ushqyer fëmijën e vet, i ushqen me mishin dhe gjakun e tij. E gjithë vjersha i ngjan një kumbimi simfonik, të kthjellët e paksa të ngadalshëm si në simfonitë bethoviane. Është thujse një psherëtimë e thellë njerëzore si e dalë nga zemra e dheut, përshtypje që e krijon jo vetëm fabula e pasqyruar, por edhe një varg tingujsh e pjesëzash gjuhësore që transmetojnë këtë gjendje:

Afër vjershave me motiv patriotik është dhe “Kënga pleqërishte”, një vjershë me vlera të shquara artistike, ku gjejmë nostalgjinë e madhe për vendlindjen, sepse syri i poetit të shikon ndryshe dhe të vlerëson ndryshe.

Citoj...

“O këngë pleqërishte ! Ti vjershë e vendit tem

O mal, o pshërëtimë, o vaj, o lot i zi”...

Poezia e tij jetohet në një kohë ku jo rrallë demonstrohet fuqia. Poeti kish besim në besimin dhe triumfin e së vërtetës njerëzore. Dehumanizmi i njeriut të caktuar, pendesa, dhembja për endjen, përgjegjësia intelektuale, janë disa nga refrenet e këtij tipi poezie. Fjala është që të ruhen lidhjet në këtë elitë dhe nuk ndodh që krijuesi në mënyrë

fantaziste të shumëfishojë veten, duke pandehur se ky është vetë le-xuesi. Të mos harrojmë se poezia priret drejt realizmit deskriptiv, shpesh mjaft të poetizuar, kemi parasysh poezi shumë të njohura apo të një stili folklorik. Poradeci na hap portën e një jete të re, që siç pati thënë Viktor Hygoi, lindet e rritet në lëmin e këngës shqiptare.

Lasgushi është konsideruar nga kritika letrare si poeti i parë modern shqiptar dhe si liriku më i madh i shekullit XX. Dy librat e tij poetikë: Vallja e yjeve (1933) dhe Ylli i zemrës (1937), i kanë sjell shkëlqim letërsisë shqipe me vlerat e larta letrare, si në formë, në përmbajtje ashtu edhe në artikullimin figurativ. Vepra e tij, poezia, ka peshën e universalitetit dhe kontemporaritetit (bashkëkohësisë) dhe si e tillë komunikon me të gjitha kohët njësoj. Një varg tjetër është figurë e re. Të gjitha vargjet janë një figurë. Kodi poetik i lasgush Poradecit provon ndjenja të shumëfishta dhe poezia e tij të bind në çdo ind dhe fokusohet drejt hije-dritave të universit shqiptar, të cilat ai i kalonte aq imtësisht në kaleidoskopin e vet. Kjo tregon që në terësinë e veprimtarisë së studimeve e të kritikës letrare, Poradeci shfaqet i formuar e me aftësi të larta impresionuese. Ky objektivitet dhe mprehtësi shkencore shfaq një varg përcaktimesh me vlerë, sepse vështirësia më e madhe në studimin e një poezie qëndron në vetë specifikën e saj dhe drejtohet si princip i lashtë sa vetë mosha e njerëzimit ku siç thoshte dhe Poradeci, në poezi duhet ta kesh shpirtin të shenjtëruar.

Përkundër shumë gjendjeve, jeta e poetit nuk topitet, por rri zgjuar në meditimin e ri të poetit, i cili si patriot ka domethënie dhe peshë të madhe.

Këng' e lasht' e vjershërisë më pëlqeu aq fare pak...

Do t'ja marr që sot e tutje si bilbil parëverak,

Që nga fund' i vetëvetes do këndoj një mall të ri:

(Zog' i Qiejve)

Disa kritikë e quajtën Lasgushin poet, që kur i mungon frymëzimi nuk di të shkruajë. Dikush e quajti poet që nuk ka utopi sociale. Por ai është vazhdues i Naimit në pasurimin e gjuhës dhe pastrimin e saj. Në vazhdim të kësaj, sipas Lasgushit, këndvështrimi historiografik është i dëmshëm.

Citoj: “*Eruditëria i dashur Mitrush, e ka zemrën e thatë, pamjen e shkurtër, logjikën e ngushtë. Largohen prej esencës dhe prej koklavitjeve psiko-analitike*”.⁴¹⁶

Si përfundim, mund të theksojmë disa veçori të poezisë së tij:

Ndoshta Lasgushi është poeti më i angazhuar në kuptimin e të qenit borizian i ideve dhe kulturore të kohës. Në përgjithësi mungojnë detajet dhe imazhet poetike, sepse autori synon t’i sjellë lexuesit me “urgjencë” jetën dhe realitetin në trajtën e tyre fillestare, si normë qëllimesh.

Si një poet i lidhur fort me dashurinë, krijon vargje të mrekullueshme me pasion dhe dashuri dhe poezia ka një rend të lirë vargjesh që karakterizohen nga prania e figurave të diksionit, përmes një kostante metrike që kultivon elegancë dhe bukuri.

Komponentët e peisazhit qëndrojnë në simfoni me motivin, me dy linja poetike: qytetare dhe letrare.

BIBLIOGRAFI:

Lasgush Poradeci, *Korrespondencë Lasgush Poradeci – Mitrush Kuteli*, vepra IV, ShB “albPAPER”, Tiranë, 2010, f.103, 104.

Luan Topçiu, *Tekstualizimi dhe stili, mbi veprën poetike të Lasgush Poradecit*, Bukuresht, 2000, f. 3.

Lasgush Poradeci, *Poezia, vepra I*, ShB “albPAPER”, Tiranë, 2009. f. 15.

Lasgush Poradeci, *Vdekja e Nositit*, “Rilindja”, Prishtinë, 1978. f. 9.
Aristotle, “The politics”, Book 1, Ch.2 1252 line 27-1253 line 17.

L. Poradeci, *Shkolla shqipe e Poradecit*, Tiranë 2002.

⁴¹⁶ Vep.e cituar, f. 51

MIMOZA ZEKAJ

MERITA ISARAJ

Universiteti i Gjirokastrës
mimoza_zekaj@yahoo.com
isarajmerita2@gmail.com

VËZHGIME RRETH MJETEVE DHE MËNYRAVE TË NDRYSHME TË SINTAKSO-STILISTIKËS NË POEZITË E LASGUSH PORADECIT

E gjithë poezia e Lasgushit është një poezi e stilit të lartë, me anë të së cilës u jepet lexuesve një përfytyrim i gjallë, konkret i fakteve dukurive apo përjetimeve. Ajo prek mendjet, ndjesitë, emocionet e tyre. Autori përdor një gjuhë të zgjedhur e të përpunuar, duke përdorur me mjeshtëri mjetet leksikore dhe gramatikore, një sintaksë komplekse, me efekte stilistikore të shumta. Kjo përbën aspektin më interesant të gjuhës së një veprë letrare.

Në punimin tonë kemi bërë objekt mjete dhe mënyra të ndryshme të sintakso-stilistikës, që përdoren më shpesh nga autori. Do të vëmë në dukje ndërtime sintaksore dhe mënyra gjuhësore stilistike që përdoren me qëllime të caktuara nga autori ynë në poezitë e tij. Do të trajtojmë përdorimin e fjalive të ndryshme thirrmore, të fjalive pyetëse jo të mirëfillta, apostrofat, përsëritjen dhe rimarrjen, rolin e rendit të fjalëve apo të gjymtyrëve të ndryshme, rolin që luan përdorimi i dendur i disa mënyrave të foljes.

Përsëritja është një dukuri gjuhësore që i përshtatet mjaft mirë kësaj gjuhe, të cilën autori e ka përdorur në vargun e atyre mjeteve që i japin gjallëri gjuhës së poezive. Përsëritja gjuhësore në veprën e Lasgushit është e shumëllojshme. Vëmë re përsëritje të njëjësive të ndryshme leksikore, përsëritje të njëjësive morfologjike apo edhe të varianteve morfologjike, të konstrukteve sintaksore.

Për të prekur sa më shumë lexuesin, për të tërhequr vëmendjen, për të gjallëruar edhe më shumë vargjet e tij, autori përdor fjalitë pyetëse të llojeve të ndryshme, fjalitë pyetëse të mirëfillta e jo të mirëfillta apo fjalitë pyetëse retorike.

Vlerë të veçantë merr rendi i fjalëve apo i gjymtyrëve për t'iu përgjigjur

më mirë kërkesave të ritmit a rimës së vargut, apo për efekte ekspresive e stilistikore.

Të gjitha mjetet dhe ndërtimet e ndryshme sintaksore të përdorura nga autori janë pjesë e pasurisë gjuhësore të përdorura me aq mjeshtëri prej tij.

Modernizimi dhe intelektualizimi i gjuhës shqipe i filluar me hov nga rilindësit tanë të mëdhenj, do të vazhdojë në letërsinë e mëvonshme, sidomos nga autorët e letërsisë moderne shqiptare. Në këtë periudhë do të gjejmë shprehjen e vet të plotë përpjekjet, për t'i hapur shteg edhe njësimi të gjuhës e për ta zhvilluar atë në një gjuhë bashkëkohore, moderne, të aftë për t'u bërë shprehëse e kulturës, e shkencës dhe e artit kombëtar⁴¹⁷. Këta shkrimtarë të mëdhenj, midis tyre edhe L. Poradeci, luajtën një rol të rëndësishëm në jetën kulturore të vendit, por në të njëjtën kohë, u bënë edhe përhapës të vlerave gjuhësore të shqipes, duke ndikuar në rritjen e prestigjit të gjuhës, me qëndrimin që mbajtën ndaj saj.

Krijimtaria poetike është pjesë e pandarë e gjithë jetës së Lasgush Poradecit. Në dialogun e tij me kohën ai nuk është thjesht poeti lirik që i këndoi natyrës dhe dashurisë, por është këngëtari i madhështisë së shpirtit plot pasione. i afeksionit fisnikërues, i sakrifikimit, i zjarrit të krijimit, pa të cilin asgjë s'mund të përparojë. Poezia e Lasgush Poradecit solli një ndjeshmëri të re në letërsinë shqiptare, një kërkim të thellë gjuhësor e formal dhe një figurë të paparë⁴¹⁸.

Me anë të krijimtarisë së tij letrare, autori ynë paraqet vizionin e tij për jetën, për të sotmen, për të kaluarën apo për të ardhmen. Ky vizion shfaqet në të gjitha rrafshet dhe njësitë e gjuhës të përdorura prej tij, pra si në përmbajtjen e mesazheve, ashtu edhe në vijimësinë formale të saj. E gjithë poezia e Lasgushit është një poezi e stilit të lartë, me anë të së cilës u jepet lexuesve një përfytyrim i gjallë, konkret i fakteve dukurive apo përjetimeve. Ajo prek mendjet, ndjesitë, përjetimet e tyre. Autori përdor një gjuhë të zgjedhur e të përpunuar, duke përdorur me mjeshtëri mjetet leksikore dhe gramatikore, një sintaksë komplekse, me

⁴¹⁷ Sh Islamaj, *Gjuha ligjërimit dhe fjala*, Prishtinë, 2001, f. 228.

⁴¹⁸ S. Hamiti, *Letërsia moderne*, vepra letrare, 8, Prishtinë, 2002, f. 428.

efekte stilistikore të shumta. Kjo përbën aspektin më interesant të gjuhës së një vepre letrare.

Në punimin tonë kemi bërë objekt mjete dhe mënyra të ndryshme të sintaksës afektive, që përdoren më shpesh nga autori. Do të vemë në dukje ndërtime sintaksore dhe mënyra gjuhësore stilistike që përdoren me qëllime të caktuara nga autori ynë në përmbledhjen “Vepra letrare”⁴¹⁹.

Një dukuri gjuhësore që i përshtatet mjaft mirë kësaj gjuhe është përsëritja, të cilën autori e ka përdorur në vargun e atyre mjeteve që i japin gjallëri gjuhës së poezive. Përsëritja gjuhësore në veprën e Poradecit është e shumëllojshme. Vëmë re përsëritje të njësive të ndryshme leksikore, përsëritje të njësive morfologjike apo edhe të varianteve morfologjike, të konstrukteve sintaksore. Këto përsëritje përdoren të kombinuara e të ndërkryera brenda një fjalie apo strofe, të cilat shpeshherë u japin ngjyrimet të ndryshme vargjeve të poezive, denduri apo informacion plotësues. Në shumë përdorime ajo ka një vlerë të veçantë në organizimin gjuhësor, si figurë ndërtimi, si përftesë shprehëse, për të theksuar përjetimet e botën emocionale. Në disa raste përsëritja është përdorur për të plotësuar ritimin a rimën e vargjeve apo për të plotësuar përbërjen rrokjesore të tyre. Gjejmë të përdorura përsëritje të thjeshta a komplekse me fjalë të ndryshme apo me rrënjë të përbashkët. Përsëritet një fjalë e veçantë apo një sintagmë, një gjymtyrë apo një pjesë vargu në të njëjtin varg apo në vargje të ndryshme, madje edhe në strofa të ndryshme të së njëjtës poezi. Kemi vërejtur se për qëllime të ndryshme stilistikore, autori përsërit të njëjtën fjalë apo sintagmë në vargje të njëpasnjëshme, në fillim, në fund, në mes, në vargje të ndryshme, disa herë radhazi. Ja si shkruan poeti:

...Ajo ngrihet...ngrihet....ngrihet...dhemshurisht e dyke qarë,/ Se ç'gëzim përjetësie! E se ç'mall! E ç'dëshirime.../Zjarri fërfëllon e ngrihet gjer në djelli, gjer ne Zoti.../Sa, t'u ngritur me vetijen më përpjetë-e-më-përpjetë,../Nër paanësi të ndrijnë yjt' e ndezur varg-e-varg; Ti me mall të paqetuar fluturon larg e më larg.../Prit-e, prit! Se po t'afrohet Zog' i Qiejve, o Zot! (f. 48-49).

Fjalët që dalin të përsëritura, pra pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, si

⁴¹⁹ L. Poradeci, *Vepra letrare*, Tiranë, 1990.

emrat, foljet, mbiemrat apo edhe ndonjë pjesë e pandryshueshme ligjërate, në shumicën e rasteve, përsëriten me të njëjtën trajtë, por dalin edhe me trajta të ndryshme. Emri mund të dalë në rase të ndryshme të tij, apo folja në format e ndryshme paradigmatiche të zgjedhimit, mbiemri në disa forma të ndryshme duke iu përshtatur emrave që ka pranë, apo disa ndajfolje duke u përdorur në shkallë të ndryshme krahasimi. *Me flamur të kuq në dorë./ Me flamurin e lirisë (f. 103); ditë e shënuar./ ditë e shenjtëruar (f. 105); Duro vashë të durojmë./ Si duron mali dëborën 9f. 117); Mall o mall.../Malli mallin më s'e gjen... (f. 148).*

Ka raste që përsëritja realizohet për të rimarrë një fjalë të përmendur më parë, më qëllim që ta plotësojë më tej atë, duke e plotësuar me gjymtyrë të tjera, duke e theksuar më tepër për arsye të ndryshme stilistike: *Djalëri, lart për liri!/ Lart për Zonjën Shqipëtare! / ...Djalëri, heu! Yll i ri!/ Djalëri, këng' e shëndetit! / Rrofsh! e lumja Djalëri! (f. 80). Kroj i fshatit tonë, ujë i kulluar, .../Kroj i fshatit tonë, ngjyrë – 'rgjëndi –lyer.../Kroj i fshatit tonë, tetë sylynjarë, .../Kroj i fshatit tonë, n'atë mal me fletë, .../ Obobo! si malli, që nuk vdes përjetë (f. 114). Gjejmë të përsëritur çdo gjymtyrë fjalië, por në shumë raste del i përdorur kallëzuesi, rrethanorët, kryefjala: *Këtu mbretëroj përjetë /Mbretëroj: e plot mëri, ... /Lidhni besën për Atdhe,/ Ju me gjak të Kastriotit!/ Lidhni shpejt e shpejt e bëni be (f. 80). Mall! O mall! Që vjen e shkon!...../Vjen e shkon e prapë vjen, /Mall që len nga perëndon;/Len e vjen e zjen e bren,/ Malli mallin më s'e gjen... (f. 148).**

Në përdorimin e përsëritjes autori ka një meritë të veçantë, sepse e përdor në forma të ndryshme, duke krijuar efekte të ndryshme. Ka raste që fjalët e ndryshme apo disa konstrukte të thjeshta sintaksore të përsëriten brenda të njëjtit varg ose te disa vargje të njëpasnjëshme, mund të rimerren në pjesën e parë të një vargu, apo të jetë fjala e fundit e pjesës së dytë të vargut. Ka raste që përsëriten fjalët e fundit të dy a më shumë vargjeve të njëpasnjëshme. *O gjuhë-e shenjtëruar, o mall me shpirtin plot./...Posi një kraharuar ti dhemb, o Gjuhë-e zjarrtë,/ O gjuhë-e e zemrës sime, o mos-e-kuvenduar (f. 60). Gjuha: shpirti i shenjt' .../Gjuha: zjarr ku djeg me dritë.../ Gjuha: afsh' i gjall' i jetës.../ Gjuha: yll' i vjershërisë! Gjuha: Verb' i Perëndisë! (f. 48). Ardhi*

dit' e shenjtëruar./ Dita e Njëzetetës/ Nat' e zisë-edh- e së metës/ Ardhi dit' e shenjtëruar./ Ditës së njëzetetës./ O moj kohë që ke shkuar/ Të vështron me syrin pyetës./ O moj kohë që ke shkuar./Ditën e Njëzetetës (f. 105). Se të desha vetë/ Dhe t'u ngasa vetë./ Dhe të putha vetë (f. 259).

Në veprën e autorit tonë përsëritja është e shpeshtë dhe e përdorur në nivele të ndryshme. Më së shumti përsëritet në ligjërimin e shkrimtarit, në skicimin e përjetimeve, në përshkrimet e mjediseve dhe dhënien e natyrës. Shfaqet mjaft dukshëm te thirrorët, te pasthirrmat, te pjesëzat e ndryshme, të cilat sjellin në poezi një tablo mjaft të larmishme. Pamja që autoi ka projektuar nëpërmjet veprës së tij, shfaqet me të gjithë tingujt, ngjyrat, larminë e sendeve, dukurive të ndryshme të natyrës, sidomos të vetë njeriut që është në qendër të të gjitha zhvillimeve. Kjo është harmonizuar mjaft bukur dhe është gjithmonë në funksion të idesë e të përmbajtjes së poezive, duke krijuar një sfond që i jep ritëm e gjallëri gjithçkaje dhe nga pkëpamja sintaksore, krijon situata të veçanta. Ja si shkruan poeti:

O këngë pleqërishte! Ti vjersh e vendit tem!// Dëgjohu as dëgjohu! Moj këngë pleqërish!// O këngë pleqërishte! O vjersh' e vendit tem!// O mall! O psherëtimë! O vajë! – O lot i zi!// O shpirt i përvëlur që qan nër syt' e mi! (f. 65).

Këto përsëritje i bëjnë vargjet ku janë përdorur të marrin një cilësi. Në gjuhën e folur përsëritja është mjet i rëndësishëm intensifikimi ose për të përçuar emocion⁴²⁰.

Duke kundruar veprën e Poradecit, vëmë re se se përsëritja nuk është vetëm përsëritje, por ajo i shërben pasurimit të ligjërimin dhe dëshmon përpjekjet e autorit për të ralizuar një organizim të pasur ligjërimor. Edhe përsëritja e strukturave sintaksore i jep gjuhës së poezive një përmbajtje të pasur ligjërimore. Çdo element i gjuhës sjell shprehësi, po të rimerret me këtë përftesë, sidomos po të bëhet përsëritja sipas një kriteri organizimi⁴²¹.

Në disa poezi kemi ndeshur edhe rimarrjen me një fjalë tjetër po të asaj teme, sidomos të ndonjë gjymtyrë të dytë, si: *Fli, fli. i harruar harrimi*

⁴²⁰ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2006, f. 48.

⁴²¹ Xh. Lloshi, *po aty*, f. 48.

(f. 59); *Flet me gojë, -e papandehur sikur ulërin çakalli,/ Qan e heq në të kënduar, zë këndon në zi të madhe* (f. 74); *Pate shkruar e punuar/ Kombin për ta kombësuar,/ Shqipen për ta shqipëzuar* (f. 106). *Trim, o trim, seç trimërove!* (f. 119); *Një dashuri, një fshehtësi/ M'e fshehur sesa fshehtësia* (f. 129); *Duro durimin si përnot/ Mendo mendimin zemërak/ Doroj durim të mbushur plot* (f. 248); *...ku dashuron kaq dashuri!/ Si djeg kaq flakë e flakërohëm* (f. 250); *Vetullo moj vetullushe!/ Gjarpëro, moj gjarpërushe!/ Fluturo, moj fluturushe!* (f. 254).

Ka raste që mendimi, përjetimet, ndjesitë e poetit të shprehen me përsëritje antonimike. *Se kish kuptim që s'kish kuptim./ Kuptim' i fellë-i mallit tonë;/ S'e s'dashuronja-as un' as ti/ Po dashuronte dashuria* (f.129). *Më zhdukesh ditën e më dukesh/ Pa të pandehur nat'-për-natë* (f. 136). *Kudo janë e kudo s'janë,/ Njëpër qiell që s'ka mbarim"/ Kur mi të, e kur nënë të,/ kur me hirë-e kur pa hirë* (f. 155). *Kush ma njohu dhemshurinë,/ S'pati njohur kurrëgjë* (f. 242); *Vjen e shkon e vjen si hija/ Plas e s'plas kjo dashuri* (f. 255).

Në mënyrë të vetëdijshme fut një përftesë specifike: shkrirjen e gjymtyrëve në një vazhdimësi të pandërprerë me një lojë të lirë fonetike. Larmia e tyre e mbështet semantikën e përsëritjes së pandërprerë, të lëvizjes valëzuese ose ciklike, e cila ka të bëjë me domethënien e motiveve edhe me konceptimet filozofike të autorit⁴²². Krahas përsëritjeve të tilla, si: *ca nga ca, mes për mes* etj., autori e çon më tej lirisht parapëlqimin e tij me: *dit -për- dit -a nat -për- natë; përpjetë -e më- përpjetë; larg-e më- larg; valle-valle; lot me lot; shpirt me shpirt; varg e varg*.

Në të gjitha poezitë e Poradecit gjejmë kombinime përsëritjesh të ndryshme nga lloji, nga sasia, nga vendi, të cilat krijojnë skena me efekte e theksime të larmishme. Larmi e gjallëri shprehjes ia japin edhe renditja e njërive sintaksore të njëpasnjëshme apo të së njëjtës strukturë, të cilat shpalosin edhe njëherë mjeshtërinë e madhe të këtij poeti: *Vetullo, moj vetullushe!/ Gjarpëro, moj gjarpërushe!/ Fluturo, moj fluturushe!* (f. 254); *Se të desha vetë,/ Dhe t'u ngasa vetë,/ Dhe të putha vetë;/...se të gjeta grua,/ Dhe të desha grua,/ Dhe të putha grua*

⁴²² Xh. Lloshi, "Lirizmi i lirikut Lasgush" në *SF*, 1-2, Tiranë, 2000, f. 24.

(f. 259).

Sintaksa e Lasgushit është gjerësisht e mbështetur në sintaksën e gjuhës bisedore, të të folurit të gjallë emocional dhe të këngës popullore⁴²³. Në përshtatje me këtë frymë dhe me qëllimin e poetit për ta gjallëruar sa më shumë poezinë, për ta bërë sa më të ndjeshëm vargun, gjejmë të përdorura edhe fjali thirrmore të tipeve të ndryshme, por edhe fjali pyetëse të llojeve të ndryshme. Fjalitë pyetëse në shumicën e rasteve tërheqin vëmendjen për atë që do të shprehet në vargjet e mëposhtme, duke krijuar një lidhje organike midis vargjeve e strofave:

Ç'm'u verbosnë-o! syt' e mia?/ U nxi dheu/... U shua qjelli/.../ U bë natë githësia?/...S'është gjë: veç yll'i vetë (f. 57); Vallë dergjja jote-e fellë pat pushim e lumturi?/ A t'ju zhduk dobare gjumit e përjetëshmeja zi?/ Të shkëlqeu pakmos së largu fush' e ndriçm' e Qerbelasë? (f. 72).

Paralajmërimin me fjali pyetëse për atë që do të thotë më poshtë, poeti shpesh e ka gërshetuar me ndërprerje të ligjërimin, për t'u ndalur para imazhit e për të përjetuar më thellë dhimbjen që rrjedh nga situata e krijuar. Grafikisht Lasgushi përdor pikat duke lënë me shumëpikësh një strofë. Formalisht kjo është një lojë me hapësirën e faqes së shkruar, por vëzhgimi më i kujdeshëm na tregon se ka një arsye⁴²⁴, duke na tërhequr vëmendjen për një largësi të madhe me botën njerëzore, për madhësinë e një dukurie apo objekti, ose për ndonjë ngjarje të dhimbshme:

Nga fluturoi bilbil –finoshi/ Q'e fryri era posi fletë?/ Ku vanë pendët e pëllumbit/ Q'e shtiu në dhet mërgim' i shkretë?/ (f.71). Flamur' i pastër që m'u nxi/ Në sulm të lumtur për liri,/ Qëndron gazmor në lartësi!...../ (f. 224).

Në disa raste fjalitë pyetëse i gjejmë të përdorura edhe për të shprehur qortim, apostrofim, habi, zemëratë me ngjyrime edhe thirrmore: *Kush u tall se pasuria është rrob e larë n'arë?/ Se një mendj' e palëmpirë zbukuron një trup bujar?/ Në fjalim të Shqipëtarit kush përqeshi? Kush gajasi? (f. 74).*

Plot me reagime afektive dalin dhe fjalitë pyetëse retorike të përdorura gjerësisht në poezitë e tij, si:

⁴²³ Po aty, f. 26.

⁴²⁴ Xh. Lloshi, *vepër e cituar*, f. 25.

Çfarë u ndje në Shqipëri?/ Ç'bëre bir, në atë mërgim?/ Bir po malli si s'të zu?/ O, cili më drejtovi nër kaqe lumturi?/ Ç'ke që vuan, o njeri?/ Ç'ke që bret me dhemshuri?/ Ç'ke që djeg posi qiri?...

Nuk janë të rralla rastet e përdorimit të foljeve në mënyrën habitore, si një mjet ekspresiv. Këto folje i gjëjmë të përdorura jo vetëm në fjalitë thirrmore, por edhe në fjali jothirrmore. Autori e ka përdorur këtë mënyrë për të shënuar një veprim të papritur, për të ngjallur habinë e lexuesit, për të shprehur habinë e tij, apo qëndrimin e tij emocional. *Kroj i fshatit tonë, tetë sylynjarë,/ Ndër tetë krahina qenke kroj i parë;/ Qenke një në botë, s'pakërke të dytë,/ Ç'na shëroke plagët, ç'na shëroke sytë* (f. 114); *Jetën ç'paskan trashëguar,/ Shpirtin ç'paskan shenjtëruar* (f. 119).

Përdorim në fjalitë nxitëse dhe nxitëse thirrmore kanë edhe trajtat e mënyrës urdhërore e të mënyrës lidhore të foljeve.

Fli, shpirt, edhe fli./ Fli, fli. I harruar harrimi,/ Ti fli.. dhe në do që të zgjohesh,/ Ta dish si djeg yll' i vërtetë (f. 59); *Lidhni besën për At dhe, /...Lidhni –e shpejt e shpejt e bëni be;* (f. 80).

Kanë përdorim të dendur edhe fjalitë dëshirore e dëshirore thirrmore, të cilat me ngarkesën e tyre emocionale që mbartin, ia forcojnë edhe më shumë përmbajtjen afektive poezive ku përdoren. Ato dalin si urime, si betime apo formula të gatshme: *Rrofsh! E lumja Djalëri!/ Rrofsh e qofsh sa val' e detit!/ Rrofsh e lira Shqipëri!/ Rrofsh! o moj Shqipëri përjetë!*

Në gjithë krijimtarinë e Poradecit vihen re përpjekjet e autorit për të përdorur larmi mjetesh dhe mënyra të shumta për ta transmetuar sa më të gjallë dhe me shumë emocion dashurinë njerëzore, botën e brendshme, qëndrimet, adhurimin, aspiratat, përzgjedhjen, gjithçka që kalon në filtrin e tij. Përzgjedh ato mjete dhe dukuri sintaksore që e shpalosin më mirë qëndrimin afektiv të tij. Sintaksa e Lasgushit është gjerësisht e mbështetur në sintaksën e gjuhës bisedore të të folurit të gjallë emocional dhe të këngës popullore⁴²⁵. Për të dhënë më shumë nuanca dhe efekte të ndryshme, në poezitë e tij ndihet mjaft e përdorur edhe rasi dhanore. Në gjuhën tonë, veçanërisht në gjuhën popullore, sidomos në folklor, përdoren shpesh trajtat e shkurtra të dhanores së

⁴²⁵ Po aty, f. 26.

përemrit vetor të vetës së dytë e të tretë, jo për të shënuar folësin a bashkëfolësin, po për të afruar më shumë faktin me autorin e tregimit ose me dëgjuesin, për t'i dhënë tregimit një karakter më ekspresiv a më intim, për të shprehur, deri diku, edhe qëndrimin emocional të folësit, Ky mjet është përdorur me efekte stilistike-artistike mjeshtërore edhe nga prozatorë e poetë të letërsisë sonë⁴²⁶.

Nga çdo anë seç na ardhë/ Seç na ardhë palë-palë (f.101); Ç'na buron nga mali dyke mermëruar,/...Që nga rrëz' e malit ç'na mburon rrëmbyer/...Ç'na shëroke plagët, ç'na shëroke sytë (f. 114).

Një dukuri sintaksore që është shfrytëzuar si mjet stilistik është rendi i fjalëve dhe i gjymtyrëve. Në poezitë e Poradecit del një rend mjaft i larmishëm, për të prekur sa më shumë mendimet dhe ndjenjat e lexuesve. Në disa raste prishja e rendit është bërë për shprehësi, në disa raste e ndikuar nga faktorë ndiesorë e sintaksorë dhe në disa raste nga kërkesat e vargëzimit, të ritmit apo rimës. Vargjet mund të fillojnë me kryefjalën, me kallëzuesin, me kundrinorët, me rrethanorë apo me kallëzuesorë, duke krijuar një larmi strukturash.

Gjuh' e ëmbël e strëgjyshve do të dukej gjuh' e vdarë;/ Kam mbeutr kaq i huaj, dh'i ndrydhur edh' i shkret!;/ Do vi! Do të vi pranë mjerush e dyke vuar;/ Pa pushim të del nga zemra vaj' e tingëllit të mjerë;/ Dheut! Ah dheut të përtëritur sot i falesh përsëri!;/ Mun në fund të zembrës sate rritet fshehur dashuria./ E kështu ti qan pareshtur bukuritë- e dashurisë,/ Prej qepallës së përлотur të pikon një pik' e ngritë.

Në disa raste bie në sy paravendosja e mbiemrit. Janë paravendosur mbiemra cilësorë në shkallën pohore me kuptim figurative afektiv, disa mbiemra cilësorë në shkallën krahasore. Është e rëndësishme të theksohet që paravendosja kushtëzohet nga luptimi leksikor i mbiemrit dhe nga karakteri afektiv i frazës, por në poezi si liri poetike⁴²⁷.

Sikur të shoh, i tmerrshëm Frashër,/ M'i nxitë sesa zemra.../ M'i ndritur se mendimi që shkrep si vetëtim,/ Ku i jep mëshirë-i tmerrshmi det/ Zu po ngre valë –i tmerrshmi det,/ Më kishte rob e tmerrëshmjia zili./ Dhe më mbush prapë plot me dritë, plot me të ëmblën

⁴²⁶ M. Domi, “Çështje të gjuhës së epikës legjendare heroike sidomos në sintaksë”, në *Kultura popullore* 1, 1984, f. 24.

⁴²⁷ M. Totoni, “Vlerësimi morfologjik i “mbiemrit” të paravendosur dhe gjymtyrëzimi sintaksor i tij”, *SF*, 2, 1991, f. 154.

dashur,/ Nga i malli shkas, nga i madhi mall,/ Të pamposhturit Sokrat.
Të gjitha vëzhgimet që sollëm nga sintaksostilistika dhe plot ndërtime sintaksore dhe mënyra gjuhësore stilistike që përdoren me qëllime të caktuara nga autori ynë (të cilat do t'i bëjmë objekt studimi në punime të tjera), janë një tregues i kontributit dhe vlerave të mëdha që ka krijimtaria e Lasgushit në kulturën shqiptare. Ato dëshmojnë punën e kujdesshme të Lasgushit me gjuhën, ndërthurjet e arritjeve të deriatëhershme me elementët modernë të saj.

BIBLIOGRAFI

- Gj. Shkurtaçaj, “Nëpër labirintet e stilemave lasgushiane: Fjalëformimi si vetjakësi e gjuhës së hijshme”, në *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009.
- I. Kadare, *Ardhja e Migjenit në letrësinë shqipe*, Tiranë, 1991.
- M. Domi, “Çështje të gjuhës së epikës legjendare heroike sidomos në sintaksë”, në *Kultura popullore* 1, 1984.
- M. Totoni, “Vlerësimi morfologjik i “mbiemrit” të paravendosur dhe gjymtyrëzimi sintaksor i tij”, *SF*, 2, 1991.
- S. Hamiti, *Letërsia moderne*, vepra letrare, 8, Prishtinë, 2002.
- Sh Islamaj, *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, Prishtinë, 2001.
- Sh. Sinani, “Lasgush Poradeci dhe kodi poetik popullor” në *SF*, 1-2, 2000.
- V. Bala, “Me gjuhën e ëmbël e të begatë shqipe”, në *Nëntori*, 7/1980.
- Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2006.
- Xh. Lloshi, “Lirizmi i lirikut Lasgush” në *SF*, 1-2, Tiranë, 2000.

EMIN AZEMI

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve,
Shkup

LASGUSHI POET, NJË LËVRUES SPECIFIK I KRITIKËS DHE PUBLICISTIKËS SHQIPTARE

Lasgush Poradeci, sic dihet, është i njohur në rend të parë si poet, dhe këtë e argumenton duke thënë “përpara të gjithëve është poezia. Ajo formon shpirtin e kombit. Një libër me një roman është unterhatungs buch (libër bashkëbisedimi), ndërsa një libër me poezi është bildungs-buch (libër formimi)”⁴²⁸

Në Shqipërinë letrare Lasgush Poradeci është një gur i rëndë, i hapur e i lartë që përkufizonte dy shpejtësi zhvillimore të identitetit estetik e të kulturës shqiptare që shtrihej midis letërsisë së pavarësisë dhe modernizmit letrar, ku ai me formimin dhe prirjet e tij avangarde, për kohën, por edhe për periudhat e mëvonshme, do të mbetet modeli i vetëm prej ku pikënisjet e këndvështrimit kritik do të duhej të kenë një qasje specifike.

Duke parë entuziazmin e thellë që përcjell poezia e Lasgush Poradecit, Eqrem Cabej, atëherë student do të shkruante: “Djalëri shqiptare, këndo Lasgush Poradecin, e pastaj vdis”⁴²⁹.

Një lëvrues i poezisë tek i cili shtrirja dhe thellësia e figurshmërisë gjuhësore kapte një gamë të gjerë instrumentesh stilistike e përmbajtësore, do ta bëjnë Lasgush Poradecin shumë të veçantë edhe në shkrimet jashtë poetike, kryesisht në publicistikë dhe në vështrimet teorike-letrare mbi autorë dhe mbi fenomene të caktuara të letërsisë.

Në publicistikë do të vërejmë se Lasgush Poradeci jo që është orator, por edhe këtu do të shohim se është poet, sepse të gjitha prozat e tij të shkruara janë metafora të lidhura si në sistemin poetik të Lasgushit. Publicistika dhe letërkëmbimet e Lasgushit trajton tema e probleme shoqërore që huk janë të huaja, por përkundrazi në këto shkrime ai

⁴²⁸ Petraq Kolevica, Lasgushi më ka thënë, Sh.B 8 Nëntori, Tiranë, 1992.

⁴²⁹ Eqrem Cabej, Studime gjuhësore, f. 87-89. Grac, shkurt 1929. Cituar sipas I. Rugova, Sabri Hamiti, Kritika letrare, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 276

dëshmon se ishte i lidhur me me jetën dhe botën shqiptare reale, njësoj sikurse në poezinë e tij. Këto i vërejmë te letërkëmbimet dhe ditaret e tij.

Poetika e Lasgushit bëhet urë ndërlidhëse midis traditës dhe modernes, botës së brendshme individuale dhe botës së jashtme njerëzore dhe ky koncept estetik gjen shprehje edhe në shkrimet jashtë poetike të tij. Ai dhe në letrat komunikuese, analizat e vështrimet përdor figura poetike, edhe këtu si në poezi dëshiron të bëhet poet i lirë i qiellit, e jo i urdhëresave dhe dëshirave të dikujt, ai shkëputej prej grykave të maleve, ngushticave dhe qorrsokaqeve të sistemeve të ndryshme, për të dalë në horizontin e gjerë poetik.

Poezia për Lasgush Poradecin është produkt njerëzor i një bote tjetërfare nga realja, natyrorja që shpreh një kumtim, shpresë dhe mbresë për botën që nuk i përkasim, botë e brendshme nga e cila s'kemi mbirë, në të cilën jemi flakur. Për të gjitha këto poeti na bën me dije se poezia i takon intuitës, imagjinatës, frymëzimit, zemrës, shpirtit, dashurisë, dritës, përjetësisë që i takojnë të njëjtit lloj gjenealogjik të esencës së krijimit.

“Poeti i vërtetë e kupton se fillimi i poezisë është zemra, e në zemër egziston esenca e krijimit, e në esencën e krijuese egziston shpirti krijues, e në shpirtin krijues egziston sekreti, e në sekretin poetik egziston një dritë, e prej kësaj drite shndërritë poezia”⁴³⁰

Ndonëse ai artin e poezisë e kishte shpallur si formë më supreme të përsosjes, teksa e thoshte edhe vet “...pse parapëlqej të shkruaj vargje dhe jo prozë? Kur them vargje, kuptoj që duhet të jenë të përsosur nga arti. Vetëm këto të përsosurit rrojnë (dhe mezi dhe këto). Të papërsosurit vdesin...”, ose “Prandaj duhet të shkruajmë poezi jo të mirë, po shumë të mirë, jo të lartë, po shumë të lartë, shumë të thellë, shumë të gjerë, që t'i vemë shpirtit të Kombit themele të shëndoshë”. Megjithatë, qasjet e tij kritike e publicistike, janë një shkollë më vete.

Depërtimi i tij në strukturën e tekstit letrar ishte një stil gati i panjohur deri atëherë kur u shfaq Lasgushi, dhe kjo shumë lehtë mund të vërtetohet, bie fjala, në analizat teorike të narracionit në prozën e Mitrush

⁴³⁰ Sulejman Mehazi, Lasgush Poradeci për poezinë, ArbëriaDesign, Tetovë. 2013. f. 141

Kutelit, teksa ai zbërthente projektimin e ëndrrës në thelbin e rrëfimit, duke e tejperçuar atë si një fibër që e bën “...realizimin e fenomenit metafizik të rrojtjes së tanishme të ngjarjes historike.”⁴³¹

Me strukturën narrative të Mitrush Kutelit , Lasgush Poradeci është marrë pa pretendimin se po thotë ndonjë gjë të re, por nëse i hedhim një sy kritik asaj që ai e quante fshehtësi të lëvrimit të prozës nga ana e Kutelit, atëherë me të drejt ai do të dijë ta arsyetojë epitetin e themeluesit të prozës moderne që më vonë e mori Kuteli, por me një vlerësim paraprak që erdhi nga Lasgush Poradeci teksa konstantone: “Krijonjës subjektiv , prej çfaqjes objektive të rrethanave. Dhe këtu fillon ai transfigurimi poetik që iu jep Mitrush Kuteli motiveve të tija, transfigurim që është e fshehta e patjetërsueshme e rrëfimit të tij...”⁴³²

Ose “...realizimin e fenomenit metafizik të rrojtjes së tanishme të ngjarjes historike.”⁴³³

Në observimin kritik të Lasgush Poradecit, Mitrush Kuteli dilte si një mjeshtër i transfigurimeve poetike-narrative në procedun e tij krijues.

“Krijonjës subjektiv , prej çfaqjes objektive të rrethanave. Dhe këtu fillon ai transfigurimi poetik që iu jep Mitrush Kuteli motiveve të tija, transfigurim që është e fshehta e patjetërsueshme e rrëfimit të tij...”⁴³⁴

Pra, të gjitha këto Lasgush Poradeci nuk i ka shprehur vetëm në poezitë dhe veprat poetike, por edhe në publicistikë, në prozë duke publikuar mendime nëpër ditaret, letrat, esetë, korrespondencat. Ai duke e ditur se burimi i poezisë është në zemër, e burimi i diturisë në mendje, prandaj edhe thotë: “Poeta nascitus. Orator fit”. (Poezia lind. Oratori bëhet)⁴³⁵

Në kohën kur Lasgush Poradeci u mor me publicistikë dhe me kritikë letrare, në letërsisë shqipe të atyre viteve, përpos Faik Konicës, e më vonë Krist Malokit, Namik Resulit, Eqrem Çabejt e ndonjë tjetri, firma e tij që shoqërohej me tekstete para mbi Mitrush Kutelin, Naim Fra-shërin, Gjergj Fishtën, Asdrenin, ishte një legjitimim mjaft kredibil i vlerave që po përhapeshin në vitet e letërsisë së pavarësisë.

⁴³¹ Lasgush Poradeci, Publicistika, Onufri, 1999, f. 33

⁴³² Po aty, f. 34.

⁴³³ Po aty, f. 33

⁴³⁴ Po aty, f. 34

⁴³⁵ Petraq Kolevica, Lasgushi më ka thënë, Sh.B 8 Nëntori, Tiranë, 1992, f. 74

Ndonëse Lasgushi ishte i pranishëm në letrat shqipe, sidomos në kulmin e pjekurisë krijuese që përshkonte periudhën e para Luftës së Dytë Botërore, dhe pak kush atë e konceptonte si emër jashtë poezisë, për arsye se buja që kishin bërë dy vëllimet e tij poetike ‘Vallja e Yjeve’ dhe ‘Ylli i Zemrës’, do ta bënin Lasgushin poet më kumbues se Lasgushin publicist apo kritik letrar.

“Më 1944, kur Shqipëria u çlirua, Lasgush Poradeci ishte, jashtë çdo diskutimi, shkrimtari më i madh që jetonte në vend”,- do të konstatojë me të drejtë Ismail Kadare.

Por edhe në këto fusha, Lasgushi ka një qasje prej poeti, sidomos në shkrimin e disa vështrimeve mbi profilet krijuese të Mitrush Kutelit, Naim Frashërit, Gjergj Fishtës, Asdrenit etj. Korrespondenca e Lasgush Poradecit me Mitrush Kutelin më shumë ishin mesazhe e komunikime shpirtërore, qiellore, sesa shoqërore e politike tokësore. Ja si i shprehet në fillim të korrespondencës, Lasgushi, duke treguar vlerën e komunikimit, mënyrën e qëllimit të korrespondencës: “ *po të dërgoj sot një mesazh qiellor, ashtu sic i-u kënda shpirtrave tonë të etuara për gjëra e vise më të mira se atje ku jemi shtrënguar të arratisemi tashi-për-tash. O shok i dashur! Ardhi koha e nisjes së letërkëmbimit t'onë! Le të fillojmë pra me muzikë të re: muzikën e poezisë dhe të ëndërrimit*”.⁴³⁶

Të flasësh për Lasgush Poradecin si gurin themeltar të modernizmit poetik shqiptar, gjithkush e këtë vlerësim tash më ka konsideruar si punë rutine, por të flasësh për Lasgushin si poet e intelektual që letrave shqipe u ka dhuruar pikëpamje krejtësisht të reja, për kohën, mbi poezinë dhe artin në përgjithësi, paraqet një punë që rumbullakon portretin e tij, i cili mbetet ende i paplotë për shkak të gjerësisë dhe thellësisë së pikëpamjeve të tij.

Këtij konstatimi ndoshta më së miri do ti shkonte një mendim i studiuesit të njohur Moikom Zeqo, sipas të cilit ‘poetika lasgushiane përbëhet nga letër-kredencialet e kombit të tij’, prandaj do të thoshim se edhe aurësia e tij në shkrimet jashtëpoetike, paraqesin një thesar të vlerave që vinë nga një bard i letrave, bota e të cilit nuk përbëhej

⁴³⁶ Lasgush Poradeci, Korrespondencë Lasgush Poradeci- Mitrush Kuteli. Vepra IV, Dhimitër Pasko, Pogradec, Albania, Grac, më 7 korrik, 1928. Sh.B.albpaper, Tiranë, 2010, f. 9

thjesht prej përsiatjeve të zakonshme poetike, por edhe prej një plazmimi shumëdimensional kulturash e traditash të përvetësuara në laboratorin e tij krijues.

BIBLIOGRAFI

Eqrem Cabej, Studime gjuhësore, f. 87-89. Grac, shkurt 1929. Cituar sipas I. Rugova, Sabri Hamiti, Kritika letrare, Rilindja, Prishtinë, 1979

Lasgush Poradeci, Korrespondencë Lasgush Poradeci- Mitrush Kuteli. Vepra IV, Dhimitër Pasko, Pogradec, Albania, Grac, më 7 korrik, 1928. Sh.B.albpaper, Tiranë, 2010, f. 9

Petraç Kolevica, Lasgushi më ka thënë, Sh.B 8 Nëntori, Tiranë, 1992

Sulejman Mehazi, Lasgush Poradeci për poezinë, ArbëriaDesign, Tetovë. 2013

LASGUSH PORADECI NË FILMIN DOKUMENTAR

Filmi dokumentar shqiptar, nuk mund të themi se zë në vend të rëndësishëm në imazhin e një figure kombëtare, sikurse është Lasgush Poradeci. Përpjekje të herëpashershme ka pasur për ta përjetësuar atë në filmin dokumentar, në periudhën e diktaturës dhe atë të demokracisë.

Ndryshimet e filmave dokumentarë ndodhin më së shumti pas viteve ‘90 në aspektin strukturor të tyre. Regjisura shqiptare vendos tituj dhe ndryshon përmbajtjen e filmave nëpër vite. Skenaristët shtojnë dhe përsërisin vetëm vargjet poetike, të autorit, në ta. Ndryshim titujsh poetik të recituara nuk kanë të gjithë filmat e analizuar në këtë proces artistik. Skenaristët shtojnë dhe pakësojnë vargje në kuadër të formës përmbajtësore të përgjithshme, të krijimeve të tyre letrare e filmike. Madje, në to, rishtohet edhe intervista reale me Lasgush Poradecin, (një e tillë) duke e risjellë si risi, në prodhimet e mëvonshme, pa zbatuar kriteret e së drejtës së autorit. Ky dimension këndvështues, na lejon të arrijmë në konkluzione të ndryshme apo të përsiatim probleme të sfondit krijues autorial. Konkretisht, për njohjen e kohës në të cilën u realizuan filmat dokumentarë dhe u shfaqën, njohjen me mjedisin ideokulturor, drejtimin socrealist të cilit ata i përkisnin, njohjen me kushtet historiko-shoqërore, kohën e krijimit, montimit dhe premirës së tyre. Kjo e fundit ka qenë e thatë, pa publicitetin e nevojshëm që meriton një film në masmedia për publikun. Janë këto aspekte, ato që na çojnë në konkluzionin përfundimtar të përcaktimit kronologjik, të filmit dokumentar, realizuar mbi jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit. Ndër krijimet më të mira mbeten ato të të realizuara nga regjisorët Endri Keko dhe Mevlan Shanaj. Mes tyre, prodhimi filmik më i mirë dokumentar, mbetet gjithsesi subjektiv. Në varësi të shijeve dhe teknikave të prodhimeve filmike në kohë, nga shikuesi, fitohet koherenca perfeksioniste.

Sqarojmë gjithashtu, s’e nuk ka një film dokumentar, i cili nga fillimi deri në fund, të flasë mbi jetën dhe veprën letrare të L. Poradecit, ta trajtojë atë me detaje. Në këtë kuadër kemi bërë një ndarje të prodhimeve

filmike sipas viteve dhe krijuar një minibibliografi të shkurtër filmike, mbi bazën e një arsyetimi logjik. Skenaristët dhe regjisorët e krijojnë filmin e tyre duke rënë në përsëritje tematike të poezive, të përzgjedhura për ilustrim apo përdorimit të intervistës së vetme, të dhënë nga Lasgush Poradeci, atyre vitesh. Duhet thënë, gjithashtu, se filmat e paktë, dokumentarë të krijuar për Lasgushin në vitet e demokracisë, lënë për të dëshiruar edhe pse mund të kenë aspektin e shprehjes së lirisë, në plan të parë më të madh. Prodhimet e tjera mbeten variante, si rezultat i arsyetimit përfundimtar për poetikën lasgushiane, e gjitha kjo, për të lartësuar artin e tij, si krijues kombëtar. Duhet thënë, se për të gjitha krijimet kinematografike lasgushiane, ka kohëzgjatje të ndryshme. Sipas mendimit tonë, në shumësinë e tyre preferohen fotografi të poetit, pamje filmike të Pogradecit, liqenit të Ohrit apo plane të kryeqytetit, Tiranës. I rrallë është takimi me poeten greke Rita Bumi Papa, takim i filmuar dhe i pasqyruar në filmin dokumentar të Mevlan Shanajt, i xhiruar në Volorekë, Pogradec. Sqaroj gjithashtu se këto filma dokumentarë, pasi i kë parë, shtojnë dëshirën e lexuesit për poezitë e tjera të poetit. Shikuesi, njëherazi edhe lexues i veprës së tij, është i lirë ta bëjë receptimin e tyre në bazë të dëshirës personale ose më saktë duke u nisur nga ilustrimet filmike, që ato ofrojnë në formë të përshkallëzuar. Shikuesi i parë filmografik, që vjen si rezultat i analizës kronologjike, filmike në vite, për poezinë e L. Poradecit, e ka më të lehtë të arrijë në përfundimin e prodhimit më të mirë, pasi e përcakton atë, mbi bazën e krijimit të parë dokumentar. Në këtë formë vijnë edhe variantet e tjera filmike. Një dokumentar i mirë e arrin përsosmërinë te puna e gjithë ekipit realizues të filmit. Vetë Lasgushi thotë: *“Poezija duhet të shprehi jetën-me simbolin poetik-në maksimumin e saj, në potencialin absolut të saj. Atëherë poezija është e përsosur, perfekte. Kur s’është e përsosur: kur s’ka fuqinë supreme, poezija nuk se është e metë, po s’i përshtatet, s’i përputhet potencialit moral të jetës, pra s’është poezi, nuk përfaqëson vitalitetin integral të jetës dhe të botës, poetncialin absolut”*.⁴³⁷

Nën këtë mendim prej mjeshtri krijues, Lasgush Poardeci arriti përsosmërinë e vargut, vetë magjinë e poezisë brilante. Jo të gjithë poetët e

⁴³⁷ L. Poradeci, *Vepra I, Poezia*, Shtëpia botuese “albPaper”, Tiranë, 2009, f. 7

letrave shqipe e kanë pasur këtë mani krijuese, që për një pjesë ishte kthyer në manjakëri. Pjesa tjetër krijonin më lehtësisht vargjet e tyre. Herë me vlera dhe herë pa vlera artistike dhe ideore, ata krijonin. Përkundër, shtërgu i fundit, në vitet '30, mbolli ndër lexues, lëndën e tij poetike me materie nga jeta, e përjetësoi atë në koherencë. Më pas ai heshti gjatë, duke folur vetëm përmes veprës që shkroi. Janë të gjitha këto etapa që pasqyrohen pjesërisht edhe në filmat dokumentarë të krijuar për të, në vite.

Lasgush Poradecit, më së miri, mund t'i ndërtohet një skemë përfundimtare të këtij rrugëtimi në filmin dokumentar shqiptar, përpjekje që përmbillet sukseshëm me veprën poetike, që lartësohet në artin e shtatë dhe televizion, si pjesa më brilante.

Filmat, shihen dhe interpretohen nga shijimi personal dhe i lirë, në gjykimin e çdo shqiptari dhe jo vetëm, në çdo kohë. Finesa e tij prej mjeshtëri edhe në dokumentar, krijon iskra bukurie që mbajnë erë Shqipërie. Sepse më periudhën e realizmit socialist të bësh art, -veçon Kuteli, është punë e vështirë: *“Profesionizmi në letërsi, në vëndin tonë, është, hë për hë, një rrugë vuajtjesh, buka e tij është e hidhur. E hidhur, them, për atë që s’di marifete dhe hipokrizira. Terreni i letërsisë është një tokë tek gëlojnë gjarprinjtë. Të vrasin shokët, se ju bën hije. Dhe kur nuk u bën hije do të thotë se nuk je i zoti për letërsi”*.⁴³⁸ Ndërkohë era e ndryshimeve solli të tjera dimensione dritëparjesh, me variante filmash dokumentarë në medime televizive private...

Lasgush Poradeci, edhe pas botimeve të dy veprave poetike, ka pasur horizontin e tij pritës. Po njëlloj ka ndodhur edhe me filmin dokumentar për të. Shikuesi njëherazi edhe lexues i veprës së tij poetike, e vërteton më së miri përpjekjen për të realizuar filma të tillë. Horizonti shoqëror i pritjes, ishte në vetvete horizonti social i kohës. Gjithmonë njerëzimi ka qenë i prirur për të prekur diçka të re. E vështruar kjo në aspektin historiko-shoqëror, duhet thënë se edhe opinioni i lexuesve-shikues dhe anasjelltas, kishte horizontin e pritjes. Rrjedhimisht, përvoja estetike e publikut lexues ishte e gatshme të pranonte poezinë e Lasgush Poradecit edhe përmes ekranit filmik. Kjo risi progresive e

⁴³⁸ M. Kuteli, *Testamenti i Mitrush Kutelit*, Gazetën “Shqip”, Tiranë, 30 prill 2009, f. 20.

horizontit letrar u pranua si shije estetike.

Filmat e parë rreth veprës së Lasgushit janë krijime sporadike. Vlen të theksojmë se ato e kanë përmbushur me sukses misionin e tyre dokumentar, duke lavdëruar prezencën e poetit ndër shqiptarë. Edhe kjo shije estetike, parë në këndvështrimin e shikuesit, duhet marrë në konsideratë. Duhet thënë, se në vitet e demokracisë, në Shqipëri i prodhuan shumë kronika televizive, por dhe disa filma dokumentarë me metrazh të shkurtër dhe të gjatë. U prodhuan edhe disa pjesë dosierësh të ndryshëm, në kuadër të disa cikleve televizivë, në televizione kombëtarë dhe lokalë. Edhe këto mbeten një mikser, që mbartin në veteve filmimet e pakta të jetës së poetit, marrë nga Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit. Recitohen vargje nga vepra poetike e Lasgushit, ditarët e tij, publicistika apo ilustrohen ato, në pjesën më të madhe me foto të poetit, dorëshkrime apo filmime të qytetit të Pogradecit dhe Tiranës. Me sa duket ky është një proces që do vijojë edhe në të ardhmen, për jetën dhe veprën e lirikut të madh kombëtar, Lasgush Poradecit. Duhet thënë se ende nuk është bërë një film dokumentar që të fokusohet fillim e fund, në jetën dhe veprën e poetit të pavdekshëm...

Filmografia⁴³⁹:

Titulli: “Lasgush Poradeci”

Skenari: Dhimitër Xhuvani; Kopi Kçykyku

Regjisor: Endri Keko

1976, Tiranë, prodhim i Kinostudio “Shqipëria e Re”.

-Në film janë përdorur vargje poerike nga Lasgush Poradeci të recituara nga artisti i popullit Kadri Roshi, si dhe filmime reale nga jeta e poetit.

Përshkrimi: Pamje e liqenit të Pogradecit. Pamje e bregut te liqenit dhe mjellmat që lahen në të. Lasgush Poradeci duke parë në liqen. Lasgushi duke shëtitur në rrugët e Pogradecit. Rrugicë e vjetër e Pogradecit. Ai shëtit në të me mikun e tij Thoma Angjele. Pamje e shkollës së parë shqipe në Pogradec. Pllakati perkujtimor i saj. Fotografi të Lasgushit në rini. Vajzat duke mbushur ujë në burim. Vjersha të ndryshme të tij, të recituara. Panoramë fshati. Rrugicë fshati. Gazetat që bëjnë fjalë për jehonën e vjershave të Lasgushit para çlirimit. Vjersha për Pavarësinë.

⁴³⁹ I. Shyta, *Bibliografi e arsyetuar*, Dija Poradeci, Pogradec, 1999, f. 285-286

Veprat e huaja që ka përkthyer poeti. Pamje e varrezave të dëshmorëve. Vjersha për Reshit Çollakun. Lasgushi duke punuar, dorëshkrimet e tij. Lasgushi midis nxënësve duke biseduar me ta.⁴⁴⁰

Titulli: “Lasgush Poradeci”

Skenari dhe regjia: Mevlan Shanaj

1981, Tiranë, prodhim i TVSH.

-Në film janë përdorur vargje nga Lasgushi si dhe filmime reale nga jeta e poetit në Pogradec.

Përshkrimi: Në këtë film Lasgushi reciton vetë poezitë “Baladë për Muharrem Çollakun” dhe “Testament”. Xhirimet e Lasgushit, më së shumti janë bërë në Pogradec dhe Volorekë të Pogradecit. Plane filmike nga takimi i tij me poeten greke Rita Bumi Papa.

Titulli: “Nositi”

Skenari: Petrit Ruka

Regjia: Edmond Topi

1989, Tiranë, prodhim i Kinostudio “Shqipëria e re”.

-Një film kushtuar Lasgush Poradecit. Në film, për ilustrim janë shfrytëzuar vargje nga krijimtaria poetike e Lasgush Poradecit. Përdoren gjerësisht edhe fotografi të Lasgushit.

Përshkrimi: Pogradec. Panoramë e liqenit. Një vajzë në sediljen e trenit shikon liqenin e bisedon me shokun e saj mbi Lasgush Poradecin. Foto të Lasgushit. Stoli ku rrinte Lasgushi. Recitohen vargje të tij. Retrospektivë e varrimit të Lasgush Poradecit. Ismail Kadareja flet sinkron mbi jetën dhe veprën e tij. Materiale arkivale të Lasgushit. Pamje e liqenit. Gjethet që bien. Portet e vajzës. Portet e Lasgushit. Vajza bisedon me Sterjo Spassen për jetën dhe veprën e poetit. Vajza duke shëtitur me Ismail Kadarenë, i cili, i bën një vlerësim të sintetizuar veprës së Lasgushit. Pamje nga kabineti i Lasgushit, raftet e librave. Pamje e liqenit, dallgët e tij shoqëruar me recitim të vargjeve të poetit. Pamje pylli. Vajza ecën me një shok të Lasgushit që e vlerëson atë dhe si përkthyes. Pamje e shkrimeve dhe foto të tij. Përkthime të Lasgushit. Pamje e librave. Lasgushi duke biseduar me shokët. Përkthime të tij

⁴⁴⁰ <http://www.aqshf.gov.al/arkiva-131-2.html?movie=736>

nga Majakovski, Gëtja, Hajne, Brehti, Eminesku, Viktor Hygo etj. Vajza vazhdon bisedën me Kadarenë, lexon poezitë e tij, shikon televizor. Portreti i Lasgush Poradecit në pikturë, librat e tij. Një moment baleti shoqëron poezitë e tij. Inaugurimi i pllakës përkujtimore të Lasgushit. Vajza vendos një buqetë me lule në varrin e poetit të madh. Portreti i Lasgushit. Lexojnë tekstin: Timo Flloko, Marjeta Ljarja.⁴⁴¹

Titulli: “Trashëgimi”.

Skenari dhe regjia: Nadire Buzo

1999, Tiranë, prodhim i Tv “Klan”.

Përshkrimi: Filmi është i ndërtuar mbi vargje të vetë Lasgush Poradecit, marrë nga vepra e tij letrare. Autorja në film, rikrijon imazhin e poetit dhe heronjve lirikë të veprës së tij poetike. Ilustrohet imazhi i poetit me konturet e një aktori figurant dhe qenin e tij.

Titulli: “Lasgush Poradeci- Patriarku i lirikës shqiptare”

Skenari dhe regjia: Monika Stafa

2018, Tiranë, prodhim i Top-Channel

“Exclusive”emisioni i përjavshëm në TCh.

Përshkrimi: TCH shkoi në Pogradec, në qytetin e poetit të dhimbjes vetjake, Lasgush Poradecit, një prej njerëzve më trillanë të historisë së letrave në Shqipëri, të përkujtojë me shumë dashuri ditëlindjen e 119-të të tij. Kërkoj arsyet nga më të ndryshmet dhe para se të bëj shpjegime të mëdha estetike, mendoj për shkaqet e mëdha shoqërore që sollën një Lasgush. Mendoj për Shqipërinë e viteve ‘20-‘30, 15-20 vjet pas Pavarësisë, kur djelmëria shqiptare u trondit nga poezia e Lasgushit. – thotë autorja.⁴⁴²

Titulli: “Dosja K”,

Prodhim i Report TV. Pa autor.

Përshkrimi: Në të jepet historia e persekutimit të Lasgush Poradecit, e dëshmuar në ditarët e poetit. Vajza e poetit Lasgush Poradeci rrëfëhet

⁴⁴¹ http://www.aqshf.gov.al/arkiva-kerko_1.html?movie=636&category=2&title=&screenwriter=&description=Lasgush%20Poradeci

⁴⁴² <http://top-channel.tv/2018/12/30/son-te-ne-exclusive-nje-dokumentar-per-lasgush-poradecin/>

në emisionin Dosja K, në Report TV. Flet vajza e vogël e tij, Marie Gusho. "...Babi ishte një qenie e jashtëzakonshme. Kur shkante mbra-pa kalasë, thoshte: "Unë e shikoj që ata më gjurmojnë. Po le të gjurmojnë. Ngaqë futem nëpër shkurreta, ata nuk më ndjekin dot, atje ku futem unë..", sepse ata rrëzoheshin...Sidoqoftë ata burra misteriozë, të kamufluar në mënyra nga më të çuditshmet nuk do t'i shqiteshin poetit. Ata do të gjenin mënyrën t'i hynin deri në shtëpi, madje edhe në bodrum, por edhe në bibliotekën e tij, ku ai ruante një arkivë të pasur me dorëshkrime, foto e dokumente të shumta. Çfarë shkruhej vallë në ato dorëshkrime në gjuhë të huaja? Rreth kësaj pyetje silleshin dyshimet dhe planet e survejimit në zyrat e Sigurimit të Shtetit. "Asgjë nuk i shpëtonte Sigurimit të Shtetit në atë kohë. Të dukej sikur gjërat ecnin normal dhe sikur ishin të qeta, por Sigurimi i Shtetit absolutisht donte të dinte se çfarë ndodhte në shtëpinë e këtij njeriu. Dhe kishte dëgjuar se ky njeri paska një arkiv, por sinqerisht, ata as që e dinin se çfarë ishte ky arkiv. Sikurse ka çdo njeri i kulturuar, sikurse kanë pasur edhe shumë njerëz të tjerë të kulturuar në Shqipëri, arkivin e vet, ashtu sikurse ka çdo familje, ato ishin dokumente, fotografi, të mbledhura gjatë gjithë viteve të jetës së babit, të cilat ishin pasuri kombëtare, nuk hidhnin dritë vetëm mbi jetën e babit. -shprehet e bija, Maria.⁴⁴³

Titulli: "Lasgush Poradeci, gjeniu me pilulë cianuri në xhep"

Përgatiti: Ferdinand Dervishi

2019. Prodhim i Abc News

Përshkrimi: Shekullin e shkuar ne shqiptarët kemi pasur një poet që nuk e kemi kuptuar si duhet, sidomos vlerën e artit të tij. Ishte Lasgush Poradeci, i cili shkroi vargje që depërtuan aq thellë në shpirtin e shqiptarëve saqë ata vendosën, pa u marrë vesh me njëri-tjetrin, që një qytet të tërë ta quajnë: "Pogradeci i Lasgushit". Lasgush Poradeci e pati kulmin e krijimtarisë në mesin e viteve '30, të shekullit të shkuar, duke firmosur poezi nga ato që shkruhen vetëm njëherë. Poezitë e tij "Vdekja e Nositit", "Poradeci" apo "Trashëgimi" e ndonjë tjetër, për nga vlerat e mesazhi, i kapërcejnë lehtësisht kufijtë e Shqipërisë, duke u renditur në nivele dinjitoze të letërsisë më të mirë europiane apo qoftë

⁴⁴³ <https://shqiptarja.com/video/lasgush-poradeci-histori-persekutimi>

botërore. Por, Lasgush Poradeci shkroi poezi deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore dhe më tej u tërhoq. Ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri kishte sjellë një klimë krejtësisht të papërshtatshme për poetin e madh. Lasgush Poradeci, edhe pse shumëkush, nisur nga gjimnazistët që studjonin poezinë e tij, e dinin të vdekur, jetoj deri në vitin 1987, duke u përballur me jetën e vështirë dhe sidomos me çuditë e letërsisë së realizimit socialist, të cilat nuk linte asnjë rast pa i qesëndisur. Por në jetën e tij kishte edhe një tjetër anë të medaljes. Lasgush Poradeci, thellë në qenien e vet jetonte me një frikë e ankth i pazakontë. Duke e lëvizur veten në drejtim të kundërt të rrymës, duke fshikulluar lart e poshtë çuditë e regjimit komunist, duke parë se si të njohur e miq përfundonin burgjeve nën akuzën e agjitacion-propagandës, duket edhe atë kishte nisur ta mundonte frika, një situatë së cilës ai i ishte përgjigjur me një zgjidhje eventuale dramatike. Vaso Samsuri, një nga miqtë e tij të ngushtë rrëfen në film, sesi poeti i madh mbante me vete një pilulë cianuri që ta përdorte për çdo rast për të helmuar veten, nëse policia politike e kohës do e arrestonte... Pikërisht, një numër detajesh edhe interesante, edhe të pabesueshme, nga jetën e poetit të madh të liqenit gjatë periudhës së komunizmit, sjell dokumentari më i ri i ciklit Abc Story...⁴⁴⁴

BIBLIOGRAFI:

- L. Poradeci, *Vepra I, Poezia*, Shtëpia botuese “albPaper”, Tiranë, 2009
M. Kuteli, *Testamenti i Mitrush Kutelit*, Gazetën “Shqip”, Tiranë, 30 prill 2009
I. Shyta, *Lasgush Poradeci. Bibliografi e arsytuar*, Dija Poradeci, Pogradec, 1999

⁴⁴⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=FkgkVnu5bNg>

FILOZOFIA NË POEZINË E LASGUSH PORADECIT

I₁. Lasgushi dhe filozofia

U bënë disa dhjetëra vjeçarë që poezia e Lasgushit është botuar e tëra në një vëllim (1990) nga Shtëpia Botuese “Naim Frashëri. Më vonë shtëpia botuese “Onufri” e ndonjë tjetër e botuan krejt veprën e tij në poezi e në prozë. Tani së fundmi, dorëshkrimet e digjitalizuara të këtij poeti në Arkivin e Shtetit janë vënë në disponim për këdo që dëshiron të njohë krijimtarinë e Lasgushit. Vepra e pjesëshme ose e plotë e poetit të madh vijon të botohet edhe sot në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e gjetkë. Letërsia lasgushiane vijon të begatohet si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë saj edhe me një sërë monografish kushtuar jetës dhe veprës së Lasgushit, madje numri i tyre po rritet shpejt.

Studiues të huaj që merren me letrat shqipe kanë nisur të shkruajnë edhe për poezinë e Lasgushit. Në to dhe në artikuj të ndryshëm studimorë të historianëve të letërsisë, kritikëve letrarë, gazetarëve, po del në pah edhe përmasa filozofike e veprës poetike të Lasgush Poradecit. Mund të përmend p.sh: z. Sabri Hamiti, z. Eldon Gjika, z. Luan Topçiu e ndonjë tjetër. Ndërkohë ende nuk kemi pasur qasje nga studiues të filozofisë. .

Për të kuptuar marrëdhëniet e një poeti si Lasgushi me filozofinë duhet të hulumtojmë për kulturën e tij të përgjithshme dhe atë filozofike në veçanti. Llazar Gusho si rrallëkush ka pasë aftësi të mëdha, ai zotëronte dhjetë gjuhë në atë shkallë sa edhe thurte poezi në to (frëngjisht, greqisht, gjermanisht, rumanisht etj). Si mjeshtër i poezisë shqipe ka gdhendur vargje në të.

Ai kishte në radhë të parë kulturën shqiptare pasi jetoi në Shqipëri e midis shqiptarësh në vendet e huaja, një kulturë popullore dhe atdhetare. Mandej ai u pajis me kulturën greke, si në shkollën fillore në Shqipëri ashtu edhe në Greqi, në Liceun Francez të atjeshëm. Lasgushit nuk i mungonte as kultura latine, që e nisi në Liceun Francez me shkrimtarët romakë (Ciceroni, Virgjili, Seneka etj), të cilët i lexonte edhe më pas. Letërsia romantike dhe iluministe frënge ishte gjithashtu pjesë e

programit në Liceun Francez në Greqi. Më pas mësoi vetë italishten, u njoh me shkrimtarët e poetët italianë (Dante etj) dhe filozofë (Viko, Kroçe, Xhentile etj).

Në Liceun Vllah të Manastirit, ku kreu semimaturën dhe gjatë qëndrimit në Rumani, ku Lasgushi ndoqi disa fakultete në Universitetin e Bukureshtit, u njoh me kulturën rumune (letërsi, art, histori). Gjatë dhjetë viteve të qëndrimit në Austri (Vienë e Grac) ai u pajis me kulturën gjermane, që zuri një vend të veçantë në jetën e Lasgushit. Ai, pra, sikurse kolegët e tij në Austri e Gjermani morën edhe “*dojç*” kulturën. Është me interes që poeti ynë e studioi sanskritishten dhe lexoi filozofët që shkruajtën në këtë gjuhë të lashtë të Indisë. Kështu u njoh si askush tjetër me kulturën antike indiane, fetë e tyre (Brahmanizmin, Induizmin, Budizmin).

Duhet përmendur përkthimet e Lasgushit nga anglishtja dhe rusishtja, por ndoshta edhe nga gjuhë të tjera sllave. Kultura lindore osmanoturke, perse dhe arabe nuk mund të mos gjente vend në njohuritë e gjera të Lasgush Poradecit. Për të nuk ishin të panjohura kryeveprat në këto gjuhë, sidomos poezia perse. Më tej, poeti ynë i shquar u interesua edhe për kulturën e lashtë (kineze, egjiptiane, babilonase, sumere). Duhet thënë se këto kultura, shumicën, ai i ka prekur në gjuhët origjinale të tyre!

Etja e madhe për dijet bashkëkohore i siguroi njohuri historike, fetare (judeo-kristiane, islame etj.), filozofike, letrare, artistike e shkencore. Kur ishte 20 vjeç dhe jetonte në Rumani, Lasgushi thotë se pat shfletuar edhe një broshurë për teorinë e relativitetit të Ajnshtajnit.

Kur Mitrush Kutelit i thanë dikur në shtëpinë botuese “Naim Frashëri” se përkthen shpejt, ky ia priti: *Nuk përkthej unë, por kultura ime enciklopedike!*

Të njëjtën gjë mund të themi për Lasgushin, falë kulturës së tij të pasur filozofike. Vargjet e tij, poezia e poemat përmbajnë një dëndësi mendimi filozofik, që përfshin vedat indiane në lashtësi, vjen në Mesjetë e pastaj iluminizmi francez e filozofia klasike gjermane, deri në filozofinë e shekujve XIX dhe XX. Sanskritishten, veç E. Çabejt, Shaban Demirajt, Petro Zhejit dhe Idriz Ajetit në Kosovë, zor se mund ta ketë ditur njeri si Lasgush Poradeci!

Në një bisedë me z. Petraq Kolevica, duke treguar respekt për filozofinë antike greke, ai më tha: Shtatëqind vjet me radhë Greqia e Vjetër nxori filozofë. A ka ndodhur kjo me një vend tjetër në një kohë tjetër? Jo!

Për Mesjetën më tha: “Përkthimi bën kulturën. Përkthimet me durim që bënë murgjit nëpër manastire nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja na sollën kulturën e lashtësisë...E, ja, tërë këtë kulturë ata murgjit e përvuajtur të mbyllur nëpër manastire na e dhanë të gatshme falë përkthimeve” Diku tjetër ai përmend filozofinë romake, si Sexstus Empirikun, Senekën etj.

Mjafton të lexosh romanin e Umberto Eco-s “Emri i Trëndafilin” (Dituria, Tiranë, 2012) për të marrë vesh se murgjit e Urdhërit Benediktin kanë vepruar në mbarë Europën. Në trojet tona ata punuan në Shqipërinë Veriore deri në Novobërdë të Kosovës, ku ngritën 30 kuvende benediktine, që drejtohen nga murgj shqiptarë dhe të huaj (italianë, gjermanë, raguzianë). Kuvende të tilla ka pasur edhe në Jug (Përmet, Këlcyrë). Një degëzim haset në Kabash të Pukës (Cisterianët). Me parullën “Lutu dhe Puno!” këta murgj kanë qenë një vatër diturie në mes malesh...

Në fund të shekullit XIV, Urdhëri Domenikan pati meritën se ngriti Universitetin e Durrësit. Me të 25 doktorët e tij të shkencave, gjë e rrallë për atë kohë, ky universitet rrezatoi edhe në Europë. Rektor i universitetit ishte vëllai i princit arbër Karl Topia, Domenik Topia. Urdhërit Domenikan i përkiste edhe filozofi teolog i famshëm i Mesjetës Thoma Akuini. Skëndërbeut i kanë shërbyer anëtarë të Urdhërit Domenikan si vëllezërit Gjon e Pal Gazulli dhe Pal Engjëlli. Urdhëri në fjalë kishte në Durrës një Kuvend të vetin.

Në Shqipëri kanë zhvilluar veprimtari katër urdhëra: murgjit benediktinë, domenikanë, françeskanë dhe jezuitë. Dy të parët iu kundërvunë sundimit sllav, ndërsa dy të tjerët pushtimit osman. Ata ngritën në trojet tona vatra diturie që i shërbyen arsimimit dhe ndriçimit të popullit tonë në kohët e egra e të errëta të pushtimeve të huaja.

Në një lice laik në Athinë që drejtohej nga vëllazëria e fretëve benediktinë mauristë të Lionit të Francës ka studiuar edhe Lasgushi ynë.

“Ishin përkthimet e murgjëve që përgatitën Rilindjen Italiane që e quajnë më kot Renaissance frëngjisht se Franca s’bëri gjë, Italia e solli Rilindjen (europiane- shënimi im)”- thotë Lasgushi.

A e ka njohur iluminizmin francez Lasgushi? Padyshim që po! Ai kreu një lice francez. Në Rumani dhe në Austri i dha provime për doktoraturë historinë e filozofisë të shekullit XVIII. Në bibliotekën e tij ndodhen vepra të enciklopedistëve francezë (Volter, Russoi, Didëro, Dalmber), Larousse të ndryshëm që ai s’i hiqte nga duart.

Sigurisht njohuritë e pasura filozofike të Lasgush Poradecit do të pasqyroheshin në krijimtarinë e tij letrare si poet. Vend të veçantë do të zinte filozofia klasike gjermane me përfaqësuesit e vet më të shquar (Kant, Fihte, Sheling, Hegel, Shopenhauer, Niçe etj). Në vargun e filozofëve përfshin ata të shekullit XIX dhe XX me rryma të tilla si pozitivizmi, neopozitivizmi, marksizmi e pragmatizmi, frojdizmi e intuicionizmi, ekzistencializmi dhe pragmatizmi.

I₂. Filozofia te vepra e Lasgushit në përgjithësi

Duhet të marrim parasysh disa gjëra kur flasim për lidhjen e veprës së Lasgushit me filozofinë.

Disertacioni filozofik për doktoraturën mbajtur në Grac

Cikli i poezive filozofike

Poezitë e shkruara për dashurinë në përgjithësi

Dy poemat filozofike “Kamadeva” dhe “Ekskursion i teologjik i Sokratit”

Në punimin e doktoraturës “Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullore atdhetare” ai merret me studimin e veprës së kryepoetit rumun Mihail Eminesku (mbase me prejardhje shqiptare sikurse thotë Dhimitër Pasko). Shqyrtimi bëhet nga pozita filozofike dhe drejtuesit e tij janë profesorë të filozofisë.

Llazar Gusho mori diplomën e doktorit për shkencat filologjike. Ai i shtoi studimit një kapitull ku shfaqet ndikimi filozofik i Kantit. Poeti rumun në fakt ka studiuar në Vienë dhe Berlin, fillimisht për filozofi, mandej për drejtime të tjera. Koha që Lasgushi qendroi në Vienë e Grac karakterizohej nga një atmosferë filozofike gjë që ndikoi në mbrujtjen e Lasgushit dhe Emineskut. Vetë Lasgushi përmend dy provime formu-

ese, një për filozofinë e Kantit dhe një për historinë e filozofisë të shekullit XVIII.

Në dy vëllimet poetike “Vallja e Yjeve” (1933) dhe “Ylli i Zemrës” (1937, 1939), posaçërisht poezitë “Vallja e Përjetësisë” dhe “Zemra e Përjetësisë” spikat boshti filozofik, që rrezaton në gjithë poezitë e tjera. Dhimitër Pasko, Andrea Varfi e të tjetër studiues (Eldon Gjika, Luan Topçiu) tregojnë burimet që kanë ndikuar gjerësisht në ciklin filozofik të poezive të Lasgushit:

Kanti

Përkimet me filozofinë e lashtë indiane (hinduizmin dhe budizmin) Teozofia (Helena Blavatski dhe Rudolf Shtajner). (Vepra “Teozofia” është tashmë edhe në shqip)

Pesë poezitë e këtij cikli: ”Lënda e Jeta”; “Fryma dhe Qëllimi”; “Ndjenja dhe Njeriu”; “Njeriu dhe Zoti” dhe “Përjetësia” përbëjnë një poemë më vete sipas Mitrush Kutelit, që trajton lëndën, materien, shpirtin, ndjenjat, Zotin dhe Përjetësinë, kategori këto filozofike.

Lasgushi na jep, nëpërmjet artit mjesh tëror poetik, një sintezë të konceptimit të vet për zhvillimin psikofizik të jetës. Kjo sintezë përmban e i kalon njoftimet e një biblioteke të tërë librash filozofikë.

Një burim tjetër për ciklin filozofik është edhe misticizmi sufist i Lindjes apo misticizmi islamik.

Doktori i shkencave letrare Eldon Gjika më 2010 dhe një profesoreshë universiteti, Brikena Smajli, më 2019 trajtojnë këto ndikime në poezinë e Lasgushit.

Edhe filozofi klasik gjerman Frederik Holderin, mik i ngushtë i Hegelit, që ka studiuar Empedoklin, ka ushtruar ndikim të madh te Lasgushi, që veprën e tij e mbante dhe e shfrytëzonte në bibliotekën e vet.

Duke kaluar në poezitë e dashurisë, vepra e Platonit “Simpoziumi apo Elohzi i Dashurisë” duket se ka ndikuar dukshëm. Dhe poezitë e dashurisë përbëjnë shumicën! Sipas kritikut Ali Aliu më tipikja është “Vallja e Yjeve”. Aty ka përkime me poezitë e Pjetër Bogdanit dhe Hasan Tahsinut mbi gjithësinë, në kuptim kozmogonik.

Lasgushi ka qenë mendjehapur, i kulturuar dhe i apasionuar pas diturisë. Poezitë e veçanta për përjetimet vetiake dashurore mund të shihen edhe si raste të konkretizimit të dashurisë abstrakte, nën ndikimin

platonian. Me të drejtë, Larousse francez e quan Lasgush Poradecin një poet-filozof, sepse në poezinë e Lasgushit pasqyrohet edhe kultura e thellë filozofike e tij.

Që në lashtësi, filozofët (p.sh. Lukreci) i kanë shprehur idetë e tyre filozofike në vargje. Këtë traditë me sa duket e vijon edhe Lasgushi. Mbetet që ky tipar të hulumtohet më tej në të ardhmen.

I3: Lasgushi ndërmjet katër poetëve kombëtarë dhe Bodlerit francez

Lasgush Poradeci përpiqej të arrinte cilësinë më të lartë në poezi. Ai e adhuronte “Bilbilin e Shqipës”, Naim Frashërin, të cilit i kushtoi dy poezi dhe tre artikuj; kryepoetin rumun Mihail Emineskun, të cilit i kushtoi studimin e doktoraturës kur ishte në Austri dhe përktheu në shqip poezi të Emineskut; kryebardhin gjerman Gëte nuk e hiqte nga goja dhe e njihte me rrënjë krijimtarinë e tij në origjinal; si dhe poetin e parë të Greqisë së kohës së re Dionis Solomos. Vetë e pohon se e njihte shumë mirë këtë poezi dhe vetë Dionisin.

Pra, kemi një Lasgush ndërmjet katër poetëve kombëtare të vendeve ku u shkollua. Fridrih Shileri, poet-filozof e përmend me respekt Sokratin, por edhe poeti francez Charl Bodler, si përfaqësues i simbolistëve, në librin “Brenge e Parisit”, në njërën prej poemave të tij në prozë (Kur rrahim të varfërit) flet për Sokratin dhe Demonin si mbrojtës i tij. Ndërkohë Bodleri flet për Demonin e vet i cili ndryshe nga ai i Sokratit, e këshillonte në veprimet e veta.

Sipas Bodlerit, filozofët në Athinë mblidheshin te Porta e Portikës. Lasgushi e njihte veprën e Bodlerit “Lulet e së keqes”, po ashtu jetën dhe mjedisin e tij dhe pati jo pak ndikime prej tij, sikurse edhe prej katër poetëve kombëtarë të sipërpërmendur.

II: Murgu iluminist i liqerit

Lasgush Poradeci dhe poema e tij “Ekskursion teologjik i Sokratit” (1975)

Prof. Skënder Luarasi i thosh një ditë prof. Eqerem Çabejt:

“Me Lasgushin ka ndodhur diçka e çuditshme. Kur ishte i ri, bota thoshin ‘Po vdes, po vdes, Lasgushi. Tashi, që është plak thonë. “More, po

rron, po rron Lasgushi! Ndërsa mua më duket se Lasgushi është bërë i përjetshëm. .”

Dhe me të vërtetë “murgu iluminist i liqerit” siç e kanë quajtur dashamirët, për gati gjysmëshekulli, krijoi dy poema si dy monumente përjetësie për veten dhe si dy kulte që duhen të falen shqiptarët: poemën “Ekskursion teologjik i Sokratit” me kultin e Njeriut në qendër dhe “Kamadevën” (perëndi e lashtë indiane e dashurisë) me kultin e Dashurisë. Pra shqiptarët, pasardhësit e pellazgëve të lashtë hyjnorë, që u shfaqën që në agim të njerëzimit, duhet të mos u ndahen këtyre dy kulteve që sigurojnë vazhdimësinë e racës njerëzore e janë të lidhur fort njëri me tjetrin.

Mesazhi është krejt i qartë: shqiptarët, në s’i vënë një emër të tyre perëndisë së dashurisë sikurse te grekët e romakët, patën një perëndi që s’e ka asnjë popull në botë për diturinë me emrin kuptimplotë URIDIA (Uri për dije). Edhe Lasgushi, në gjurmë të popullit të vet, ka qenë sikurse shprehet vetë, “një krimb librash” që e donte dijen fort.

Studiuesja shkodrane Brikena Smajli, doktore e shkencave letrare, në një libër të saj shkruan:

“Ai (Lasgushi) është poeti më i plotësuar nga pikëpamja e edukimit, por edhe nga më aristokratët për kulturën e tij poetike...ka në qendër edhe një hierarki kulturore e kuptimore, ka vetëdijen dhe njohjen e thelluar të kulturës së Europës dhe më gjerë, që nga Vedat e deri te autorët bashkëkohorë. Si rrjedhojë edhe leximi i poezisë së tij është një lexim i kulturës së njerëzimit”

“Ndryshe nga autorët francezë (këtu ajo ka parasysh Charl Bodlerin me të cilin e krahason Lasgushin), cilësia e të cilëve mbi përkueshmërinë sjell një revolucion në poezi, ‘revolucioni lasgushian’ në poezinë shqipe ende pret të ‘projektohet’”.

Rrezatimi i murgut iluminist të liqerit, vizionar si ai, ishte jo për dje e për sot por për të ardhmen, për shekuj. Dy poemat e fundit që i ‘gdhendi’ dhe i ‘limoi’ si ai janë dy gardianë që përcjellin mesazh për të ardhmen e shqiptarëve e të njerëzve në përgjithësi. Prandaj s’është e rastit që për një poemë të veten ai zgjedh filozofin më të madh të gjithë kohëve, “babanë e filozofisë” e të filozofëve, Sokratin, që la gjurmë të pashlyeshme në historinë e filozofisë e të mbarë njerëzimit. “Murgu”

Lasgush ishte e do të mbetet një njeri me ideale të mëdha të mishëruar në jetën e veprimtarinë sa qe gjallë, ashtu edhe në poezinë e veprën e tij, për t’u përjetësuar. .

Do shqyrtoj vetëm poemën “Ekskursion teologjik i Sokratit”. Autori nuk merret me atë pjesë që ka hyrë në historinë e filozofisë e të letërsisë me titullin “Apologjia e Sokratit”, ku ai mbrohet vetë gjatë gjyqit. Pas asaj mbrojtje u dha dënimi me vdekje me pirje helmi. Me titullin e poemës Lasgushi kap jo momentin e fundit por jetën e Sokratit, bën një ekskursion në të. Po pse teologjik? Sepse Sokrati u akuzua për propagandë kundër fesë politeiste zyrtare të shtetit të Athinës së Vjetër. Ishte akuza kryesore. Me fantazinë e autorit Lasgush, në poemë dalin të palarat e shoqërisë së kohës. Ajo për të cilën e akuzuan Sokratin, ishte thjesht një pretekst, pasi vetë paria laike dhe fetare ishin zotmohuesit e parë, pastaj vinte populli i thjeshtë që besonte në fe, duke ndjekur udhëheqësit e vet politikë, juridikë e fetarë (shpirtërorë).

Duke u shkuar pas këtyre shkelësve të fesë zyrtare që ishte edhe ideologjia kryesore, populli padashur binte vetë në zotmohim. Kur të dilte në shesh ky mashtrim, parinë hipokrite, dallkauke që mendonte vetëm për sundimin, fronin, karrigen e vet, dikur, do ta merrte lumi.

Ndërkohë këtë sistem drejtues mashtrues që u siguronte jetesë mes të mirash, Sokrati po e prishte dhe rrezikonte ta shëmbte. Prandaj u dha dënimi më i rëndë- vdekja. Sokrati pranoi të viktimizohej e martirizohej nga ky sistem shfrytëzimi i pashpirt, që me shembullin e vet të bëhej një simbol për luftën kundër sundimtarëve që mbanin pushtetin laik dhe fetar, sikurse edhe ndodhi më pas. Sokrati u vetësakrifikua me pasoja edhe për familjen e vet (për të tre fëmijët), duke mbetur përjetësisht martir i filozofisë.

Dikush e quan, madje, “paraardhës i Krishtit”. Si person historik i gjallë, me jetën e veprimtarinë e vet, Sokrati u bë fanar ndriçues deri në ditët tona. Emri i tij erdhi deri sot ndonëse nuk ka lënë vepra të shkruara. E famshme është thënia e Sokratit te dialogu i Platonit “Fedoni”, që trajton momentin kur Sokrati piu helmin e nxjerrë nga bima e kukutës: “Kur të vini pas meje, mendoni më pak për Sokratin e më shumë për të vërtetën!” Sokratin na e kanë sjellë deri në ditët tona si filozof dhe mjeshtër i mendimit:

Komediografi i shquar Aristofani, pastaj Polikrati, Ksenofoni, Platoni me 28 dialogët (sidomos Apologjia e Sokratit, Kritoni, Evthifro, Fedoni, Simpoziumi, etj). Po ashtu shkrimet e Aristotelit, të sokratikëve minorë, të Aristoksenosit dhe më vonë të Diogjen Laertit.

Poema e Lasgushit, e shkruar më 1975 e pa dritën e botimit më 1990, është trajtuar nga Sabri Hamiti në Kosovë, Moikom Zeqo, Faslli Haliti, Aristotel Mici dhe ndonjë tjetër. Mungojnë studime të mirëfillta, vetëm artikuj shkencorë, ku disa mjaftohen me përmendjen e poemës. .

Poema ka parahistorinë e vet. Moikomi përmend një dystrofësh ku Lasgushi flet për Sokratin në një letër të dërguar nga Grac:

“Do ta pi të shkretën kupë

Siç e piu Sokrati plak”

E njëjta gjë përsëritet në një poezi me titull “Kush ma njohu dhembshurinë” të botuar në përmbledhjen poetike “Ylli i Zemrës” më 1937. Poezia ka dhjetë strofa ku përfshihen edhe dy strofat e Grac-it me një ndryshim të vogël.

Petraç Kolevica tregon se Lasgushi e kish gjithnjë në gojë Sokratin. Në një bisedë me të, Lasgushi citon filozofin e lashtë se si janë poetët, edhe në prani të gruas së vet, Nafijes:

“Se ç’janë poetët, e shpjegon Sokrati, të cilin e pyetën se ç’ gjë të veçantë kanë poetët që shkruajnë këto gjëra të bukura? Njerëz janë..., por kur ata shkruajnë poezi, u qendron pranë një perëndi e veçantë dhe ata tjetërsohen e shkruajnë siç i mëson Ajo. Kur kjo perëndi largohet, ata kthehen sërish në njerëz si ne, si unë, si ti, si ai tjetri. Hanë, pinë, dehen dhe grinden siç grindemi edhe ne të dy”.

Më vonë, për vite të tëra, Lasgushi vijoi të merret me Sokratin dhe shkroi një poemë për të, tepër të ngjeshur në mendime filozofike. Sokrati në historinë e filozofisë gëzon një emër të madh dhe ka pasur një ndikim të padiskutueshëm. I madhi Lasgush dinte ç’bënte që i kushtonte vëmendje këtij filozofi më të shquar të gjithë shekujve! Për këtë e ndihmonte kultura e vet filozofike, dijet e gjithanshme enciklopedike. Autoriteti i Sokratit ishte i tillë sa historianët i ndajnë filozofët e lashtë në parasokratikë dhe pas-sokratikë!

Platoni ishte nxënës i Sokratit, Aristoteli nxënës i Platonit etj. Sokrati ka ndikuar fuqishëm te Thoma Akuini, te iluministët, pozitivistët, prag-

matistët, ekzistencialistët, strukturalistët, neopozitivistët (logjikë e linguistikë), frojdistët etj

Njëri syresh, Karl Jungu, është parë në një podium duke folur, me bustin e Sokratit në krah të tij. Në historinë e filozofisë perëndimore në katër vëllime, Bertrand Rasëlli e çmon shumë Sokratin, “që sot ndriçon nga errësira e shekujve!”

Në një leksikon të filozofisë, në zërin “Sokrati Athinas” nënvizohen dy qëndrime të kundërta për Sokratin në historinë e filozofisë. Iluminizmi e konsideron atë si pararendës të Krishtit dhe intelektin më të lartë moral dhe filozofik të antikitetit. Ndërsa Niçe përpiqet ta shpallë mbretërinë e koncepteve absolute të Sokratit si mashtrimin më të madh në historinë e kulturës njerëzore që e gjymtoi, e moralizoi dhe e varfëroi kulturën e pasur antike dhe më vonë i errësoi parasokratikët.

Më vonë po ky Niçe do tërhiqej nga ky qëndrim dhe Sokratin do ta radhisë në njerëzit e veçantë të historisë së njerëzimit, krahas personaliteteve të tilla si Napoleoni etj që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në histori.

Emri i Sokratit përdoret rëndom në jetën tonë. Ne themi se ai është “Sokrati i Parisit bashkëkohor” duke e nënkuptuar si emër i ertësisë dhe figurë mbizotëruese jashtë politikës. “I ngjante një Sokrati të skenës së bashkë-pirjes” (të vdekjes së Sokratit në prani të miqve të vet-autori). Ose “Edhe i ati ashtu si i Sokratit ka qene gurëgdhëndës”- janë shprehje që provojnë sa thellë ka hyrë figura e Sokratit në jetën tonë. Guido Sonuvilla pat thënë në varrimin e At Zef Valentinit “Sa herë u shpjegoj Sokratin nxënësve të mij të liceut, unë e përfytyroj atë në portretin e At Valentinit”.

Edhe shkrimtarët tanë të shquar të fundit të Rilindjes dhe të kohës së Pavarësisë (Çajupi, Asdreni, Noli, Konica, Gjeçovi, Migjeni etj.) përfshi Lasgushin, e kishin Sokratin një emër shumë të lakuar. Për shembull, Faik Konica në kryeveprën e vet “Doktor Gjilpëra” (1924) flet për një intelektual shpirtëror të shkolluar në Perëndim, Dr. Gjilpërën (në fakt vetë Faik Konica- autori) me një kulturë e shije të hollë në arte e letërsi, një qytetar i botës, duke dashur t’u shëmbëllejë të mëdhenjve që adhuron, Sokratit dhe Gëtes, kthehet të njohë e të ndihmojë vendin e vet, i bindur se mund të bëhet i madh edhe në vendin e vet. Sh. Gjeçovi

ka shkruar në Rubik më 6 Korrik 1921 “Përkthimi i Fjalëve të Urta të Sokratit” (Dorëshkrimi ndodhet në Arkivin Qendror të Shtetit, Fondi 58, Dosja 63, Dok. 1-9). Ndërsa Migjeni, njëri nga novelistat apo skicat e veta letrare e titullon “Sokrat i vuajtur apo derr i kënaqur”.

Le t’i kthehemi poemës së Lasgushit për Sokratin.

Merita e këtij filozofi është se e zbriti në tokë lëndën e filozofisë antike (pra më e gjerë se ajo greke).

Ti filozofinë antike

O Sokrat me tru në kokë

Që prej qiellit e zbritë

Krejt përposh këtu në tokë

Këto fjalë ngjasojnë shumë me thënien e Ciceronit fisnik, sipas të cilit “Sokrati e sollti filozofinë nga qielli në tokë, pa u druajtur ta paraqiste atë nëpër tregje e bujtina”

S’është çudi që Lasgushi ta ketë marrë nga Cicero këto ide. .

Poshtë krejt në këtë tokë

Zbritë ti filozofinë

Që ajo të studiojë

Tokën, jetën e njerëzisë.

Sokrati, sipas Lasgushit, u mor edhe me moralin dhe drejtësinë. Në qendër të tyre ai vë Njeriun e veç njeriun. Dija të ishte për moralitetin dhe ligjshmërinë. Morali të ishte i pastër dhe i painteres, t’i shërbente drejtësisht njerëzisë, shoqërisë, pa dallim gjithë kolektivit shoqëror. Të mos qe moral shfrytëzues që rrjep e zhvat.

Pas filozofisë dhe moralit, Sokrati u mor edhe me fenë, në atë kohë politeiste pagane, me shumë zotër. Në Greqinë e vjetër kryezot qe Zeusi.

Periudha kur jetonte Sokrati po shënonte kalimin nga rendi fisnor në një rend më të lartë, atë skllavopronar dhe nga fetë politeiste në atë monoteiste. Në kritikën ndaj fesë zyrtare me shumë perëndi, shohim te

Lasgushi kritikën nga pozitrat e Krishtëritimit. Lasgushi citon vargjet biblike kundër adhurimit të idhujve, të cilat i vë në gojën e Sokratit.

Psalmi 38-39:

*“Kanë gojë, po nuk flasin, kanë sy po nuk shohin,
Kanë duar po nuk prekin, kanë këmbë po nuk ecin”.*

Ja vargjet lasgushiane:

*Kanë gojë e s’flasin dot,
Kanë sy po nuk shikojnë,
Kanë këmbë po nuk ecin,
Veç në vend ata qëndrojnë. ”*

Pasi vjen te feja, Lasgushi rendit në “Ekskursionin teologjik të Sokratit” katër linja. Dy janë të pushtetit laik, kryeshtetari dhe kryegjyqtari dhe dy lidhen drejt me fenë, kryepriifti dhe populli i thjeshtë, që nën shembullin e tre të parëve beson në zot e perëndi dhe u falet statujave të tyre, të derdhura në ar, argjend e fildish.

Studiuesit Sabri Hamiti nuk i ka shpëtuar edhe një veçori e poemës për Sokratin- terminologjia e përdorur. Kjo është e natyrshme, se aty merret me një filozof, me filozofi dhe teologji. Sipas Hamitit, Lasgushi përdor një fjalor të paparë që ka të bëjë me debatet për idetë, ideologjitë dhe nomenklaturat pushtetmbajtëse dhe synimit për kërkimin e të vërtetës absolute.

Ja disa syresh: Frymë, Ide, Zot, Moral, Drejtësi, Moralitet, Dije, Ligjshmëri, Njerëzi, Shoqëri, Kompromentim, Pronë, Konstatim, Teologji, Filozofi, Ideologji, Art, Poezi, Dituri, Antife, Demaskim, Kryeparësi, Histori, Mitologji, etj.

Njëkohësisht kështu Lasgushi pasuron edhe fjalorin e shqipes me terma filozofikë dhe format e ndryshme të përdorimit të tyre. Mund të mirret shembull me këtë rast se si nuk duhen përdorur fjalët e huaja pa kriter e me tepri në terminologjinë filozofike. Lasgushi është përpjekur t’i shqipërojë ato apo të gjejë të barasvlefshmit nga shtrati burimor e brumi i shqipes. Ai thotë, ta zemë “filozofisht” etj.

Aristotel Mici, në një studim për Lasgushin, duke iu referuar një studiuesi amerikan, thotë se Sokrati flet si një çlirimtar modern i qytetëruar i të gjitha kohëve moderne. Ai nuk është vetëm një filozof i anti-

kitetit por një mendje universale që ka qendruar në shekuj për shkak të logjikës së tij të hekurt dhe guximit qytetar.

Në kundërshtim me qeverisjen e kohës, filozofi Sokrat nuk del si një grinjar për gjëra të vogla vetiake por për çështje madhore, për të drejtën, për të vërtetën, për lirinë. E, pra, çdo kohë ka shumë nevojë të ndriçohet nga Sokratët e vet!

Në Radion Shtetërore turke në vitin 1959 u dha një emision me titull “Vdekja e Sokratit”, ku nderohej filozofi mëndjendritur, që ushtronte veprimtarinë e vet që nga Parlamenti e deri në tregun e qytet -shtetit të Athinës.

Në anën tjetër të Atlantikut, dy autorë amerikanë, Irvin Edman dhe J. V.Stoun, botuan përkatësisht veprat e Platonit ku flitej edhe për Sokratin dhe “Gjyqin e Sokratit”, ku Sokrati paraqitet si dijetar që donte ndryshimin për të mirën e shoqërisë, që nuk bënte dot kompromise, që nuk bëhej kurrë vegël e shitur te qeveria. Njerëz të tillë që luftojnë padrejtësitë, kundërshtarë të tillë që prishin *status quonë*, natyrisht nuk pëlqehen nga qeveritë.

Në gjithë takimet që pati Sokrati me kryeshtetarin, me kryegjyqtarin dhe sidomos me kryepriiftin, Lasgushi na zbulon tërë prapaskenën e qendrimit të ujqëve të teologjisë, që mashtronin dhe gënjenin popullin e thjeshtë besimtar. Në bisedë me dhelpren, skilen e vjetër të fesë zyrtare, kryepriiftin, Sokrati merr propozim që të bëjë kompromis me fenë, por përgjigjia e tij është kuptimplotë se “për ne të diturit”:

“Feja jonë është trefish

Shkencë e art e poezi

Zoti ynë është njëfish

Ky quhet Dituri!”

Megjithë paralajmërimet kërcënuese të pushtetarëve të kohës e të priftit të madh se Sokrati po u prishte “qetësinë”, po u hapte punë, ky nuk u tërhoq nga veprimtaria e vet si filozof për të ndriçuar mendjet e njerëzve, sidomos të rinisë që e kish të ardhmen përpara. Atëhere, ata, të alarmuar, sipas poetit tonë, i thonë:

“Prap po i mohon Sokrat

Perënditë shtetërore

*Prap ti me ide të reja
Po zgjon masat popullore!”*

Më në fund, tre vetë të Parisë, gjyqtari Meleti, Aniti dhe Likoni e hodhën Sokratin në gjyq, sikurse marrim vesh nga thellësia e shekujve. Prapa akuzës zyrtare se Sokrati po “shpërfillte” perënditë shtetërore, po paraqiste perëndi të reja dhe po korruptonte moralisht rininë, duke e larguar nga parimet e demokracisë, fshiheshin tre arsye që objektivistët rëndonin mbi Sokratin. Kjo solli edhe dënimin me vdekje dhe martirizimin e tij.

Veprimi tradhtar i Alkibadit, nxënësi tradhëtar i Sokratit, i cili i këshilloi spartanët në luftën e tyre kundër Athinës.

Me rënien e Athinës, në krye të saj erdhi oligarkia tradhtarë, anëtarë kryesorë të së cilës kishin qenë shokë të ngushtë të Sokratit, si Kritia dhe Karmidi.

Sokrati tërthorazi ra në konflikt me shtetin, pasi kërkonte që në zgjedhjen e drejtuesve më të lartë shtetërore të mos përdorej shorti, por të vinin njerëz të përgatitur, profesionistë cilësorë e jo injorantë. Këto dhe disa qendrimet e tjera të Sokratit kur ai ishte në Parlament, e mbushën kupën dhe atë e hodhën në gjyq.

Apologjia e Sokratit në gjyq e dhënë nga Platoni, po edhe Ksenofoni, është e famshme. Atë e ka letrarizuar shkrimtari grek Kostas Varnalis. Tek ne atë e ka luajtur si monolog aktori i mirënjohur Mirush Kabashi, i cili ka pasur sukses me këtë edhe në Londër edhe në Athinë vetë. Vetë Sokrati, duke përjashtuar komediografin Aristofan me komedinë “Retë e Mëdha”, thotë se akuzuesit e tij ishin shpifësa dhe thashethemexhinj anonimë, po ashtu të tre firmëtarët e akuzës me gjyqtarin Meleti në krye.

Me mbrojtjen që bëri në gjyq dhe respektimin e ligjeve të shtetit për dënimin e tij, figura e tij martire kaloi në shekuj duke ardhur deri në ditët tona.

Në “Apologji” Sokrati thotë se fundi i tij dihet por fundi i akuzuesve të tij s’dihet si do të jetë. Fillimisht vdekja e Sokratit rëndoi mbi pasuesit e tij, të cilët u larguan nga Athina. Kjo ndodhi me Platonin që iku në udhëtim e u kthye pas disa vitesh. Por vdekja e tij si na vjen nga

historia e nga legjenda, u kthye në bumerang për akuzuesit e tij. Ata, nën presionin e masës së gjërë të athinasve që e kuptoi të vërtetën e vdekjes së filozofit Sokrat, ose u vetëdënuan dhe vranë veten ose u dëbuan përjetësisht nga Athina në internim.

Me poemën e tij Lasgushi i ka ngritur një monument madhështor filozofit Sokrat dhe nëntë strofat e fundit që do i citoj përbëjnë kulmin e poemës. “Një Sokrat në miniaturë” si Lasgushi i këndoi me frymëzim filozofit të madh të pavdekshëm të Antikitetit...

1.

*Dhe kështu në mes t' Athinës
Boci i madh Kryegjyqtar
Akuzon në gjyq Sokratin
Anti-Zot, antifetar*

2

*Kështu, me ndërgjegje t'ashpër
Merr vendim gjyqi - xhelat
I jep kupën e Zeherit
Të pamposhturit Sokrat*

3

*Kështu djajtë e bestytnisë
Kështu breshkat e moçalit
Vranë filozof Sokratin
Madhështorin Dre të malit.*

Ky është një himn për të dijshmin e Greqisë, gjenium Sokrat.

Shkrimtari humorist Gaqo Veshi, që e ka njohur nga afër poetin tonë Lasgush, një ditë më recitoi me pasion këtë strofë që më mbetet në mendje.

4

*“O Sokrat, Sokrat, Sokrat
Tunde tempujt e Greqisë
Nga përbindëshit mashtronjës
Ujqit e Mitologjisë”*

Në këtë strofë Lasgushi përsërit tri herë fjalën Sokrat dhe në dallim nga dy strofat e tjera ku përmend tri herë fjalën Sokrat dhe e nis vargun me pasthirmmat “Ah” dhe “Oh”, këtu përdor pasthirmmën “O”.

Pra kur ulërin më parë për vdekjen e tij tragjike prej gjeniu nga Ujqit e Teologjisë, tani kur e pësërit thotë Ujqit e Mitologjisë. Dhe jo më kot! Këta ujqër të Teologjisë u harruan, mbetën “na ishte një herë”, një përrallë, një mit, kurse Sokrati viktimë e tyre, u bë i pavdekshëm dhe emri i tij i kapërceu shekujt. Me O-në e famshme, poeti Lasgush ulërin në poezi për vdekjen e filozofit e dijetarit Sokrat me merita të jashtëzakonshme, që u vemë mbiemrin “sokratike”. Sot ne themi “metoda sokratike”, “morali sokratik”, “dialektika sokratike”, “drama sokratike”, “majevtika (arti i të lindurit) sokratike”, “shkollat sokratike”, etj. Madje edhe “Balli sokratik” si tipar fizik i tij! Fjalët vlerësuese të Platonit si “njeriu më i mirë, më i ditur, më i drejtë i kohës së tij”, të thëna në fund të dialogut “Fedoni” për vdekjen e Sokratit, pasi piu kupën me helm, i kemi pothuaj njësoj edhe te Lasgushi.

5

*Ti m' i miri, ti m' i urti
Ti m' i drejti i gjith Greqisë
Vdiqe përmes errësirës
Linde përmes historisë*

Forcat e errëta të kohës e mbytën këtë zë, se u prishte punë. Poeti Lasgush Vdekjen fizike të Sokratit e konsideron njëkohësisht Lindje, se ai u bë një simbol i madh në historinë e njerëzimit. A ka vargje më të fuqishme se këto:

6

*Qani male, qani fusha
Qaj ti, moj Greqi e Vjetër,
Qaj , o moj Evropa e Re
Se nuk vjen Sokrat tjetër.*

Njëri varg flet më shumë se tjetri, njëri më i fuqishëm se tjetri. Janë vargje mbresëlënëse të gdhëndura nga Lasgushi për një vigan.

7

*Jo se vjen dhe prap vjen
Vjen parreshtur ditë e natë
Vjen duke ndriçuar botën
Jo me fjalë po me shpatë.*

Do dalin të tjerë Sokratë që i kërkon koha në kushtet e reja

8

*Shkuan vjete dhe qindvjete
Shkuan edhe mijëra vjete
Të nderon Sokrat njerëzimi
Mirënjohës jet pas jete.
Pra, Sokrati ka fituar pavdekësinë.*

9

*Shkuan edhe fluturuan
Nëpër rruzullin pa anë
Ti Sokrat lind dhe rilind
Përmes botës anembanë*

Ka një kreshendo rritëse në këto nëntë strofa që e ngrenë filozofin Sokrat në piedestalin më të lartë. Sokrati tani është kthyer në simbol pavdekësie dhe i takon jo thjesht Greqisë por mbarë Botës, pra edhe Shqipërisë! Ai është frymëzim edhe për Lasgushin, “një Sokrat i vogël” i ditëve tona, që me penën e tij e gdhëndi monumentin e Sokratit në poezi! Në se shohim portretet e Lasgushit në fotografi e pikturë të bie në sy edhe balli i tij “Sokratik”?! A mund ta themi këtë? Pse jo? Lasgushi e kishte fizikisht një ballë të tillë të të *mençurit të madh, të të urtit të madh*, ndofta e të një *filozofi të madh*, që foli poetikisht.

“Thonë se unë s’merrem me vjersha sociale, poezia ime është apolitike- tha një herë Lasgushi- Unë di t’i bie vetëm violinës dhe asaj mundohem t’i bie mirë e më mirë!”

Dhe Lasgushi, për gati 50 vjet, nxorri nga duart e veta krahas poemës “Kamadeva” edhe një “margaritar” të tillë si “Ekskursion teologjik i Sokratit”, me vargje të gdhendura në mermer fjalësh! Me Sokratin filloi era e filozofisë me në qendër njeriun, që vazhdoi në shekuj me iluminizmin dhe ekzistencializmin e rryma si strukturalizmi etj.

“Gjyqi kundër Sokratit- shkruan profesor Alfred Uçi- ishte një krim i shëmtuar sepse humbi një gjeni i pazëvendësueshëm, por ishte edhe një ngadhënjim i një martiri të ndershëm që mbeti simbol i pavdekshëm, u bë një pishtar që ka ndriçuar dhe ndriçon nëpër shekuj rrugën e përkushtimit të njeriut ndaj së vërtetës, lirisë e drejtësisë”

Ndërsa Lasgush Poradeci, duke e evidentuar këtë figurë të shkëlqyer të mbarë njerëzimit si Sokrat Athinasi, tregoi veten, atë që thonë dy njohtësit e miqtë e tij më të afërt, Çabej e Kuteli, se ai është një kulm vigan

(Kuteli 1937) dhe një poet që “Shqipëria do t’ja falë një herë botës” (Çabej, 1929) dhe i cili ka për të zotëruar shumë kohë me hijen e vet lehtësinë dhe mendimin shqiptar (Kuteli 1937). Megjithë këtë, në fund të fundit, Lasgushi mbeti një rilindas i pandreqshëm. Rilindja-do të thotë ai- e bëri Shqipërinë “Shqipëri me shqiptarë”. Poezia e Lasgushit është një vijim i mëtejshëm i poezisë së Rilindjes. “Do të vijë një ditë- do thoshte Lasgushi-kur në dasmë...në vdekje...kur dollia do të fillojë me këto fjalë: Mos e pifshim këtë gotë në mos u bashkofshim me Kosovën!”

Një mësues i Kosovës, Shaqir Salih, që nga burgjet serbe kaloi te “Zëri i Amerikës”, në librin e vet “Rrëfime lirike” shkruan: U rrita në varfëri të madhe. Jetova vetëm 27 vjet në Kosovë në fshat. Por edhe pse larg saj, unë eci me të dora-dorës. E mora me vete si mall, si dhimbje, si amanet dhe si dëshirë të flaktë për të ndihmuar dhe për të nderuar siç ndihmon e nderon biri nënën e vet. Po të ishte gjallë Lasgushi, do të vjershonte: “*Fluturoi dhe shtegtari i fundit!*. Atdheu do të ketë nevojë gjithnjë për bijtë e vet shtegtarë!”

Po të ishte gjallë Lasgushi?! Si “nosit”, do të fluturonte nga liqeri e do të vinte të përshëndeste si Kosovën e çliruar tash 20 vjet, që s’e pa dot (iku shpirtëdjegur), ashtu edhe shqiptarët që e kujtojnë vazhdimisht atë dhe poezinë e tij. Edhe ne që jemi në këtë sallë, në këtë konferencë shkencore së bashku me të bijën, Marien midis nesh!

BIBLIOGRAFI

- Lasgush Poradeci, “Vepra Letrare”, Naim Frashëri, Tiranë 1990
Lasgush Poradeci, “Vepra 1”, Onufri, Tiranë 1999
Lasgush Poradeci, “Eminesku i injoruar dhe ideologjia e tij popullor-atdhetare”, Argeta, LMG Tiranë, 2009
Petraq Kolevica, “Lasgushi më ka thënë”, 8 Nëntori, Tiranë 1992
Eldon Gjika, “Cikli filozofik në poezitë e Lasgush Poradecit”, Naim Frashëri, Tiranë 2010; ribotim Zambak Tiranë 2014
Moikom Zeqo, “Lasgushi i Panjohur”, Erik, 2017
Dhimitër Pasko, “Shënime letrare” Grand Print, Tiranë 2007
Alfred Uçi, “Esse dhe Etyde filozofike- Estetike”, Dituria, 2015
Sabri Hamiti, “Letërsia moderne shqipe” Alb-ass, Tiranë 2002, ribotim i përpunuar UET Press, Tiranë 2019

Luan Topçiu, “Tekstualizëm dhe stil në poezinë e Lasgush Poradecit, Getic, Bukuresht 2000

Luan Topçiu, “Tradita moderne në letërsinë shqipe”, Zenit Edition, 2010

Aristotel Mici, “Meditime letrare”, Neraida, Tiranë 2016

Radyo Kultur Yayinlari, Emniyet Sandigi, Istanbul 1962

Sadetin Limani, “Kompendium filozofik”, Fan Noli, Tiranë 2012

Platoni, “Apologjia e Sokratit & Simpoziumi”, përkthyer nga Lazër Radi, Fakt, Tiranë 2010

Ali Jashari, “Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe”, Dudaj, Tiranë 2007

Brikena Smajli, “Simbolikë mitike e krijimit. Poezi shqipe, poezi europine”, UET Press, 2019

Fjalorë, botime të ndryshme filozofike dhe enciklopedi (shqip dhe në gjuhë të huaja)

TEKNIKA POETIKE E VARFËRIMIT TË QËLLIMSHËM

Poezia si zhanër ka si karakteristikë kryesore paraqitjen e fjalëve si të tilla, vënien në dukje të mundësisë së pashmangshme që fjala të flasë për veten. Kjo do të thotë se ciladoqoftë referenca jashtëgjuhësore e fjalëve, ekziston potenciali i një kthimi përmbys: ajo për çka flitet vlen vetëm si shkas pragmatik që fjalët të kenë prani, pra që çdo fjalë për një çast të ekzistojë “e paemërtuar nga emri i vet”, njësoj siç ndodh me gjësendet që janë të pranishme pavarësisht nëse u thërrasim emrin apo jo.

Kjo do të thotë që emërtimi i gjësendit, pra aftësia e fjalës për të thirrur një objekt univesal (koncept) apo një objekt individual (gjësend), të përdoret si gjendje neutrale e saj, në njëfarë mënyre si ekzistencë e fjalës jashtë ligjërit, në kuptimin që fjala nuk e interferon ligjërimin me praninë e saj, por i shërben ligjërit me funksionin e saj.

Zhanri i poezisë i nxjerr fjalët nga ky neutralitet duke i paraqitur fjalët jo si emër i diçkaje jashtë tyre, por duke e paraqitur çdo fjalë si emër (pavarësisht nëse fjala është emër, folje, përemër, ndajfolje etj.), si emër të vetvetes, njësoj si emrat e përveçëm.

Ky proces zhvillohet si një luhatje (tension dhe ekuilibër) mes semantizimit dhe desemantizimit permanent, luhatje që duke qenë permanente e bën semantizimin efekt anësor të ligjërit poetik.

Te poetika e Lasgush Poradecit, vërehet për herë të parë në poezinë shqipe kjo karakteristikë kryesore e zhanrit, sipas nesh sipas teknikës së varfërimit të vetëdijshëm të fondit të fjalëve dhe temave, në favor të një efekti totaliteti apo shterueshmërisë në aspektin e një kombinatorike të fjalëve si emra, që nuk tregojnë se çfarë ka jashtë tyre, por çfarë është e kombinueshme mes tyre.

1. Emrat e përveçëm

Ndoshta nuk janë aq të shumta praktikat ligjërimore ku fjalët, që si rregull emërtojnë diçka tjetër, të tregojnë të qenët e vet drejtpërdrejt, pra

masën dhe profilin tingullor që bën të mundur praninë e tyre. Por kjo nuk duhet të na bëjë të harrojmë që prirja e natyrës njerëzore për ta dëshiruar këtë efekt është një prirje bazike e përhershme dhe gjithmonë e mirëpritur, edhe pse jo gjithmonë e mbërritshme. Mund ta themi ndryshe këtë, duke e quajtur fjalën kur ajo emërton një koncept a gjësend emri i gjësendit dhe kur emërton veten, pra transmeton zbrazëtinë e vet kuptimore dhe plotësinë e saj tingullore, duke e quajtur emri i fjalës.

Kur ndodh ky fenomen, fjala nuk shërben më si operator që ndërlidh të brendshmen me të jashtmen (vëzhgueshmërinë me përjetueshmërinë), por si ancorë që e lidh ekskluzivisht me jashtësinë qenien njerëzore në kontakt me të. Sepse ajo që më së shumti në këtë rast, shkakton një efekt të jashtëzakonshëm tek qeniet njerëzore, është përballimi me faktin që vetë fjalët nga një gjë amfibe (njëherazi e brendshme, edhe e jashtme), shndërrohen në një gjë vetëm e jashtme, krejt të çliruara nga mundimi për t'u endur në përjetueshmëri në kërkim të një kuptimi potencial, sepse me jashtësinë e vet akute, na dhurojnë qartësinë që e vërteta për nga natyra është jashtë dhe jo brenda nesh dhe për pasojë mund të mbërrihet jo vetëm përmes koncepteve së brendshmi, por edhe mund të preket prej shqisave së jashtmi. Kjo mundësi për ta realizuar kontaktin me të vërtetën aty ku ajo e ka selinë e saj (pra ekskluzivisht jashtë njeriut), përmes përtëritjes së kapacitetit shqisor (dhe jo përmes detyrimit që ky kontakt të realizohet përmes punës enkoduese dhe dekoduese të koncepteve), është në thelb arsyeja e ekzistencës së poezisë së pastër, të ligjërimit poetik në vetvete.

Pasi bindemi për saktësinë e çfarë sapo thamë më sipër, atëherë ajo që duhet të shqyrtohet pashmangshmërisht, është zbulimi i mekanizmave që e bëjnë të mundshme që fjalët të jenë vetëfokusuese dhe për pasojë ligjërim vetëm i jashtëm.

Në veprën tonë “Zhanret si shprehje ligjërimore dhe transfiguruese tërësisht të jashtme”, ne kemi treguar sesi në ligjërimin njerëzor, moduli bazë, i cili mundëson brenda gjuhëve natyrore një praktikë ligjërimore thelbësisht të jashtme, është kategoria e emrave të përveçëm.“ Pra fjalët e një gjuhe, përfshirë mbi të gjitha klasën e madhe të emrave, nuk

mund të ekzistojnë veçmas nga koncepti, e për pasojë ato kanë gjithmonë një natyrë të brendshme.....”

Por “Nga ky kushtëzim shpëton vetëm klasa e emrave të përveçëm, të cilët ekzistojnë jo si emërtime mesatarizuese mes konceptit dhe gjësendit, por ekzistojnë veçmas dhe pavarësisht çdo koncepti, të lidhura drejtpërdrejt me trajtën akustike që i përfaqëson sëjashtmi (...). Një emër i përveçëm për këtë arsye nuk është i paraprirë as nga gjësendi singular që emërton, që do të thotë se ekziston edhe veçmas dhe pavarësisht gjësendit singular (.....). Dhe ku ekziston? Jo brenda (atij nuk i korrespondon një koncept)..... por jashtë, i strehuar në kufijtë zanorë (jo si figurë akustike por si akustikë e figurativizuar) dhe i konfirmuar nga historia, pjesë e së cilës ose është, ose bëhet.

Në këtë kuptim emrat e përveçëm janë forma boshe -ose maska- të cilat nga përsëjashtmi i mbivendosen gjësendeve singolare, duke e shkëputur singularitetin e tyre nga çfarëdo përgjithësimi. Emri dhe personi janë pra që të dy të jashtëm dhe takohen me njëri – tjetrin së jashtëmi. Dhe kjo mënyrë sesi ekzistojnë emrat e përveçëm, pra si ligjërime i jashtëm, tregon se çfarë patëm parasysh kur supozuam se poezia si zhanër, në thelb përfaqëson mundësinë e ekzistencës së të gjithë gjuhës si ligjërime i jashtëm.”⁴⁴⁵ Edhe poezia në historinë e saj si zhanër, s’bën tjetër veç asaj që bëjnë emrat e përveçëm në ligjërimin natyror, duke kultivuar tre teknika të përhershme bazë që bëjnë pashmangshmërisht veprues ligjërimin tërësisht të jashtëm në poezi. Këto teknika janë enumeracioni, perifraza dhe idioma të cilat ne po ashtu i kemi përshkruar në këtë veper, dhe që do përpiqemi të tregojmë se i gjejmë dominuese në poetikën e Lasgushit.

2. Një mundësi në katër, apo teknika e dyfishtë e varfërimt të qëllimshëm

Një nga gjërat që vëren pa u sforcuar një lexues i poezisë së Lasgush Poradecit, është repertori i ngushtë tematik (kryesisht poezi dashurie, një grusht peizashesh dhe edhe më të pakta poezitë metafizike). Por ajo që bie në sy gjithashtu është edhe fondi i kufizuar i fjalëve (leksemave), shoqëruar me faktin e pritshëm që pjesa më e madhe e këtyre të njëjtave fjalë përsëriten pothuajse pandërprerë në poezitë dhe strofat e

⁴⁴⁵ Zhanret si shprehje ligjërimore tërësisht të jashtme , f.111 – 112.

kësaj poetike, madje jo vetëm kaq, por në njëfarë mënyrë duket së kemi përsëritje *en block* të grupeve të njëjta të fjalëve, në mos të njëjta të përfaqëta.

Ne e përshkruam këtë dukuri me termat ngushtim apo kufizim, apo më lart madje, varfërim, por duke qenë ky varfërim i qëllimshëm, me siguri që mund ta quajmë këtë një gjest përfundimtar përkorjeje – abstinence, për të hequr dorë nga e shumta me qëllim për të hedhur dritë të plotë mbi të paktën.

Në fakt çfarë ndodh kur temat përsëriten, madje në njëfarë mënyre është vetëm një a dy tema që ripërsëriten ciklikisht? Pashmangshmërisht një praktikë e tillë ligjërimore sugjeron se kjo temë, ky shqetësim është e vetmja gjë e rëndësishme, është e vetmja brengë që nuk rrezikon të jetë e kotë, është e mjaftueshme që e vetme të përmbledhë gjithë aspiratat e qenies. Dhe kjo teknikë e varfërimit të qëllimshëm të temave, mund të realizohet në rrafshin formal të ligjërimit ose duke patur një marrëdhënie intensive me të gjithë fondin potencial të fjalëve të një gjuhe, duke e rritur, pasuruar pandërprerë numrin e fjalëve në kontakt, ose duke e përsëritur (në njëfarë mënyre duke e klonuar) edhe në rrafshin e formës, të njëjtën procedë tashmë të përdorur në rrafshin e përmbajtjes, pra duke rimarrë teknikën e varfërimit të qëllimshëm të fondit të fjalëve.

Ne besojmë në fakt tek një paradoks: si pasurimi eksponencial i fondit të fjalëve, si teknika e varfërimit të qëllimshëm, janë dy anë të së njëjtës medalje, pra që kur realizohen me virtuozeitet, sugjerojnë të njëjtën gjë: që ekziston vetëm një brengë që ia vlen, relacioni mes qenies dhe ligjërimit, relacion që kulminacionin e vet e mbërrin në ndërkëmbueshmërinë mes tyre.

Dhe është e qartë që poetika e Lasgush Poradecit e ka refuzuar ndershmërisht mundësinë e begatisë së pambarimtë të shumësisë së fjalëve (të temave po e po), duke zgjedhur po ashtu ndershmërisht, mundësinë e dytë të rimarrjes së papërtuar të të njëjtit fond fjalësh të pakta. Në fakt me siguri që ekzistojnë edhe dy mundësi të tjera, përveç këtyre që ne i quajmë më lart dy faqe të së njëjtës medalje, pra mundësia e shumësisë së temave trajtuar me një numër limit fjalësh-çelsa (në këtë rast fjalët do të kondensoheshin krejtësisht si koncepte, por që në fund do të su-

gjeronte se edhe konceptet s'janë tjetër pos shenja vetëm se të një rendi tjetër); dhe po ashtu mundësia e trajtimit të një numri paraprakisht të limituar temash me një fond të palimit të fjalëve. Kështu nga metafora e dy faqeve të një medaljeje, do të ishte më e saktë të kalohej tek metafora e katër faqeve të një kubi (një kub ne e dimë vetëm teorikisht se ka gjashtë faqe, sepse në praktikë, në kohë reale, ne arrijmë të perceptojmë vetëm katër prej faqeve të tij).

Dhe brenda kësaj metafore, a kësaj skeme me katër mundësi, poetika e Lasgush Poradecit është shembulli i madh i poezisë shqipe, shembulli i poezisë së madhe të përfutur nga varfërimi i qëllimshëm, i dyfishtë, pra i temave (*dashuria + brengën dhe ëndjen*, që të dyja ekstatike; *qenia + vetminë dhe paplotësinë*) dhe i fjalëve: të njëjtët ata pak emra, të njëjtat ato pak folje, të njëjtat ata pak diektikë.

(Mund të statistikohen automatikisht: zemër, dhembshuri, dashuri, bukuria, fshehtësi, zemërim, vuajtje, i gjurë, yll, vashë, sy, dorë, buzë, kujtim, mall, lot, puthje, liqen, dëborë, i ëmbël, i llahtaruar, prapë, pra, as, ndaj, vetë; me siguri që kaq janë vetëm një grusht fjalësh dhe me siguri që ky është një glosar i mangët dhe do të mund të shtonim edhe njëherë apo dyherë apo tre herë aq, po në fund është po e njëjta, një pakicë e qëllimtë fjalësh të privileguara).

3. Emra dhe diektikë

Por ne mendojmë se radikalizmi i kësaj zgjedhjeje shtrihet edhe në një nivel tjetër më të thellë, në nivelin e organizimit kategorial– ontologjik të gjuhës njerëzore, gjë që do përpiqemi ta paraqitim në vijim.

Siç e përmendëm që në fillim, ky efekt i jashtëzakonshëm i përfutur nga varfërimi, e ka origjinën tek thelbi i poezisë si zhanër, pra tek mundësia e ekzistencës së fjalëve të vetmuara, pra të paasociura njëherazi as nga gjësendet (referentët), as nga konceptet (të shenjuarit), pra ekzaltimi i fjalës në pastërtinë e materialitetit të vet tingullor si shenjë, dhe të inercisë sinjalistike, po ashtu dhe përfundimisht si shenjë, vetëm si shenjë.

Mundësia e ekzistencës së fjalës si shenjë e pastër është qëllimi më i lartë i poezisë si zhanër, mundësi që posa realizohet (jo gjithmonë, por në ato herë fatlume kur mbërrihet) implikon që në fakt, posaqë ekziston mundësia të ketë vetëm shenja dhe jo më të shenjuar, atëherë ligjërimi në vetvete përbëhet vetëm nga emra dhe diektikë. Pra, kategoritë e

ligjëratës janë vetëm dy, Emri dhe Diektiku (fjalëzat për të lubrifikuar relacionet ndëremërore). Që do të thotë se ajo që ndodh si lëvizje apo si atribut, mund të shprehet gjithherë gjithsesi me emra (duke i bërë të panevojshme, të tepërta, foljet, mbiemrat e aq më tepër përemrat). Dhe që do të thotë po ashtu se fjala mund të ketë ekzistencë edhe e zhveshur nga kuptimi, pra një ekzistencë josemantike. Këtë patëm parasysh më lart kur thamë që fjala mund të jetë emri i një koncepti apo gjësendi, por mund të jetë po ashtu edhe emri i vetvetes, duke mbërritur tek termi i pashmangshëm emër i fjalës.

Dhe nëse do të kishim marrë si të mirëqenë që në fillim këtë pohim të fundit, do të kishte qenë po ashtu e mundshme të niseshim prej tij, pra ta merrnim si premisë, dhe të arrinim pashmangshmërisht në përfundimin, që poezia është një praktikë ligjërimore, ku është ruajtur kjo natyrë bazike emërore e tërë fondit të fjalëve, natyrë që është kapërcyer apo shpërndërruar nga praktikat e tjera ligjërimore njerëzore. (A mos do të thotë kjo se poezia është moduli i pastër dhe modulet e tjera ligjërimore janë korruptim i kësaj pastërtie?) Me siguri jo, nuk donim të thonim këtë, por që poezia është mundësia ligjërimore e ekzistencës së gjuhës si tërësi absolute shenjash, pra e ekzistencës së shenjave si të tilla në ligjërim, pra në akt dhe jo në fjalor, në *parole* dhe jo në *langue*; duke shërbyer si një mundësi e përhershme ripërtëritjeje përballë rreziqeve të rutinës, vrazhdësisë dhe sipërfaqësisë, prej të cilave kërcënohen praktikat e tjera ligjërimore. Duke qenë e vetmja praktikë ligjërimore josemantike, ajo shërben si kundërmodel ekuilibruës për tërësinë e trajtave ligjërimore semantike.

4. Seritë emërore, seritë foljore dhe seritë diektike

Poetika e Lasgush Poradecit gjenerohet nga këto mekanizma bazikë (zanafillorë dhe thelbësorë) që qëndrojnë në themel të marrëdhënies së fjalëve më njëra-tjetrën dhe të fjalëve më konceptet dhe të qenies njerëzore me fjalët dhe konceptet. Është kjo arsyeja që poetika e Lasgush Poradecit është një nga poetikat më të mëdha të shqipës duke e bërë në mos të pakuptimtë, të parëndësishëm dhe të padëmshëm diskutimin nëse është ai poet.

Gjithë sa thamë na ndihmon drejtpërsëdrejti të kuptojmë teknikën bazë që mundëson efektet e jashtëzakonshme të poezive të tij në shqip. Nga

sa më lart, ne jemi duke sugjeruar se poetika e tij është poetika e parë e rëndësishme në shqip, që strukturoi konsistencën e natyrës desemantizuese të poezisë si zhanër. Në një rrafsh më konkret dhe për pasojë më teknik, në rrafshin e fjalisë, kjo do të thotë se fjalia është ai inert ligjërimor që përputhet me kapacitetin semantizues të ligjëritimit. Fjalia klasike përbëhet nga dy rubrika të përhershme, *rema* dhe *këpuja*, që është një format që sugjeron se në thelb çdo fjali mundëson shtimin e informacionit për një gjësend apo koncept të dhënë paraprakisht. Format që historikisht është proceduar si një njësi emërore që ftillohet përmes një njësie foljore apo mbiemërore, duke bërë të pashmangshme që ky shtim informacioni të jetë në funksion të rritjes së kuptimit.

Dhe ne nuk mund të mos vemë re se ky format klasik i fjalisë është periferik në tërësinë frazale të poezive të Lasgush Poradecit. Pra, fjali të tilla, ku një emër paraprak shoqërohet nga akte apo attribute që paraqesin vlerën apo kuptimin e tij, janë të pakta dhe në njëfarë mënyre aksidentale apo të improvizuara, thënë ndryshe: njëherazi të pasyruara dhe të pashmangshme. Kemi parasysh “se nuk dashuroja as unë as ti, por dashuronte dashuria” apo “se kish kuptim që s’kish kuptim” apo “fluturoi dhe shtërg i fundit, madhështor me shpirt të gjorë” etj., capak të tjera. Është e vërtetë që pikërisht të tilla vargje janë shndërruar në emblemë të poetikës së tij, por kjo nuk do të thotë se kjo poetikë është këto va-rgje, por e kundërta: duke qenë të vetmet ndër të paktat fjali me remë e këpujë, që sugjerojnë një kuptim-semantizim të ripërtërirë, ato duke qenë të pakërkuara, shfaqen si një dhunti e jashtëzakonshme dhe e pa-pritur brenda korpusit të tij poetik.

Mund të bëhet e pranueshme çka sapo thamë nëse paraqesim si argument konstatimin se teknika më e përhapur në poetikën e tij është teknika e përdorimit serial të emrave, foljeve dhe dietikëve. Kemi parasysh sesi në mënyrë këmbëngulëse dhe masive fondi frazal i poezive të Lasgush Poradecit përbëhet nga fjali me anulim, apo sëpaku mjegullim, të kufijve mes remës dhe këpujës, që realizohet duke përdorur njëpasnjëshmërisht, ose një seri emrash (pa folje), ose një seri foljesh (pa emra), ose një seri dietikësh. Procedë të tilla gjejmë tek pjesa më e madhe e poezive të tij, si tek “Përse të dua”, “Zemra”, “Durimi” “Pamja”, “Syt’e lumtur”, “Ritornel”, “Kujtimi”, “Dëgjimi i zemrës” etj. Në

të gjitha këto raste, fjalia pushon së organizuari me një remë, si rregull emërore, dhe një këpujë, si rregull foljore a mbiemërore, por fjalia organizohet si një strukturë asimetrike, e hapur dhe me homogjeni atipike, qëllimi i së cilës nuk është të instrumentalizojë fjalët duke shtuar informacion, por të ripërtërijë marrëdhëniet me fjalët si të tilla pavarësisht çdo informacioni.

-Seri emërore.

“Zemra e shokut”:

Të kam shok nga kohë e vjetër/shok prej zemre dhe prej gjaku/ shok të ri e me besë plaku/ nuku kam nuku ke tjetër.

Kjo është një serti e pastër emërore, e pastër edhe pse duket se ndotet nga folja kam, por në rrafshin ligjërimor folja kam është në thelb një parazit sepse Të paturit është gjithmonë i nënkuptuar dhe s’ka nevojë të shprehet medoemeos me fjalë (mund ta heqim nga fillimi i strofës dhe nuk çënohet vlera dhe arsyeja e asaj që thuhet). E njëjta gjë është edhe për foljen jam, duke qenë edhe jo gjithmonë e nënkuptuar mundet edhe të mos shpehet, të mos formulohet shprehimisht. Nuk është rastësi në fakt që në poezitë e Lagush Poradecit folja jam praktikisht mungon, me aq sa mund të verifikohet në mënyrë të shpenguar dhe sigurisht joshterues, në një bllok prej rreth tridhjetë poezish rezulton të përdoret vetëm një herë tek “Dora jote ledhatarja”:

Dora jote ledhatarja është e zbehtë si qiri.

“Vallja e yjeve”:

Dashuri heu mall i ri/dashuri këngë e durimit/ti liri,ti robëri/ti valim i shkrepletimit.

“*: Zemër lule e verë/gas e vrer përherë/zemër kopsht me erë/zemëra-skëterrë.*

-Seri foljore.

“Dëgjimi i zemrës”:

Kur të më kujtosh/kur të vish të shkosh/kur të shkosh këtejza pranë/që të çmallërosh.

“Përse të dua”:

Se të desha vetë,/dhe t’u ngasa vetë/ dhe të putha vetë.

“Kujtimi”:

Edhe në mungove/edhe në ndryshove/ edhe në dredhove/në më gjarpërove.

“Pamja”:

Sot u pamë e sot u ndamë/dhe nuk thamë asnjë fjalë/kur u ndamë vamë e qamë/qamë shpejt ca lot me valë.

Të gjitha këto seri foljore pa dyshim që janë shprehje e refuzimit të fjalisë klasike me remë e këpujë, por mbi të gjitha janë shprehje e faktit që foljet janë thjesht fjalë të tepërta, sepse ajo që ato tregojnë mund të reduktohet në një thelb që shprehet me emër (ndërkohë që emri në vet-evete është i pareduktueshëm). Kështu, strofa e e parë e poezisë “Pamja” që sapo cituam më lart, në thelb mund të shprehet vetëm me emra: *Njohja (sot u pamë) – Ndarja (e sot u ndamë) – Heshtja (dhe nuk thamë asnjë fjalë) – Vajtimi (qamë shpejt me ca lot të valë)*. Sigurisht që si poezi ajo ekziston si seri foljore dhe jo si seri emërore por vetëm donim të thoshim që seritë foljore bëhen të mundshme vetëm si refleksi i ekzistencës paraprake të serive emërore, gjë që është e verifikueshme për çdo rast sipas shembullit që sapo dhamë.

-Seri diektike.

“Zemra”:

Ha, tek bëj kështuzë/hop të shoh këtuzë/ha tek bën ashtuzë/hop buzë për buzë. Kjo nuk është një seri foljore por diektike, pasi që foljet *bëj e shoh* janë jodomethënëse dhe të sfumuar nga intensiteti i pjesëzave, pasthirrmave dhe ndajfoljeve që e dominojnë tërësisht strofën.

Në fakt poezia “Zemra” është e ndoshta më tipkja, pasi të pesta strofat e saj janë seri kategoriale të njëjta:

Strofa e parë – seri foljore: *Bëj e rri mendohem/të mos të afrohem/bën e rri mendohesh/ të mos më afrohesh.*

Strofa e dytë – seri foljore: *dhe rri bëj e bëjmë/mos të shkoj andejnë/dhe rri e bën bëjnë/mos të shkosh këtejne.*

Strofa e tretë – seri diektike (e cituam më lart).

Strofa e katërt – seri diektike: *Pa më puth njëherë/ të të puth dy herë/pa më puth dy herë/të puth tridhjetë herë.*

Dhe e gjithë kjo e bën poetikën e tij një poetikë të çmuar në rendin e poezisë së madhe enumerative, sipas kritereve që i kemi paraqitur tek punimi ynë“ Zhanret si shprehi ligjërimore dhe transfiguruese tërësisht

të jashtme”. Aty ne e kemi paraqitur organizimin enumerativ si teknike desemantizuese, gjë që vërehet në zemër të poetikës së Lasgush Poradecit, sepse seritë emërore, seritë foljore dhe seritë diektike të fjalive jokëpujore dhe sidomos dy seritë e fundit, bëjnë të mundshme atë që thamë që në fillim: në marramendjen e rikthim ciklik të të njëjtave fjalë e fjalëza, ato e humbasin peshën e tyre semantike (pra të të qenit emër i konceptit a gjësendit) dhe kondensojnë vlerën e tyre ikonike, duke u shfaqur si emër i vetes. Për publikun e një poezie të tillë ky është ngashnjimi më i madh, pra të përfshihet në një marrëdhënie ligjërimore ku në një kohë reale fjalët shndërrohen pandërprerë në emra të fjalëve. Për ta mbyllur, shpresojmë të ketë qenë e qartë dhe e besueshme, nga sa paraqitëm, sesi poetika e Lasgush Poradecit, gjenerohet nga një modul primordial i trefishtë i varfërimit të qëllimshëm: pra ngushtim dhe kufizim i fondit të temave, ngushtim dhe kufizim i fondit të fjalëve dhe ngushtim dhe kufizimi i rendit të kategorive ontologjike të ligjëratës. Me këtë konstistencë të shquar procedurale, kjo poetikë si çdo poezi e madhe na mundëson që përmes ligjërimit poetik të përfshihemi në përvojën primordiale të një marrëdhënie të pastër me fjalët të pakontaminuar nga vlera e tyre e përdorimit. Vetëm për aq sa një përvojë e tillë, i bën të mundshme qenies njerëzore të ripërtërijë marrëdhënien e vet me veten dhe botën dhe të parandjenjë një tjetër lloj ekzistence dhe mënyre të qeni të gjërave, vetëm për kaq poezia si shprehi ligjërimore e për ligj nevojën tonë për të.



Lasgum Goradei

ISBN: 978-9928-4568-4-7